

ENVER HOXHA

VEPRA


56

PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TE PPSH

ENVER HOXHA

V E L L I M I

56

NËNTOR 1975 - MARS 1976

SHTËPIA BOTUESE "8 NENTORI"
TIRANË, 1987

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 56-TË

Vëllimi i 56-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përmban materiale të periudhës nëntor 1975 — mars 1976, shumë prej të cilave botohen për herë të parë.

Një pjesë e mirë e materialeve të këtij vëllimi përmbajnë probleme të zhvillimit ekonomik të vendit dhe të politikës që ka ndjekur Partia për zgjidhjen e tyre. Nën udhëheqjen e Komitetit Qendror, masat punonjëse, me komunistët në ballë, mbyllën me sukses planin e vitit 1975, viti i fundit i pesëvjeçarit të pestë, dhe nisën me guxim e optimizëm revolucionar punën për realizimin e pesëvjeçarit të gjashtë. Lufta me vështirësitë dhe me pengesat e karakterit objektiv e subjektiv, vendimet e Plenumit të 7-të të KQ të Partisë, masat që ndërmoi Partia pas shkatërrimit të veprimtarisë armiqësore të Abdyl Këllezit e të Koço Theodhosit në ekonomi dhe orientimet e shokut Enver Hoxha e pasuruan më tej përvojën e ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Në mënyrë të veçantë, në këtë vëllim shtrohet me forcë domosdoshmëria e përsosjes së organizimit, të drejtimit dhe të planifikimit të ekonomisë në mënyrë shkencore, për të siguruar vazhdimësinë e zhvillimit socialist të vendit, duke u mbështetur në forcat tona. Në mbledhjet e Byrosë Politike më 25 dhjetor 1975 dhe 26 shkurt 1976 shoku Enver Hoxha ndalet në një varg

problemesh të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë: të minierave, të asaj elektrike, të ndërtimeve, të bujqësisë etj. dhe jep orientime të qarta e të vlefshme për realizimin e detyrave dhe për kapërcimin e vështirësive në këta sektorë. Duke kritikuar drejtuesit e atëhershëm të Ministrisë së Bujqësisë, që nuk i kishin ndjekur në bazë të vijës së Partisë problemet kyç të këtij sektori, shoku Enver Hoxha udhëzonte të luftoheshin shfaqjet e subjektivizmit e të spontaneitetit, dhe komunistët, punonjësit e kuadrot të përvetësonin mirë orientimet e Partisë për bujqësinë, të zbatonin si duhet e ritmikisht detyrat e caktuara dhe të ngulnin këmbë për arritjen e rendimenteve më të larta në prodhimet bujqësore e blegtorale.

Qëllimi i Partisë ka qenë dhe mbetet plotësimi sa më mirë i nevojave të ekonomisë dhe rritja e mirëqenies së popullit. Këtij qëllimi do t'i shërbente edhe ecja drejt mbylljes së gërshërës në nivelin e jetesës mes punonjësve të qytetit e të fshatit. Shoku Enver Hoxha jep ide shumë të rëndësishme për rregullimin e pagave dhe për marrjen e disa masave favorizuese për fshatin e për kooperativistët.

Në vëllim nënvizohet ideja se përballimi me sukses i detyrave të ngjeshura ekonomike kërkon përsosjen dhe revolucionarizimin e pandërprerë të punës së Partisë, rritjen e efektivitetit të saj. Komunistët, dhe veçanërisht ata që janë zgjedhur në forume, porosit shoku Enver Hoxha, të veprojnë shpejt e me iniciativë dhe të luftojnë qëndrimet e mefshta për zgjidhjen e problemeve. Kjo kërkon që ata vetë të jenë në rolin pararojë dhe shembull për të gjithë punonjësit. Komunistët, thekso-

het në vëllim, krahas punës së përditshme duhet të përpigjen edhe për zgjerimin e horizontit të tyre kulturor nëpërmjet studimit të vazhdueshëm të teorisë marksiste-leniniste, të historisë e të kulturës së popullit etj.

Mësimet e rëndësishme dhe me vlera aktuale gjenden në materialet e këtij vëllimi edhe për përsosjen e veprimtarisë së levave të Partisë e sidomos të organizatave të bashkimeve profesionale. Puna kryesore e tyre, thekson shoku Enver Hoxha, është edukimi komunist i punonjësve. Që ta kryejnë sa më mirë rolin e madh që kanë, bashkimet profesionale nuk duhen mënjeluar dhe nuk duhen penguar në ushtrimin e funksioneve e të kompetencave të tyre; ato të sigurojnë udhëheqjen kolegjiale dhe bashkëpunimin e ngushtë me organizatat e tjera të masave, të bëjnë një jetë aktive, të gjallë e luftarake.

Detyra konkrete shtrohen në materialet e kësaj periudhe edhe për punonjësit e organeve të Punëve të Brendshme e të drejtësisë, prej të cilave kërkohet të sigurojnë në çdo hap rolin udhëheqës të Partisë dhe të mos e dobësojnë atë nën pretekstin se çështjet e tyre janë sekrete. Punonjësit e këtyre organeve, porosit shoku Enver Hoxha, duhet të punojnë në rrugë partie, duke i parë veprimet e tyre jo vetëm nga ana profesionale e teknike, por, në radhë të parë, ideologjikisht e politikisht, duke zbatuar me rigorozitet normat e Partisë.

Problemet e zhvillimit botëror e të gjendjes ndërkombëtare gjejnë pasqyrim në disa materiale të këtij vëllimi. Në to dënohet politika agresive, hegjemoniste e luftënxitëse e të dyja superfuqive, si armiket më të egëra të lirisë e të pavarësisë së popujve, të revolucionit e

të socializmit. Shoku Enver Hoxha riafirmon qëndrimin e vendosur të Partisë së Punës të Shqipërisë në mbrojtje të parimeve të marksizëm-leninizmit dhe luftën e saj të pandërprerë e pa asnjë kompromis për demaskimin e thelbit tradhtar të varianteve të ndryshme të revizionizmit modern. Në bisedat me miq të huaj, në artikujt dhe shënimet e kësaj periudhe spikatit analizat e thella shkencore të situatave e të ngjarjeve dhe shpjegohet rrezikshmëria e koncepteve dhe e praktikave titiste, hrushoviane e maoiste. Në to konkludohet se demagogjia e stërholluar, frazeologjia politike, degjenerimi në të gjitha fushat janë aspekte të dështimit të revizionizmit modern, si ideologji dhe si praktikë.

Me interes është në këtë vëllim edhe trajtimi që u bëhet rrugëve për arritjen e stabilitetit në Ballkan. Në një kohë kur gjendja e këtij rajoni, nënvizohet në artikullin «Çfarë e ndihmon dhe çfarë nuk e ndihmon sigurimin dhe bashkëpunimin e vërtetë të Ballkanit», është mjaft e komplikuar, kur në marrëdhëniet ndërmjet vendeve ballkanike ekzistojnë një mori çështjesh të pazgjidhura, që krijojnë tension midis tyre, kur prania dhe ndërhyrjet direkte ose indirekte të superfuqive në këtë rajon kanë krijuar konjunktura të rrezikshme politike e ushtarake, nuk ekzistojnë kushtet për të realizuar marrëveshje politike shumëpalëshe. Rruga e drejtë për forcimin e lirisë e të pavarësisë së popujve të Ballkanit, thekson shoku Enver Hoxha, është ajo që problemet e Ballkanit të zgjidhen nga vetë vendet e këtij rajoni, të cilat të punojnë për të krijuar atmosferë mirëbesimi reciprok dhe të mos lejojnë ndërhyrjen e superfuqive; të përjashtohen plotësisht superfuqitë nga

problemet ballkanike, të hiqen bazat e tyre në këtë rajon dhe të eliminohen ata faktorë të huaj që pengojnë popujt e Ballkanit të vendosin në mënyrë sovrane për marrëdhëniet ndërmjet tyre.

Materialet e këtij vëllimi do të jenë një ndihmë e madhe për komunistët, kuadrot dhe masat punonjëse të vendit tonë në luftën për realizimin e detyrave që nëntron ndërtimi i socializmit dhe një frymëzim i ri për suksese të reja në të gjitha frontet.

Vëllimi është i pajisur me tregues.

TE DIFERENCOJME ELEMENTËT QË KANË GABIME NGA ELEMENTËT ARMIQ E TRADHITARË

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

7 nëntor 1975

Armiqtë u qëruan¹. Tani duhet bërë shumë kujdes dhe të rritet vigjilenca, po midis njerëzve duhen bërë diferencime. Rrethi i këtyre shtrihet si valët rrethore që krijohen pas hedhjes së një guri në një pellg me ujë të qetë. Në qendër ka pasur elementë armiq dhe cilët kanë qenë më afër tyre aq më të ngarkuar janë, siç është, për shembull, Sadik Bekteshi, që vazhdon të kapardiset në Berat. Elementët si ai duhen thirrur dhe t'u thuhet: «Dëgjoni këtu, ne e dimë mirë cilët jeni ju, çfarë keni bërë dhe qëllimet që keni pasur, por Partia është zemërgjerë, prandaj rrini urtë!»².

1. Fjala është për likuidimin e komplotistëve puçistë në ushtri, B. Balluku, P. Dume, H. Çako, si edhe të grupit të armiqve sabotatorë në ekonomi, të kryesuar nga A. Këllezi e K. Theodhosi.

2. Sadik Bekteshi «nuk ndenji urtë» dhe gjyqi i popullit e dënoi për veprimtari armiqësore.

Pra, në këtë veprimtari kemi rrethin e armiqve, si edhe rrethin e të gabuarve.

Duhet pasur kujdes që të gabuarit të mos trajtohen si armiq, por Partia t'i ndihmojë të korrigjohen njerëz të tillë si në ushtri, ashtu dhe jashtë ushtrisë. Këta, në përgjithësi, janë të moshuar, njerëz që kanë bërë luftën, prandaj puna dhe e kaluara e tyre duhen pasur në konsideracion, por u duhet thënë dhe duhet ta njohin se në punën e tyre kanë pasur gabime. Gjatë periudhës së luftës ata kanë qëndruar e kanë luftuar mirë, por pas Çlirimit, pasi bënë edukimin ushtarak në shkolla e në akademi, patën edhe trajtim të mirë, faktorë që krijuan te këta shokë një botëkuptim të sëmurë që duhet shëruar. Por edhe ne duhet të pranojmë se puna edukative e Partisë ka bërë pak efekt tek ata. Pse ndodhi kështu?

1. «Ne kemi bërë luftën», thonë ata dhe për këtë mburren, u lindi kështu megalomania. Kontributin që dhanë ata nuk e shohin me thjeshtësi, por me megalomani dhe me epërsi. Këtu ne duhet të kemi parasysh se lufta është bazë për njëfarë krenarie te këta njerëz, por, meqenëse edukata marksiste-leniniste në ta nuk pati një ndikim të madh, atëherë kjo ndjenjë u shndërrua gradualisht në një prirje që u pleks me megalomaninë. Duhet pranuar se ata nuk ishin brenda normave të Partisë.

2. Këta njerëz Partia i çoi në shkollë, se kishte një besim të madh në ta, pasi ishin kuadro të ushtrisë të dalë nga lufta. Cilët të dërgonte të tjerë Partia? Sigurisht këta, dhe këta duhej të mësonin. Po ku të dërgoheshin veç Bashkimit Sovjetik? Ai ishte në atë kohë

një vend socialist me eksperiencë, ku kuadrot tanë do të kishin mundësi të mësonin nga ushtria e Leninit dhe e Stalinit. Dhe kështu i dërguam të mësonin, duke menduar se kjo do të ishte një fitim për ne. Po si mësuam? Atje këta kuadro mësuam edhe gjëra të mira, edhe të këqija, sepse, siç e dimë, Ushtria e Kuqe trashëgoi edhe shumë gjëra nga e kaluara, të cilat i zhvilloi. Kuadrot tanë bënë përpjekje, po nuk mësuam si duhet. Megjithatë, përpjekjet e tyre ne i konsiderojmë pozitive. Po përse nuk mësuam si duhet? Se u mungonte kultura, se përkthyes nga rusishtja në shqip nuk kishin, gjuhën ruse nuk e dinin. Po si i mbaronin këto akademi? Ja, ashtu siç thonë, «më mirë se hiç». Ky ishte një faktor tjetër për zhvillimin e megalomanisë. Atyre iu krijua bindja se përvetësuan shumë dhe u bënë specialistë të mbaruar dhe, duke pasur edhe këtu specialistët sovjetikë, filluan ta krahasojnë veten me kuadrot e ushtrisë sovjetike. Këto gjëra i shtynë ata (këtu nuk bëhet fjalë për armiqët Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako e të tjerë, por për ata që kanë gabuar) që të ishin jo kundër Partisë, po kundër normave të saj. Në fakt, ata nuk ishin për ato norma dhe krijuan kështu norma, koncepte e botëkuptime të tyre, të huaja për vijën e Partisë.

3. Pasi e vunë veten jashtë normave të Partisë, një shkak tjetër që ndihmoi në lindjen e zhvillimin e këtyre prirjeve të këta elementë, dhe për këtë jemi edhe ne fajtorë, është trajtimi i tyre. Këta kuadro ne i kemi favorizuar moralisht dhe materialisht. Ishte i drejtë ky trajtim? Po, njëfarë diferencimi na duket se që i drejtë. Mirëpo kjo krijoi keqinterpretimin nga

ana e tyre dhe organizata e Partisë në ushtri nuk qe vigjilente deri në atë shkallë që t'i zbulonte, t'i nxirrte në shesh këto keqinterpretime e keqkuptime të vijës e të normave të Partisë dhe t'i luftonte.

Ja, erdhi një moment që për shumë nga këta kuadro çështja nuk mbetej më thjesht te megalomania, por në atë që, duke kultivuar pikëpamje të tilla, si: «Unë jam zot i luftës», «zot i ushtrisë», «unë kam luftuar», «kam qenë komandant këtu, komandant atje» etj., nisën edhe të veprojnë prapa shpinës së Partisë, për ta degjeneruar ushtrinë. Kjo kategori ushtarakësh u grupua në formën e një bërthame tradhtarësh dhe pikërisht ishin këta armiq që u dënuan.

Vijmë tani te kategoria tjetër e kuadrove, që thamë, disa prej të cilëve janë edhe anëtarë partie. Disa prej tyre janë në ushtri, disa nuk janë në ushtri, por që të dyja palët ruajnë nostalgjinë për gradat e për trajtimin dhe nuk janë të qartë. Kuadrot e kësaj kategorie i dënojnë tradhtarët, por, në fakt, për vete kanë gjëra të paqarta, sidomos kur shohin që po ngrihen në përgjegjësi elementë të rinj. «Ku dinë të rinjtë të drejtojnë ushtrinë?», «këta nuk kanë luftuar, nuk e kanë bërë luftën», thonë ata. Këta kuadro harrojnë se lufta nuk bëhet përditë dhe se ushtria nuk mund të mbahet vetëm me ata që kanë bërë luftën njëherë, se është e domosdoshme që ajo të përgatitë edhe elementë të rinj për luftë. Kjo nevojë lind edhe për faktin që, dhe kjo objektivisht nuk varet nga ne, kuadrot e brezit të vjetër po plaken dhe ka ardhur koha gradualisht të dalin në pension, mbasi tash janë mbi 50 vjeç. Një pje-

së bile ka filluar të dalë, ndërsa pjesa tjetër do të dalë gjatë viteve të ardhshme.

Mendoj se me këta njerëz tash jemi në një situatë shumë sensibil. Megjithëse këta e kanë mbushur moshën, po t'i nxjerrësh tani në pension, këtë mund ta marrin jo sikur po nxirren në pension, si dalin zakonisht të gjithë ata që arrijnë moshën e tyre, por sikur po nxirren se «ka diçka» për ta, se «dyshohet» etj. Të tillë kuadro janë me mijëra në ushtri dhe jashtë saj. Prandaj materialet e katër plenumeve¹ të Komitetit Qendror të Partisë atyre u duhen shpjeguar mirë që t'i kuptojnë drejt, në mënyrë që kur të nxirren në pension, të dalin me zemër të ngrohur nga Partia, të jenë të qartë.

Duhet ruajtur njëlloj si nga nënvleftësimi i të rinjve nga ana e të vjetërve, që mund të thonë: «E po këta nuk kanë luftuar», por, gjithashtu, edhe nga qëndrimi i atyre të rinjve, të cilët mund të thonë: «Edhe ju të vjetrit na hodhët nga një pushkë dhe na bëtë gjithë këto gjëra». Këtu nuk është puna më përshëndete, s'më përshëndete, por rëndësi ka çështja të kihet parasysh porositë e Partisë që të mos na krijohen ndarje në të vjetër dhe në të rinj.

Këto gjëra kanë rëndësi të madhe, prandaj, kur takoheni me kuadro, ua shpjegoni këto! Hapni sytë: Vigjilencë kundër armikut, vigjilencë ndaj shokëve pasivë që t'i gjallërojmë; vigjilencë, gjithashtu edhe ndaj njerëzve që nuk janë të qartë dhe që me veprimet e tyre u shërbejnë edhe pa dashur armiqve.

1. Është fjala për Plenumin e 5-të e të 6-të të vitit 1974, dhe të 7-të e të 8-të të vitit 1975, të KQ të PPSH.

Kemi shokë të vjetër që kanë të tilla shfaqje. Ne duhet të njohim se nuk ka vepruar si duhet tek ata edukata e Partisë. Kur themi se Partia, në përgjithësi, po e bën punën e saj, duhet të pranojmë edhe anën tjetër, që ka shumë kuadro funksionarë të cilët nuk e kryejnë mirë punën që u ngarkohet. U duhen shpjeguar shokëve këto gjëra, kur bini në kontakt me ta.

Në jetë, shokë, dalin gjithfarë problemesh, deri dhe familjare e personale. Ja, më shkruante një oficer se djali i është martuar me një vajzë, babai i së cilës ka qenë oficer i Zogut dhe pas Çlirimit është futur në burg, «kurse unë, thotë ai, kam qenë partizan dhe tash vazhdoj të jem oficer i Ushtrisë Popullore. Kur i them djalit të heqë dorë, ai më përgjigjet: «Ti baba nuk më kupton, je me koncepte të vjetra», dhe në fakt u martua me të». Për këto arsye i lutet Partisë të ndërhyjë që djalin ta ndajë nga ajo vajzë. Pra, ky shok kërkon të ndërhyjë Partia në këtë çështje, gjë që nuk mund të bëhet. Prandaj iu përgjigja që djali, tash që janë martuar, të përpiqet ta bindë nusen që të mos mbajë anën e prindërve, por ta edukojë atë me mësimet e Partisë.

Lufta e klasave vazhdon të ashpërsohet, prandaj duhet një punë e madhe sqaruese brenda vendit, me qëllim që armiku të mos ketë baza ku të mbështetet, kurse jashtë le të lehë sa të dojë. Vallë janë të rastit aktivizimi i shovinistëve grekë për «Vorio-Epirin»? Apo «irredentizmi shqiptar» i Titos? Jo, këto janë veprime të organizuara me qëllime të caktuara, janë kundërveprime të armiqve të jashtëm kundër politikës së brendshme dhe të jashtme të Partisë sonë. «Pa t'ju

nxjerrim pak telashe, sikur duan të na thonë armiqtë përtej kufirit.

Populli pret sqarime, prandaj tash që armiqtë u dënuan duhet përgatitur një komunikatë, me anën e së cilës duhet vënë në dijeni populli, ashtu sikurse e kemi vënë vazhdimisht.

Në këtë komunikatë mendoj se duhet thënë që me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH u krijua një gjykatë speciale ushtarake, e cila shqyrtoi çështjen penale të këtyre personave, për këtë e për këtë akuzë; se gjatë gjykimit fajësia e të pandehurve u vërtetua plotësisht dhe ata vetë e pranuan fajësinë e tyre. Në përfundim të procesit gjykata i dënoi me këto dhe ato masa dhe Presidiumi i Kuvendit Popullor nuk aprovoi faljen e tyre, prandaj dënimi i këtyre armiqve u ekzekutua.

Kjo komunikatë të punohet me popullin nga organizatat e Frontit Demokratik, nën udhëheqjen e organizatave të Partisë¹.

Pastaj duke diskutuar për çështje të bujqësisë, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Vëmë re se rendimentet e bimëve bujqësore që po parashikohen për vitin që vjen, nuk përputhen me orientimet e Partisë. Ka shumë raste që, në vend që të planifikohen, ta zëmë, 26 quintalë për hektar, kur janë marrë në fakt 23 quintalë për hektar, planifikohen

1. Kjo Komunikatë e Gjykatës së Lartë të RPSH, që mban datën 14 nëntor 1975, iu bë e njohur gjithë Partisë dhe popullit, të cilët u solidarizuan njëzëri me të dhe dënuan me urrej-tje të madhe veprimtarinë armiqësore të komplotistëve.

edhe më pak, deri në 22 kuintalë për hektar. Kjo do të thotë se nuk është kuptuar drejt nga të gjithë letra që u dërguam kooperativisteve të Këmishtajt dhe kooperativisteve të dalluara të rrethit të Lushnjës. Si është e mundur që nga një anë thuhet se në masat kooperativiste ka entuziazëm dhe nga ana tjetër planifikohet më pak, bile caktohen rendimente më të ulëta se ato që u arritën këtë vit?

Kooperativat tona bujqësore duhet të planifikojnë sa mesatarja e rendimenteve të arritura në kooperativat më të mira. Edhe rrethi, gjithashtu, të planifikojë mbi mesataren e përparuar. Nuk duhet të pranojmë në asnjë rast ulje të rendimenteve duke u justifikuar se gjoja kolia vjet ka qenë më e mirë, ose me atë që na thonë disa që «Të kemi dhe ne tokën si të Këmishtajt, pa e dimë». Pikëpamje të tilla nuk janë të drejta, mbasi duhet kuptuar që kooperativistët e Këmishtajt kanë derdhur shumë djersë dhe punë në atë tokë, duke marrë masa të gjithanshme për kullime, për sisteme, plehërime e gjithfarë shërbimesh të tjera. Kryesorja është të punohet për të ngritur më lart ndërgjegjen e komunistëve dhe të atyre që punojnë në organet e pushtetit, sidomos të zyrtarëve, se nuk janë këta që bëjnë prodhimet bujqësore e blegtorale, por punonjësit e fshatit, shumë nga të cilët, bile edhe brigada, janë bërë shembuj frymëzimi.

Pra, ka koncepte penguese në këto çështje, që e kanë burimin deri në Ministrinë e Bujqësisë. Ata që bartin koncepte të tilla duhen kritikuar e sqaruar dhe duhet të bëjnë një analizë marksiste-leniniste të ndërjegjes së tyre. Këtu ta shohim ne frymën e burokra-

tizmit, te njerëz që janë mësuar t'i shohin gjërat vetëm nga shkresat dhe, në vend që të planifikojnë drejt, zbresin në shifra edhe më të ulëta se ato që janë realizuar. Kjo nuk duhet lejuar, sepse plani i 1976-s është i vitit të parë të pesëvjeçarit të ri dhe, po shkoi viti i parë me ulje, kjo do të ndikonte edhe në vitet e tjera.

*Botuar për herë të parë,
me shkurtime, në librin:
Enver Hoxha, «Gjithmonë
vigjilencë» (Për organet e
Punëve të Brendshme),
vëll. 2, f. 410*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë
nga procesverbali i takimit
ditor të sekretarëve të Komitetit
Qendror të PPSH, që
gjendet në AQP*

PROJEKTI I KUSHTETUTËS DO TË PASQYROJË REALITETIN TONË SOCIALIST DHE DO T'I HAPË PERSPEKTIVA ATDHEUT

*Fjala në mbledhjen e parë të Komisionit të posaçëm
për hartimin e projektkushtetutës së RPSSH¹*

17 nëntor 1975

Shokë dhe shoqe,

Po hapim mbledhjen e parë të Komisionit të posaçëm, që sapo krijoi Kuvendi Popullor, për hartimin e projektkushtetutës së re të Republikës Popullore të Shqipërisë. Sesionit të tretë të legjislaturës së tetë të Kuvendit Popullor i takoi nderi i madh që të vendosë për hartimin e kushtetutës së re, ligjit themeltar të Republikës sonë Popullore, që do të zëvendësojë kushtetutën në fuqi.

Ne shokëve që përbëjmë komisionin na u ngarkua një detyrë me rëndësi të madhe: të hartojmë projekt-

1. Në sesionin e tretë të legjislaturës së tetë të Kuvendit Popullor të RPSH shoku Enver Hoxha u eaktua kryetar i Komisionit të posaçëm për hartimin e projektkushtetutës së re.

kushtetutën e re dhe t'ia paraqesim atë popullit shqiptar për diskutim e për vërejtje, pastaj Kuvendit Popullor për miratim. Ne do ta kryejmë me nder këtë detyrë, do t'i zbatojmë me përpikëri vendimet e Kuvendit Popullor dhe porosinë e Komitetit Qendror të Partisë, që parashtroi shoku Hysni Kapo në raportin e mbajtur para Kuvendit «Mbi hartimin e projektkushtetutës së re të Republikës Popullore të Shqipërisë»¹.

Sot Kuvendi Popullor dhe Komisioni i posaçëm për hartimin e projektkushtetutës mbledhen në një datë të shënuar, që është ajo e çlirimit të kryeqytetit tonë. Me këtë rast më lejoni t'ju uroj: Gëzuar festën!

Partisë, që udhëhoqi Luftën heroike Nacionalçlirimtare, dhe popullit shqiptar, që mori pjesë tërësisht në këtë luftë për çlirimin e tij, u takojnë meritat e mëdha për ditët e lumtura që jetojmë. Shumë gjak e shumë sakrificë u deshën për çlirimin e atdheut, por lufta dhe vështirësitë nuk i përkulën as Partinë, as popullin tonë, përkundrazi. ato u dhanë forcë shpirtërore të jashtëzakonshme dhe kurajë të pashembullt. Fitortja e luftës ishte rezultat i zbatimit me këmbëngulje të vijës marksiste-leniniste nga ana e Partisë sonë. Mbështetja në marksizëm-leninizmin i siguroi Partisë një vijë politike dhe organizative të drejtë, si dhe mundësinë e dhënies së direktivave të qarta për mobilizimin e popullit në luftë.

Pas fitores, populli, me Partinë në krye, brenda një kohe shumë të shkurtër, rindërtoi vendin e shkatërruar. Që nga Çlirimi i Shqipërisë e gjer sot kanë ka-

1. Shih: Hysni Kapo, «Vepra të zgjedhura», vëll. 5, f. 280.

luar 31 vjet, gjatë kësaj periudhe janë bërë ndryshime të mëdha në vendin tonë.

Në vitin 1946, siç e dini, Partia i dha popullit shqiptar Kushtetutën e parë të Republikës Popullore të Shqipërisë. Në atë kohë te ne u shpall Republika Popullore, që është një formë e diktaturës së proletariatit.

Kongresi i 6-të i Partisë na caktoi detyrën të hartonim një kushtetutë të re për vendin tonë, për arsye se gjatë gjithë periudhës prej tri dekadash në Shqipëri në socialiste janë bërë transformime të mëdha morale-politike, ideologjike, ekonomike, të cilat kërkojnë doemos një kushtetutë të re që t'u përgjigjet situatave reale të brendshme, domethënë ndërtimit të plotë të socializmit në vendin tonë dhe, njëkohësisht, t'i hapen atdheut perspektiva të mëtejshme. Ligji ynë themeltar, që është në fuqi, përfaqëson vijën marksiste-leniniste të Partisë për zhvillimin e ekonomisë, ndërtimin e bazave të socializmit dhe formimin e njeriut të ri. Vijën e Partisë do të përfaqësojë edhe kushtetuta e re, e cila do të mishërojë dëshirat dhe aspiratat e mëdha të popullit tonë, që lufta e vazhdueshme revolucionare i ka bërë realitet. Kur studiojmë Kushtetutën e 1946-s, vërejmë se orientimet e Partisë, të sanksionuara me ligj, kanë qenë të drejta dhe të bazuara në teorinë marksiste-leniniste për shtetin dhe për të drejtën; ato kanë qenë në përputhje me kushtet tona reale konkrete, në harmoni të plotë me mundësitë e zhvillimit të forcave ekonomike dhe shpirtërore brenda vendit.

Një pjesë të vendimeve historike të Kongresit të 6-të të Partisë i kemi realizuar brenda këtij viti. Ne do të shkojmë në Kongresin e ardhshëm të Partisë me

detyra të plotësuara. Një ndër këto detyra është edhe hartimi i kushtetutës së re. Projekti i kushtetutës, që do të hartojmë, jo vetëm do të pasqyrojë etapën e sotme të zhvillimit të vendit, tërë realitetin tonë socialist dhe vijën e Partisë në të gjitha drejtimet, por edhe do t'u hapë perspektiva Partisë, popullit, atdheut për forcimin dhe përsosjen e mëtejshme të shtetit të diktaturës së proletariatit, të ekonomisë, të arsimit, të kulturës, të shkencës, të mbrojtjes dhe të mbarë zhvillimit socialist të shoqërisë.

Prandaj, që nga nëntori i vitit 1971, kur mori vendim Kongresi i 6-të i Partisë për hartimin e kushtetutës së re, e vazhdimisht Komiteti Qendror i Partisë ka punuar në këtë drejtim. Ai krijoi një komision dhe grupe të veçanta pune. Ky komision grumbulloi rreth vetes elementë nga klasa punëtore, nga fshatarësia kooperativiste, nga inteligjencia popullore, pra njerëz të punës e të shkencës, të cilëve u dha orientimet e përgjithshme që duhej të kishin parasysh për t'i pasqyruar në projekt kushtetutë. Ashtu siç tha edhe shoku Hysni, për projektin u punua me vite të tëra.

Puna paraprake e bërë nga Komiteti Qendror i Partisë, sigurisht, do të na ndihmojë shumë në detyrën tonë ne anëtarët e Komisionit të posaçëm për hartimin e projekt kushtetutës së re, që sapo krijoi Kuvendi Popullor. Të gjithë ne, shokë, e kuptojmë se projekt kushtetuta, që do të kemi në duar, nuk është një formulim i thjeshtë i disa dispozitave nga një komision, qoftë ky edhe shumë i gjerë, siç ishte.

Parapërgatitja e bërë nga Partia nuk do të thotë aspak se ne pjesëtarët e Komisionit të posaçëm të cak-

tuar nga Kuvendi Popullor për hartimin e projektkushtetutës së re, si dhe masat e gjera të popullit nuk kemi se çfarë të themi. Jo. Partia kurdoherë na ka mësuar se janë masat e popullit të udhëhequra prej saj ato që e bëjnë revolucionin të ecë përpara dhe krijojnë gjithë këtë situatë të kënaqshme. Prandaj edhe në hartimin e projektkushtetutës, si për çdo problem tjetër shumë të rëndësishëm, kërkohet të marrin pjesë gjallërisht masat e gjera të popullit. Këto duhet t'i thonë hap-tazi mendimet e tyre për çka u duket se është drejt apo nuk është drejt, për çka mendojnë se duhet shtuar, hequr apo ndryshuar. Diskutimi të mos kufizohet për asgjë, bile as për termat që janë përdorur, qofshin këta politikë, juridikë etj. Natyrisht, hartimi i Kushtetutës së re nuk është një punë e thjeshtë dhe automatike.

Të gjithë ne e kuptojmë që Komiteti Qendror i Partisë dhe shokët e shoqet që u aktivizuan në hartimin e projektkushtetutës janë përpjekur jo vetëm për të gjetur fjalët dhe frazat më të përshtatshme e precize, por edhe që këto fjalë e fraza të pasqyrojnë një ide të tërë, një gjendje të tërë, një epokë të tërë. Gjatë punës janë rrahur shumë mendime nëse kjo apo ajo çështje duhet të thuhet kështu apo është më mirë të thuhet ndryshe, duhet thënë «Republika Popullore e Shqipërisë» apo «Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë» apo vetëm «Republika Socialiste e Shqipërisë». Pra, gjatë rrahjes së mendimeve ka pasur plot diskutime dhe për të gjitha çështjet janë dhënë variante të ndryshme.

Përpjekja e mendimeve dhe e ideve për të arritur në përfundime sa më të drejta, me qëllim që projekti

të bëhej sa më i përsosur, që ky t'u përshtatej me të vërtetë rrugës së lavdishme të Partisë dhe të popullit tonë në fazën e ndërtimit të plotë të socializmit dhe perspektivës drejt rrugës së komunizmit, ka qenë frytdhënëse.

Projekti përmbledh në vetvete vijën e drejtë të Partisë, realizimet e mëdha të arritura nga Partia dhe populli gjatë gjithë kësaj periudhe. Ai është një sintezë e qartë e shumë precize e teorisë dhe e praktikës revolucionare që ka ndjekur Partia në udhëheqje të popullit për ndërtimin e socializmit.

Në këtë projekt, mes të tjerave, pasqyrohen edhe qëndrimet heroike të Partisë dhe të popullit tonë, që janë gjendur kurdoherë në ballë të luftës së klasave, në planin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar, për të asgjësuar sulmet e armiqve të vendit dhe të revolucionit botëror, si dhe për të zbrapsur furtunat e egëra që dialektikisht priteshin të vinin. Në kohën e luftës, pas Çlirimit dhe më vonë çdo gjë është dashur të arrihet me luftë dhe me përpjekje. Këtë Partia dhe populli kanë nxjerrë mësimin që për mbrojtjen e atdheut dhe të diktaturës së proletariatit armët duhet t'i mbajmë në dorë, energjitë t'i shtojmë, edukatën tonë marksiste-leniniste ta futim thellë në shpirt, patriotizmin ta zhvillojmë në kulm.

Mbi të gjitha çdo njeri duhet të ketë parasysh se, pa mbrojtjen e atdheut, asnjë fitore, asnjë sukses i arritur me kaq mund, me kaq gjak dhe me kaq djersë, nuk do të ketë jetë të gjatë. Pse? Sepse imperializmi amerikan dhe satelitët e tij, socialimperializmi sovjetik dhe satelitët e tij e kanë halë në sy Shqipërinë socialiste, prandaj punojnë dhe do të vazhdojnë të pu-

nojnë për të goditur Republikën Popullore të Shqipërisë. Në këtë ndërmarrje të ndyrë armiq të tanë do të humbasin, ata nuk do të kenë kurrë sukses në luftën kundër nesh. Partia jonë dhe populli shqiptar, në unitet të plotë me njëri-tjetrin, do t'i thyejnë ata. Çdo sulm e çdo furtunë ne, si kurdoherë, do ta përballojmë me sukses.

Sado i fshehtë, sado mizor dhe i kurdisur me intriga e me poshtërsi që ishte komploti i Beqir Ballukut, i Petrit Dumes, i Hito Çakos dhe i grupeve të tjera armiqësore, Partia dhe populli, në sajë të vigjilencës revolucionare që i karakterizon, e zbuluan dhe e shpartalluan.

Partia do t'u japë dackën e merituar të gjithë revizionistëve dhe borgjezëve reaksionarë, ajo do të përpiqet t'u japë zemër popujve dhe shokëve tanë marksistë-leninistë, të cilët luftojnë në kondita të vështira kundër imperializmit dhe borgjezisë që sundojnë në vendet e tyre. Partia jonë do të luftojë, gjithashtu, kundër socialimperializmit sovjetik dhe këlyshëve të tij, të cilët, nën maskën e leninizmit (në të vërtetë ata janë antileninistët më të tërbuar), përpiqen të sundojnë botën tok me imperializmin amerikan.

Në radhë të parë ne pjesëtarët e Komisionit të posaçëm duhet ta studiojmë me vëmendje të madhe projekt Kushtetutën që na ka vënë në dorë Komiteti Qendror i Partisë. Kjo duhet bërë për arsye se ne deputetët dhe gjithë Partia do të shkojmë në popull dhe atje nuk do ta lexojmë, por do ta komentojmë projektin. Ky koment të mos shndërrohet në një veprim formal, por të përqendrohet për të zbërthyer qartë kup-

timin e çdo neni, të çdo kapitulli, sepse, siç thashë, në ta është pasqyruar një jetë e tërë luftarake e Partisë dhe e popullit. Pikërisht këto ide të koncentruara, që ne do t'i gjejmë të shprehura në nenet apo kapitujt e projektit, na bie barra t'ua shpjegojmë masave të gjera të popullit me shembuj konkretë. T'u themi masave se kjo ide përfaqëson këtë situatë, kjo tjetra këtë etj. Për shembull, me popullin ne do të diskutojmë përse jemi kundër marrjes së huave nga imperialistët dhe nga socialimperialistët. Ne duhet të shpjegojmë që marrja e kredive nga armiqtë është jo vetëm robëri, shitje e atdheut dhe hap i rrezikshëm drejt pushtimit të tij nga të huajt, por edhe likuidim i diktaturës së proletaria-tit dhe i lirive të vendit. Për këtë gjë të japim shembuj konkretë se si revizionistët modernë, duke tradhtuar marksizëm-leninizmin, kanë hyrë borxh deri në grykë tek imperialistët, i kanë shndërruar aktualisht vendet e tyre në shtete kapitaliste, ku është krijuar borgjezia burokratike e lidhur ngushtë jo vetëm ideologjikisht, por edhe ekonomikisht me kapitalizmin botëror, me imperializmin amerikan.

Këtë shembull e solla sa për të thënë që, në radhë të parë, neve na bie detyra ta studiojmë intësisht projektin dhe, në qoftë se në të ka gjëra të paqarta, në qoftë se kërkohen shpjegime, aparati i Komitetit Qendror të Partisë, anëtarët e Byrosë Politike e të Komitetit Qendror, që kanë marrë pjesë në përgatitjen e tij, janë në dispozicion të plotë tuajin për t'ju dhënë çfarëdo shpjegimi që të kërkoni. Kjo punë ka për qëllim që, para se të miratohet projekti nga Kuvendi, të jetë i qartë dhe i njohur mirë nga gjithë masa e popullit.

Ne do të caktojmë edhe disa afate për ta studiuar këtë projektkushtetutë, pastaj do të caktojmë kohën kur do t'ia bëjmë të ditur popullit, sa do të zgjatin diskutimet dhe debatet revolucionare nga masat e gjera të popullit, kur do të mbledhen të gjitha vërejtjet, sugjerimet etj. nga ana e Komisionit tonë të posaçëm. Kjo detyrë kërkon që herë pas here të bëjmë disa mbledhje pune, ku të raportojmë se ç'na dërgon masa e popullit.

Përpara se të vemi në popull, ne do të kemi vërejtje për të bërë, të cilat do t'i diskutojmë. Për këtë arsye propozoj që çdonjëri nga ne, pasi ta studiojë projektin, vërejtjet ose sugjerimet që ka për nenet ose kapitujt e tij, ose mendimet për të shtuar, për të ndryshuar apo për të hequr diçka, t'ia bëjë me shkrim komisionit pranë Presidiumit të Kuvendit Popullor.

Pasi t'i kemi marrë këto vërejtje dhe pasi t'i kemi klasifikuar, do të bëjmë një mbledhje të Komisionit të posaçëm dhe aty do të njoftojmë që nga shokët kanë ardhur këto mendime e vërejtje. Disa prej tyre, që kërkojnë diskutim, sigurisht, do t'i diskutojmë, por për to nuk do të vendosim. Ne vetëm do të sheshojmë ato mendime që mund të sheshohen, të tjerat, që mund të jenë të diskutueshme, do t'i evidencojmë e do t'i mbajmë në ruajtje. Kur të shkojmë në popull për të diskutuar projektin, edhe populli do të bëjë propozime për ndonjë ndryshim, por shumë gjëra ai do t'i miratojë. Pasi t'i marrim të dhënat e diskutimit popullor, ne do të bëjmë përsëri mbledhje për të biseduar për problemet që dalin. Në përfundim të kësaj pune, bashkë me projektin përfundimtar të Kushtetutës, do t'i paraqesim një raport të shkruar Kuvendit Popullor.

Ne do t'i raportojmë Kuvendit se, në bazë të diskutimit që u bë në popull, sipas vijës së Partisë dhe në mënyrën më demokratike, u arrit në këto konkluzione. Ne duhet të japim arsyetimet tona bindëse në raport, përse është më e drejtë të bëhet ashtu si u sugjerua në diskutimin popullor e të tjera. Pra, ne do t'i japim Kuvendit Popullor projektin përfundimtar të komisionit për hartimin e projektkushtetutës së re me të gjitha vërejtjet që do të gjenden të drejta. Pas diskutimeve Kuvendi ka të drejtë të vendosë miratimin ose ndryshimin e projektit përfundimtar.

Kjo është metoda e punës që mendoj se duhet të ndjekim.

Më falni që po e përsëris, se ju e dini edhe vetë, por kjo detyrë me përgjegjësi kërkon studim të vëmendshëm nga ana jonë.

Jeni dakord, shokë, me këtë procedurë pune që ju propozoj? Keni ndonjë vërejtje rreth saj?

(Të gjithë shokët u shprehën se janë dakord.)

Atëherë, në qoftë se nuk ka ndonjë vërejtje për procedurën, duhet të caktojmë disa data. Vërejtjet, sugjerimet e propozimet që do të bëhen nga shokët e komisionit për projektin, propozoj t'i dërgohen Presidiumit të Kuvendit Popullor brenda muajit dhjetor 1975, në adresë të Komisionit të posaçëm për hartimin e projektkushtetutës. Kështu, përveç nëntorit, ne do të kemi edhe muajin dhjetor për të lexuar, për të reflektuar dhe për t'i bërë vërejtjet me shkrim. Jeni dakord me afatin që propozova? Pas kësaj do të kemi edhe procedura të tjera.

Mendoj të bëjmë një mbledhje tjetër të komisio-

nit afërsisht në 15-ditorin e dytë të janarit 1976¹. Kjo mbledhje duhet bërë edhe për të parë vërejtjet e shokëve, por njëkohësisht për të vendosur edhe shpalljen e projektkushtetutës në popull. Jeni dakord të bëjmë një mbledhje në 15-ditorin e dytë të janarit 1976?

(Shokët u shprehën se janë dakord.)

Ne mund të bëjmë edhe mbledhje të tjera sipas nevojës.

Diskutimi në popull mendoj se do të jetë mirë të fillojë pasi të marrim mendimin që projektkushtetuta t'i vejë popullit për diskutim. Popullit t'i lëmë për diskutim një afat prej dy muajsh e gjysmë. Kjo do të jetë një periudhë kohe e punë e ngjeshur dhe mjaft intensive. Dy muaj e gjysmë mendoj se janë të mjaftueshëm. Edhe punët e tjera do të bëhen gjatë kësaj kohe, duke u lidhur me ngjarjen e rëndësishme të diskutimit popullor të projektkushtetutës. Jeni dakord me afatin e diskutimit popullor?

(Shokët njëzëri thanë se janë dakord.)

Brenda kësaj kohe duhet të bëhet një punë politike jashtëzakonisht e madhe dhe e qartë për sqarimin e masave rreth projektkushtetutës. Për këtë qëllim do të mobilizohen gjithë Partia, të gjitha organizatat e masave, si Fronti Demokratik etj. Kuptohet që ne anëtarët e komisionit dhe shokët e tjerë deputetë do të jemi në ballë të punës. Gjatë kësaj periudhe detyrat

1. Komisioni i posaçëm i Kuvendit Popullor për hartimin e projektkushtetutës së re të RPSSH, në mbledhjen e tij të datës 19 janar 1976, miratoi tekstin e projektkushtetutës dhe vendosi për shpalljen e tij të menjëhershme, me qëllim që të diskutohej gjerësisht në popull.

tona janë: e para, të bëjmë vërejtjet që mund të kemi dhe ashtu si t'i kemi, qofshin këto të gabuara, qofshin të mira; e dyta, të shkojmë te masa në mënyrë të organizuar dhe t'i shpjegojmë asaj dita me ditë përmbajtjen e projektkushtetutës së re.

Ne si komision kemi detyrë jo vetëm të shpjegojmë përmbajtjen e projektit, por edhe t'i grumbullojmë të gjitha vërejtjet e popullit dhe t'i studiojmë me vëmendje. Kjo është një çështje me përgjegjësi të madhe, që kërkon punë voluminoze. Prandaj të mos harrojmë, shokë, se krahas nderit të madh që na bëri Kuvendi Popullor duke na zgjedhur në Komisionin e posaçëm për hartimin e projektkushtetutës së re, na dalin edhe detyra të mëdha për ta justifikuar këtë nder.

Ne mendojmë që tërë kjo procedurë që thamë të përfundojë brenda muajit korrik 1976.

Jeni dakord me këtë datë?

(Shokët u shprehën se janë dakord.)

Pra, duke filluar që nga nëntori, që jemi tashti, e deri në korrik, i bie rreth 9 muaj për të zbatuar këtë procedurë. Unë mendoj se edhe kjo kohë është e mjaftueshme. Për të organizuar mirë punën dhe për të dalë faqebardhë ne i kemi të gjitha mundësitë, se kemi një Parti të fortë, kemi gjithë këto organizata masash, kemi popullin, që është i përgatitur politikisht e ideologjikisht dhe karakterizohet nga një hov revolucionar i papërskruar në zbatimin e detyrave. Populli e kupton rëndësinë e Kushtetutës së re, se ai i ka jetuar situatat dhe e di që Kushtetuta e re është fryt i luftës së tij.

Këto kisha për të thënë, shokë, në këtë mbledh-

je të parë të komisionit. Pavarësisht se e vendosëm procedurën, në qoftë se ndonjë shok dëshiron të marrë fjalën. të bëjë ndonjë shtojcë apo ndonjë vërejtje, mund ta dëgjojmë.

Dëshiron njeri të marrë fjalën? Meqenëse nuk do të flasë ndonjë shok, atëherë ta mbyllim mbledhjen. Na mbetet të kryejmë me sukses detyrat që na kanë vënë Partia dhe Kuvendi Popullor.

Të rrojë Partia!

Mbledhjen e konsideroj të mbyllur. Mbetshi me shëndet, shokë! Mirupafshim e punë të mbarë!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

NË GRUPET E KONTROLLIT PUNËTOR E FSHATAR TË VIHEN NJERËZIT MË TË AFTE, MË TË NDRSHËM E MË VIGJILENTË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSII¹*

24 nëntor 1975

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Lidhur me këtë unë kisha një vërejtje. Në projektvendimin e paraqitur sikur më zuri syri idenë që, sipas tezave të Leninit, nëpunësit duhet të ekskludohen nga grupet e kontrollit punëtor, për arsye se do të kontrollohen ndërmarrjet shtetërore.

Nëpunësit specialistë mund të marrin pjesë, por këta të mos jenë anëtarë të grupit të kontrollit punëtor, sepse mund të komprometohen, duke u nisur nga pretendimet që «Mos më shiko ti të metën time, se, kur të më vijë rasti, edhe unë nuk do ta shikoj hollë tënden». Kjo na del edhe nga eksperiencia e deritanishme. Unë kështu e kuptoj edhe idenë e Leninit që në-

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth projektvendimit «Për forcimin e mëtejshëm të kontrollit të drejtpërdrejtë punëtor e fshatar».

punësit të mos jenë anëtarë të grupit të kontrollit punëtor e fshatar, por të marrin pjesë në të vetëm si ndihmës të këtij kontrolli.

Sipas Leninit duhet të ushtrohet kontrolli mbi nëpunësit e administratës nga grupet e punëtorëve dhe nëpunësit duhet t'i nënshtrohen këtij kontrolli. Lenini thotë, gjithashtu, që grupet e kontrollit punëtor ose fshatar duhet të mësohen nga kontrolli shtetëror, t'u bëhen leksione që edhe ato të kuptojnë e të dinë deri edhe ligjet etj.

Sigurisht, duke zbërthyer këtë tezë të Leninit, nuk duhet kuptuar që anëtarët e grupit të kontrollit punëtor e fshatar të bëhen të tërë enciklopedistë. Ata ndahen sipas specialiteteve e punëve që bëjnë dhe, duke punuar me ta, do të mësojnë edhe ligjet apo rregulloret. Megjithatë, grupet e kontrollit punëtor e fshatar mund të marrin edhe nëpunës specialistë, por këta, siç e thashë edhe më lart, të mos jenë anëtarë të grupit të kontrollit.

Lenini thotë që në grupet e kontrollit punëtorët të jenë të zgjedhur, po kjo anë, mendoj unë, s'ka nevojë të vihet fare në vendimin që do të nxjerrim. Numri i punëtorëve e i fshatarëve të këtyre grupeve do të jetë i madh, prandaj komiteti i Partisë ose organizata-bazë të bëjë planin e vet se me sa veta do ta ketë grupin e kontrollit punëtor e fshatar dhe të caktojë punëtorët apo kooperativistët më të mirë, duke marrë edhe aprovimin e masës. Në qoftë se ndonjë gjatë punës nuk del i mirë ose sëmuret, e zëvendësojnë me të tjerë.

Eksperienca do të na mësojë edhe për gjëra të tjera, përveç këtyre që parashikojmë ne. Mund të ketë

njerëz që nuk do ta kryejnë mirë detyrën, që mund të bëjnë edhe hatëre, ose që mund të komprometohen. Këto edhe mund të ngjasin, se nuk evitohen dot menjëherë. Gjithashtu mund të dalin të tjerë që do t'i kritikojnë këta që marrin pjesë në kontrollin punëtor e fshatar e do t'u thonë: «Çfarë keni bërë kështu?!». Pra, këto raste edhe do të ndodhin. Por, herë pas here, ne do të ndalemi t'i analizojmë kontrollet e ushtruara e do të nxjerrim edhe konkluzione. Të përpiqemi që në këto grupe të vihen njerëz nga më të zotët, më të ndershmit dhe më vigjilentët.

Mendoj që grupet e kontrollit punëtor e fshatar të masivizohen, në kuptimin që të mos jenë përgjithnjë të njëjtët njerëz, se ka rrezik që të bien në burokratizëm, në komprometim. Ata që do të caktohen në grupet e kontrollit punëtor, të zgjidhen nga organizatat-bazë e Partisë sipas nevojës. Pastaj vetë eksperiencia do të na mësojë se si duhet vepruar më mirë, se kjo është një punë e gjerë.

Meqenëse në rrethe nuk ka organe të veçanta të inspektimit shtetëror, grupet e kontrollit punëtor e fshatar duhet të bashkëpunojnë ngushtë me të gjitha llojet e kontrolleve që ekzistojnë në rrugë shtetërore në rrethe. Ato të mos jenë bisht i këtyre, po as të qëndrojnë jashtë, pra duhet të bashkërendohet veprimtaria. Këto grupe duhet të bashkëpunojnë për arsye se organet shtetërore dinë më mirë se si bëhet kontrolli, kanë eksperiencë. Nga ana tjetër, të kihet kujdes që këto kontrolle të mos i kundërvihen njëri-tjetrit, se janë kontrolle të së njëjtës klasë në fuqi, të udhëhequra nga Partia. Kontrolli punëtor e fshatar duhet të kun-

dërvihet vetëm në ato raste kur kontrollet e tjera janë në kundërshtim me vijën e Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të FPSH,
që gjendet në AQP*

MË PARË EDUKIMI I NJERËZVE, PASTAJ MASAT ADMINISTRATIVE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

24 nëntor 1975

Në fillim unë kam disa pyetje. E vini ju² në korrent opinionin shoqëror lidhur me krimet që vërtetohen dhe me dënimet që jepen për autorët e tyre? Nuk e kam fjalën këtu për njoftime skematike me anë buletinesh, por për të vënë në dijeni masat me konkluzione të ndryshme, sipas llojit të krimeve që gjykoni. E nxirrni ju thelbin e tyre dhe ia bëni të njohur popullit se vërehet kjo ose ajo prirje e dëmshme me rrezikshmëri shoqërore, duke përcaktuar se ç'duhet bërë për t'u vënë fre këtyre shfaqjeve? Fjala vjen, gjyqtari, kur shkon me shërbim në fshat, të mbledhë masën

1. Në këtë mbledhje u mor në shqyrtim edhe raporti i paraqitur nga Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykata e Lartë «Mbi shkaqet e kriminalitetit dhe masat për parandalimin e tij».

2. U drejtohet shokëve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Gjykatës së Lartë, të pranishëm në këtë mbledhje.

e kooperativistëve dhe t'u thotë: «Shikoni, vëllezër e motra, këto lloje krimesh po na ndodhin dhe, që të mos na ngjasin më të tjera, duhet të kryejmë këto detyra. . . » e t'i numërojë ato me radhë.

A vihen në korent rregullisht nga gjykatat komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve lidhur me gjykimet që bëhen, për llojet e krimeve që kryhen dhe për problemet që dalin, me qëllim që të tërhiqet vëmendja edhe për vjedhjet ose dhe për krimet e tjera? Mendoj që ky lloj informacioni duhet dhënë rregullisht në periudha të caktuara. Jo votëm kaq, por ka rëndësi edhe çfarë lloji janë këto të dhëna e si u jepen ato.

Po ju shokët e Gjykatës së Lartë veni ndonjëherë në komitetet e Partisë të rretheve për t'i diskutuar këto probleme bashkë me gjyqtarët e rretheve?

Dihet se gjyqtarët janë zgjedhur nga populli dhe, sipas këtij parimi, ata duhet të japin llogari përpara tij. Me sa duket gjyqtarët nuk japin llogari sa duhet, se, po të vepronin kështu dhe po të lidheshin si duhet me popullin, ky do t'u thoshte se filani po na vjedh, filani po na grabit, filani po na prish mallrat e shtetit etj., etj. Këto konstatime populli i ngre vazhdimisht. Mirëpo, në qoftë se populli vete «një herë në hënë», në mbledhjen që bëhet për këtë çështje nga këshilli popullor, ku ka edhe probleme të tjera, atëherë ndodh, ashtu siç thamë, nga të dyja palët: edhe gjyqtari s'jep llogari, edhe populli s'ka si t'i ngrejë problemet ashtu si duhet.

Kjo punë nuk është në rregull kështu, prandaj lufta kundër kriminalitetit duhet të bëhet intensive dhe

e efektshme, e tillë që elementëve keqbërës t'u krijohet kudo një ambient mbytyës që të mos kenë nga të vepronjë. Kjo, sigurisht, mund të bëhet vetëm me një punë politike të dendur e të vazhdueshme e jo t'i lihet spontaneitetit.

Si zbatohen afatet që janë caktuar në procedurën penale për zhvillimin e hetimeve dhe të gjykimeve? Del ndonjë problem nga kjo anë?

Po përsëritësit, kur ata mbushin një afat të caktuar nga dita e vuajtjes së dënimit, do të vazhdojnë t'i quajnë të padënuar? Nëse jo, do të shfuqizohet dispozita përkatëse e Kodit Penal apo jo? Megjithatë, ju shikojeni këtë çështje. Unë e ngrita atë se, kur kalon ca kohë, personi që ka qenë i dënuar, vete merr në gjykatë një dëshmi penaliteti «të bardhë» që vërteton se nuk ka qenë dënuar. Ne mund ta kemi bërë këtë, pse kemi pasur shumë besim te forca e madhe edukuese. Sa për vendet borgjezo-revizioniste, ato mund ta kenë, por për të tjera arsye, se vetë ata që janë në fuqi atje e nxitin kriminalitetin, vetë ata vjedhin, grabitin e vrasin ditë e natë.

Çfarë bëhet për përhapjen e eksperiencës së rrethit të Durrësit, që përmendet në raport, lidhur me punën për parandalimin e krimeve? Duke lexuar raportin, më bëri përshtypje që përqindja më e madhe e krimeve është kryer nga të rinjtë. A mund të na flisni pak për këtë, pse ndodh një fenomen i tillë dhe çfarë masash janë marrë për ta parandaluar? Ç'bëjnë Partia dhe organizata e rinisë për të gjitha këto konstatime të qarta e të vërteta? Kjo do të na interesonte shumë. E them këtë se nuk është çështja vetëm

ta ngremë problemin, por duhet ta organizojmë punën në mënyrë të tillë që organizatat e Partisë, së bashku me organizatat e bashkimeve profesionale, të rinisë e të gruas, të marrin masa praktike për ta zgjidhur atë. Pra, të insistojmë në organizimin e punës për ta zgjidhur në praktikë këtë problem e jo të mbetemi vetëm në fazën e shtruarjes së tij. Shtruarja do të thotë të japësh vijën, mirëpo, po nuk u organizua puna për zbatimin e vijës, kjo mbetet si një gjë abstrakte. Ne duhet të luftojmë për të formuar opinionin e shëndoshtë që njerëzit jo vetëm të mos bëjnë krime, por edhe të respektojnë rregullat kudo: në autobus, në ndërmarrje, në shkollë, në dyqan e gjetkë. Kjo, sigurisht, nuk është një punë që bëhet me fushata. Puna e Partisë dhe e organizatave të masave në këtë drejtim duhet të jetë frontale dhe të mbahet përherë e ndezur. Ajo s'duhet bërë me hope, ashtu siç u tha këtu, që herë ngrihet e herë ulet. Pse të ndodhë kështu? Si i ndjek Partia në rreth këto probleme? Po aparati i Komitetit Qendror, sektori i edukimit, sektorët e tjerë si merren me to? A kanë diskutuar ndonjëherë instruktorët dhe sektorët e aparatit, fjala vjen, për çështjet e edukimit të rinisë dhe për ato shfaqje negative që vihen re?

Mbas përgjigjeve që iu dhanë pyetjeve dhe mbas diskutimeve të pjesëmarrësve të tjerë të mbledhjes, shoku Enver Hoxha tha:

Unë, përgjithësisht, jam dakord me raportin e paraqitur dhe me diskutimet që bënë shokët.

Partia duhet t'i kushtojë rëndësi të madhe çështjes së edukimit moralo-politik të masave punonjëse, të klasave dhe të të gjitha shtresave që përbëjnë popullin.

Në qoftë se nuk punohet vazhdimisht për edukimin e njerëzve kundër neglizhencave, indiferentizmit, hatërllëqeve, gjykimeve të njëanshme liberale ose sektare në zbatimin e vijës së Partisë, atëherë do të kemi pasoja të papëlqyera.

Sipas mendimit tim, këto pasoja aktualisht nuk janë alarmante, sepse, duke marrë parasysh gjithë këtë veprimtari revolucionare që zhvillon Partia në krye të masave, në krye të klasës punëtore, të organizatave të rinisë, të gruas, të bashkimeve profesionale, si dhe patriotizmin e madh që tregojnë masat tona punonjëse në përgjigje të thirrjeve të Partisë, duhet konsideruar se e përgjithshmja që sundon në jetën tonë është pozitivja. Por në këtë proces edhe negativja nuk mungon të shfaqet. Shfaqjet negative të na preokupojnë shumë, sepse prapa tyre qëndron nxitja e armikut të klasës, veprimtaria e tij.

Armiku ngjitet si vemja, prandaj, në qoftë se nuk i mbyllim derën mirë, ai do të veprojë me ngadalë, urtë e butë dhe në mënyrë të pakuptueshme. Në fillim armiku vepron me dinakëri atje ku gjen më shumë dobësi, pastaj, po të mos gjejë kundërshtim të fortë, kryen veprime të egra.

Kur themi që Partia duhet të interesohet dhe të punojë intensivisht për organizimin e luftës kundër elementit armik, sepse suksesi në këtë luftë varet vetëm nga puna organizuese e Partisë, të mos kuptojmë sikur kjo çështje qëndron vetëm në shtruarjen e problemit. Për luftën parandaluese kundër kriminalitetit nuk mjafton aspak të shtrohet çështja vetëm në komitete partie, në komitete ekzekutive apo në ministri të

ndryshme. Natyrisht, këto probleme do të shtrohen, do të rrihen e do të studiohen nga sektorët përkatës, por çështja qëndron në atë që të gjithë komunistët, atje ku punojnë, ku luftojnë e ku militojnë duhet të merren me edukimin e njerëzve që të parandalohen krimet. Partia duhet të përpiqet që t'i shpëtojë nga veprimtaria keqbërëse ata që duhen shpëtuar dhe t'ia japë drejtësisë për gjykim ata që kanë kryer vepra shoqërisht të rrezikshme dhe të dënueshme nga ligji. Kjo është një nga detyrat e organizatave të Partisë.

Në qoftë se Partia nuk i vë rëndësi, në radhë të parë, punës edukuese, atëherë do të na shkojë dëm edhe puna tjetër që është bërë për forcimin e ekonomisë dhe të mbrojtjes. Gjithë puna e elementëve armiq kundër shtetit të diktaturës së proletariatit, qoftë në fushën e ekonomisë, të ushtrisë, të ideologjisë dhe të arsimit e të kulturës, synon të godasë socializmin, sepse ata nuk e duan regjimin tonë.

Vjedhja e pasurisë socialiste, qoftë kjo shtetërore ose kooperativiste, apo vjedhja e pasurisë së personave të veçantë, si dhe krimet e tjera kryhen nga elementë të degjeneruar, të ndikuar nga një frymë armiqësore. Duke vjedhur, keqbërësit atakojnë regjimin tonë dhe bazën ekonomike të socializmit. Vlera e pasurisë së përvetësuar është njëra anë e problemit, por ajo që ka rëndësi të jashtëzakonshme është ana politike e aktit të kryer, sepse me anë të krimit armiku synon të krijojë në masat e popullit, në ata që dëmtohen dhe në vetë aparatin shtetëror gjendjen e pasigurisë. Në qoftë se Partia nuk u vë rëndësi të gjitha këtyre shfaqjeve të dëmshme antishoqërore, atëherë ajo bën gabim.

Kur them Partia, unë kam parasysh të gjithë anëtarët e Partisë kudo që ata jetojnë e punojnë.

Ekziston sadopak një mentalitet i tillë i gabuar që «Unë jam vetëm për të shkrirë çelikut», «unë jam oficer dhe merrem vetëm me këtë punë», «unë jam mjeshër vetëm për të ndërtuar mure». Kështu, mendohet se është dikush tjetër ai që duhet të shohë se shoku pranë po vjedh çimento, se ai tjetri, duke bërë bataçillëqe, mbush kamionin me tullat e shtetit dhe i çon për të ndërtuar shtëpinë e vet! Duke gjykuar kështu, ndodh që edhe kur ndonjë nëpunës i shtetit i shikon këto shfaqje të dënueshme, mbyll sytë para tyre ose nuk i shikon ato, sepse nuk bën asnjë përpjekje për t'i parë! Beso dhe kontrollo cilindo! Kështu na mëson Partia. Secili duhet ta mbërthejë atë që vepron keq, ta qortojë aty për aty shokun që shkel rregullat, ta ngrejë për diskutim në kolektiv sjelljen e keqe të ndonjërit dhe; në qoftë se e shikon që faji i tij është i rëndë e i dënueshëm nga ligji, të kërkojë, sipas rastit, në mbledhjen e kolektivit ose të Partisë dërgimin e tij për të dhënë llogari në gjyq. Kjo gjë, në radhë të parë, duhet të bëhet nga komunistët. Në organizatat-bazë duhet të krijohet kjo frymë revolucionare, sepse nuk ekziston sa duhet, shokë.

Fryma revolucionare, për të cilën po flasim, nuk shkon si duhet në të gjitha organizatat shoqërore ku përfshihen masat e popullit. Nuk mund të thuhet se nuk bëhen leksione kundër krimeve, se në luftën kundër krimeve nuk ka rezultate. Jo, rezultate ka, mendoj unë, por leksionet, referatet dhe studimet shpeshherë bëhen në mënyrë formale. Shokët, që janë në kontakt

më të drejtpërdrejtë me punonjësit, i vërtetojnë këto që po them.

Dikasteret, për shembull, kanë suksese, ato udhëheqin sektorë me rëndësi të punës së shtetit, por nuk shqetësohen sa duhet për zbatimin e përpiktë të ligjeve. Natyrisht, ministri ose zëvendësministri nuk mund të dijë edhe për gjënë më të vogël që ngjet diku, por ai duhet të vihet doemos në dijeni për disa fenomene shumë negative që vërtetohen në sektorin e punës ku drejton. Ky problem i njohjes së gjendjes nuk shtrohet vetëm për ministrin ose zëvendësministrin, por për gjithë «piramidën» që ata kryesojnë. Është mësuar apo jo kjo «piramidë» t'i shikojë dhe t'i luftojë të gjitha shfaqjet antisocialiste që vërtetohen në sektorin e jetës që udhëheq dhe të marrë masa organizative dhe edukative ndaj fajtorëve? Bëhet kjo punë apo nuk bëhet? Unë mendoj se nuk bëhet mirë, por veprohet në mënyrë automatike.

Në goftë se Partia në rreth e në bazë kënaqet kur bëhen një apo pesë referate kundër kriminalitetit dhe kujton se puna mbaroi me kaq, në goftë se bashkimet profesionale mbajnë më shumë referate dhe pandehin se kështu e kryen detyrën, kjo mënyrë të vepruari nuk na jep atë që dëshirojmë. Referatat që përgatiten, duhet të kenë vlerë politike, ideologjike dhe edukative.

E kemi bërë shumë herë vërejtjen që organizatat e bashkimeve profesionale nuk janë krijuar për të bërë punën e drejtorit dhe të kryeinxhinierit të ndërmarrjes. Me problemet ekonomike duhet të njihet kjo organizatë masash e punëtorëve dhe e nëpunësve, se në bazë të tyre do të ndërtojë punën e saj për propaga-

ndën, por çështja është që të merret seriozisht me edukimin e gjithanshëm të anëtarëve të saj, prandaj duhet të shkundet nga dobësitë.

Për sa kohë që zhvillohet lufta e klasave edhe tona do të ketë vazhdimisht krime, por çështja shtrohet që, meqenëse nuk ka mundësi të likuidohen plotësisht, sa të jetë e mundur ato të vijnë gjithnjë duke u pakësuar. Fenomeni i kundërt, domethënë në rast se shohim prirje drejt ngritjes së numrit të krimeve, duhet të na shqetësojë, sidomos kur shohim rritje në disa lloje të tyre.

Armiku, në radhë të parë, synon të godasë Partinë, por është një shenjë mjaft e mirë kjo që një përqindje shumë-shumë e vogël e të dënuarve kanë qenë anëtarë dhe kandidatë të Partisë. Kjo shifër tregon që Partia është e shëndoshë, i ka shtrënguar radhët fort, i ka tendosur nervat dhe armiku futet me shumë zor në radhët e saj. Ky proces drejt uljes së numrit të krimeve të kryera nga komunistët duhet të vazhdojë, sepse Partinë duhet ta kemi të pastër si qelibari, prandaj të punojmë në këtë drejtim e jo ta flemë mendjen.

Partia na e ka theksuar vazhdimisht se armiqtë, borgjezë e revizionistë, synojnë dhe veprojnë aktivisht që të degjenerojnë masat, klasat, dhe sidomos të rinjtë, nëpërmjet përhapjes së pikëpamjeve të tyre idealiste, antimarksiste dhe kundërrevolucionare. Kjo për arsye se rinia përbëhet nga një shumicë e madhe njerëzish që do të marrin në dorë stafetën e revolucionit, se të rinjtë janë e ardhmja jonë. Në këto rrethana ne duhet t'i kundërvihemi veprimtarisë së armiqve

dhe rininë ta kemi, si kurdoherë, të shëndoshë. Partia të marrë masa serioze organizative që numri i krimeve të kryera nga të rinjtë të ulet absolutisht, siç po ulet numri i krimeve të kryera nga komunistët. Kjo gjë ka mundësi të arrihet, se në përgjithësi kemi një rini të mrekullueshme.

Le të kujtojmë, shokë, periudhën e rinisë sonë. Edhe ne dikur kemi qenë entuziastë e të hedhur, kemi pasur mendimet tona, por është fakt se ndryshe gjykonim atëherë kur ishim 15-16 vjeç dhe ndryshe mendojmë tashti. Të rinjtë tanë sot janë shumë më të pjekur nga ç'ishim ne në moshën e tyre, prandaj hovin e rinisë, vrullin që është kurdoherë karakteristikë e saj, duhet t'i përdorim për të mirën e atdheut.

Çështja e edukimit të punëtorëve të rinj në ndërmarrjet ekonomike duhet t'i shqetësojë organizatat-bazë të Partisë, ato të rinisë dhe veçanërisht të bashkimeve profesionale që, siç u tha edhe këtu, nuk punojnë si duhet për edukimin e punëtorëve. Vërejtja që u bë këtu se në punën parandaluese kundër krimeve në radhët e të rinjve punëtorë organizatat e Bashkimit të Rinisë nuk mbështelen nga ato të bashkimeve profesionale, unë e gjej të drejtë. Është e arsyeshme që organizata e rinisë t'i evidencojë këta elementë, por edhe organizata e bashkimeve profesionale duhet të ndihmojë në këtë drejtim. Ajo duhet t'i ngarkojë detyrën punëtorit me moshë 45 ose 50 vjeç që ky të ketë në kujdes punëtorin e ri, që nuk ka zënë rrugë të mirë. Kështu, kur i riu të punojë me një njeri të pjekur e të respektuar që t'i qëndrojë pranë e t'i flasë me zemër të ngrohtë, duke i thënë: «Hajde ti, djalë, këtu, kjo çështje është

kështu, për këtë gjë duhet vepruar në këtë mënyrë etj., shfaqjet e sëmura do të shërohen patjetër. Çështja qëndron në atë që të luftohen shkaqet që çojnë në rrugën e degjenerimit, se kjo rrugë i sjell leshrat e gjata, pantallonat kauboj, vagabondazhin, që manifestohet edhe duke ngacmuar vajzat rrugës, e të tjera sende.

Nuk mund të lejohet nga Partia një opinion i tillë i gabuar, sipas të cilit, punëtorin e dënua për një krim nuk e pranojnë në punë, se ai është i keq, grindavec, i padisiplinuar dhe për këtë arsye e transferojnë në një ndërmarrje tjetër. Të mendosh dhe të veprosh kështu, do të thotë të mos merresh me edukimin e njeriut që ka kryer faje, të harrosh, pra, një nga detyrat më rëndësi të Partisë, e cila na mëson të punojmë pa u lodhur që të shpëtojmë njerëzit, me qëllim që t'i ndreqim ata që janë të korrigjueshëm. Në qoftë se ndërmarrjet nuk e pranojnë në punë një njeri që ka vuajtur dënimin me heqje të lirisë, ai do të futet përsëri në rrugën e krimit dhe do të përfundojë në burg. Në qoftë se nuk merrmi ne edhe me edukimin e këtyre njerëzve, atëherë kush tjetër do të merret me këtë punë? A e kanë të qartë në ndërmarrje vijën e Partisë për edukimin e clementëve që fillojnë të lëkunden, të bëjnë hatëre e padrejtësi, të vjedhin diçka etj.? Drejt e tha shoku Qirjako Mihal, sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit, që, në qoftë se ne nuk i sistemojmë në punë të rinjtë që kanë vese të këqija, në qoftë se i përbuzim dhe nuk i edukojmë, atëherë ata gjejnë njëri-tjetrin dhe kryejnë krime bashkërisht. Në këtë drejtim duhet menduar seriozisht. E vërteta është se nga të tërë ka luftë e përpjekje, por fakt është që

duhet akoma shumë punë, më sistematike dhe më e organizuar për luftën kundër kriminalitetit.

Në goftë se shokët drejtues dhe komunistë në qendrat e punës kujtojnë se me edukimin e kësaj kategorie njerëzish do të merren të tjerë jashtë ndërmarrjes, atëherë këta nuk e kanë kuptuar mirë vijën e drejtë të Partisë për edukimin e njeriut. Vija e Partisë, shokë, nuk duhet kuptuar thjesht si diçka që mund të zbatohet me metoda administrative. Partia, natyrisht, ka përcaktuar edhe vijën administrative e penale që duhet të ndiqet ndaj keqbërësve kur këta e mbushin kupën, në raste të tilla veprojnë ligjet e diktaturës së proletariatit, mirëpo, para se të vijë puna e ndëshkimit shtetëror të njerëzve, duhet të bëhet një luftë e vazhdueshme për edukimin e tyre, që të parandalohet veprimtaria kriminale.

Flitet që punëtorët e rinj nuk kanë detyrime, prandaj ka prej tyre, të cilët, pagën që marrin e shpenzojnë për qejf, duke pirë etj. Para se të gjykohet për këtë çështje, mendoj se duhet psikologjisur gjendja e të rinjve sot, duke u parë veprimet e tyre të lidhura me kohën. Kur ishim ne të rinj, brengoseshim se nuk kishim t'u dërgonim dot tre lekë për ushqim prindërve tanë, kurse sot kohët kanë ndryshuar shumë. Partia dhe rendi ynë shoqëror socialist kanë krijuar situata të tjera, të cilave duhet t'u adaptojmë një edukatë të re. Duhet të kuptohet se punëtori i ri, për vetë moshën që ka, nuk është i formuar si prindërit e tij, që janë të rrahur në jetë me vaj e me uthull. Babai dhe nëna e tij sot kanë rrogë ose pension, motra e vëllai i tij, gjithashtu, kanë pagën e vet, kurse prindërit tanë

ose motrat e vëllezërit tanë më të mëdhenj nuk kishin rrogë në kohën e tyre. Pra, ndërsa ne, në kohën e rinisë sonë, kishim detyrime familjare, të rinjtë e sotëm kanë pak. Ky është fakt. Kjo gjendje e re e krijuar, natyrisht, jo në të gjithë të rinjtë, por te një pjesë e tyre, që nuk janë të edukuar mirë, ka bërë që këta të zhvillojnë aktet e veta me një pavarësi të shprehur, duke menduar keq se asnjë njeriu ata nuk i bëjnë ndonjë dëm kur harxhojnë paratë e tyre dhe venë e pinë në klub shishe me birrë e raki. «Gjersa prishim paratë tona dhe nuk vjedhim, përse të shqetësohen të tjerët?». Kështu mendojnë këta të rinj, se nuk thellohen që pirja e shisheve me birrë jashtë mase sot është një ves që të çon më tej nesër. Duke bredhur klubeve, këta të rinj nuk do të angazhohen në punë në mënyrë serioze dhe dalngadalë ata që pinë do të thonë: «Punë e madhe se nuk vete tri ditë në punë, unë për qejf i kam lekët e pagës sime!». Mirëpo duke munguar në fillim nga tri ditë, pastaj mungesat shtohen, bëhen me javë e me muaj. Duke mos pasur para, sepse nuk paguhet asnjëri pa punuar, ai që është mbërthyer nga vesi i të pirit ose nga vese të tjera të këqija do të fillojë të vjedhë. Ky proces i futjes në rrugën e krimit duhet njohur që të parandalohet, prandaj të veprohet pa humbur kohë dhe pa pritur që të kryhet krimi.

Për të parandaluar këto shfaqje, duhet punuar një nga një me këta njerëz me qëllim që të edukohen, të mos bëhen vagabondë, të mos kryejnë krime e të mos futen në burg, pra duhet bërë një punë e diferencuar edukative me secilin prej tyre. Pikërisht kjo punë, që është e domosdoshme, nuk bëhet sa duhet. Leksione i

riu dëgjon mjaft, ato kanë vlerën e tyre, por gjithçka nuk e zgjidh dot me leksione.

Gjyqtarët nuk duhet të mendojnë vetëm që të gjykojnë drejt e sipas ligjit të akuzuarin, këtë gjë partjetër ata do ta bëjnë, se është detyrë e tyre, por të përpiqen që ta zhvillojnë gjykimin në mënyrë të tillë që ky të ndikojë për edukimin e të akuzuarit dhe të të gjithë të pranishmëve në sallën e gjyqit. Këtë qëllim ka edhe organizimi i gjykimeve jashtë qendrës së gjykatës.

Roli i prokurorit, si mbrojtës i ligjit, te ne nuk është i njëlojtë me atë të prokurorit borgjez e revizionist. Disa herë ne kemi menduar se për çfarë arsye duhet pjesëmarrja e prokurorit në gjykim, kur, në fakt, vetë gjyqtarët tanë, të zgjedhur nga populli, janë njerëz partie që vendosin me drejtësi dhe dinë të mbrojnë interesat e popullit gjatë gjykimit. Megjithatë ne e kemi pranuar pjesëmarrjen e prokurorit në gjykim pikërisht për arsye të rolit edukues që duhet të luajë ai. Prandaj prokurorët të mos bëjnë ligjërata të kota në gjyq dhe të mos përqendrohen vetëm në analizën e provave gjyqësore, që natyrisht duhet t'i çmojnë me kujdes e me përgjegjësi për të ndihmuar gjykatën, por, kur të mbahet pretenca, nga përmbajtja e saj, masat të kuptojnë më thellë rrezikshmërinë e kimit të kryer dhe të fajtorit e të binden për drejtësinë e konkluzioneve të prokurorit. Prokurori duhet të luajë rolin e mbrojtësit të ligjit. Ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë që ai, jo vetëm të mbikëqyrë zbatimin e njëlojtë e të përpiktë të ligjit nga të gjitha institucionet, ndërmarrjet, organizatat shtetërore e kooperativiste dhe nga shtetasit, por, në të njëjtën kohë, të punojë që

ligji t'u futet njerëzve në shpirt, sepse ligji është sinteza e vijës së Partisë në shumë drejtime. Pra, që prokurori të mbrojë ligjin, duhet që këtë ligj ai ta bëjë të qartë në masat e popullit. E bëjnë prokurorët tanë si duhet këtë gjë? Unë them se jo të tërë e bëjnë këtë gjë, se nuk venë të përgatitur si duhet në gjyq, nuk i vënë vetes që më parë detyrën që në këtë proces gjyqësor meritojnë të theksohen këto çështje, të demaskohen këto shfaqje dhe të nxirren këto konkluzione politike dhe ideologjike për mbrojtjen e vijës dhe të direktivës së Partisë. Nuk është e drejtë të mendohet që masa le t'i nxjerrë vetë konkluzionet, po të dojë, se niveli ideopolitik i tërë njerëzve nuk është në shkallën që kërkohet.

Roli edukativ i gjyqtarit dhe i prokurorit nuk duhet të konsiderohet si një diçka pa rëndësi, përkundrazi, ky rol ka shumë rëndësi për edukimin e masave dhe të personit që gjykohet, me qëllim që të parandalohen shkeljet e ligjit. Në qoftë se themi t'u krijojmë keqbërësve një ambient mbytës, këtë ambient duhet ta krijojmë me të vërtetë e jo ta deklarojmë si slogan. Kjo ide duhet zburthyer dhe, që të zburthohet drejt, duhen bashkërenduar përpjekjet dhe veprimtaria e Partisë, e organizatave të masave, e organeve të Punëve të Brendshme, të prokurorisë dhe të gjykatës.

Ministria e Punëve të Brendshme këshillon shumë njerëz që futen në rrugën e shkeljes së ligjit e të krimt. Ky veprim i saj, siç e kemi theksuar, është i mirë, sepse këshillimi i atyre që gabojnë është me vlerë të madhe moralo-politike, por ka edhe karakter paralajmërues. Kur organi i Punëve të Brendshme thotë:

«Shiko, ki mendjen ti, shtetas i pandërgjegjshëm i republikës; se me aktet që po kryen po vepron keq dhe, po vazhdove kështu, arma e diktaturës së proletariatit do të të hedhë dorën në zverk nesër», këtë punë duhet ta bëjnë në rrugët e tyre shumë efikase edhe organet e organizatat e tjera, edhe Partia. Në qoftë se veprohet kështu, kjo punë do të jetë shumë e dobishme. Pastaj, pasi të jetë konsumuar kjo veprimtari parandaluese dhe edukuese dhe shtetasi nuk korrigjohet, do të zbatohen masat administrative dhe penale.

Kjo ndihmë nuk mund të jepet efektivisht në rast se ekziston indiferentizmi mikroborgjez dhe mendohet: «Ç'më duhet mua të denoncoj, pse të ngatërrohem unë në këtë punë, pse ta marr unë në qafë këtë njeri dhe, nesër, kur të bëj edhe unë ndonjë gabim, të më qepen për të më dëmtuar?». Këto qëndrime shumë negative ekzistojnë dhe duken edhe në disa nga njerëzit tanë.

Raporti, kjo mbledhje dhe të gjitha diskutimet e shokëve të na shërbejnë për të rishikuar mirë përmirësimin e punës edukative dhe organizimin më të mirë të saj. Partia të angazhohet që këto shfaqje të huaja të shkojnë duke u ulur në çdo drejtim.

*Botuar për herë të parë,
me shkurtime, në librin:
Enver Hoxha, «Raporte e
fjalime 1974-1975», f. 388*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë
nga procesverbali i mbledhjes
së Byrosë Politike të KQ të
PPSH, që gjendet në AQP*

PUNA KRYESORE E BASHKIMEVE PROFESIONALE ËSHTË EDUKIMI

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

26 nëntor 1975

Në përgjithësi unë jam dakord me diskutimet që bënë shokët dhe, për të konkluduar rreth këtyre çështjeve, dëshiroj të shpreh disa mendime.

Materiali që na është paraqitur mban titullin: «Mbi disa probleme të udhëheqjes së Partisë në bashkimet profesionale». Por, gjatë leximit, m'u krijua përshtypja sikur këtu nuk flitet shumë për të metat e punës së Partisë në udhëheqjen e bashkimeve profesionale, por më tepër bëhet fjalë si punojnë bashkimet profesionale. Vetëm sa përmendet problemi dhe pastaj ngarkohen të tjerët me gabime. Pra, mua më duket se materiali nuk i përgjigjet temës së caktuar. Pse të ndodhë kështu?

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi disa probleme të udhëheqjes së Partisë në bashkimet profesionale», të paraqitur nga sektori i edukimit pranë aparatit të KQ të PPSH.

1. «Llafet» e bashkimeve profesionale, siç i quajnë disa njerëz, duhen konsideruar se i shërbejnë edukimit ideopolitik, se ato ndihmojnë që punonjësit të zbatojnë si duhet detyrat tekniko-operative. Pra, nuk janë llogje e pallavra. Për këto arsye janë të gabuara prirjet e atyre komunistëve, sadopak që të jenë, të administratës dhe të ndërmarrjeve, që mund të bien në këtë gjykim të gabuar dhe të devijojnë rolin e bashkimeve profesionale. Fjalë të tilla që «janë llafe këto që thonë bashkimet profesionale» shprehin një pikëpamje të gabuar. Ngrihet kjo gjë në organizatën-bazë të Partisë? Thuhet atje se ka edhe komunistë që manifestojnë të tilla koncepte?! Mua më duket se këtyre gjërave nuk u bëhet kritika e duhur.

Pa hyrë thellë në anën teorike të këtyre çështjeve, dëshiroj të theksoj që jo vetëm punonjësit e bashkimeve profesionale, po tërë Partia dhe në veçanti sektorët e aparatit të Komitetit Qendror duhet t'u kthehen edhe një herë vlerësimeve që u ka bërë Lenini bashkimeve profesionale, luftës që ka zhvilluar ai kundër Kolontajt¹ dhe shokëve të saj, t'i kthehen vijës së Partisë sonë dhe të këqyrin me kujdes në këtë drejtim devijimet revizioniste të titistëve dhe të hrushovianëve.

Shokët duhet të ruhen nga formulat, se këto, shumë herë të kuptuara gabim, të çojnë në devijime. Duhet të kuptohet mirë, teorikisht dhe praktikisht, se ç'është ekonomizmi nga i cili janë të prirura bashkimet profe-

1. A. M. Kolontaj, diplomate sovjetike, e cila në kohën e diskutimit për bashkimet profesionale (nëntor 1920 — mars 1921) ka qenë pjesëtare aktive e grupit antiparti «opozita punëtore».

sionale. Them janë të prirura, se unë mendoj që bashkimet tona profesionale nuk merren vetëm me ekonominë. Po të gjykonim ndryshe, atëherë do të gabonim në vlerësimin e drejtë të punës së tyre. Këto organizata masash merren edhe me edukim ideopolitik të punëtorëve, prandaj ata që thonë se «bashkimet profesionale t'i lënë llafet e të merren me ekonominë» janë tamam të infektuar nga teoritë antimarksiste për rolin e kësaj organizate dhe vijnë në kundërshtim me realitetin tonë dhe me vijën e Partisë sonë.

Partia na mëson se, për t'i udhëhequr masat, duhet dëgjuar zëri i tyre, se masat duhen mësuar të drejtojnë të gjithë sektorët e jetës. Kur themi që klasa punëtore duhet të jetë në drejtim dhe në udhëheqje, sepse është klasa në fuqi që ka pushtetin e vet dhe ushtron diktaturën e saj, kemi parasysh që ajo të udhëheqë efektivisht dhe në të gjitha drejtimet tërë jetën e vendit tonë. Kjo është vija e Partisë.

Kur Lenini shprehet që organizatat e masave janë «leva» të sistemit të diktaturës së proletariatit, kjo do të thotë që bashkimet profesionale, si organizatë shoqërore masash, që lidhin klasën punëtore me Partinë, në radhë të parë, në fushën e prodhimit, kanë edhe funksionin e mbikëqyrjes së ekonomisë. Në fushën e prodhimit dhe mbi bazën e mbikëqyrjes ekonomike ato duhet të bazojnë gjithë propagandën e tyre. Detyrat në fushën e ekonomisë nuk mund të lihen pas dore nga punëtorët, se, po të veprohej kështu, atëherë këto punë do t'u mbeteshin në dorë burokratëve dhe teknokratëve. Burokratët dhe teknokratët i hedhin në shportë vërej-

tjet e punëtorëve për punën dhe pastaj thonë: «T'i lënë fjalët punëtorët!».

Termet «burokratë», «teknokratë», «ekonomizëm» të kuptohen mirë teorikisht dhe pastaj të përdoren. Anët teorike të çështjeve duhet t'i kuptojmë e t'i thellojmë dhe jo të përdorim fraza vend e pa vend, se frazeologjia e zbrazët për t'i paraqitur gjërat ndryshe nga ç'janë të çon në revizionizëm. Për këto arsye them që formulat të kuptohen politikisht drejt, të përdoren me vend dhe të thellohen nga ana ideologjike.

Më parë ka ekzistuar një prirje revizioniste, sipas së cilës partia nuk duhej të merrej me problemet ekonomike, por vetëm me edukimin e njerëzve. Këtë vijë ka ndjekur Titoja, i cili e likuidoi ish-Partinë Komuniste të Jugosllavisë, e hoqi nga drejtimi dhe e bëri ineffikase, sa të merret me të vërtetë vetëm me llafe. Tani që Titoja e ka parë punën ngushtë, sepse i gjithë regjimi i tij është degjeneruar, si rezultat i shkeljes së vijës marksiste-leniniste, ai po përpiqet më kot të vërë në vend rolin e humbur të partisë. Këtij qëllimi nuk do t'ia arrijë kurrë.

Nuk është drejtori i ndërmarrjes, por klasa punëtore ajo që luan një rol të madh për edukimin e punonjësve, pra edhe të vetë drejtorit të ndërmarrjes. Në qoftë se drejtori o zyrtarë të tjerë nuk punojnë mirë, klasa punëtore, me Partinë në krye, u tërheq veshin dhe, kur është rasti, i çon edhe në gjyq. Që ta luajë klasa punëtore rolin drejtues, është e nevojshme që ajo të marrë pjesë në drejtimin e ekonomisë, të njohë planin. Nuk mjafton aspak që këtë plan të ndërmarrjes ta dinë vetëm kryetari dhe zëvendëskryetari i or-

ganizatës së bashkimeve profesionale, por duhet ta dijë e gjithë baza, pra çdo punëtor. Këta duhet të njohin jo vetëm kaq, por të dinë, njëkohësisht, edhe si do të mbështetin politikisht dhe ideologjikisht plotësimin e detyrave, si do të nxjerrin esencën e problemit, që, duke e zhvilluar këtë nga ana teorike, politike, edukative dhe morale, të organizojnë edhe masa të përshtatshme për ta vënë në jetë. Këtu, kuptohet, se unë nuk po flas për masat administrative, por për masa të tjera. Në këtë çështje, shokë, mua më duket se duhet ta shikojmë mirë realitetin dhe jo të përdorim formulime të pakuptuara mirë.

2. Disa shokë drejtues të organizatave të bashkimeve profesionale, që në çdo rast nxjerrin në radhë të parë «masat administrative», nuk janë drejtues të mirë dhe njerëz politikë të kësaj organizate. Puna kryesore e organizatës së bashkimeve profesionale është edukimi. Bashkimet profesionale, duke vepruar si shkolla të edukimit komunist, duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet që t'i mësojnë punonjësit me frymën e qëndrimit socialist ndaj punës e pronës. Kur disa prej punonjësve punojnë keq ose shpërdorojnë pasurinë socialiste, kjo organizatë e ka për detyrë t'i kritikojë e t'i demaskojë. Masat represive ka kush i merr, për këtë qëllim janë organet shtetërore, që veprojnë sipas ligjit. Disa kuadro, që, sikurse thashë më lart, lënë mënjanë punën edukuese dhe u japin prioritet masave shtrënguese, bien në pozitat e administratorëve burokratë.

Bashkimet Profesionale të Shqipërisë duhet të shpjegojnë qëllimin dhe brendinë politike e ideologjike të masave shtrënguese administrative, ato duhet t'u

shpjegojnë punëtorëve ligjet, dekretet, vendimet e urdhëresat me qëllim që ata të mos gabojnë nga mosnjohja e tyre. Këtë gjë duhet ta bëjë kjo organizatë për arsye se, sikurse e theksova edhe pardje në mbledhjen e Byrosë Politike¹, ligjet përmbajnë vijën e Partisë në mënyrë të sintetizuar. Ligjet popullarizohen që të njihen dhe të zbatohen në mënyrë të ndërgjegjshme nga punonjësit e jo që të zëvendësojnë punën bindëse me kërcënime për marrjen e masave.

3. Fenomeni i kundërt, që në vend të punës bindëse të bëhen vetëm llafe, mund të duket në bashkimet profesionale ose në disa drejtues të tyre, të cilët bëjnë nga një leksion dhe vetëkënaqen, duke e fjetur mendjen se «e kanë kryer detyrën». Këta ia lënë dikujt tjetër barrën që të jetë vigjilent, të hartojë planin, të hetojë vjedhësin që vepron në gjirin e kolektivit të tyre. Drejtuesit e këtij lloji e quajnë të mjaftueshme vetëm të indinjohen kur zbulohet dhe dënohet fajtori. Të tilla mendime të rrezikshme i çojnë disa drejtues të bashkimeve profesionale në një punë të sipërfaqshme. Puna e tyre nuk matet me norma, por me fjalime, me referate, me leksione edukative. Kjo veprimtari nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme, se gjithçka duhet vlerësuar edhe me rezultatet që arrihen, me përparimet që bëhen. Bashkimet profesionale dhe punonjësit e tyre kanë edhe anë pozitive, edhe të meta. Këto organizata kanë përgjegjësinë e vet të madhe kur nuk shkojnë punët mirë në kolektiv, ashtu sikundër kanë edhe meritë kur ato ecin mirë.

1. Shih në këtë vëllim, f. 27.

4. Një ditë shoku Rita [Marko] më foli për punën e organizatave të bashkimeve profesionale në shkolla. Gjatë bisedës më tha se atje këshilli pedagogjik i secilës shkollë, me rregullore, i paska marrë të gjitha të drejtat dhe kompetencat e organizatës së bashkimeve profesionale! Kjo do të thotë që administrata ka mënjanuar bashkimet profesionale, ka eliminuar rolin politik dhe ideologjik të tyre. Atëherë, i thashë shokut Rita, përse nuk e ngrenë zërin organizatat-bazë të Partisë dhe ato të bashkimeve profesionale që të mos pengohen në ushtrimin e funksioneve dhe të kompetencave të tyre? Pse u pëlqen të dyja palëve të qëndrojnë në këto pozita dhe kanë gjetur të drejtë rrugën burokratike shtetërore, duke e quajtur të paqenë rolin e madh të bashkimeve profesionale? Në këto raste ky është një devijim nga rruga e drejtë prej të dyja palëve.

5. Derisa ekziston dhe nuk luftohet tendenca që disa organizata të bashkimeve profesionale fshihin të metat, mungesat, dobësitë dhe fajet e kolektivave punonjës ku veprojnë, atëherë duhet të konkludohet se edukimi, që gjoja bëhet në këto organizata, është i sipërfaqshëm, formal e me rreziqe. Një klasë e edukuar keq degjeneron dhe kështu as që mund të bëhet fjalë për një kontroll të saj qoftë brenda, qoftë jashtë ndërmarrjes.

Kontrolli i klasës, pavarësisht se drejtohet nga Partia (dhe nga Partia duhet të drejtohet), nuk përjashton veprimin aktiv të të gjitha organizatave të masave dhe veçanërisht të bashkimeve profesionale.

6. Mjaft herë unë kam theksuar nevojën e bashkëpunimit të ngushtë, nën drejtimin e Partisë, të të gjitha

organizatave të masave në marrëdhëniet në mes tyre. Nga ky raport që na është paraqitur vërej se kjo punë nuk bëhet si duhet. Po pse? Për këtë çështje le të reflektojnë drejtuesit e këtyre organizatave, të përcaktojnë arsytet dhe të likuidojnë situatën e krijuar.

7. «Mendjemadhësia komuniste» e anëtarëve të Partisë, që bëjnë pjesë në organizatat e bashkimeve profesionale, duket kur ata, siç thuhet në raport, nuk marrin pjesë rregullisht në mbledhje ose, kur marrin pjesë në to, nuk diskutojnë. Ky qëndrim duhet kuptuar jo vetëm thjesht si «mendjemadhësi», por sidomos edhe si moskuptim nga ana e këtyre komunistëve i rolit të masave. Që masat popullore janë forcat që bëjnë historinë, që luajnë një rol vendimtar në zhvillimin e shoqërisë, këtë fakt e pohojnë vazhdimisht anëtarët e Partisë, por disa prej tyre nuk e kuptojnë thellë këtë të vërtetë të pamohueshme, prandaj, kur janë midis masave, në vend që të jenë shumë aktivë, lidhin duart. Në të vërtetë këta nuk janë masovikë, por dembelë, dhe me qëndrimin pasiv që mbajnë ulin rolin e organizatave të masave. Komunistë të tillë qenien në Parti e konsiderojnë si një privilegj dhe kujtojnë sikur bëjnë pjesë në Parti jo që të punojnë shumë më tepër dhe më me përgjegjësi nga masat e gjera punonjëse, por vetëm që të japin urdhra dhe të komandojnë!

8. Udhëheqja kolegjiale është parim dhe detyrë numër një që duhet të kuptohet e të vëhet në jetë në rrugën marksiste-leniniste edhe në organizatën e bashkimeve profesionale. Kryetari ose zëvendëskryetari i organizatës së bashkimeve profesionale mund dhe duhet të japë mendim për zgjidhjen e shumë çështjeve

që i takojnë dhe që i dalin përpara papritur. Ai duhet të mbajë përgjegjësi për to dhe, në rastin më të parë, t'ia paraqesë për miratim udhëheqjes kolegjiale.

9. Çështja e punës vullnetare duhet kuptuar dhe duhet zbatuar drejt nga organizatat e bashkimeve profesionale. Partia na mëson se masat e gjera të popullit, me komunistët në krye, në shembullin e ditëve të shtuna të organizuara për punën vullnetare me porosi të Leninit, duhet të mobilizohen për interesin e socializmit. Vetë Lenini punonte vullnetarisht, duke ngritur edhe trarë në krahë për të ndërtuar shtëpitë e punëtorëve. Këtej del se është një parim i drejtë që njerëzit të sakrifikojnë një pjesë të kohës së tyre të lirë për interesin e përgjithshëm, pra edhe për interesin e tyre.

Njerëzit tanë janë të gatshëm t'i përgjigjen edhe kësaj thirrjeje të Partisë, por nuk duhet tepruar në këtë drejtim, aq sa punëtorët dhe punonjësit e tjerë të rëndohen orë e çast, duke mos u lënë mundësi të çlodhen dhe të merren me edukimin e fëmijëve të tyre, të luajnë me ta e t'i rritin me një formim të shëndoshë ideopolitik e kulturor. Këtë abuzim me gatishmërinë e punonjësve e bëjnë drejtuesit e çdo shkalle dhe të çdo natyre, të cilët veprojnë kështu se kanë gjetur rrugën më të shkurtër e më «të leverdishme», për të mbuluar dobësitë e punës së tyre në terren.

Kemi konstatime që jo vetëm abuzohet me gatishmërinë e njerëzve për punën vullnetare, por, në këtë drejtim, bëhen edhe shtrembërime të karakterit ideologjik. Kështu, për shembull, në disa ndërmarrje bëhen ndalesa nga paga e punonjësve meqenëse këta nuk kanë

mundësi të punojnë vullnetarisht si muratorë ose si karpentierë, për arsye se nuk janë specialistë të këtyre profesioneve. Këto metoda që shtrembërojnë karakterin e drejtë të punës vullnetare duhet të marrin fund. Këtu unë e kam fjalën për punën vullnetare të njerëzve në përgjithësi, por jo për atë që bën rinia jonë heroike gjatë 15 ditëve ose 1 muaji në vit në aksionet që i beson Partia, as për punën në prodhim që bëjnë punonjësit në bazë të ligjit.

Për punën vullnetare duhet të bëhet një plan ku të vihen në ballë ato punë që janë më të nevojshme të kryhen dhe për të cilat duhet të sakrifikojmë edhe gjumin. Në radhë të parë, në kushtet tona, vijnë sakrificat për mbrojtjen, pastaj ato për prodhimin. Puna vullnetare për prodhimet bujqësore duhet organizuar vetëm në kohë piku, domethënë kur gjykohet se nevojat e prodhimit nuk mund të përballohen vetëm me punën e kooperativistëve dhe me mekanizmat ekzistues.

Prodhimi është çështje e dytë që duhet marrë në konsideratë. Të tjerat janë të dorës së tretë dhe të katërt. Punë vullnetare do të bëhet edhe për ndërtimin e shtëpive. Kjo punë do të llogaritet që të fillojë e të mbarojë për të gjithë brenda një orari të caktuar. Në qoftë se punonjësi nuk është murator, s'ka gjë, se punë për të do të ketë, ai do të mbajë trarë, do të mbajë gurë. tulla, tjegulla, llaç ose do të ngjitë kovat lart etj. Por, e përsëris, nuk është e drejtë t'u zihet njerëzve gjithë dita e pushimit javor ose t'u bëhen ndalesa nga paga për punën vullnetare. Ata që abuzojnë në këto drejtime thonë se «ka entuziazëm të madh në punën vullnetare», por nuk mund të jetë kështu. Nje-

rëzit nuk shkojnë të gjithë me -entuziazëm të madh-, duke i ngritur që në orën katër të mëngjesit, në acar, për të punuar në një kooperativë bujqësore, sepse, bie fjala, mjaft fshatarë të kësaj kooperative, në vend që të punojnë vetë, shkojnë në pazar të Tiranës për të shitur disa kokrra vezë. Puna vullnetare të organizohet kur duhet dhe jo për të zëvendësuar mungesën e drejtimit normal e sistematik të punëve nga organizatat e Partisë dhe nga organet shtetërore ose ekonomike në fshat, që s'janë në gjëndje të organizojnë punën. Në raste të tilla nuk duhen dërguar njerëz për punë vullnetare në fshat.

Bashkimet profesionale kanë rolin e tyre në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Mund të ketë parti që i lejon grevat dhe demonstratat, por Partia jonë, në bazë të mësimëve të Leninit, nuk i lejon. Qëndrimi që mbajmë ne është leninist, sepse në një vend ku është vendosur diktatura e klasës punëtore grevat e demonstratat janë të gabuara në parim. Në vendin tonë, ku shteti dhe Partia janë shumë të interesuar për mbrojtjen e interesave të punonjësve, jo vetëm nuk janë të nevojshme grevat e demonstratat, por bile janë të dënueshme. Përkundrazi, në vendet ku është vendosur pushteti i borgjezisë ose diktatura fashiste, apo revizioniste, grevat e demonstratat me kërkesa ekonomike dhe politike janë të domosdoshme.

Lenini na mëson që klasa punëtore ka rol kontrollues. Ky kontroll i klasës punëtore ushtrohet mbi të gjithë administratën shtetërore. Kështu, në qoftë se plani i shtetit nuk hartohet mirë, klasa punëtore dhe organizata e saj e bashkimeve profesionale duhet të

bëjnë vërejtje, në qoftë se plani hartohet, por nuk zbatohet mirë, klasa gjithashtu duhet të bëjë vërejtje, në qoftë se nga ana e administratës së ndërmarrjes nuk respektohen dhe shkelen interesat e punëtorëve të mbrojtur nga ligjet e shtetit socialist dhe direktivat e Partisë, punëtorët duhet të ngrenë zërin. Ku duhet të ngrenë zërin këta? Në demonstrata? Jo! Në organizatën e Partisë e të bashkimeve profesionale, që zëri i tyre të dëgjohet gjer në udhëheqje.

Punëtorët, kooperativistët, mësuesit e të tjerë t'i thonë «Ndal!» atij nëpunësi të administratës që guxon të bëjë dallavere, hatëre, abuzime dhe vjedhje. Në qoftë se i zbatojmë tezat leniniste për këto çështje, Partia do të ketë suksese të jashtëzakonshme në udhëheqjen e masave dhe organizatat e masave do të bëhen me të vërtetë leva të shëndosha, ashtu siç na porosit Lenini.

Këto kisha për të thënë unë. Jeni dakord?

(Të gjithë shokët shprehen njëzëri se janë dakord.)

*Botuar për herë të parë,
me ndonjë shkurtim, në
librin: Enver Hoxha, «Rapor-
te e fjalime 1974-1975»,
f. 401*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë
nga procesverballi i mbledhjes
së Sekretariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

**DISA MENDIME PËR FORCIMIN E SHTYPIT
USHTARAK DHE TË PROPAGANDËS PËR
MBROJTJEN NË SHTYP DHE NË
RADIOTELEVIZION**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

26 nëntor 1975

Kam edhe unë disa vërejtje për këtë çështje që po shqyrtojmë.

1. Unë nuk njoh shumë nga kuadrot e rinj të ushtrisë. Edhe shokun kryeredaktor të gazetës «Luftëtari», që është një kuadër i ri me perspektivë, i cili është përgatitur në shkollë dhe e njeh ushtrinë, sot e shikoj për herë të parë, prandaj nuk mund të them sa aktivizohen të rinjtë për të shkruar në shtyp, por nga kuadrot e vjetër ushtarakë, që i njoh, nuk kam parë të aktivizohen shpesh për të shkruar në shtypin ushtarak.

1. Në këtë mbledhje u mor në shqyrtim raporti i paraqitur nga sektori i shtypit pranë aparatit të KQ të PPSH «Mbi disa masa për forcimin e mëtejshëm të shtypit ushtarak dhe të propagandës për mbrojtjen në shtyp dhe në RTV».

Edhe ato shkrime që botohen në organet e shtypit ushtarak, janë më tepër të përgjithshme, me karakter korrespondencash të thjeshta informative ose të shkruara nga redaktorët. Më përpara organet e shtypit mbështeteshin në redaktorët e tyre dhe jo në korrespondentët vullnetarë, të cilët janë edhe ata shokë me partishmëri dhe mund të trajtojnë në shtyp, me kompetencë, probleme politike, ideologjike, ushtarake dhe teknike. Në qoftë se kjo praktikë është edhe tani, duhet të marrë fund. Sado të zotë të jenë redaktorët e një gazete, vetëm ata nuk mund ta ngrenë nivelin e gazetës, po për këtë qëllim duhet të kontribuojnë edhe shumë shokë të tjerë. Po kështu ndodh edhe në shtypin ushtarak. Që të mund të ngrihet niveli i këtij shtypi, aq më tepër kur pranojmë që në ushtri kemi njerëz kompetentë, me zotësi politiko-teorike, teknike etj. dhe që e kuptojnë mirë vijën e Partisë, del se sa i domosdoshëm është bashkëpunimi me shokë të tjerë jashtë redaksisë.

2. Mendoj se në shumë nga shkrimet që botohen në organet e shtypit ushtarak, në përgjithësi ka frazeologji. Shumë herë në to shprehen ide të përsëritura, bile të thëna gati njësoj në çdo numër. Kjo mënyrë veprimi, shokë të ushtrisë, i bën organet tuaja të shtypit pa shumë interes. Nga vjen kjo? Kjo vjen nga cektësia e autorëve që shkruajnë, të cilët i ka mbuluar rutina dhe shumë herë udhëhiqen nga ndjenja për të mbushur gazetën me llafse, se faqet e saj duhen plotësuar doemos.

3. Në organet e shtypit vazhdojnë akoma lavdërimet dhe epitetet bombastike të stilit të vjetër, të dë-

nuar, që u vihën ushtarakëve vend e pa vend. Kjo gjë duket deri edhe në botimin e fotografive të ushtarëve, të cilëve, para se të fotografohen, me siguri u rekomandohet të marrin poza dhe pamje prej «fodulli», pamje «marciale», që të duket se «janë gati të shqyejnë në çast kundërshtarin». Të mos harrohet se edhe fotografia luan rol edukativ, prandaj edhe në këtë drejtim duhet të bëhet kujdes.

Është e vërtetë që, siç the ti, shoku kryeredaktor i gazetës «Luftëtari», Beqir Balluku kishte urdhëruar për të mbushur shtypin me fotografi, për arsye se bashkë me Hito Çakon dhe Petrit Dumen donin ta shndërronin shtypin në një instrument pa përmbajtje. Ata urdhëronin për të botuar fotografi ushtarësh e kuadrosh andej e këtej, me vend e pa vend, me qëllim që të mos botoheshin shkrime, ku të trajtoheshin e të zbërtheheshin politika dhe vija e Partisë.

Këto të meta në shtypin ushtarak, natyrisht, nuk kanë ardhur vetvetiu, ato janë pasojë e një deformimi të vijës, të politikës, të ideologjisë dhe të moralit proletar. Kjo frymë, që futej në shtyp në shumë drejtime, ishte shprehje e veprimtarisë së tradhtarëve të Partisë në ushtri, që kishin për synim të ulnin rolin dhe forcën e ushtrisë, të degjeronin Partinë dhe, më në fund, të bënin puçin ushtarak. Ne e dimë tani punën armiqësore të Hito Çakos. Ai vinte rregullisht në mbledhjet e Sekretariatit të Komitetit Qendror, ku kemi marrë shumë herë në shqyrtim edhe probleme të shtypit. Po ai nuk u thoshte ndonjë fjalë shokëve që punonin në këto organe të ushtrisë për problemet që diskutoheshin këtu dhe që u takonin drejtpërsëdrejti atyre për

t'i vënë në jetë. Prandaj, për të zhdukur të metat që vërchen, duhet të merren masa rrënjësore.

4. Problemet e historisë së popullit dhe të vendit tonë trajtohen shumë rrallë dhe shumë dobët në shtypin ushtarak. Mendohet nga disa se në revistat e ushtrisë, qofshin edhe ato me karakter propagandistik, duhet të shtypen vetëm tregime ushtarake të kohës së Luftës Nacionalçlirimtare dhe këto të ilustruara vetëm me shigjeta. Në këtë mënyrë edukimi patriotik kufizohet. Edhe që të shkruhet për ndonjë ngjarje të kohës së kaluar si, bie fjala, për ndonjë përpjekje të rilindësve, duhet të kurdisen shigjetat që të tregojnë zhvillimin e një beteje të përgjakshme. Tema e madhe patriotike shihet rrallë në shtypin ushtarak, sikur kjo të jetë e huaj për të.

Mund të thuhet se me trajtimin e temës patriotike merren edhe revista të tjera. Kjo është e vërtetë, por unë jam i sigurt që, megjithëse duhet, ato nuk lexohen nga ushtarakët. Nuk jam në gjendje të them gjë të saktë për shkallën e përhapjes së letërsisë patriotike nëpër reparte, nuk mund të përcaktoj sa mundësi ka që revistat e ndryshme t'u bien në dorë ushtarëve dhe kuadrove ushtarakë, por vë dorën në zjarr se për këto probleme nuk jep rezultate leximi i shpejtë për pesë minuta i disa gjërave nga shtypi i përditshëm.

5. Jam i bindur se në shkrimet me karakter edukativ, për punën e Partisë redaksitë e organeve të shtypit ushtarak janë në stadin e shabllonizmit dhe të rutinës së dënueshme të kohës para zbulimit të punës armiqësore. Kjo ndodh për arsye se nuk merret as shembulli, nuk përfitohet sa duhet as nga eksperiencia dhe as

nga mënyra e paraqitjes së këtyre problemeve nga shtypi ynë joushtarak. Në shumë gazeta e revista si, bie fjalla, në gazetën «Bashkimi» e «Zëri i rinisë», në revistën «Rruga e Partisë» e të tjera, pa folur për «Zërin e popullit», nga kreu e deri në fund flitet për edukatën komuniste, por ky shembull nuk ndiqet, se shkohet me mendimin e gabuar që gjithë ushtria, në çdo gjë, ka karakteristika të veçanta. Kjo, mendoj unë, nuk mund të pranohet absolutisht.

Frika që keni ju, shokë të Komitetit të Partisë të Ministrisë së Mbrojtjes, për të botuar në shtypin ushtarak artikuj orientues për punën e Partisë, është e pajustificuar. Po të pranohet teza që në gazetën e në revistat ushtarake të mos ketë artikuj me karakter orientues për punën e Partisë, sepse këto organe shtypi janë të Ministrisë së Mbrojtjes e jo të Komitetit Qendror, atëherë do të dilej në një rrugë krejt të kundërt nga ajo që synojmë të arrijmë. Po të pranohet kjo tezë e gabuar, gjithë shtypi ushtarak duhej të shkruante vetëm për çështjet tekniko-ushtarake dhe jo për ato politike. Këtë gjë dëshironin Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja. Ju mendoni që për çështjet e Partisë të shkruajë vetëm gazeta «Zëri i popullit» ose revista «Rruga e Partisë», që janë organe të Komitetit Qendror të PPSH, po atëherë ç'të bëni ju, shokë, të transmetoni vetëm urdhrat e Komandës?! Nuk është e drejtë kjo pikëpamje. Të kuptohemi drejt. Edhe për çështjet ushtarako-teknike, aq sa lejojnë rregullat e sekretit, do të shkruhet, siç bëjnë edhe organet e tjera. Për këto çështje shkruajnë edhe në gazetën «Zëri i popullit», por anës ushtarako-teknike ata i veshin edhe

anën politike. Pikërisht këtë gjë duhet ta edukojmë te njerëzit që shkruajnë në gazetë, me qëllim që shkrimet e tyre të jenë të plota dhe të mos i trajtojnë çështjet në mënyrë të njëanshme.

Partia na mëson se në drejtim është politika, pra ndaj ata që nuk mendojnë kështu, por i japin përparësi teknikës, nuk janë në binarë. Sigurisht, edhe teknika duhet t'u mësohet ushtarëve, por duhet t'u mësohet që ata, në radhë të parë, të jenë njerëz politikë, se ashtu e kuptojnë rëndësinë e teknikës, të armës. Ne ngahera themi se politika e Partisë është në radhë të parë. Po politika e Partisë nuk është e shkëputur edhe nga të mësuarit, për shembull, të topit, të mitralozit, të avionit etj. Këto janë të gjitha të lidhura e nuk mund t'i ndash me thikë. Nga ana e atyre që kanë më shumë eksperiencë, duhen bërë përpjekje për t'i parë dhe për t'i trajtuar problemet në radhë të parë politikisht.

E kemi shpjeguar qartë dhe nuk ka përse ta përsëritim tashti se urdhrat e Komandës nuk kanë vlerë në qoftë se ato nuk mbështeten në udhëzimet e Partisë dhe në qoftë se nuk trajtohen në prizmin e politikës dhe të ideologjisë së Partisë. Nuk është e drejtë të mendohet që «Për çështje ushtarake duhet drejtuar në zyrat e Komandës, kurse për ato të Partisë këtej nga dhoma tjetër, në zyrën e komitetit të Partisë!». Kjo nuk është çështje formale. Le të jetë gazeta «Luftëtari» organ i Ministrisë së Mbrojtjes, ky fakt nuk pengon aspak që në të të shkruhet për vijën e Partisë dhe për udhëzimet që jepen prej saj në ushtri. Në gazetë do të bëhet e qartë se kështu orienton, këshillon, porosit,

urdhëron Komiteti Qendror i Partisë, ose kështu ka vendosur për këtë çështje, për këtë eksperiencë pozitive, ta zëmë, organizata e Partisë e njësisë «N», këtë eksperiencë duhet ta adaptojnë të gjithë në punën e tyre politike, ideologjike, kulturore etj., se pa bërë këtë gjë nuk mund të zbatohet drejt urdhri i Komandës në këtë ose në atë drejtim etj. E rëndësishme është që në shtypin ushtarak të ruhet e të mbrohet vija e Partisë. Ishte tjetër metodë dhe udhëhiqej nga të tjera qëllime veprimtaria e përbashkët e Beqir Ballukut, Petrit Dumes e Hito Çakos me shokë për t'iu shmangur udhëheqjes së Partisë në ushtri. Qëllimet e tyre ishin antiparti, kurse ju jeni besnikë të Partisë, prandaj mos gurroni në këtë drejtim.

Sikurse tha edhe shoku Ramiz [Alia] në diskutimin e tij, tani që Komiteti Qendror i Partisë lidhet drejtpërdrejt me komiteet e Partisë të njësive, ky, nëpërmjet aparatit të vet, e ka syrin kudo dhe shikon jo vetëm punën politike që po zhvillohet në ushtri ose për të cilën shkruhet në gazetën «Luftëtari», në revistën «10 Korriku» apo «Për mbrojtjen e atdheut», por edhe mënyrën e kuptimit dhe të zbatimit të të gjithë urdhërave të Komandës. Në qoftë se punohet në rrugë formale dhe mbyllen sytë para shfaqjeve të papëlqyeshme, atëherë mund të kemi abuzime. Gabime të tilla nuk duhet të lejohen më në të ardhmen.

Ushtria ka veçoritë e veta, po ama, po t'i shikojmë këto në thellësinë e tyre, në kuptimin leninist dhe të Partisë sonë, do të dalë se në ushtri nuk është gjithçka specifike. Puna në ushtri ka veçori, por ka dhe shumë gjëra të përbashkëta me punën e Partisë në te-

rren. Ushtria jonë është ushtri e popullit të armatosur. Gjithë populli ynë është ushtar. Në këto kushte, çfarë karakteristikash të veçanta ka topi për ushtrinë në kazermë dhe për ushtarakët rezervistë, që punojnë në ndërmarrje apo në kooperativë? Çfarë karakteristikash të veçanta ka zbërthimi i Artit Ushtarak të Luftës Popullore për ushtarakët aktivë dhe për ata që janë në rezervë? Nuk ka asgjë të veçantë. Ushtaraku, qoftë aktiv apo rezervist, etj., është ushtar për mbrojtjen e atdheut socialist dhe, si i tillë, duhet të njohë mirë artin ushtarak.

Ruajtja me fanatizëm e sekretit ushtarak është një specifikë e ushtrisë, por kjo detyrë u takon gjithë popullit, gjithë Partisë, se ka të bëjë me interesat e lartë të mbrojtjes së atdheut. Disa gjëra që janë specifike për ushtrinë si, për shembull, organizimi, efektivi numerik, dislokimi, armatimi, planet e mobilizimit, plani i mbrojtjes, gatishmëria luftarake e forcave të armatosura në përgjithësi dhe të tjera çështje, në asnjë mënyrë nuk mund të bëhen llafe pazari. Nuk lejohet që diçka sekrete, të cilën për shkak të detyrës që kryejnë, e njohin vetëm 20 veta, ta marrin vesh dhe një milion veta. Nesër të tërë do të luftojmë për mbrojtjen e atdheut, por a do të thotë kjo që ta dijë gjithë populli planin operativ? Jo, në asnjë mënyrë, se ky plan është specifik dhe njihet vetëm nga një rreth i kufizuar njerëzish. Në këto drejtime ka çështje të veçanta që janë vetëm për ushtrinë. Kuadrot duhet t'i mësojnë dhe t'i edukojnë njerëzit që në këtë drejtim të reflektojnë më gjerë në bazë të vijës së Partisë dhe të perspektivës sonë. Këtë vijë të Partisë na e kishin shtrembëru-

ar armiqtë. Këto mendime që shprehen janë, si me thënë, mbeturinat e asaj paqartësie që ekziston në ushtri ndaj problemeve të rëndësishme ushtarake.

6. Të rinjve në ushtri nuk u duhet të dinë vetëm për jetën në repartin ushtarak ku shërbejnë, por ata kanë nevojë të njihen edhe me jetën jashtë ushtrisë, prandaj do të jetë gabim t'ua kufizojmë atyre horizon-tin e shikimit dhe t'i privojmë nga njohja e luftës së madhe që bën gjithë rinia e vendit tonë për ndërtimin e socializmit. Njohja me këto probleme duhet të jetë një nxitje për të rinjtë në ushtri, që edhe ata t'i kryejnë në mënyrë të përpiktë detyrat e tyre në fushën e mbrojtjes. Pra, jo vetëm nuk duhet shkruar pak dhe vetëm për disa tema në shtypin ushtarak, por të shkruhet shpesh dhe në mënyrë sa më të larmishme për ato probleme që i interesojnë më tepër rinisë.

7. Edukimi teknik dhe ai ideopolitik duhet të zënë pjesën kryesore të shtypit ushtarak. Informacionet e vogla të shumta, që edhe ju i kritikuat, si fjala vjen, për të vënë në dukje e për të mburrur një repart, një kuadër apo ushtar, duhet të evitohen sa të jetë e mundur më shumë. Të kuptohemi, unë nuk them që të mos shkruhet fare për këto çështje, por e kam fjalën që të mos mbushet gazeta me këto shkrime.

Mjaft herë lexojmë që në repartin ushtarak ku shërben filani veprohet kështu ose ashtu. Këto të dhëna me emra ushtarakësh mezi i presin armiqtë. E mbani mend, shokë, se në kohën e luftës Komanda e Përgjithshme kishte urdhëruar që, kur kapeshin robërit, këtyre t'u merreshin shenjat dhe yjet, për të parë se të ç'repartit ishin, nga vinin etj.? Këto veprime i bën edhe agjentura e huaj.

Nuk e di sa e ka marrë në analizë çështjen e vigjilencës Komanda dhe si e keni trajtuar në shtyp ju, punonjësit e redaksisë. Keni analizuar për çfarë duhet e për çfarë nuk duhet të shkruhet, si duhen paraqitur njoftimet në shtyp, që të kuptohen mirë këto ose ato probleme? Se kjo gjë ka rëndësi të madhe. Ka rëndësi, në radhë të parë, që problemi për të cilin shkruhet, të bëhet i kuptueshëm dhe i asimilueshëm për gjithë ushtrinë, që ushtari dhe kuadri, kur lexojnë shtypin, të kuptojnë se është fjala për ta, se ato që thuhet janë direktiva e sqarime për ta, kurse armiku të mos kuptojë asgjë nga ato që i interesojnë, nga shkrimet e shtypit tonë ai të jetë në tym e në mjegull. Këto duhet t'ua mësojmë shokëve që drejtojnë ose që shkruajnë në shtypin ushtarak dhe në shtypin tjetër të Partisë, se kanë rëndësi të madhe.

Në qoftë se në mbledhjet e redaksive të shtypit ushtarak dhe joushtarak nuk bëhet problem edhe çështja e konspiracionit për të dhënat me karakter ushtarak, kjo neglizhencë do të ketë pasoja të rënda. Këtu nuk shtrohet çështja që të mos shkruhet asgjë për ushtrinë, se atëherë do të vihej pyetja ç'e duam shtypin, por puna është që, krahas kujdesit e vigjilencës që duhet të kemi para botimit të çdo gazete apo reviste, të bëjmë analiza të herëpashershme për të parë nëse është botuar diçka që mund t'i shërbejë armikut. Në këtë drejtim duhen bërë debate e diskutime për mënyrën se si t'i shtrojmë e t'i trajtojmë në shtyp problemet e ushtrisë, pse vetëm kështu gjendet rruga e drejtë e zbërthimit të direktivave.

Po të bëhet drejt diskutimi i çështjeve, atëherë

çdo gjë do të rregullohet. Mos kini frikë se mund të gaboni një herë, dy apo tri herë. Unë dua t'ju jap një porosi: Mos e neglizhoni mendimin e organizatës-bazë të Partisë për çështje të rëndësishme që u dalin redaksive për diskutim. Mbledhja e redaksisë nuk e zë kurrë vendin e mbledhjes së organizatës-bazë të Partisë. Është mbledhja e organizatës-bazë të Partisë, në radhë të parë, pastaj vjen mbledhja e redaksisë. Pavarësisht nga fakti se në redaksinë tuaj shumica e kuadrove mund të jenë komunistë, prapëseprapë është mbledhja e organizatës-bazë ajo që vendos më me kompetencë dhe që jep mendimin më të saktë.

Mendoj që shkrimet kryesore, qofshin me karakter teknik ose teorik, duhet të bëhen nga kuadro kompetentë. Me kuadro kompetentë që duhet të përgatitin këto shkrime, unë nuk kuptoj frazaxhinjtë dhe ata që bëjnë «simite», se diçka duhet të shkruajnë. Jo. Këtu kam parasysh shokët që shqetësohen për edukimin politik, ideologjik dhe teknik të ushtrisë dhe që për këtë qëllim studiojnë thellë materialet dhe eksperiencën e Partisë jo vetëm në ushtri, por edhe jashtë saj, duke u përpjekur që ta kryejnë këtë detyrë me përgjegjësi të madhe. Këto që thashë, natyrisht, nuk përjashtojnë që për të tilla probleme të shkruhet edhe nga ushtarë të thjeshtë ose nga rezervistë që i kemi me mijëra. Në shtyp të shkruhet jo vetëm për çështje ushtarake, por edhe për çështje politike e historike, të botohen skeçe, tregime etj., si dhe lloj-lloj kuriozitetesh që t'i interesojnë ushtarit. Këto mundësi ju nuk i shfrytëzoni si duhet. Mos u dëshpëroni nga kritika që ju bëj, se nuk jeni të vetmit ju që neglizhoni në këtë

drejtim. Edhe në këtë në aparatën e Komitetit Qendror e në Sekretariat nuk i shfrytëzojmë kurdoherë mirë të gjitha mundësitë që kemi. Qëllimi i kritikës sime është që ju t'i kuptoni mirë detyrat tuaja dhe, me ndihmën e Partisë, të përmirësoni punën.

8. Paraqitja e temave ushtarake në gazetën «Zëri i popullit» mendoj të qëndrojë kështu siç është aktualisht. «Zëri i popullit» nuk mund të trajtojë tema ushtarake me karakter thjesht teknik etj., që nga natyra e tyre i përkasin ushtrisë. Por «Zëri i popullit» docmos duhet të shkruajë për ushtrinë, bile edhe në mirë nga sa ka shkruar. Për këtë qëllim të ndihmohet edhe nga ushtarakët kompetentë, por ky organ i shtypit të Partisë nuk duhet të marrë detyrat që u përkasin organeve të shtypit ushtarak.

Unë nuk jam i mendimit që të ketë medoemos një plan të parapërgatitur të përbashkët të gazetës «Zëri i popullit» dhe Ministrisë së Mbrojtjes Popullore për përgatitjen dhe për botimin e temave ushtarake, sikurse tha shoku kryeredaktor i gazetës «Zëri i popullit», sepse kjo gjë ka rrezik, nga një anë, të mos mendohet vazhdimisht për problemet e reja që dalin dhe, nga ana tjetër, ta mënjanojnë shtypin e ushtrisë nga puna për zbërthimin e çështjeve që kanë të bëjnë me edukimin ushtarak etj. Jam i sigurt që shokët ushtarakë nuk përtojnë të shkruajnë, por, sikurse vura në dukje pak më parë, këta duhet të kuptojnë se s'ka aspak rrezik që në gazetën e ushtrisë të flitet në emër të Komitetit Qendror të Partisë ose në emrin e Komitetit të Partisë të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore. Shoku sekretar i Komitetit të Partisë të Ministrisë së

Mbrojtjes, është e vërtetë se Komiteti i Partisë ku punon ti drejton punën e Partisë në ministri, varet drejtpërdrejt nga Komiteti Qendror dhe bashkëpunon shumë ngushtë me Komandën, por kjo nuk do të thotë aspak që ti dhe shokët e tu të komitetit të mos njihni gjithë situatën e Partisë në ushtri. Në qoftë se ju nuk do ta njihni këtë situatë, atëherë nuk mund t'i udhëzoni dhe nuk mund t'i kontrolloni si duhet komunistët e ministrisë për plotësimin e detyrave, sepse do të flisni në hava. Kështu kuadrot komunistë ose ata të paorganizuar në Parti, kur venë në bazë, mund të bëjnë çfarë të duan dhe Komiteti i Partisë nuk do të ketë mundësi të marrë dijeni për punën e tyre. Kjo gjë nuk do të ishte e drejtë.

Kur zëvendësministrat e Mbrojtjes ose kuadro të tjerë venë në njësi ushtarake për të kontrolluar dhe për të ndihmuar në zbatimin e detyrave në planin ushtarak, ata, pavarësisht se janë ose nuk janë anëtarë të Komitetit Qendror të Partisë ose të Byrosë Politike, nuk do të mbyllin sytë për punën e Partisë në këto njësi. Shokët drejtues të Ministrisë së Mbrojtjes kurrë nuk mund të jenë indiferentë për punën e Partisë në ushtri, jo vetëm sepse janë anëtarë partie, por edhe për faktin se po nuk mësuan si punon Partia në ushtri, atëherë nuk kanë marrë vesh asgjë për qëllimin që kanë vajtur në reparte. Nuk mund të shkëputen artificialisht problemet politike nga ato teknike.

Është çështje tjetër ajo se nga udhëhiqen komitetet e Partisë dhe komandat e njësive dhe se sekretari i Komitetit të Partisë të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore nuk jep dot urdhra atje, por kjo gjë nuk për-

bën pengesë që për vërejtjet që ka ai të sinjalizojë Komitetin Qendror ose udhëheqjen e ministrisë dhe vetë komitetin dhe organizatën e Partisë ku vete shikon. Kur ju, shokë drejtues të ministrisë, shkoni në një repart ushtarak dhe atje vëreni të meta, mund t'u thoni shokëve të repartit: «Këtu nuk ka disiplinë, këtu mungon konspiracioni, ju shokë komunistë bëni gjumë» etj. Mendimin tuaj për këto të meta mund ta thoni në organin kompetent të Partisë. Ne themi që çdo njeri, pra edhe ai që nuk është anëtar partie, ka të drejtë të vijë deri këtu në Komitetin Qendror për të shfaqur mendimet e tij për punën dhe për njerëzit e jo më komunistët e kuadrot. Pirrjen e armiqtve për izolimin e Komitetit Qendror të PPSH nga çështjet ushtarake Partia e ka demaskuar dhe e ka dënuar.

Duke vendosur në rrugë të drejtë, nga ana organizative, çështjen e drejtimit të Partisë në gjithë ushtrinë, ne nuk cenojmë asnjë nga normat e Partisë. Përkundrazi, nuk do të ishte aspak e drejtë që një kuadër ushtarak të vejë në njësinë e caktuar dhe atje të shikojë vetëm çështjen ushtarake, kurse për problemin e Partisë të mos interesohet. Kuadri i ushtrisë duhet t'i shikojë të dy këto drejtime, sepse, siç kemi thënë edhe tjetër herë, drejtimi politik dhe ai ushtarak nuk shkëputen nga njëri-tjetri, prandaj dhe sekretari i komitetit të Partisë, komandanti dhe komisari janë udhëheqësit kryesorë të ushtrisë e të Partisë në njësi. Në goftë se flitet për artilerinë, nuk mund të heshtet për artiljerin. Dhe që të flitet mirë për armën dhe për njeriun që e përdor këtë armë, çështja duhet të trajtohet bashkërisht nga Partia dhe nga komanda. Në këtë

drejtim duhet pasur kujdes që të mos shkelet vija organizative e Partisë, e cila nuk duhet shikuar në mënyrë të ngurtë.

Jam dakord me paraqitjen e temave ushtarake në televizion, por këto duhet të studiohen mirë, pse tani arrihet deri atje sa, disa herë, shumë emisione të sektorit civil, që jepen në seri, janë të specializuara deri në atë shkallë sa mund t'u shërbejnë vetëm specialistëve, ndërsa masat e gjera punonjëse i mërzhitin. Televizioni nuk duhet t'u paraqesë spektatorëve, ta zëmë; auditorin e psikiatrisë në seri, ose të japë kursin e leksioneve të universitetit me skica e me plane të stërholluara për arkitekturën. Këto që po them nuk i marr me mend, por i kam parë në emisionet tona televizive. Kur flitet për artin e popullit shqiptar dhe për punimet artistike, ta zëmë, në Berat, telespektatori ka dëshirë të shikojë objektet artistike: dollapin, tavanin, musandyrën etj. dhe jo vetëm fytyrën e arkitektit, që jep shpjegime. Arkitekti mund të paraqitet një a dy herë në ekran sa për të treguar cili është ai që flet dhe pastaj ai të mos duket më. Duke paraqitur vazhdimisht specialistin që jep shpjegime dhe skicat që ai ka varur në mur për të treguar se këtu është dritarja dhe atje oxhaku që del nga ana e derës me qëllim që të mos ketë korrente e të tjera, emisioni bëhet i mërzhitshëm. Këto hollësi mund t'i hyjnë në punë auditorit në universitet, por jo publikut.

Të metat e natyrës që përmenda, nuk duhet të ekzistojnë edhe në emisionet televizive për ushtrinë. Çdo temë me subjekt ushtarak e tërheq publikun tonë, por interesimi i tij varet shumë edhe nga mënyra si i

paraqitet kjo temë, si skenarizohet dhe si punon regjia për këtë qëllim. Televizioni ynë është i ri, por duhet të punohet akoma që të korrigjohet. «Bukën», me aq sa ka, ai ta mbrujë dhe ta pjekë mirë, që ajo të hahet me shije.

Duke marrë parasysh të gjitha ato që u thanë, gazeta «Luftëtari» duhet të mbetet dhe të përmirësohet në të gjitha drejtimit që flet raporti, që përmendën shokët dhe ju gjatë diskutimit. «Luftëtari» është një gazetë masive e ushtrisë, që e duan ushtarët, por ne nuk kemi mundësi ta nxjerrim në një tirazh aq të madh sa i nevojitet Ushtrisë Popullore, e cila, siç dihet, nuk është vetëm ajo e kazermës. Për të lexuar këtë gazetë, janë të interesuar edhe rezervistët, edhe pjesëtarët e çetave vullnetare. Megjithatë të përpiqemi ta shfrytëzojmë mirë këtë tirazh që botojmë. Kryesore është që në shtypin ushtarak të përmirësohet mënyra e trajtimit të problemeve ushtarake, politike, ideologjike, morale dhe të kurioziteve shkencore e zbavitëse e të tjera. Të përpiqemi që shtypi të ruajë kurdoherë karakterin ushtarak, por të tërheqë lexuesit.

Të them të drejtën unë nuk jam i mendimit që në vend të dy revistave ushtarake «10 Korriku» dhe «Për mbrojtjen e atdheut» të kemi vetëm një revistë. Mendoj që revista «10 Korriku» të mbetet përsëri, por jo të trajtojë edhe anën teknike. Ju doni t'i bashkoni të dyja revistat, sepse këto i keni shumë të dobëta. Ky shqetësim juaji është i drejtë, por gjendja aktuale nuk duhet të na pengojë për të kapërcyer hendekun. Të jemi të bindur që në ushtrinë tonë kemi njerëz të zotë. Këtë e them me plot gojën. Këta njerëz të aftë, që ishin nën-

vleftësuar nga armiqtë, i shohim tani që kanë një mprehtësi politike, ideologjike dhe ushtarake shumë të lartë. Kur bëjmë mbledhjet e Këshillit të Mbrojtjes, kemi vënë re se shokët ushtarakë, që thërriten në këto mbledhje, qëndrojnë në nivelin e detyrave të caktuara. Këta njerëz mund të shkruajnë gjëra shumë të mira në gazetë ose në revistat ushtarake. Ne kemi jashtëzakonisht shumë nevojë për shkrimet e këtyre shokëve.

Revista «10 Korriku» ka karakter ushtarak, politik, edukativ, kulturor dhe artistik. Po kështu dhe revista «Për mbrojtjen e atdheut» ka profilin e saj. Në radhë të parë, ka rëndësi brendia e tyre, larmia e temave. Paraqitja, ilustrimi dhe fotografia kanë rëndësinë e tyre, por nuk mund të vihen mbi përmbajtjen. Për këto arsye fotografia në shtyp duhet të botohet duke ruajtur përpjesëtimet e nevojshme, pa cenuar aspak brendinë.

Shtypi ushtarak duhet të flasë edhe për edukimin patriotik të rinisë, për rilindësit, për luftën e Dedë Gjo Lulit, të Bajram Currit, për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, për Kongresin e Manastirit etj., etj. Është e vërtetë se për këto probleme shkruajnë edhe organet e tjera qendrore dhe lokale të shtypit tonë, por s'ka asgjë të keqe veç së mirës në këtë drejtim po të shkruajë edhe shtypi ushtarak. Mbi të gjitha ngjarjet historike dhe luftërat e kohës së kaluar qëndron Lufta e madhe Nacionalçlirimtare, prandaj duhen botuar shumë shkrime për episode interesante nga kjo luftë. Këto shkrime të jenë të përgatitura me kujdes, të jenë mobilizuese, prekëse dhe jo të botohen përralla e gënjeshtër, siç bë-

nin Beqir Balluku, Hito Çakoja dhe shumë bashkëpunëtorë të tyre, të cilëve ju bëtë mirë që u vutë fshesën.

Mos kujtoni, shokë, se, me masat që mori Partia për spastrimin e armiqve në ushtri, u zhduk tërë mentaliteti i sëmurë që ka ekzistuar më parë. Nuk ndryshohet kollaj mentaliteti ose rutina e formuar prej një kohe të gjatë. Shokët që keni ju në organet e shtypit janë të gjithë të mirë, për këtë gjë unë nuk kam asnjë dyshim, asgjë për të diskutuar, veçse duhet të punoni vazhdimisht e vazhdimisht për riedukimin e tyre, ashtu sikurse na mëson Partia. Pas kësaj situatë që u krijua në ushtri, si kudo edhe në redaksitë e organeve tuaja të shtypit, ju keni sjellë shokë të rinj me pikëpamje të shëndosha ideopolitike, me horizont të gjerë. Me një punë të mirë partie, me studime dhe me diskutime të herëpashershme të problemeve këta shokë të rinj do të zgjerojnë horizontin e tyre ideopolitik, kulturor dhe profesional.

Kurdoherë flasim për Artin Ushtarak të Luftës Popullore dhe themi që ky duhet të zërbërthohet, por vërejmë një gjë, shokë, se në këtë drejtim ecet ngadalë, nuk bëhet sa duhet. Ka kuadro që presin t'u dërgohen zërbërthime nga lart. Përfytyroni pak ju, shokë të ushtrisë, sa fushë e gjerë është çështja e zërbërthimit të strategjisë dhe të taktikës sonë ushtarake në bazë të vijës së Partisë, sa e thellë është kjo punë jo vetëm për sa i përket anës teorike, por edhe zbatimit në praktikë. Zbatimi në praktikë nuk do të bëhet ala Beqir Balluk, por sipas realitetit tonë të sotshëm. Kjo praktikë aktuale do të bëhet jashtëzakonisht frytdhënëse dhe në mbështetje të saj Partia do të shtrojë çështjen e edu-

kimit të ushtrisë, të organizimit, të armatimit, të mbrojtjes së territorit etj. Kjo situatë krijon probleme jash-tëzakonisht të shumta e të gjera teorike të vërtetuara nga praktika.

Për disa nga problemet e mbrojtjes, natyrisht, nuk mund të shkruhet në revista. Problemi që po shtrojtani unë ka të bëjë me nevojën e një studimi serioz nga ana e kuadrove ushtarake, të cilët pa të drejtë presin zberthime nga qendra. Këto detyra nuk kryhen vetëm duke bërë mbledhje me shokët komandantë të njësisve ushtarake, ku të ngrihet ndonjëri e të flasë një orë e gjysmë për Artin tonë Ushtarak të Luftës Popullore. Nuk mund të veprohet kështu, more shokë, se Arti ynë Ushtarak Popullor nuk mund t'i komunikohet ushtrisë vetëm në këtë mënyrë. Edhe mbledhje e shpjegime do të bëhen, por do të bëhen edhe leximi e studimi i Artit Ushtarak të Luftës Popullore dhe i materialeve të tjera që do të ribotohen me korrigjimet e duhura brenda një kohe të shkurtër. Ju do t'i keni në dorë këto materiale, që janë baza mbi të cilën duhet të reflektoni. Zberthimi në praktikë do të bëhet duke u shoqëruar me stërvitje ushtarake nga toga deri në brigadë. Këto nuk do të jenë stërvitje për bujë, por të tilla që të ngjajnë sa më tepër me luftën e vërtetë. Pra, atje, në praktikë do të zberthehen parimet e Artit Ushtarak të Luftës Popullore, por më parë këto duhet të mësohen jo me një referat, por me një studim të vazhdueshëm.

Revista teorike nuk mund të ketë një plan perspektiv dhjetëvjeçar për problemet që do të trajtojë, ajo duhet të planifikojë me afate më të shkurtra, për shembull, të shikojë çfarë stërvitjeje do të ketë gjatë këtij gjash-

tëmujori dhe, pasi të informohet në këtë drejtim, atëherë të përcaktojë që të zërthehen këto ose ato probleme. Këtë zëbrëthim duhet ta bëjnë njerëzit më kompetentë të ushtrisë sonë, se revista është një organ me rëndësi ushtarake, politike, teorike.

Revista mund t'i vejë ose jo gjithë ushtrisë, por në çdo bibliotekë duhet të ketë nga 10 numra të saj që të lexohen nga ushtarakët. Në qoftë se kjo revistë do të mbushet me fraza, atëherë nuk vlen asnjë grosh. Është e nevojshme dhe e domosdoshme të ndryshojë shpejt koncepti i bashkëpunimit në këtë revistë.

Unë kam pasë lexuar artikuj nga revista ushtarake dhe nga disa organe të tjera të shtypit sovjetik për strategjinë, për taktikën dhe për çështjet e artilerisë. Natyrisht, atje shkruanin edhe njerëz të dëgjuar, që kishin marrë pjesë në Luftën e Madhe Patriotike, por në të gjitha këto revista, bile edhe në gazetën «Pravda», binte në sy frazeologjia e rëndë, e rëndomtë, e mërzitshme, që e bënte shkrimin të palexueshëm ose pa vlerë. Kjo frymë e dëmshme kishte hyrë edhe në shkrimet e disa njerëzve të Akademisë sonë Ushtarake, që, kur u kërkohet një artikull, kopjonin nga literatura e huaj. Edhe kur donin të shkruanin diçka nga koka e tyre, bënin ndonjë «simite» që nuk kishte asnjë vlerë. Ne duhet ta mënjanojmë dhe ta zhdukim krejtësisht këtë praktikë të shkruarit në shtyp.

Në fund, dëshiroj të përsëris që të rishikohet edhe një herë mundësia e mbetjes më vete të revistave ushtarake «10 Korriku» dhe «Për mbrojtjen e atdheut». Mendoj se duhet të ekzistojnë të dyja revistat dhe të ketë secila karakterin që thashë më lart. I kam drejt

apo jo mendimet për këto dy revista, çështjen shikojeni edhe një herë ju, pastaj të vendoset si të gjykohet më drejt.

Në këtë drejtim ju duhet të mbani parasysh edhe vërejtjet që janë bërë për revistën «10 Korriku» e për shkrimet e ndryshme.

*Botuar për herë të parë,
me ndonjë shkurtim, në
librin: Enver Hoxha, «Rapor-
te e fjalime 1974-1975»,
f. 412*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë
nga procesverbali i mbledhjes
së Sekretariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

PARTIA NA MËSON TË JEMI TË PATUNDUR NË MBROJTJEN E PARIMEVE

Nga biseda¹ me një përfaqësues të PK të Australisë (m-I)

29 nëntor 1975

Shoku Enver Hoxha, në fillim të bisedës, shprehu kënaqësinë për takimin dhe, pasi e pyeti mysafirin për shëndetin, vazhdoi:

Do të kemi rast të bisedojmë përsëri bashkë, por së pari dëshiroj t'ju them të çlodheni si duhet, të shkonini për pushime në Vlorë, po të doni edhe në Sarandë, e të mos largoheni shpejt. Pushimi do t'ju bëjë mirë, do t'ju japë mundësi që, kur të ktheheni në atdhe, të punoni akoma më shumë. Është e vërtetë se nuk mund të shkëputeni për shumë kohë nga puna, por, që të punosh mirë, duhet të kesh forca fizike, të cilat përtërihen duke i kombinuar herë pas here edhe me pushim. Organizmi është kryesori në mposhtjen e çdo sëmundjeje.

Duke iu përgjigjur pyetjes së mysafirit për gjendjen e tij shëndetësore, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Mirë jam. Agjencitë e huaja kanë dhënë lajme fal-

1. Kjo bisedë u zhvillua gjatë pritjes së dhënë në Pallatin e Brigadave me rastin e 31-vjetorit të Çlirimit të vendit tonë.

se për gjendjen time shëndetësore, sikur nuk kam dalë në publik etj., kurse unë kam dalë, jo vetëm këtu në Tiranë, por kam qenë edhe në Korçë e gjetiu, ku kam vizituar ndër marrje e kooperativa bujqësore etj. Ne e kemi të qartë se të tilla lajme e kanë burimin tek agjencia jugosllave e lajmeve, Tanjug. Kur vajta në pritjen që dhanë shokët kinezë me rastin e festës së 1 tetorit, mbasi mësuan se unë dukesham mirë me shëndet, këto agjenci shkruan se kisha bërë «makiash». Siç thonë, Titoja bën makiash para se të dalë në publik.

MIKU AUSTRALIAN: Kur po vija në Shqipëri, qëndrova disa ditë në Beograd. Ajo që të binte më shumë në sy atje ishte influenza e madhe e shteteve përrëndimore, sidomos e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Që në shikimin e parë, duket që në jetën e këtij vendi ka korrupsion të madh. Krejt ndryshe është kur vjen në Shqipëri.

SHOKU ENVER HOXHA: Revizionistët jugosllavë janë në falimentim të plotë në të gjitha drejtimet. Teoria e tyre e vetadministrimit ka mbaruar, kurse ekonomia jugosllave tash ka rënë pothuajse në duart e kapitalistëve të huaj. Titoja ka deklaruar e premtuar vazhdimisht se do të bëjë përpjekje për ta ndryshuar gjendjen e vështirë që është krijuar në Jugosllavi, por fjalët e tij i merr era. Ai e shikon që punët po i shkojnë në keq, prandaj mundohet të bëjë diçka, mirëpo, ekonomia ka rënë në duart e të huajve, morali i masave ka rënë përtokë, në çdo drejtim vihet re degjenerim i madh, kurse partia në Jugosllavi ka kohë që është likuiduar si parti komuniste. Megjithatë arriti 83 vjeç,

Titoja po bën përpjekje ta kthejë atë në pozita gjoja marksiste-leniniste.

Çdo gjë te ne Partia dhe populli e ndërtojnë me djersën e tyre dhe jo me të ashtuquajturat ndihma nga jashtë. Gjendja aktuale e shteteve revizioniste dhe e vendeve të tjera tregon se «ndihma» në kredi që japin shtetet e pasura kapitaliste është për këto vende zgjedhë jo vetëm ekonomike, por edhe politike, prandaj në projektkushtetulën që po përgatitim ne theksojmë se ndjekim politikën e ndihmës reciproke me shtetet socialiste.

Marrja e kredive nga vendet kapitaliste është ro-bëri e re për popullin, jo me ushtarë, por me dollarë, me agjenturë, që i përgatit terrenin sulmit ushtarak. Pra, pas subversionit ekonomik fillon ndërhyrja ushtarakë. Jeta tregon se ato udhëheqje shtetesh që bien në kthetrat ekonomike të imperialistëve dhe të socialimperialistëve, detyrohen të bëjnë si duan këta, ndryshe kreditorët, siç e thashë, u sulen edhe ushtarakisht për t'i gllabëruar fare. Kreditë që merren rëndojnë shumë në kurrizin e popullit dhe të atdheut, prandaj nuk u duhet zgjatur dora as imperialistëve, as revizionistëve.

Rrojmë në situata revolucionare, por edhe në situata të vështira të krijuara nga imperialistët dhe nga socialimperialistët.

MIKU AUSTRALIAN: Lexova me interes shumë të madh përkthimin e disa pjesëve të vëllimit¹ me Veprat tuaja, të botuar kohët e fundit. Unë e mbaj mend

1. Vëllimi i 19-të i Veprave të shokut Enver Hoxha.

mirë periudhën shumë interesante kur u bë Konferenca e 81 partive në Moskë, por në këtë vëllim bëhet fjalë për disa ngjarje që nuk i dija më parë.

SHOKU ENVER HOXHA: Atëherë ne nuk i kishim thënë të gjitha, pse Partia jonë, si parti marksiste-leniniste që është, eci me hap të matur në luftën kundër revizionistëve hrushovianë. Këtë ajo e bëri me pjekuri e në kohën e duhur, pasi qëllimet e tyre të vërteta nuk njiheshin akoma plotësisht. Dyshime na kishin lindur që në fillim dhe në mbledhjet e Komitetit Qendror të Partisë sonë kemi folur për këtë. Pra, taktika e Partisë sonë ishte e tillë që të mos flisnim hapur menjëherë për mosmarrëveshjet që na lindën me hrushovianët. Por, kur u mbush kupa dhe pamë se nuk mund të pritej më, atëherë ne ua thamë hapur mendimin tonë.

Pasi vdiq Stalini, unë vajta në Moskë, në qershor të vitit 1953. Atje Malenkovi, Beria, Mikojani e të tjerë më sulmuan frontalisht, duke e paraqitur shtrembër gjendjen e vendit tonë në të gjitha drejtimet, në ekonomi, në kulturë, në ushtri etj. Sidomos Mikojani e Beria s'lanë gjë pa rrokullisur. Ata na akuzuan se populli ynë vuante për bukën e gojës dhe se po e rripnim fshatarësinë. Natyrisht, unë i kundërshtova me argumente e me gjakftohtësi sulmet e tyre. Pas rezistencës që u bëra, ata u detyruan të tërhiqeshin. U thashë se ne jo vetëm kishim trashëguar një gjendje të mjeruar nga lufta, por pas luftës na grabitën edhe revizionistët jugosllavë në të gjitha drejtimet.

Ne parashikuam se do të kishim përpara një luftë të madhe e të ashpër, e cila nuk mund të zhvillohej me sukses po të mos kishte unitet të fortë si në udhëheqje,

ashtu edhe në Parti. Vija e Partisë sonë kërkonte që në ato situata të ruanim si sytë e ballit unitetin në udhëheqje. Uniteti në Komitetin Qendror ka rëndësi të madhe, rëndësi ka, gjithashtu, uniteti edhe në Parti. Kjo kërkonte që shokët e udhëheqjes dhe gjithë Partia të ishin të qartë.

Fjalimet dhe bisedat që ju keni lexuar e ilustrojnë edhe më mirë fjalimin që mbajta në emër të Partisë sonë në Moskë.

Kur vendosëm të flisnim në Moskë, Komiteti Qendror i Partisë sonë e dinte se me cilët kishte të bënte. Ne parashikuam me këtë rast edhe vështirësitë që do të na dilnin. Kur marrëdhëniet tona me revizionistët sovjetikë po acaroheshin së tepërmi, kishte edhe ndonjë që na bëri telegram për të na njoftuar se dëshironte të vinte në Shqipëri, natyrisht, për të na pajtuar me hrushovianët, dhe, pa pritur fare aprovimin tonë, na njoftoi se po nisej. Atëherë unë iu përgjigja: Në qoftë se vjen si mik, eja kur të duash, por në qoftë se ke ndër mend të vish për të na pajtuar me Hrushovin, nuk mund të të presim. Kështu ai nuk erdhi.

Partia jonë në luftë e sipër mësoi se ç'qëndrim duhej të mbante. Ajo na mëson të jemi të qëndrueshëm e të patundur në mbrojtjen e parimeve. Megjithëse në fillim ishim të rinj dhe nuk kishim eksperiencën e duhur, ne kishim besim të plotë në marksizëm-leninizmin e komunizmin dhe i mbronim me gjithë shpirt.

Lufta me armiqtë brenda në Parti na forcoi, lufta që bëmë kundër titistëve na forcoi edhe më shumë. Kur erdhën hrushovianët në fuqi pas vdekjes së Stalinit, eksperiencën e fituar në luftën e deriatëhershme na dha

mundësi të shikonim më qartë e të kuptonim më shpejt se udhëheqësit e rinj sovjetikë nuk ishin në rregull. Edhe lufta me hrushovianët ishte një shkollë e madhe për Partinë tonë, ajo na mësoi shumë.

Te Bashkimi Sovjetik, te Stalini, te Partia Bolshevike ne kishim besim të madh. I prekshëm për mua ka qenë takimi me Stalinin më 1949 në Suhumi, në breg të Detit të Zi. Pesë orë kemi ndenjur bashkë duke biseduar. Takimin e fundit me të e bëra në prill 1951 në Moskë. Në takimet me Stalinin, ai më ka thënë se, megjithëse i djegur e i dëmtuar shumë nga lufta, Bashkimi Sovjetik do të na ndihmonte, se ndihmat që na ishin dhënë deri atëherë, ishin të pakta, por ato do të shtoheshin dhe se do të na jepeshin edhe fabrika, traktorë e farëra të mira për bujqësinë etj. Për këtë ai u kishte dhënë porosi Mikojanit dhe Malenkovit. Të tilla janë fjalët që më ka thënë Stalini. Kur vajta në Bashkimin Sovjetik pas vdekjes së tij, e dija se këta të dy, Malenkovi dhe Mikojani, me siguri i kishin marrë porositë, mirëpo në vend që t'i zbatonin, ata u hodhën në sulm kundër meje. Në një takim me Mikojanin, ky më tha: «E ç'janë ato lopë që keni ju dhe që japin nga 500-600 litra qumësht në vit? Më mirë është të mos i mbani, por t'i therni!». Dhe ai vazhdoi të më mburrej duke thënë se një lopë tek ata jepte kaq e aq mijë litra qumësht. Iu përgjigja se populli ynë kishte pak ushqime, ai luftonte për bukën e gojës, prandaj nuk mund t'i thernim lopët. I thashë, gjithashtu, se pas Revolucionit të Tetorit edhe ata nuk mund të kishin marrë menjëherë aq mijë litra qumësht nga një lopë. Ai atëherë e mbylli gojën dhe nuk foli më për këtë çë-

shtje. Është e vështirë për shumë njerëz në botë t'i kuptojnë këto situata, por, sidoqoftë, ato i kanë ndodhur Partisë sonë.

Kur po përgatitej kundërrevolucioni në Hungari, shkova në Moskë, duke kaluar nga Budapesti. Aty pata rastin dhe i pyeta shokët hungarezë: More, çfarë po bëhet kështu te ju?! Për sa po ndodhte atje, i thashë edhe Suslovit në Moskë: Në Hungari është duke u përgatitur kundërrevolucioni dhe Imre Nagi është tradhtar. Por Suslovi më kundërshtoi. Ai hapi një sirtar të tavolinës, nxori një shkresë dhe ma tregoi duke më thënë: «Shikoje, është autokritika e Nagit. Kjo është gjë e mirë». E pashë në sy Suslovin dhe përsëri i thashë: Nagi është tradhtar! Suslovi përsëri kundërshtoi e u mundua të më bindte për «meritat» e Imre Nagit. Dihet si mbaroi Imre Nagi. Të tillë ishin e janë ata, revizionistët hrushovianë.

Tani, më falni, se më duhet të shkoj. Do të shihemi përsëri. Të fala shoqes!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

**SITUATAT NË BOTË JANË TË TURBULLTA,
PRANDAJ NUK KA VEND PËR VETËKËNAQËSI,
PËR QETËSI OSE PËR EUFORI**

*Nga biseda me një përfaqësues të PK
të Australisë (m-l)*

6 dhjetor 1975

*Pas përshëndetjeve të rastit, fjalën e mori shoku
Enver Hoxha:*

Nesër ne kemi një ngjarje të madhe për historinë e popullit tonë, na vijnë eshtrat e një pjese të dëshmorëve shqiptarë që kanë luftuar për çlirimin e Jugosllavisë. Atje, në tokën e Jugosllavisë, kanë rënë mbi 500 partizanë shqiptarë, por nesër na vijnë eshtrat e rreth 130 prej tyre.

Duke dashur t'ju vëmë shkurtimisht në dijeni, pa ju lodhur, për situatën në vendin tonë, mund të them se situata jonë politike dhe ekonomike, si dhe gjendja e Partisë sonë janë të shëndosha dhe shkojnë vazhdimisht duke u forcuar. Natyrisht, kjo situatë është arritur me luftë kundër armiqve të brendshëm, që nuk mungojnë, por edhe kundër armiqve të shumtë të jashtëm që ushqejnë këta të brendshmit. Siç e dini, në

i japim një rëndësi të dorës së parë forcimit të Partisë. Në rast se Partia është e fortë dhe monolite, në qoftë se ajo ndjek pa u përkulur mësime të marksizëm-leninizmit, lufta dhe punët e tilla mirë dhe vendi është i fortë. Ne mendojmë se Partia jonë është e fortë. Por forcimi i saj është një proces dialektik që zhvillohet pandërprerë. Prandaj ne nuk e kemi fjetur mendjen, por jemi vazhdimisht në luftë për ruajtjen e forcimit të Partisë kundër të metave e gabimeve.

Rëndësi të veçantë ka çështja e unitetit në Komitetin Qendror. Është fakt se te ne uniteti i gjithë Partisë rreth Komitetit Qendror dhe uniteti i popullit rreth Partisë është shumë i madh. Por armiqtë e Partisë vepronin. Ata mund të fshihen nën maska shumë të stërholluara, megjithatë përballë këtij uniteti nuk e kanë pasur, nuk e kanë dhe nuk do ta kenë kurrë jetën të gjatë.

Kohët e fundit ne zbuluam një grup armiqsh që vepronin në ushtri dhe në ekonomi, të cilët përgatiteshin për një komplot mjaft të organizuar. Po kështu edhe në lëmin e propagandës armiqtë e Partisë kishin atakuar ideologjinë e Partisë në letërsi, në arte e gjëkë. Kurse në ekonomi sabotimi filloi nga përpjekjet për të vënë në zbatim vetadministrimin titist jugosllav. Natyrisht, Partia jonë vigjilonte dhe ata që e kishin mbushur kupën, ia dorëzoi drejtësisë së popullit.

Elementët armiq në Komisionin e Planit të Shtetit punonin për depërtimin në vendin tonë të metodës së vetadministrimit titist jugosllav. Partia dhe Qeveria shikonin që po përdreshin një mori taktikash nga

ana e këtyre njerëzve, por këto duheshin verifikuar prej nesh dhe, kur u panë si duhet, e vërteta doli në shesh. Edhe në tregti bëheshin të tilla veprime, prandaj edhe ministri i Tregtisë u vu përpara përgjegjësisë. Në sektorin e naftës armiqtë vepruan duke na sabotuar nga ana teknike. Plani në këtë sektor tre-katër vjet nuk u realizua e veçanërisht në zbulimin e fushave të reja. Mirëpo, sa vuri dorë Partia, armiqtë pohuan që kishin sabotuar, se ishin agjentë të sovjetikëve dhe qenë rekrutuar si të tillë që në vitin 1957. Ata kishin porosi të mos u jepnin fusha të reja naftë Qeverisë, Partisë, popullit tonë, prandaj dhe na kanë sabotuar duke na dhënë kot pika të shpimit të puseve dhe në studimin e fushave të naftës. Por tani edhe në këtë sektor situata është stabilizuar.

Gjykimi i armiqve vazhdoi për shtatë-tetë muaj në Parti dhe në ushtri, në një kohë kur këta ishin të lirë, të paarrestuar. Një gjë e tillë mund të bëhet vetëm në një vend si yni, ku Partia është shumë e fortë dhe gëzon besimin absolut të popullit. Gjatë kësaj kohe masa e Partisë dhe populli u bindën se çfarë ishin këta elementë. Faktet e shumta dhe pohimet e vetë armiqve provuan se ata ishin agjentë të vjetër të revizionistëve jugosllavë dhe të atyre sovjetikë. Beqir Balluku pohoi se që në shkurt të vitit 1943, pa dijeninë e Komitetit Qendror, pa dijeninë time si Komandant i Përgjithshëm i ushtrisë, kishte rënë dakord me Titon që të vinin në Shqipëri divizione jugosllave, pikërisht në Korçë, se gjoja do të sulmonte Greqia. Natyrisht, ne e refuzuam këtë kërkesë të titistëve dhe i bëmë menjëherë telegram Stalinit, i cili gjithashtu ishte i një

mendimi me ne se, nën maskën e divizioneve «të ndihmës», Titoja synonte të pushtonte Shqipërinë. Lufta me titizmin ishte një shkollë e madhe për ne.

Edhe në ushtri u zhvillua punë armiqësore. Të tëra këto kanë dalë nga vetë armiqtlë. Ata kanë pohuar me gojën e tyre që ishin agjentë të të huajve. Të gjitha poshtërsitë që kishin bërë ata, ne ia thamë popullit, ia thamë Partisë. Dokumentet janë bërë të njohura në gjithë Partinë tonë. Populli, Partia, ushtarët, oficerët i shkruan Komitetit Qendror çfarë kishin parë dhe çfarë kishin konstatuar për punën armiqësore të këtyre tradhtarëve. Çështja është që, me gjithë veprimtarinë e tyre agjenturore dhe sabotuese, ushtria e mori veten përnjëherë. Partia u shpjegoi kuadrove në ushtri situatën, i sqaroi njerëzit se ku kishin tradhtuar Beqir Balluku me shokë dhe ata u mobilizuan për zbatimin e vijës së saj, për likuidimin e pasojave të veprimtarisë armiqësore. Ka njerëz në ushtri që kanë bërë gabime, por këto i njohën dhe po shkojnë përpara. U fshi ajo situatë e rëndë e çmobilizuese që kishin krijuar tradhtarët, dhe Partia, kuadrot, oficerët morën situatën në dorë. Ushtarakët, të preokupuar për normalizimin e gjendjes, i janë futur punës për të ndrequr sa më parë dëmin e madh që na shkaktoi në ushtri armiku i brendshëm. Por puna vazhdon, ne nuk flemë, do të jemi vigjilentë, sepse armiku punon.

Këto grupe armiqësore janë rezultat i luftës së ashpër të klasave që zhvillohet sot dhe i punës agjenturore diversioniste të imperialistëve amerikanë dhe të socialimperialistëve sovjetikë, që punojnë për të shkatërruar Shqipërinë socialiste, mbasi këtu është ve-

ndosur diktatura e proletariatit, që udhëheq Partia jonë, të cilën asnjë prej tyre nuk e do. Por lufta i forcon edhe më shumë Partinë tonë dhe unitetin e saj me masat e popullit.

Të gjitha këto që na ndodhën, u diskutuan me masat e gjera. Neve na intereson shumë mendimi i popullit dhe duam që ai çdo gjë ta shikojë qartë, të gjykojë vetë çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar, t'i thotë haplazi mendimet dhe t'i dënojë armiqtë me rreptësinë më të madhe. E tillë është vija e papërkullur e Partisë sonë. Komiteti Qendror vazhdimisht na ka theksuar që asgjë formale të mos ketë në këtë problem kapital.

Ne nuk dëshirojmë ta mburrim popullin tonë, por është fakt se ai është i mrekullueshëm, i fortë, trim, shumë i durueshëm në çfarëdo vështirësie që mund t'i ndodhë. Ai ka qenë shumë i varfër dhe ka vuajtur shumë në të kaluarën, megjithatë nuk është përkullur në shekuj. Partia i ngriti në një nivel shumë më të lartë qëndrueshmërinë dhe papërkulshmërinë e popullit, e mësoi atë si të luftojë për jetën dhe socializmin, si të gjykojë dhe të dallojë cilët janë armiqtë dhe cilët janë miqtë e tij, e mësoi t'i dojë miqtë dhe t'i urrejë pa masë armiqtë. Populli shikon që vetëm Partia dhe socializmi e nxorën në dritë, prandaj është i vendosur të mbrojë vendin dhe fitoret e arritura me dyfek në dorë, nën udhëheqjen e Partisë. Dhe tërë popullin e kemi të armatosur.

Ne nisemi nga parimi i drejtë marksist-leninist që diktatura e klasës punëtore, me partinë në krye, ta zhvillojë luftën e klasave pa pushim. Prandaj punojnë

që populli ynë të kuptojë mirë se neve na duhet të zhvillojmë një luftë të vazhdueshme e të pandërprerë kundër armiqve të brendshëm, kundër imperializmit dhe socialimperializmit, të kuptojë se duhet të zhvillohet lufta e klasave. Këtu është përqendruar kurdoherë kujdesi i madh i Partisë sonë, me qëllim që ajo të ketë me vete në këtë luftë masat e gjera të popullit. Por, që t'i ketë me vete këto, duhet t'i vërë në dijeni plotësisht për ngjarjet e rëndësishme që ndodhin, të marrë mendimin e tyre për probleme të ndryshme, deri edhe për pranimin apo jo në Parti të një personi, për të parë nëse ai i ka kushtet për t'u futur në radhët e saj. Në qoftë se masa është e mendimit se ai i ka kushtet, atëherë zbatohen rregullat për pranimin e tij si kandidat i Partisë. Në rast se mendimi i masës është ndryshe, ai njeri nuk pranohet në Parti. Pikërisht se zbatohen këto rregulla marksiste-leniniste, se zbaton këto norma të drejta të pranuar në Statutin e saj, Partia jonë është e shëndoshë.

Zbulimi dhe shpartallimi i punës armiqësore i forcoi edhe më shumë Partinë, pushtetin dhe ekonominë e vendit tonë. Sivjet ne kemi një vit të mbarë në bujqësi. Në industri dhe në kulturë kemi bërë një hop përpara. Në këto arritje shikojmë sukseset e vijës së drejtë që ka ndjekur Partia. Por nuk mjafton vetëm kjo. Rëndësi ka edhe shpjegimi i kësaj vije në masat punonjëse, organizimi i punës për zbatimin e saj dhe mobilizimi për kryerjen e detyrave që shtron Partia.

Në industri, në përgjithësi, punët na shkojnë mirë. Por suksese të mëdha kemi arritur në bujqësi, veçanërisht në grurë. Tani sipërfaqet e tokave nga të cilat

ne marrim nga 30-40 kuintalë grurë për hektar janë të gjera në tërë Shqipërinë. Ka mjaft kooperativa bujqësore që në qindra hektarë kanë marrë nga 45 kuintalë grurë për hektar. Kur mendojmë që 10 vjet përpara mezi merrnim nga 15-16 kuintalë për hektar, ne themi se kjo është një rritje e mirë. Megjithëkëtë, synojmë rezultate akoma më të mira. Buka është çështja kryesore për popullin dhe, në këtë drejtim, kemi bërë përmirësime të dukshme. Edhe në misër këtë vit rendimentet nuk do të jenë të këqija, megjithëqë mund të mos jenë siç do të dëshironim ne. Pambuku është një bimë tjetër me rëndësi të madhe dhe e nevojshme për vendin tonë. Edhe në prodhimin e tij është bërë një kthesë e mirë. Kthesë është bërë gjithashtu edhe në prodhimet e tjera bujqësore.

Një gjë tjetër dëshiroj t'ju them, se, në këto situata, kur gjithë bota është futur në një krizë të rëndë ekonomike, te ne gjendja është e kënaqshme; furnizimi i popullit është i mirë, çmimet e artikujve ushqimorë, industrialë etj., qiratë e bancave nuk janë ngritur. Në vendin tonë populli nuk paguan asnjë lloj takse. Të gjitha vendimet që janë marrë në Komitetin Qendror dhe në Qeveri synojnë ngritjen e nivelit të jetesës së masave, prandaj te ne jeta zhvillohet krejt normale dhe populli është i kënaqur. Natyrisht, ne kërkojmë dhe luftojmë edhe për më mirë, por tash për tash kaq janë mundësitë tona. Veç kësaj, në këto situata ndërkombëtare në të cilat jetojmë, ne bëjmë përpjekje të mëdha për të forcuar mbrojtjen e atdheut, sepse qëllimi i të gjithë armiqve është që ta shkatërrojnë Shqipërinë, këtë kala të socializmit. Prandaj çështjen

e mbrojtjes Partia dhe masat e gjera të popullit e konsiderojnë detyrë mbi detyrat. Ato punojnë për të rritur fuqinë mbrojtëse, për të fortifikuar vendin në të katër anët, për ta bërë të gjithë popullin ushtar, si në mëson Lenini. Kjo detyrë kaq e madhe nuk mund të bëhet vetëm me fjalë; ajo kërkon edhe shpenzime, por edhe organizim të përsosur. Partia jonë e ka organizuar punën në mënyrë të tillë që populli, nën udhëheqjen e saj, t'i kryejë këto detyra të mëdha e jetike sistematikisht, jo me sforcë të madhe, por me punë, me përpjekje normale. Kështu punohet në Shqipëri edhe për mbrojtjen, edhe për ngritjen e ekonomisë e të kulturës, edhe për edukimin e njerëzve, sepse neve na duhet në radhë të parë, të shtojmë prodhimin e bukës në vend, të rritim prodhimet bujqësore e blegtorale, të zhvillojmë më tej industrinë, të zhvillojmë e të përhapim gjërat e kulturës, arsimin, që të plotësojmë gjithnjë e më mirë kërkesat materiale e shpirtërore të popullit.

Kështu është, pra, situata, në përgjithësi, brenda vendit tonë.

Detyra jonë është që entuziazmin e madh patriotik e revolucionar të popullit të mos e lëmë të ulet në asnjë moment, por të punojmë fort që, me përpjekjet e popullit dhe me Partinë në krye, ky entuziazëm popullor të ngrihet vazhdimisht e më lart.

Partia jonë ka pikëpamjen se situatat sot në botë janë të turbullta, prandaj nuk ka vend për vetëkënaqësi, për qetësi ose për eufori. Partia e Punës e Shqipërisë nuk mendon se gjendja në botë është e shkëlqyer. Nga analizat që ka bërë, ajo ka arritur në përfundimin se armiqtë e proletariatit e të socializmit

dhe popujt, që luftojnë kundër tyre e kërkojnë çlirim, edhe sot janë në atë gjendje që na mësojnë Marksii, Engelsi, Lenini e Stalini, në kontradikta të papajtueshme midis tyre. Kjo do të thotë që imperializmi, me atë amerikan në krye, dhe tani, pas tradhtisë së Hrushovit, edhe socialimperializmi sovjetik, pra e gjithë bota kapitaliste e revizioniste dhe borgjezia reaksionare duhet të luftohen nga popujt dhe nga forcat revolucionare të të gjithë botës. Në radhët e këtyre armiqve dy janë më kryesorët: imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, të cilët luftojnë për hegjemoni botërore. Për Partinë tonë nuk është e drejtë pikëpamja sipas së cilës njëri nga këta armiq është hegjemonist dhe tjetri nuk është. Partia jonë mendon se të besosh në politikën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të thotë që të janë errësuar sytë. T'u besosh socialimperialistëve sovjetikë do të thotë të bësh tradhti ndaj marksistë-leninistëve dhe gjithë popujve. Të ulësh luftën kundër njëres superfuqi dhe të ngresh më lart luftën kundër tjetrës nuk është e drejtë. Të dyja fuqitë e mëdha janë hegjemoniste, për arsye se janë imperialiste dhe me anë të forcës e të luftës duan të sundojnë mbi popujt e botës, të ndajnë tregjet. Superfuqitë përgatiten për luftë botërore dhe, për këtë qëllim, përpiqen të krijojnë rrethanat që i gjykojnë të përshtatshme, duke nxitur kundër njëra-tjetrës klikat borgjeze në vendet e ndryshme, duke ngacmuar ndjenjat kombëtare për t'i vënë kombet në luftë me njëri-tjetrin etj. Gjithë kjo veprimtari dhe këto metoda të ndyra të superfuqive çojnë drejt rrugës së përgatitjes së luftës së re botërore.

Partia jonë e shikon edhe këtë çështje në prizmin klasor. Cilët janë aleatët tanë? Janë partitë marksiste-leniniste, proletariati botëror dhe popujt që luftojnë për t'u çliruar. Në këtë drejtim Partia jonë mendon se nuk gabohet. Për Partinë e Punës të Shqipërisë nuk ka botë «të parë», «të dytë» apo «të tretë», për të ekzistojnë, nga njëra anë, kapitalizmi dhe, nga ana tjetër, socializmi, nga njëra anë imperialistët dhe socialimperialistët me gjithë satelitët e tyre dhe, nga ana tjetër, popujt që luftojnë për liri, partitë marksiste-leniniste, proletariati botëror. Ne jemi kundër të parëve dhe përkrahim të dytët.

Nuk përjashtohet që udhëheqjet e partive marksiste-leniniste të kenë edhe mendime të ndryshme për vlerësimin e qëndrimit të shteteve të ndryshme të botës, pa folur këtu për imperializmin amerikan dhe për socialimperializmin sovjetik, ndaj të cilëve qëndrimi i partive marksiste-leniniste duhet të jetë i prerë. Simpatia jonë, e bazuar në vështirimin klasor të çështjes, është për ato shtete, qeveri dhe qeveritarë, që janë përparimtarë, që nuk duan të pranojnë zgjedhën imperialiste amerikane, apo atë socialimperialiste sovjetike dhe që nuk shtypin popullin. Në qoftë se Partia jonë shikon se udhëheqja e një shteti «demokratik» borgjez shtyp popullin, shtyp lëvizjen përparimtare dhe bëhet mashë në duart e dy superfluqive, ajo e demaskon atë. Komiteti Qendror i Partisë sonë mendon se një pikëpamje e tillë është leniniste, se kjo ndihmon partitë marksiste-leniniste, luftën revolucionare dhe revolucionin.

Partia jonë mendon se në aleancën me borgjezinë

për luftën kundër të dyja superfuqive në asnjë moment nuk duhen harruar interesat e klasës dhe të revolucionit. Të veprosht ndryshe do të thotë të mbështetesh në politikën e koniunkturave. Ne marksistë-leninistë mund t'i shfrytëzojmë ato, por nuk duhet të ndjekim një politikë në themel koniunkturale. Ne, për shembull, në marrëdhëniet me Jugosllavinë, i mbajmë parasysh, përpigemi t'i shfrytëzojmë në dobinë tonë situatat e krijuara, por nuk bëjmë me të politikë koniunkturale, por politikë thellësisht parimore. Marrëdhëniet tona me Jugosllavinë i shikojmë në prizmin klasor revolucionar, sepse e dimë që Titoja është armik i revolucionit dhe i proletariatit, që ai është një borgjez që e ka shitur vendin e tij tek imperialistët, që i ka shtypur dhe i shtyp akoma popujt e Jugosllavisë. Me Bashkimin Sovjetik Titoja ndjek një politikë balancimi, nganjëherë e ka mirë me të, nganjëherë e ka keq. Për të mbështetja kryesore janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai ka punuar për shkatërrimin e Jugosllavisë. Kjo ide mund të duket kontradiktore, por është krejtësisht e vërtetë. Në fjalimet që ka mbajtur Titoja ka pohuar se ata kanë lejuar likuidimin e partisë dhe të diktaturës së proletariatit. Tani ai bën thirrje gjoja për t'u kthyer drejt forcimit të partisë, por me atë që është krijuar në Jugosllavi, jo Titoja, por as pasuesit e tij nuk mund të dalin nga gjendja ku janë katandisur. Partia e klasës punëtore dhe diktatura e proletariatit në Jugosllavi mund të fitojnë vetëm kur të likuidohen bazat ku mbështetet titizmi.

Gjendja e Jugosllavisë është krunde, atje çdo gjë mund të ngjasë. Federata e krijuar mund të mbahet

inë këmbë edhe pas vdekjes së Titos, por me siguri do të krijohet një rivalitet i madh në mes serbëve dhe kroatëve, që do të thotë rivalitet midis sovjetikëve dhe amerikanëve. Atje është krijuar një situatë e ngjashme si ajo në kohën e mbretërve, të Karagjorgjeviçit. Në qoftë se serbët do t'i pranojnë sovjetikët, këta mund të futen në Jugosllavi, por, ama, po ndodhi ky fenomen, mund të futen edhe amerikanët e italianët në Kroaci. Por ka mundësi që edhe të dyja palët të mbajnë këtë situatë që është tani, sepse kanë interes të mbajnë një qeveri pa Titon, por ala Tito, ku të lëvrijë si imperializmi amerikan, ashtu edhe socialimperializmi sovjetik. Në këtë rast do të ketë një luftë tregjesh, një luftë për ndikime politike e ideologjike, derisa të piquet fiku dhe të bjerë në gojën e njërit apo të tjetrit.

Politika tradhtarë e Titos ka krijuar kushtet që Bashkimi revizionist Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të futen brenda në Jugosllavi. Jugosllavia është bërë kështu një fushë e ndeshjes së interesave midis superfuqive. Neve na intereson që Jugosllavia të mos sulmohet as nga sovjetikët, as nga amerikanët, por Titoja ka krijuar një situatë të tillë që ajo mund të sulmohet edhe nga njëra palë, edhe nga tjetra. Shteti ynë ka deklaruar botërisht që, në rast se do të sulmohet Jugosllavia, ne do të jemi në anën e popujve të Jugosllavisë. Me këtë vend fqinj ne zhvillojmë tani njëfarë tregtie, kemi marrëdhënie kulturore, por nuk kemi dhe nuk mund të kemi asnjë grimë besim në politikën që ndjekin titistët. Ne kemi besim vetëm te popujt e Jugosllavisë dhe mendojmë se këta janë popuj të fortë, që nuk e duan robërinë. Këtë cilësi të mirë

këta popuj e kanë provuar. Në qoftë se popujt e Jugosllavisë do të luftojnë, ata mund t'i shpëtojnë invalidit të armiqve, në të kundërtën, po nuk luftuan, do të pushtohen. Po të kishte luftuar populli çek, situata në Çekoslovakia do të ishte ndryshe. Mirëpo çekët, të tradhtuar nga revizionistët brenda vendit, nuk u ngritën në këmbë për mbrojtjen e atdheut nga sulmi i tankeve sovjetike.

Politikën që bëjmë ne me Jugosllavinë, e quajmë të drejtë, por nuk rrojmë me ëndërrime; në marrëdhëniet me të nuk ushqejmë asnjë iluzion dhe nuk mendojnë kurrë se, meqenëse Jugosllavia është kundër sovjetikëve, politika e saj është marksiste-leniniste. Ne nuk biem në këtë gabim, sepse marrëdhëniet tona me të tjerët i shikojmë me syrin klasor.

Me Greqinë ne kemi marrëdhënie diplomatike e disa marrëveshje tregtare, por nuk harrojmë se atje ka edhe nga ata të ashtuquajturit vorio-epiriotë që kanë pretendime territoriale ndaj vendit tonë, që lakmojnë një pjesë të Shqipërisë së Jugut. Me shtetin grek ne ndjekim një politikë realiste të fqinjësisë së mirë e të miqësisë me popullin grek, për të cilin kemi respekt.

Qeveritarët grekë na propozuan që të organizohet një mbledhje e përbashkët e vendeve të Ballkanit, po ne nuk pranuan, sepse asgjë e mirë nuk do të vinte nga kjo konferencë e përbashkët e vendeve ballkanike, që kanë në mes tyre një mijë e një kontradikta të egra, të cilat lidhen me kontradiktat në mes sovjetikëve dhe amerikanëve. Ne e dimë mirë se në këto konferenca do të sundojnë pikëpamjet e egra shoviniste, që nxiten nga dy superfuqitë, prandaj pjesëmarrja në to është pa

dobi dhe shërben për të vënë popujt në gjumë.

Partia jonë nuk e ngatërron kurrë politikën e koniunkturave me qëndrimin dashamirës ndaj një qeverie përparimtare, por nuk ushqen asnjë iluzion për qeveritë borgjeze e reaksionare, si bie fjala për regjimin diktatorial të Frankos, për qeverinë e Mobutus, për «X-in» dhe «Y-in», ose për qeverinë që u rrëzua në vendin tuaj. Ne nuk mund të kemi besim në klikat e në qeveritë borgjeze. Është e domosdoshme që ne marksistë-leninistët të punojmë që të ngjallim kudo në masat e proletariatit dhe të popullit frymën revolucionare. Këtë duhet ta bëjmë docmos, sepse të gjithë armiqtë konkurrojnë me njëri-tjetrin që të mbytin revolucionin.

Nga analizat që ka bërë Komiteti Qendror i Partisë sonë, del se sot njerëzimi po kalon krizën më të madhe botërore. Shtetet e Bashkuara të Amerikës po kalojnë një krizë të rëndë ekonomike dhe politike, që po ndikon në aleancat me miqtë e tyre. Imperialistët e rinj, socialimperialistët sovjetikë, po kalojnë gjithashtu një krizë të thellë ekonomike, politike, ideologjike. Me miliona të papunë, që janë shtuar në botë, dalin në greva. Kjo revoltë përbën një forcë kolosale. Po kush e manipulon këtë forcë? Revizionistët dhe socialdemokracia, që janë agjentët e të dyja superfuqive.

Në këto kushte nuk na lejohet të gjykojmë se gjendja në botë është e shkëlqyer. Por a mjafton ndihma që ne marksistë-leninistët u japim forcave revolucionare? Ne mendojmë se jo, bile duhet të pranojmë se shumë herë kjo ndihmë nuk është shumë efikase.

Konferencën e Sigurimit Evropian, që u mbajt në

Helsinki, ne e dënuam që në fillim dhe refuzuam pjesëmarrjen në të, kurse të gjitha vendet evropiane dërguan atje përfaqësuesit e tyre. Të tjerët thanë për ne se u treguam origjinalë, por ne nuk e mbajtëm këtë qëndrim për «origjinalitet». Ne vepruam kështu duke u nisur nga një analizë marksiste-leniniste e zhvillimit të ngjarjeve. Këtë konferencë e donin jo vetëm sovjetikët, por edhe imperialistët amerikanë. Pse? Për të kapërcyer krizën, për t'u rforcuar, për të rimarrë veten, për të krijuar iluzionin që Evropa po sigurohet, se kjo nuk do të sulmohet nga Bashkimi Sovjetik, sepse, po të sulmohej prej tij, atëherë do të ndërhynin edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për sy e faqe superfuqitë donin të krijonin një gjendje të ngrirë, njëfarë statukuoje. Çdo gjë që bëhej në këtë konferencë, ishte një falsifikim dhe, në fakt, shumë nga ata që merrnin pjesë në të, nuk besonin në dobitë e saj.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërkojnë me rrugë të ndryshme të penetrojnë në Bashkimin Sovjetik që të dobësojnë forcat sovjetike; Britania e Madhe, Franca dhe Gjermania Perëndimore kërkojnë, gjithashtu, të futen në Bashkimin Sovjetik dhe në Evropën Lindore. Kjo duket në përpjekjet e këtyre shteteve që të penetrojnë jo vetëm me anën e kapitaleve, por edhe në shumë forma me idetë dhe me mënyrën e tyre të jetesës. Sovjetikët nuk e pranojnë këtë orvatje të shteteve të Evropës Perëndimore, sepse e dinë që, po u futën këto në Evropën Lindore, do t'i humbasin përnjëherë aleatët e tyre, të cilët duan me gjithë qejf të futen në lojë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Megjithatë, shtetet e Evropës Perëndimore dhe Shtet-

tet e Bashkuara të Amerikës po investojnë kapitale në vendet e Evropës Lindore. Nën parullën e «qarkullimit të lirë të ideve dhe të njerëzve» këto shtete po e shtojnë praninë e tyre në Evropën Lindore.

Imperializmi sovjetik e mban në zap Evropën Lindore me anën e ushtrisë, të Traktatit të Varshavës, që i siguron mish për top në luftën e ardhshme, e me anën e KNER-it, nëpërmjet integritimit ekonomik.

Përfaqësuesi i PK të Australisë (m-l) duke marrë fjalën, ndër të tjera, falënderoi për pritjen e ngrohtë, vlerësoi përparimet që ishin bërë në vendin tonë dhe shprehu bindjen se, ashtu si në të kaluarën, Partia e Punës e Shqipërisë do t'i bënte ballë çdo të papriture. Pastaj ai dëshoi të dinte pikëpamjen e Partisë sonë se cilat ishin kryesore, bashkëpunimi apo kontradiktat midis imperialistëve amerikanë dhe socialimperialistëve sovjetikë dhe se a duhej të thelloheshin këto kontradikta.

Fjalën e mori përsëri shoku Enver Hoxha:

Lufta e ardhshme midis superfuqive nuk është përgatitur akoma si duhet, pse të dyja palëve, edhe imperialistëve amerikanë, edhe socialimperialistëve sovjetikë, u duhet kohë. Po të ishte që lufta në mes tyre të bëhej me armë konvencionale, ajo mund të kishte filluar me kohë, por është çështja e armës atomike në mes. Në qoftë se do të bëhet një luftë e re botërore, kjo do të jetë atomike, se Bashkimi Sovjetik do të hedhë bomba mbi Nju-Jork e mbi qytetet e tjera të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe këto të fundit do të bëjnë të njëjtën gjë kundër Bashkimit Sovjetik.

Ne mendojmë se qofshin sovjetikët apo amerikanët dhe borgjezia e Evropës Perëndimore, qofshin satelitët

e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ata të Bashkimit Sovjetik, bëjnë përpjekje të mos ballafaqohen në një luftë, që do të ishte një ballafaqim atomik. Prandaj, në qoftë se vihet re njëfarë bashkëpunimi midis tyre, ky realizohet për të dalë nga kriza dhe për të mos u ballafaquar në luftën atomike. Të dyja superfuqitë kanë kontradikta të papajtueshme me njëra-tjetrën. Ne jemi për atë që kontradiktat midis imperialistëve amerikanë dhe socialimperialistëve sovjetikë të thellohen, prandaj duhet t'i luftojmë të dyja palët. Nuk mund të ketë unitet të vërtetë midis imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik, se ata janë të dy imperialistë. Çdo veprim e kryejnë për të siguruar hegjemoninë secili për vete, por në kurriz të popujve, prandaj ne nuk bëjmë dallime në luftën kundër tyre. Do të shikojmë se si do të zhvillohen situatat më tej, por kurdoherë duhet të jemi në vëzhgim e vigjilentë.

Mirëpo pavarësisht nga këto përpjekje, nga njëra anë ekzistojnë organizatat agresive ushtarake si NATO-ja dhe Traktati i Varshavës, që janë krijuar nga superfuqitë si instrumente të luftës, dhe, nga ana tjetër, ekzistojnë Tregu i Përbashkët Evropian, që është një bashkim i madh trustesh dhe koncernesh kapitaliste, dhe KNER-i me tendenca krejtësisht skllavëruese. Ne jemi kundër NATO-s dhe Traktatit të Varshavës, jemi kundër KNER-it dhe Tregut të Përbashkët Evropian, pse të gjitha këto organizata me karakter agresiv ushtarak ose shfrytëzues ekonomik janë kundër interesave të popujve, janë skllavëruese.

Partia jonë nuk mund të pranojë që KNER-i është i keq dhe Tregu i Përbashkët Evropian është i mirë,

për sa kohë që të dyja këto organizata kanë karakter shfrytëzues kapitalist dhe mbrojnë interesat e monopoleve të mëdha për të shfrytëzuar popujt e tyre, që janë aleatët tanë.

Bashkimi Sovjetik deklaroi se bën pjesë në aleancën e shteteve të «bashkësisë socialiste», por në këtë «aleancë» sundon grushti sovjetik, prandaj kjo e ashtuquajtur aleancë është antimarksiste, është një bluf. Edhe Evropën e Bashkuar e ka dënuar Lenini. Një bashkim i tillë i Evropës, — ka thënë ai, — është reaksionar. Të gjitha shtetet e Evropës Perëndimore, në fakt, kërkojnë të bëjnë një bashkim qoftë edhe artificial në Evropë për shumë qëllime. Së pari, ata duan të qëndrojnë bashkërisht përballë sovjetikëve, ashtu si mund të qëndrojnë; së dyti, duan të shtypin popujt, të shfrytëzojnë më lehtë proletariatin e vendeve të tyre për të siguruar fitime sa më të mëdha. Prandaj Partia jonë, duke e parë në prizmin klasor këtë bashkim të shteteve të Evropës, është kundër tij dhe e demaskon.

Ka rrezik të bëhet luftë në Evropë? Mund të ketë, por lufta nuk mund të bëhet për qejfin e njërit apo të tjetrit, historia nuk mund të përsëritet për t'i plotësuar dëshirën njërit apo tjetrit. Imperialistët e duan luftën. Kur kontradiktat acarohen në shkallë të tillë sa që llafet, propaganda dhe «reformat» ekonomike nuk mund t'i frenojnë më, atëherë fillon lufta. Lufta mund të pëlcasë qoftë atje ku ndeshen interesat e superfuqive, qoftë atje ku superfuqitë kanë ose mund të kenë leverdi më të madhe, edhe atje ku forcat demokratike janë kundër fashizimit të vendit. Në situata të tilla vijnë në fuqi njerëz të tillë si Frankoja, Musolini, Hitleri dhe të tjerë.

Do të fillojë lufta më parë në Evropë? Këtë nuk mund ta themi me siguri, pse mund të ndodhë që lufta të pëlcasë edhe gjetkë, ajo mund të fillojë më parë edhe në Lindjen e Mesme, ku po shikojmë gjithë këtë zhvillim ngjarjesh. Derisa Shtetet e Bashkuara të Amerikës bashkë me aleatët e tyre po investojnë kapitale të mëdha në Bashkimin Sovjetik, derisa ata i shesin këtë mbi 20 milionë tonë grurë në vit, kjo tregon se i shmangen ballafaqimit me të, prandaj mund të mendojmë se lufta në Evropë nuk është imediate. Por në një kohë kur Franca po bën investime në Bashkimin Sovjetik, kur Gjermania Perëndimore po investon, gjithashtu, atje dhe në Gjermaninë Lindore, në Rumani e doemos edhe në Jugosllavi, kjo do të thotë se kapitalistët e Evropës Perëndimore po ndihmojnë agresorin sovjetik dhe po e inkurajojnë këtë që të sulmojë «aleatët» e pabindur ose të sulet gjetkë. Këtë mundësi Partia jonë nuk mund ta përjashtojë.

Aktualisht ekzistojnë kontradikta midis revizionistëve sovjetikë dhe revizionistëve të vendeve të tjera, për arsye se sovjetikët përpiqen të diktojnë mbi ta. Megjithatë, ata nuk ia kanë arritur dot qëllimit, sepse partitë revizioniste, si ajo e Francës, e Italisë, e Anglisë, e Spanjës apo e Jugosllavisë, duke përfaqësuar interesat e borgjezive të tyre nacionale, nuk duan të komprometohen përpara këtyre, duke iu nënshtruar sovjetikëve. Kjo flet për një çarje midis tyre. Kundërshtime me fjalë bën edhe Rumania e duket sikur nuk është dakord me pikësynimet e revizionistëve sovjetikë.

Bashkimi Sovjetik mund të bëjë sulme të pjeshme. Ai mund t'ia hipë në zverk Rumanisë, por nuk

përrjashtohet që Bashkimi Sovjetik të sulmojë edhe Jugosllavinë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të mos lëvizin as gishtin, si nuk lëvizën në kohën e pushimit të Çekoslovakisë. Bashkimi Sovjetik mund të sulmojë edhe Republikën Popullore të Shqipërisë, por ama nuk sulmon Greqinë, Francën, Anglinë, Austrinë. Këto mundësi për luftë nga ana e sovjetikëve shikojmë ne në Evropë. Historia na ka mësuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në të dy luftërat botërore, u kanë ardhur në ndihmë aleatëve në «aksham», kur dukej qartë se nga ç'anë ishte fitorja. Mundet që ato përsëri ta bëjnë një gjë të tillë, prandaj përpiqen edhe kësaj radhe që t'ua nxjerrin të tjerët gështenjat nga zjarri.

Në bazë të tezave të Leninit imperializmi duhet të dobësohet nëpërmjet luftërave çlirimtare të popujve. Në qoftë se nuk mund ta ndalojmë luftën agresive imperialiste, atëherë duhet të përpiqemi ta kthejmë këtë në luftë civile, në luftë revolucionare, në luftë çlirimtare. Këtë gjë ne duhet ta përgatitim. Çfarë roli ka Partia e Punës e Shqipërisë në këtë luftë? Ajo nuk ka ndonjë rol shumë të ndjeshëm, për shkak të madhësisë së paktë të vendit tonë, por, pa qenë mendjemëdhenj, ne mund të themi se Partia jonë zbaton besnikërisht marksizëm-leninizmin dhe si e tillë ndihma e saj për revolucionin nuk është e parëndësishme. Po të ndjekim marksizëm-leninizmin në të gjitha çështjet, atëherë do të jemi në gjendje t'i frymëzojmë masat si duhet, t'i ngremë ato kundër imperializmit, socialimperializmit, kundër revizionizmit modern dhe kundër borgjezisë reaksionare, që po punojnë me zell për përgatitjen e luftës kundër popujve.

Ju thatë se nuk keni dëgjuar që PPSH të ketë pasur pikëpamje të kundërta me revizionistët para Mbledhjes së Moskës të vitit 1957. Unë mund t'ju them se jo vetëm kemi pasur, por edhe ua kemi shprehur kundërshtimet e pikëpamjet tona hrushovianëve, që sa erdhën në fuqi. Por ato nuk i publikuam që atëherë. Më kujtohet kur, pas një seance të kësaj mbledhjeje, që e drejtonte Suslovi, siç mund t'ju kujtohet, ai që mbante cullufet mbi sy dhe ecte si në majë të gishtave, ne u zëmë me Hrushovin e Mikojanin për çështje që kishin të bënin me marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Hrushovianëve u leverdiste të ruanin në dukje unitetin në lëvizjen komuniste. Kurse në vitin 1960 ne ngritëm edhe përpara kinezëve çështjen se nuk mund të ketë pajtim me tradhtarët hrushovianë, se nuk duhet të ketë ulje të polemikës nga ana jonë, se polemika duhet të vazhdojë deri në fund kundër revizionistëve të Kremlinit. Në mjaft dokumente të Partisë sonë shprehet se në asnjë mënyrë nuk mund të vazhdohet të kihet besim tek ata. Komiteti Qendror i Partisë ka marrë vendim për këtë çështje. Për ne u krijua atëherë një situatë e vështirë, por Partia jonë, e lindur dhe e forcuar në Luftën Nacionalçlirimtare dhe e kalitur në luftën kundër revizionistëve jugosllavë, e përballoi me sukses atë.

Partia jonë mendon se vendi ynë i vogël duhet të jetë vetë i fortë dhe i përgatitur për të përballuar situatat më të rënda dhe rreziqet që mund t'i kanosen, veç e veç ose të gjitha së bashku. Në këtë çështje Partia dhe vendi ynë, ashtu si të gjitha lëvizjet marksiste-leniniste dhe ato përparimtare të botës, mbështeten edhe në ndihmën internacionaliste të popujve liridashës.

Kjo forcë e madhe kolosale i bën të pamposhtur Partinë dhe popullin tonë. Partia e Punës e Shqipërisë nuk e ndan çështjen kombëtare nga ato ndërkombëtares, por është e domosdoshme që vendi të jetë i fortë që t'u rezistojë armiqve të fuqishëm e për të pasur mundësi të ndihmojë edhe miqtë e shokët e shumtë në botë.

Me pak fjalë, kjo është rruga që ndjek Partia jonë. Edhe kur na vijnë këtu shokë të tjerë, ne këto çështje ua themi. Ne dëshirojmë të shkëmbejmë mendime me ta, se jemi vend i vogël dhe nuk kemi pamje të një hapësire të madhe, kështu disa gjëra mund të mos i shikojmë si duhet. Pikërisht pse populli ynë është i vogël, ai e kupton se edhe rreziqet për të janë të mëdha. Duke i vlerësuar realisht këto rreziqe, jemi vigjilentë. Partia jonë trashëgon në drejtim të vigjilencës përvojën e madhe e të çmueshme të popullit tonë.

Të gjithë popujt kanë luftuar për lirinë e tyre, por në këtë luftë kanë pasur edhe ndihma. Kurse popullin tonë të tjerët jo vetëm që s'e kanë ndihmuar, por e kanë shtypur, e kanë gjakosur, e kanë vrarë, e kanë përçarë vazhdimisht në shekuj. Ja, një milion e gjysmë shqiptarë janë matanë kufirit tonë, në Jugosllavi. Partia jonë i ka kurdoherë parasysh këto vuajtje të mëdha e shekullore, prandaj edhe sot, edhe në të ardhmen e shikon me kujdes rrezikun.

Mund të na quajnë «sektarë», por ne nuk jemi as të tillë, as liberalë. Jemi vetëm marksistë-leninistë. Sektarizmi dhe liberalizmi janë të dy të këqij. Shqipëria është një shtet që mbështetet në pozitën e saj të forta, por ajo nuk është e mbyllur në guaskë, sepse me 70

vende të botës kemi marrëdhënie diplomatike, me mbi 100 kemi marrëdhënie tregtare dhe, siç tregojnë faktet, të tërë popujt e këtyre vendeve kanë simpati për vendin tonë. Po pse kanë simpati? Sepse ata e dinë që ne shqiptarët, Partia dhe Qeveria jonë thonë atë të vërtetë që ata nuk e thonë dot. Mbrojtja e së vërtetës dhe e së drejtës është një ndihmë për popujt e botës.

Neve na vihen shumë detyra, në radhë të parë për mbrojtjen e atdheut, prandaj me qëndrimet tona korrekte përpiqemi për të krijuar sa më shumë miq në botë, për të ruajtur miqësinë me të gjithë marksistë-leninistët dhe për të fituar simpatinë e popujve të botës.

Po na sulmuan armiqtë e socializmit, ne do të jemi të detyruar të luftojmë të rrethuar, ndihma e popujve të tjerë në drejtim të Shqipërisë do të jetë e madhe në kuptimin moral, por ndihmë konkrete nuk mund të na jepet. Ne po e stërvitim ushtrinë tonë në mënyrë të tillë që çdo fishek i harxhuar të godasë në shenjë, të vrasë një armik, që predha e parë e topit të qëllojë drejt e në shenjë. Po u ndez lufta me ne, kemi llogaritur të mos e lejojmë armikun të vërë këmbën në truallin tonë dhe parashikojmë që lufta jonë do të jetë e gjatë. Para se të të sulmojë, armiku merr përsipër të të likujtë, prandaj ne jemi të përgatitur të luftojmë deri në fund, sado që të zgjatë lufta. Në qoftë se armiku nuk do të tërhiqet, as ne nuk do të tërhiqemi nga pozitat tona në asnjë rrethanë.

Këto janë mendimet tona. Në qoftë se ju keni ndonjë vërejtje, ne do ta dëgjojmë me vëmendje e dasha-

mirësi, se jemi shokë dhe kur kemi vërejtje duhet t'ia bëjmë njëri-tjetrit.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Kundër revizionizmit modern
1971-1975» (Përmbledhje
dhje veprash), f. 610*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Kundër revl-
zionizmit modern 1971-1975»
(Përmbledhje veprash), f. 610*

**NDAJ ARMIQVE DUHET MBAJTUR QËNDRIM
I PRERË DHE TË MOS HYHET
NË PAZARLLËQE ME TA**

Nga biseda¹ me princin Norodom Sihanuk

9 dhjetor 1975

Duke i takuar miqtë kamboxhianë, shoku Enver Hoxha u uroi mirëseardhjen dhe i përgëzoi për fitoren që kishin arritur kundër imperialistëve amerikanë dhe klikës së Lon Nolit. Ndër të tjera, ai tha:

Lufta e armatosur e popullit kamboxhian kundër agresorëve imperialistë amerikanë e shërbëtorëve të tyre do të mbetet një ngjarje me rëndësi historike, sepse, gjatë pesë vjetëve, vetëm me forcat e mjetet e veta, me gjakun e tij, ky popull heroik mundi një armik shumë të egër. Imperializmi amerikan nuk mundi të fitonte, sepse vullneti i popullit kamboxhian ishte shumë më i fuqishëm nga armët e tij të shumta e moderne, nga politika e tij demagogjike,

Ne vazhdimisht e kemi përkrahur luftën e popullit tuaj. Mund të themi me siguri që as populli juaj,

1. Biseda u zhvillua në selinë e Komitetit Qendror të PPSH.

as luftëtarët brenda Kamboxhias, as ne shqiptarët nuk u gabuam në parashikimet tona për perspektivat e kësaj lufte. Fitorja e dëshiruar mbi imperialistët amerikanë u arrit.

Lufta juaj tregoi edhe një herë se takimet me armiqtë, qoftë sekrete, qoftë të hapura, nuk duhen pranuar. Të mos i lejojmë vetes që të hyjmë në pazarllëqe me armiqtë. Mbajtja e një qëndrimi të prerë ndaj tyre është meritë e madhe, që flet për dashuri dhe respekt të thellë për popullin e për gjakun që ai derdh në fushën e betejës. Hedhja poshtë e tentativave për komprometim, refuzimi i marrëveshjeve që janë në dëm të luftës së popullit, tregojnë besim në fitore.

Lufta e popullit kamboxhian nuk ishte e izoluar. Kamboxhianët luftonin edhe për vete, edhe për ne dhe për popujt e tjerë të botës, që akoma nuk e kanë fituar lirinë dhe vuajnë nën sundimin imperialist e revizionist. Rezistenca e Kamboxhias ndaj forcës ushtarake amerikane ka qenë një shembull i madh për të gjithë, sidomos për popujt e Afrikës, të Azisë dhe të Amerikës Latine.

Tani, siç e dini, për ju fillon një etapë tjetër, ajo e rindërtimit të vendit, që është, gjithashtu, periudhë lufte. Edhe populli ynë ka kaluar nëpër këtë etapë, që, sigurisht, paraqet vështirësi, por këto populli kamboxhian do t'i kapërcejë, ashtu siç i ka kapërcyer edhe populli shqiptar. Ne kemi qenë shumë më të vegjël në numër nga ju dhe ishim shumë të varfër ekonomikisht. Ashtu si ju, lufta na shkatërroi edhe ne. Në vendin tonë armiqtë rrafshuan gjithçka që gjenin përpara, nga Jugu në Veri.

Kemi besim se ju do ta merrni veten shpejt, vendi juaj do të hyjë në një jetë normale dhe të lulëzuar. Në këtë punë dhe luftë për rindërtimin e vendit, populli kamboxhian do të ketë gjithnjë me vete zemrën e popullit tonë. Ne do të jemi kurdoherë me të. Betejat e reja që do të fitoni do të jenë për të mirën e popullit, që tani është i çliruar prej armiqve.

Princi Norodom Sihanuk në fjalën e tij falënderoi shokun Enver Hoxha për vlerësimin e lartë që i bëri luftës së popullit kamboxhian dhe trajtoi disa probleme të brendshme të Kamboxhias. Pastaj fjalën e mori përsëri shoku Enver Hoxha:

Ashtu si populli ynë, edhe populli juaj është punëtor. Ai me siguri do të arrijë rezultate të mira, bile edhe më të mira se tonat, se ju keni një vend të gjerë me toka mjaft pjellore.

Pas luftës në Shqipëri ka pasur mobilizim dhe kurajë, u bënë përpjekje shumë të mëdha për të rindërtuar vendin e shkatërruar. Nuk mund të përfytyrohet sa i madh ka qenë zelli i popullit për punë, edukim dhe mësim. Në atë kohë armiqtë pyesnin me qesëndi: «Këta janë ata që do të qeverisin vendin dhe do të ndërtojnë Shqipërinë e shkatërruar?!». Por neve na u deshën vetëm dy vjet për të vënë punët në vijë, për të vënë rregull. Këtë rregull e vendosi populli i bashkuar rreth Partisë, me po ata njerëz që luftuan, që zbritën nga malet. Kështu është rindërtuar gjithçka në Shqipëri.

Është e vërtetë se që prej kohës së luftës situata tona ka ndryshuar shumë në drejtim pozitiv. Gjithçka, siç e dini mirë edhe ju, ne e filluam nga e para. Në

këtë punë ndërtuese na ka inkurajuar e na inkurajon edhe dashamirësia e miqve tanë.

Vitet e fundit ne kemi arritur suksese të mëtejshme në zhvillimin e bujqësisë, të industrisë dhe të kulturës. Sivjet korrjet e drithërave ishin më të mira se vitin e kaluar, megjithatë te ne ka akoma shumë gjëra për të bërë, pra, duhet të punojmë me më shumë këmbëngulje, më me kurajë dhe të forcojmë më tej organizimin e punës për të plotësuar të gjitha detyrat, për arsye se situata ndërkombëtare është e turbullt.

Si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe Bashkimi Sovjetik, si fuqi agresive që janë, përgatiten për luftë. Ata intrigojnë për të krijuar vatra të reja zjarri, nxitin të tjerët që të luftojnë për ta, duke u përpjekur për të krijuar secili një situatë më të mirë për veten. Përballë luftës së këtyre superfuqive, që zhvillohet për të ndarë tregjet dhe sferat e influencës në botë, ne duhet të jemi gjithnjë në gatishmëri dhe vigjilentë.

Në mbrëmjen e së njëjtës ditë Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë dhanë një pritje në Pallatin e Brigadave për nder të princit Norodom Sihanuk dhe të personave që e shoqëronin. Në bisedën që u zhvillua gjatë pritjes, shoku Enver Hoxha, ndër të tjera, tha:

Shqipëria është e do të jetë gjithmonë mike besnike e popullit kambodhian. Fjalimi¹ shpreh ndjenjat e ngrohta të popullit tonë për popullin tuaj, që arriti fi-

1. Fjalimi që mbajti në fillim të pritjes shoku Haxhi Lleshi, në atë kohë Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor.

tore kundër agresorëve imperialistë amerikanë e shërbëtorëve të tyre.

Ne gjithmonë jemi përpjekur të kemi miq të vërtetë në botë. Ardhja juaj në Shqipëri i shërben forcimit të miqësisë së popullit tonë me popullin tuaj, i cili ka një histori e kulturë të lashtë, të respektuar nga e gjithë bota. Ai është popull liridashës e nuk mund ta duronte skllavërinë, pushtimin e vendit të vet. Një popull, sado i vogël të jetë, kur bën luftë të drejtë për liri, do të fitojë, pavarësisht se armiku që ka përballë mund të jetë shumë i madh.

Armiqtë tanë, imperialistët amerikanë dhe social-imperialistët sovjetikë, janë shumë agresorë. Ata presin momentin e përshtatshëm për të sulmuar kundërshhtarët e tyre me të gjitha mënyrat e mjetet. Për këtë përdorin edhe demagogjinë që mundohen ta vënë në jetë me anë të mbledhjeve e konferencave që organizojnë. Le të marrim, për shembull, Konferencën për Sigurimin Evropian. Ne i qëndrojmë besnikë pikëpamjes sonë për sa i përket kësaj konference, e cila, në të vërtetë, nuk është konferencë sigurimi. Ajo sanksionon gjendjen e pasigurisë në Evropë, prandaj nuk morëm pjesë në të. Ne mendojmë se ajo nuk dha asnjë rezultat pozitiv. S'ka asnjë dyshim që kjo konferencë u manipulua nga dy superfuqitë për të ruajtur njëfarë statukuoje dhe drejtohej kundër popujve të botës. Pjesëmarrësit e tjerë në të vetëm «vallëzonin». Kjo u zhvillua si konferenca e Vjenës, ku të tjerë ishin ata që mbanin fjalime bombastike, të tjerë ata që bisedonin korridoreve vesh më vesh dhe të tjerë ata që ngrinin dollin e përpunoheshin nga të tjerët.

Këto ditë ne sollëm në atdhe eshtrat e partizanëve e partizaneve tona, që ranë në luftë për çlirimin e popujve të Jugosllavisë. Eshtrat e një pjese prej tyre i kishim sjellë më parë, kurse tani sollëm eshtrat e pjesës tjetër. Ato ne i vendosëm në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit. Martirët që luftuan trimërisht në Kosovë, në Malin e Zi e në vise të tjera në Jugosllavi e meritonin plotësisht këtë nder. Me rastin e sjelljes së eshtrave të tyre në atdhe, këtu në Tiranë erdhën për t'u bërë homazhe edhe prindërit dhe të afërmit nga të katër anët e Shqipërisë.

Edhe popujt e Jugosllavisë luftuan kundër fashizmit. Lufta e përbashkët me ta kundër të njëjtëve armiq e forcoi miqësinë midis popujve tanë. Kur çliruam vendin, ne nuk i lëshuam armët. Partizanët tanë e ndoqën pushtuesin këmba-këmbës edhe brenda Jugosllavisë dhe luftuan atje bashkërisht me partizanët jugosllavë. Luftëtarët tanë, që ranë atje heroikisht, ishin nga të gjitha krahinat e Shqipërisë.

Në Shqipëri janë ngritur pothuajse kudo pllaka përkujtimore, lapidare, buste e monumente për nderimin e kujtimit të luftëtarëve të rënë. Varret e dëshmorëve tanë i kemi mbuluar me gurë mermeri e me lule shumëngjyrëshe. Varrezat e Dëshmorëve janë kthyer në kopshte të bukura. Kjo flet për respektin e madh që ka populli ynë për ata që dhanë gjakun e tyre për çlirimin e vendit. Në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit dhe në vendet ku ata kanë dhënë jetën duke luftuar me trimëri kundër armiqve, njerëzit shkojnë për t'u përlulur me respekt të madh para kujtimit të tyre të paharruar.

Në këto momente disfatë për armiqtë, atyre duhet të vazhdosh t'u japësh grushte. Kundër armiqve duhet folur hapur, pa doreza. Është me të vërtetë katastrofë që, mbasi të kesh luftuar e t'i kesh thyer imperialistët amerikanë në fushën e betejës, t'u shtrish dorën për ndihmë revizionistëve sovjetikë, që janë po aq të rrezikshëm sa edhe të parët. Revizionistët sovjetikë ne i kemi demaskuar si armiq, që kanë pasur dorë në veprimtarinë e urryer të grupeve armiqësore kundër lirisë dhe pavarësisë së vendit tonë, të cilat i kemi zbuluar. Po e përmend këtë fakt, sepse, në qoftë se ju do të pranoni shkëmbimin e përfaqësive diplomatike me Bashkimin Sovjetik, duhet të ruheni nga intrigat dhe përpjekjet e tyre për të minuar fitoren tuaj, që u arrit me gjak. Këtë mendim jua kam shprehur edhe herë tjetër, sepse ne shqiptarët kemi eksperiencë mjaft të hidhur në marrëdhëniet me revizionistët në përgjithësi dhe me ata sovjetikë në veçanti.

Këto që thatë ju në fjalimin tuaj¹ janë shprehje e ndjenjave të miqësisë së popullit dhe të luftëtarëve trima të Kamboxhias për popullin vëlla shqiptar. Por edhe populli ynë ushqen për popullin kamboxhian të njëjtat ndjenja miqësie, të cilat ne punojmë t'ia forcojmë akoma më shumë. Para disa ditësh u tregova fëmijëve të mi një album të mrekullueshëm për Kamboxhian, ku paraqiteshin edhe monumentet e famshme kamboxhiane. Fëmijët tanë duhet t'i mësojmë të njohin mirë se cilët janë miqtë dhe cilët janë armiqtë tanë, të njohin vështirësitë e miqve dhe vuajtjet e popullit të

1. Fjalimi që mbajti princ i Norodom Sihanuk në pritje.

tyre. Në këtë mënyrë forcohet dhe përjetësohet miqësia. Me popujt e botës ne jemi miq, i duam dhe i respektojmë.

Mbasi princi Norodom Sihanuk vlerësoi interpretimin e njërës prej këngëtareve që dhanë shfaqje gjatë pritjes, shoku Enver Hoxha tha:

Ajo është artiste amatore, kurse këngëtarja që tani po interpreton një nga këngët tona partizane, është nga më të mirat që kemi. Në këngët e vjetra popullore shqiptare u këndohet vuajtjeve dhe jetës së vështirë, por edhe trimërive të popullit tonë, që kurrë nuk u është përkulur armiqve. Në këngët tona të reja u këndohet Luftës së madhe Nacionalçlirimtare, heroizmit masiv partizan, maleve që shërbyen si kështjella të pathyeshme në këtë luftë dhe jetës së re socialiste.

Populli ynë bën punë të madhe për të zhvilluar kulturën e tij socialiste. Nën kujdesin e Partisë e të shtetit tonë socialist ai punon për të ngritur më tej nivelin e tij kulturor e material. Këtij qëllimi i shërbejnë edhe kreditë me afat të gjatë që u jep shteti kooperativave bujqësore.

Populli përgatitet edhe ushtarakisht për të qenë kurdoherë gati për çdo eventualitet e situatë të vështirë që mund të krijojnë armiqët. Morali dhe entuziazmi i tij në këtë drejtim janë shumë të lartë.

Partia dhe Qeveria janë veprojnë gjithmonë me modesti, punojnë në rrugë të drejtë dhe janë të lidhura me popullin. Ky fakt e inkurajon atë për të ecur gjithmonë përpara. Në veprimtarinë e tyre, Partia dhe Qeveria kërkojnë mendimin e popullit, me të cilin bëj-

në punë sgaruese, edukuese e bindëse, duke e mobilizuar dhe duke e udhëhequr për ndërtimin socialist të vendit.

Mbasi shkëmbyen mendime edhe për disa probleme të gjendjes së brendshme e të situatës ndërkombëtare, shoku Enver Hoxha shprehu kënaqësinë për bisedën që pati me princin Norodom Sihanuk dhe u largua pasi u përshëndet me të e me të pranishmit.

Dotohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

NË MARRËDHËNIET ME TË TJERËT NE JEMI KORREKTË, VIGJILENTË E GJAKFTOHTË

Nga biseda me princin Norodom Sihanuk

15 dhjetor 1975

Në fillim të takimit shoku Enver Hoxha i shprehu Norodom Sihanukut kënaqësinë që po takoheshin përsëri pas vizitave që princi kishte bërë në disa vende. Ndër të tjera, ai tha:

Ju duhet të ndiheni në Shqipëri si në vendin tuaj dhe ju falënderojmë për vizitën miqësore që po na bëni. Keni ardhur nga Kamboxhia e largët dhe ne duhet të gjejmë kohë të lirë për t'u parë dhe për të biseduar me njëri-tjetrin.

Princi Norodom Sihanuk shprehu kënaqësinë që po takohej me shokun Enver Hoxha dhe, mbasi foli shkurt për vizitën që kishte bërë në Rumani, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Rumania tani zhvillon një aktivitet «të madh» politik dhe presidenti i saj Çaushesku duhet të jetë «shumë i zënë», se bën një politikë të jashtme të «kalibrit botëror». Ai hiqet sikur është kundër sovjetikëve, por në të vërtetë është me ta dhe me imperialistët ameri-

kanë. Nuk ju tha të pajtoheshit me sovjetikët? Çausheku do me çdo kusht «pajtim» midis shteteve të Ballkanit dhe gjithë shteteve të botës, do «vëllazërimin» e popujve arabë me sionistët izraelitë. Ai dhe ata që e pasojnë në Rumani kërkojnë «të pajtojnë» shiun me zjarrin, por nuk shikojnë se është tepër vështirë për ta arritur këtë gjë, edhe sikur të kishin mundësi të impononin me forcë pikëpamjet e tyre. Në këto orvatje për «pajtime» nuk kanë mbetur pas as sovjetikët dhe amerikanët, por provat e bëra prej tyre nuk u kanë dhënë asnjëherë përfundimin e dëshiruar.

Rumunët kanë bërë gjithnjë politikë proizraelite. Në Rumani ka mjaft çifutë. Prej viteve 1954-1955 e këtej shumë prej tyre janë shpërngulur për në Izrael. Edhe tani vazhdon ky proces emigrimi.

Ne nuk jemi kundër çifutëve si popull, por jemi kundër sionizmit dhe politikës agresive të shtetit reaksionar të Izraelit, që s'është tjetër veçse një kobure në duart e imperializmit amerikan. Izraeli pa asnjë të drejtë mban me forcë pjesë të territorit të Palestinës vetëm sepse atje paskan jetuar izraelitë! Me këtë «arsyezim», duke anksuar tokat e palestinezëve e të arabëve të tjerë dhe duke i përzënë e duke i persekutuar ata, sionistët kanë krijuar shtetin e tyre.

Palestinezët që sot luftojnë kundër sionistëve, ishin fëmijë kur u pushtuan tokat e tyre. Sot ata kanë plot të drejtë të kenë kombin e vet të bashkuar, të kthehen në trojet e tyre. Ata sot jetojnë të mjeruar, në çadra që kanë ngritur në shkretëtirën e Jordanisë e në vende të tjera arabe.

Partia dhe shteti ynë e shikojnë drejt dhe se-

riozisht lojën e rrezikshme që luhet mbi shpinën e popujve arabë. Nga njëra anë, duket sikur në marrëdhëniet midis egjiptianëve e amerikanëve ka njëfarë qetësie dhe, nga ana tjetër, në Liban, si rezultat i intrigave që thuren, vazhdon gjakderdhja, bëhet luftë civile e brendshme, që gjoja nxitet nga arsye fetare. Mirëpo kjo nuk është aspak e vërtetë. Prapa kësaj lufte fshihet ndërhyrja e imperialistëve amerikanë dhe e socialimperialistëve sovjetikë, që krijojnë ngatërresa për të lehtësuar detyrën e kobures izraelite.

Superfuqitë zbatojnë parimin e vjetër «përça e sundo», prandaj bëjnë çmos që popujt arabë të Lindjes së Mesme të mos bashkohen kundër armiqve të tyre të përbashkët, që janë imperialistët amerikanë, social-imperialistët sovjetikë dhe sionistët izraelitë. Këta të fundit janë maja e shpatës, sidomos e imperialistëve amerikanë.

Në themi se nuk duhet të kemi besim te superfuqitë, përkundrazi, duhet të jemi vigjilentë, të armatosur e të bashkuar, me qëllim që ato të mos gjejnë as të çarën më të vogël në radhët tona, ku të mund të futin shpatën e tyre.

Kreditë që japin këta armiq, janë zinxhirë skllavërues për ata që i pranojnë.

Kohët e fundit lexova fjalimin që ka mbajtur Titoja, të cilit ju do t'i bëni vizitë. Fjalimi i tij ishte fund e krye pesimist. Ai shprehej pak a shumë kësh-tu: Ku po shkojmë ne me këto borxhe që jemi zhytur deri në grykë? Ato duhet t'i paguajmë, mirëpo për t'i paguar, po marrim kredi të reja dhe, për të shlyer përqindjet e këtyre kredive, mbushemi përsëri me më

shumë borxhe. Titoja pohonte me dëshpërim se fajin për këtë situatë të rëndë e kanë «komunistët» jugosllavë dhe Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë. E solla shembullin e borxheve të Jugosllavisë për të treguar se «ndihmat» dhe kreditë e superfuqive janë helm, që shkatërrojnë plotësisht organizmin e kombit, janë si krimbi që të gërryen përbrenda, ato janë korruptuese dhe shkatërrimtare për ekonominë dhe për moralin. Pra, ne mund të mbështetemi vetëm te miqtë tanë, por jo tek imperialistët. Gjatë pesë vjetëve imperialistët e dogjën pa mëshirë vendin tuaj dhe të kesh qoftë edhe një fije shpresë se këta armiq mund të të ndihmojnë për të shëruar ato plagë të mëdha që vetë ti kanë shkaktuar, do të thotë të kesh humbur arsye.

Ne gjithmonë kemi ndjekur politikën e fqinjësisë së mirë me shtetet përreth dhe dëshirojmë që edhe ata të jenë, gjithashtu, korrektë në marrëdhëniet me vendin tonë. Historia ka treguar se shqiptarët kanë qëndruar gjithnjë në të drejtën e vet dhe nuk kanë lejuar të shkelet mbi këmbët e tyre. Mirëpo, pardje ndodhi një incident i rëndë në kufirin shqiptaro-jugosllav. Set një tjetër. Një anije peshkimi shqiptare gjendej në lumin Buna, lumë në veriperëndim të Shqipërisë. Anija po peshkonte në dalje të Bunës, krejtësisht në ujërat tona territoriale, kurse një anije ushtarake jugosllave, që doli nga një port jugosllav i bregdetit të Adriatikut, u përpoq ta merrte me vete anijen tonë të peshkimit! Tanët me të drejtë e kundërshtuan këtë veprim piratesk. Ata ishin në ujërat territoriale shqiptare dhe, natyrisht, nuk do të zbatonin urdhrat e të tjerëve. Anija ushtarake jugosllave, në mënyrë

provokuese, u soll disa herë përqark anijes shqiptare të peshkimit dhe papritmas e qëlloi. Kështu na vranë kapitenin e anijes dhe plagosën një marinar të ekuipa-zhit të saj. Anijet tona të luftimit dolën menjëherë në mbrojtje të të drejtave të shtetit tonë sovran, por u kthyen, se anija ushtarake jugosllave ishte larguar.

Ka dhjetë ditë apo një javë, nuk më kujtohet me saktësi, që tre ushtarë jugosllavë hynë afërsisht një kilometër e gjysmë në thellësi të territorit tonë. Rojat tona kufitare nuk qëlluan, por i kapën dhe ne ua dorëzuam autoriteteve jugosllave të kufirit. Kjo është shprehje e politikës së fqinjësisë së mirë nga ana jonë.

Ne kemi protestuar për veprimet provokuese të jugosllavëve. Ata nuk mund të mohojnë asgjë për sa thashë, se faktet janë evidente. Këto qëndrime nuk duhet të përsëriten më në të ardhmen.

Ne deklarojmë se në marrëdhëniet me të tjerët jemi e do të jemi korrektë, vigjilentë e gjakftohtë. Të drejtën tonë e mbrojmë e duhet ta mbrojmë me fanatizëm dhe, në të njëjtën kohë, respektojmë të drejtat e të tjerëve. Ai që cenon të drejtat e të tjerëve, duhet të presë edhe kundërpërgjigjen. Politika jonë është politikë korrekte. Kjo kërkon doemos që edhe fqinjët tanë të respektojnë të drejtat dhe gjakftohtësinë tonë. Ata që na provokojnë nuk duhet të na marrin kurrë për njerëz që mbyllim sytë kur na bëjnë padrejtësi.

Edhe socialimperialistët sovjetikë si imperialistët amerikanë janë. Hrushovi, së bashku me Mikojanin dhe Kozlovin, ishin tradhtarë. Të tjerët tradhtarë që erdhën pas tyre ishin akoma më dinakë. Ju nuk besoj ta keni njohur Kozlovin, por mund t'ju them se ai ishte

si një ka pa kokë. Edhe kur fliste, e ngrinte dhe e traste me kapadaillek zërin, për t'i dhënë gjoja forcë dhe gjallëri bisedës!

Në Mbledhjen e Moskës më 1960 ç'nuk u thamë ne atyre, se të gjitha i meritonin. Edhe kinezët, gjithashtu, u thanë shumë gjëra, por nuk i kanë botuar. Ne i kemi botuar, se ndjekim rrugën e Leninit, udhëheqësit të madh të proletariatit botëror, i cili thoshte se politika e shtetit proletar duhet të jetë e hapur. Ai bënte politikë të hapur me qëllim që gjithë proletariati dhe mbarë njerëzimi të dinin atë që mendonin ai dhe qeveria sovjetike. Lenini asnjëherë nuk i shkeli parimet.

Udhëheqësit e sotëm sovjetikë bëjnë të kundërtën. Sepse në fakt ata janë antileninistë të tërbuar, por hiqen si pasues të Leninit me qëllim që të ruajnë te personat naivë besimin se gjoja janë përfaqësues të denjë të tij dhe të teorisë leniniste. Veprat dhe jo llafet janë ato që tregojnë se me cilin je, me cilin shoqërohesh dhe me cilin punon. Veprat, aksionet që ndërmer, tregojnë se cila është teoria ku mbështetesh, pavarësisht nga propaganda që bën.

Ju keni vizituar disa vende të Afrikës që kanë fituar pavarësinë dhe lirinë e tyre. Këto vende e shikojnë konkretisht, të materializuar në vepra, politikën e jashtme që bëjnë imperialistët dhe socialimperialistët. Popujt e çliruar të Afrikës duhet të bëjnë kujdes për të ruajtur pavarësinë e fituar, se amerikanët dhe sovjetikët janë gati t'i mashtrojnë, t'u japin disa kredi që t'u hedhin lakun në qafë dhe zinxhirët në duar. Në goftë se vendet afrikane do të fillojnë të ndërtojnë ekonominë me forcat e veta, nga ana e tyre duhet shumë

më tepër këmbëngulje, organizim e vullnet. Natyrisht, për të zhvilluar bujqësinë e për të ngritur një industri moderne, për të ndërtuar një ekonomi solide e të shëndoshë duhen kohë e punë. Megjithatë, vendet afrikane do të shkojnë përpara, do të përparojnë.

Kur Partia jonë i kërkoi ndihmë Bashkimit Sovjetik në vitet e para të pasçlirimit, ai na e akordoi atë. Në atë kohë, në takimet që pata me Stalinin, ai më tha se sapo kishin dalë nga lufta dhe akoma nuk i kishin rimarrë forcat e nevojshme, por megjithëkëtë do të na ndihmonin. Dhe vërtet, na ndihmuan. Stalini më tha gjithashtu, se specialistët sovjetikë nuk duhej të qëndronin për një kohë të gjatë në Shqipëri, sepse ne duhej të përgatitnim specialistët tanë për t'i zövendësuar ata dhe na këshilloi të hapnim universitetin me ata kuadro me arsim të lartë që kishim dhe me disa pedagogë që do të vinin nga Bashkimi Sovjetik. Stalini më porositi që të mos u jepnim specialistëve sovjetikë pagë më të lartë nga ajo e specialistëve shqiptarë. Unë iu përgjigja se ata vinin nga larg dhe nuk mund t'i trajtonim njësoj si tanët, por ai më kundërshtoi: «Jo, jo, le të vijnë nga Azerbajxhani dhe nga çdo anë tjetër e Bashkimit Sovjetik. Ne kemi rregullat tona për trajtimin e specialistëve që dërgojmë në ndihmë të popujve vëllezër».

Ndryshe nga Stalini, Hrushovi, sa erdhë në fuqi, kërkoi që t'ua shtonim pagën specialistëve sovjetikë. Ne i vumë në dukje qëndrimin e Stalinit për këtë çështje, por ai nguli këmbë në të tijën. Sovjetikët, duke marrë te ne paga shumë të majme, na i boshatisën dyqanet duke blerë mjaft sende të kushtueshme. Çdo spe-

cialist blinte 10-12 kostume në Shqipëri për të bërë tregti me to. Këtë gjest prej matrapazësh e hajdutësh ata duhet ta kenë bërë edhe në Kamboxhia.

Ne jemi miq besnikë të popullit kamboxhian. Atë na e respektojmë për heroizmin që tregoi në luftën çlirimtare. Kjo luftë na ka shërbyer edhe neve, edhe çlirimit të popujve. I urojmë me gjithë zemër popullit kamboxhian suksese e fitore, begati dhe unitet për t'i bërë ballë çdo eventualiteti dhe për të ruajtur lirinë e fituar. Ju urojmë shëndet e gjithë të mirat!

Sotohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

PLENUMET E KOMITETEVE TË PARTISË TË RRETHEVE TË VIHEN PLOTËSISHT NË ROLIN UDHËHEQËS

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

22 dhjetor 1975

Materiali që na paraqiti sekretari i Komitetit Qendror të Partisë, shoku Hekuran Isai, mbi çështjen se si luftohet nga plenumet e komiteteve të Partisë të rretheve për zbatimin e vendimeve të Komitetit Qendror, na bën të mendohemi e të thellohemi mbi këtë analizë që i bën ai kësaj çështjeje.

Problemi qëndron në atë se si e organizojnë udhëheqjet e byrove të komiteteve të Partisë të rretheve punën e plenumeve dhe si i ndihmojnë shokët e rinj punëtorë, fshatarë dhe intelektualë që Partia ka dërguar në udhëheqjet e rretheve.

Kemi folur shumë herë për këtë problem, por ky

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga aparati i KQ të PPSH, se si luftohet nga plenumet e komiteteve të Partisë të rretheve për zbatimin e porosive të Plenumit të 6-të të KQ.

vazhdimisht duhet theksuar, pse nga analiza që na u paraqit, del se, me gjithë përmirësimet e arritura, ekzistojnë edhe shumë të meta.

Duhet të kemi parasysh se mbledhjet e plenumeve nuk bëhen çdo ditë, prandaj byrove të komiteve të Partisë u del detyrë që në këto plume të shtrohen problemet më të rëndësishme që preokupojnë Partinë, organizatat e masave, pushtetin dhe vetë masat e gjera punonjëse. Nuk është e mjaftueshme vetëm të përcaktohen rendet e ditës për planin vjetor të problemeve që duhen marrë në shqyrtim në çdo plenum, por gjatë rrjedhës së kohës, në këtë plan mund të bëhen edhe korrigjime, për arsye se jeta nxjerr përpara probleme të ndryshme të paparashikuara, bile shpeshherë edhe më urgjente sesa ato që janë përcaktuar në program që disa herë u ka ikur edhe koha. Programi i punës së plenumeve, pavarësisht se duhet të ndiqet herë pas here, siç thashë më lart, nuk duhet të ndërtohet me hamendje ose të rishtrohen në të problemet në një rrugë formaliste dhe që nuk i përgjigjen aktualitetit. Vetëm një udhëheqje që është në korent të plotë të çështjeve dhe në krye të drejtimit të rrethit, nuk mund të bjerë në këtë gabim.

Çështja tjetër që ka rëndësi është se udhëheqësit e rrethit nuk duhet të mendojnë vetëm për të përgatitur një referat, qoftë të gjatë apo të shkurtër, që mund të tingëllojë bukur nga frazat, por që vuan nga idetë. Rëndësi ka që ky referat të paraqesë problemin kryesor realisht dhe qartë, jo gjatë dhe të mos tjerë fraza. Referati duhet të ndërtohet në mënyrë të atillë që, si thonë, «të zërë kaun nga brirët», të pasqyrojë

realisht situatën e problemit që diskutohet, të vërë në dukje jo me fraza rutine, po me një shpirt kritik në ç'mënyrë janë arritur rezultatet dhe për ç'shkak janë shfaqur gabimet.

Ka. gjithashtu, rëndësi të shpjegohet se çfarë forcash janë vënë në veprim dhe si janë organizuar këto për të arritur rezultate. Kjo shërben për t'u dhënë anëtarëve të plenumit të kuptojnë se me një organizim të tillë, me një kuptim të tillë politik dhe ideologjik të problemit, mund të arrihen suksese. Nga ana tjetër, në referat duhet të vihen qartë në dukje edhe dobësitë dhe përse janë shfaqur ato, cilët janë bartësit e dobësive, objektive dhe subjektive, sepse edhe të metat objektive rrjedhin nga subjekti që drejton në sektorin që kritikohet, se në këtë rast shumë herë subjekti ka dobësi në kuptimin politik e ideologjik të problemit, se ai nuk është i aftë të organizojë si duhet punën dhe të mobilizojë si duhet shokët, se ai ka mbeturina të theksuara mikroborgjeze dhe ky subjekt duhet treguar me gisht se kush është.

Me fjalë të tjera, mbledhja e plenumit duhet të bëhet një ngjarje, një pikënisje e zhvillimit të një pune të shëndoshë për shkruarjen qartë të problemit që trajtohet dhe, që ajo të japë rezultat, duhet të mbarojë me detyra, me detyra politike, ideologjike, si dhe me detyra organizative, pa të cilat mbledhja nuk do të ishte tjetër veçse një paradë fjalësh për të shkuar radhën.

Përveç kësaj, udhëheqësit dhe tërë byroja e komitetit të Partisë, pa përjashtuar këtu anëtarët e plenumit, kanë përgjegjësi të madhe, por në radhë të parë

kanë udhëheqësit, me sekretarin e parë në krye. Ata të shpjegojnë përse ka pasur ose nuk ka pasur sukses në zgjidhjen e problemit, pse janë shfaqur të meta dhe ku janë shfaqur këto, si i kanë mobilizuar ose përse nuk i kanë mobilizuar anëtarët e tjerë të plenumit, si dhe masat e tjera punonjëse që drejton Partia. Këtë e them se udhëheqja e rrethit duhet të kuptojë mirë që në çdo mbledhje plenumi ta shikojë me sy kritik punën e vet, veprimtarinë që zhvillon. Me këtë unë kuptoj jo vetëm sa për të bërë autokritikë, por atje ku është nevoja autokritikën ta bëjmë si duhet, të shëndoshë dhe të thellë.

E kam theksuar edhe në Plenum të Komitetit Qendror se udhëheqësit e byrosë, duke përfshirë sekretarin e parë të komitetit të Partisë të rrethit, duhet të jenë njerëz të thjeshtë dhe të palodhur në punë. Ata vetëm me një punë të ndërgjegjshme e të palodhur mund të fitojnë dashurinë dhe respektin e shokëve të tjerë. Imponimi i tyre me mënyra të tjera, jo partie, është i dënueshëm.

Nuk mund t'i lavdëroj ata shokë të byrove dhe sekretarë të parë të komiteteve të Partisë të rretheve që nuk po zbatojnë si duhet orientimin për ndihmën që duhet t'u japin gjithë shokëve të rinj që Partia dërgon në plenumë dhe që vazhdimisht rekomandon të mbështeten tek ata. Raporti që na paraqiti shoku Hekuran Isai, duke na sjellë këtu eksperiencën e Partisë për këtë problem, tregon se shumë shokë të rinj nuk i aktivizojnë si duhet dhe këta nuk po diskutojnë në plenumë. E kam theksuar dhe e theksoj se kjo vjen për arsye se këta vërtet janë sjellë në plenumë, por nuk veprojnë si anëtarë plenumesh, ca për fajin e tyre,

por më shumë për fajin e udhëheqjeve të byrove të komiteteve të Partisë të rretheve dhe të sekretarëve të parë.

Byrotë e komiteteve të Partisë të rretheve nuk kanë akoma bindjen se plenumi është forumi më i lartë në rreth, se atje duhet të rrihen mirë mendimet, se diskutimet në plenum duhet të jenë të gjalla, kritikën ndaj fajit të jenë të ashpra, atje të shtrohet direktiva dhe anej të fillojë puna. Byrotë e kanë për detyrë t'i nxitin dhe t'i ndihmojnë anëtarët e plenumit të flasin dhe të diskutojnë, jo me fjalë të mëdha e boshe, por si komunistë të pjekur, që sjellin në udhëheqjen e rrethit zërin dhe eksperiencën e masës dhe të tyren personale. Këtë zotësi dhe këtë eksperiencë ata e kanë dhe e shtojnë çdo ditë.

Sigurisht, shumica e anëtarëve të plenumit janë dhe duhet të jenë në prodhim, por të mos kuptohet kjo se ata duhet të qëndrojnë si njerëz të thjeshtë të prodhimit. Është shumë mirë që një anëtar plenumi të jetë tornitor ose kooperativist, por ai duhet, në radhë të parë, të jetë nga më të dalluarit si tornitor ose si kooperativist dhe në ndërmarrjen ku punon ta ndiejë njëkohësisht veten si drejtues i gjithë kolektivit, pse është drejtues që bën pjesë në udhëheqjen e Partisë të rrethit. Kjo do të thotë, gjithashtu, që nga stadi i punës ku punon, ai duhet të kalojë në udhëheqjen e gjithë rrethit dhe të zbatojë me kompetencë detyrat që i ka ngarkuar Partia. Këtë rrugë anëtari i plenumit duhet ta çajë edhe vetë me pjekuri marksiste, por edhe të ndihmohet fuqimisht nga byroja e komitetit të Partisë.

Por mjaft byro komitelesh partie në rrethe nuk veprojnë kështu: shumë nga anëtarët e plenumit ato i kanë vetëm për numër, i vënë pak në korent të problemeve, i thërresin pak, për të mos thënë aspak, në mbledhjet e byrosë, ku rrahin probleme të ndryshme. Duke i trajtuar kështu, ato anëtarët e plenumit nuk i përgatitin në masë për udhëheqje. Një qëndrim i tillë është shprehje pikëpamjesh të ngushta sektare dhe egoiste, pra jomarksiste, të disa udhëheqësve në byrotë e rretheve. Këta harrojnë se Partia jo vetëm nuk mund të drejtojë me dy dhe me tre veta, por çështja kryesore, që thuhet me fjalë, por nuk ndërtohet me vepër, është se me këtë qëndrim dhe me këtë metodë nuk mund t'i përgatitim Partisë kuadro të rinj që të vijnë të marrin drejtimin e punëve në duart e tyre.

Po të veprojmë kështu, pa perspektivë, mbetëm te njerëzit me moshë të kaluar, për të cilët Partia kurdoherë ka respekt për punën e tyre të madhe. Ajo ka besim tek eksperiencia e tyre, por pa mbështetjen e kuadrot e rinj dhe pa i ngritur këta në shkallën e udhëheqësit, do të bëhej një gabim i madh nga forumi, si edhe nga vetë shokët e moshuar, të cilët duhet të mendojnë edhe vetë se vjen koha (dhe për këtë po punojmë) që të rinjtë të na zëvendësojnë dhe ne të kemi e të gjejmë kohën që t'u japim eksperiencën tonë.

Kur flasim për gjakun e ri, që duhet të vijë në Parti, ta kuptojmë se gjaku i ri duhet të vijë jo vetëm në Parti, por edhe në udhëheqje. Unë mendoj se shokët e pjekur dhe marksistë-leninistë të vendosur, që e kuptojnë drejt këtë problem dhe detyrë, kur moshë u kalon, duhet të mos kenë dobësi në këtë drejtim për

të qëndruar pa lëvizur, por vetë t'i kërkojnë forumit udhëheqës se ka ardhur koha që kuadri i ri, që kemi përgatitur me kaq kujdes, të na zëvendësojë. Askush nuk mund ta përçmojë këtë gjest marksist të tyre, duke menduar gjoja se ata u lodhën, u tërhoqën nga puna. Jo, si kurdoherë ata janë e duhet të jenë në pararojë dhe ka vende e detyra të tjera boll ku mund të ndihmojnë, por Partia dhe udhëheqja e saj vazhdimisht duhet të përtërihen me gjak të ri dhe jo të lihen që të plaken e të sklerozohen.

Prandaj të kuptohet mirë udhëzimi i Komitetit Qendror të Partisë për këtë çështje që elementët punëtorë me përvojë nga prodhimi është e domosdoshme të kalojnë edhe në udhëheqje konkrete të shtetit dhe të Partisë. Të mos na trembë çështja e termit se «nga punëtor prodhimi ai u bë nëpunës». Këtë çështje ne duhet ta kuptojmë drejt dhe jo formalisht për skedarët, se vërtet një punëtor, duke e sjellë në udhëheqje, bëhet nëpunës në skedar, por ai qëndron prapë njeri i klasës, ai është me prejardhje punëtor. Dhe nëpunësit tanë të tillë duhet t'i kemi, njerëz të klasës, të regjur «me vaj e me uthull» si punëtorë, dhe mundësisht nga sektorët më të vështirë të punës. Në udhëheqje ne nuk mund të sjellim vetëm njerëz të shtresës intelektuale, njerëz të zyrave, të kalemave, të shkresave, por njerëz të regjur në luftë me vështirësitë, njerëz të prodhimit, nga ata punëtorë, sidomos, që të jenë në gjendje të thellohen, ashtu siç e do klasa, në problemet e ndryshme, të marrin vendime revolucionare, të godasin gabimet me forcë dhe jo me dorashka. Prandaj të mos trembemi nga një veprimtari e tillë.

Çështja qëndron në atë që thashë më përpara, që njerëzit e rinj që vijnë në udhëheqje, t'i mësojmë të bëhen udhëheqës. Që të mësohet të bëhet udhëheqës një element i ri, nuk mjafton, mendoj unë, ta thërresësh kohë pas kohe sa për të kaluar radhën dhe t'i flasësh për ndonjë problem të dorës së pestë. Jo! Ai, qoftë në mënyrë individuale, qoftë në mënyrë kolektive, duhet të thërritet dhe me seriozitetin më të madh t'i shpjegohen problemet që preokupojnë Partinë në gjithë thellësinë e tyre dhe t'i merret seriozisht mendimi, jo t'i jepen vetëm urdhra, por të dilet në konkluzione të përbashkëta dhe të jepen detyra edhe për byrotë e komiteteve të Partisë, edhe për anëtarët e plenumeve veç e veç.

Qenia drejtpërdrejt në prodhim e anëtarëve të plenumit është e nevojshme të kuptohet si një domosdoshmëri për vetë personin, i cili duhet të punojë, dhe nga puna e tij të nxjerrë konkluzione, të nxjerrë mendime, të japë shembullin atje ku punon, të organizojë edhe të tjerët dhe t'i çojë këta përpara. Por puna drejtpërdrejt në prodhim është, gjithashtu, domosdoshmëri, se i hap atij një horizont më të gjerë për të kuptuar zhvillimin e procesit në sektorë të tjerë pune të rrethit, të kuptojë shumë më mirë analizat që bëhen për probleme të ndryshme jashtë sferës ku ai punon, të kuptojë drejt kritikën që u bëhet punës dhe njerëzve e të mësohet kështu të drejtojë si anëtar i plenumit.

Kështu të kuptohet roli i udhëheqësve dhe i anëtarëve të plenumit në prodhim. Ata nuk duhet të mbeten punëtorë të tñjeshtë dhe qenien në plenum ta kenë vetëm sa për titull, por këtë ta kuptojnë se, duke qenë

punëtorë që krijojnë të mira për popullin, njëkohësisht fitojnë eksperiencë dhe drejtojnë jo vetëm një repart, por edhe jashtë repartit. Për anëtarin e plenumit që konsiderohet drejt si i tillë, nuk ka një përcaktim ose të shkruajmë një recetë, siç bën mjeku, por detyrën si udhëheqës ai duhet ta realizojë vetë si udhëheqës dhe byroja t'ia forcojë. Natyrisht, këtë detyrë, të shumtën e kohës, ai duhet të bëjë përpjekje që ta realizojë jashtë orarit të punës së zakonshme të tij, por mund të ketë edhe raste që ta lërë punën e vet në repart për një kohë të caktuar, pse një detyrë më e rëndësishme e kërkon të shkojë përkohësisht në një drejtim tjetër, ku duhet të vejë të japë ndihmë, të udhëzojë e të kontrollojë. Unë mendoj se kështu duhet kuptuar ky problem, ndryshe udhëheqësin e katandisim vetëm një punëtor të thjeshtë uzine.

Byrotë e komiteteve të Partisë të rretheve nuk mund t'i realizojnë në asnjë mënyrë detyrat e caktuara jashtë veprimtarisë së gjerë të anëtarëve të plenumit. Ato duhet të kenë parasysh që shokët e plenumit të kryejnë mirë detyrat e tyre në vendet ku janë caktuar të punojnë, por kjo të mos i shtyjë këta të harrojnë se janë udhëheqës ose, nga ana tjetër, t'i heqin orë e çast nga puna dhe t'i bëjnë korrierë për të çuar diku një ose dy urdhra apo udhëzime. Byrotë e komiteteve të Partisë të rretheve duhet të mendojnë për një organizim pune më të gjerë e të menduar më mirë me ata qindra e mijëra anëtarë partie që militojnë në të tërë sektorët; të cilët duhet t'i vënë në lëvizje, në vend që të tërheqin nga puna pa arsye të shëndoshë anëtarët e plenumit. Prandaj në këtë drejtim unë jam dakord me

shokun Hekuran Isai që byrotë duhet të rishikojnë më tej metodën e tyre të mbledhjeve e të takimeve, si dhe punën që bëjnë për zbërthimin e direktivave me anëtarët e plenumit dhe me aktivistët e anëtarët e thjeshtë të Partisë.

Në mbledhjet e byrove dhe në ato të plenumeve të komiteteve të Partisë është bërë zakon, dhe ky është një zakon i mirë, që thërriten edhe shokë që janë të lidhur me problemet, por edhe disa shokë të tjerë të shquar në rreth për punë, dhe kjo gjithashtu është e mirë. Por nuk do të jetë gabim që, sidomos në byro, të thërriten më shumë shokë dëgjues, jo zyrtarë, por punëtorë dhe punonjës, qofshin këta të lidhur ose jo me problemin, me qëllim që të marrin eksperiencë se si studiohen problemet në byronë e komitetit të Partisë, si bëhet atje kritikë dhe autokritikë etj.

Mua më kujtohet që, në kohën e grupeve, Grupi i Korçës, kur kishte fituar në zgjedhjet bashkiake, mbledhjet e asamblesë bashkiake i bënte me pjesëmarrjen e publikut, kryesisht me elementë të klasës punëtorë. Atëherë pse të mos e praktikojmë ne tash një gjë të tillë? Unë nuk them që mbledhjet e byrosë së komitetit të Partisë në rreth të kthohen në pazar, por të bëhen me qëllim që të edukojnë njerëzit me frymën e diskutimit të organizuar e të thellimit të problemeve dhe, përse të mos themi, edhe të kontrollit një çikë, të përgatitjes më të mirë të shokëve të byrosë, tek të cilët pa dashje mund të krijohet një familjaritet i sëmurë në mes tyre në rrumbullakosjen dhe në zbutjen e kritikës. Përpara një audience më të gjerë partie në këtë forum kjo mund të evitohet.

Të gjitha ato byro komitetesh partie në rrethe, që në mos në mënyrë të përsosur, por e kanë vënë ujin në zjarr dhe e kanë zbatuar në njëfarë mënyre ndihmën për anëtarët e plenumit, kanë pasur rezultate të mira në punë e në drejtim. Këta anëtarë plenumi atje ku kanë shkuar të ndihmojnë e të kontrollojnë punën, kanë treguar aftësi dhe eksperiencë. Siç na tregon shembulli i raportit që kemi në studim, vajtja e këtyre kuadrove të plenumit për ndihmë e për kontroll ka nxjerrë mjaft herë në shesh punën e pakualifikuar të punonjësve të aparateve të komiteteve të Partisë të rretheve, bile dhe të vetë sekretarëve të komiteteve të Partisë. Prandaj lidhur me këtë çështje mund të nxirren konkluzione, pse kanë vlerë të madhe konkluzione të tilla.

Mund të ketë sekretarë komitetesh partie në rrethe që, si drejtues që janë, evitojnë, me lezet, dërgimin e të tillë shokëve për të kontrolluar punën e Partisë, pse u nxjerrin lakrat, por edhe për ndonjë qëllim të dënueshëm, për të mos fituar si duhet eksperiencë, pse mos u zënë vendin, ose mos u nxjerrin telashe. Ata evitojnë kështu «grindavecët» në plenum me kritikën e drejta që mund t'u bëhen shokëve sekretarë ose shokëve të aparateve të komiteteve të Partisë.

Një gjë e tillë nuk paraqitet kudo, por, siç na thotë raporti, në një rast ka ndodhur që, kur dy shokë të tillë kritikuan sekretarin e parë të rrethit, në vend që kritika e ngritur të diskutohet në plenum, çështja e këtyre dy shokëve u çua në organizatat-bazë përkatëse, ku ata u kthyen në të akuzuar, se kishin guxuar të kritikonin sekretarin e parë. Këto ndodhi nuk janë të shumta, por kjo mund të jetë një nga arsyet që disa sekretarë

të komiteteve të Partisë nuk i aktivizojnë dhe nuk i nxitin si duhet shokët e plenumit. Për këtë, duhet të më kuptoni drejt, nuk jam aspak kategorik, pse kjo ngjet jo shpesh.

Kjo dobësi duket edhe në çështjen e diskutimeve në plenumë. Në përgjithësi, të rinjtë e ardhur në forume, pavarësisht se kanë nga dy-tre vjet apo më shumë, nuk marrin pjesë në diskutime, po diskutojnë vetëm kuadrot kryesorë. Vallë, shokët sekretarë të komiteteve të Partisë të rretheve reflektojnë pse ngjet ky fenomen dhe kush e ka fajin? Më duket se faji qëndron tek ata vetë dhe jo te shokët e rinj, anëtarë të plenumit. Në Komitetin e Partisë të Rrethit të Tiranës, sipas raportit, 40 për qind e anëtarëve të plenumit nuk kanë diskutuar asnjëherë gjatë dy vjetëve. Vihet pyetja: Duan këta të diskutojnë? Sigurisht që duan. Po kush i ndalon, mos vallë i ndalojnë sekretarët? Jo, nuk i ndalon njeri, por me punën që bëjnë sekretarët e komitetit të Partisë. anëtarët e plenumit të rrethit nuk janë në gjendje të diskutojnë. Kjo do të thotë se sekretarët e komitetit të Partisë nuk kërkojnë mendimin e tyre, por kërkojnë që anëtarët e plenumit vetëm të zbatojnë urdhrat e disa njerëzve që janë në udhëheqje.

Këtyre fenomeneve duhet t'u japim fund dhe të përdoren të gjitha masat dhe mjetet që vë në dispozicion Partia që mbledhjet e plenumëve të bëhen me frymë revolucionare, të kthehen në mbledhje ku të diskutohen probleme të rëndësishme që i përkasin Partisë, të dilet në to me detyra dhe nga byrotë e sekretarët e komiteteve të Partisë të jepet llogari përpara plenumëve të rretheve, ashtu siç jepet nga sekretarët

përpara byrove, dhe të aktivizohen seriozisht dhe metodikisht anëtarët e plenumeve, si udhëheqës të Partisë të rrethit që janë.

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1974-1975»,
f. 432*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Për Partinë»
(Përmbledhje veprash),
vëll. I 3-të, f. 263*

**TË MOS DOBËSOHET ROLI UDHËHEQËS I PARTISË
NË ORGANET E PUNËVE TË BRENDSHME
NËN PRETEKSTIN SE ÇËSHITJET E TYRE
JANË SEKRETE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

22 dhjetor 1975

Për forcimin e rolit udhëheqës të Partisë në organet e Punëve të Brendshme kemi folur shumë herë, prandaj nuk kam ndër mend të zgjatem, pse të gjitha sa thuhet në këtë relacion, në parim, janë shtruar nga Byroja Politike dhe nga Komiteti Qendror i Partisë edhe herë të tjera. Sigurisht, relacioni na është paraqitur për të treguar se sa dhe si zbatohen këto udhëzime nga organizatat, byrotë dhe komitetet e Partisë të organeve të Punëve të Brendshme e nga komitetet e Partisë të rretheve. Jam dakord se, me zbatimin e këtyre direktivave, ka suksese, por ka edhe dobësi, të cilat duhet të përpiqemi t'i zhdukim. Të zhdukim, gjithashtu, rutinën dhe formalizmin.

1. Në këtë mbledhje u diskutua mbi masat për forcimin e rolit udhëheqës të Partisë në organet e Punëve të Brendshme.

Siç e kam theksuar edhe në mbledhje të tjera, ideja se «qështjet e organeve të Punëve të Brendshme janë sekrete, që mund të shtrohen vetëm në sektor, apo ku ta di unë, dhe, si rrjedhim, nuk mund t'i shtrojmë në organizatën-bazë, në byro ose në komitetin e Partisë», nuk është as parimore dhe as praktikë e drejtë, në qoftë se ecet kështu, pse bën që udhëheqja e Partisë e të gjitha rangjeve në degët e Punëve të Brendshme të jetë formale, në organizatat-bazë të tyre do të bëhen muhabetë të përgjithshme dhe Partia nuk do të ketë kështu në dorë drejtimin konkret të punës e të detyrave.

Komiteti i Partisë dhe byroja e tij duhet të jenë domosdo në krye të drejtimit dhe jo të qëndrojnë në bisht. Nuk mund të imagjinohet që një komunist funksionar i Ministrisë së Punëve të Brendshme të jetë në dijeni të një qështjeje sekrete, kurse komiteti i Partisë i saj ta injorojë këtë sekret. Në komitet janë njerëzit më të zgjedhur të ministrisë, në të bëjnë pjesë anëtarë nga gjithë sektorët dhe, kur merren problemet në shqyrtim, analizohen ato kryesore dhe jo detajet më të vogla, merren vendime dhe jepen orientime kryesore politike, ideologjike, organizative, preventive, jepen porosi për shfrytëzimin në praktikë të të dhënave të shkencës së kriminalistikës e të tjera, e të tjera, të cilat duhet të zbatohen nga të gjithë komunistët dhe punonjësit, nga të gjitha organet shtetërore të Punëve të Brendshme, në bazë të platformës. Asgjë nuk ka këtu kundër platformës. Po të veprohet ndryshe nga sa përmenda, atëherë veprohet kundër platformës.

Varet shumë se si dhe çfarë problemesh caktohen

të merren në diskutim në komitetet, në organizatat-bazë e në byrotë dhe si trajtohen ato, por problemeve që caktohen dhe janë të nevojshme të merren në studim duhet t'u shkohet thellë, të dilet me konkluzione e detyra, të dihet dhe të përcaktohet afërsisht se kjo ose ajo gjë nuk mund të bëhet, jo për arsye sekreti, por për arsye pune dhe kompetence, pse duhet pasur e qartë se cilat probleme duhen shtruar në komitet, cilat në organizatën-bazë dhe cilat në seksione. Për komitetin, për byronë dhe për organizatën-bazë të Partisë, në platformën e tyre, nuk mund të ketë sekret, sekreti duhet të ruhet për jashtë. Në rast se nuk bëhet si duhet një gjë e tillë, atëherë seksioni ose një kuadër i veçantë mund të punojë sipas kokës së tij, pas krahëve dhe të fshihet pas fjalës «sekrete», të humbasë fuqinë zbuluese, të mos zhvillojë metodën e drejtë të rënies në kontakt me armikun dhe të goditjes me forcë të tij.

E kemi theksuar vazhdimisht se të gjitha veprimet e punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk duhet të shikohen vetëm nga ana profesionale dhe teknike. Kjo është një anë kryesore për ta, por veprimet e tyre duhet të shikohen njëkohësisht në prizmin politik dhe ideologjik për çdo problem. Prandaj, shokët e Sigurimit të Shtetit do të quhen të zotë dhe do të veprojnë në rrugë partie, në rast se zbatojnë me përpikëri normat e Partisë. Platforma ka parasysh që komunisti t'i njohë mirë normat e Partisë dhe të jetë i kalitur me to. Këto norma, si për të gjithë komunistët, por ca më shumë janë të detyrueshme për komunistët që janë punonjës të Sigurimit, të cilët duhet të jenë shumë rigorozë në përvetësimin dhe në zbatimin e drejtë të tyre.

Nuk jam aq dakord me mënyrën si e kanë menduar shokët e grupit të Instruktorëve të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë çështjen e dhënies llogari përpara efektivit lidhur me punën e Partisë në organet e Punëve të Brendshme. Unë e përcaktova më lart si duhet vepruar. Nuk jam dakord, gjithashtu, për zbatimin në mënyrë automatike dhe shablone, si në sektorin civil; të kontrollit punëtor-fshatar me ushtarë e policë ose të dhënies llogari përpara masës së popullit nga ana e kryetarit të degës së Punëve të Brendshme apo të shefit të policisë të rrethit. Në punën e këtyre organeve mund të themi se ka një specifikë, të cilën duhet ta kuptojmë. Kontrollit të masës nuk duhet t'i shpëtojnë as këta, por për ato çështje për të cilat ka marrë fund veprimi, sepse, pa marrë fund veprimi nga ana e organeve të Sigurimit të Shtetit ose të Policisë, masat nuk mund dhe nuk duhet të vihen në korent, pse është pikërisht siç mendojnë disa shokë të Sigurimit, që këtu përmenden për të keq, por që nuk e kanë gabim kur thonë: «Si mund të japim llogari, çështjen e merr vesh armiku». Në radhë të parë çështja nuk i duhet fshehur Partisë që udhëheq organet e Punëve të Brendshme. Kontrolli punëtor-fshatar me ushtarë e policë duhet krijuar rigorozisht, bile shumë rigorozisht me njerëz tepër të besueshëm dhe të sprovuar, të cilët të venë të bëjnë kontroll për ndonjë problem që ngjall dyshim, por për të cilin ka marrë fund veprimi, dhe kjo të bëhet nën kontrollin e rreptë të komitetit të Partisë, por në asnjë rast në veprim e sipër.

Dhënia llogari përpara masës pse të mos bëhet? Edhe kuadrot e organeve të Punëve të Brendshme du-

het të japin llogari për veprimet e tyre, por, natyrisht, siç e theksova më lart, për ato çështje për të cilat ka mbaruar veprimi. Kjo është një punë edukative edhe për ata vetë, edhe për popullin. Punonjësit e Sigurimit të Shtetit dhe të Policisë mund t'u shpjegojnë masave që «ne arrestuam filanin, ia dhamë atë gjyqit, që e dënoi për agjitacion e propagandë; ose filanin e proceduam për arsye se ka vjedhur, ka dhunuar apo se ka kryer krime kundër moralit socialist» etj. Këto ata mund t'ua thonë masave. Atyre mund t'u thuhet, gjithashtu, se «unë punonjësi i organeve të Punëve të Brendshme nuk jam treguar vigjilent, prandaj Partia ka marrë masë të kësaj natyre për mua»; pra këta punonjës të japin llogari, veç në një formë tjetër, por Sigurimi i Shtetit dhe Policia është e ndaluar të japin llogari përpara masës për çështje për të cilat janë duke vepruar.

Në relacionin që na është paraqitur, theksohet, gjithashtu, që si mund t'i thuhet organizatës-bazë ato që mund të thuhet vetëm në seksionet. Këtë e shpjegova më lart, por shokët që ngrenë problemin kanë një arsye që i bën ta shtrojnë një gjë të tillë dhe kjo vjen, mendoj unë, se në organizatat e Partisë të Sigurimit të Shtetit, të themi, përveç punonjësve të seksioneve të ndryshme që kanë në duar sekrete të rëndësishme, ka edhe shokë me detyra të një natyre tjetër, si pastruese, shoferë, kaldaistë e të tjerë¹. Tash vihet çështja: Këta komunistë me profesione të tilla, kanë të njëjtat të drejta dhe detyra me ata që janë në funksione të caktuara

1. Punonjësit e këtyre kategorive më vonë filluan ta bëjnë jetën e Partisë në organizatat-bazë të sektorëve të prapavijës.

në këto organe? Dihet se jo të tërë komunistët janë të ngritur në të njëjtin nivel. Ka pastaj edhe nga ata komunistë, qoftë të kategorive që përmenda, qoftë edhe të kategorive të tjera, që punojnë me çështje sekrete të rëndësishme, por që nuk dinë të mbajnë konspiracion, atëherë kjo bëhet një çështje e rrezikshme.

Prandaj problemi vihet se çfarë shtrohet në organizatën-bazë dhe si shtrohet, se organizata-bazë e Partisë nuk diskuton në detaje veprimet që duhet të bëjnë shokët e organizatës-bazë të ndarë nëpër seksione, ajo kontrollon dhe drejton zbatimin e vijës së përgjithshme, prandaj nuk duhet abuzuar qoftë nga një raportim i gjithë detajeve ose nga një mosraportim i çështjes së përgjithshme orientuese.

Lidhur me të drejtat e anëtarëve të organizatës-bazë, të cilët janë të njëjlojtë dhe të barabartë, komitetit të Partisë, byrosë, sekretariatit¹ dhe dikasterit u bie barra të kujdesen që shokët me funksionet që përmenda më lart t'i zgjedhin nga njerëzit më me partishmëri dhe jo sidokudo, biografite e tyre të jenë të kulluara, sjelljet në shoqëri dhe në punë t'i kenë, gjithashtu, të kulluara. Kontaktet e tyre me njerëzit të jenë në rrugë partie, ndryshe nuk mund të zbatohen si duhet direktivat e Partisë në lidhje me ruajtjen e sekretit, çështje kjo me shumë rëndësi për punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Mendoj të shikohet edhe një mundësi tjetër. Në

1. Në atë kohë funksiononte edhe sekretariati i komitetit të Partisë të rrethit. Me vendim të Byrosë Politike të KQ të PPSH të datës 21 shkurt 1982 ky sekretariat u suprimua.

qoftë se shihet me vend, të krijohet një organizatë-bazë partie e veçantë me shokë të tillë që punojnë në organet e Punëve të Brendshme ose në ministri, por që, për shkak të detyrës, nuk lidhen drejtpërdrejt me problemet që përbëjnë sekret shtetëror. Kjo organizatë ka për detyrë të marrë në shqyrtim, si çdo organizatë-bazë tjetër partie, probleme që i përkasin asaj dhe këto probleme të rrihen nga të tërë komunistët që bëjnë pjesë në të dhe të mobilizohen që vendimet t'i zbatojnë si duhet.

Për udhëheqjet e Partisë të rretheve nuk dua të zgjatem, se për këtë çështje kam folur dhe Plenumi i Komitetit Qendror i ka përcaktuar mënyrat se si duhet të bashkëpunojnë, të ndihmojnë dhe të kontrollojnë veprimtarinë e degëve të Punëve të Brendshme, të komitetit, të byrosë ose të organizatave-bazë që kanë në juridiksionin e tyre. I duhet futur kësaj çështjeje për të dalë nga sektarizmi, pasi vetëm sekretari i parë mban kontakte me kryetarin e degës së Punëve të Brendshme të rrethit. Po t'u futesh problemeve, do të gjesh mënyrën më të mirë se si duhet të mbahen lidhjet dhe si duhet të jepet ndihma e të ushtrohet sa më mirë kontrolli i Partisë. Këtej do të dalë edhe specifika se deri ku dhe përse byroja e komitetit të Partisë të rrethit duhet të angazhohet në kompetencat e komitetit, të byrosë dhe të organizatave-bazë të degëve të Punëve të Brendshme ose të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe as më shumë sesa duhet e as më pak sesa duhet. Kjo të përcaktohet në punë e sipër, se me fjalë mund të thuhet një recetë jo shumë e drejtë dhe jo operuese, por më parë të futen duart në brumë,

mbruje miellin, se pastaj do të bëhet buka. Prandaj edhe në këtë drejtim duhet të punohet nga ana e komiteteve të Partisë të rretheve dhe e atyre të Ministrisë së Punëve të Brendshme që të gjendet rruga më e drejtë e bashkëpunimit.

Mendoj se në përgjithësi organet e Sigurimit të Shtetit dhe të Policisë, qofshin këto në qendër apo në rrethe, kanë fituar eksperiencë, po duhet akoma të luftojnë dhe vazhdimisht të luftojnë që të përmirësojnë punën e tyre, sepse armiku përfiton nga çdo ndodhi e dobësi për të propaganduar kundër rendit tonë socialist, për të infiltruar dhe për të na goditur. E theksoj edhe një herë se mbështetja e organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet të jetë populli. Teknicienët më të mirë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në radhë të parë, duhet të jenë të ngritur politikisht e ideologjikisht dhe të mos mendojnë kurrë se po të bëjnë veprime të vetmuara, do të kenë suksese, pa pasur mbështetjen dhe ndihmën e gjithanshme të masave të gjera të popullit e, në radhë të parë, të Partisë.

Dotuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Gjithmonë vigjilencë» (Për organet e Punëve të Brendshme), vëll. I 2-të, f. 425.

Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Gjithmonë vigjilencë» (Për organet e Punëve të Brendshme), vëll. I 2-të, f. 425.

NGRITJA E MUZEUT TË SKËNDERBEUT ËSHTË NËRDMARRJE DELIKATE DHE KOMPLEKSE

*Nga biseda¹ në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

23 dhjetor 1975

Sekretari i Partisë duhet të njohë, krahas jetës së brendshme, edhe probleme të veçanta. Ai do të shkojë, për shembull, në Institutin e Studimeve dhe të Projektimeve. Atje jo vetëm të rrijë e të dëgjojë dhe në fund të thotë: «Këto punë i dini më mirë vetë». Sigurisht që sekretari nuk do të futet në teknikën e projektimit, por duhet të njohë vijën e Partisë për arkitekturën. Ai të flasë për arkitekturën tonë kombëtare, se, me sa kam marrë vesh, për këtë në shkolla bëhen vetëm dy-tre leksione dhe ato «rraftë kulla» këtu, «rraftë kulla» atje. As vetë njerëzit që merren me këtë punë nuk e kanë të qartë kombëtarën në arkitekturë.

Pyeta se si do të bëhet Muzeu i Skënderbeut në

1. Shënimet e kësaj bisede u bënë bazë orientuese dhe frymëzuese për grupin e arkitektëve, që u caktua më vonë dhe u mor gjatë viteve 1976-1982 me projektimin dhe realizimin e Muzeut të Skënderbeut siç është sot në Krujë.

Krujë. Më thanë se për këtë çështje ka disa mendime: 1. Ndërtesa ekzistuese (që në fakt është si barakë) të rregullohet; 2. Të bëhet një tjetër më tutje; 3. Të merret një shtëpi që është atje dhe të modifikohet; 4. Ka dhe mendime që të bëhet nën tokë. U thashë që kjo «nën tokë» qenka varianti «më i mirë», mbasi Skënderbeu ka luftuar «nën tokë»! Çudi, për çfarë nuk u shkon mendja disa njerëzve, por si të bëjnë një muze me karakteristika kombëtare nuk e vrasin shumë mendjen.

Pyeta nëse arkitektët që do të merren me këtë punë kanë haber nga historia e Skënderbeut, dhe mora përgjigje se ndonjë studim të veçantë, përveç sa kanë mësuar në shkollë për Skënderbeun e kanë lexuar në ndonjë libër, nuk kanë bërë. Nuk janë konsultuar as me historianë që merren me historinë e Skënderbeut.

Ata mendojnë ta bëjnë muzeun si një shtëpi dhe ana racionale kombëtare konsiderohet guri i Zgërdheshit, me të cilin mendojnë ta veshin në brez e poshtë. Jo, thashë, nuk është guri që i jep muzeut karakterin nacional, se shtëpi me gurë kanë edhe vende të tjera.

Kalaja është momenti kryesor dhe asnjë ndërtesë nuk duhet të dominojë mbi të. Atje të bëjmë diçka që t'i ngjitet kalasë jo si çiban, por që të ruajmë karakteristikat e kohës dhe që të duket, e s'ka se si të mos duket, se e kemi bërë ne, por që është art i shekullit të 15-të. Këto karakteristika duhet t'i gjejmë në shkrimet e ndryshme dhe jo vetëm në shkrimet e Barletit e të Nolit. Për ta shprehur mirë kombëtarin në këtë muze më parë duhet bërë një punë kolosale përgatitore e studiuese, që të hyhet mirë në jetën dhe në ambientin e kohës. Duhet parë e studiuar kalatë e she-

kullit të 15-të të Italisë, të Greqisë, të Jugosllavisë dhe jo duke shkuar atje, kur për t'u njohur me to ka plot libra, gravura e albume. Në to mund të shihet si kanë qenë kalatë e kohës. Duke parë dhe te ne kalatë e reja dhe të vjetra, banesat që kanë qenë brenda tyre etj., do të krijojmë një ide se si duhet të jetë pamja e Muzeut të Skënderbeut. Këtu në Krujë kalaja ka qenë për mbrojtje, por dimë se ka pasur edhe kala për banim.

Të shikohen kalatë e ndryshme të Francës; kalatë e Vobanit atje kanë qenë të famshme. Nga këta tipa mori edhe Gjermania. Është e pamundur që në ndërtimet e shekullit të 15-të, si në çdo ndërtim të çdo kohe, të mos ketë influenca të huaja. Po t'i shohim me kujdes, do të gjejmë në kombëtaren diçka që nuk është kombëtare. Shtëpi me qoshe kemi ne, por shtëpi me qoshe ka shumë edhe Turqia. Hajde tani ta gjejmë, ne e morëm nga Turqia apo Turqia e mori nga ne. Osmanët ndenjën 500 vjet këtu.

Më treguan se për këto probleme dikur kanë biseduar edhe me Aleks Budën, edhe ai i ka porositur që për Skënderbeun të bëhet diçka që të ketë karakteristikat e shekullit të 15-të.

Nuk mund të ndërtohet Muzeu i Skënderbeut me penxhere të mëdha për të zgjidhur problemin e dritës, por nuk duhen bërë penxheret as si frëngji kullash. Në radhë të parë, që në pamjen e jashtme, muzeu duhet të ketë karakteristikat e një ndërtese shqiptare të shekullit të 15-të. Nga brenda është tjetër punë se si mund të zgjidhet çështja e ndriçimit.

Më duket që në disa drejtime kemi ecur më për-

para për sa i përket kombëtares, për shembull, në kulturë, si në këngë, në valle, edhe në kostume kemi bërë shumë përpara, kurse në arkitekturë jemi prapa dhe në këtë drejtim nuk bëhen përpjekje sa duhet. Nuk e vrasin mendjen shumë njerëzit si ta kombinojnë kombëtares me të tashmen. Mirë kulla, po ç'do të marrim nga kulla? Siç është do ta marrim? Sigurisht që jo. Po kështu për kulmet e shtëpive, penxheret, divanet etj.

Shtëpia e Zekatëve në Gjirokastër nuk është shumë e vjetër, por ashtu siç është tregon se si jetonin të pasurit dhe si mbroheshin nga frëngjitë e katit të parë. Ajo ka karakterin e një kështjelle të përpunuar në një kohë më të vonë; kur e sheh nga jashtë, të bën përshtypje me bukurinë e saj. Unë nuk them që muzeu të bëhet si shtëpia e Zekatëve, por e kam fjalën që, duke vrojtuar, duke studiuar shumë shtëpi të tilla, dhe të tilla ka në vendin tonë, mund të përpunohen linja dhe pamje që edhe të kohës të jenë, edhe karakteristika kombëtare të kenë.

„Mirë, mirë, — kanë thënë shokët arkitektë, — edhe kështu mund të bëhet, por ç't'i bëjmë kohës; neve na kanë dhënë afat ta mbarojmë para një date historike“. Më duket se është shumë e shtrembër që të nxitohemi për të bërë jo si duhet një muze, që i vlen historisë, vetëm e vetëm për ta inauguruar në një datë historike. Data historike vijnë gjithnjë, por muzeu bëhet një herë e për shumë data që do të vijnë.

Shokët që japin urdhra dhe caktojnë afate të pa-studiuara për gjëra të tilla të rëndësishme, mendojnë gabim, sikur kjo është ndërmarrje e vogël që mund ta realizojnë një apo dy arkitektë. Jo, ngritja e Muzeut

të Skënderbeut është ndërmarrje delikate dhe komplekse. Për të bërë një punë serioze duhen krijuar komisione me njerëz kompetentë, historianë, arkitektë e të tjerë. Paralelisht me këta duhet të punojnë piktorët e skulptorët, prej të cilëve kërkohet punë këmbëngulëse. Atyre t'u jepen temat në bazë të materialeve që do të vendosen në këtë apo atë stendë, t'u thuhet se cilat episode të luftës do të pikturojnë dhe çfarë skulpturash do të realizojnë. Jo vetëm kaq, por u duhet dhënë edhe madhësia sa do t'i bëjnë, gjë që varet nga vendi që do t'i caktohet ngjarjes në muze dhe jo nga dëshira e piktorit apo e skulptorit.

Piktori, për shembull, nuk do të bëjë me këtë rast një pikturë sipas kokës së tij për të dalë në konkurs, por një pikturë që t'i shërbejë ngjarjes, periudhës historike për të cilën bëhet fjalë. Për shembull, i jepet të pikturojë luftën e Albulenës, të Vaikalit etj. Ky piktor, si dhe arkitekti, duhet të studiojë mirë e nga shumë burime ngjarjen që do të pikturojë, çdo detaj i pikturës të jetë pjesë e muzeut. Për këtë arsye duhen njohur mjetet e luftës, llojet e armëve, të shpatave, të topuzeve, veshjet e luftëtarëve, deri pajisjet origjinale të kuajve, natyra etj., etj.

Duhet punuar paralelisht edhe për një sërë problemesh të tjera. Muzeu do mobilitet; të mos pandehin shokët që do të merren me këtë punë se do të bëjnë mobilie si të Pallatit të Brigadave. Duhet studiuar mobilie ku të spikatë stili i shekullit të 15-të. Është tjetër lloj druri, ndryshon cilësia e punimeve, por edhe këtu ka punë, se duhet të studiohet deri historia e mjeteve konkrete të artizanatit të shekullit të 15-të.

Pastaj gjërat në muze duhen bërë me aq përgjegjësi, saqë edhe bojaxhiu nuk mund të punojë me kokën e tij. Edhe ai është i varur nga kompleksi i problemeve që thamë. Duhet caktuar çfarë ngjyre do t'u jepet mureve apo vendeve që nuk i zënë tablotë ose stendat. Për këtë bojaxhiu duhet të lidhet dhe të koordinojë punën me piktorin e arkitektin, ta pyesë piktorin se çfarë ngjyrash do të ketë tabloja e tij në këtë faqe muri dhe në kombinim me këtë të vendosë llojin e bojës me të cilën do të lyejë murin.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i takimit ditor të se-
kretarëve të Komitetit Qend-
ror të PPSH. që gjendet në
AQP*

PLANI ËSHTË REAL, TË MOBILIZOHEMI TË GJITHË PËR REALIZIMIN E TIJ

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

25 dhjetor 1975

Në këtë mbledhje kemi për të shqyrtuar dy probleme. Në fillim, po të jeni edhe ju dakord, mendoj të shikojmë çështjen e planit dhe të dytën studimin për pagat. Cilën dëshironi të marrim të parën?

(Shokët përgjigjen se janë dakord që të shqyrtohet në fillim plani.)

Po nuk realizuam mirë planin, nuk do të kemi as pagat, prandaj fillojmë me këtë çështje. Pastaj mund të shikojmë edhe ndonjë problem tjetër shqetësues dhe që duhet të diskutohet në Byronë Politike.

Unë kisha disa pyetje, më shumë për shokët ministra sesa për drejtuesit e Komisionit të Planit të Shtetit.

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të Këshillit të Ministrave «Mbi plotësimin e planit e të buxhetit të shtetit për vitin 1975 dhe detyrat e planit e të buxhetit të shtetit për vitin 1976».

Problemi i tejkalimit të preventivave gjithmonë na ka shqetësuar jashtëzakonisht. Qeveria ka caktuar disa limite, mirëpo këto vazhdimisht kapërcehen. Atëherë, kërkoj të na shpjegohet pse kapërcehen këto limite, ku është faji dhe çfarë masash kanë marrë Ministria e Ndërtimit dhe shokët që janë ngarkuar me këtë problem.

Kam një pyetje për Pirro Dodbibën¹: Kohët e fundit u bënë gjithë këto analiza e u korrigjuan shumë gabime. Por, a keni menduar se në këtë organizim të bujqësisë, ku ministria është shkëputur nga të gjitha ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore të tipit të lartë, ka gabime? Keni bërë analiza për këto çështje apo jo? A kemi pasur konsekuenca nga ky organizim që është bërë?

Për shokët e Komisionit të Planit të Shtetit kisha diçka në lidhje me importin, disa çështje që më duken si qesharake. Them kështu se kërkohet, për shembull, të importohet një makinë prerëse, disa motopompa e të tjera gjëra të vogla të kësaj natyre. Këto janë si ato kërkesat e atij personi që vete nëpër dyqane e thotë: «Më jep një stilograf e tre defterë!». Mendoj se nuk duhet të merremi me kërkesa të tilla të rëndomta, qoftë edhe për 400 apo 500 elektromotorë të ndryshëm, se, po të bëjmë një kontroll se sa elektromotorë kemi në vendin tonë dhe si shfrytëzohen, mund të dalë se ata që na nevojiten janë, por nuk përdoren.

Pastaj vazhduan pyetjet, u dhanë përgjigjet e u bë ndonjë ndërhyrje dhe vazhduan diskutimet:

1. Në atë kohë ministër i Bujqësisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Përgjigjja e Pirros për mënyrën e ndjekjes së problemeve nga Ministria e Bujqësisë mua nuk më pëlqen dhe nuk është e pranueshme. Ti nuk e analizon thellë ideologjikisht dhe praktikisht këtë problem kaq të madh, prandaj po na nxjerr një mijë e një arsye, duke thënë: «Kemi vendosur kështu e kemi vendosur ashtu».

PIRRO DODBIBA: Nuk e kam studiuar këtë problem në tërësi, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Në qoftë se nuk e ke studiuar, ke bërë gabim. Përse të kanë vënë Partia dhe Qeveria atje? Për këto punë të kanë vënë. Kuptoje një çikë se nuk mund të ecim kështu! Si mund të thotë një ministër «Unë nuk e kam menduar këtë gjë»? Po ç'ke menduar pastaj?! Ne po luftojmë këtu dita me ditë edhe për një kokërr gruri. Mund të na thuash ti pse kanë rënë prodhimet në ndërmarrjet bujqësore? Pse ato nuk janë në lartësinë e kooperativave të tipit të lartë, bile edhe më mirë akoma? Na i thuaj arsyet që t'i dimë dhe ne!

PIRRO DODBIBA: Në ndërmarrjet bujqësore kemi shumë dobësi organizative.

SHOKU ENVER HOXHA: Pse ndodh kjo? Ti na thua këtu se merresh me organizimin, domethënë i ke braktisur të gjitha të tjerat dhe ke vënë në ministri si kryesore çështjet organizative. Atëherë, përse ky organizim ecën dobët? Fjalët që thua, mendoji mirë, se ne kërkojmë shpjegime për to. Pse të ketë dobësi organizative?

PIRRO DODBIBA: Nuk ka tre muaj që e ngritëm drejtorinë e bujqësisë, se nuk e kishim.

SHOKU ENVER HOXHA: Atëherë, ju gjithë këtë kohë nuk paskeni bërë gjë, se vareni nga puna që do të bëjnë ata dy-tre persona të asaj drejtorie. Kjo nuk është e drejtë. Ju nuk interesoheni sa duhet për bujqësinë, se, po të ishit interesuar, puna do të ecte ndryshe.

Doja të diskutoja edhe unë për planin e vitit të ardhshëm, po të mos konsiderohet kjo, siç e kemi zakon, si një fjalë e mbylljes nga ana ime, mbasi këtu kam edhe propozime të diskutueshme, për të cilat mund të shkëmbejmë mendime, prandaj, në qoftë se më lejoni, të diskutoj unë, pastaj le të vazhdojnë diskutimet përsëri.

Në lidhje me planin e vitit 1976, që është viti i parë i pesëvjeçarit të ardhshëm, mendoj ta përqendrojmë vëmendjen në këto gjëra kryesore.

1. Në nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve:

a) Nafta. Sabotimi që na bënë Koço Theodhosi dhe grupi armiqësor i naftës është shumë i ndjeshëm. Ata na lanë pa fusha të reja, na dëmtuan në fushat ekzistuese, deri në njëfarë shkalle mbollën frymën disfatiste dhe druajtjen në një pjesë të kuadrove që punojnë në këtë sektor. Të gjitha këto vështirësi duhet t'i kapërcejmë, duke ngjallur besim në kuadrot, duke i inkurajuar ata dhe duke forcuar punën shkencore dhe organizative në kërkimin dhe në shfrytëzimin e naftës.

Plani i naftës që na propozohet definitivisht për vitin 1976, në gjendjen që është krijuar mund të pranohet. Natyrisht, duhet të organizohet mirë puna e nxjerrjes, e përpunimit dhe e përdorimit me shumë ni-

koqirllëk të këtij produkti, siç e tha dhe shoku Qirjako Mihali. Asnjë njeri të mos ecë me iluzionin se do të importojmë karburante më tepër nga sa kemi caktuar në këtë plan. As Qeverinë nuk duhet ta vëmë në vështirësi dhe as asaj nuk i lejohet të lëshojë nga sasilë e caktuara. Është e domosdoshme të forcohen tek të gjithë ndjenja e disiplinës, ndjenja e kursimit dhe përpjekjet për realizimin e planit.

Por pesëvjeçari nuk mbaron më 1976, pse janë edhe katër vjet të tjerë. Në rast se ne nuk do të zbulojmë dhe nuk do të përpunojmë fusha të reja nafte në këtë pesëvjeçar, jo vetëm që do të qëndrojmë në vend, por do të kemi deficite të mëdha. Katër-pesë vjet sabotatorët nuk na dhanë fusha nafte, prandaj, në rast se do të vazhdojmë edhe pesë vjet të tjerë pa zbuluar fusha të reja, për ekonominë tonë do të krijohet një gjendje shumë e vështirë, ne do të kemi një deficit të madh nafte për nevojat e brendshme dhe nuk do të jemi në gjendje që të importojmë, për mungesë devize dhe për arsye të krizës së madhe botërore të karburanteve.

Prandaj Ministrisë së Industrisë dhe të Minerave jo vetëm i vihet detyrë ta organizojë mirë punën për realizimin e tonëve që parashikohen për vitin 1976, por ky vit duhet të jetë periudha e një pune intensive të organizuar shumë mirë nga çdo pikëpamje për të zbuluar fusha të reja nafte. Unë mendoj se është imperative për ekonominë tonë që çdo vit të paktën të bazojmë planifikimin e naftës në fushat ekzistuese, por edhe në fushën ose në fushat e reja që duhet mëdoemos të zbulojmë që në vitin 1976 dhe pastaj më vonë çdo vit me radhë.

Në planifikimin e naftës mendoj se duhet të ecim kurdoherë në rritje, por kurrë sipas dëshirës, pra vetëm të bazuar në fushat ekzistuese naftëmbajtëse, si dhe në fusha të reja që duhet të zbulojmë. Fushat e reja ne duhet t'i zbulojmë dhe plani pesëvjeçar i naftës duhet të jetë një plan i nevojave, por edhe me shtesa rezervash industriale. Këto do t'i realizojmë me kërkime serioze fushash të reja. Prandaj këtë detyrë unë e konsideroj si më delikaten, më seriozen dhe më të zorshmen.

Mirëpo, në një raport të 2 dhjetorit 1975 konstatoj se për shpim-kërkimet e vitit 1976 jepet një shifër që mua më duket shumë e vogël. Këtë e them se, duke ndjekur më poshtë raportin, thuhet që do të bëhen shpime në gëlqerorët, në flishe, shpime strukturorë e ku ta di unë. Këta metra linearë nuk përfaqësojnë veçse 18 puse. Kur numërohen vendet ku mendohet të shpohen këto puse, natyrisht, shifrat nuk dalin në ujdi në të 18 ose të 20 puset që janë cakluar, pse, pa marrë parasysh se edhe në fushat e njohura do të hapen puse kërkimi, vendet janë më shumë dhe ne do të kënaqeshim që mesatarisht me gjashtë të shpuara të arrijmë naftën, se kemi arritur të shpojme deri në 13 puse, kurse këtu caktojmë vetëm një, pra 18 puse për të gjitha kërkimet.

Për mua një situatë e tillë nuk është e qartë dhe nuk ndihmon në zgjerimin e perspektivave të fushave të reja për të ardhmen. Sikurse e kam theksuar edhe më lart, mendoj se viti 1976 duhet të jetë një periudhë kohe që të ndihmojë për vitet e mëtejshme të pesëvjeçarit. Kjo nuk do të thotë se kërkimet në këtë pesë-

vjeçar janë çdo gjë, se këto u përkasin edhe pesëvjeçarëve të ardhshëm. Për vitet e tjera ne do të caktojmë të tjera metrazhe, por, me sa di unë dhe me aq sa më kanë informuar, mjetet teknike ekzistojnë, domethënë ne kemi një sasi sondash që presin, prandaj duhen mobilizuar dhe duhen organizuar më mirë për këtë qëllim gjithë gjeologët.

Unë jam dakord, siç thuhet në këtë raport, që nga plani i parashikuar tetë mijë metra linear t'u kushtohen rajoneve të njohura të Patosit, të Qytetit Stalin etj. Mendoj se këto duhet të hyjnë në shpim-shfrytëzim, pse në shumicën e tyre janë fusha, në mos plotësisht, treçerek të njohura.

Dua të them, gjithashtu, se, kur specifikohen rishikimet e shpim-kërkimeve, në gëlqerorët 12 puse ose në shtresa të tjera 15 puse, të them të drejtën këto shifra nuk i kam shumë të qarta, për arsye se deri tani di se ne po gjejmë naftë jo vetëm në thellësi të vogla, por, në përgjithësi, kemi shkuar poshtë edhe në thellësi të mëdha. Prandaj si janë bërë këto llogari dhe si janë caktuar këto proporcione? Për këtë duhet të na jepni sqarime. Vetëm dëshiroj të theksoj se duhet të bëjmë përpjekje të mëdha për naftën, si për shpim-kërkimet, ashtu edhe për shpim-shfrytëzimet, të mobilizojmë totalisht të gjitha forcat që kemi në dispozicion, t'i futim mirë në lëvizje specialistët dhe teknikët tanë, t'u heqim druajljen, t'i ndihmojmë dhe t'i kontrollojmë si duhet e të mos pranojmë situata të tilla, që nuk janë tjetër veçse mbeturina të kohës së kaluar, të ecjes me një ritëm të ngadalshëm dhe armiqësor, siç u vërtetua. Pa naftë ne do të gjendeshim në vështirësi të më-

dha. Prandaj shokët përgjegjës problemeve të naftës duhet t'u kushtojnë shumë vëmendje, ndihmë dhe kontroll më të mirë.

Po kaq rëndësi të madhe duhet t'i vëmë ne edhe zbulimit të fushave të reja të gazit. Edhe në këtë çështje armiqtë na kanë sabotuar hapur, na kanë dëmtuar rëndë ekonominë. Unë jam dakord me ekonomizimin që parashikohet t'i bëjmë përdorimit të gazit, por një ekonomizim i tillë drakonian i tij do të na dëmtojë rëndë zhvillimin e ekonomisë. Megjithatë për vitin 1976 s'kemi ç'bëjmë, do të pranojmë vendimin që ka marrë Qeveria, por në vitet e tjera të bëjmë përpjekje për të gjetur fusha të reja gazi që ka, ashtu siç ka edhe fusha të reja naftë, që duhet t'i zbulojmë.

Duhet pasur kujdes rutina (sabotuese) në shpime, për të realizuar planin e shpimeve. Në këtë çështje duhet ecur si në ushtri, «predha e parë në shenjë», çdo rrugë tjetër është e dëmshme.

b) Kromi është një mineral me shumë rëndësi për ekonominë tonë. Unë jam dakord me shifrën e parashikuar nga Qeveria për nxjerrjen e kromit për vitin 1976, dhe për këtë të mos bëhen naze e diskutime, por të tendosen si duhet muskujt dhe mendjet për realizimin e kësaj shifre. Punimet në minierat për nxjerrjen e kromit të vihen sa më parë në rrugë të drejtë. Perspektivat e krijuara të mos mbeten parulla, por të punohet që vitet e ardhshme të pesëvjeçarit të na gjejnë të përgatitur për të hartuar plane më të mëdha për kromin. Punimet, tunelet e fabrikat duhet të mbarohen sa më parë dhe këto do të bëhen në rast se fillojmë çdo punë nga kryesorja e jo nga bishtrat.

Ne do të luftojmë për të nxjerrë krom të pastër, por duhet të bëhen përpjekje që çfarëdo kromi t'i gjeendet treg. Për këtë Ministria e Tregtisë duhet të braktisë rutinën sabotuese të Kiço Ngjelës dhe të shokëve të tij.

c) Qymyret kanë qenë nënvleftësuar, si nga Abdyl Këllezi, ashtu edhe nga shoku i tij Koço Theodhosi. Ata përçmonin vlerën e madhe të qymyreve, gjoja me kalori të ulët, se mund të zëvendësoheshin me naftë që është më ekonomike. Duhet t'i kemi sytë seriozisht nga qymyret, të marrim masa për pasurimin e tyre, të zgjerojmë kërkimet dhe të përmirësojmë minierat. Qymyret t'i përdorim pa hezitim kudo ku mund të përdoren, pa tjerë masat që duhet të merren për të bërë transformime teknologjike. Të vlerësohen drejt sasi, të vlerësohet Valiasi dhe të merren aty masa rrënjësore për eliminimin e ujërave.

Unë jam dakord me planin e hartuar për vitin 1976 për qymyret, por plani për këtë mineral në vitet e ardhshme duhet të shkojë duke u rritur, si në nxjerrje, në ndërtim minierash të reja, ashtu edhe në përdorim. Duhet të vërtetohen sa më parë shenjat e marra të linjilit, për të cilat më ka vënë në korent shoku Pali [Miska].

d) Natyrisht, edhe për bakrin ekzistojnë po këto probleme, ndoshta jo aq të mprehta sa edhe të mine-raleve të tjera. Megjithatë bakri, ky mineral kaq i çmu-eshëm e deficitar, siguron të ardhura të mëdha në devizë për ekonominë tonë. Asgjë të mos lihet pas dorë në këtë drejtim, as modernizimi i minierave, as zgjerimi i tyre, as shkrirja dhe as pasurimi i mineralit të bakrit.

Dëshiroj të tërheq vëmendjen për problemin e metaleve të tjera të çmuara që shoqërojnë bakrin. Këto mund të jenë tok me bakrin dhe ne i ndajmë prej tij. Por, në qoftë se s'gabohem, këto metale të çmuara mund të gjenden edhe pa bakrin. Gjeologët i dinë më mirë këto çështje, por le të më falin që ua kujtoj, sepse nganjëherë mund të ndodhë që të kërkojnë vetëm bakrin dhe të harrojnë metalet e tjera të çmuara që e shoqërojnë atë. Për këto metale të bëhen kërkime të kujdesshme dhe të inkurajohen ato. Kështu duhet të veprohet edhe për metalet e tjera të çmuara, të cilave u janë diktuar shenjat. Por në këto drejtime, sipas mendimit tim, nuk ecet me tempin e duhur dhe shokët tanë merren pak, për të mos thënë aspak. Çdo punë shkel e shko, çdo nënvlerësim, çdo ngadalësim i sjell dëme ekonomisë.

Ky pesëvjeçar duhet të jetë pesëvjeçari jo vetëm i shtimit të nxjerrjes së mineraleve ekzistuese dhe të njohura, por edhe i zbulimit dhe i vënies në shfrytëzim të mineraleve të tjera të panjohura akoma. Është absolutisht e domosdoshme që ky problem të merret me seriozitetin më të madh.

Duhet të nxjerrim sa më shumë minerale të ndryshme, se përpunimi dhe eksportimi i tyre na sjellin të ardhura të qëndrueshme nga më të rëndësishmet për ekonominë e vendit tonë. Është e vërtetë se ne i studiojmë veç e veç kërkimin, nxjerrjen, përpunimin dhe eksportin e çdo minerali dhe s'ka si bëhet ndryshe. Por të mos harrojmë se ne si qendër e si udhëheqje këtë sektor të ekonomisë duhet ta shohim dhe ta llogaritim edhe si një të tërë. Këtë e them për arsye se

deri tash, qoftë dikasteri përkatës (pavarësisht nga sabotimi), ashtu edhe ndërmarrjet i shikojnë këto degë të industrisë minerare në mënyrë të veçuar, për çdo minierë e për çdo mineral dhe harrojnë që mosrealizimi në tërësi i planit të nxjerrjes së mineraleve e të përpunimit të tyre i shkakton ekonomisë disbalancime të rënda.

«Me lehtësi» u kaluan 4 vjet dhe më shumë pa u qederosur që nuk po na jepeshin fusha të reja naftë. Por ja ç'na ngjau dhe ç'konsekuenca të rënda na u krijuan! Po ashtu, «me lehtësi» është kaluar edhe në atë që punimet në minierat e kromit janë pak e të tjera situata dhe këto janë shikuar si të veçuara. Më shumë është menduar si e me se duhet t'i mbulojmë deficitet e krijuara, saqë Kiço Ngjela përpiqej të na ngopte me përralla se duhet të mbledhim bimë medicinale etj. Bimë medicinale ne duhet të mbledhim dhe do të mbledhim sa më shumë, bile ky është një zë dhe një detyrë plani që duhet plotësuar si gjithë të tjerat, por deficitet e naftës dhe të kromit nuk mund të mbulohen me të tilla ekspediente.

Kam insistuar e vazhdoj edhe sot të ngul këmbë që drejtuesit t'i mësojnë vartësit të punojnë me përgjegjësi dhe kuadrot kryesorë të mos merren me çikërrima, por me problemet e mëdha, dhe të tilla ka në çdo ministri. Ministrat vazhdojnë të merren edhe me gjërat më të vogla. Kjo është një punë pa bukë dhe mendoj se edhe nga një punë e tillë na ngjanë ato që na ngjanë e mund të na përsëriten edhe më vonë.

Për të qëndruar te çështja e minierave dhe e mineraleve: është vallë e rekomandueshme që drejtuesit

kryesorë të merren vetëm me problemin e një pusi nafte apo të merren me orientimet e tashme dhe të perspektivës të kërkimeve të naftës? Sigurisht, kjo e fundit është më kryesorja dhe paraqet shumë aspekte të rëndësishme, për të cilat ka shumë teori, shumë teza që duhen vlerësuar, si ato që ekzistojnë, ashtu edhe ato që po propozohen. Ka që thonë se duhen zhvilluar kërkimet e naftës në Veri; ka të tjerë që thonë të intensifikohen këto punime në Jug të vendit. Të dy versionet mund të jenë të drejta, por ato duhet të argumentohen shkencërisht.

Edhe unë dëshiroj të jap një mendim timin, që më ka ardhur duke lexuar libra të ndryshëm: Në rajonet ku ne nxjerrim naftë, mund të ndodhet një pellg i madh naftëmbajtës, i cili nuk është prekur deri tash, ose është prekur vetëm në disa vende dhe është sabotuar nga armiqtë. Ma merr mendja se ky pellg mund të shtrihet edhe thellë në det. Po a e kemi parë me këtë sy? Më duket se kemi ngelur në disa skema, në disa kufij dhe me zor dalim prej tyre.

Natyrisht, shteti ynë nuk ka para për të shpenzuar kot, por na vihet detyrë të bëjmë studimin me perspektivë jashtë «vijës së verdhë» të sovjetikëve. Pikërisht për këto arsye, them unë, nuk duhen lënë problemet e mëdha nga ana e drejtuesve kryesorë, pse të voglat ka kush i kryen dhe duhet t'i kryejnë.

2. Në zhvillimin e industrisë:

Problemi i minierave është i lidhur ngushtë me industrinë, pse kësaj minierat i japin «bukën», prandaj Partia ka krijuar një ministri të posaçme vetëm për

sektorin e rëndësishëm të industri-minierave. Me këtë dua të them që Ministria e Industrisë dhe e Minerave kurrë nuk duhet t'i shkëputë minierat nga industria. Në rast se çalon njëra prej tyre, do të çalojë edhe tjetra. Të gjithë e kemi të qartë se, po të mos realizojnë prodhimin minierat, do t'i shkaktohej dëm i madh ekonomisë, fabrika të lëra të rëndësishme nuk do të punonin dhe me mijëra veta do të mbeteshin pa punë. Dihet se Kombinati i madh Metalurgjik do të ketë nevojë për hekur e nikel, për energji elektrike, për koks e karburant, prandaj, në rast se këta do t'i mungojnë, ai nuk do të funksionojë. Ne nuk mund të shkojmë me idenë që mungesat në të gjitha këto lëndë të para e të tjera të domosdoshme do të na i plotësojë dikush tjetër, ose do t'i blejmë jashtë me devizë, por duhet të përpiqemi t'i sigurojmë në vendin tonë.

Ne kemi ndërtuar një sërë rafinerish. Por edhe këto duan ushqim, domethënë naftë, prandaj, po nuk u realizua plani i naftës, në mos të gjitha, një pjesë e mirë e rafinerive që kemi, do të mbeten pa punë. Ne kemi krijuar një industri të rëndë mekanike, e cila nuk është vënë aq mirë dhe sa duhet në lëvizje, prandaj është e domosdoshme që edhe këtu të merren të gjitha masat që ajo të japë rendimentin maksimal. Dihet se pa çelike industria mekanike e rëndë nuk ecën, për këtë arsye çeliquet ose do t'i prodhojmë vetë, ose do t'i importojmë. Importimi i çeliqueve kërkon eksport, prandaj planin duhet ta realizojnë dhe ta tejkalojnë jo vetëm industria e minerave, por të gjitha ministritë që kanë detyra eksporti, ndryshe ekonomia jonë nuk mund të ecë përpara me tempin që caktohet dhe tempi

që caktohet nuk është maksimali. Unë mendoj se në këtë drejtim nuk ka arsye për t'u kënaqur, por për të reflektuar dhe për të marrë masa të mëtejshme të forta.

Është vepruar mirë që është ulur plani i importit të veglave të ndërrimit. Unë jam dakord me shifrat e parashikuara nga Qeveria, por mendoj që edhe më shumë po të ulen, më mirë do të jetë, se kapacitetet tona mekanike ekzistojnë, vetëm duhet siguruar importi i çelikut. Mendoj se ne mund të mos kemi përherë mundësi për të importuar çdo vit çelik për veglat e ndërrimit, kështu që ky problem nuk është aq i lehtë për t'u zgjidhur siç duhet.

Kuadrot që punojnë në industrinë mekanike të përpiqen që të kualifikohen me kujdesin më të madh për të qenë në gjendje të kontrollojnë edhe kualitetin e çelikut të importit. E theksoj këtë çështje se dëgjohet andej-këtej të flitet që jo tornot janë të vjetra, jo pjatat nuk bëjnë, jo çeliku nuk vjen me dimensionet e duhura etj. Tornot dhe të gjitha makineritë e tjera të industrisë mekanike ne i kemi në përgjithësi të reja. Atyre mund t'u themi të vjetruara pas dhjetëra vjetësh, prandaj këtu nuk ka vend të thuhet se tornoja apo diçka tjetër është e vjetër ose e re. Problemi qëndron te mungesa e kualifikimit të punëtorit dhe kualifikim nuk do të thotë ngritje e punëtorëve në kategori, por përgatitje serioze e tyre që të jenë të aftë të ngrenë cilësinë e detalit dhe të ulin koston e tij, të ekonomizojnë lëndën e parë etj. Në këtë drejtim duhet të punojnë jashtëzakonisht mirë organizatat-bazë të Partisë, organet e pushtetit dhe ndërmarrjet ekonomike,

se, në radhë të parë, për industrinë e minierat ne kemi ndërtuar dhe po ndërtojmë hidrocentrale dhe termocentrale që po na kushtojnë me miliarda. Këta prodhues të mëdhenj të energjisë elektrike nuk i kemi ndërtuar dhe nuk i ndërtojmë vetëm për ta eksportuar energjinë e prodhuar, por, në radhë të parë, për të vënë në lëvizje industrinë tonë dhe teprica që mbetet të eksportohet.

Të bëhen përpjekje që hidrocentralet dhe termocentralet e fuqishme të ndërtohen në kohën e caktuar, me kualitet të përsosur dhe pa tejkaluar fondet që janë caktuar në projektet. Ne duhet të kemi parasysh në këtë drejtim edhe amortizimin e tyre, pse mjaft herë kjo gjë shikohet e veçuar nga tërë problemi i investimeve të shtetit tonë. Lypset të kuptojmë se gjithë këto objekte që ndërtojmë duhet të hyjnë në prodhim sa më parë, të krijojnë të ardhura dhe këto të ardhura të plotësojnë edhe nevojat e riprodhimit të zgjeruar në ekonominë popullore, edhe nevojat e përditshme të popullit.

3. Në zhvillimin e bujqësisë:

Mendoj që sivjet bujqësia ka qenë më e mirë nga vjet, megjithëkëtë planet nuk janë realizuar në të gjitha llojet e bimëve. Ne do të shkojmë në Kongresin e ardhshëm të Partisë me disa mosrealizime të planit të bujqësisë. Kuptohet që ky mosrealizim është një minus i madh.

Të gjithë e dimë se për bujqësinë, në radhë të parë, shtrohet problemi i tokës. I kemi bërë ne përmirësime kësaj toke që prodhon dhe duhet të prodhojë çdo

vit e më shumë drithëra e prodhime të tjera bujqësore? Pa hyrë në hollësi, mund të themi se përmirësime tokës bujqësore i kemi bërë dhe kjo punë ka ndikuar që çdo vit e çdo pesëvjeçar të ngrihen rendimentet. Ky është fakt dhe fakt pozitiv, por nuk duhet të na kënaqë as ne, as Ministrinë e Bujqësisë. Këtu s'ka nevojë për shumë teorizime. Studime po, duhen bërë, por në qoftë se nuk gabohem, edhe këto studime, sipas mendimit tim, nuk zbatohen si duhet e sistematikisht në praktikë, duke kontrolluar se sa i shërben përmirësimit të tokave çdo masë që marrim. Përmirësimi i tokës është një art i veçantë dhe këtë art specialistët t'ua mësojnë gjithë kooperativistëve e punonjësve të tjerë të bujqësisë, të cilët duhet të bëhen mjeshtër të tokës dhe të prodhimit.

Unë nuk do të hyj në detaje, se edhe herë tjetër kam biseduar me Pirro Dodbibën dhe kemi analizuar studimet që janë bërë nga shkencëtarët e bujqësisë sonë. Por them se këto studime duhet të vihen sistematikisht në zbatim e të mos mbeten diskure në letër gjërat për të cilat është vendosur rruga që do të ndiqet. Janë vënë në jetë këto? Unë mendoj se pjesërisht po, por pa i kontrolluar në mënyrë të organizuar dhe sistematike se si zbatohen, pa nxjerrë si duhet detyrat që dalin në procesin e këtij zbatimi dhe pa raportuar në Qeveri për rezultatet e arritura për këto çështje me kaq rëndësi, rreth të cilave afro 100 studiues tanët kanë mbajtur kumtesa e referate. Për moszbatimin e studimeve në bujqësi përgjegjësinë kryesore e ke ti, Pirro, dhe gjithë shokët e tu që ke rreth e rrotull në ministri e në rrethe.

Toka arë duhet shtuar. Në këtë drejtim nuk kam parasysh vetëm hapjen e sipërfaqeve të reja, se jam dakord me sasinë që është caktuar nga Qeveria, por vërej me keqardhje se punët në shumë objekte bonifikimesh të mëdha, për të cilat u diskutua, nuk po na ecin mirë, plani i tyre nuk zbatohet. Dhe kjo e keqe nuk ka ndodhur vetëm sivjet, por përsëritet çdo vit, megjithëse shumë vite me radhë e kemi ngritur këtë problem. Këtu ka përgjegjësi të madhe Pirro Dodbiba si ministër i Bujqësisë, po kështu ka përgjegjësi shumë të madhe edhe ministri i Ndërtimit që ka në varësi bonifikimet.

Kur do të mbarojë bonifikimi i Karavastasë së Vogël, nga e cila do të përmirësohen 1 300 hektarë dhe do të përfitojmë 2 750 hektarë tokë të re, ku do të ndërtohet edhe një rrjet ujitës i ri për 2 720 hektarë? Kur do të mbarojë puna në kënetën e Hoxharës, prej së cilës do të përfitojmë 7 700 hektarë tokë të re dhe do të përmirësohen 11 500 hektarë të tjerë? Kur do të përmirësohet bonifikimi i Velipojës dhe i shumë fushave të tjera? Personalisht unë nuk mund të kënaqem duke dëgjuar vetëm fjalë se «do të përfundojnë». Kjo na është thënë e na është përsëritur disa herë. Puna në Hoxharë ka s'unië vjet që ka filluar dhe, po të hapim projektet që na janë paraqitur ose vendimet e marra për të, do të vërejmë se periudha e bonifikimit të saj ka qenë parashikuar për një kohë shumë të shkurtër.

Këtu në Byronë Politike janë dhënë orientime për këto çështje kaq të rëndësishme për ekonominë e vendit tonë e jo vetëm janë dhënë udhëzime, por dhe janë marrë vendime për t'u spastruar kanalet e mëdha,

për t'u bërë bonifikime tokash, rektifikime, për të ndërtuar rezervuarë të mëdhenj për ujë, që nuk kanë dalë me sukses etj. Çfarë është bërë për to?

Të bëmë pyetjen këtu çfarë po bëhet për shkripëzimin e kënetës së Durrësit, shoku ministër i Bujqësisë. Do të mbillet vallë ndonjëherë gjithë kjo fushë dhe do të nxirren të gjitha ato shpenzime të mëdha që ka bërë shteti për të? Ti mund të na thuash se kjo fushë mund të mbillet dhe të na shpjegosh gjithë teorinë e shkripëzimit por personalisht mua nuk më mbushet mendja. Vetëm për një gjë jam i sigurt: për interesimin tuaj të paktë për këtë fushë, për të mos thënë aspak.

Përpara gjithë këtyre tokave të mëdha pjellore, ku kemi harxhuar miliarda, nuk po tregohet interesimi i duhur. Në qoftë se ne do të zbatojmë porosinë e Kongresit të 6-të të Partisë dhe të Komitetit Qendror që bujqësia mbetet përsëri dega bazë e ekonomisë sonë, unë mendoj se Komiteti Qendror dhe Qeveria duhet të caktojnë afatet minimale për marrjen në dorëzim të këtyre veprave. Sipas gjykimit tim, është më e preferueshme të lëmë mënjanë mjaft vepra të tjera, prej të cilave përfitojmë disa qindra ose edhe ndonjë mijë hektarë, sesa të tororisemi me këto vepra kolosale që do të kthehen në hambar drithërash buke dhe të prodhimeve të tjera bujqësore.

Unë kujtoj se nuk është i njëjtë dhe proporcional interesimi që po tregohet për veprat industriale me atë që tregohet për veprat bujqësore. Kur vendosim që buka të bëhet në vend, atëherë kjo detyrë duhet të plotësohet. Për të kemi folur vite me radhë, po ende

s'e kemi realizuar. Mundet që këtë detyrë ta kemi vënë edhe në kohën kur kushtet akoma nuk ishin krijuar, por, aktualisht, mendoj se të tëra kushtet ekzistojnë. Ashtu si Qeveria, edhe unë jam i mendimit që Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve kanë pasë vepruar shumë gabim kur i planifikonin me rezervë të madhe dritërat dhe prodhimet e tjera bujqësore. Mua më duket se këta shokë drejtues që kanë vepruar kështu, nuk rrojnë me situatat politike, ideologjike dhe ekonomike, ndryshe nuk mund të bënin një veprim të tillë. Si do t'i sigurojmë ne bukën, pambukun, vajin, sheqerin etj. për popullin? Do t'i bëjmë në vend apo mendoni t'i sjellim nga jashtë? Ngahera e përsëritim se importi i mallrave që na nevojiten bëhet përherë e më i vështirë për shkak të situatave që krijohen në botë, dhe jo vetëm për shkak të situatave, por edhe për arsye se çmimet e mallrave rriten në mënyrë të konsiderueshme. Kur armiku i brendshëm saboton në sektorin e naftës, kur nuk realizohet plani i nxjerrjes së mineraleve të tjera, kur binët medicinale mbledhen sikur të ishin manushaqe, kur nuk realizohen perimet, patatet etj., kjo gjendje i vë para vështirësish ekonominë dhe shtetin tonë. Po përse të vihemi në vështirësi, kur kemi shembuj të shkëlqyer të realizimeve në bujqësi; kur toka jonë tash është bërë më pjellore; kur 60-70 për qind e sipërfaqes së tokës së punueshme ujitet, gjë që rrallë e kanë arritur shtete të tjera; kur kemi gjithë këto fabrika plehrash azotike, fosfatike etj; kur kemi një mekanizim të mirë dhe, në radhë të parë, një popull patriot e të ngritur politikisht nga Partia jonë?

Unë nuk pajtohem me mendimin tënd, Pirro, që nuk je dakord për të shtuar sasinë e hektarëve të misrit në fushë dhe paraqet si pengesë faktin që për këtë bimë duhen pesë deri gjashtë ujitje. Le të bëjmë një shtesë sipërfaqeje në fushë për misrin, se kemi mundësi që t'i bëjmë atij edhe gjashtë-shtatë ujitje, por edhe në qoftë se nuk do t'i bëjmë kaq, atëherë le t'i bëjmë katër-pesë, por t'i bëjmë si duhet e në nivel të lartë agroteknik shërbimet e tjera që kompensojnë ujitjen. Me një pikëpamje të tillë nuk mund të ketë rrezik shkenca, pse shkencën e vërteton praktika. Në vendin tonë të vogël praktika bujqësore ka vërtetuar se misri mund të bëhet mirë, po t'i kushtohet kujdesi i duhur. Duhet ta përsëritim këtu, në Byronë Politike, se ky problem ka qenë shtruar edhe për pambukun, për të cilin ju arritët derisa të kërkonit gati ta likuidonit këtë bimë, por me këmbënguljen e Byrosë Politike u bë e mundur që në parcella të mëdha të merren deri 20 apo 22 kuintalë pambuk për hektar. Ky rezultat është larg nga 5 deri 6 kuintalë për hektar që merreshin.

Kjo tokë, këta njerëz dhe këto mjete janë që e realizuan kthesën jo vetëm për pambukun, por edhe për grurin. Pse të mos bëhet kështu edhe për misrin, për të cilin eksperiencia e fshatarësisë sonë është e madhe? Duhet gjetur arsyet përse Dibra, që ka pasur eksperiencë të mirë për ujitjen e misrit, të bjerë në rendimente të vogla, kurse në rajone të tjera, si, bie fjala, në fushën e Gjirokastrës etj., që e bënin misrin të hollë si gishti i dorës, të ngrihen sot rendimentet e tij dhe të merren 60 deri në 110 kuintalë për hektar. Duhet ditur se këta bujq, që i kanë ngritur rendi-

mentet, nuk kanë pasur ujë as për të pirë e jo më për të ujitur bimët bujqësore. Kur Partia ua solli ujin, ata e vlerësuan si duhet atë dhe prandaj iu vunë punës për të mësuar se si të ujitin. Si fusha e Gjirokastrës që ujitet ne kemi sot me dhjetëra e dhjetëra mijë hektarë të tjerë në gjithë Shqipërinë.

Për të gjitha sa përmenda, a është e pranueshme të sillen pikëpamje jo të drejta në Byronë Politike? Po flas me këtë ton, shokë, dhe po i bëj këto kritika, sepse sigurimi i bukës është detyrë kryesore, se këtë duhet ta prodhojmë vetë, mbasi nuk na e jep kush dhe për të nuk duhet të varemi nga të tjerët. Në këto kushte vihet çështja: Ose do ta prodhojmë bukën vetë, ose do të ulim sasinë e konsumit të saj nga populli. Zgjidhja e dytë është e papranueshme, prandaj duhet të bëjmë të parën.

Duhet të dimë, që nga lart e deri në bazë, se ky plan që u caktua për drithërat është një detyrë primordiale, e mundshme dhe e realizueshme. Kjo është dëshira e zjarrtë e gjithë popullit që nuk do kurrë të gjendet në vështirësi dhe të dobësojë mbrojtjen e atdheut. Por dëshira është njëra anë e problemit. Ana tjetër me rëndësi është që kjo të kthehet në realitet dhe kthimi në realitet kërkon besim të plotë për mundësinë e realizimit të asaj që vendoset, organizim e kontroll të shëndoshë dhe punë të palodhur. Në qoftë se nuk ngremë në këmbë kooperativistët, ky plan do të mbetet në letër dhe mund të na ngjasë, siç edhe na ka ngjarë, e të themi: «Jo ashtu e jo kështu, jo bëmë kaq, jo nuk bëmë aq». Prandaj të tendosemi mirë që plani të realizohet.

Unë mendoj ta pranojmë shifrën që caktoi Qeveria për drithërat. Kjo nuk është një shifër «aforfe», por e llogaritur dhe e mundshme të realizohet. Natyrisht, kjo do të arrihet me djersë, se pa djersë dhe pa organizim nuk mund të realizohen tonët e caktuar.

Sipërfaqja e tokave që do të mbillen me misër vërtet është rritur mbi detyrën e vitit 1975, po prapë kjo rritje më duket se është frenuar nga «teoritë e ujitjes», si ato që po dëgjojmë: «Misri do më shumë shërbime, se ka një sasi mbi ujë», «grurin e kemi më të sigurt...» etj. Po të ndjekim këto arsyetime, natyrisht, nuk rriten as sasia e hektarëve, as rendimentet e drithërave. Prandaj propozoj të rishikohen të dhënat për të dy këta tregues, sepse edhe rendimenti mesatar prej 33,3 kuintalësh për hektar i misrit mua më duket i ulët. Ai nuk duhet krahasuar me atë të vitit 1975 që ishte 29,6 kuintalë për hektar dhe nga kjo të na duket se e kemi ngritur. Grurin ne po e ngremë 3,7 kuintalë për hektar në krahasim me vitin 1975, kurse misrin vetëm 4,3 kuintalë për hektar. Këto proporcione për mendimin tim s'janë të drejta. E di që si arsye sillët fakti që kemi një pjesë të sipërfaqes së mbjellë me misër mbi ujë, por mendoj se duhet të luftohet që të merret më shumë misër si në tokat mbi ujë, ashtu dhe në tokat që janë nën ujë. Më duket se, kur flasim për ujitjen, shiun që bie në vëndin tonë nuk e llogaritim fare, po llogaritim vetëm ujitjen nga rezervuarët. Prandaj propozoj të rishikohen këto shifra, pasi të merren në tokat nën ujë 39,1 kuintalë misër për hektar më duket pak. Ne duhet të luftojmë që të arrijmë të marrim 45-50 kuintalë për hektar dhe jo më pak,

derisa rrethe të tëra kanë parashikuar të tilla rendimente. Pse duhet të bëjmë lëshime për më pak në tokat nën ujë në rrethet e tjera?

Pastaj, siç e tha edhe shoku Pali [Miska], për realizimin e prodhimit të drithërave të bukës duhet të jepen të dhëna të sakta dhe të mos flitet në hava. Prandaj edhe për misrin të merren masa dhe brenda dhjetë ditëve të sigurohet Qeveria për sasinë ekzakte të prodhimit që është marrë dhe jo kështu me dyshime. Të gjitha duhet t'i japim ekzakt, se tani misri ka kaluar në koçekë, është mbledhur. Ata që na japin shifra të pabazuara, duhet të mbajnë përgjegjësi. që nga ministri e deri tek organet shtetërore ekonomike në rrethe.

Sasia e drithërave për bagëtinë, siç parashikohet në material, më duket akoma e lartë. Mendoj se shifra që caktuat më vonë është e mirë, në rast se kjo sasi do të përdoret drejt dhe do të shfrytëzohen si duhet ushqimet e tjera, që jam i sigurt se nuk përdoren siç janë porositë, nuk shtohen dhe nuk përpunohen mirë. Prandaj ta ekonomizojmë drithin dhe, nga ana tjetër, bagëtitë e prodhimet e tyre t'i shtojmë dhe jo meqenëse pakësuam drithin për to, të ulim planin e prodhimeve blegtorale.

Kooperativave të tipit të lartë të mos u lëmë për zahirë nga aq kilogramë drithë për frymë, siç propozohet. Këto mendoj të mos kenë ndryshime në këtë çështje nga kooperativat e tjera. Anëtarët e kooperativave të tipit të lartë marrin më shumë lekë për ditëpunë. Bënkë duhet të ekonomizohet, me të të mos lejojmë që të bëhen favore për njërin ose për tjetrin.

Dëshiroj të vë në dukje se në zhvillimin e bujqësisë tregohemi vazhdimisht të njëanshëm. Ne nuk i vëmë rëndësinë e duhur prodhimit të ndihmësve të bukës, siç janë perimet, patatet, frutat, mishi, vezët e qumështi. Interesimi i deritanishëm, për mendimin tim, përveçse për vezët e mishin e pulës, nuk është i kënaqshëm dhe mendoj që, në qoftë se nuk u vëmë rëndësi zhvillimit të gjithë këtyre prodhimeve dhe blegtorisë, edhe sikur bujqësia të prodhojë shumë, ne nuk do të mundim t'i japim popullit atë kalorazh që nevojitet për zëvendësimin e forcave që harxhohen nga njeriu dhe nuk do të sigurojmë as rezervat shtetërore.

Vërehet se, megjithëqë Qeveria ka marrë vendime e masa dhe ka sjellë edhe nga jashtë farëra të zgjedhura për perime, prapëseprapë plani i tyre nuk realizohet. Por, sido që plani nuk realizohet, bie në sy një vetëkënaqësi pa vend që shprehet nga kuadrot me formulën «Ka furnizim në treg». Ky, më duket mua, nuk është një shikim i drejtë i problemit, se na shtyn të mos bëhen përpjekje për të realizuar planin, të mos merren masa për një shpërndarje të mirë të perimeve, të mos thahen perime dhe të mos eksportohen këto të njoma dhe në kohën e duhur.

Kam thënë se në konferenca po bëhen edhe deklarata për bujë, po jepen e merren premtime se «nga lopët e racës që kemi sjellë do të marrim nga 4 000 deri në 4 500 litra qumësht në vit» dhe, për fat të keq, mjaft zotime të marra jo vetëm nuk janë vënë në jetë, por kanë ndodhur edhe ngordhje lopësh. Pse të ngjasë një gjë e tillë? Na thonë se ndodh për arsye të ushqij-

mit. Po pse, pak foragjere kemi planifikuar, pak tokë kemi caktuar për to? Do të merren masa që bagëtia jonë të përmirësohet e të zhvillohet dhe të rriten rendimentet e ulëta që merren prej saj, apo do të lejojmë që bujqësia të na kthet prapë në një bujqësi thjesht ekstensive e të mos sigurojmë prodhimet e nevojshme? Nuk mund të ceket gjatë kështu, në qoftë se nuk e riparojmë këtë gabim të rëndë.

Tash po marrim masa për shkurtimin e pagave të larta. Këto masa janë të drejta. Ne synojmë të ndihmojmë fshatin dhe të ngushtojmë mbylljen e gërshërës, domethënë dallimet thelbësore midis fshatit dhe qytetit. Këto masa kërkojnë të prodhohet me shumicë, që në të ardhmen pagat reale jo vetëm të mos ulen, por bile të ngrihen. E gjithë kjo çështje varet nga prodhimet bujqësore që nevojiten për konsumin e përditshëm. Këtu ne duhet të bëjmë kujdes që të mos na krijohen mungesa prodhimesh e vështirësi të tjera, prandaj jo vetëm të mos kemi asnjë dyshim për këtë plan rigorozisht të drejtë, por të bëjmë të gjitha përpjekjet që t'i tejkalojmë detyrat e tij. Unë mendoj se një ide e tillë duhet të na udhëheqë për hartimin e planit të ri pesëvjeçar.

Kurdoherë kemi qenë deficitarë në yndyrna, por edhe në sallon e derrat, për shkak se plani për rritjen e derrave nuk po realizohet, por edhe sepse ajo sasi që prodhohet, realizohet me dotacione të mëdha. Fabrika e margarinës vihet në plan, po kushedi kur do të mbarojë¹. Bimët për prodhimin e vajrave sapo e kanë ma-

1. Kjo fabrikë filloi nga prodhimi në vitin 1977.

rrë veten dhe kanë filluar të ngrenë rendimentin, por mundësitë janë që rendimenti i tyre të ngrihet akoma më tepër, si, për shembull, ai i lulediellit. Po me ullinj-të si jemi? Asnjëherë nuk na ka raportuar shoku ministër i Bujqësisë se në çfarë gjendje ndodhen ullinj-të e rinj, të cilët kanë 20 apo 25 vjet që janë mbjellë. Japin prodhime këta apo jo, u bëhen shërbimet e nevojshme apo nuk u bëhen? Këto përgjigje duhet të na jepen me hollësi çdo vit. Unë nuk dua të më japësh shpjegim këtu, shoku ministër, se ato që mund të më thuash i kam dëgjuar, por dua të shpreh mendimin se nuk po tregohet kujdes për këtë pemë kaq të rëndësishme. Këto pakujdesi duhet të marrin fund!

Çështja e blegtorisë nuk është kuptuar drejt. Kurrë Komiteti Qendror i Partisë, Byroja Politike dhe Qeveria nuk kanë dhënë ndonjë porosi që të zhduken ose të qëndrojnë në vend bagëtitë e imëta. Mirëpo Ministria e Bujqësisë dhe rrethet kanë ecur në drejtim të kundërt me atë që ka orientuar Partia. Këta, duke u nisur nga qëllimi i shtimit të numrit të lopëve dhe i përmirësimit të racës së tyre, ku kemi pasur suksese dhe duhet vazhduar të punohet në këtë drejtim, kanë gjetur si rrugë më të lehtë pakësimin e bagëtive të imëta. Kjo është rrugë e dëmshme për ekonominë popullore, se nga to populli siguron qumësht, djathë, gjalpë, mish dhe lesh. Duke vepruar në këtë mënyrë, ne largohemi nga një traditë e shkëlqyer e popullit tonë. Të mos harrojmë, shokë, se ekonomia jonë socialiste ka ekzigjencat e saj, që nga zhvillimi ekstensiv i bagëtive të imëta të kalohet në zhvillimin në thellësi të tyre dhe të përdoren të gjitha mundësitë për rri-

tjen e tufave më të mëdha e më të shëndetshme se më parë, bile edhe sesa në kohën e paraçlirimit, kur bagëtitë e imëta ishin dominuese.

Si në të gjithë sektorët e ekonomisë, edhe në atë të bujqësisë kam mendimin se duhet të përqendrohen puna, materialet e fondet monetare. Kjo do të thotë që edhe në këtë sektor të mbarojë sa më parë dhe brenda kohës minimale çdo vepër që parashikohet të bëhet dhe kësaj populli t'i shikojë hairin. Të mos hallakatemi e të mos i marrim në dorëzim veprat jo vetëm pas një afati shumë të gjatë, por edhe me kualitet shumë të dobët.

Për sa i përket mekanizimit të bujqësisë është e domosdoshme të kemi parasysh se nuk do të importojmë më atë sasi traktorësh si deri tash. Mekanizimi që kemi nuk është i dobët, vetëm se ai duhet mirëmbajtur, pse në këtë drejtim ka neglizhenca të dënueshme. Shumë uzinave, të cilat i kemi orientuar për prodhimin e veglave të ndërrimit të makinerive bujqësore, Ministria e Bujqësisë u ka bërë kërkesa pa mend, si pasojë e të cilave janë harxhuar materiale e fonde të konsiderueshme monetare, ndërsa ato që janë prodhuar janë hedhur mënjanë! Gjëra të tilla, mendoj unë, nuk duhet të lejohen më, por të merren masa të rrepta ndaj atyre që bëhen shkaktarë për dëmtimin e ekonomisë.

Mirëmbajtja e traktorëve kërkon edukimin e shëndoshë të traktoristëve me ndjenjën e ruajtjes së pasurisë socialiste, të forcimit të ekonomisë. Këtë Partia e ka thënë me kohë. Unë mendoj se nuk po zbatohet si duhet orientimi i Partisë për zgjatjen e jetës së

traktorëve, por them se jemi larg nga shembuj të tillë të shkëlqyer, siç janë ata të traktoristëve të dalluar Budo Isufi, Shyqyri Kanapari dhe shumë e shumë të tjerëve.

Edhe veglat e ndërrimit të traktorëve duhet të dalin me cilësi të lartë. Të mos mbushen raftet dhe dollapët e SMT-ve me vegla që mbeten pa u përdorur ngaqë janë të cilësisë së dobët, se nuk jemi një shtet që notojmë në çelik.

4. Për sektorin e ndërtimeve:

Ne po ndërtojmë vepra të mëdha, shumë të kushtueshme, por të domosdoshme për zhvillimin e ekonomisë popullore, që kanë një peshë të rëndë dhe do të bëjnë një revolucion në përparimin e mëtejshëm të industrisë sonë. Nuk flas këtu vetëm për veprat e mëdha, por edhe për veprat e tjera, që për ne janë, gjithashtu, të rëndësishme. Në këto vepra shteti investon shuma kolosale. E vërteta është se, nën udhëheqjen e Partisë, kemi arritur suksese, janë bërë punë të mira, është ngjallur hovi revolucionar i masave, është krijuar një klasë punëtore heroike dhe specialistë e inxhinierë të aftë. Por dua të theksoj se edhe në këto ndërtime ka një përhapje të madhe, se nuk u është dhënë prioritet ndërtimeve më të domosdoshme dhe më rezultative. Kjo vjen nga plani i mëparshëm dhe nga dëshirat e pamatura.

Unë mendoj se, po të ecet me këtë mënyrë, kështu të përhapur, do të jetë shumë gabim. Kam arritur në përfundimin se ndërtimin e disa objekteve që presin, ne mund ta lëmë edhe në mes dhe t'i drejtojmë forcat

për të mbaruar sa më parë ndërtimet më të nevojshme, më të ngutshme e më prodhuese. Përveç kësaj, ky pësim të na bëhet mësim, që të mos përhapemi shumë. Në mjaft ndërtime nën kufi dhe në kufi, që kryhen nga vetë ndërmarrjet, ne jemi përhapur si vaji në lakra. Të dyja këto lloje ndërtimi mua më duket se nuk janë sa duhet nën kontroll nga plani, nga ministritë dhe nga bankat.

Për ndërtimet nën kufi ju keni zbritur në 50 përqind. Kjo mund të jetë një shifër e drejtë dhe e pranueshme, por sikur edhe më pak të reduktohej, mendoj se nuk do të bëhej keq. Kjo çështje duhet parë me këtë sy edhe për ndërtimet që marrin përsipër të bëjnë vetë me forcat e tyre dikasteret ose ndërmarrjet. Këto forca janë të kufizuara dhe kështu duhet të jenë. Nga kjo mund të na dalin dy situata: ose ky kufizim do të thuhet vetëm me fjalë, po në fakt do të marrin punëtorë jashtë planit, ose vepra nuk do të mbarojë dot. Atëherë ne duhet të zgjedhim rrugën e mesme: të ndërtojmë brenda mundësive dhe të ndërtojmë më të nevojshmet, por ndërtimet kryesore të realizohen patjetër, në kohën e duhur dhe me kualitet shumë të lartë! Për këtë qëllim duhet që qysh nga fillimi i punës të ushtrohet një kontroll i rreptë nga Ministria e Ndërtimit, e cila të mos harrojë se ka të bëjë me një situatë ku vihen re herë pas here shfaqje të teknokratizmit.

Duhet njohur që një situatë e tillë na ka shkaktuar dëme të mëdha, pasi disa nga teknikët e inxhinierët, meqenëse kanë të bëjnë me çështje teknike, e konsiderojnë veten si të pakontrollueshëm nga kurrkush,

prandaj, sipas kokës së tyre, ata planifikojnë e tejkalojnë si pa të keq planin dhe investimet. Këtu jo vetëm është, si me thënë, një rezervë e madhe, por, gjithashtu, i bëhet një dëmtim i rëndë ekonomisë shtetërore nga koncepti i gabuar i inxhinierit, i teknikut, i projektuesit, i zbatuesit, i ministrit, që kanë përgjegjësi të madhe për këtë situatë. Këta nuk mund të lajnë duart nga ato që kanë ndodhur në Kombinatin Metalurgjik, në hekurudhë, në Ballsh ose gjetikë. Shumë herë janë parë këto probleme me sy prej burokrati, teknokrati dhe prepotenti. Disa shokëve u pëlqen «mendja teknike» e tyre dhe pretendojnë se nuk influencohen nga kurrkush, domethënë nuk marrin në konsideratë zërin e masave, tregohen egoistë e mendjemëdhenj dhe i shkaktojnë kështu vështirësi Partisë, mbasi vepra nuk mbaron në kohë, përfundon me cilësi të dobët dhe hyn në prodhim me vonesë, duke penguar në këtë mënyrë planet tona. Këtë gjë nuk mund ta lejojë Byroja Politike.

Lidhur me këtë dëshiroj të trajtoj çështjen edhe në një aspekt tjetër që e konsideroj shumë të rëndësishëm për ekonominë tonë dhe për mbarëvajtjen e saj. Ndërtimet e mëdha që po bëjmë përfaqësojnë vërtet një sukses të rëndësishëm, ato e forcojnë ekonominë, por me kusht që këto, siç e thashë, të realizohen në kohën e caktuar, me cilësi, me preventiva të drejtë dhe këta preventiva të mos tejkalohen nga shuma e caktuar fillimisht nga Qeveria, siç po bëhet rrugë.

Me keqardhje konstatojmë se në Ministrinë e Ndërtimit është krijuar një botëkuptim i dënueshëm (kjo ka qenë deri diku e falshme kur ne kishim pak

inxhinierë dhe specialistë ndërtimi, por e pafalshme aktualisht), që konsiston në tejkalimin e fondeve në gali të gjitha veprat që ndërtojmë, në të mëdhatë e në të voglat, jo me 5 apo me 10 për qind, por me 30, 40 e nganjëherë edhe më shumë. Ky tejkalim nuk është diçka e vogël, po mund të llogaritet me miliarda. Vë pyetjen: nga dalin këta miliarda? Në buxhetin vjetor ne nuk i lëmë Qeverisë veçse një fond rezervë, kurse këto tejkalime janë shumë herë më të mëdha. Nga del gjithë kjo kartmonedhë dhe ç'rrezik krijon kjo për ekonominë tonë popullore?

Financier nuk jam, por, herë pas here, në disa farë raportesh prej një faqeje ose një faqeje e gjysmë që na dërgon me disa formula gjoja shkencore Ministria e Financave, informohemi se «qarkullimi monetar qëndron mirë, se kartmonedha që është duke qarkulluar është rritur pak, po nuk krijon ndonjë shqetësim, se ai do të mbulohet andej, do të mbulohet këtej» etj., etj. Nga ana tjetër, fondi i pagave gjatë këtyre viteve nuk ka shkuar duke u pakësuar si duhet, përkundrazi, ka ardhur duke u shtuar. Atëherë pyes: Një situatë e tillë nuk çon në inflacion dhe në uljen e pagës reale të punonjësve tanë? Teoria na mëson se po, kurse praktika jonë, siç na paraqitet, tregon që jo. Kjo për mua nuk është e qartë. Mundet që ju shokët e Qeverisë, dhe veçanërisht ministri i Ndërtimit, të thoni se këto shtesa në preventiva vijnë nga mosrealizimi i fondeve të çaktuara për veprat e tjera. Kjo ka të ngjarë të ndodhë dhe ndodh. Por të veprohet kështu, do të thotë që ne vetë të lejojmë të shkelet plani i shtetit, sikurse tha këtu shoku Hekuran Isai. Atëherë, në qoftë

se lejojmë që të shkelet plani i shtetit, kemi hyrë në një rrugë të gabuar.

Në rast se me kaq lehtësi marrim fonde të një ndërmarrjeje dhe ia japim këto një tjetre, do të jetë më mirë që ndërmarrjes, së cilës i marrim fonde, t'ia heqim këto me kohë nga plani. . .

Dëshiroj edhe një herë të theksoj se këtu kanë përgjegjësi edhe organizatat e Partisë në qendër e në rrethe, Qeveria dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve e jo vetëm për këto probleme që ngrita më sipër, por edhe për mungesën e vigjilencës në hartimin e preventivave të objekteve të ndërimit dhe në zbatimin e tyre, që duhen bërë me rigozitetin më të madh dhe me vigjilencë, gjë që duhet të shërbejë edhe për edukimin e inxhinierëve dhe të teknikëve, edhe si kontrolluese e punës së tyre.

Konstatojmë me keqardhje se kur janë veprat në mes, ose kur këto janë duke përfunduar, dikush «e pickon» Komitetin Qendror. Atëherë, ngrihet vigjilenca nga të gjithë, dalin në dritë shumë të këqija, gabime të rënda në punë, deri edhe sabotime, dhe arrihet në konkluzionin se duhet të merren masa, në radhë të parë, ndaj inxhinierëve, agronomëve e të tjerëve, me një fjalë ndaj specialistëve me arsim të lartë.

Konstatojmë, gjithashtu, se në krye të shumë prej këtyre sektorëve që drejtojnë punimet në këto vepra dërgohen edhe njerëz me biografi të dyshimtë. Pse ngjet kjo? Kush e ka fajin këtu? Kjo ngjet nga mungesa e vigjilencës klasore, ngjet për faj të shokëve drejtues të Partisë dhe të pushtetit. Partia na ka theksuar kurdoherë se për njerëzit duhet pasur parasysh ana

politike, në radhë të parë, pastaj zotësia e tyre teknike. Në rast se ana politike e disave nuk është aq e kulluar, kërkohet që Partia dhe punonjësit ta ndjekin me vigjilencë punën e këtyre elementëve, jo me qëllim që t'i futin në burg, por për t'i orientuar drejt, për t'i kontrolluar, për t'i korigjuar kur gabojnë dhe për t'i nxitur të ecin përpara. Por kjo gjë nuk bëhet si duhet, prandaj nga kontrollet që janë bërë tash na vijnë raporte për një sërë kuadrosh me arsim të lartë që duhet t'i procedojmë.

A është një rrugë e drejtë kjo? Kur e mbushin kupën, njerëz të tillë të procedohen patjetër, po ne s'duhet t'i lëmë që të mbushin kupën. Prandaj, kur ka vend për t'i shpëtuar, të bëhen përpjekje që t'i shpëtojmë, po në asnjë rast të mos i lëmë pa u vënë mirë në dukje atyre fajet që kanë kryer, dhe jo t'i bëjmë drejtues e t'u besojmë punë shumë të rëndësishme, po t'u themi të venë të punojnë në vende të përshtatshme, sipas gabimeve e fajeve që kanë kryer, dhe atje të korigjohen.

Këtë e them se ka rrezik të krijohet një intelektualofobi dhe të mos kuptohet drejt në teori dhe në praktikë teoria e Marksit. Dua të them se marksizëm-leninizmi intelektualin dhe kuadrot me arsim të lartë, sidomos ata që dalin nga gjiri i klasës punëtore dhe i fshatarësisë punonjëse, nuk i konsideron si elementë që duhen parë me syrin e dyshimtë, por duhen parë nga pikëpamja që këtyre intelektualëve, me arsim të lartë ose të mesëm qofshin, po të mos e kuptojnë mirë dhe të mos e zbatojnë si duhet teorinë tonë, gjatë punës së tyre mund t'u ngjallen veset mikroborgjeze të

mendjemadhësisë, të teknokratizmit, të vënies së vetes mbi të tjerët: mund t'u ngjallet fryma e urdhërdhënësve, e prepotentëve, e mburravecëve. Këtë çështje në asnjë mënyrë të mos e përgjithësojmë, ashtu siç nuk duhet të ndodhë që teorinë tonë, që na udhëheq, të mos e përdorim drejt për njohjen e realitetit dhe të klasës sonë punëtore e fshatarësisë punonjëse kooperativiste. Ne e dimë që kemi një klasë punëtore të re, ideologjikisht akoma jo shumë të ngritur, prandaj, duke e njohur mirë atë e duke e marrë ashtu siç është, na vihet detyrë që me gjithë këta njerëz Partia të punojë me zemër të hapur dhe me ndërgjegje. Ne e dimë se shumica e kësaj klase vjen nga fshatarësia dhe se mbart mentalitete mikroborgjeze, prandaj nuk duhet të mbyllim sytë dhe të mendojmë se në radhët e saj nuk ka, po ashtu, elementë që akoma janë të pandërgjegjshëm për rolin e tyre të madh të klasës, nuk mund të mbyllim sytë përpara ndonjë banditi, si ish-kryetari i kooperativës bujqësore të Shëngjergjit, duke thënë se ai na qenkësh kooperativist i dalluar derisa kishte ardhur në kryesinë e kooperativës, bile propozohej të bëhej edhe Hero i Punës Socialiste, kurse, nga ana tjetër, vidhte e grabiste kooperativën, bënte ahengje me Beqir Ballukun, Abdyl Këllezin, Koço Theodhosin, Ndue Marashin e të tjerë në kurriz të ekonomisë kooperativiste.

Partia na ka mësuar që çështja e vigjilencës klasore nuk është vetëm një fjalë goje. Ajo nuk vihet në jetë as me dy, as me 50 diskure. Edhe këto, patjetër, shërbejnë për edukimin e njerëzve, por në rast se në praktikë, në jetë ne nuk i zbatojmë mësimet e mark-

sizëm-leninizmit, atëherë zigzagët në këtë drejtim do të jenë jo vetëm të vazhdueshme, por edhe shumë të theksuara.

Partia jonë ka zhvilluar dhe vazhdon të zhvillojë një luftë të rreptë klasash kundër armiqve të brendshëm të çdo natyre; ajo ka ngritur peshë masat e komunistëve dhe të punonjësve. Por kemi konstatuar dhe konstatojmë se ky zjarr revolucionar nuk mbahet ngritur vazhdimisht dhe si duhet. Pas një zjarri revolucionar vihet re një rënie në qetësi, një vetëkënaqësi, sëmundje këto që ndihmojnë të zhvillohet mikrobi, pas zbulimit të të cilit fillon prapë lufta kundër tij, ngrihet përsëri zjarri revolucionar. Dhe ky proces përsëritet. Është dialektike çështja e luftës së klasave dhe e vazhdimësisë së saj, pse klasa, kur armiku ngre kokën, godet përnjëherë, stabilizon gjendjen dhe siguron zbatimin e vijës së saj të drejtë. Kur armiku prapë është ngjallur, ai përsëri goditet. Këtë proces ne nuk do të mund ta evitojmë edhe për shumë vjet, lufta e klasave do të vazhdojë. Në këtë proces armiqve do t'u tregojmë vendin, njerëzit e pandërgjegjshëm do t'i ndreqim.

Pra, në rast se vigjilencën e kuptojmë jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe, kur them në praktikë, në gjithë zbatimin e urdhrave e urdhëresave, të ligjeve e të planeve që hartojnë Partia dhe Qeveria, ne nuk u lëmë shteg elementëve të këqij t'i shkelin, t'i shtrembërojnë ose t'i sabotojnë këto direktiva.

Si konkluzion i këtyre çështjeve, mendoj se duhet të rishikohen mirë metodat e punës së udhëheqjes sonë, metoda e punës që përdorin shokët që shkojnë kudo në bazë për të ndihmuar, për të drejtuar, për të kontrolluar.

Kam përshtypjen që shkohet shumë në bazë dhe këtë nuk e kritikoj, përkundrazi, e lavdëroj, por dëshiroj të kritikoj atë lloj kontrolli, gjatë të cilit mjaft shokë u shkojnë çështjeve përciptas, notojnë në eufori, globali nuk i lë të shikojnë të metat, gabimet e shtrembërimet. Kështu jo vetëm nuk zbulohet e keqja, por, për më tepër, arrihet edhe në pikëpamje të sëmura dhe të dëmshme si ato që shprehin disa inxhinierë fajtorë të Kombinatit Metalurgjik, të cilët thonë: «Përse fryhen këto gjëra «të vogla», kur ne po ndërtojmë një vepër kaq të madhe?». Me këtë ata duan të thonë që veprat e mëdha duhet të mbulojnë gabimet e tyre të rënda. Kjo gjë na ngjet edhe në Ballsh dhe në kantiere të tjera ndërtimi.

Të kuptohemi shokë, te ne në përgjithësi dominon pozitivja, por kjo pozitive nuk duhet të na bëjë të mos shohim anët negative dhe të rrumbullakosim çështjet, pse rrumbullakosja, sidomos në këto çështje kryesore që përmenda më lart, në sektorin e ndërtimeve ka efektet të pallogaritshme në dëm të ekonomisë sonë.

5. Për tregtinë, furnizimin dhe eksport-importin:

Shokë, ne duhet të balancojmë mirë ekonominë e përgjithshme të vendit dhe të mos shkojmë me mendimin se ndihma nga jashtë do të plotësojë mosrealizimet dhe deficitet tona. Ne duhet të prodhojmë jo vetëm për të mbajtur nivelin aktual të jetesës së popullit, por edhe për eksport, për t'u bërë ballë nevojave që do të kemi për importime. E theksoj se Komisioni i Planit të Shtetit importimet duhet t'i ketë shumë të kufizuara, kurdoherë të kushtëzuara nga eksporti ynë

dhe ato të jenë nën kontrollin e rreptë të Qeverisë. Jam dakord që importi të drejtohet nga nevojat më të domosdoshme për prodhimin dhe të hiqet dorë nga importimi i sendeve të luksit.

Kiço Ngjela dhe bashkëpunëtorët e tij na kanë dëmtuar shumë në tregti. Ata jo pa qëllim e kanë pasë kufizuar shumë eksportin tonë vetëm në disa shtete dhe në disa çmime. Aktualisht tregtia duhet të çajë përpara për eksportin, me njerëz të zgjedhur, kompetentë dhe, në radhë të parë, të ndershëm. Shumë njerëz me të cilët punonte Kiço Ngjela ishin të poshtër, të etur për të vënë lekë në xhepat e tyre, ose për t'u bërë agjentë të të huajve. Prodhuesi ynë duhet të dijë që po prodhon për eksportin dhe t'i ngulitet mirë në kokë që vera e prodhuar, ta zëmë, të jetë e mirë, stofrat e eksportit të jenë nga më të mirat, ndryshe ato nuk i blen kush. Prodhuesi i stofrave duhet të mendojë që, në rast se nuk blihen prodhimet që nxjerr për eksport, atëherë ekonomia jonë dëmtohet shumë. Këto stofra mund të mos blihen dot as brenda, për arsye se, duke u prodhuar me lëndë të parë më të shtrenjtë, do të kenë çmime më të larta.

Për sa i përket importit, përveç sa thashë më sipër, Ministria e Tregtisë të ketë parasysh që të mos importojë çfarë t'i jepet nga shitësi i huaj, por të marrë çfarë i nevojitet; të mos i blejë mallrat me atë çmim që i propozon shitësi i huaj, i cili bën shumë përpjekje për ta shitur mallin e tij me çmime të larta, por të luftojë për t'i blerë ato që nevojiten me çmime sa më të leverdishme për ne.

Tregu i huaj tash po kalon një krizë të thellë. Thu-

het se ka filluar superprodhimi dhe një papunësi e madhe. Punonjësit e tregtisë së jashtme t'i kenë parasysh këta faktorë për gjendjen brenda e jashtë vendit dhe jo të veprojnë vetëm «na e nëm».

Valutën duhet ta përdorim me nikoqirllëk të madh, pse kam pasur përshtypjen që deri tash nuk është vepruar kështu. Abdyll Këllezi, Kiço Ngjela, Lipe Nashi dhe të tjerë «bukuroshë» kanë përdorur shuma të konsiderueshme devize për të blerë lloj-lloj mallrash të panevojshme, që rrinë kot. Këto nuk duhet të ndodhin më në të ardhmen. Qeveria duhet të ketë nën kontrollin e vet të rreptë gjithë devizën, e cila të mos ndahet «ti ke kaq dhe ti ke aq». Deviza, pra, duhet të jetë në dorën e Qeverisë.

Furnizimin e popullit jo vetëm ta mbajmë në nivelin që është, por të luftojmë që ta përmirësojmë edhe më shumë. Mbajtja konstante e furnizimit duhet të konsiderohet si një veprim i përkohshëm, sa për të dalë nga vështirësitë që na krijuan sabotatorët.

Për sa u përket veprave që do të ndërtojmë, nuk jemi në shomazh¹, se kemi shumë për të ndërtuar, po mungesa e mundësive është ndjerë në drejtime të tjera, si në importimin e mallrave të ndryshme, prandaj duhet të mbështetemi kryesisht në forcat tona. Ne duhet të krijojmë mundësitë tona reale që nivelin e jetesës së popullit dhe forcat prodhuese të vendit tonë t'i ngremë e t'i zhvillojmë më tej vetë.

6. Për fuqinë punëtore:

Siç del nga raporti, edhe në vitin 1976 na krijohen

1. Nga frëngjishtja — papunësi.

forca të reja që do të hyjnë për herë të parë në punë. Ky është një problem i madh ekonomik dhe politik që duhet të na shqetësojë jo në mënyrë formale, por seriozisht, prandaj t'i gjejmë zgjidhjen e drejtë. Nuk mund të krijohen vende sa për t'u gjetur punë njerëzve, se kjo gjë me të drejtë është dënuar. Ne nuk mund t'i mbushim zyrat ose ndërmarrjet me punonjës pa qenë nevoja, por të orientojmë shumicën e njerëzve të pazënë në punë që të drejtohen në fshat. Jam dakord me mendimin që të mos tërheqim më forca pune nga fshati, përveç rasteve kur nuk do të jetë e mundur të zgjidhen ndryshe nevojat që krijohen. Rininë e qytetit ta dërgojmë të punojë në ndërtim, por në këtë sektor pune të mbahen aq të rinj sa ka nevojë dhe të tjerët t'i drejtojmë në bujqësi, t'i fiksojmë në fshat, t'i bindim që edhe ta bëjnë jetën atje e të martohen me të reja të qytetit që do të venë në fshat ose me të rejat e vetë fshatit. T'i mësojmë këta njerëz se fshati ynë do të popullohet, se ai ecën drejt rrugës së afrimit e barazimit me qytetin. Këtë besim të rinjve do t'ua sjellë aleanca midis fshatit dhe qytetit, aleancë kjo që nuk ekziston vetëm në diskure, por në punën konkrete, në vëllazërimin konkret.

Në këtë drejtim të luftojmë paragjykimet qoftë për djalin. qoftë për vajzën. Prindit i duket si një gjë e rëndë që vajza e tij e re, sapo mbaron shkollën, të shkojë në fshat dhe të marrohet atje. Është mentaliteti i vjetër që i bën prindërit të mendojnë sikur bija e tyre atje do të jetë pa mbrojtje, pa ndihmë, sikur asaj, duke mos qenë pranë tyre, do t'i shkelin nderin. Të gjitha këto koncepte duhen luftuar, duke i bindur njerëzit se

realiteti ynë në fshat nuk lejon shfaqje të tilla, se atje nuk ekzistojnë situata të kësaj natyre.

Jo vetëm vajzën, por edhe djalin mentaliteti i vjetër i njerëzve e do që prindërit t'i kenë në qytet, që djali apo vajza të punojë në torno, por jo larg syve, në bujqësi. Kjo ndodh se ata nuk e kuptojnë që këtë lidhje kaq të ngushtë në mes fshatit dhe qytetit e kërkon jeta jonë socialiste, se qyteti pa fshatin nuk mund të jetojë asnjë çast. Ne duhet të punojmë me njerëzit që ata ta kuptojnë këtë gjë, dhe, që ta kuptojnë mirë, t'u themi se buka, veza, mishi, gjalpi, perimet etj., që do të vijnë në qytet, do të na i japë fshati. Por, që ky fshat të prodhojë më shumë, më mirë dhe më lirë për veten e tij dhe për qytetin, ka nevojë për forca pune.

Këto kisha për të thënë, shokë. Unë kam besim se ky plan është real, prandaj të gjithë do të mobilizohen për realizimin e tij. Pa djersë dhe organizim, pa punë politike dhe ideologjike, të jemi të sigurt se plani nuk mund të arrihet si duhet. Të gjitha këto punë duhet të kombinohen në mënyrë të harmonishme dhe me frymë revolucionare. Në këtë frymë dhe me këto orientime ne duhet të hartojmë edhe planin e ardhshëm pesëvjeçar, domethënë planin edhe për katër vjetët e tjerë që na mbeten. të cilin do t'ia paraqesim globalisht Kongresit të ardhshëm të Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

NË DALLIMET NË NIVELIN E JETESËS SË PUNONJËSVE TË FSHATIT E TË QYTETIT TË ECIM DREJT MBYLLJES SË GËRSHËRËS

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

25 dhjetor 1975

Në përgjithësi, ashtu si edhe ju, shokë, jam dakord, si me studimin që ka bërë Qeveria, edhe me shumë vërejtje që u bënë këtu rreth këtij studimi. Unë fash mendoj të ngarkojmë prapë Qeverinë që të gjejë rrugën më të drejtë e më të përshtatshme për të bërë rregullimet përkatëse në bazë të këtyre vërejtjeve.

Tani dëshiroj të parashtroj edhe unë disa konsiderata për këtë studim.

Materialin «Analizë kritike mbi gjendjen e pagave dhe rrugët për një shpërndarje më të drejtë të fuqisë blerëse ndërmjet fshatit dhe qytetit», megjithëse mjaft voluminoz, dhe nuk mund të ishte ndryshe, u

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth studimeve të paraqitura nga Këshilli i Ministrave i RPSH për gjendjen e pagave dhe rrugët për një shpërndarje më të drejtë të fuqisë blerëse ndërmjet fshatit dhe qytetit.

përpoqa ta studioj dhe e gjej të drejtë studimin që është bërë e që do të na shërbejë, pavarësisht se aprovojmë variantin e dytë. Është pastaj çështja tjetër se çfarë mundësisht kemi dhe çfarë mund të na krijohen më vonë për të zbatuar si duhet në jetë një program kaq të gjerë dhe të domosdoshëm.

Vendimet që do të marrim duhet t'u përshtaten situatave të brendshme, ekonomike dhe politike, pa harruar perspektivën e zhvillimit tonë, por kurdoherë në kontekstin e ngjarjeve ndërkombëtare, të cilat nuk paraqiten të favorshme dhe nuk mund të mos i kemi parasysh. Lidhur me to ne duhet të parashikojmë çfarëdo të papritur. Pra, të krijojmë një situatë të shëndoshë politike brenda vendit tonë dhe rezerva materiale të mjaftueshme. Nga ana tjetër kërkohet një punë e gjerë partie për t'i kuptuar drejt masat që do të marrim dhe për t'u mobilizuar totalisht, në mënyrë që edhe me ndryshimin që mund të bëjmë duke vendosur rrogat e reja, të mund të përballojmë vazhdimisht e më mirë nivelin e jetesës së punonjësve.

Së pari, Partia dhe masat punonjëse të kuptojnë politikisht se vendi ynë, i rrethuar nga imperialistë e revizionistë, duhet të bëjë përpjekje të mëdha për të krijuar rezerva të shëndosha për çdo të papritur. Kjo do të arrihet në rast se kuptohet drejt dhe realizohet e tejkalohet plani ekonomik, në rast se bëhen kursime në të gjitha degët e ekonomisë dhe sidomos në disa çështje kyç të tyre, siç janë drithërat e bukës, lëndët djegëse, mineralet etj.

E dyta, Partia dhe punonjësit të kuptojnë se ndryshimi i nivelit të jetesës mes punonjësve të qytetit

dhe atyre të fshatit nuk duhet të qëndrojnë në vend si një formulë, por të ecë drejt mbylljes së gërshërës. Sipas studimit, po të ecet me ritmet e këtyre katër vjetëve të fundit, për ta bërë këtë, do të duhen 20 vjet. Varet nga zhvillimi i ekonomisë sonë që ky afat të shkurtohet apo të zgjatet. Dëshira dhe vullneti i Partisë e i popullit janë që kjo kohë të shkurtohet, por, natyrisht, duhet të ecim me vëmendje të madhe dhe të derdhim djersë.

E treta, Partia dhe punonjësit të kuptojnë se masat që po marrim nuk kanë për qëllim nivelimin e rrogave, pse kjo do të ishte gabim, por shkurtrimin e rrogave të larta. Unë jam dakord që ky shkurtrim të bëhet për rrogat mujore prej 900 lekësh e lart të nëpunësve, kurse pagat deri në 900 lekë në muaj të mos preken, por, ashtu siç thuhet në studim, në to të bëhen ndryshime shumë të vogla, disa rregullime të rasteve të veçanta të nevojshme për mënjanimin e barazimit të pagave dhe me qëllim që të zbatohen minimalja, mesatarja dhe maksimalja. Rrogat e tjera, të ulëta, edhe unë, siç u shprehën të gjithë të një mendimi, them të mos preken. Në qoftë se mund të ketë raste që këto të preken, të mos mendohet për t'i ulur, por për t'i ngritur. Krahas këtyre masave, duhet luftuar vazhdimisht që të krijohen kushte më të mira ekonomike në të ardhmen për gjithë popullin.

E katërta, përcaktimi i niveleve të jetesës: i minimumit jetësor për punonjësit e zënë në punë të lehtë, për ata që kryejnë punë të rënda, që, sigurisht, ka rezultuar nga një studim në përgjithësi i bazuar, na jep një ide ku mund të bazohemi si pikënisje në vendosjen

e shumë çështjeve që përmban studimi, si aktualisht, edhe për më vonë. Gjithashtu e ardhura mesatare normale, aq sa është parashikuar, është një tregues që na plotëson këtë horizont. Këto përcaktime të nivelit të jetesës në atë masë që thuhet në studim, duhet t'i konsiderojmë të arsyeshme për situatat aktuale që kalojmë ne dhe gjithë bota.

E pesta, Partia dhe punonjësit, me këtë vendim që do të marrim, të kuptojnë se pas 31 vjetësh çlirim, brenda mundësive, duhet të shpejtohen masat e përmirësimit të raporteve të jetesës mes fshatit dhe qytetit, duke pasur kurdoherë parasysh se ky është një kusht jetik për forcimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse kooperativiste dhe, në qoftë se nuk arrijmë dhe nuk do ta arrijmë dot brenda një kohe të shkurtër që t'i afrojmë këto diferenca, nëpunësit dhe klasa punëtore duhet të binden për një nevojë të tillë.

E gjashta, fshatarësia kooperativiste ta ndiejë veten të lidhur ngushtë me klasën punëtore dhe me punonjësit e qytetit dhe, në qoftë se po marrim e do të marrim masa favorizuese në dobi të saj, duhet të kuptojë se, siç kanë detyra të mëdha punonjësit e qytetit, edhe ajo ka detyra të mëdha për çështjen e mbrojtjes, për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës dhe për ngritjen e mirëqenies së masave të të gjithë republikës. Në këtë vështrim nuk është i drejtë mendimi, sipas të cilit «neve fshatarësisë duhet të na bëheshin këto favore, sepse jemi ne që e mbajmë qytetin me bukë», por të kuptohet dhe të mendohet drejt se socializmi dhe Partia na mësojnë që çdo masë e tillë, qoftë dhe sa-

krifika që bën qyteti për plotësimin e nevojave të fshatit, ka një kuptim të thellë politik, ideologjik dhe ekonomik dhe nuk e përjashton fshatarësinë nga të njëjtat detyrime. Këtë kuptim të dyja klasat duhet ta shikojnë drejt, në mënyrë që të mos ulen për asnjë grimë entuziazmi dhe hovi revolucionar në punë për të krijuar një mirëqenie akoma më të lartë nga sa e kemi arritur dhe paga reale e gjithë punonjësve, të qytetit dhe të fshatit, të mos ngrihet me operacione administrative e burokratike, por me shtimin e prodhimit në të gjithë sektorët, me ngritjen e cilësisë së prodhimit, me uljen e çmimeve të mallrave ushqimore dhe industriale e me krijimin e rezervave. Të gjitha këto do të ndikojnë në uljen e çmimeve. Kjo është një rrugë për të cilën duhet të luftojmë që nga ky operacion i domosdoshëm që po bëjmë, jo vetëm të mos ketë ndonjë pasojë negative, por edhe të krijohen premisa të tilla politike dhe ideologjike që hovi revolucionar i masave të ngjitet e të realizohen këto qëllime të mëdha.

Edhe unë mendoj që, ashtu siç është thënë në studim, siç jeni edhe ju të gjithë dakord, me këto masa që po marrim të preken, në radhë të parë, ata që marrin rroga mbi 900 lekë e lart në muaj, shumica e të cilëve janë nëpunës. Te këta nuk duhet të krijohet asnjë pakënaqësi, në qoftë se mendojnë drejt politikisht e ideologjikisht dhe kuptojnë situatat që thamë më lart, në qoftë se kuptojnë që të ardhurat reale për frymë të popullsisë së qytetit janë 30 për qind më të larta nga ato të fshatit, gjë që shkaktohet nga diferenca e pagave dhe nga ndarja e fondit shoqëror të konsumit.

Kur u hedhim një sy tabelave të paraqitura dhe bëjmë krahasimin mes pagave mesatare të punëtorëve të zënë me punë në të gjithë sektorët ekonomikë shtetërorë dhe pagave të drejtorëve në ministri e të atyre në funksion të barabartë me ta, siç janë specialistët, pedagogët dhe punonjësit me tituj shkencorë, shikojmë se pagat e këtyre nëpunësve i kapërcejnë në përqindje shumë të madhe pagat mesatare të punëtorëve. Nga ana tjetër, kur e krahasojmë këtë mesatare me të ardhurat mesatare të një kooperativisti, duke përfshirë këto edhe të ardhurat e oborrit, në të gjitha kategoritë e kooperativave, fushore, kodrinore etj., del se të ardhurat e këtyre të fundit janë nën këtë mesatare. Prandaj është e logjikshme dhe e drejtë që të bëhet një ndryshim. Këtë e lypin ligjet e diktaturës sonë, mësimet e Leninit dhe eksperiencia konkrete e luftës së Partisë sonë.

Ne e shikojmë, dhe këtë e kemi theksuar edhe herë tjetër, se qoftë klasa punëtore, qoftë fshatarësia, në këtë bilanc, në pagë, pra, edhe në jetesë, janë më pak të favorizuara se nëpunësit. Të dyja këto klasa bëjnë punë shumë më të rënda, më të lodhshme dhe, me gjithë këto masa që mund të marrim, ne nuk bëjmë nivelime, përkundrazi, ngushtojmë raportin, gjë që është e domosdoshme dhe e drejtë politikisht e ideologjikisht, përderisa ecim e do të ecim në rrugën e Leninit dhe në atë të Komunës së Parisit. Niveli i jetesës së kësaj kategorie nëpunësish, rrogat e të cilëve do të preken, qëndron përsëri mbi nivelin mesatar të jetesës. Prandaj këtë çështje në të ardhmen duhet ta shikojmë prapë.

Jam gjithashtu dakord të rregullohen disa anomali dhe shpërpjesëtime që janë të pajustificuara dhe që më parë kanë mbetur jashtë analizës e shikimit kritik. Këto figurojnë në studimin e paraqitur dhe nuk do t'i përsëris, pse edhe shumë nga shokët i ngritën në diskutimet e tyre. Prandaj të gjitha këto Qeveria t'i ketë parasysh dhe të marrë vendimet përkatëse.

Pra, nga vendimi që po marrim për shkurtimet dhe rregullimet e rrogave, do të preken një numër nëpunësish. Të kemi kurdoherë parasysh që, me masat që do të vendosim, të mos krijojmë pakënaqësi, pra, të bëjmë diçka të drejtë dhe të arsyeshme që të pranohet, pa ulur entuziazmin në punë dhe besimin se me punë kjo ulje e pagave të larta do të plotësohet përsëri, do të kompensohet me shtimin e prodhimit, me mosngritjen e çmimeve ose me uljen e tyre, pra, me ngritjen e pagës reale.

Jam gjithashtu i mendimit se duhet të bëhet një dallim midis specialistëve me arsim të lartë dhe të mesëm, që dalin për herë të parë në punë, dhe kategorive të tjera të një rangu. Këta mendoj të kenë një pagë më të ulët nga ajo e punëtorëve më të kualifikuar të degës përkatëse, por kjo diferencë, mendoj unë, me punë, me kualifikim dhe në një kohë pak a shumë të shkurtër, duhet të ndreqet dhe të mos qëndrojë e përhershme. Kjo kohë mund të jetë 4 vjet, si tha shoku Xhafer [Spahiu]¹, por ne mund ta arrijmë edhe më parë. Jam gjithashtu dakord që ky kriter të zba-

1. Në atë kohë zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH.

tohet në vitin 1976 për ata që dalin rishtazi në punë dhe jo për ata që kanë dalë deri tani, për të cilët të ruhet paga që kanë, ndryshe pastaj do të na krijohet anomali.

Jam dakord që edhe problemi i specialistëve me arsim të lartë, kur fillojnë punën në miniera, të zgjidhet. Këta të mos kenë paga më të ulëta nga ato të punëtorëve të kualifikuar. Po ashtu është e drejtë që specialistët me arsim të lartë e të mesëm që punojnë nëpër ndërmarrje dhe në aparatet e komiteteve ekzekutive të mos marrin paga më të larta se kolegët e tyre që punojnë në prodhim. Prandaj, pasi të miratohet kjo, të bëhet caktimi i pagave fikse në tri kategori, duke hequr kufijtë minimalë dhe maksimalë dhe kjo të bëhet në bazë të atestimit kulturor-profesional brenda minimale e maksimale dhe pagave të sotme, një pjesë e të cilave (të atyre që janë mbi 900 lekë) do të ulet, ashtu siç do të ndodhë edhe me kategorizimin e vendit të punës me punëtorët.

Nuk do të hyj në detaje lidhur me shkurtimet dhe me kategorizimet që bëhen, por jam dakord me tabelat e pagave të larta e të mesme të nëpunësve për disa detyra dhe funksione kryesore që paraqiten sipas projektit të ri. Ata që i kanë ndërtuar këto tabela janë specialistë, i kanë krahasuar dhe besoj se në përgjithësi janë të drejta e në përshtatje me këto situata politike të brendshme dhe të jashtme. Janë po ashtu të arsyeshme propozimet që bëhen në variantin për Ministrinë e Mbrojtjes Popullore për çështjen e uljes së pensioneve të larta të vjetërsisë së shërbimit që marrin

sot ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore dhe ata të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Për sa u përket honorareve dhe shpërblimeve për të drejtën e autorit, nuk duhet pranuar propozimi i ardhur nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve që këto të hiqen krejtësisht. Unë jam i një mendimi me ju që ato të ulen, siç është bërë dhe propozimi, në një masë 30 deri në 50 për qind, dhe të forcohet kriteri i dhënies së tyre. Të kihet parasysh që kjo përqindje uljeje të mos e disfavorizojë shkrimtarin ose artistin në raport me punonjësit e tjerë të barazuar në një rang me ta. Në qoftë se kjo përqindje gjendet e arsyeshme, atëherë të pranohet.

Po ashtu mendoj të mos ulen pagat e punëtorëve të mekanizimeve, të sondatorëve dhe të të gjithë atyre që punojnë në pajisjet që janë nën presion, si dhe të mos hiqen shtesat mbi pagën e shoferëve të automjeteve të rënda, të punëtorëve të fabrikave të qelqit etj. Jam dakord që në fabrikat e qelqit të përfitojnë vetëm ata që punojnë me frymë dhe që kanë një punë shumë të rëndë, të tjerët të shihen me kujdes dhe jo të futen të tërë në një rang.

Gjithashtu të mos ketë kufizim në asnjë degë për shpërblime për tejkalimin e normave, për arsye parimi, siç shtrohet në studim, por, natyrisht, të punohet për vendosjen e normave teknike dhe herë pas here të bëhen kontrole dhe analiza që të mos tejkalohen normat në kurriz të cilësisë e të lëndëve të para deficitare. Unë jam dakord me të gjitha propozimet që u bënë, por për shumë prej tyre lypset të bëhen studime.

Çështja e pagës së punonjësve pedagogjikë e shken-

corë joefektivë, për të cilët në studimin e dytë thuhet se duhet të shpërblehen kur japin mësim brenda orëve të punës, mua më duket se është diçka që duhet diskutuar. Në këtë drejtim duhet parë edhe ajo që u ngrit këtu, që është e drejtë, se ka edhe nga ata pedagogë që e përgatitin një herë një leksion dhe e mbajnë atë 5 vjet me radhë pa i bërë ndryshime.

Jam dakord që maksimalja e pensionit të qëndrojë 700 lekë në muaj dhe në varësi me këtë të caktohet edhe pensioni maksimal për vjetërsi shërbimi.

Shpërblimi për familjet e heronjve të popullit dhe të atyre të punës socialiste mendoj të mos ndryshojë.

Vendosja e shpërblimeve të diferencuara për punën me norma teknike duhet të bëhet dhe të vazhdohet. Jam dakord me atë që thuhet në studim për këtë, sepse kjo do të bëjë që normat teknike të zgjerohen.

Për sa i përket ngritjes së pagave të punëtorëve në ndërmarrjet bujqësore, mendoj që këto t'i lidhim me prodhimin dhe jo vetëm me realizimin e normave. Për të bërë një gjë të tillë mund të zbatojmë rrugën që ndjekim në kooperativat bujqësore.

Në përgjithësi jam dakord me pasqyrat e pagave të punonjësve të aparateve dhe të institucioneve të Partisë, të organizatave të masave dhe të shtypit, të cilat duhet të barazohen, pa kurrfarë favorizimi, me pagat analoge të sektorit shtetëror, por edhe të harmonizohen drejt brendapërbrenda këtyre aparateve. Në qoftë se ka ndonjë ndryshim për të bërë në këto tabela, unë do të jem dakord me ato më të arsyeshmet. Specialist nuk jam, por them se, në përgjithësi, dhe kjo ka qenë rregull, në udhëheqje të Partisë në rrethe dhe

në aparatin e Komitetit Qendror kemi synuar e duhet të synojmë që të sjellim nga kuadrot më të mirë, që të kenë edhe besimin politik, ngritjen ideologjike dhe arsimin, por të jenë edhe specialistë e teknikë të zotë. Prandaj edhe në qoftë se në ndonjë rast mund të ketë ndonjëfarë ndryshimi në pagë, kjo mund të jetë deri diku e lejueshme, por, në përgjithësi, mendoj se ndryshim të madh nuk duhet të ketë.

Për shpërndarjen e fuqisë blerëse dhe për masat favorizuese në drejtim të fshatit mendoj të ndjekim këtë parim: mirëqenia në fshat duhet të vijë me shtimin e prodhimit dhe të mos krijohet artificialisht ngritja e nivelit të jetesës nëpërmjet ngritjes së çmimeve të blerjes sidomos të drithërave, të patates, të fasules, të ullirit etj. Ngritja e këtyre çmimeve është thikë me dy presa: mund edhe ta inkurajojë fshatarësinë që të prodhojë më shumë, se do të ketë më tepër të ardhura, por edhe mund të mos e nxitë drejt një prodhimi më të madh. Rreziku i të kënaqurit me pak, duke marrë parasysh diferencën kolosale të së kaluarës me të sotmen, na ka ngjarë dhe mund të na ngjasë prapë. Një veprimtari e tillë, ngritja e çmimeve për disa prodhime, mund të na krijojë tash edhe disa disbalancime buxhetore dhe në furnizimin e popullatës, për arsye se prodhimet do të shtohen shumë, të ardhurat e kooperativistëve do të rriten, atëherë ka rrezik të ngrihet edhe fondi i pagave.

Përveç kësaj, prodhimet bujqësore në fjalë mund të «emigrojnë» nga fusha në kodra e në male për t'u shitur me çmime më të larta, prandaj ekzistenca e dy çmimeve, sidomos për bukën, mund të jetë e rrezik-

shme, pasi në rast mosrealizimi të planeve mund të na krijohen probleme të inflacionit etj. Prandaj duhet të jemi të matur në këtë çështje dhe në këto situata. Por, siç paraqitet në studim, ne mund ta çlirojmë fshatarësinë nga shumë pagesa dhe shpenzime si, për shembull, për ato shoqërore e kulturore, të cilat në qytet përballohen tërësisht nga shteti, gjë që duhet të bëhet edhe për fshatin. Shteti t'i paguajë edhe në fshat mamitë, infermieret, edukatorët e kopshteve dhe kujdestaret e çerdheve të fëmijëve, punonjësit e kulturës në qendër të kooperativës bujqësore të bashkuar. Mundet që edhe diferenca e vlerës së ushqimit, që nuk e paguajnë kooperativistët për fëmijët që kanë në kopshte e në çerdhe, të barazohet me normën e fëmijëve në qytete, domethënë, shteti të paguajë gjysmën e asaj që paguan sot kooperativa. Edhe këtë ta shikojë Qeveria, që ose të mos paguajnë kooperativistët, ose të shihet çfarë lehtësie mund t'u bëhet. Të çlirohen kooperativat, gjithashtu, nga shpenzimet për transportin lidhur me lëvizjen e karburanteve, për ruajtjen e tyre dhe të makinerive të SMT-së. Të gjitha këto shpenzime t'i marrë përsipër SMT-ja. Po ashtu, shteti të marrë përsipër edhe në fshat investimet për shkollat dhe kopshtet e fëmijëve, për shtëpitë e kulturës dhe për objektet shëndetësore në qendër të kooperativës.

Fshatarësia, natyrisht, në këto çështje do të japë kontributin e saj me materiale dhe me forca, me punë vullnetare. Shteti do të vazhdojë të ndërtojë rrugët, ujësjellësit, rrjetin elektrik të brendshëm në fshat dhe të marrë përsipër që t'i mirëmbajë ata. Mund të bëj-

më edhe diçka tjetër, sidomos të ulim çmimin e shitjes së plehrave kimike.

Dëshiroj të shtoj edhe diçka për shpërndarjen e prodhimeve. Natyrisht, shpërndarja e tyre nuk duhet të bëhet në mënyrë mekanike, por as edhe me ato ndryshime të theksuara siç bëhet aktualisht. E kam fjalën sidomos për furnizimin e fshatit me prodhime industriale e bujqësore. Për sa u përket prodhimeve industriale, mendoj se as për qytetin dhe as për fshatin nuk duhet të lejojmë teprime. Siç kam marrë vesh, kërkohen fshesa me korent. Por në radhë të parë popullit t'i sigurojmë fshesat e zakonshme, që gati janë zhdukur nga tregu, për shkak të neglizhencave të industrisë së lehtë dhe të bujqësisë. Prandaj çdo pririje për të kërkuar mallra importi duhet ta luftojmë jo vetëm me propagandë, por edhe me tregun tonë, si në qytet, edhe në fshat. Gjithashtu të luftojmë që fabrikat tona të prodhojnë mallra të lira, të mira e të forta, të krijojmë guston e shëndoshë socialiste dhe jo të nxitim tekat mikroborgjeze të disa njerëzve, duke sjellë, siç është bërë deri tani, vetëm stofra të kushtueshme për burra e gra.

Çështje tjetër është se qyteti ka qenë i favorizuar në krahasim me fshatin, sidomos me yndyrna, me sheqer, me mish dhe me ndonjë artikull tjetër blegtoral. Këtë situatë nuk duhet ta lejojmë. Është e vërtetë se varet nga fshatarësia që t'i kemi këto prodhime në një sasi më të madhe dhe atëherë do të përmirësohet edhe furnizimi i fshatit dhe do të mbajmë në nivelin e duhur edhe furnizimin e qytetit, por edhe me këtë sasi prodhimi që krijohet, qyteti nuk duhet të jetë më i favorizuar

ar. Proporcionet ne duhet t'i ndreqim dhe të luftojmë që, me rritjen e prodhimit të brendshëm, të ngremë nivelin e furnizimit të të gjithë popullit me sendet ushqimore e industriale dhe veçanërisht të fshatit me ata artikuj ushqimorë që përmenda më lart.

Mendoj gjithashtu që kooperativave bujqësore të zonave malore dhe gjysmëmalore t'u japim ndihmë me investime për hapje tokash të reja, për përgatitje kullotash, për rregullime tarracash, për ujitje, por të mos i mësojmë njerëzit atje që të ngrenë nivelin e tyre të jetesës pa iu përveshur si duhet punës për të organizuar më mirë bujqësinë, blegtorinë dhe degët e tjera të ekonomive kooperativiste që u sjellin të ardhura. Këtë e them se konstatohet që në kooperativat malore dhe kodrinore kemi dy lloje shfaqjesh: ka nga ato kooperativa që sigurojnë të ardhura të larta për ditë-punë, dhe këtë e bëjnë se kanë organizim të mirë dhe punojnë; po ka edhe të tjera që, megjithëse në të njëjtat kushte, marrin shumë pak të ardhura. Atëherë ne duhet t'u bëjmë atyre favore që të ngrenë ekonominë, por jo të atilla favore që të vazhdojnë plogështinë. Kjo në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar, mendoj unë. Deri tash këtyre kooperativave u kemi bërë mjaft favore. Të qëndrojmë në ato që përmenda më lart, edhe në ato që u kemi bërë përpara. Kooperativat malore, duke mos harruar traditën e vjetër, kanë mundësi të mbajnë dhe të rritin bagëti të imëta (pavarësisht se atje janë hapur shumë toka të reja gjatë kësaj periudhe). Në malësi ekzistojnë akoma mundësi kolosale për kullota, por këto mundësi nuk shfrytëzohen. Nuk shfrytëzohen bile as për bagëti personale, të cilat mund të bashkohen

dhe kooperativistët të krijojnë kushte për shtimin e ushqimit të këtyre bagëtive me foragjere, pasi, më duket mua, u kemi lënë tokë të mjaftueshme për kullota, dhe jo të drejtohen në arat e kooperativës për të kullotur bagëtitë e oborreve. Por konstatohet se rendimentet e foragjereve janë jashtëzakonisht të ulëta, pasi nuk bëhen përpjekje për rritjen e tyre dhe sepse vazhdon të ekzistojë mentaliteti i ekstensivitetit.

Me këto masa, mendoj unë, në përgjithësi mund të përmirësohet situata. Natyrisht, na vihet detyrë të mos krijohet asnjë pakënaqësi, por edhe këtu duhet të veprojnë propaganda dhe puna sqaruese e Partisë, që duhet të lozin rol të madh, por, në radhë të parë, të determinojë puna për krijimin e shtimit e të mirave materiale. Puna e njerëzve dhe udhëheqja e drejtë e Partisë duhet të krijojnë një situatë të atillë ekonomike që ky rregullim i drejtë, që na imponohet dhe që bëhet në këtë situatë, të jetë i pranueshëm dhe masat e popullit të mos ndiejnë asnjë mungesë malli, asnjë ngritje çmimi; jeta e tyre të jetë e stabilizuar, bile të ecet në ngjitje, çka do të thotë që paga reale e punonjësve të rritet.

Vendimi që po marrim për këtë problem, propozoj të hyjë në fuqi në fund të tremujorit të parë të vitit të ardhshëm, për dy arsye: së pari, se në atë kohë në treg do të kemi me shumicë prodhime bujqësore e blegtorale dhe, së dyti, që këta tre muaj që mbeten t'i përdorim për një punë sqaruese dhe propagandë, sigurisht jo zyrtare, por të bëjmë një punë të gjallë e kokë më kokë me njerëzit, me qëllim që kjo çështje të mos u bjerë papandehur, të përgatiten shpirtërisht

ata që preken dhe të mos krijohet asnjë shqetësim për ata dhe për të tjerët që nuk preken.

Jam i bindur se të gjithë jemi dakord dhe nuk kemi asnjë kundërshtim për këto masa. E përsëris edhe një herë që për të gjitha ato që u ngritën në këtë mbledhje të Byrosë Politike për të bërë disa rregullime, të ngarkojmë Qeverinë t'i rishikojë dhe, në frymën e tyre, të vendosë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

ORGANET E PROKURORISË DHE TË HETUESISË TË QENDROJNË NË LARTËSINË E DETYRAVE

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit
Popullor të RPSH¹*

27 dhjetor 1975

Partia u ka ngarkuar organeve të Prokurorisë misionin e rëndësishëm të mbikëqyrjes për zbatimin e përpiktë e të njëlojtë të ligjeve nga institucionet, ndërmarrjet, organizatat, nëpunësit dhe shtetasit. Roli i Prokurorisë, si organ i Kuvendit Popullor, duhet të forcohet akoma më tej në shumë drejtime e jo vetëm në kontrollin mbi ligjshmërinë në hetime. Pikërisht për këtë arsye Byroja Politike, para dy vjetësh, mori vendimin për forcimin e rolit të Prokurorisë dhe përqendrimin e Hetuesisë në organet e Punëve të Brendshme².

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth kontrollit të prokurorit mbi ligjshmërinë në hetime dhe në drejtime të tjera.

2. Ky vendim, që u mor në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, më 21 dhjetor 1973, ishte në atë kohë një masë e drejtë për revolucionarizimin e organeve të Prokurorisë dhe për rritjen e efektivitetit të hetimit, të zbulimit dhe të parandalimit të veprave penale. Por vendimi u sabotua nga armiqtë

Përgjithësisht organet e Prokurorisë e kanë rritur cilësinë e ndihmës dhe të kontrollit për zbatimin e ligjshmërisë nga organet e hetimit. Edhe organet hetimore, gjithashtu, pas riorganizimit dhe përqendrimit të tyre në organet e Punëve të Brendshme, megjithë mungesën e eksperiencës për hetimin e disa krimeve, që i hetonte më parë Prokuroria, kanë arritur suksese. Mbi bazën e eksperiencës që është fituar, të sukseseve që janë arritur dhe të përpjekjeve që bëhen për kualifikimin e hetuesve, në të ardhmen do të ngrihet më tej niveli i punës hetimore.

Kontrolli i prokurorit mbi ligjshmërinë në hetime mendoj që synon të plotësojë dy qëllime: Së pari, të sigurojë efektivitetin e luftës kundër kriminalitetit në mënyrë të tillë që asnjë fajtor të mos ketë mundësi t'i shmanget përgjegjësisë penale dhe, së dyti, të sigurojë respektimin e përpiktë të të drejtave ligjore të shtetasve në procesin hetimor, në mënyrë që asnjë i pafajshëm të mos i nënshtrohet përgjegjësisë ligjore.

Këto dy qëllime që ndjek prokuroria në punën e saj për ushtrimin e kontrollit mbi ligjshmërinë në hetime nuk duhen interpretuar si kërkesa formale të kodit

e kamufluar të Partisë e të popullit K. Hazbiu e F. Shehu që drejtonin Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ata e kthyen Hetuesinë në shtojcë të sektorit operativ dhe dëmtuan politikën e Partisë. Duke parë se praktika e përqendrimit të Hetuesisë në MPB krijonte edhe rreziqe në vazhdimësi për hetimet e plota, të gjithanshme e objektive, Byroja Politike e KQ të PPSH, në mbledhjen e saj të datës 8 qershor 1983, vendosi që Hetuesia të riorganizohet, të ndahet nga organet e Punëve të Brendshme dhe të veprojë si organ më vete, nën varësinë e Kuvendit Popullor.

të procedurës penale, por duhen zbërthyer e kuptuar, në radhë të parë, nga ana politike dhe duhen vlerësuar si shfaqje të demokracisë sonë thellësisht socialiste.

Në raport, me të drejtë, kritikohen raste të fillimit të çështjeve penale dhe të marrjes së shtetasve si të pandehur edhe atëherë kur nuk është kryer ndonjë krim, kur ligji përjashton përgjegjësinë penale etj. Dhe këto raste nuk janë pak. Nga çështjet penale të filluara nga Hetuesia, më pak se gjysma i janë dërguar gjyqit. Unë jam dakord me atë që thuhet në raportin e paraqitur. që këto shkelje kanë ndodhur për arsye se nga ana e hetuesve nuk janë studiuar e nuk janë verifikuar me kujdes materialet e denoncuara dhe se nga ana e organeve të Prokurorisë nuk është ushtruar kontrolli i duhur e nuk është dhënë ndihma e nevojshme që në kohën e fillimit të çështjes. Nga këto neglizhencat kanë ardhur si pasojë jo vetëm harxhimi pa vend i kohës së punës të hetuesve dhe shkëputja pa arsye e shumë dëshmitarëve nga fronti i prodhimit, por edhe procedimi i nxituar dhe në kundërshtim me ligjin i mjaft shtetasve, që janë marrë të pandehur nga Hetuesia.

Unë e kuptoj, shokë, se nuk është e thënë që çdo rast për të cilin fillohet çështja penale, ose çdo shtetas që merret i pandehur në Hetuesi, duhet të përfundojë doemos në gjyq, por shifrat e paraqitura në raport tregojnë për veprime të pakujdesshme, bile nganjëherë edhe pa përgjegjësi, të disa hetuesve. Si fillimi pa bazë i çështjeve penale, ashtu dhe refuzimi pa arsye i ndjekjes së tyre kur baza ligjore ekziston dhe materiali i denoncuar është i mjaftueshëm, duhen shmangur sa të jetë e mundur më shumë.

Masa e arrestimit duhet zbatuar drejt dhe me efekt, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe me kriteret e përcaktuara për zbatimin e tij. Në çdo vendim për arrestim, veç të tjerave, të kihen parasysh interesat shtetërorë të goditjes së elementit armik e keqbërës që kryen krime të rënda, prirja që ka dinamika e kriminalitetit në shkallë republike apo rrethi dhe shkalla e zhvillimit të luftës së klasave në një periudhë kohe të caktuar. Në zgjedhjen e kësaj mase personi zyrtar kompetent që bën propozimin dhe ai që duhet të vendosë, lypset të gjykojnë me përgjegjësi, drejt e me pjekuri, të vlerësojnë objektivisht, nga pozitat e Partisë, masën e arrestimit dhe nevojën për marrjen e saj. Përgjithësisht në praktikë kështu është vepruar, por në këtë drejtim ka vend edhe për kritikë. Nxitimi apo ngurrimi për vendosjen e masës së arrestimit janë të dëmshëm dhe kundër ligjit, prandaj të bëhen përpjekje kundër teprimeve dhe lëshimeve që nganjëherë vërehen në politikën e arrestimeve. Në këtë drejtim, si organet e hetimit, edhe ato të Prokurorisë të qëndrojnë në lartësinë e detyrave, me qëllim që arrestimi të përdoret në përputhje me kërkesat e ligjit dhe me efikasitet.

Për sa i përket respektimit të afateve në hetime dhe të dispozitave të tjera me karakter procedural, që sigurojnë të drejtat ligjore të të pandehurve dhe personave të tjerë pjesëmarrës në gjykimin penal, ne duhet të jemi të interesuar. Mua më duket që ky problem ka rëndësi. Nëpërmjet respektimit të afateve dhe formës procedurale në hetim sigurohen demokracia e hetimit dhe zbulimi i së vërtetës, për të cilën janë

shumë të interesuar Partia dhe shteti ynë socialist. Prandaj duhet kritikuar mentaliteti i ndonjë hetuesi apo prokurori që mendon se s'ka qeder kur shkelen normat proceduriale. Në këtë drejtim le të kujtojnë shokët fjalët e Marksit që thoshte se procedura dhe e drejta janë të lidhura kaq ngushtë njëra me tjetrën sa, për shembull, format e bimëve janë të lidhura me bimët, kurse format e kafshëve me mishin dhe me gjakun e kafshëve. Nuk mund të pretendohet se zbatohet drejt Kodi Penal, duke u shkelur normat e procedurës, që janë ligje të vendosura nga pushteti popullor, dhe, si të tilla, duhen respektuar detyrimisht nga hetuesit, nga prokurorët dhe nga gjyqtarët.

Në qoftë se në kodin e procedurës penale ka dispozita që parashikojnë formalitete të tepruara e burokratike, gjë që unë nuk e përjashtoj, le të bëhen propozime për ndryshimin e tyre në rrugë legjislative, siç na mëson Lenini, por jo të vendosë hetuesi, prokurori apo gjyqtari për shkeljen e tyre, se këta nuk kanë të drejtë të shfuqizojnë ligjin. U zgjata ca për rëndësinë e normave proceduriale, se mua më duket që pikërisht në nënvleftësimin e tyre duhen kërkuar disa shfaqje negative që përmenden në raport, siç janë, për shembull, moszbatimi nga ana e hetuesve i udhëzimeve të prokurorit apo të gjykatës kur u bëhen vërejtje për hetimin dhe u kthehen çështjet për rihetim, mungesat në verifikimin e pretendimeve të të akuzuarve, mosnjohja e tyre me materialet në ngarkim kur përfundojnë hetimet etj.

Unë kam respekt për punën e ndershme, të lodhshme e me shumë përgjegjësi të hetuesve tanë, por dua

të bëj një vërejtje. Më kanë thënë se ka raste që ndonjëri prej tyre, sidomos kur nuk është shumë i aftë të zbulojë mjaft nga provat në favor të akuzës, ngul këmbë në marrjen doemos të pohimit të të akuzuarit. Pohimi i të pandehurit ka rëndësinë e vet si provë, ai nuk duhet nënvlerësuar, por është një nga llojet e provave, siç janë edhe thëniet e dëshmitarëve, dokumentet me shkrim etj. Te ne, për shumë arsye, është hedhur poshtë si i padrejtë koncepti i vjetër i të huajve që pohimi i të akuzuarit është «mbret i provave». Unë besoj se të tërë hetuesit e dinë këtë gjë, por ata duhet të përpiqen që njohuritë e tyre t'i zbatojnë në jetë, në praktikën e hetimit të çështjeve. Duke ngulur këmbë në pohimin e të akuzuarit, ka rrezik të nënvlerësohen provat e tjera, të shkelen rregullat e hetimit dhe të varet fati i çështjes vetëm në ato që thotë i pandehuri. Por fati i çështjes nuk duhet lënë në dorën e të pandehurit.

Kam edhe një vërejtje tjetër për një çështje që më ra në sy gjatë leximit të raportit, në pjesën ku thuhet se, duke mos i dërguar të tërë të pandehurit të arrestuar në gjyq, «i lihet edhe gjykatës një fushë më e gjerë për të caktuar, veç heqjes së lirisë, edhe lloje të tjera dënimi nga ato të parashikuara në ligj». Ky mendim nuk më duket i drejtë dhe nuk e di nëse është një shprehje që ka kaluar rastësisht, apo është një koncept i rrënjosur. Në caktimin e llojit të dënimit gjykatës, si organ shtetëror i zgjedhur nga populli, merr parasysh shkallën e rrezikshmërisë së krimit, të personit dhe shkallën e fajit, si dhe rrethanat rënduese e lehtësuese, por kujtoj se ajo nuk është e detyruar të zbatojë doemos llojin e masës që ka marrë Hetuesia. E

theksoj këtë anë të çështjes, sepse më duket që ka rëndësi parimore.

Për sa i përket rastit të heqjes nga dosja dhe të falsifikimit të dokumenteve me rëndësi procedurale nga tre hetues të pandërgjegjshëm, është vepruar mirë që janë ndëshkuar. Hetues të tillë nuk e meritojnë besimin që u është dhënë. Falsifikimi i proceseve hetimore e gjyqësore është karakteristikë e borgjezisë dhe e revizionistëve, prandaj shfaqje të tilla, që mund të ketë ndonjë hetues, të ndalohen menjëherë dhe atij t'i tregohet vendi.

Prokurori ka të drejtë dhe detyrë të mbikëqyrë respektimin e ligjit dhe të rregullave në vendet e vuajtjes së dënimit. Të dënuarit me heqje të lirisë janë të detyruar të respektojnë me përpikëri rregullat e vendosura në vendet e vuajtjes së dënimit, por ata gëzojnë plotësisht edhe të drejtat që u njohin këto rregulla. Në këtë drejtim ka dhe ndonjë shkelje. Përveç sa thuhet në raport, ka pasur raste që të dënuar me heqje lirie më janë drejtuar edhe mua me letra për shkeljen e rregullave dhe unë, natyrisht, kam porositur organet shtetërore kompetente që të respektohen normat e vendosura.

Në raportin e Prokurorisë thuhet që ankesat e të dënuarve janë zgjidhur në vend dhe janë marrë masat e nevojshme për të zbatuar kërkesat e rregullores për të drejtat e të dënuarve. Është një gjë e mirë kur njihet gabimi dhe riparohet, por është shumë më mirë kur nuk gabohet ose gabohet shumë pak, prandaj të tregohet më tepër kujdes për respektimin e rregullave, qoftë për detyrimet, qoftë për të drejtat e të dënuarve.

Unë e di se në këtë drejtim ne nuk kemi probleme shqetësuese, por kjo nuk do të thotë që të lejohet sadopak shkelja e rregullave që janë vendosur. Në këtë drejtim edhe kontrolli i Prokurorisë të jetë më efikas.

Jam dakord me detyrat që vihen në raport për zhdukjen e të metave që vërchen në punë, për rritjen e cilësisë dhe të thellësisë së kontrollit të prokurorit dhe për ngritjen e nivelit ideopolitik e profesional të punonjësve të Prokurorisë e të Hetuesisë.

Këto ishin disa mendime dhe ndonjë vërejtje që kisha rreth problemeve të trajtuara në raportin e Prokurorisë së Përgjithshme.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Presi-
diumit të Kuvendit Popullor,
që gjendet në AQP*

ZIGZAGET E VIJËS KINEZE

Shënime

1 janar 1976

Kam shkruar edhe herë të tjera se ç'mendoj për vijën e Partisë Komuniste të Kinës dhe lidhur me të kam dhënë mendime për shumë çështje dhe probleme të politikës kombëtare e ndërkombëtare të saj, ashtu si i kam gjykuar unë këto ngjarje (e natyrisht sa kam mundur), në prizmin e teorisë sonë marksiste-leniniste. Kam dhënë mendime për të gjitha ngjarjet kryesore që vërtetoheshin në Kinë e për rrugën politiko-ideologjike që merrnin ato. Brenda mundësive, që më jepeshin nëpërmjet informacioneve për këto ngjarje, jam përpjekur t'i kuptoj dhe t'i interpretoj ato, në radhë të parë, në prizmin e vijës së Partisë sonë, por edhe të koniunkturave ndërkombëtare, duke thënë se këto qëndrime jokorrekte të Kinës ishin, sipas mendimit tim, të përkohshme dhe të detyruara nga rrethanat e brendshme e të jashtme, si një shtet i madh që ishte. Por, pavarësisht nga këto rrethana, gabimet në vijë të Partisë Komuniste të Kinës i kam cilësuar gabime, kurdoherë duke pasur shpresë se do të ndreqeshin me kapërcimin e situatave të vështira nëpër të cilat kalonte Kina.

Një diçka tjetër, që mund të të çojë në një gjykim

të gabuar të vijës kineze, është fshehtësia e madhe në të cilën mbahen ngjarjet. Udhëheqësit kinezë këto ngjarje i fshehin me xhelozinë më të madhe, dhe, kur diçka shpallet, prapë ajo është e cunguar, jo e qartë, shumë herë e pakuptueshme dhe e habitshme! «Shpjegimi» për ndonjë ngjarje (e kam fjalën për ngjarje me rëndësi) vjen papritur dhe kjo proklamohet si «vija e përsosur» me vite të tëra; pastaj për një a dy vjet me radhë flitet me aluzione, më vonë deklarohet «hapur» se ka qenë reaksionare. Por «hapur» i thëncin, sepse, pas një kohe prej dy ose tre vjetësh që «është folur hapur» për gabimet dhe për njerëzit që kanë gabuar, deklarohet se «gabimet u ndreqën dhe njerëzit u rehabilituan». Kjo tregon një lëkundshmëri të madhe në vijë, në ide, në qëndrime dhe në veprime, e cila është si lavjerrësi i orës që lëkundet djathtas dhe majtas, pra një *suspense*¹ e vazhdueshme në vijë.

Vija politike dhe ideologjike e Liu Shao Çisë u deklarua se ishte një vijë revizioniste, liberale, oportuniste. Dhe ne kështu mendojmë: e tillë ishte ajo. Liu Shao Çisë zyrtarisht iu vunë shumë epitete, por sidomos atij iu atribua epiteti «Hrushovi i Kinës». Ky «Hrushov i Kinës» ishte bërë «i plotfuqishëm» dhe, me sa lihej të kuptohej (se kështu, me nënkuptime, lihen të gjitha çështjet në Kinë) «Mao Ce Duni ishte izoluar, ishte lënë mënjanë», por çdo gjë bëhej «nën emrin e tij, me flamurin e tij». Kjo për ne do të thoshte, pra, se Maoja nuk duhej të ishte ashtu siç thoshin, «i izoluar», mbasi ai udhëhiqte partinë, udhëhiqte kongrese partie.

1. Frëngjisht — këtu ka kuptimin pasiguri.

Në vitin 1957 ai mori pjesë në Mbledhjen e Moskës dhe foli pro Hrushovit, të cilin e quajti «Lenini i kohëve tona». Maoja, me këtë rast, kritikoi edhe Stalinin, duke thënë: «Kur vajta te Stalini qëndrova si nxënësi para mësuesit», dhe këtë Maoja e bëri për të treguar «prepotencën» e Stalinit ndaj tij. Ai, gjithashtu, e uroi Hrushovin se «kishte bërë mirë që goditi elementët anti-parti», domethënë grupin e Molotovit. A mund të mendohet, pra, që Mao Ce Duni të ketë qenë i izoluar nga Liu Shao Çia? Jo, më duket mua; përkundrazi, ai ka qenë në të njëjtat pozita me Liun dhe me Hrushovin.

Pra, pikëpamjet politike, ideologjike, ekonomike etj. të Kongresit të 8-të të Partisë Komuniste të Kinës, në të cilin asistua edhe ne, në vitin 1956, ishin jo vetëm idetë liberale, djathtiste dhe revizioniste të Liu Shao Çisë, por edhe të Maos, edhe të Ten Hsiao Pinit, Çu En Lait, Pen Çenit etj., me fjalë të tjera, të të gjithë udhëheqjes. Vihet pyetja në këtë rast: Maoja, që uroi Hrushovin, përse nuk bëri edhe vetë ashtu, dhe t'u vinte fshesën këtyre fraksionistëve? S'u vuri fshesën, sepse ata kishin fuqinë?! Jo, kjo nuk u tha asnjëherë. Po çfarë ishte kjo bandë e Liu Shao Çisë, «e djathtë» apo «e majtë»? Kjo nuk u tha asnjëherë hapur. Por Maoja vetë çfarë ishte, djathtist, centrist, liberal, majtist, apo marksist-leninist? Kurdoherë ai është hequr dhe hiqet si marksist-leninist, si dishepull i Marksit, i Engelsit, i Leninit dhe i Stalinit, fotografitë e të cilëve në Kinë vihen në mure në formate të mëdha, por në realitet Maoja as veprroi dhe as vepron në bazë të mësimëve të tyre kundër deviatorëve dhe armiqve të marksizëm-leninizmit.

Në shkrimet e tij Maoja është shprehur dhe vazhdon të shprehet se «fshatarësia është forca më revolucionare, tek e cila duhet të mbështetet revolucioni». Rolin vendimtar të proletariatit në revolucion sipas teorisë së Marksit, Maoja e vë në plan të dytë, në mos të tretë. «Kështu është kryer revolucioni kinez, prandaj kjo teori duhet të mbizotërojë», — thotë ai. «Rroftë Marksit», — thotë Mao Ce Duni, por për të nuk qëndron teoria e Marksit për rolin udhëheqës të klasës punëtore. Me fjalë të tjera, sipas Maos, nuk mundet që klasa punëtore ta udhëheqë revolucionin dhe fshatarësia e varfër dhe e mesme të jetë aleatja e saj në revolucion; e kundërta duhet të ngjasë, ta udhëheqë revolucionin fshatarësia dhe klasa punëtore të jetë aleatja e së parës.

Shprehje tjetër e kësaj vije antimarksiste të Maos është edhe koncepti, sipas të cilit «fshati të rrethojë qytetin». Kjo do të thotë që revolucionin ta udhëheqë fshatarësia e varfër, se «proletariati i qytetit e ka humbur frymën revolucionare, ai është bërë konservator, i është përshtatur shtypjes dhe shfrytëzimit kapitalist». Natyrisht, kjo teori është antimarksiste dhe nuk mund të çojë në revolucion, nuk mund të vendosë dhe t'i japë rolin që i përket diktaturës së proletariatit dhe as udhëheqjes së saj, partisë proletare marksiste-leniniste. Me fjalë dhe me propagandë çdo gjë mund të mbulohet, por jo esenca e çështjes, dhe për pasojë, në mos sot, nesër do të vijë koha që çatia dhe muret të rrëzohen, sepse socializmi nuk mund të ndërtohet pa udhëheqjen e partisë komuniste marksiste-leniniste dhe pa zbatuar drejt e me vendosmëri tezat e pavdekshme të teorisë marksiste-leniniste.

Partia Komuniste e Kinës, pavarësisht nga pamja dhe nga reklama që bën, nuk është dhe nuk mund të jetë një parti e vërtetë marksiste-leniniste dhe në pozita të shëndosha revolucionare. Historia e kësaj partie tregon se në gjirin e saj jo vetëm kanë ekzistuar fraksione të ndryshme ideologjike që kanë vepruar kundër njëri-tjetrit, gjë që është e natyrshme, sepse edhe në parti ekziston dhe zhvillohet lufta e klasave, por më e rëndësishme dhe shqetësuese është se këto fraksione lejohen, vazhdojnë të ekzistojnë, bëhen zyrtare, derisa botërisht thuhet: «Le të lulëzojnë njëqind lulet». Një parti që lejon të lulëzojnë në gjirin e saj liberalizmi, pikëpamjet kulake, revizioniste e anarkiste të çdo lloji, apo që lejon t'u paguhet rentë kapitalistëve të qytetit, në një kohë kur është vendosur diktatura e proletariatit (sic), nuk mund t'i vësh emrin parti marksiste-leniniste.

Në një parti të tillë zotëron mentaliteti fshatar mikroborgjez, dhe s'ka si të jetë ndryshe kur në veprimtarinë e saj parimet marksiste-leniniste jo vetëm nuk zbatohen, por ato shkelen, nënvleftësohen dhe përdoren si perde për të fshehur realitetin josocialist. Kjo vijë oportuniste revizioniste e kishte krimbur partinë dhe Kinën po e çonte në rrugën hrushoviane.

Mao Ce Duni reagoi në mënyrë vigoroze¹, por jo si udhëheqës i një partie marksiste-leniniste. E kam fjalën për Revolucionin e madh Kulturor Proletar. Ç'ishte ky Revolucion Kulturor?! Kush e drejtonte atë dhe kundër kujt bëhej?! Këtë revolucion, si të thuash, e drejtonte Mao Ce Duni dhe një shtab i ngushtë rreth

1. Nga frëngjishtja — këtu ka kuptimin fort.

tij. Maoja, afërsisht, bëri këtë thirrje: «Të sulmojmë shtabet». Po cilat ishin këto shtabe? Që nga Liu, Teni, Çuja, Li Hsien Nieni e shumë e shumë të tjerë, deri poshtë në komitetet. Kush do t'i sulmonte këto shtabe? Rinia, e cila me thirrjen e Maos doli rrugëve në mënyrë spontane, anarkiste.

E gjithë kjo veprimtari u bë e përqendruar jo në rrugë marksiste-leniniste dhe as u zhvillua në këtë frymë. Karakteristike është se ata që u ngritën në këtë «revolucion» ishin studentë, nxënës, intelektualë. I famshmi «revolucion» bëhej kështu nga intelektualët, jashtë kontrollit të partisë dhe kjo jo vetëm që nuk drejtonte, por në fakt ishte, si të thuash, e likuiduar.

Shtabi i revolucionit nuk kishte besim as te partia e klasës, as te vetë klasa. Dhe ngjanë përleshje të përgjakshme, bile u bënë edhe luftime të rregullta me artileri dhe me mortaja. Hunveibinët¹ bënë ligjin në rrugë e në sheshe, arrestonin njerëz dhe, me faj e pa faj, i diskreditonin, u vinin «kapelën», deri dhe i vritnin nëpër rrugë; ata arritën sa të djezin edhe ambasada të huaja. Ksenofobia u shpreh e egër kundër të huajve, kundër kulturës së popujve të tjerë, por luftë u bë edhe kundër trashëgimisë kulturore mijëvjeçare të vetë Kinës.

Ç'tregonte gjithë kjo furtunë? Është e qartë se nuk tregonte frymën dhe parimet marksiste në veprim, por dëshmonte për zbatimin e teorive anarkiste të Shtirnerit, të Bakuninit e të atyre të Prudonit, kundër të cilave Marksi dhe Lenini kishin luftuar me ashpërsinë më të madhe. Revolucioni i madh Kulturor Proletar

1. Gardistët e kuq.

nuk ishte një Revolucion Kulturor (ai drejtohej kundër asaj kulture që predikonin Marksi dhe Lenini), ai ishte një revolucion politik jo në rrugën marksiste-leniniste, por një revolucion pa program, anarkist, kundër klasës punëtore dhe partisë së saj, sepse faktikisht roli udhëheqës i klasës dhe vetë partia qenë likuiduar. Por, veç rrëmujës dhe spontancitetit anarkist edhe autoriteti i organeve lokale të pushtetit shtetëror po ashtu nuk ekzistonte më, kurse ushtria, e udhëhequr nga Lin Biaoja, që luftonte me flamurin e Maos, me librin e kuq të Maos dhe me miliarda pafka të madhësive të ndryshme me fytyrën e Maos, qëndronte e plotfuqishme «në rezervë» të Maos. Lin Biaoja ishte bërë figura kryesore e shtabit të revolucionit, po kështu edhe Çen Po Taja. Mirëpo më vonë këta të dy u deklaruan «komplotistë, tradhtarë, organizatorë të atentateve të ndryshme kundër Mao Ce Dunit, që dështuan».

Mao Ce Duni dha urdhër që fshati të mos ngrihej në revolucion, se gjoja atje çdo gjë ishte në rregull. Siç thuhej, «e keqja ishte në qytete, ishte në parti, ishte në klasën punëtore» (sic). Kjo dukej dhe cilësohej si majtizëm, por në fakt është djathtizëm, dhe kjo do të thotë se djathtistët revizionistë — dhe këta ishin njerëzit e grupit të Liu Shao Çisë — kishin hedhur në dorë klasën dhe partinë e saj, kurse «majtistët», Maoja me shokë, ngritën në revolucion studentët dhe intelektualët për të rimarrë partinë dhe klasën! Ç'gjëra të çuditshme ndodhin në Kinë! Këtu del qartë në pah teoria djathtiste e Maos, sipas së cilës «fshati dhe të rinjtë të sulmojnë dhe të kapin qytetin» (sic).

Gjatë revolucionit kaotik dhe anarkist gjoja u bënë

riparime, gjoja u rikrijua partia. Dhe sa u përjashtuan pas gjithë kësaj katrohure dhe periudhe mosbesimi e pasigurie? Vetëm 3-4 për qind. Por kjo shifër nuk dëshmon se partia ishte «krimbur», por dëshmon, se Maoja me disa pasues të tij s'kishin besim te partia.

Ç'gjë tjetër «të mirë» solli Revolucioni Kulturor? Asgjë! Pushteti i diktaturës së shkatërruar duhej mëkëmbur. Po si? Një sallatë ruse, sido që udhëheqësit kinëzë ishin kundër rusëve! Pushteti i krijuar kudo përbëhej nga njerëz të partisë, nga ushtria, fshatarësia dhe nga punëtorë. Udhëheqësi kryesor i këtij pushteti ishte oficeri më i lartë. Por akoma edhe tash nuk dihet se si është formuar pushteti në Kinë. Thonë se partia është organizuar, por organizatat e masave akoma nuk janë formuar dhe s'po i bëjnë kongreset përkatëse.

Lufta e klasave në teori gjoja vazhdon, veçse të gjithë ata që u dënuan dhe u poshtëruan nga ky «revolucion» u rehabilituan dhe Teni, *de facto*, tash zë vendin e parë në udhëheqje, meqë Maoja dhe Çuja janë sëmurë. Të gjithë njerëzit që kishin pasur përgjegjësi të larta, si ministra, mareshalë dhe gjeneralë të Çan Kai Shisë, u falën dhe janë të lirë. Thuhet se ata po «punojnë me ndërgjegje» për atdheun e tyre, Kinën socialiste.

Të gjitha teoritë jomarksiste të Maos u quajtën maocedunide. Natyrisht një gjë e tillë u bë për ndarjen në mes marksizëm-leninizmit dhe maocedunidesë. Këtë «teori» u përpoqën të na e impononin si neve, ashtu edhe gjithë komunistëve në botë, por ne nuk pranuan të binim në një gabim të tillë fatal. Maoistët, për të gënjyer, domethënë për t'i shitur idetë liberale, revizio-

niste dhe anarkiste të Maos sikur janë marksiste, nxorën formulën tjetër: «Marksizëm-leninizmi-maoecedunideja». Kuptohet qartë hileja e këtij maskimi. Bota revizionis-to-kapitaliste dhe disa lakenj të kinezëve, që e quajnë veten «parti komuniste marksiste-leniniste», siç është ajo e Francës, e adoptuan këtë «teori». Maoecedunideja revizioniste po zhvillohet tash pa kurrfarë mbulese në politikën ndërkombëtare.

Politika kineze bazohet në «luftën kryesore kundër socialimperializmit sovjetik». «Kush ka kontradikta me Bashkimin Sovjetik, është në një anë me Kinën». Me këtë udhëheqësit kinezë duan të thonë, dhe e thonë hapur, se «socialimperializmi sovjetik është armiku kryesor». Këtë e thonë edhe për të forcuar idenë se Kina është një «vend socialist» dhe «udhëhiqet» nga marksizëm-leninizmi.

Në politikën e saj të jashtme, Kina nuk udhëhiqet në asgjë nga marksizëm-leninizmi, nga revolucioni dhe nga pikëpamja klasore. Në Kinë janë braktisur të gjitha parimet bazë marksiste-leniniste. Ajo nuk bën një luftë klasore kundër dy superfuqive, politika e saj jo-marksiste e ka fshirë ideologjinë marksiste në politikën e jashtme. Kina e Liut ishte për «aleancë me të gjithë, edhe me revizionistët sovjetikë kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës», kurse Kina e Maos është për «një aleancë me të gjithë, në radhë të parë me imperializmin amerikan dhe me borgjezinë reaksionare, kundër Bashkimit Sovjetik».

Kina po shtrembëron teorinë marksiste-leniniste, e cila na mëson se nga njëra anë e barrikadës qëndrojnë popujt me në krye proletariatin dhe, nga ana tjetër,

imperializmi dhe kapitalizmi botëror, të cilëve iu shtua edhe socialimperializmi sovjetik.

Në politikën e jashtme të Kinës vazhdon të mbizotërojë teoria e Maos «fshati të rrethojë qytetin» dhe kjo shprehet në «teorinë» sipas së cilës «bota e tretë (ku është inkuadruar dhe Kina) të rrethojë dhe të likuadojë botën e dytë dhe të parë». Por këto dy «botë», që Kina e Maos pretendon t'i rrethojë e t'i luftojë, efektivisht ajo i mbështet për të shtypur popujt e tyre dhe popujt e «botës së tretë», të cilët ajo i konsideron gjoja si ushtarët e revolucionit. Titoja, Çaushesku dhe të tjerë si këta janë aleatët e Kinës, janë për «revolucionin» (sic)! Të tillë konsiderohen gjithë këta edhe nga hrushovianët, bile këtë lojë hrushovianët e çojnë deri atje sa vendet ku drejtojnë ata që përmenda më sipër, i quajnë «socialiste». Kina mbron Frankon, Pinoçetin, NATO-n, Tregun e Përbashkët Evropian dhe «Evropën e Bashkuar» reaksionarë si anglezin Hith e të tjerë. Kjo s'mund të quhet një politikë klasore marksiste-leniniste. E famshmja «botë e tretë» nuk mund të pranohet në bllok, siç bëjnë kinezët. Një vend i vërtetë socialist edhe në aleancat me shtete të ndryshme, edhe në dhënien e ndihmës shtetërore duhet absolutisht të bëjë diferencime. Pa folur këtu për Frankot dhe për Pinoçetët, edhe marrëdhëniet me një shtet të «botës së tretë» duhet më parë të shikohen me syrin klasor, në mënyrë që të mos pengohen forcat revolucionare dhe përparimtare që luftojnë brenda këtij apo atij vendi; përkundrazi, marrëdhëniet të bëjnë që këto forca të ndihmohen. Por Kina me teorinë e Maos i neglizhon këto, bile lë të kuptohet qartë se nuk dëshiron të pri-

shet me udhëheqësit borgjezë, kapitalistë e satrapë të këtyre vendeve që janë kundër popujve të tyre, që janë me ato fuqi të mëdha, të cilat u japin më shumë përkrahje e kredi. Kjo s'duhet të jetë kurrë politika e një vendi socialist.

Një politikë e gabuar nga ana e Kinës duket edhe në lidhje me partitë komuniste marksiste-leniniste që janë formuar në botë. Krahas këtyre partive si kërpudha kanë lindur grupime të çdo kallëpi, trockiste, anarkiste, që nga grupet që vepronin nën udhëheqjen e Sartrit dhe deri tek ato të çdo fraksioni borgjez e provokator; dhe Kina na mban lidhje me të gjitha këto pa asnjë dallim. Përfaqësuesit e këtyre ajo i pret e i përcjell, u predikon bashkim me socialdemokratët, propagandim për Kinën e për Maon dhe alcancë me borgjezinë e vendit dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër Bashkimit Sovjetik.

Kjo është një politikë armiqësore borgjeze, anti-marksiste dhe antirevolucionare prej shteti të madh. Por me Partinë tonë atyre nuk mund t'u shkojnë të tilla aventura të rrezikshme. Kinezët e dinë që ne nuk jemi dakord në vijë me ta dhe këto kundërshtime i themi çdo ditë, duke mbrojtur pikëpamjet e Partisë sonë për çdo problem. Ne nuk dalim hëpërhë hapur kundër tyre, por edhe ata kështu veprojnë, heshtin, flasin ndonjë fjalë të mirë në popull për ne, por asgjë nuk botojnë mbi qëndrimet tona, sepse atëherë do t'u dilnin probleme dhe bile të rrezikshme. Edhe kur botojnë diçka në shtypin e tyre, e shtrembërojnë me marifete ala kineze.

Një karakteristikë e përbashkët është se, si në shtypin kinez, edhe në atë sovjetik nuk gjen artikuj të the-

llë teorikë për demaskimin e njëri-tjetrit. Artikujt që botojnë ata, janë bajatë, të përciptë, me slogane pa vlerë, dhe kjo ngjet sepse, po të bëjnë një analizë të thelluar të problemeve, do të demaskojnë bllofin e njëri-tjetrit, se që të dyja palët janë shtete dhe parti revizioniste.

Këto mendime për qëndrimet e Kinës dhe pikëpamja jonë që Kina të quhet një vend revizionist në shikim të sipërfaqshëm mund të duken si të çuditshme. Një mendim i tillë mund të dukej i gabuar dhe joreal, por nuk ka si shpjegohen ndryshe këto drejtime në një varg çështjesh të politikës së brendshme dhe të jashtme. Kina është gati të bjerë në ujdi për bisedime, bile të pajtohet në shumë çështje edhe me vendet revizioniste, edhe me partitë revizioniste që deri dje e mbështetnin Bashkimin Sovjetik dhe sot e kritikojnë. Kjo që po them nuk është një supozim, por realitet. Kinezët priten në Pekin Karriljon e Spanjës, biseduan dhe u ndanë me të si miq. Dhe pse jo? Pse nuk u shpall ndonjë komunikatë e kundërt? Me Spanjën e Frankos lidhën marrëdhënie diplomatike, kurse Partinë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste), anëtarët e së cilës vriten nga falangistët, kinezët as që e përfillin fare.

Kina flet mirë për çdo vend revizionist, mjaft që ky të afrohet me imperializmin amerikan. Ndaj Polonisë, që po hyn në sferën e kapitalit amerikan, deri dhe ndaj Bullgarisë së Zhivkos, për të mos folur për Rumaninë dhe Jugosllavinë, Kina është e lëvizshme në qëndrime.

Rumania për kinezët është mikja më e shtrenjtë. Pse? Preteksti është se ajo «u reziston sovjetikëve».

Kjo «rezistencë» e rumunëve kundër sovjetikëve është një «atu» që u duhet. Rumunët dhe sovjetikët shumë gjëra i kanë të njëjta, e njëjtë është politika e tyre e brendshme, po e njëjtë është edhe e jashtëmja. Të dyja partitë e tyre janë revizioniste, të dyja shtetet janë kapitaliste, dhe kontradiktat, në qoftë se kanë, ose janë të pakta, ose janë efemere, ose janë fare lojë. Kina as bën dhe as që dëshiron të bëjë ndonjë analizë të kësaj gjendjeje.

Jugosllavinë, po ashtu, Kina e përkrah politikisht, se ideologjikisht tash për tash hapur s'mund ta përkrahë dot, për arsye se qelbet, bie erë tradhti. Por titizmi nuk është veçse kapitalizmi i gjallë; Jugosllavia titiste udhëhiqet nga ide anarkiste të vetadministrimit federalist, ku shteti ruhet për nevojat e rastit, ku partinë e komunistëve titizmi e likuidoi. Ai e likuidoi partinë dhe gjoja la klasën «të vetadministronte», por në fakt me këtë favorizoi borgjezinë pasanike, të re dhe të vjetër, të bëhej zonjë e Jugosllavisë, të pasurohej dhe ta shiste vendin tek të huajt. Në realitet, në Jugosllavi mbretëron kaosi e anarkia, në ekonomi, në politikë e në ideologji. Dhe bota borgjezo-revizioniste e quan Jugosllavinë «socialiste», kurse Titon «njeri të madh», se i rezistoi Stalinit, por me këtë ai u bëri dhe vazhdon t'u bëjë shërbime të mëdha imperializmit amerikan dhe kapitalit të madh botëror.

Në politikën e Kinës ne nuk dënojmë marrëdhëniet diplomatike që ka vendosur ajo me shtete të ndryshme kapitaliste, revizioniste (marrëdhëniet e saj me shtetet fashiste, natyrisht, i dënojmë), por dënojmë vijën jo-marksiste që e udhëheq këtë politikë. Ne nuk jemi da-

kord me qëndrimet joklasore të saj ose me ato qëndrime kineze që nuk i shërbejnë as revolucionit botëror, as çlirimit nacional të popujve të «botës së tretë». Kina me qëndrimet e saj politiko-ideologjike i bën një dëm të madh socializmit e revolucionit, si dhe luftës çlirimtare të popujve në shkallë botërore.

Bota kapitaliste e di dhe e njeh këtë shërbim të Kinës. Çdo lëvizje marksiste-leniniste të vërtetë ose turbullirat e studentëve të Kon Benditit e të Tupamarëve, me gjithë ndryshimet që kanë, bota kapitaliste i quan «maoiste» dhe Kina gëzohet për këtë kualifikim, për këtë «nder» që i bën reaksioni botëror. Bile ajo predikon bashkimin e të gjitha këtyre rrymave maoiste, «opozitare», anarkiste, dhe të partive komuniste marksiste-leniniste në një, pa marrë parasysh pikëpamjet diametralisht të kundërta që ekzistojnë midis tyre. Përveç kësaj, Kina i këshillon që këto parti të bashkëpunojnë me qeveritë borgjeze të vendeve të tyre, të mbështetin ushtritë e tyre borgjeze që shtypin popujt dhe proletariatin. Ato parti marksiste-leniniste, të cilat nuk e ndjekin vijën që predikon Kina, kjo i braktis dhe i lufton. Atëherë si mund ta quash këtë vijë marksiste-leniniste? Jo, kjo është një vijë revizioniste.

Karakteristikë dalluese e revizionizmit modern është «bashkekzistenca paqësore», e parë dhe e zbatuar kjo në prizmin joklasor, jorevolucionar. Një tjetër karakteristikë e tij është rruga paqësore, rruga parlamentare e marrjes së pushtetit «për të shkuar në socializëm». E tillë është vija që predikoi Hrushovi dhe që e predikojnë sot edhe revizionistët sovjetikë, e tillë është vija e revizionistëve italianë, francezë, spanjollë etj. Kjo është edhe

vija, rruga e kinezëve. Dhe ata po këtë rrugë predikojnë. Revolucionit ata i kanë vënë pikën, derisa predikojnë aleancë dhe bashkëpunim me shtetet borgjeze kapitaliste dhe me gjithë institucionet e tyre, në mes të të cilave edhe me parlamentin borgjez. Ky është realiteti, në teori dhe në praktikë, pavarësisht se teorikisht kinezët s'e pohojnë këtë. As sovjetikët nuk i pohojnë krimet e tyre: bashkëzistencën paqësore hrushoviane e quajnë «leniniste» dhe rrugën parlamentare të marrjes së pushtetit nuk harrojnë kurrë ta shoqërojnë me atë që ka thënë Lenini, se «ka mundësi të merret pushteti edhe me këtë rrugë». Por revizionistët këtë e kanë bërë të vetmen rrugë dhe *de facto* luftojnë rrugën tjetër, rrugën me armë, me dhunë, rrugën e revolucionit dhe vendosjen e socializmit të vërtetë.

Fidel Kastroja po trumbeton se «ushtria është partia». Revizionistët modernë këtë nuk e thonë hapur, por fakt është se në Kinë ushtria komandon partinë, të cilën Mao Ce Duni «e shpërndau» gjatë Revolucionit Kulturor. Gjatë këtij revolucioni ishte ushtria që mbeti dhe qëndroi si e vetmja «shtyllë» e regjimit: pa parti, pa bashkime profesionale, pa klasë punëtore në fuqi. Kështu ngjau, ky është fakt. Po pse ndodhi kjo? Është fare e qartë: për shkak të një botëkuptimi ideologjik jomarksist-leninist.

Këtyre problemeve themelore teorike duhet t'u shkohet deri në fund dhe jo përciptas, nuk u duhet besuar fjalëve, por fakteve, dhe këto fakte duhen analizuar në prizmin e teorisë sonë marksiste-leniniste. Si mund ta kuptosh gjestin e kinezëve në ditët e fundit të vitit të kaluar, kur liruan helikopterin sovjetik me

tre aviatorë brenda, të cilët u mbajtën rob 21 muaj me radhë «pse kishin hyrë 400 km në tokën kineze»? Që i liruan, vepruan mirë, se dy gjëra duheshin bërë: ose të çoheshin aviatorët sovjetikë në gjyq, ose të liroheshin pas ndonja dy muajsh. Por ç'ngjau? Gjatë 21 muajve ç'nuk u tha në shtyp nga ana e kinezëve për këtë helikopter: «Kjo është vepër kriminale, vepër spiunazhi, provokacion brutal» etj. Zyrtarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme e RP të Kinës i kanë pasë thënë Behar Shtyllës se «aviatorët sovjetikë janë spiunë, helikopteri ishte plot me aparatura spiunazhi, kemi zënë dokumente të rëndësishme»; se «helikopteri kishte zbritur në Sinkiang për të rrëmbyer njerëz» etj. Kurse sovjetikët mbanin tezën se helikopteri kishte humbur rrugën. Mirëpo, pas 21 muajve, edhe Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Popullore të Kinës deklaroi ndryshe, sikur helikopteri kishte humbur rrugën, se aviatorët janë të pafajshëm, prandaj lirohen, u jepet edhe një darkë zyrtare në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe përcillen në «mënyrë solemne» në aerodrom.

Ç'ti thuash këtij qëndrimi? Ç'emër t'i vësh? Kjo nuk mund të kuptohet veçse si diçka që ekziston në prapaskenë. Diçka ka në këtë mes, diçka e qelbur bie erë. Nuk është e papritur për ne që një kthesë e tillë ala kineze të quhet «gjest madhështor politik i Mao Ce Dunit», natyrisht, edhe kthesë «marksiste-leniniste». Mundet që pas kësaj «kthese gjeniale», Çu En Lai ose Ten Hsiao Pini t'i thonë ambasadorit tonë në Pekin: «Hajde të shkojmë në Moskë, ç'prisni, ndërroi situata», se tamam kështu i tha Çu En Lai ambasadorit tonë kur u rrëzua Hrushovi. Hedh ndokush ndonjë fjalë që «para-

shikohet rënia e Brezhnjev-it» dhe kinezët ëndërrojnë për kthesa e përgatitin planë në fshehtësi, ndoshta në marrëveshje me sovjetikët. Do t'i shohim hiletë revizioniste dhe tradhtarë.

Qëndrimi kinez ndaj Partisë sonë të Punës dhe Shqipërisë socialiste nuk është i singertë. Ne deri tani kemi qenë «miqtë më të mirë dhe më besnikë të Kinës dhe të Partisë Komuniste të Kinës». Kjo frymë në Kinë është zhvilluar e shtrirë shumë mirë në bazë, dhe për këtë s'kemi asnjë vërejtje. Por qendra mban qëndrim tjetër. Kurse ne ua kemi shtruar hapur pikëpamjet tona dhe kemi kërkuar të shkëmbejmë delegacione e të zhvillojmë bisedime, por kërkesat tona kanë rënë në vesh të shurdhër. Udhëheqja kineze, pa e thënë shprehimisht se nuk është dakord me ne për shumë çështje parimore, në fakt, me këtë qëndrim që mban, lë të kuptohet se nuk është dakord. Ndihamat ekonomike që ne kërkuam për veprat e periudhës pesëvjeçare 1976-1980, të cilat me siguri do të mbaronin për 6-7 vjet, kinezët na i dhanë shumë të reduktuara. Ata na dhanë 20-25 për qind të kredive që kërkuam, duke na pritur ftohtë, duke na mbyllur derën për çdo shtesë e duke thënë se «ky është edhe mendimi i Maos». «Jemi shumë të varfër», na thanë, kurse deri dy vjet më parë, pa u bërë asnjë shtesë pohimeve të tyre, bile të vetë Çu En Lait, deklarorin: «Ju ndihmojmë pak, shumë pak, po pas dy-tre vjetësh, në pesëvjeçarin tjetër (domethënë në këtë që kemi hyrë), do t'ju japim më shumë». Mirëpo ngjau krejt e kundërta, dhe me çfarë përbuzje flasin sot, duke na thënë: «Mos kërkonit gjë, se s'pranohet asnjë kërkesë tjetër». Mënd ta quajmë

këtë presion ekonomik? Mund ta quajmë, bile me plot gojën. Pse mbahen këto qëndrime nga ana e tyre? Sepse s'janë dakord me ne në vijë.

Me një mesazh drejtuar Maos, u kërkuam ndihmë ushtarake. Kinezët, këtë radhë, na akorduan një ndihmë gesharake, ata me paturpësi na thanë që «tash mos kërkonim më!». Pse ngjau kjo kthesë? Sepse s'janë dakord me vijën tonë politike, strategjike dhe ideologjike, se duan që ne t'i nënshtrohemi vijës së tyre revizioniste.

Udhëheqësit kinezë na kanë thënë që «të bashkëpunojmë, të lidhemi me Jugosllavinë dhe me Rumani­në», domethënë të bëhemi revizionistë si ata, «të lidhim marrëdhënie diplomatike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës» e të tjera poshtërsira si këto, domethënë të bëjmë siç bën Kina. Kjo është një tradhti që ne e përbuzim me neveritje dhe këtë vijë ne e luftojmë në një mënyrë a në një tjetër, haptazi e në çdo rast, me shtypin dhe propagandën tonë.

U vërtetua se grupi tradhtar i Beqir Ballukut dhe i Abdyl Këllezit ka qenë për këtë vijë kineze, e cila në realitet është njëkohësisht edhe me vijën sovjetike, jugosllave, rumune, amerikane etj., sepse të gjithë këta duan dhe luftojnë që të likuidohet Partia jonë marksiste-leniniste dhe udhëheqja e saj që mbrojnë marksizëm-leninizmin dhe socializmin në Shqipëri. Udhëheqja revizioniste kineze, pra, mori gjithë këto masa për të na dobësuar. Këto veprime tash për tash nuk janë aq brutale sa ato të Hrushovit, por edhe kinezët në këtë rrugë ecin, duke menduar se do të na e marrin frymën pak nga pak, por... do të na e marrin të keqen!

Jo vetëm kaq, por Mao Ce Duni vepron njëlloj si

hrushovianët. Dy-tri mesazhe të rëndësishme i janë dërguar atij në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe me firmën time, kurse ai nga ana e tij, nuk ka denjuar të na japë përgjigje, të paktën për mirësjellje ose për reciprocitet. Ose s'ka denjuar, ose nuk do që të lërë dokument për problemet që i kemi ngritur. Edhe përgjigjet me gojë. që na janë dhënë nëpërmjet shokëve të tjerë të tij. kanë qenë shumë negative. Një letre zyrtare duhet t'i jepet përgjigje me letër, pozitivisht ose negativisht.

Mënyrat e veprimtimit të kinezëve janë të papëlqyera, dhe. pse të mos e themi, edhe dinake. Për furnizimin me armë gjithë pjesëtarët e delegacionit kinez. me të cilin u trajtua ky problem, kësaj radhe u sollën në mënyrë të poshtër ndaj nesh, ata na i mbyllën të gjitha portat. Dhe kryetari i delegacionit tonë ua shfaqti pakënaqësinë. Në darkën e fundit Jch Çien Jini. në fjalën e tij, filloi nga përkëdheljet bajate «Do të vini edhe vitin tjetër të shihni dhe të bisedojmë» e të tjera profka të tilla pa kripë, kurse, nga ana tjetër, na kishin thënë «nga viti 2 000 do të jemi në gjendje t'ju ndihmojmë».

Këto qëndrime jo vetëm që s'janë miqësore, por ata shkojnë edhe më tej, bëjnë përpjekje të përçajnë kuadrot tanë nga udhëheqja, duke u lënë atyre të kuptojnë se «Ja, ju ju presim shumë mirë, por armë nuk ju japim se s'e kemi mirë me udhëheqjen tuaj». Metoda trockiste!

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Shënime për Kinën», vëll.*

II, f. 183

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Shënime për
Kinën», vëll. II, f. 183*

DISA PROBLEME TË STUDIMIT DHE TË SHKRIMIT TË HISTORISË SË LASITË TË POPULLIT TONË

Shënime

20 janar 1976

Gjatë gjithë jetës sime më ka preokupuar një problem me rëndësi të madhe. Ky problem ka të bëjë me studimin dhe shkrimin e historisë së fshatarësisë sonë gjatë shekujve, gjatë epokave të ndryshme të historisë, gjatë mesjetës, mesjetës së hershme, bile edhe shumë më parë akoma. Unë jam interesuar ca gjatë jetës sime në studimin e historisë së popujve të ndryshëm të botës, të Evropës dhe të popujve fqinj. Kam lexuar jo vetëm manuale skolare, por histori speciale të popujve në epoka të ndryshme, në aspekte të ndryshme dhe të shkruara me metoda të ndryshme. Natyrisht, flas për sa kam lexuar unë, ato kanë vlera të ndryshme nga përmbajtja, nga dokumentacioni, nga prirja ideologjike, nga stili dhe metoda e analizës që kanë përdorur autorët në paraqitjen e fakteve dhe në interpretimin e tyre. Ka shumë nga këta që kanë bërë epokë dhe historitë e tyre, pavarësisht nga metoda e përdorur dhe nga numri i fakteve ku janë mbështetur, janë burime të shëndosha, të cilave u referohen brezat e historianëve pasardhës.

Problemi, që shtroj, është studimi dhe hartimi i historisë së fshatarësisë sonë, domethënë, me fjalë të tjera, edhe historia e popullit tonë.

Kjo nuk është bërë dhe ne duhet ta bëjmë. Historianët e vendit tonë duhet t'i futen thellë këtij problemi të madh, shumë të rëndësishëm. Askush nuk duhet të mendojë se me nxjerrjen në dritë të vëllimit I dhe II të Historisë së Shqipërisë çdo gjë mbaroi. Jo, kjo është një histori më e gjerë se një libër shkolle, prandaj u rekomandoj disa historianëve të apasionuar që t'i futen këtij problemi.

Duhet të njohim se dijetarët tanë në të kaluarën nuk e kanë studiuar thellë historinë e fshatarësisë sonë, domethënë të popullit tonë, në thellësi dhe me metoda shkencore¹. Më tepër ata kanë riprodhuar në mënyrë propagandistike gjeste dhe akte heroike të popullit tonë kundër okupatorëve dhe mjerimin e jetës shoqërore, ekonomike dhe shpirtërore, që ishin pasojë e kësaj shtypjeje të huaj. Por një gjë e tillë nuk ka qenë dhe nuk është e mjaftueshme për ne. Socializmi dhe shkenca e materializmit historik, nga e cila udhëhiqet Partia jonë, na ka hapur neve perspektiva dhe mundësi kolosale, që nuk i kanë pasur dijetarët tanë të kohëve të kaluara. Neve na bie si detyrë ta thellojmë këtë studim, duke përdorur metodën shkencore marksishte-leniniste.

1. Problemet e historisë së fshatarësisë dhe të luftërave të saj shoku Enver Hoxha i ka trajtuar në mënyrë të veçantë në diskutimin e mbajtur në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH më 9 maj 1983. Shih: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1982-1983», f. 337.

Historia veridike¹ duhet të bazohet në fakte dhe në interpretimin drejt të tyre. Çdo subjektivizëm, çdo formë shovinizmi ose imagjinatë fantaziste e këtyre fakteve e zhduk dhe e zhvlerëson historinë që kërkohet të shkruhet. Propaganda dhe fantazia janë një gjë, ndërsa historia e bazuar në fakte reale dhe në interpretimin shkencor marksist-leninist të tyre është një gjë tjetër.

Studiuesit tanë të vjetër dhe sidomos të kohës sonë i janë vënë studimit të gjenezës së popullit shqiptar dhe veçanërisht të epokës ilire dhe në këtë drejtim kanë pasur rezultate. Por ç'është bërë me paraardhësit, prejardhësit e ilirëve, kjo është gati një kartë e bardhë. Ka gjëra fragmentare, të shkëputura, të imagjinuara, të qëntuara andej-këtej, pa kritere, nga të huaj, që u jepnin interpretime të ndryshme, sipas interesit të tyre, ose edhe nga njerëzit tanë, të cilët i merrnin ashtu siç i jepnin të tjerët dhe i transkriptonin pa i kaluar në një analizë shkencore.

Studimi i ilirëve është një çështje me rëndësi, për të cilën janë interesuar shkencëtarët tanë, si edhe shkencëtarë të huaj. Unë mendoj se studimet e të huajve janë një bazë e mirë, por jo e plotë dhe e shuman-shme. Metodat e studimit dhe përshkrimi i gjendjes shoqërore dhe shpirtërore të ilirëve nga ana e tyre, lë shumë për të dëshiruar. Unë mund të gabohem, por studimet e tyre në këtë drejtim nuk janë të thelluara si duhet. Është ngulur këmbë veçanërisht në zbulimin e disa objekteve arkeologjike, në përshkrimin e tyre

1. Që pajtohet plotësisht me të vërtetën.

dhe fare pak në interpretimin dhe në zgjerimin e tyre. Të tjera orientime i preokuponin këta shkencëtarë, të tjera zhvillime të shoqërisë që marrin rrugë nga ilirët. Për shqiptarët, prejardhës të ilirëve, as flisnin fare, ose sa i përmendnin kalimthi.

Kurse shkencëtarët tanë, që janë marrë me studimin e ilirëve, kanë bërë hapa përpara dhe më të përparuar nga të huajt jo vetëm nga zbulimet e shumta me vlerë që kanë bërë, por edhe nga metoda e studimit, stili i punës, interpretimi i zhvillimit ekonomik-shoqëror të ilirëve. Por jam i mendimit se nuk duhet të kënaqemi as nga zbulimet, as nga metoda dhe interpretimi. Pse e them këtë? Për arsye se studimet për ilirët nga studiuesit tanë më duket se bëhen si një studim në vetvete, për të shpjeguar vetëm se ne kemi prejardhjen prej tyre. Mirëpo ilirët vetë nga e kanë prejardhjen? A janë bërë studime në këtë çështje nga tanët, apo bazohen kryesisht në ato ç'kanë thënë deri sot të tjerët? Këto kanë rëndësi, por shkencëtarët tanë duhet t'i analizojnë këto teori në bazë të teorisë dhe të analizës marksiste dhe nga e njohura (ilirët) të shkojnë tek e panjohura (epoka parailire).

Çështja tjetër që kërkon studime është kjo: «Ç'është bërë me jetën e me zhvillimin e prejardhësve të ilirëve — me shqiptarët?». Sa është studiuar ky problem? Mendoj se në këtë fushë duhet punuar sistematikisht dhe me metoda shkencore¹.

1. Që nga koha kur janë dhënë këto porosi, studimet në fushën e arkeologjisë ilire dhe të mesjetës së hershme kanë zgjeruar rrethin e tematikës së tyre dhe kanë sjellë një varg rezultatesh, që kanë pasuruar njohuritë shkencore në këto

Duhet të lidhen njëra pas tjetrës hallkat e zinxhirit, që nga paraardhësit e ilirëve, ilirët dhe deri në ditët tona. Për ilirët jemi interesuar, interesohemi dhe do të interesohemi, por mendoj se duhet parë metoda e studimit dhe e interpretimit të materialeve arkeologjike, që të dihet mirë se si ka jetuar ky popull, si ka luftuar, si ka menduar, si ka besuar, ç'marrëdhënie shoqërore ka pasur, si janë zhvilluar e transformuar këto, cilat kanë qenë influencat e brendshme dhe të jashtme, ç'ndryshime kanë sjellë të gjitha këto në jetën ekonomike, shoqërore, intelektuale, morale etj. Kjo, mendoj unë, ka rëndësi shumë të madhe, pse ndryshe qëndrojmë në metodën e çalë të shkencëtarëve të huaj, natyrisht duke zgjeruar vetëm gamën e zbulimeve arkeologjike.

Nga një punë e tillë do të kalojmë nga e panjohura në të njohurën, domethënë ç'bënë, si jetuan e ç'besuan paraardhësit dhe pasardhësit e ilirëve, shqiptarët. Duhet, pra, të mos qëndrohet në vend, vetëm tek ilirët, por të njohim zhvillimet para dhe pas ilirëve.

Ilirëve u gjejmë shumë gjurmë arkeologjike. Po pas ilirëve, në periudha të ndryshme, nuk ka gjurmë?

fusha. Është rritur veprimtaria e gërmimeve dhe kanë dalë në dritë qendra të reja me material tepër të pasur, që hedhin dritë mbi gjenezën e ilirëve dhe të shqiptarëve. Një sërë studimesh e konferencash u janë kushtuar problemeve të etnogjenezës së shqiptarëve, siç qe konferenca e vitit 1982, e cila bëri një sintezë të parë të rezultateve të studimeve gjuhësore, arkeologjike dhe historiko-etnografike lidhur me këtë problem. Këtyre rezultateve u janë kushtuar një varg botimesh të Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë.

Ka, patjetër, edhe më shumë, ka një zhvillim progresiv dhe më të përparuar se qytetërimi ilir derisa ne, prejardhësit e ilirëve, as nuk u zhdukëm, as nuk u asimluam nga popujt e tjerë më të mëdhenj. Kjo tregon vitalitetin e popullit tonë, zotësinë, kulturën, organizimin e mbrojtjes dhe të jetës shoqërore të përparuar. Kjo duhet studiuar, duhet zbuluar, duhet zhvilluar. Këtu ka vazhdimësi dhe jo ndërprerje, kjo është një çështje dialektike. Ne nuk mund të bëjmë përjashtim nga historia dhe nga zhvillimi i popujve të tjerë.

Mund të thotë ndokush se s'kemi të dhëna, s'kemi dokumente, ku t'i gjejmë, si t'i kërkojmë. Me të vërtetë ky është një problem aq i madh sa dhe i vështirë, por të ngresh duart lart pa u menduar, s'del gjë.

Një punë, një detyrë e tillë, duhet të zgjidhet nga historianët tanë, të cilët duhet të kuptojnë mirë se historia nuk është një përrallë ku të përzihen legjendat dhe evenimentet e mbinatyrshme mitike, sido që edhe këto kanë vendin dhe rolin e tyre në studimin e historisë së lashtë të popujve, por historia është një shkencë dhe si e tillë ajo duhet njohur, studiuar dhe shkruar.

Historianët tanë duhet t'i futen një punë të tillë, ata duhet të dalin nga guaska e historive të cekëta shkollore ose të formuluar në bazë të të dhënave të pakontrolluara dhe shumë të kufizuara. Historianët tanë, që duhet të merren me këto studime të lashta për popullin tonë në mesjetë, në mesjetën e hershme, në kohën e Romës dhe para saj, duhet të jenë dhe të bëhen eruditë, pse erudicioni është një mjet jo vetëm për të ditur shumë gjëra të ngatërruara, por është një mjet me rëndësi që duhet të përdoret mirë dhe jo të lihet

që «koka të bluajë si mulliri pa kokrra». Erudicioni historianit duhet t'i shërbejë për të bërë ballafaqime shkencore të ngjarjeve, të zhvillimeve, të lidhjeve, të prejardhjeve, jo vetëm për sa i përket thjesht popullit tonë, por në lidhje edhe me të tjerët.

Çështja e dokumenteve për të shkruar historinë e një epoke të lashtë, nuk mund të bazohet vetëm në shkrime, pse shumë popuj nuk kanë pasë shkrimin e tyre, por ata kanë lënë gjurmë të pashlyeshme gjatë shekujve. Dhe këto gjurmë nuk janë vetëm zbulimet arkeologjike, të cilat zënë një vend të rëndësishëm në punën për të shkruar jetën dhe historinë e një populli. Por nuk janë vetëm këto dokumentet e një historiani.

Gjuha dhe veprimtaria prodhuese janë dy thesare të paçmuara për të njohur historinë e një populli. Populli ynë i lashtë, si gjithë popujt e lashtë, ka pasë gjuhën e vet, pavarësisht se nuk janë gjetur dokumente të shkruara. Studimi i gjuhës sonë ka bërë disa hapa të mirë përpara, por mendoj se ky studim nuk duhet të mbetet si diçka e thatë, si një shkencë e palidhur me transformimet e shoqërisë në shekuj. Ne, marksistët, duam të dimë pse bëhen ndryshimet fonetike në një epokë të caktuar, pse ndryshoi fjala, tingulli, kuptimi? Këto ndryshime nuk u bënë vetvetiu, pse deshën njerëzit mijëra o qindra vjet më parë, por u bënë se u zhvillua jeta shoqërore dhe këto ndryshime i solli veprimtaria prodhuese, e cila zhvilloi njeriun dhe shoqërinë. Në rast se linguistikën e studiojmë të shkëputur nga jeta shoqërore, në rast se bën një analizë të palidhur me analiza të tjera, ajo nuk mund t'i shërbejë çështjes së madhe. Linguistika, mendoj unë, nuk shër-

ben vetëm për të njohur gjuhën e tashme, por sidomos ajo duhet të shërbejë që nëpërmjet saj të njohim edhe historinë e lashtë të popullit tonë.

Përveç linguistikës, gërmimeve arkeologjike, mësimet me imtësi dhe në zhvillim të gjeografisë së vendit dhe faktorëve të tjerë, historianët e këtyre epokave duhet të tregojnë një interesim të gjallë edhe për këngët popullore, për legjendat e besimet fetare. Marksizmi nuk i hedh këto në kosh, si «ëndrra», si mistifizëm, por i studion me syrin e materializmit dialektik. Shqiptarët e periudhës pasilire kanë besuar, kanë ëndërruar dhe dëshirat e ngjarjet edhe ata, si popujt e tjerë, i kanë kthyer në legjenda. Këtu qëndron forca e historianit, që nga të gjitha këto të nxjerrë dhe të bëjë analizën historike që na mëson Marks, i cili ka qenë mjeshtri i analizës shoqërore, që bota dhe njerëzimi tjetër më të madh nuk kanë nxjerrë. Dhe historianët tanë duhet ta ndjekin këtë metodë të Marksit, metodën e materializmit dialektik.

Ekzistenca e dëshmimeve materiale është kryesore në studimin e historisë së një populli, me to lidhet edhe studimi i grupeve shoqërore, që kanë zhvillim të pabarabartë, format dhe metodat e punës, nëpërmjet të cilave zhvillohet intelekt, transformohet njeriu dhe grupi shoqëror, me to lidhen zakonet, të folurit dhe transformimet më të hollësishme të kuptimit që marrin fjalët, besimet fetare, ndryshimet dhe ndarjet që janë vërtetuar në to, si edhe gjithë jeta shpirtërore. Të gjitha këto mund të quhen «arkeologjia» e çështjeve të jetës së njerëzve, të jetës së përditshme të tyre, që historiani duhet t'i zbulojë dhe t'i studiojë. Kështu, me

durim, me studim, me erudicion, me gërmime, duke përdorur krahasime dhe analogji shkencore materialiste mund të zbulohet koha e lashtë, të vihet në dukje dhe të gjallërohet «inercia» shekullore, të zbulohen sistemet e ndryshme shoqërore të epokave të ndryshme, të zbërthohen e të lidhen ato në mënyrë të pashkëputur. Për t'ia arritur këtij qëllimi çdo gjë vlen, çdo gjë shërben, deri edhe një vegël pune prej hekuri, prej bronzi apo prej stralli, një unazë, një pandatif¹, një praktikë, një traditë, një mënyrë të ngrëni e të piri, mënyra e veshjes dhe kujdesi për trupin etj.

Misioni i historianit, siç na mësojnë klasikët tanë, është i lartë. Puna e tij duhet të karakterizohet nga rregulli dhe vërtetësia në drejtim të kërkimeve, duke kaluar nga dokumenti bruto, në klasifikim, në renditje, në krahasim me të tjerat dhe, këtej del historia e vërtetë, sinteza që kërkohet. Historiani duhet të bazohet në fakte të natyrave të ndryshme, që përmban një epokë e caktuar. Këto fakte duhen grupuar e klasifikuar, pse janë të ndryshme: politike, ekonomike, strukturore, shoqërore, të jetës besimtare etj. Detyra e historianit është të gjejë lidhjet e vërteta në mes tyre, të hedhë urat, si me thënë, dhe të vendosë kështu raportet në mes një vargu të tillë heterogjen të dhënash. Të gjitha këto fakte të natyrave të ndryshme heterogjene, të cilave u krijohet dhe u shpjegohet lidhja, përbëjnë qytetërimin. Ky quhet qytetërimi i një epoke, nga të dhënat e të cilit duhet të gjesh unitetin.

Por detyra e historianit të vërtetë, që di të zba-

1. Varëse zbukurimi.

tojë si duhet materializmin dialektik, është të vihet më lart dhe të shikojë më tej nga burimet që na kanë lënë shekujt. Shembullin më të shkëlqyer na e jep Engelsi në librin e tij të famshëm «Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit». Nga veglat prej guri, nga zakonet, zhvillimi i ngadaltë i tyre dhe nga qindra e mijëra shenja të tjera, që kanë lënë kohët dhe popujt gjatë shekujve, Engelsi përcaktoi jo vetëm origjinën materialiste të zhvillimit shoqëror dhe të njeriut si qenie shoqërore, por na dha edhe armën e metodës së kërkimeve të sakta e realiste.

Fola më sipër për erudicionin që i shërben historianit. Natyrisht ky erudicion s'ka kufi si në kohë, si në gjerësi. Njeriut i duhet shumë kohë që të mësojë çdo gjë dhe mirë. Megjithatë, njeriu në jetën e tij e ka për detyrë që, në përputhje me zhvillimin materialist të shoqërisë, të zhvillojë edhe njohuritë e tij të përgjithshme, në përgjithësi dhe në veçanti të zhvillojë thellë dijenitë e tij në sektorin ku punon. E kam theksuar shumë herë se njerëzit tanë kanë bërë përparime të mira në këtë drejtim, por kultura e përgjithshme e tyre ka mbetur akoma gati në stadin e asaj që është mësuar në shkollë. Edhe thellimi e zgjerimi i kulturës në specialitetin ku punon secili dhe të ambientit që e rrethon, është jo i plotë; nuk bëhen sa duhet përpjekje për nxitjen e kuriozitetit shkencor. Shumë lëndë, me gjithë përmirësimet që janë bërë, në disa raste, trajtohen pothuajse në atë vijë që i kanë trajtuar shkencëtarët e huaj. Flas këtu për disa çështje gjuhësore. Disa shkencëtarë të huaj kanë punuar për gjuhën shqipe, por jo për historinë e popullit tonë që fliste këtë

gjuhë. Ata flasin për prejardhjen e gjuhës sonë dhe për transformimet që ka pësuar ajo, por pse u bënë këto transformime ata s'flasin, po kanë mbledhur të dhëna dhe kanë proceduar kryesisht me krahasime. Rezultati i punës së tyre mund të jetë i drejtë, por jo i mjaftueshëm, pse neve nuk na duhet vetëm që kjo ose ajo gjuhë është me origjinë indoevropiane ose nga ndonjë tjetër, por ajo duhet lidhur me të gjitha studimet e tjera, të bashkuara me ura me njëra-tjetrën dhe që nga gjithë ky ansambël shkencor të dalë qytetërimi ilir, parailir, pasilir, dhe deri në ditët tona si një zinxhir i pashkëputur.

Për sa thashë mbi studimin e historisë së lashtë të popullit tonë, sidomos të periudhës ilire dhe pasilire, duhet të bëhen kërkime e studime të thella në vend, për të arritur në burimet dhe, për këtë qëllim, duhen përdorur metoda shkencore. Përveç kësaj, duhet ribërë një inventar i saktë i çdo materiali që është shkruar te ne për popullin tonë, deri te këngët, te legjendat, te zakonet, te ritet fetare, te veshjet, te mënyra e të ngrënit, te prodhimet, te bujqësia, te blegtoaria, te gjeografia etj., etj. Të gjitha këto duhen analizuar në mënyrë shkencore për qëllimin që thamë dhe jo në mënyrë propagandistike. Të gjitha këto të dhëna duhet t'i klasifikojmë dhe nga çdo e dhënë të shohim në drejtimin që thashë më parë, më lart dhe më larg nga dokumenti, pse vetëm kështu zbulohet dhe shkruhet historia.

Shumë gjëra që aktualisht kanë kaluar si të vërteta historike, do t'i verifikojnë dhe t'i vënë siç duhet në vend këto studime, pse në mjaft prej tyre kanë luajtur një rol subjektivizmi dhe rrethanat e krijuara nga

të huajt, të cilat shtynin dijetarët dhe patriotët tanë të adoptonin qëndrime më tepër politike-propagandistike sesa historikisht të vërtetuara.

Në shkollë, si mua dhe bashkëkohësve të mi, na mësonin, dhe kështu e dinim dhe dimë, se Bishti i Pallës në Durrës ardhka nga fjala pallë, pasi ka formën e pallës dhe, për më tepër, se atje Skënderbeu kishte luftuar me turqit me pallë, prandaj këtij vendi i paska mbetur emri «Bisht i Pallës». Mirëpo në një libër të serisë «Mémorial des Siècles» lexova një ditë një shkrim të vjetër «Aleksiada» të shkruar nga princesha Ana Komnena¹, vajza e perandorit të Bizantit Aleksis i Parë, që mbretëroi nga 1081 deri 1118 në Bizant, nën sundimin e të cilit ishte dhe Dyrrakiumi (Durrësi). Princesha Ana Komnena flet për kryqëzatën e parë dhe pikërisht për mbretin Ubos, që valët e detit e përplasën në Durrësin e Vjetër dhe është pikërisht ajo që thotë se anija e këtij mbreti u shkatërrua në «kepin Palli». Pra, Bishti i Pallës, sipas Ana Komnenës, s'ka të bëjë as me pallën, as me Skënderbeun, që jetoi tre shekuj më vonë nga kjo ngjarje.

Këtë shembull nuk e solla vetëm për saktësinë historike, por edhe në lidhje me çështjen e erudicionit. Të tjerë kanë shkruar për popullin tonë, drejt ose shtrembër, drejtpërdrejt për të apo kalimthi, kanë shkruar në epoka të ndryshme, siç i kanë parë, siç i kanë menduar dhe siç i kanë interpretuar vetë. Historiani ynë e ka për detyrë shkencore që t'i kërkojë këto të dhëna, t'i analizojë, t'i krahasojë, t'i verifikojë dhe kjo hyn në

1. Historiane bizantine (1083-1148).

atë grumbullim dokumentesh që thashë. Por për historinë e popullit tonë kanë vlerë dhe historitë e popujve të tjerë, sidomos të atyre me të cilët kemi pasur lidhje. Prandaj e ngre unë këtë problem dhe e konsideroj sa të zorshëm, aq edhe të domosdoshëm. Çdo gjë e zorshme në këtë drejtim mund të kapërcehet. Ne duhet të ngjallim interes dhe të krijojmë pasion në kuadrot, t'u mësojmë atyre edhe metodën marksiste-leniniste të kërkimeve, disiplinën shkencore në punë, në studim dhe në konkluzione.

Botuar për herë të parë në revistën «Studime politiko-shoqërore», nr. 6 1984, f. 7

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Për shkencën»
(Përmbledhje veprash), vëll.
II, f. 3*

MËSIMET E PARTISË I KALITIN DHE I AFTËSOJNË KUADROT TË KRYEJNË SA MË MIRË DETYRAT

Nga biseda me shoqen Lenka Çuko¹

22 janar 1976

Përfitova nga rasti që erdhe këtu, në mbledhjen² që po bëhet në aparatën e Komitetit Qendror, dhe të thirra, se dua të bisedoj me ty lidhur me punën e re që do të të ngarkohet. Përpara se të bisedojmë, dëshiroj të të uroj ta kryesh me sukses detyrën si sekretare e parë e Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës, që, natyrisht, do të mbetet e pashpallur deri sa propozimin për zgjedhjen tënde ta diskutojë dhe ta vendosë plenumi i komitetit të Partisë të rrethit.

Ti i ke të gjitha mundësitë për ta drejtuar mirë

1. Në atë kohë kandidate e Komitetit Qendror të PPSH dhe sekretare e Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës.

2. Në datën 22 dhe 23 janar 1976 në aparatën e KQ të PPSH u zhvillua një seminar me sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rrethëve dhe me kuadro kryesorë të Partisë e të shtetit, lidhur me disa probleme aktuale të rëndësishme. Në mbarrim të seancës së paradites të datës 22 janar, shoku Enver Hoxha thirri në takim shoqen Lenka Çuko dhe zhvilloi me të këtë bisedë.

byronë dhe plenumin e komitetit të Partisë të rrethit, prandaj hiç mos u druaj. Kur isha unë në moshën që ke ti sot, Partia më ngarkoi të drejtoja atë dhe Luftën Nacionalçlirimtare. Mos harro se unë në atë kohë nuk e kisha këtë eksperiencë kaq të madhe që ke ti sot. Atëherë unë kisha me vete Partinë, popullin dhe besimin e patundur se do të fitonim. Dhe në fakt fituam, se na mësoi Partia me mësimet e saj marksiste-leniniste si të punonim dhe si të luftonim deri në fund, kurse ti, aktualisht, ke një eksperiencë të madhe që nuk ka barazim me eksperiencën tonë fillestare të asaj kohe. Këtë nuk ta them për të të mburrur, apo që të të jap kurajë për detyrën që të ngarkojmë, por sepse kështu qëndrojnë punët. Personalisht unë kam kaluar vetë në këtë rrugë, prandaj jam në gjendje të krahasoj forcën e mendimit, të gjykimit dhe të diturive që kishim ne në atë kohë me këto të tuat sot. Eksperienca e madhe e Partisë, mësimet e saj shumë të vlefshme, ashtu si të gjithë ne, të kanë forcuar e të kanë kalitur edhe ty. Pastaj, ti je një kuadër që ke dalë nga baza, nga toka e Myzeqesë, nga një familje fshatari e varfër dhe gradualisht ke ngjitur shkallët në instancat e Partisë deri në Plenumin e Komitetit Qendror, si kandidat e tij. Kjo ka rëndësi shumë të madhe për punën. Me këto dua të them se edhe eksperiencë ke, prandaj nuk ka arsye t'i trembesh detyrës së re dhe jam i bindur se ti nuk i trembesh, po në fillim, është e natyrlig, njeriu ka një çikë druajtje. Apo s'është kështu?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Kështu është, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Prandaj hiqe ndjenjën e druajtjes. Kjo ndjenjë është e përkohshme, që lind në momentet e fillimit, po barrë të tilla nuk duhet të jenë të papritura për kuadrot tanë. Sikurse e di mirë, Komiteti Qendror dhe Partia vazhdimisht na mësojnë që në punë drejtuese duhen ngarkuar edhe kuadrot e rinj, që bashkë me më të moshuarit duhet të udhëheqin dhe ta edukojnë Partinë, të zhvillojnë ekonominë, industrinë, bujqësinë, arsimin e kulturën etj. Në këtë drejtim kanë ecur Komiteti Qendror dhe Partia dhe, aktualisht, sidomos pas Kongresit të 7-të të saj që do të bëjmë, ne do të ecim edhe më me forcë në këtë rrugë, sepse të rejat dhe të rinjtë tanë kanë dhënë prova pjekurie, politike dhe ideologjike, prova vendosmërie dhe zotësie organizative si kuadro.

Me këtë nuk dua të them se të vjetrit, më të moshuarit se ty, i kanë humbur këto veti. Jo! Në asnjë mënyrë, përkundrazi ata i kanë rritur dhe i kanë shtuar dhe këto, aftësitë dhe vlerat e tyre, përbëjnë një thesar të madh për Partinë. Por, për t'u bërë udhëheqës, nevojitet një kohë përgatitore, gjatë së cilës lypset të përfitojmë që tok me të vjetrit të mësojmë edhe të rinjtë se si të udhëheqin, prandaj Partisë i vihet detyrë t'i ngarkojë edhe këta me punë drejtuese.

Partia na mëson që brenda vijës, normave dhe direktivave të saj, secili të gjykojë me kokën e vet dhe të koordinojë gjykimet, rezultatet e mendimeve dhe të veprimeve që duhen kryer në mënyrë kolegjiale. Këtë metodë duhet të ndjekim ne në marrjen e vendimeve, të cilat të luftojmë t'i zbatojmë dhe të kemi rezultate.

Detyra e re po të ngarkohet ty edhe për arsye se e njeh Myzeqenë dhe masat atje, gjithashtu, të njohin. Prandaj, gjersa të njohin dhe i njeh, s'ka dyshim që punën do ta bësh mirë. Po mos harro, krahas punës në zyrë, duhet të vazhdosh të shkosh në bazë, në kooperativa e ndërmarrje dhe nëpër organizatat-bazë. Gjithashtu, ta bësh praktikë pune të thërresësh në raport edhe shokët e byrosë së komitetit të Partisë, kur kthehen nga baza. Të tërë në byro dhe në sekretariat jeni shokë me njëri-tjetrin, po Komiteti Qendror të ka ngarkuar me detyrën e sekretarit të parë, prandaj të bie ty detyra kryesore të kontrollosh se si zbatohen vendimet e byrosë së komitetit të Partisë të rrethit dhe ato të Komitetit Qendror të Partisë. Me këtë dua të them që edhe vetë të punosh, po njëkohësisht edhe shokët e tjerë bashkëpunëtorë të afërt t'i kontrollosh, se ata jo vetëm kanë të drejta, por kanë edhe detyra. Të dyja këto anë duhen parë.

Ti, si sekretare e parë e komitetit të Partisë të rrethit, duhet të japësh mendim për të gjitha problemet, se je në postin më me përgjegjësi në rreth. Por, sigurisht, shokët përreth teje kanë detyrë dhe të drejtë të thonë edhe ata mendimet e tyre, të plotësojnë mendimet e tua me këtë ose atë ide.

Detyrën si sekretare e parë duhet ta kuptosh drejt, prandaj nuk duhet të mendosh se duke qenë në këtë funksion, shokët nuk kanë të drejtë të bëjnë vërejtje të bazuara, kur kanë, duke shkuar me pikëpamjen e gabuar se gjoja nuk duhet të prishin qejf me ty. Një gjë e tillë nuk duhet të ekzistojë në Partinë tonë në asnjë instancë. Edhe ne kështu ve-

projmë në mbledhjet e Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror. Mbledhjet tona zhvillohen në frymë luftarake, ne ia bëjmë hapur kritikën shoku-shokut dhe kjo na forcon të gjithë.

Duke pasur parasysh këto që të thashë, në asnjë rast të mos ndrydhesh për të thënë pikëpamjen tënde me frymë partie për faktin se në byro të komitetit të Partisë të rrethit ka shokë që janë më të vjetër se ti. Le të jenë ata më të vjetër, ti duhet t'i respektosh për moshën, për meritat dhe për eksperiencën e gjatë që kanë në punët e Partisë, po edhe ata duhet të të respektojnë ty nga ana e tyre, se je kandidat e Komitetit Qendror të Partisë dhe sekretare e komitetit të Partisë të rrethit. Natyrisht, ti duhet të bësh përpjekje të përfitosh nga eksperiencia e tyre, ashtu siç e kanë edhe ata për detyrë të përfitojnë nga eksperiencia jote, se dhe ti ke goxha eksperiencë. Këtë e them për rëndësinë që kanë funksionet që ke pasur. Këto funksione konsiderohen nga më kryesoret të Partisë, ashtu sikurse konsideroheshin gjatë Luftës Nacional-çlirimtare çështjet politike, komisarët politikë. Pushkën mund ta hidhte në sup kushdo, po çështja ishte se si dhe kundër kujt duhej luftuar. Partia na këshillonte të bënim më parë përpjekje të bindeshin njerëzit dhe të vinin sa më shumë në rrugën e Partisë. Dhe kësh-tu u bë.

Prandaj, eksperiencia që ke fituar deri tash në sektorin që ke drejtuar, në bazë të ndarjes së punës që keni pasur në komitet, është një gjë shumë pozitive dhe me vlera të mëdha. Po për ty edhe problemet e bujqësisë nuk janë të huaja, se ke qenë në Krutje, në

fillim kooperativiste, pastaj me detyra drejtuese, si sekretare e organizatës së Partisë të kooperativës dhe më vonë kryetare e kësaj kooperative. Me këtë dua të them se bujqësinë, gjithashtu, e njeh mirë. Industri rrethi i Lushnjës nuk ka shumë, prandaj nuk do të kesh vështirësi në këtë drejtim. Megjithatë, kuadro kenë kudo në rreth, në çdo ndërmarrje. Përveç kësaj, për industrinë ka shokë përgjegjës si në komitetin e Partisë, edhe në pushtet, ashtu siç ka për bujqësinë. Këta kuadro do të interesohen dhe do të drejtojnë sektorët përkatës për të cilët janë ngarkuar, kurse ti do të drejtosh gjithë sektorët, natyrisht, në mënyrë kolegjiale.

Të kesh kujdes që t'u kërkosh llogari deri në një shokëve për detyrat e ngarkuara, mos u druaj aspak prej tyre. Burrat kanë anët e tyre pozitive, po kanë edhe anë negative, siç është prirja e dënueshme për të komanduar. Një dobësi të tillë duhet t'ua kritikosh atyre që janë të molepsur nga kjo sëmundje, pse do të jesh sekretare e parë e komitetit të Partisë të rrethit, prandaj ti, si grua, mos u druaj se të tjerët janë burra. E them këtë se Komiteti Qendror konstaton që në shumë rrethe janë shkarkuar mjaft brigadiere në kooperativat bujqësore dhe në vend të tyre janë vënë burra. Vihet pyetja: kush e bën më mirë punën nëpër kooperativat bujqësore? Përgjigjja është reale, po të themi se e bëjnë gratë. Po në rrethin tuaj kush është dalluar më shumë midis kooperativave? Kooperativa bujqësore e Këmishtajt, që ka më shumë gra në drejtim. Këtë nuk e them për të nënvlerësuar burrat, po për të kritikuar tendencën e huaj të disa burrave që i sjell

dëme Partisë, vijës së saj. Prandaj në këtë drejtim mos u tund.

Përpiqu të kuptohesh me shokët, të jesh e dashur, e afërt, popullorë dhe jam i bindur se ti e tillë je. Atëherë nuk të mbetet tjetër veçse të thellohesh në problemet dhe t'i ndjekësh mirë ato. Personalisht, kur marr të studioj materialet e Byrosë Politike ose të Sekretariatit të Komitetit Qendror, nënvizoj të gjitha ato probleme që meritojnë vëmendje, që kërkojnë zgjidhje dhe ç'bëj pastaj? Rri dhe mendoj se ç'duhet të them për këtë ose për atë problem që na paraqitet të zgjidhim në mbledhje. Të flas gjëra të përgjithshme, këto nuk i vlejnë çështjes. Atëherë, si sekretar i parë, mua më bie barra të reflektoj dhe të punoj më shumë se të tjerët, prandaj përgatitem me kohë përpara se të bëhet mbledhja. Por nga çështjet që shqyrtojmë, ka nga ato që i njoh mirë, por ka edhe nga ato që i di në përgjithësi. Kjo më imponon të studioj disa nga materialet teorike të Partisë sonë, materiale të ndryshme të Komitetit Qendror, ndonjëherë të lexoj edhe shkrime nga të miat që i kam formuluar në të kaluarën, për të parë se si i kam thënë ato më përpara dhe ç'të re duhet të vë në dukje tani, në kushtet e reja të zhvillimit të situatave politike, ekonomike, organizative etj. Në këtë drejtim kujdesem që të mos bëj përsëritje. Përveç këtyre, lexoj edhe libra të huaj. Këtu dua të theksoj se njerëzit tanë duhet të bëjnë kujdes, pasi duke lexuar të tillë libra, ka shumë rreziqe, se ata janë me përmbajtje borgjeze. Duhet të kesh një praktikë të gjatë marksiste-leniniste që të dish çfarë të marrësh prej tyre dhe të nxjerrësh atë që

duhet e që mund t'i shërbejë nga ana teknike, ta zëmë, bujqësisë sonë, industrisë etj., fusha këto ku të tjerët kanë bërë studime të mëdha dhe kanë arritur rezultate shkencore e teknike që edhe ne duhet të bëjmë përpjekje t'i njohim, t'i realizojmë dhe t'i shfrytëzojmë në dobinë tonë.

Të marrim, për shembull, çështjen e tokave në rrethin e Lushnjës. Ne kemi theksuar kurdoherë se ky është problemi më i madh dhe kryesori në bujqësi. Edhe unë kam folur shumë herë për këtë problem, megjithëse bujk nuk jam dhe për fat të keq nuk kam punuar kurrë në fshat. Por, nga gjithë eksperiencat e Partisë, kam mësuar diçka edhe në këtë fushë, duke lexuar libra të ndryshëm, enciklopedi bujqësore, ku ka studime të veçanta për tokën, për përbërjen e saj, si duhet trajtuar ajo dhe, me aq sa kam mundur, kam nxjerrë disa konkluzione që ia kam thënë Partisë. Dhe në këtë drejtim po punohet. Toka, si faktori kryesor në bujqësi, kërkon t'i bëhen shërbime, mbasi prodhimet prej saj merren, prandaj sa më shumë e më mirë t'i bëhen asaj shërbimet, aq më shumë rendimente të jep ajo. Për tokën nuk duhet hequr dorë asnjëherë nga studimet, mirëpo për këtë problem ka lloj-lloj teorish.

Të marrim çështjen e kullimit të tokës. Disa, për të ndihmuar kullimin, praktikojnë përgatitjen e tokës në formë «kurriz peshku», disa të tjerë drenazhimet, ka vende që përdorin forma të tjera. Kohë përpara ne u entuziazmuam me sistemin e tokave në formë «kurriz peshku» dhe punuam për disa vjet për ta vënë në jetë këtë formë. Mirëpo tokat nuk po i siste-

monim siç e kërkon kjo formë, as traktoristët tanë nuk e bënin mirë punën që u ngarkohej. Tani kemi gjetur metodën tjetër, atë të drenazhimit, duke vendosur në vijat që hapim tuba gres, bazuar në teorinë e vjetër të ndërtimit të ujësjellësve nga romakët. Dihet se këta kanë qenë ndërtuesit më të mëdhenj e më të zotë në çështjen e ujërave përpara erës sonë. Tani më kanë thënë që ju keni nxjerrë një eksperiencë tjetër për drenazhimin, duke mbushur vijat e hapura me zhavor.

SHOQJA LENKA ÇUKO: Bëhet hapja e vijave dhe atje, pasi vendosen tubat, vendi mbushet me zhavor.

SHOKU ENVER HOXHA: Kur ma treguan mua këtë, më shpjeguan sikur kjo punë kushton më lirë dhe ujët kullon në ato toka ku bëhet ky lloj drenazhimi. Mirëpo mendoj se duhet provuar me kujdes kjo punë, pse, duke i mbuluar vijat me baltë, gjithë ky material shpejt mund të çimentohej dhe ç'të shohësh, një vit — dy, ujët mund të kullojë në arat, pastaj hipën balta dhe çdo gjë kthehet si çimento, kështu që ujët mbetet në sipërfaqe pa kulluar dhe na dëmton bimët e arave. Prandaj mendoj se duhen bërë prova në këtë drejtim për të parë ka siguri apo jo një punë e tillë.

SHOQJA LENKA ÇUKO: Sivjet kemi bërë prova në 15 hektarë.

SHOKU ENVER HOXHA: Këtë sipërfaqe ju duhet ta ndiqni edhe vitin e ardhshëm, edhe më pas, për të parë si shkon kjo punë dhe a na leverdis ta praktikojmë në sipërfaqe të gjera apo jo.

Ju provojeni, por po të shohësh si kanë punuar dhe si punojnë muratorët, gurët përpara ata i ngjitin me njëri-tjetrin vetëm me baltë ose me rërë e gëlqere, tani i ngjitin me llaç, prandaj mendoj se duhet parë kjo çështje. Pastaj ka lloj-lloj tokash. Zavorin ju ia hidhni vijës, ndryshe balta do të ngjishej pa të dhe do të bëhej si një masë e padepërtueshme nga uji, kështu nuk vlen asnjë grosh për kullimin. Po ashtu duhet bërë kujdes që kur kalon traktori të mos e dëmtojë kullimin.

Shikojeni këtë çështje, me qëllim që çdo gjë të provohet më parë, që të përfitojmë nga dobia e saj dhe të mos na shkojë puna kot. Kryesorja është të bëjmë drenazhin dhe puna për këtë të jetë sa më pak e kushtueshme dhe për një kohë sa më të gjatë e durueshme. të përfitojmë sa më shumë kohë dhe punë dhe t'i bëjmë shërbime të mira tokës. Ne synojmë që drenazhimi jo vetëm t'i sjellë shërbime bimës që mbjellim, duke e mbrojtur nga lagështira, nga kalbja, po t'i shërbejë edhe përmirësimit të tokës dhe uji, që do të grumbullohet nga kullimi, të shërbejë për të ujitur dhe të mos na prishë rrënjët e bimëve. Këto shërbime agroteknike janë të lidhura me procese të tjera pune që bëhen për përmirësimin e tokës, si me plehërimet e ndryshme, me humusin, me mbathjen e tokave etj. Shërbimet agroteknike kanë një rëndësi shumë të madhe. Këtë e them me sa di unë nga ato që kam mësuar me të lexuar dhe me të dëgjuar, se ju i dini më mirë këto gjëra, pasi jeni rritur, keni punuar dhe jeni mësuar me to.

Ne kemi besim se ti do t'i japësh një ndihmë të

madhe Partisë në rrethin e Lushnjës, jo vetëm në sektorin e agjitacionit dhe të propagandës, në punët politike dhe ideologjike, të kulturës dhe atë të arsimit, ku ke fituar eksperiencë, por edhe në sektorët e tjerë, ku, gjithashtu, duhet ta kesh syrin dhe të japësh ndihmën tënde si sekretarë e parë. Dhe mos u tremb në asnjë çështje. Në kooperativat bujqësore ke plot kuadro të zotë, shokë dhe shoqe që drejtojnë, prandaj merr kontakt me ta, merr kontakte të vazhdueshme me punonjësit e bujqësisë, bisedo shtruar me njerëzit dhe gjatë punës përdor kurdoherë metodën e bindjes, por mos lësho në parime. Nuk e vlen të thërrasësh dhe të ngresh zërin fort, po njerëzit që janë në rrugë të gabuar të bësh përpjekje t'i bindësh me argumentime. Mbjaj kurdoherë gjakftohtësinë në çdo gjë, lëre tjetrin të të përgjigjet, dëgjoje me vëmendje mendimin e tij, po kur ai nuk është i drejtë, hazërxevap të jesh dhe të siguroj se ai që gabon ka kurdoherë arsytetime jo të drejta, pa baza dhe njeriu është në gjendje ta kapë kur të dojë.

Kur ishim të rinj, dua të them nxënës në shkollë, kishim një drejtor që e donim dhe e respektonim shumë. Ai nuk fliste kurrë me zë të lartë, megjithatë ne, nxënësit, kishim turp të madh t'i dilnim përpara. Me njëri-tjetrin thoshim se ai «të vret me pambuk». Ai nuk i dënonte nxënësit që gabonin, përkundrazi, fliste butë dhe me zë të ulët me ne, kur kërkonte të dinte pse e bëmë këtë apo atë veprim të gabuar dhe nga qëndrimi që mbante, ne skuqeshim nga turpi. Ja, këtë taktikë ndiqte ai, mirëpo qëndrimi dhe fjala e tij sa efekt të madh bënte te ne, nxënësit!

Mund të na flasësh me pak fjalë si është situata në rrethin e Lushnjës? Mos të lodha gjë?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Jo, shoku Enver, përkundrazi.

Në bujqësi, në krahasim me vitin e kaluar, me plugimet jemi mirë. Megjithatë duhet të ishim akoma më mirë, se detyrat këtë vit janë shumë të ngjeshura, të rëndësishme dhe të mundshme për t'u realizuar.

SHOKU ENVER HOXHA: I ngritët edhe ca rendimentet që kishit parashikuar?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Po, i ngritëm edhe më në krahasim me sa kishim menduar më përpara.

SHOKU ENVER HOXHA: Ç'thonë tani shokët e kooperativave? Kanë mbajtur më rezerva?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Po, përpara ata kishin mbajtur, gjë që ne nuk duhej ta kishim bërë, duke marrë parasysh rrethimin imperialisto-revizionist të vendit tonë. Rrugë tjetër për sigurimin e bukës për popullin tonë nuk ka, përveçse duke prodhuar dritërat vetë, në vend.

SHOKU ENVER HOXHA: Interesi ynë e lyp të planifikojmë duke mobilizuar të gjitha mundësitë që kemi, të bëjmë një plan sa më real, pa mbajtur asnjë rezervë dhe të vëmë të gjitha forcat për t'i realizuar detyrat. Forcat ekzistojnë që jo vetëm ta realizojmë, po edhe ta tejkalojmë, po të bëjmë përpjekje. Rezerva, siç thashë, nuk duhet të mbajmë, dhe nuk duhet lejuar të mbajmë më, ndryshe do të hasim në vështirësi. Këtë e them nga eksperiencia se, megjithëse kemi mbajtur rezerva të brendshme, planet nuk i kemi realizuar, për arsye se nuk jemi mobilizuar si duhet për rea-

lizimin e rezervave që i kishim lejuar vetes të kishim. Prandaj t'i rishikojmë totalisht me kujdesin më të madh planet. Është më mirë të parashikojmë realisht planin dhe të vëmë, kur janë mundësitë, edhe 46 kuintalë grurë për hektar, sesa të parashikojmë 42 kuintalë për hektar dhe 4 kuintalë për hektar t'i mbajmë rezervë të brendshme. Duke vepruar kështu jeta na ka mësuar se nuk bëhet si duhet mobilizimi i njerëzve, përkundrazi kjo i plogështon ata.

Të kemi parasysh se këtë vit Kina nuk na dha asnjë kokërr grurë. «Nuk kemi», na thanë kinezët. Atëherë ç'të bëjmë? Na bie detyrë ta bëjmë medoemos vetë bukën. Prandaj të planifikojmë pa as më të voglën rezervë dhe me seriozitetin më të madh të mobilizohemi totalisht për realizimin e plotë të planit. Për këtë njerëzit tanë duhet t'i vihen punës që tani. Dhe ty atje, në rrethin e Lushnjës, të bie ta kesh syrin në të gjitha kooperativat bujqësore të rrethit, po sidomos në ato të fushës, duke bërë që të ngrihen të gjitha në nivelin e kooperativës së Këmishtajt, pa lënë mënjandë kooperativën bujqësore të Krutjes, e cila duhet të vihet në garë dhe të konkurrojë me Këmishtajt, bile edhe t'ia kalojë, se i ka të gjitha kushtet dhe mundësitë.

SHOQJA LENKA ÇUKO: Para ca kohësh nuk na ecte mirë puna me plugimet. Për këtë arsye mbledhëm byronë dhe plenumin e komitetit të Partisë dhe këtë problem e lidhëm edhe me fjalimin tuaj në mbledhjen e Byrosë Politike. Me këtë rast diskutuam se si ta përmirësojmë punën për rritjen e rolit të plenumit të rrethit për problemet ekonomike, ashtu siç kërkon Par-

lia, por në mënyrë të veçantë për çështjen e drithit, si dhe për prodhimet e tjera të rëndësishme, si për lulediellin, pataten, për sigurimin e bazës materiale, për mbjelljen e pambukut dhe të misrit me kubikë etj. Tani jemi duke marrë masa për prodhimin në Durrës të mjeteve për përgatitjen e kubikëve, mbasi këtë vit mendojmë të mbjellim deri 3 000 hektarë me misër vetëm në këtë mënyrë, po kjo do të thotë 50 për qind të sipërfaqes.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë!

SHOQJA LENKA ÇUKO: Lidhur me këtë problem kemi ca vështirësi për tërheqjen e torfës.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk mund të merrni torfë në fermën e rrethit tuaj?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Jo, se një gjë e tillë do të na prishte strukturën e tokës së kësaj ndërmarrjeje, prandaj kemi menduar që atë ta marrim në Kosovë¹, megjithëse torfa e atjeshme në një përqindje të madhe është me ujë. Megjithatë atje ka një sasi të mirë që ne mund ta tërheqim për të plotësuar nevojat e kubikëve.

SHOKU ENVER HOXHA: Torfën e hidhni në tokë në mënyrë të studiuar, apo ashtu si t'ju dalë?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Këtë sasi që marrim në Kosovë dhe e përdorim për kubikët, e përziejmë me baltë. Pa përdorur torfën, që është një masë e shkri-fët, kemi frikë se rrënjët e bimës së vendosur në baltën e kubikut, kur të vijë koha që bima të mbijë, nuk do të jenë dot në gjendje ta shpojnë.

1. Fshat në rrethin e Lushnjës.

SHOKU ENVER HOXHA: Kujdesuni që komunistët, kuadrot, kryetarët e kooperativave dhe agronomët të kenë kurdoherë parasysh hartat pedologjike dhe kimike. Në brigadat ku bëjnë pjesë, ata duhet të njohin më së miri natyrën e tokës dhe përbërjen e saj, të njohin çfarë përbërje kimike kanë tokat e tyre dhe ç'kërkojnë akoma që të përmirësohen më tej e të bëhen më prodhuese, si: pleh, torfë, hi, humus etj. Këto ata jo vetëm duhet t'i dinë, por edhe t'i planifikojnë që më përpara kërkesat për to dhe pastaj lypset të bëjnë përpjekje që t'ia plotësojnë tokës, pse zhvillimi dhe përmirësimi i saj nuk bëhen menjëherë, por me periudha. Gjatë këtyre periudhave duhet të merren masa të njëpasnjëshme dhe të studiuara që do të ndihmojnë për rritjen e shëndetshme të bimëve, që përmirësojnë edhe këto, nga ana e tyre, tokat. Prandaj të pyeta për torfën nëse këtë ju e përdorni vetëm për kubikët apo edhe për përmirësimin e vazhdueshëm të tokave nën kulturë.

SHOQJA LENKA ÇUKO: Torfën ne e përdorim vetëm për kubikët, nuk kemi mundësi transporti që ta përdorim atë edhe për përmirësimin e tokave në përgjithësi.

SHOKU ENVER HOXHA: Po të keni shumë torfë, mendoj ta hidhni në ato toka që kanë nevojë për mbathje, pse nuk ka më të mirë se ajo. Sasinë që ju nevojitet për kubikët përdoreni për këtë qëllim, po gjersa keni në sasi më të mëdha, u hidhni torfë edhe tokave.

Po çështjet e edukimit ju shkojnë mirë në rreth?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Nuk kemi probleme shqetësuese as në këtë drejtim, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Pedagogët dhe lektorët a i keni njerëz të mirë dhe të përgatitur si duhet për këtë punë kaq të rëndësishme?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Të mirë janë. Kemi prej tyre arsimtarë, kemi pastaj edhe kuadro të tjerë dhe instruktorë në aparatën e komitetit të Partisë, që janë, gjithashtu, shokë të përgatitur si propagandistë të Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë!

Sa herë në muaj e bëni mbledhjen e byrosë së komitetit të Partisë?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Rregullisht e bëjmë një herë në muaj, por ka raste që e bëjmë edhe dy herë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po që kur vdiq Iljazi¹ e këtej, keni bërë ndonjë mbledhje?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Po, kemi bërë një mbledhje, në të cilën kemi marrë në analizë punën e kooperativës bujqësore të Krutjes. Me këtë rast aprovuam edhe disa lëvizje kuadrosh të ushtrisë. Edhe në fund të këtij muaji do të bëjmë një mbledhje tjetër për shpërndarjen e forcave të Partisë dhe për shqyrtimin e disa masave ndëshkimore në kuadrin e ndërrimit të dokumenteve të Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Si shkon puna për shpërndarjen e dokumenteve të reja në rrethin tuaj?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Vitin që shkoi kemi përjashtuar komunistë. Gjithashtu, duke u bazuar edhe në letrën që na erdhi nga ana e Komitetit Qendror të

¹ Iljaz Reka. Deri në atë kohë ishte sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës.

Partisë, mendojmë të mos ua japim dokumentin e ri të Partisë edhe disa të tjerëve. Këtë letër ne e punuam dhe e komentuam në plenumin e komitetit të Partisë të rrethit, se e vërteta është që duhet të ketë dhe ka akoma disa anëtarë partie që janë të mefshtë, ka edhe nga ata që kanë njollosur figurën morale të komunistit, prandaj duhet parë medocmos qenia në Parti e elementëve të tillë. Natyrisht në këtë çështje ne do të ecim me shumë kujdes, që të mos na krijohen shqetësime në organizatën e Partisë të rrethit.

SHOKU ENVER HOXHA: Rëndësi ka ta kemi Partinë të fortë, jo vetëm pa elementë armiq brenda radhëve të saj, por as me të mefshtë. Megjithatë, në rast se ka disa të mefshtë me stazh partie prej 10-15 vjetësh, duhet bërë kujdes se nuk mund t'i përjashtojmë të tërë në radhë, se ka nga ata që kanë bërë dhe diçka bëjnë, pavarësisht se nuk e kanë hovin që kërkohet. Pra, ndërrimi i dokumenteve të shfrytëzohet që të na shërbejë për forcimin e radhëve të Partisë. Ka qenë i nevojshëm zgjerimi i radhëve të Partisë, po gjatë kësaj pune, duke mos pasur kujdesin e duhur, Partia vërtet është rritur me disa mijëra njerëz, por ndërmyjet tyre ka pasur edhe nga ata që nuk e meritonin të futeshin në Parti. Në pranime mund të ishim ca më të shtrënguar, me qëllim që Partinë ta mbajmë kurdoherë të pastër, të fortë dhe rreth saj të mobilizohen me besim të plotë të gjithë njerëzit patriotë, të rinj, të reja, burra dhe gra që nuk janë në Parti, po me luftën që bëjnë dhe me qëndrimet revolucionare që mbajnë janë shumë afër saj dhe të gatshëm për të bërë sakrifica në çdo moment.

Në një kohë pas Revolucionit Socialist të Tetorit Lenini propozoi që vetëm punëtorë të pranoheshin në radhët e Partisë, prandaj, në bazë të propozimit të tij, u mor një vendim që të futeshin në parti vetëm punëtorë nga të fabrikave të mëdha, me qëllim që të formohesh një bërthamë e çeliktë brenda radhëve të Partisë Bolshevike kundër rrymave të ndryshme socialdemokrate që ekzistonin atëherë në Rusi. Edhe neve ndërrimi i dokumenteve të na shërbejë që të pastrojmë Partinë nga ndonjë element armik ose i padenjë dhe të futim brenda radhëve të saj gjak të ri.

Kini shumë kujdes në pranimet, sidomos në fshat, se atje ekzistojnë fise e tarafe. Për mbledhjen e ardhshme të Sekretariatit, që do të bëjmë më 30 janar¹, na është paraqitur një raport, ku na bëhet e ditur se në një fshat të rrethit të Beratit ka 7 familje që nuk flasin me njëra-tjetrën dhe këto nuk flasin as me lagjen; në një fshat tjetër janë 15 familje që nuk flasin me njëra-tjetrën dhe të tëra këto nuk flasin me tërë fshatin. Shqetësues është fakti se në më të shumtat e këtyre familjeve ka pjesëtarë që janë komunistë. Edhe në udhëheqje të kooperativave kanë ardhur, gjithashtu, njerëz me bazë fisi. Kjo do të thotë se nuk mbahen kurdoherë parasysh normat për pranimin e njerëzve në Parti. Në Parti nuk ka vend për fis dhe për familje. Në radhët e saj duhet të vijnë vetëm ata që zbatojnë me besnikëri vijën dhe normat e Partisë dhe nuk marrin parasysh familjen, vëllanë, motrën, kushëririn apo fisin. Secili vlerësohet e duhet të vle-

1. Shih në këtë vëllim, f. 318.

rësohet me atë se sa e mbron vijën e Partisë dhe si lufton për zbatimin e saj. Në këtë drejtim duhet bërë shumë punë. Të mos mendohet se këto të këqija mund të pastrohen shpejt, duhet të luftohet vazhdimisht kundër tyre, se mentalitetet e gabuara të njerëzve kërkojnë kohë që të luftohen dhe të ndreqen. Ndjenjat dhe mbeturinat mikroborgjeze tek anëtarët e Partisë dhe tek ata që nuk janë të organizuar në Parti janë dhe do të jenë akoma të gjalla për shumë kohë akoma. Natyrisht, përmirësime do të kemi vazhdimisht, veçse të kemi parasysh se mbeturinat do të vazhdojnë të ekzistojnë, po në Parti, ato ne nuk duhet në asnjë mënyrë t'i lejojmë, se bëhen rrezik për të.

Po ndonjë gjë tjetër nga Lushnja çfarë ka? Ecën përpara ndërtimi i uzinës së plastmasit?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Sipas planit kjo do të futet në prodhim në gjashtëmuorin e dytë të këtij viti, mirëpo ne kemi dëshirë mos e avancojmë diçka ndonjë muaj a një muaj e gjysmë më përpara afatit që është caktuar në plan. Përveç kësaj në rrethin tonë jemi duke ndërtuar edhe një fabrikë mielli.

SHOKU ENVER HOXHA: Korrespondon vënia në shfrytëzim e uzinës suaj të plastmasit me uzinën e polivinilkloridit të Vlorës, ku do të prodhohet lëndë e parë edhe për fabrikën që po ndërtoni? Është duke u bërë në rregull montimi i makinerisë në Vlorë? Jeni interesuar ju për këtë çështje?

SHOQJA LENKA ÇUKO: Shoku Adil [Çarçani];

1. Uzina e lëndëve plastike në Lushnjë u vu në shfrytëzim në vitin 1976.

në një takim që kam pasur me të, më ka njoftuar se edhe atje janë duke i avancuar punimet.

SHOKU ENVER HOXHA: Prandaj ngarko drejtorin e kësaj uzine të vejë në Vlorë dhe të interesohet se si shkojnë punët për ndërtimin e uzinës së polivinilkloridit dhe të vijë menjëherë të të raportojë, se për ju, po të mos keni lëndë të parë, s'ka asnjë rëndësi nëse mbaron para afatit ndërtimi i uzinës së plastmasit të rrethit tuaj. Që të prodhojë, kjo duhet të ketë lëndë të parë, që do t'i vijë nga Vlora.

Ki parasysh që shokët duhet të kenë iniciativë revolucionare në punë, po edhe të vijnë të të vënë në dijeni për realizimet, për pengesat e vështirësitë dhe si mendojnë ata t'i kapërcejnë etj. Ju mund ta bëni edhe dy herë në muaj mbledhjen e byrosë, po ti praktikoj edhe një metodë tjetër pune: kur shokët kthehen nga baza, thirri në zyrë, mbledhi dhe bisedoni bashkërisht për problemet që u kanë dalë përpara. Kjo nuk është mbledhje zyrtare. Kështu veprojmë edhe ne nga një orë e nganjëherë edhe një orë e gjysmë çdo ditë. Në kohën që do të marrim nga një kafe, takohemi dhe diskutojmë për problemet më të ndryshme korrente, duke vënë në dijeni shoku-shokun, sidomos për disa nga problemet më kryesore. Unë dua të di, fjala vjen, ç'u bë me pusin e gazit që pësoi avari në Durrës. Hakiu [Toska]¹, menjëherë pas takimit, u informua dhe na raportoi të nesërmen për situatën, se gjer ku kishte arritur puna para avarisë dhe ç'rezultate janë

1. Në atë kohë anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i KQ të PPSH.

arritur pas eliminimit të saj. Për këtë sektor sidomos ne bëjmë shumë kujdes, pse të gjithë armiqtë na kanë sabotuar haptazi në naftë dhe asnjëri nuk na vinte në dijeni. Kështu është vepruar edhe në fushën gazmbajtëse të Durrësit, ku ka dalë gaz që ndoshta si sasi mund të jetë më e madhe nga ajo e Divjakës. Ky është një sukses pas sabotimit, por duhet të zbulojmë të tjera fusha, se na kanë sabotuar rëndë në këtë drejtim.

Pra, kur kthehen shokët nga baza, praktiko mbledhje të tilla, qoftë edhe fare të shkurtra, nga gjysmë ore, pse njëri mund të thotë se në këtë ose atë kooperativë është krijuar kjo apo ajo situatë dhe të tregojnë për masat që ka marrë, një tjetër të vë në dijeni ç'ka dalë në një organizatë-bazë etj. Pastaj vendosni bashkërisht të dërgoni në vend një të deleguar, duke e ngarkuar të marrë takim me komunistët e organizatës për ta diskutuar problemin që ka dalë. Ose kur ndonjë çështje është me shumë rëndësi, shko edhe vetë, mbledh organizatën dhe bisedo me shokët e bazës se si do ta ndreqni situatën etj.

Sa të jetë e mundur problemet t'i kesh të qarta, se po pate të qartë çështjen, çdo gjë zgjidhet. Në këtë drejtim duhet të mësosh edhe kuadrot të punojnë më mirë, të mendojnë dhe të realizojnë vetë detyrat. Kërko që shokët e afërt të flasin shkurt, jo gjatë, se po e pate të qartë problemin, je në gjendje të rrish edhe pesë orë të flasësh, po ama duhet t'i lësh edhe tjetrit mundësi që t'i bluajë koka vetë. Të mos i mësojmë njerëzit, duke ua thënë të gjitha gjërat, përgjegjësi t'u flasë atyre për çështjet kryesore dhe si duhet ve-

pruar për zgjidhjen e tyre, çfarë materialesh e ç'literaturë duhet të lexojë, pa ku dhe në ç'faqe, këtë ta gjejë vetë. Me një fjalë të mos u jepet kuadrove çdo gjë e gatshme. Duke punuar kështu, vetë ti do të fitosh çdo ditë që kalon eksperiencë dhe gjithnjë e më shpejt do të ngrihen edhe shokët rreth teje.

Kaq kisha dëshirë të të thosha. Kurdoherë që do të kesh nevojë për ndihmë ose për konsultime, të vish pa druajtje edhe te shokët e tjerë sekretarë të Komitetit Qendror, edhe tek unë. Rruga këtu është e hapët. Personalisht mua më vjen shumë mirë kur shokët vijnë dhe më raportojnë për punët. Nuk është e domosdoshme të më flasin mua për të gjitha çështjet, po për ato më të rëndësishmet. Për çdo nevojë tjetër ti mund të vesh te shokët Hysni, Ramiz, Haki, Hekuran.

SHOQJA LENKA ÇUKO: Unë kam besim te Partia dhe porosinë që më dhatë do t'i kem parasysh, do të konsultohem vazhdimisht ngushtë me shoqet dhe me shokët që kam pranë për t'i zgjidhur gjithnjë e më drejt çështjet.

SHOKU ENVER HOXHA: Shoqet mos i harro dhe asnjëri mos lejo që të të thotë se «mbron shoqet», meqenëse je vetë shoqe. Ti mbroji njëllëj edhe shokët, edhe shoqet, natyrisht të gjithë ata dhe ato që janë me të vërtetë shoqe dhe shokë partie, të fortë, të qëndrueshëm dhe të aftë për t'i ngritur masat në këmbë për realizimin e plotë të vijës së Partisë.

Ti ke besim te Partia dhe ke marrë edukatën e saj. Përveç kësaj ke dalë nga baza, ke punuar në arat me baltë, prandaj të kesh besim në veten tënde dhe të jesh e sigurt se detyrat do t'i kryesh me sukses dhe

ajo që ka rëndësi është se punët do të ecin mirë në rrethin e Lushnjës.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

KINEZËT NUK PROPAGANDOJNË VIJËN E DREJTË TË PARTISË SONË

Shënime

22 janar 1976

Vëllimi i 19-të i Veprave është shtypur dhe shpërndarë në shumë gjuhë. Gjithë bota e jashtme, miq dhe armiq të Shqipërisë, flasin për vijën e drejtë dhe për guximin e Partisë sonë në demaskimin dhe në luftën që u bëri revizionistëve hrushovianë, për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit e në veçanti për mbrojtjen që i bëri Partisë Komuniste të Kinës. Vetëm në Kinë nuk është folur, nuk po flitet dhe as që ka dalë ndonjë organ shtypi të thotë diçka, të paktën edhe vetëm si njoftim që një vepër e tillë është botuar në Shqipëri.

Komiteti Qendror i PPSH dhe Presidiumi i Kuvendit Popullor botuan tekstin e Projektkushtetutës së re të Republikës Popullore të Shqipërisë. Jashtë, të gjithë kanë folur e po flasin për të dhe po e analizojnë publikisht. Vetëm në Kinë as që është përmendur fare-fare kjo ngjarje me kaq rëndësi për vendin tonë, ky dokument, me kaq rëndësi politike, ideologjike, organizative dhe konstitucionale, i Partisë sonë dhe i shtetit shqiptar.

Në shtypin kinez shkruhen gjëra pa vlerë për vendin tonë. Pikësëpari, shtypi atje nuk harron të riprodhojë ç'flitet mirë në vendin tonë për Kinën, kurse lajmet e tjera janë kronika banale: Jo u bë kjo mbledhje, jo u bë ky miting, në këtë foli ai, në këtë foli ky, në Shqipëri vajti ai, nga Shqipëria u largua ky, botohen edhe kronika sportive. Por asnjëherë nuk përmendet se «në Shqipëri vajti ky ose ai delegacion i kësaj ose i asaj partie komuniste marksiste-leniniste». Deri në këtë shkallë i ka reduktuar Kina marrëdhëniet politiko-ideologjike me vendin tonë! Kjo ndodh në rrugën e shtypit dhe të propagandës, kurse bisedimet politiko-ideologjike midis dy palëve tona janë reduktuar me kohë në zero me xhufkë. As shkëmbimi më i vogël i pikëpamjeve mbi ngjarjet në botë nuk bëhet.

Për sa u përket marrëdhënieve ekonomike dhe ndihmave për ushtrinë, edhe këto u reduktuan në minimumin e minimumeve. Megjithëkëtë, në dukje kinezët blofojnë dhe duan të tregojnë se «Shqipëria është aleatja më besnike» e tyre.

Si duhet t'i kuptojmë ne këto qëndrime? T'i shpjegojmë me atë që udhëheqja kineze të jetë informuar me vonesë nga njerëzit e saj? Kjo s'qëndron, sepse s'keni të bëjmë me gjëra të vogla, por me ngjarje e me materiale të rëndësishme të vendit e të Partisë sonë. Pastaj, përveç të dërguarve të HSINHUA-së në Tiranë, çdo javë ka avion Pekin-Tiranë dhe anasjelltas, Kina ka, gjithashtu, edhe ambasadën e saj në Tiranë.

Apo mos kinezët duan kohë sa t'i përkthejnë dhe t'i studiojnë materialet tona? As kjo nuk qëndron, sepse ata kanë një batalion përkthyesish dhe ne nuk kër-

kojmë që të botojnë ndonjë artikull ose të bëjnë komente për këto ngjarje, por vetëm të japin nga një lajm të thjeshtë, nëpërmjet të cilit opinioni kinez të mësojë se në Shqipëri «dolën këto dokumente». Atëherë përse veprojnë kështu? Ç'po ngjet? S'ka tjetër shpjegim veç këtij: nga ana e kinezëve ka sabotim, ata s'janë dakord me vijën politike të Partisë sonë.

Kinezët flasin «për diktaturën e proletariatit», edhe ne për atë po luftojmë; ata flasin kundër Bashkimit Sovjetik, po vëllimi i 19-të për çfarë bën fjalë? Pastaj çfarë po bëjmë ne çdo ditë? Atëherë përse nuk japin të paktën thjesht lajmin që dolën në dritë këto dokumente?

Si të kuptohet kjo enigmë kineze? Ata nuk duan t'i bëjnë propagandë vijës së drejtë të Partisë sonë, për këto arsye:

a) Se del qëndrimi fals i tyre;

b) se ekziston megalomania e partisë së madhe dhe e shtetit të madh;

c) se s'janë dakord me vijën tonë marksiste-leniniste, si në teori, edhe në praktikë, prandaj, po të propagandojnë vijën e drejtë të Partisë sonë, vetvetiu do të evidentohet ballafaqimi;

e) se formulat dhe sloganet e kinezëve janë gjoja marksiste;

d) se ata duan që ne t'u krehim bishtin, të flasim dhe të veprojmë njëloj me ta. Kinezët nuk e pranojnë qëndrimin parimor marksist-leninist të Partisë sonë. Ata duan që ne të bëhemi servilë të tyre. Kjo, natyrisht, nuk do të ngjasë kurrë;

dh) se atyre nuk u kanë pëlqyer masat e brendsh-

me që morëm ne kundër armiqve të Partisë dhe të shtetit, Beqir Ballukut, Hito Çakos, Petrit Dumes, Abdyl Këllezit e të tjerë. Pse? Deri ku kishin gisht kinezët në komplotin e tyre? Ne një gjë dimë: vija e tradhtarëve të vendit tonë u pëlqente shokëve kinezë;

e) se kinezët duan të na shkulin nga pozitrat marksiste-leniniste, duan që ne të bashkohemi me tradhtarët Tito dhe Çausheku dhe të na hedhin në pellgun revizionist. Natyrisht, ne ua kemi dënuar këto pikëpamje antimarksiste dhe kapitulluese.

Të gjitha këto i kam bërë shumë herë si pyetje dhe u kam dhënë disa shpjegime. Jam përpjekur të jem objektiv dhe i drejtë në analiza, pavarësisht nga termat shumë të fortë që kam përdorur disa herë. Por mendoj se gjërat duhen quajtur me emrin e tyre.

Duke analizuar faktet për këtë çështje, në enigmën kineze mua më duket se kryesorja që duhet parë është kjo: A është Partia Komuniste e Kinës në rrugë të drejtë marksiste-leniniste? Ka qenë ajo në një rrugë të tillë? Është vallë ajo në rrugën organizative të një partie leniniste, siç na mësojnë Marks, Engelsi dhe Lenini? (Për të mos folur për Stalinin, ndaj të cilit kinezët kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë kundër. Kinezët flasin pro Stalinin se s'kanë ç'të bëjnë, se morën një herë qëndrim lidhur me këtë çështje, dhe, sa për formë, e vënë Stalinin në opozicion me Hrushovin.)

Natyrisht nuk mund të kem pretendimin se e njoh Partinë Komuniste të Kinës në zhvillimin dhe në organizimin e saj. Por mendimi im është se kjo parti hapin e saj të parë nuk e ka pasë hedhur drejt, në rrugën marksiste-leniniste, qoftë në organizim, qoftë

në parimet leniniste, qoftë në problemet e ndryshme që i viheshin përpara për të zgjidhur, në revolucionin demokratiko-borgjez apo më vonë në fuzionin me Guomindanin, në luftën civile, në luftën kundër japonezëve, në rolin e klasës punëtore, në rolin e fshatarësisë. Pra, në të gjitha këto probleme të dorës së parë mendoj se partia në Kinë ka ecur në mënyrë kaotike.

Ne konstatojmë se, derisa erdhi Maoja në udhëheqjen e partisë, në organizimin e saj, në ideologji dhe në praktikë, u vërtetuan devijime e fraksione që nga Li Li Sani, Van Mini etj., etj. Natyrisht, edhe në partinë e Leninit ngjanë gjëra të tilla, armiqtë e sulmonin nga brenda dhe nga jashtë Partinë Bolshevike; por Lenini veproi kundër tyre me ideologji të qartë marksiste dhe me dorë të hekurt; ai e kaliti partinë dhe i dha asaj normat e pavdekshme që udhëheqin dhe do të udhëheqin vazhdimisht drejt partitë e vërteta marksiste-leniniste dhe revolucionin në botë.

Me të ardhur Maoja në fuqi, mendoj se ky vuri disi rregull, krijoi dhe udhëhoqi ushtrinë dhe luftën, por në organizimin e partisë, në qëndrimet e saj, nuk u vendosën si duhet as parimet bazë, as normat leniniste. Partia Komuniste e Kinës e ngriti emrin e saj, por ajo duhej të kalitej në rrugën e madhe të luftës dhe të pasluftës. Në radhë të parë, pikëpamjet e Maos, të fillimit dhe të tanishmet, mbi hegjemoninë e klasës punëtore dhe mbi alcancën e saj me fshatarësinë nuk përputhen me teorinë marksiste-leniniste. Ato pikëpamje në këtë drejtim janë liberale, pavarësisht nga sloganet, dhe mendoj se këtej e kanë burimin lëkundjet në vijë të Partisë Komuniste të Kinës dhe të Maos.

Këto, siç na mëson teoria dhe praktika, janë lëkundjet e borgjezisë së vogël, të fshatarësisë. Fshatarësia luajti me të vërtetë një rol të madh në luftën nacionalçlirimtare si në Kinë, edhe te ne, por në Kinë ajo nuk u udhëhoq nga ideologjia e klasës punëtore si te ne. Në vendin tonë klasa punëtore nuk dominonte, si numër, ajo ishte shumë e vogël, por ideologjia e saj ishte e madhe. Kjo do të thotë se Partia jonë u organizua në baza leniniste dhe e vuri klasën punëtore në pozita hegjemone.

Kurse në Kinë vërtet u formua Partia Komuniste, por dominonte pikëpamja që «fshati të rrethojë qytetin». Këtej, medoemos, do të rridhnin edhe lidhjet e dobëta organizative të partisë, kjo do të vuante nga norma partie gjysmake dhe në radhët e saj me siguri do të lulëzonin, siç lulëzuan, një sërë fraksionesh dhe deviatorësh antimarksistë, pavarësisht se Li Li Sanët dhe Van Minët u rrëzuan.

Kështu, mendoj unë, Partia Komuniste e Kinës shkoi në luftë e paorganizuar si duhej. Ajo nuk kishte një vijë të qartë dhe nuk mund ta luante rolin e vërtetë të pararojës. Kjo parti u rrit në fraksion dhe vazhdoi me fraksione, herë majtiste, herë djathtiste.

Ushtria dhe lufta i mbulonin këto sëmundje të rrezikshme dhe fraksionistët u grumbulluan nën drejtimin «e zotërve të luftës», por që këtë herë ishin komandantë armatash dhe komunistë, ashtu siç i mendonte Partia Komuniste e Kinës. Partia ekzistonte, por ushtria ishte aq e plotfuqishme, sa mund të gjykohej se nuk komandohej nga partia, por ishte ajo që e komandonte partinë. Të gjithë këta komandantë të shquar e trima e quanin veten komunistë, por komu-

nizmin e kuptonin sipas pikëpamjeve dhe orientimeve jo të sakta, të lëkundura të partisë së tyre.

Maoja, në shkrimet e tij të kohës së luftës, i trajton drejt njaft çështje partie. Me to edukoheshin kuadrot, por sa dhe si edukoheshin, ky është një problem tjetër, pasojat e të cilit do të duken më vonë. Udhëheqësit kryesorë ushtarakë, me Maon në krye, ishin në udhëheqje edhe në kohën e luftës, edhe në atë të pasluftës, dhe kjo ishte një gjë e natyrshme. Tok me ta, në udhëheqjen e partisë dhe të shtetit të ri, erdhën jo vetëm njerëz që kishin bërë luftën, por edhe të tjerë. Kjo zgjedhje u bë gjoja «në forma partie», por në fakt secili udhëheqës solli me vete më shumë njerëzit e tij sesa njerëzit me frymë partie.

Kina e madhe e dalë nga lufta duhej organizuar edhe si shtet. Po çfarë shteti? Shtet i demokracisë popullore, por flamuri i kuq i tij kishte 4 yje që përfaqësonin katër klasat e shoqërisë kineze (!) dhe një yll tjetër në mes. Hegjemoninë e kujt përfaqësonte ky yll? «Të klasës punëtore», thuhej, por reformat ekonomike, politike dhe organizative që bëheshin nuk eenin në këtë drejtim, sepse vetë partia nuk ishte monolite, nuk ekzistonte uniteti ideologjik në radhët e saj, por «unitet» rreth Maos. Kapitalistët vazhdonin të rronin në këtë shtet, bile të merrnin edhe renta.

Liu Shao Çia, nën flamurin e Maos, hodhi në dorë pushtetin dhe partinë. Ten Hsiao Pini drejtonte partinë, kurse Çuja shtetin. Maoja ishte strumbullari rreth të cilit luhej vallja. Ushtria ishte në duart e mareshallit Pin De Hua. Ky grup i fuqishëm manovroi si deshi. Flitej për socializmin, por shkohej në revizionizëm.

Pin De Huaja ishte aq i lirë sa ushtrinë e manipuloi në rrugën hrushoviane, duke huajtur prej saj të gjitha tiparet psikike, politike, materiale dhe organizative. Liu me Pin De Huanë dhe me Ten Hsiao Pinin përgatitnin kundërrevolucionin. Pin De Huaja u shkakua nga Komiteti Qendror dhe vendin e zuri shoku i tij, Lin Biaoja. Reforma të reja krejt të kundërta nga të parat u bënë në ushtri dhe këto bëheshin nga Maoja. Ushtria ishte kurdoherë shtylla, se gjoja e kishte Maoja nën drejtimin e vet. Partinë e kishte Liu Shao Çia, kurse Çu En Lai ishte moderatori oportunist, që kur lindi dhe derisa vdiq. U acarua lufta për pushtet. Po si? Me parulla oportuniste, duke filluar që nga ajo e «njëqind luleve», domethënë e lejimit të të gjitha ideologjive dhe fraksioneve në parti, te «lufta kundër operës dhe universitetit» e gjer te «çdo gjë ta hedhë hapin sipas ushtrisë». Kështu Lin Biaoja u bë «shpëtimtari» i plotfuqishëm. Liu Shao Çia e pa rrezikun dhe u përpoq t'ia ngrinte këmbët Maos, siç ia bëri Brezhnjevi Hrushovit.

Maoja gjithashtu e pa rrezikun dhe ngriti atëherë me miliona hunveibinë. Filloi Revolucioni Kulturor pa udhëheqjen e partisë, pa klasën punëtore. Veproi edhe Liu, dolën «rebelët» dhe të tjera organizata. Në Kinë po bëhej anarki, partia që likuiduar, u likuiduan edhe organizatat e masave dhe filloi atëherë lufta civile midis fraksioneve. Merret, pra, me mend ç'parti komuniste ishte ajo e Kinës! Maoja atëherë i bëri thirrje Lin Biaos, të cilin e mbuloi me tituj, që t'i jepte urdhër ushtrisë të ndërhynte, dhe ushtria ndërhyri. U zhdukën nga ky Revolucion Kulturor Liu Shao Çia dhe disa krye-

sorë si Ten Hsiao Pini. (Se ç'u bë i pari nuk dihet, kurse Teni «u riedukua» dhe tash, si pa gjë të keq, «armiku numër dy» i Kinës ka zënë vendet që kishte më parë.) Lin Biaoja gjatë Revolucionit Kulturor u bë «zot i luftës», ai bënte ligjin; ai botoi dhe përhapi «librin e kuq», «biblën» maoiste; ai bënte pafkat me portretin e Maos, kurse Çen Po Taja fjalimet. Ushtria dominonte mbi partinë dhe pushtetin, u krijuan «komitetet revolucionare», që bënin siç thoshte Lin Biaoja. Ky bënte petulla për vete, «përgatitej ta hidhte në erë Maon dhe ta lidhte Kinën me Bashkimin Sovjetik», siç thuhet. Maoja manovroi, ia ngriti këmbët Lin Biaos dhe bashkë me Çunë i kthyen antenat nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Tregu i Përbashkët Evropian, nga «Evropa e Bashkuar», nga Frankoja e Pinoçeti dhe e deklaruan Kinën pjesëtare të «botës së tretë» tok me Spanjën, Egjiptin, Kilin, Jugosllavinë, Turqinë etj., etj.

Ç'mund të nxjerrim nga një radhitje jo shumë e plotë, e shkurtër, e këtyre ngjarjeve që kanë ndodhur në Partinë Komuniste të Kinës?

Udhëheqja e saj thotë se në Partinë Komuniste të Kinës ka dy vija. Ajo e pranon këtë ekzistencë dhe e vë, më duket mua, si kusht për ekzistencën e partisë, dhe këtë e quajnë lufta e klasave në parti. Mirëpo unë mendoj se nuk ka vetëm dy vija në këtë parti, por shumë vija, që përplasen njëra kundër tjetrës për të marrë fuqinë. Partia është në një kaos dhe nuk zhvillon një luftë klase mbi parime të shëndosha revolucionare marksiste-leniniste, ose më mirë të themi se partia nuk zhvillon aspak luftë klase, por në të bëhet luftë klanesh. Klanet janë në parti dhe në pushtet, në bazë dhe në

udhëheqje. Të gjithë partizanët e fraksionistëve, që gjoja janë dënuar, gjenden brenda në parti dhe vepronë. I gjithë ky zhvillim është kryer dhe po kryhet nën emrin e Maos, i cili po bëhet tabú, mësohen citate të tij, por nën rrogos çdo fraksion bën punën e vet. Maoja vetë, në mos «njëqind lulet», lejon «dy lulet». «Le të jenë dhe le të bashkëjetojnë të dy ose tri fraksionet, pastaj bëjmë nga një revolucion në çdo 7 vjet, — thotë ai, — dhe shohim se kush do të fitojë. Në qoftë se do të fitojnë të djathtët, të majtët do të ngrihen dhe do t'i rrëzojnë». Kjo është «teoria e ndritur e Maos»!! Dhe në fakt kështu ka ngjarë. Që kur erdhi Maoja në udhëheqje të Partisë Komuniste të Kinës, Li Li Sani u rrëzua, u ngrit Van Mini, u rrëzua, u ngrit Liu Shao Çia, u rrëzua, u ngrit Lin Biaoja, edhe ky u rrëzua, vetëm Çu En Lai vdiq duke qëndruar në fuqi. Po tash si do të vejë puna? Ja, në këtë rrugë vazhdon ta ndërtojë Maoja punën. Tash kryeministër s'ka në Kinë, funksionet e kryetarit të qeverisë i kryen Teni, i cili është edhe shef i shtabit të përgjithshëm. Po ne e dimë kush është ky. Si drejtor politik përballë Tenit qëndron Çan Çun Çiaoja, dhe në vend të ministrit të Mbrojtjes, se s'ka akoma, është një plak që anon më shumë nga rryma e Çu En Lait, kurse në ekonomi në krye, pa qenë në krye, qëndron Li Hsien Nieni, njeriu më besnik i Çusë, i Tenit, i Lin Biaos, i Maos, i të gjithëve, por kurrë i mark-sizëm-leninizmit.

Kjo është gjendja në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës, pa lëre pastaj gjendjen poshtë. Atje ka «të majtë», ka «të djathtë», ka «të moderuar», ka çfarë të duash. Të gjithë bëjnë sikur ndjekin vijën e Maos

dhe në fakt janë të detyruar ta ndjekin, se kanë frikë nga grushtet që mund të hanë gjatë luftës fraksioniste, po kjo, në mos tash shpejt, kur të vdesë Maoja, do të pëlcasë. Tash kanë filluar skaramushet: jo ministri i Arsimit është revizionist, jo ai nuk është në rregull etj. Fushata kundër Liut është ulur, tash në rend të ditës është vënë fushata kundër Lin Biaos dhe Konfucit. Deri kur do të vazhdojë kjo? Po ulet? U botuan dy vjersha të Maos dhe u bë bujë e madhe për to. Ç'del nga këto vjersha-parabola? Asgjë s'po merret vesh. Vazhdohet, sipas zakonit, të flitet me dorashka dhe duhet të vijë ekzekutet¹ t'i interpretojnë, siç bëri Lin Biaoja në kohën e tij.

Shkruhet një artikull jo i keq mbi diktaturën e proletariatit, vazhdon daullja kundër revizionistëve sovjetikë, dhe, nga ana tjetër, mbështetet politika imperialiste amerikane. Vihet pyetja: Kush dominon në këtë mes? Të majtët: Çian Çini, Çan Çun Çiaoja, Van Hun Veni dhe Jao Ven Juani, apo të djathtët me Tenin e bandën e tij, apo të moderuarit, oportunistët, revizionistët si Çuja me rrethin e tij? As që mund të përcaktohet dot gjë me saktësi. Kina ecën «për inerci»; thuhet se po forcohet ekonomikisht dhe ushtarakisht, por ideologjikisht dhe politikisht nuk mund të themi se po ecën drejt. Populli kinez është trim, i zgjuar, punëtor, por politikisht dhe ideologjikisht nuk po udhëhiqet në rrugë të drejtë.

Thonë se të majtët dominojnë në udhëheqje, por në politikën e Partisë dhe të shtetit nuk shohim asnjë

1. Nga frëngjishtja — komentues, interpret.

ndryshim të dukshëm. Thuhet se njerëzit e Lin Biaos janë të shumtë dhe kjo mund të jetë e vërtetë; thonë, gjithashtu, se Çu En Lai s'kishte shumë mbështetje veç asaj të Maos. Flitet se po marrin fuqinë njerëzit e Tenit, të tjerë thonë se po e marrin ata të Linit, po kujt t'i besosh e kujt të mos i besosh? Çdo gjë duhet ta përcaktosh nga politika, nga ideologjia, nga veprimet e tyre. Pikërisht këto janë enigma, gjëra jo të qarta, si të njerit dhe të tjetrit.

Ç'tregon kjo? Sipas mendimit tim kjo tregon se Partia Komuniste e Kinës nuk ka një vijë të drejtë marksiste-leniniste, brenda saj ka rryma, ka fraksione, ka lëkundje, se në të s'ka stabilitet, sepse s'ka unitet marksist-leninist në mendime dhe në veprime. Partia nuk është efektivisht në komandë; ushtria ecën, por ajo nuk është nën komandën e partisë; ekonomia ecën, por, gjithashtu, jo nën komandën e partisë; politikë bëhet, por jo e drejtuar nga partia dhe jo në rrugën marksiste-leniniste.

Njerëzit, grupet, fraksionet që punojnë nën ombrellën e emrit të Maos, drejtojnë, përplasen e ç'thonë sot nuk thonë nesër. E ardhmja, pra, e nesërmja e Kinës nuk dihet. Ku shkon, ku do të shkojë dhe si do të shkojë Kina? Kjo s'dihet. Në këto situata, siç e kam thënë edhe herë të tjera, kjo gjendje është me rrezik për revolucionin, për paqen botërore, për socializmin.

Qëndrimet e Kinës ndaj Partisë sonë dhe Republikës sonë Popullore shpjegohen. Ne nuk lëvizim nga pozitat tona të drejta, se udhëhiqemi nga marksizëm-leninizmi. Kurse qëndrimet e kinezëve ndaj nesh janë të lëkundshme. Baza në Kinë na do, ajo flet mirë, kurse

udhëheqja e ka me hope; dikur fliste mirë, pastaj s'fliste fare, tash ia ka dhënë lumit. Kuptohet dhe shpjegohet se këto qëndrime ndaj nesh nuk janë parimore, nuk janë marksiste-leniniste.

Mund të ndryshojnë udhëheqësit kinezë? Mund të kemi më vonë «kohë të mirë»? Çdo gjë mund të ndodhë me kinezët. Ne jemi vigjilentë dhe mbrojmë Partinë tonë, vijën e saj marksiste-leniniste dhe republikën. Ne punojmë dhe do të punojmë për revolucionin.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 200

Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 200

ZËNIA E NJERËZVE MË PUNË — PROBLEM KRYESOR PËR ZHVILLIMIN E FORCAVE PRODHUESE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

28 janar 1976

Në bazë të materialit që i është paraqitur Byrosë Politike dëshiroj të bëj edhe unë disa vërejtje të përgjithshme.

Problemi që shtrohet përbën një preokupacion të madh, që duhet të jetë në vëzhgim të vazhdueshëm nga Partia dhe nga organet e pushtetit. Vija e Partisë për angazhimin në punë të të gjithë njerëzve është konkretizuar edhe në Kushtetutën e republikës. Pra, kjo detyrë partie dhe pushteti është bërë ligj dhe duhet të zbatohet në të gjitha mënyrat.

Por disa e kuptojnë në mënyrë spontane zbatimin e kësaj detyre. Në mënyrë spontane kuptojnë ata edhe

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe mbi gjendjen e fuqisë punëtore të pazënë në punë, problemet që dilnin dhe masat që duhej të merreshin në këtë drejtim.

gjetjen e punës për njerëzit. Kjo, duke qenë një detyrë me rrjedhime ekonomike të mëdha, pozitive ose negative sipas zgjidhjes, ka njëkohësisht edhe rrjedhime po aq të mëdha politike, ideologjike dhe edukative.

Papunësia duhet të konsiderohet si diçka e tmerrshme. Kjo, në rast se nuk merr masat me kohë, në rast se nuk mendon me kohë se ku do të punojnë njerëzit aktualisht e të përgatitësh edhe perspektivën, atëherë, siç vërtetohet në vendet kapitalisto-revizioniste, kalon në të gjitha fazat degraduese të papunësisë, që shkon që nga gjysmëpapunësia, në shomazhin teknologjik dhe deri në shitjen e fuqisë punëtore jashtë, duke lejuar emigrimin dhe skllavërimin e shtetasve nga kapitalistët e huaj. Një gjë e tillë nuk ka ngjarë e nuk duhet të ngjasë kurrë te ne. Ky problem duhet të studiohet vazhdimisht dhe të zgjidhet, por jo me dëkrete pa vend, as të kthehemi te njëfarë robërie ekonomike e njerëzve nga ana e atyre pjesëtarëve të familjes që janë në punë e në rrogë. Të mos e harrojmë asnjëherë të kaluarën, por të punojmë që kjo e kaluar të mos kthehet më kurrë nga pakujdesia jonë.

Duke u bazuar në statistikat që na japin, numrin e punonjësve të zënë me punë në vendin tonë e quaj të kënaqshëm, por nuk kuptoj që në disa familje të ketë marzhe, pra, që disa të qëndrojnë pa punë. Jo, çdo njeri te ne duhet të punojë. Edhe në qoftë se ka momente kur për një kohë shumë të shkurtër ndonjë person në familje nuk është i zënë me punë, duhet bërë çmos nga shteti që ai të sistemohet.

Fshati do të jetë një burim i rëndësishëm pune, po kjo çështje duhet të studiohet imtësisht, pse edhe ky

burim mund të merret si një slogan: «Fshati ka vend, fshati mban». Mirëpo duhet të kemi të qartë ku janë këto vende, cili fshat mban e sa mban, dhe cili s'mban. Në llogaritë tona duhet të kemi kurdoherë parasysh shtesën natyrore të popullsisë si në qytet, ashtu edhe në fshat, duhet të kemi parasysh, gjithashtu, zhvillimin, mekanizimin, automatizimin. Këta tre faktorë bëjnë pjesë në përparimin tonë, për shkak të këtyre proceseve do të dalin vazhdimisht forca të tepërta, të cilat ne duhet t'i vendosim në vende të tjera pune, ndryshe përparimi ynë do të ngadalësohet.

Këto çështje, e të tjera si këto, janë jetike. Më poshtë unë do të flas edhe për zyrat e punës, por zënia me punë është problem i madh në rang shtetëror, është çështje planifikimi që duhet të parashikohet shkencërisht.

Numrin e punonjësve që kanë ardhur nga fshati në qytet ne duhet ta caktojmë nga koha kur kanë ardhur në qytet, por njëkohësisht duhet të vazhdohet puna sgaruese politike me ata që mund të kthehen në fshat. Shifra që na jepet për ata që kanë ardhur në qytet nga fshati mund të na çorientojë, pse mes këtyre, ka shumë nga ata që pavarësisht se kanë nënën e babanë në fshat, kanë 8-9 vjet o më shumë në ndërmarrjet e ndryshme në qytete e në ndërmarrjet bujqësore, për të cilët shteti ka nevojë që të punojnë atje ku janë.

Në sektorët e minierave, të sharrave, të ndërtimeve e të ndërmarrjeve bujqësore mendoj se problemi duhet vënë që të jemi sa më të shtrënguar në marrjen e njerëzve nga fshati dhe të mos kthehen në

fshat me detyrim njerëz që punojnë në këta sektorë prej një kohe të gjatë, veçse me dëshirën e tyre.

Shpërnguljen e fshatarëve nga qyteti duhet ta vazhdojmë, por duke caktuar kriteret e jo duke shkuar nga fakti pse në Tiranë kanë ardhur dhe punojnë nga fshati, kur në qytet ka forca të lira. Çështja vihet të ç'kategorie, të ç'moshe, të ç'seksi dhe në ç'gjendje shoqërore janë këto forca të lira dhe, pasi të bëhet ky kategorizim, atëherë të vendoset cilët do të venë në miniera, cilët në ndërtim e cilët në fshatra dhe kujt do t'i jepet më parë punë në qytet. Të moshuarve mbi 50 vjeç, kur kërkojnë të punojnë, të përpigemi t'u gjejmë ndonjë punë të përshtatshme dhe, në qoftë se ata janë të intoresuar, të presin për pak kohë sa t'u gjendet.

Lëvizjet nga fshati në qytet dhe anasjelltas, nga qyteti në fshat, në miniera o në ndërmarrje bujqësore, nuk duhet të bëhen në mënyrë bruskoze, pa një punë politike sparuese me njerëzit. Përveç kësaj, atyre që do të lëvizin duhet t'u krijohen kushte normale për banim. Thuhet kurdoherë «po, do të marrim masa», por fakt është se në këtë çështje nuk tregohet kujdesi i duhur. Ky kujdes duhet të jetë efektiv, sidomos kur është fjala për vajza dhe për ndonjë të ri ose të re që sapo janë martuar dhe kanë fëmijë të vegjël. Kjo çështje duhet të bëhet problem preokupant i Partisë dhe i pushtetit në bazë dhe të mos pritët t'ua zgjidhë dikush nga lart dhe një nga një. Nga lart jepet direktiva, eaktohen edhe fonde (se baza duhet të nxjerrë ligjërisht fonde nga të sajat) dhe këto direktiva të zbatohen dhe të zbatohen në bazë. Ndryshe, po nuk u

zbatua direktiva si duhet, do të krijohen pakënaqësi. Varet kryesisht nga ne që të mos na krijohen pakënaqësi.

Në lidhje me këto spostime ishte vendi dhe koha të na jepej një raport se sa njerëz kanë kaluar deri tani nga qyteti në fshat, a u vendosën atje dhe ç'probleme ka. Një raport i tillë ka qenë i nevojshëm të na jepej nga organet e Partisë dhe ato të pushtetit, sepse kështu do të kishim një ide më të qartë se si u bë kjo lëvizje dhe ç'konsekuenca të ndryshme pati.

Për zëvendësimin e burrave me gra në qytete kemi caktuar disa kritere, sepse, po ta shohim këtë problem globalisht, do të gabohemi. Zëvendësimi i njerëzve të martuar dhe me stazh në punë nuk mund të bëhet në mënyrë mekanike. Ndërsa për të rinjtë dhe për të rejtat që fillojnë rishtazi punën, drejtimi për ta duhet të jetë të punojnë jashtë qyteteve, kur nuk ka punë për ta në qytete.

Të gjitha këto kritere dhe orientime ndërmarrjet duhet t'i zbatojnë me rreptësi dhe ato të kontrollohen nga organet prej të cilave varen. «Kompetenca» për të shkelur këto direktiva dhe kritere, jo vetëm nuk duhen dhënë nga ministritë dhe komitetet ekzekutive, por shkeljet duhen dënuar.

Sipas llogarive që na paraqiten, për vitin 1976 shifra e të pazënëve me punë nuk është e madhe. Ajo mund të reduktohet akoma, në rast se në qytete do të mbahet parasysh kriteri i ndarjes së njerëzve të pazënë me punë, që thashë më lart, pse do të ketë edhe nga ata, burra e gra mbi 50 vjeç që kërkojnë rishlas punë.

Këto llogari janë në kartë, por problemi më i vështirë qëndron në zbatim kur të bëhen lëvizjet, se si do të organizohen dhe do të koordinohen këto. Kjo çështje duhet zbrërthyer; ky duhet të jetë qederi, se mosorganizimi i mirë i saj do të na vështirësojë zbatimin e planeve dhe do të rëndojë ekonominë familjare nga parazitët, të cilët i krijojnë kokëçarje të tjera Partisë, shtetit dhe familjes.

Me të rejat e qyteteve të mos jemi naziqë. Ato të mos punojnë në miniera, po jashtë minierës ka vende për to, në prodhim po, në fshat po, dhe në disa procese jo të rënda të sektorit të ndërtimeve etj. Në fabrika dhe në administratat, në tregli e në shëndetësi, në sektorët social-kulturorë shumica duhet të jenë gra.

Përqindjet që na jepen se nga forcat e lira në qytete vetëm 0,5-1 për qind nuk kanë asnjë pjesëtar në punë, kurse pjesa tjetër kanë nga 2 deri 4 veta në punë, janë shumë inkurajuese dhe me një vërtetim mirëqenieje. Kjo na krijon edhe një rezervë kohe që duhet të na japë mundësinë, pa krijuar shqetësime ekonomike, të manovrojmë për t'i vendosur në punë të pasistemuarit.

Marrja e punëtorëve nga fshati për ndërmarrjet duhet të jetë një masë ekstreme dhe shumë e kontrolluar, ndryshe do të na rëndohet shumë qyteti.

Ne duhet të mos lëmë asnjë njeri të pazënë me punë, bile të krijojmë vende pune prodhuese më tepër nga sa na nevojiten. Kjo do të arrihet duke u kujdesur çdo vit për forcat e punës, për lëvizjet e tyre, për krijimin e vendeve të punës, jo sipas kritereve të Abdyl Këllezit, por duke ndërtuar fabrika të mundsh-

me e të nevojshme për ekonominë tonë me forcat tonë, si fabrika çimentoje, fabrika çumështi e fabrika të tjera ushqimore rentable, punishte të shumta e të leverdishme, të lira dhe të ndërtueshme brenda një kohe sa më të shkurtër edhe pse shpejt të amortizueshme.

Më vjen rëndë që po e përsëris kush e di për të satën herë çështjen e organizimit të zyrave të punës në rrethe dhe në qendër. A janë organizuar ato ashtu siç kërkohet, që të bëjnë një punë të studiuar dhe të luajnë rolin që u takon? E vlen barra qiranë të merremi me këtë problem, sepse ka shumë interes. Në vendet e tjera zyra e punës është bërë një institucion i rëndësishëm, pse papunësia atje është kthyer në një plagë të tmerrshme, plagë shoqërore me konsekuenca të rënda ekonomike dhe politike. Kriza e madhe botërore në vendet kapitaliste dhe revizioniste ka hedhur në rrugë me miliona të papunë. Një gjë e tillë nuk ekziston dhe nuk duhet të ngjasë kurrë në vendin tonë socialist, por, që të mos na ndodhë, duhet të zbatojmë në mënyrë konkrete dhe krijuese vijën marksiste-leniniste të Partisë në zhvillimin e ekonomisë socialiste.

Te ne zyrat e punës nuk kanë qëndruar në vend, as në rrethe, as në qendër. Por sa herë që e kam ngritur këtë çështje, jam informuar se në këto zyra punë bëhet vetëm një regjistrim i thjeshtë, kurse çdo kërkesë nga ana e ndërmarrjeve, ka raste që plotësohet jashtë dhe përmbi kokën e zyrave të punës. Atëherë, po të veprohet kështu, këto kol që i paskemi ngritur. Në të vërtetë zyrat e punës duhet të bëjnë pikërisht një punë shkencore me ata që kërkojnë punë dhe

me ata që kërkojnë punëtorë. Me fjalë të tjera, ato duhet të kenë në evidencë për çdo person që kërkon të hyjë në punë moshën, seksin, nëse hyn për herë të parë në punë apo jo, profesionin, shkollën, prirjet, gjendjen moralo-politike dhe të tjera karakteristika. Këto të dhëna zyrat e punës duhet t'i kenë të azhurnuara. Njëkohësisht ato duhet të kenë të azhurnuara edhe vendet e punës që disponon rrethi në çdo moment e në çdo ndërmarrje, të njohin se ku janë këto vende pune dhe çdo kërkesë për punonjës, që bëhet nga ana e ndërmarrjeve, duhet të kalojë nga këto zyra, e jo t'i marrin vetë ndërmarrjet.

Qendra, domethënë Komisioni i Planit të Shtetit, që ka një sektor të veçantë për këtë problem, duhet të jetë në lidhje të gjallë me të gjitha zyrat e punës në rrethe dhe drejtoria apo dega qendrore e këtij organi të bëjë koordinimin e specifikuar për të gjitha rrethet dhe për të gjitha specifikat e punës.

Më konkretisht, në rast se do të nevojiten për ndërtimet, ta zëmë, në Kukës 100 veta, atëherë ky organ qendror duhet t'u drejtohet rretheve që ta informojnë për disponibilitetet që kanë në punonjës ndërtimi, të marrë përgjigjen prej tyre, të zgjedhë nga rrethet më të afërta atë që ka nevojë dhe t'ia dërgojë Kukësit. Ose, kur i ka me të dhëna të freskëta evidencat, t'u thotë rretheve: «Nga ata që keni në dispozicion, përgatitni për këtë sektor pune dhe për këtë rreth kaq punëtorë nga qyteti». Veç duhet kujdes që kërkesa të mos bëhet sot për nesër, çdo nevojë të parashikohet më parë dhe në kohë. Gjithashtu të kihet parasysh edhe vësh-

tirësitë që ka një rreth i caktuar për të bindur njerëzit, që ka në dispozicion, të pazënë me punë, që të venë në Kukës apo në ndonjë rreth tjetër që ka nevojë. Nuk e di a është një organizim i përshtatshëm ky që po them. Në qoftë se gjendet i arsyeshëm, mirë, të zbatohet, në mos jo, të mendojmë një tjetër më të përshtatshëm.

Puna në vendin tonë socialist është një nder, por, sipas teorisë marksiste-leniniste, ajo njëkohësisht është një nga format e aktivitetit të njeriut si pjesëtar i qenies shoqërore. Siç thotë Marksi,

«Puna është... një proces që kryhet në mes njeriut dhe natyrës...»¹.

Këndeje duhet të nxjerrim konkluzionin se puna kondicionon jetën materiale të shoqërisë. Të gjithë, i madh e i vogël, anëtar partie ose jo, duhet të dinë se puna është kushti i parë për ekzistencën dhe për ndërtimin e socializmit, por edhe të çdo shoqërie njerëzore.

Duhet të kuptohet teorikisht se puna e zbukuron njeriun. Kjo do të thotë se njerëzit, duke bërë ndryshime, duke transformuar natyrën, duke i kuptuar ligjet e saj dhe duke i vënë këto në shërbim të shoqërisë, ndryshojnë edhe vetë, sepse në procesin e punës bëhen metamorfoza në qenien e tyre njerëzore. Engelsi e ka shpjeguar në mënyrë të mrekullueshme këtë humanizim të njeriut nga puna gjatë çindra miliona vje-

1. K. Marks, Kapitali, vëll. I, libri i parë, f. 243.

tësh. Këtë kuptim të thellë kanë fjalët e tij «puna ka krijuar vetë njeriun»¹.

Puna nuk duhet kuptuar si një nocion idealist dhe i përgjithshëm. Përkundrazi ajo është objektive, matet, është një kategori ekonomike dhe e lidhur si në shoqërinë tonë socialiste, ashtu edhe në shoqëritë e tjera, kapitaliste dhe revizioniste, me procesin e punës. Puna lidh njeriun me natyrën dhe njerëzit me njëri-tjetrin². Mënyra se si realizohet kjo lidhje, pra e njeriut me natyrën, me botën materiale dhe e njerëzve ndërmjet tyre, përbën atë esencë dhe atë realitet objektiv të shoqërisë, qoftë socialiste, ku janë zhdukur klasat shfrytëzuese, qoftë të shoqërisë kapitaliste ku sundojnë shfrytëzuesit. Në shoqërinë kapitaliste ekziston skllavëria dhe shfrytëzimi i egër i punëtorëve, i krahut të punës, nga i cili kapitalisti nxjerr mbivlerën. Kjo shoqëri e urryer është mbarsur me revolucionin që kapitali, imperializmi, socialimperializmi, revizionizmi etj. përpiqen ta mbylin.

Prandaj zënia e njerëzve me punë në vendin tonë është një nga problemet kapitale të zhvillimit të mëtejshëm të forcave prodhuese, të ndërtimit të plotë të socializmit, të kalitjes së vazhdueshme të njeriut tonë të ri me virtyte të pastra komuniste.

Në gjithë këtë zhvillim, në gjithë këtë edukim, teorik dhe praktik, në punë, duhet të kemi kurdoherë parasysh vështirësitë që mund dhe do të hasim, prandaj

1. K. Marks, F. Engels, Vepra të Zgjedhura, vëll. II, Tiranë, 1975, f. 176.

2. Shih: K. Marks, F. Engels, «Ideologjia gjermane», Tiranë, 1993, f. 29.

kërkohet vëmendje, kujdes, organizim dhe ekonomizim i vlerave materiale. Këto duhet të jenë vazhdimisht në këqyrjen tonë dhe kjo këqyrje t'i kapërcejë caqet e sotme për të parashikuar të ardhmen, ç'mund të na vijë më vonë.

Të punojmë që të sjellim të mira për popullin, për socializmin dhe të evitojmë ndodhitë e vështira. Rruga e socializmit dhe ideologjia e Partisë sonë i parashikojnë zhvillimin e proceseve për të ardhmen, perspektivën, veçse, po të mbyllësh sytë, po të notosh në eufori, po të harrosh edukimin e vazhdueshëm politiko-ideologjik të njerëzve dhe të mos dish t'i edukosh këta me punën, e cila është e lidhur dhe krijon të mirat materiale dhe kondicionon formën, mbarëvajtjen dhe forcimin e regjimit, atëherë nuk mund të parashikosh të ardhmen, as të mirat, as të këqijat e vështirësitë që lindin e që duhen kapërcyer.

*Bolohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbalë i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

KUADROT E DALË NGA SHKOLLAT USHTARAKE T'I PËRGATITIM EDHE SI TEKNIKË, EDHE SI EDUKATORE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ
të PPSH¹*

30 janar 1976

Sot në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë do të marrim në shqyrtim relacionin: «Mbi disa probleme të revolucionarizimit të mëtejshëm të punës në shkollat ushtarake». Me siguri shokët do të na flasin si janë me shëndet dhe me punë ushtarët, kuadrot, oficerët?

Dëbora që ra, besoj se ju bën mirë juve, ushtarakëve, për stërvitje, sepse krijon kushte të përshtatshme për kalitjen e ushtarëve dhe të oficerëve. Natyrisht, ne, të moshuarit, tani nuk i ngjitim dot si dikur këto kodra që i shikojmë nga larg, por ju admirojmë ju, të rinjtë, që i ngjitni lehtësisht. Një kohë e tillë është e mirë për stërvitjen e ushtrisë, si në shkolla,

1. Në këtë mbledhje u diskutua mbi disa probleme të revolucionarizimit të mëtejshëm të punës në shkollat ushtarake.

ashtu dhe jashtë, në terren. Për punën e mirë që ju bëni në këto shkolla ne do t'ju lavdërojmë, por edhe do t'ju kritikojmë për disa të meta që janë vënë re. Ju e kuptoni që kritika është kurdoherë e mirë.

Mendoj të flasin shokët me radhë. E fillojmë më parë nga skënderbegasit, sepse kjo shkollë është, si të thuash, fidanishtja e kuadrove të ushtrisë. S'ka nevojë për fraza të bukura: ne ju kemi ftuar në këtë mbledhje që të na flisni lirisht, ashtu si i shikoni ju punët.

Programi i shkollës «Skënderbej» nuk është njësoj me atë të shkollave të mesme të arsimit të përgjithshëm. Kjo është e kuptueshme. Por, ju, a keni konstatuar nëse kultura e përgjithshme që merret në shkollën tuaj është në një nivel me atë të shkollave të mesme të arsimit të përgjithshëm?

Të më falni, se ndoshta kam një çikë dobësi për historinë dhe gjeografinë, ndaj desha t'ju pyes se sa e keni parashikuar sasinë e orëve në planet mësimore të këtyre lëndëve? Pyes për këtë, sepse oficeri duhet të njohë mirë veçanërisht historinë e gjeografinë e Shqipërisë. Kijeni parasysh këtë! Njëkohësisht ai duhet të dijë mirë edhe matematikën, sepse mund të dalë edhe artilier.

Si e gjykoni ju dhënien e marksizëm-leninizmit dhe përvetësimin e tij nga ana e nxënësve në shkollën tuaj? Po me shokët e rinj, sidomos, si veprohet që teoria e mësuar në shkollë dhe në libra të shërbejë sa më shumë në jetë? Shokët ta kenë kurdoherë parasysh se mësimet vërtet duhen përvetësuar, por efektin e tyre duhet ta shikojmë në jetë. Ndaj edhe pyeta nëse ato lëndë

që janë përveçsuar zbatohen apo jo në jetë në mënyrë të ndërgjegjshme.

Po pedagogët a mbajnë lidhje të ngrohta me skënderbegasit edhe jashtë mësimit? A e ndiejnë për detyrë ata që të zhvillojnë dhe të pasurojnë më tej, individualisht, njohuritë e tyre ushtarake, duke mos qëndruar në ato që kanë pasë mësuar njëherë? A bëhen përpjekje që të përmirësohen edhe metodat e dhënies së mësimit, duke përfutur si nga eksperiencia e tyre shumëvjeçare, ashtu edhe nga shkencat bashkëkohore? Vini re ju, në biseda të lira, që të jenë bërë përmirësime e metamorfoza nga pedagogët edhe në drejtim të zgjerimit të horizontit të tyre kulturor, teknik, politik, në fushën e historisë botërore, të luftërave që janë zhvilluar në kohët e shkuara etj.? Zhvillohen në sinkollë debate të tilla që të vërtetojnë se kuadrot tanë nuk qëndrojnë në vend, por e ushqejnë intelektin e tyre dhe dinë të nxjerrin konkluzione të vlefshme nga veprime ushtarake, të themi, të kohëve të kaluara?

Po Luftën Nacionalçlirimtare, pedagogët ua mësojnë si letërsi, si legjendë nxënësve, apo thellohen në shtjellimin e parimeve të saj? A flasin ata për madhësinë e kësaj lufte, për gjithë atë frymëzim e heroizëm që e karakterizonte dhe a nxjerrin nga ajo konkluzione teorike ushtarake?

Po historia e Shqipërisë si studiohet, duke u lexuar si roman, apo duke e bashkërenduar më lëndët e tjera? Ju, drejtuesit e shkollave, a mund të na thoni nëse kjo histori është bërë objekt i një studimi të thellë e të drejtë dhe cilat momente të saj duhet të njohin absolutisht mirë nxënësit e shkollave ushtarake? Pas-

taj, a mund të na thoni se çfarë detyra keni vënë për studimin individual të historisë së Shqipërisë? Kjo ka shumë rëndësi, se po të mos dish historinë e atdheut nuk do të dish as si ta mbrosh si duhet këtë. Studimi i historisë së Shqipërisë duhet të jetë një program tepër i gjerë, që përfshin historinë e lëvizjeve politike, të zhvillimeve ekonomike, të ngjarjeve ushtarake, të pikëpamjeve ideologjike që përkohen nga zhvillimi i luftës së klasave.

Sidoqoftë, kijeni parasysh se historia është dhe duhet të jetë një nga lëndët e para dhe kryesore. Gjetkë mësojnë me hollësi jo vetëm historinë e popullit, por edhe të monarkëve ose të diktatorëve të tyre, pavarësisht se arti i sotëm luftarak i tyre nuk është më ai i kohës së Aleksandrit të Parë ose të Napoleon Bonapartit. Por, këto histori ata i mësojnë në mënyrë të tillë që t'u shërbejnë momenteve aktuale.

Ë them këtë gjë për arsye se historia e vendit tonë e epokave të ndryshme, si e kohës së Skënderbeut, e kohës së rilindësve, e çetave për liri e të tjera është shkruar. Në të ju duhet të gjeni momentet më të rëndësishme e më interesante e t'u referoheni atyre. Bile, të punoni që lëndën e historisë ta zhvilloni në atë mënyrë që ajo të kuptohet sa më mirë. Die fjala, ç'është lufta partizane? Kjo luftë nuk është diçka e krijuar, por është rezultat i një zhvillimi më të përparuar të luftërave të mëparshme të popullit tonë kundër otomanëve, e frymëzuar nga ideologjia marksiste-leniniste. Prandaj, studimi i historisë së Shqipërisë ka rëndësi shumë të madhe. Po e kuptuan mirë ushtarakët historinë e Shqipërisë, të zhvillimit shoqëror të

vendit, të përplasjes së ideve në çdo epokë dhe të luftërave të ishatarësisë kundër bejlerëve, agallarëve dhe pronarëve, po njohën mirë ata taktikat që kanë përdorur gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë në luftime (se edhe ata kanë përdorur taktika në luftime), atëherë do të kuptojnë më mirë tërësinë e zhvillimit të luftës popullore, do të kuptojnë shumë më mirë edhe marksizëm-leninizmin e dialektikën, do të kuptojnë shumë më mirë edhe mësimet që do t'u jepen. Historia jonë është e shkruar, duke u bazuar në materializmin historik që na mëson marksizëm-leninizmi. Prandaj duhet t'i vini rëndësi kësaj çështjeje dhe asgjë të mos kuptohet në mënyrë shabllone.

Po ju në akademi, ku vijnë të specializohen oficerë të lartë, a e keni parasysh se me cilin do të luftoni, duke u bazuar në Artin tonë Ushtarak Popullor? I njihni ju taktikat e luftës së armikut që të dini t'i kundërvini asaj taktikën dhe strategjinë tonë luftarake? Çfarë bëhet konkretisht në këtë drejtim?

Pasi u dhanë përgjigje pyetjeve të bëra dhe pas diskutimeve të të pranishmëve në mbledhje, shoku Enver Hoxha tha:

Jam dakord me vërejtjet që bënë shokët. Relacioni që na jepet për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollave ushtarake, ka një rëndësi të madhe në punën për edukimin e gjithë Ushtrisë sonë Popullore, se pasqyron qartë anët e mira e dobësitë në punën e këtyre shkollave.

Shkollat ushtarake kanë për detyrë t'u mësojnë oficerëve Artin Ushtarak të Luftës Popullore të lidhur ngushtë me ideologjinë marksiste-leniniste, me prakti-

kën revolucionare të ushtrisë dhe me eksperiencën që kanë grumbulluar popujt e botës. Kur them të mësohet arti ushtarak i lidhur me praktikën revolucionare dhe me ideologjinë marksiste-leniniste, kjo ide nuk duhet të kuptohet në mënyrë të ngushtë e shabllone. Unë kam vërejtur se ushtria ka botuar një sërë librash, si: Citate të Marksit, të Leninit e të Stalinit mbi luftën, «Vepra të zgjedhura ushtarake» të Engelsit dhe disa vëllime të tjera nga përvoja e Partisë për punën në Ushtrinë tonë Popullore. Botime të kësaj natyre janë shumë të dobishme e të nevojshme, por dëshiroj të theksoj se shkollat ushtarake dhe Partia në ushtri duhet të botojnë materiale të studiuara, duke u konsultuar me Institutin e Studimeve Marksiste-Leniniste pranë Komitetit Qendror të Partisë. Konsultimi të mos kuptohet sikur punën do ta bëjë vetëm instituti. Atij duhet t'i vijnë çështjet të studiuara e të përgatitura për botim, kurse ai ka për detyrë të japë mendime e këshilla dhe të diskutojë me ata që i kanë përgatitur këto materiale për ta përmirësuar më tej lëndën që mendohet të botohet.

Materialet e botuara të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit janë baza e teorisë sonë marksiste-leniniste, ato janë me shumë vlerë për ushtrinë tonë dhe për cilindo, vetëm se thelbi i shumicës së tyre nuk mund të kuptohet si duhet pa njohur mirë kohën kur u shkruan, objektin që trajtojnë etj. Mendimet e klasikëve tanë paraqesin realitetin objektiv dhe idetë e mëdha shkencore për periudha të caktuara të historisë së luftërave të popujve ose të luftërave që kanë zhvilluar midis tyre fuqitë borgjezo-kapitaliste për ndarjen e zonave

të botës dhe për shtypjen e revolucioneve. Prandaj, që të kuptosh idetë e mëdha të këtyre klasikëve, për shembull, të Marksit mbi Komunën e Parisit, mbi revolucionet e vitit 1848 ose mbi luftën e klasave në Francë, duhet të njohësh edhe historinë përkatëse të secilës ngjarje. Që të përvetësosh mendimet e «gjeneralit», siç e quante Marksi Engelsin, për shkak të njohurive të gjera të këtij të fundit në fushën ushtarake, duhen studiuar të lidhura me njëra-tjetrën ngjarjet të cilave u referohen këto mendime. Analizat aq të holla, aq të sakta e marksiste të Engelsit në fushën ushtarake janë me të vërtetë vepra të një gjenerali të madh. Ato priteshin me padurim për t'u botuar nga të gjitha gazetatat e Evropës, të Amerikës dhe të botës. Nga studimi i thellë i luftërave që janë zhvilluar, Engelsi ka bërë deduksione gjeniale, si për shembull, lidhur me Luftën e Krimesë dhe me pjesëmarrjen në të të ushtarëve të mbretërisë së Piemontit. Në qoftë se nuk njihen përpjekjet që bënin kryeministri Kamilo Benso Kavuri dhe mbreti i Piemontit Viktor Emanueli II për bashkimin e Italisë dhe për sigurimin e aleancës me Napoleonin III, nuk mund të kuptohen vërejtjet e Engelsit, i cili i jep një rëndësi të dorës së dytë trupave të Piemontit në Luftën e Krimesë. Kur Engelsi flet për ushtrinë e Fransua Kanroberit, kryekomandantit të trupave franceze në Luftën e Krimesë, ai bazohet në gjendjen konkrete të ushtrisë franceze në momente të caktuara të historisë së sundimit të diktaturës së Napoleonit III, kur, megjithëse ushtria ishte lënë përtokë, Fransua Kanroberi deklaronte se ushtria ishte e gat-

shme dhe e pajisur me gjithçka, se asaj nuk i mungonin as pullat e getave!

Teoricienët tanë, duke u nisur nga kushtet dhe nga jeta e ushtrisë sonë, janë përpjekur t'i zbërthejnë në praktikë idetë e klasikëve të marksizëm-leninizmit. Partia, gjithashtu, me ato mundësi që ka pasur, në bazë të situatave konkrete të luftës që është bërë dhe të gjendjes së popullit, ka nxjerrë konkluzione të vlefshme për punën në ushtri. Zgjedhjes dhe përshtatjes me kushtet tona të materialeve që mendohen për botim dhe pastaj botimit të tyre u duhet kushtuar rëndësi. Shokët oficerë të mos i lexojnë këto materiale si romane, se kështu nuk mund të përfitojnë prej tyre, por të bëjnë përpjekje që, për të kuptuar idetë e mëdha të klasikëve të marksizëm-leninizmit, të shfletojnë leksione, libra, enciklopedi etj. Pikërisht për këtë arsye përmenda shkurtimisht mënyrën e kuptimit të disa ngjarjeve historike.

Këto që thashë lidhen ngushtë me kuptimin e ideologjisë marksiste-leniniste, me zhvillimin e praktikës revolucionare të ushtrisë sonë dhe me njohjen e eksperiencës ushtarake të popujve të botës.

Klasikët tanë na mësojnë se informacioni është syri dhe veshi i ushtrisë. Me informacion nuk duhet të kuptojmë vetëm të dhënat sa ushtarë ka armiku, çfarë armatimesh përdor ai etj., por edhe çështjen tjetër më të madhe: çfarë taktike do të ndjekë ai për të vënë në jetë strategjinë e tij, çfarë mënyrash do të praktikojë duke u përpjekur për të thyer dhe për të asgjësuar forcat tona. Nuk mjafton të mësohen vetëm lloji dhe fuqia e armëve të armikut, por duhet ditur patjetër

se si do t'i përdorë ai këto armë kundër nesh. Këto të dhëna kanë rëndësi të madhe jo vetëm për t'i studiuar materialet e armikut, por edhe për të reflektuar me kokë mbi ato që ai nuk i shkruan.

Nga sa kam lexuar, mund t'ju përmend vetëm dy shembuj, sa për të argumentuar domosdoshmërinë e njohjes së taktikës e të strategjisë së ushtrive të huaja dhe nxjerrjen e konkluzioneve nga secili shembull, duke u bazuar në taktikën dhe në strategjinë që na mëson marksizëm-leninizmi. Më ka takuar rasti të vete në Austerlic dhe në Vaterlo, ku, siç dihet, janë zhvilluar dy nga betejat kryesore të Napoleonit. Historianët e Napoleonit i mburrin shumë taktikën dhe strategjinë e luftërave të tij, qoftë në Austerlic, qoftë në Vaterlo. Në Austerlic, që është afër Bërnos, Napoleoni fitoi. Nga shpjegimet që më kanë bërë në vend, por edhe nga ato që kisha parasysh nga leximet mbi dispozicionin e ushtrive të mareshalëve të car Aleksandrit të Rusisë dhe të perandorit të austriakëve, del qartë se në Austerlic kundërshtarët e Napoleonit kanë gabuar, kurse Napoleoni nuk gaboi. Mareshalët caristë dhe austriakë kujtonin se e kishin rrethuar Napoleonin dhe në të gdhirë do ta asgjësonin, por ky u mori krahët dhe, kur lindi dielli mbi Austerlic, arriti t'i futë ushtarët e armikut aq thellë në kënetë, sa ushtritë ruse dhe austriake pësuan disfatë të plotë. Dhjetë vjet më vonë, në Vaterlo, fitorja nuk i buzëqeshi më Napoleonit. Në këtë vend është ngritur një pirg i madh mbi të cilin qëndron një luan jo në kujtim të tij, por të dinastisë së Hanoverit. Nga ky pirg mund të shikosh gjithë Vaterlonë. Këtu qëndronin përballë

njëra-tjetrës ushtria angleze e Uelingtonit dhe ushtria e Napoleonit me mareshalët e tij të famshëm Neji, Sult, Davù e të tjerë komandantë të sprovuar të shtabit të tij të përgjithshëm. Napoleoni ngurroi ta sulmonte në kohën e duhur Uelingtonin dhe pikërisht këtë radhë ai gaboi shumë rëndë, se forcat e tij ishin më të forta nga ato të anglezëve. Po të kishte sulmuar me kohë, do të kishte vajtur në lartësinë e Mont Sen Zhanit, ku ishte Uelingtoni, dhe do ta kishte likuiduar atë. Napoleoni priste në Vaterlo që t'i vinte në ndihmë mareshali i tij Grushi, të cilin e kishte dërguar të ndiqte dhe të shkatërronte ushtrinë prusiane. Mirëpo kjo pritje i kushtoi shumë, se në vend të Grushisë arriti më parë në fushën e betejës së Vaterlosë mareshali prusian Blyher me armatën e tij, dhe Napoleoni, që ishte një strateg dhe takticien i madh, e humbi betejën. Sipas mendimit tim, ai e humbi luftën në Vaterlo kryesisht se këtu i mungoi shpirti sulmues që e karakterizonte.

Taktika e armikut nuk duhet marrë kurdoherë ashtu si e publikon ai nëpër manuale. Të gjitha të dhënat mbi strategjinë dhe taktikën e vet armiku nuk i thotë haptazi. Ka shumë mënyra me të cilat ne mund të mësojmë mbi planin e kundërshtarit, por këto mënyra duhet t'i njohim. Duhet ta keni parasysh, shokë, që strategjia dhe taktika janë të mësohen jo ashtu si donte tradhtari Beqir Balluku me shokët e tij, por siç e kërkojnë Arti ynë Usharak i Luftës Popullore, vija e Partisë sonë dhe marksizëm-leninizmi.

Ka rëndësi, shokë, përvetësimi i mirë i artit ushtarak. Çdo kuadër ushtarak, që nga skuadërkomandanti dhe deri te më i larti, duhet që me kokën e tij, në

atë repart ku është, të mendojë që këtë art jo vetëm ta mësojë, por edhe të dijë si ta zbatojë. Të përfytyrojë se si do të vepronte sikur të ishte përballë një ose dy skuadrave apo një batalioni të armikut. Ushtaraku i përgatitur duhet të njohë terrenin me pëllëmbë dhe të imagjinojë jo një version, por shumë versione të sulmit të mundshëm të armikut. Duhet të parashikohet se nga mund të vijë armiku. Ta zëmë se ai do të futet nga Perëndimi. Po ne, do të jemi këtu, ç'do të bëjmë, si do të veprojmë? Duhet të llogaritim mirë se si do ta përballojmë ne këtë sulm. Në këtë drejtim do të bëhet përnjëherë edhe punë politike në përshtatje me situatat e supozuara të luftës. Do të diskutohet me komandantin, se këtu duhet kjo ose ajo ndihmë, duhen kaq apo aq forca; se kjo pikë kalimi e armikut është e rëndësishme. Pra, ushtarakut duhet t'i punojë mendja, se këto zgjidhje që kërkojnë fusha e luftës në momente kritike nuk gjenden në asnjë manual.

Ushtarakët tanë kanë një bazë të shëndoshë ku të mbështeten; ata kanë Artin tonë Ushtarak të Luftës Popullore, kanë metodat dialektike dhe frymën revolucionare politike, vendosmërinë që nuk mund t'i ketë armiku.

Është e domosdoshme të kuptohet se puna për përvetësimin e të gjitha lëndëve ushtarake, që jepen nga ana e pedagogëve dhe që lypset të përvetësohen nga nxënësit, kërkohet të jetë e gjallë, konkrete dhe, natyrisht, e lidhur me realitetin dhe me artin ushtarak. Pra, si pedagogët që i japin, edhe ata që i mësojnë këto lëndë, duhet t'i frymëzojnë kurdoherë shpirti krijues, iniciativa dhe vullneti për një edukim të thellë

proletar, për të përvetësuar shkencën ushtarake në mënyrë krijuese dhe për ta zbatuar si duhet në terrenin tonë dhe në kushtet e luftës.

Shkollat tona ushtarake kanë luajtur vërtet një rol të madh në edukimin e kuadrove, por, para zbulimit të punës tradhtare të Beqir Ballukut, Petrit Dumes, Ifito Çakos dhe të të tjerëve ka pasur edhe shumë të meta në bazën teorike dhe teknike të lëndëve, në organizimin e dhënies së mësimeve, në përvetësimin e tyre, si dhe mungesa të theksuara nga disa kuadro, të cilët nuk e kanë pasë marrë me seriozitet përgatitjen e mësimeve që u jepnin nxënësve.

Sigurisht, pas likuidimit të kësaj pune armiqësore, shkollat ushtarake u vunë në rrugë të drejtë, por asnjëri të mos mendojë se çdo gjë u arrit me një të rënë të shkopit. Sigurisht, jo si më parë, por të metat akoma vazhdojnë të duken, sidomos për sa u përket thellimit të përmbajtjes së lëndëve që japin pedagogët, lidhjes së tyre me praktikën dhe përvetësimin nga ana e nxënësve. Këto kanë të bëjnë shumë me përmirësimin e cilësisë së dhënies së mësimit. Dihet se një metodë e studiuar dhe e shkathët pune quhet revolucionare. E kundërta e saj sjell një punë rutinë që bëhet sa për të kaluar ora e mësimit.

Në metodën e punës së shkollave tona ushtarake, siç na raportohet, ka akoma formalizëm dhe globalizëm si në dhënien e mësimit, ashtu edhe në përvetësimin e tij. Pse ngjet kjo? Pedagogët e këtyre shkollave nuk bëjnë vazhdimisht përpjekjet e duhura për të zhvilluar dituritë e tyre jashtë caqeve të rutinës, për t'u thelluar në lëndët e mësimit që japin dhe për të

nxjerrë konkluzione të reja, të gjalla, shkencore. Vetëm kështu mësimi do të bëhet tërheqës e i kuptueshëm.

Globalizmi në dhënien e mësimit tregon përtaci, mosthëllim dhe paaftësi nga ana e pedagogëve, të cilët duhet ta kuptojnë mirë se u është ngarkuar një detyrë shumë delikate, shumë e rëndësishme dhe me përgjegjësi të madhe.

Që të luftohen shabllonizmi dhe globalizmi, të gjithë kuadrot që japin mësim në shkollat ushtarake duhet të jenë teoricienë marksistë të Artit Ushtarak të Luftës Popullore, njohës të mirë të teorisë marksiste-leniniste dhe të zotërojnë mirë teknikën ushtarake. Të jesh teknikien, që zbaton si duhet vijën e Partisë, nuk do të thotë të jesh teknokrat. Po të shikohet në çdo manual filozofik, merret vesh se teknokracia është një pseudosistem politiko-ekonomik, i cili manifestohet në formën e pushtetit të të gjithë atyre specialistëve që kanë kompetenca teknike. Teknokratizmin, këtë rrymë sociologjike borgjeze me frymë të theksuar antimarksiste, u përpoqën ta futnin në ushtri armiqtë e Partisë. Ata kërkonin t'i kthenin kuadrot ushtarakë, veçanërisht të lartët, në sundimtarë ushtarakë me kompetenca teknike jashtë frymës, ndihmës dhe kontrollit të Partisë. Pikërisht këtë ideologji të teknokratizmit, të krijuar nga kapitalizmi botëror për të mohuar rolin e masave në histori, për të gënjyer proletariatin dhe për të krijuar përshtypjen e rreme se gjoja tani në vend të kapitalistëve drejton prodhimin dhe merr vendime inteligjencia teknike, teknokratët etj., kërkonin të përhapnin në ushtrinë tonë Beqir Balluku, Petrit Dumja e Hito Çakoja.

Vija e Partisë sonë është kundër deri në fund me këto prirje teknokratike. Mos mendoni, shokë, se me luftën që u bë kundër këtyre shfaqjeve dhe bartësve të tyre tani është zhdukur rreziku. Në raport del vetëm maja e veshit e disa prej këtyre shfaqjeve, kur thuhet se në disa shkolla ushtarake nuk ekzistojnë akoma marrëdhënie të shëndosha midis pedagogëve e nxënësve, sepse nxënësit kanë shumë pyetje për të cilat nuk marrin përgjigje të sakta, kanë shumë vërejtje që nuk merren parasysh sa duhet nga pedagogët. Ç'del nga kjo? Del ai pushtet i kuadrove kryesorë që zëmë në gojë.

Pse nuk merren parasysh sa duhet vërejtjet e nxënësve e të studentëve ushtarakë? Sepse pengon mendjemadhësia e disa pedagogëve, të cilëve nuk u vjen mirë kur kritikohen, që duan të ruajnë një autoritet fals, megjithëse qëndrimet e tyre dëmtojnë mësimin. Të tillë pedagogë nuk japin shembullin revolucionar të afërimit proletar me bazën, për krijimin e marrëdhënieve të përzemërta mësues-nxënës. Ky qëndrim është një shprehje teknokratizmi. Me fjalë të tjera, kuadro të tillë, me veprimet që kryejnë, u thonë nxënësve oficerë ose ushtarëve: «Hani këto «gjellë» kështu siç i kemi përgatitur ne dhe mbyllni gojën!».

Pedagogët duhet të bëjnë shumë përpjekje që të studiojnë. Këtë studim të mos e kufizojnë vetëm në nxjerrjen nga dokumentet e Partisë dhe të Këshillit të Mbrojtjes të disa civateve, se këto nuk janë gjithçka, por të thellohen në kuptimin e gjithanshëm të këtyre dokumenteve, të zhvillojnë debate për kuptimin e saktë të thelbit të problemeve që shtrohen. Pastaj, shokë, duhen hedhur në kartë idetë, jo me fraza stereotipo

e të përgjithshme, por në mënyrë krijuese, duke i ilustruar me shembuj konkretë, të marrë, në radhë të parë, nga puna dhe nga jeta e ushtrisë sonë, por edhe e ushtrive të tjera të botës. Ne kurrë nuk kemi rekomanduar që të mos studiohet eksperiencia e të tjerëve, por kemi qenë dhe jemi kundër kopjimit të saj në mësimet e ushtrisë sonë, siç bënin tradhtarët. Eksperiencën e ushtrive të huaja duhet ta njohim për ta kritikuar e për ta luftuar dhe jo për ta kopjuar. Se si duhen luftuar konceptet e huaja borgjezo-revizioniste të luftës, duke u kundërvënë këtyre konceptet marksiste-leniniste të Artit tonë Usharak të Luftës Popullore, këtë gjë duhet ta studiojnë pedagogët në bazë të orientimeve të Partisë, me qëllim që t'ua shpjegojnë nxënësve sa më qartë e sa më drejt.

A është bërë më parë dhe a bëhet tash si duhet kjo punë me kaq rëndësi? Më duket se nuk bëhet siç kërkohet, prandaj pedagogët dhe nxënësit të reflektojnë mbi këtë. Na thuhet se në disa shkolla ushtarake lënda e marksizëm-leninizmit jepet si në Shkollën e Partisë. Kjo tregon njëfarë përtacie e shabllonizmi nga pedagogët e këtyre shkollave ushtarake. Në parim, për shkollat e tjera nuk është e gabuar që mënyra e zhvillimit të lëndëve që jepen në Shkollën e Partisë «V. I. Lenin» të vlejë si orientim, por veç të bëhen përpjekje që lënda të zhvillohet në bazë të nivelit dhe lidhur me nevojat e nxënësit që ka përpara një program ushtarak. Të veprohet ndryshe nuk është e drejtë, ashtu siç nuk është e drejtë që në një shkollë ushtarake kursantët me arsim 8-vjeçar brenda një viti e gjysmë bëjnë po ato mësimet që zhvillohen në tre vjet në Shkollën e

Bashkuar të Oficerëve, ku mësojnë jo nxënës, por studentë universitarë! Unë jam i bindur që në shkollën ku mësojnë kursantë me arsim 8-vjeçar, nuk përfillohet shumë nga një program i tillë pune. Marksizëm-leninizmi është një shkencë e thellë, e cila, që të kuptohet, duhet të zbërthehet, duke marrë parasysh shkallën e zhvillimit kulturor të auditorit. Prandaj shembulli që thashë tregon, përveç të tjerave, edhe një mungesë ndërgjegjeje në punë nga ana e disa pedagogëve që nuk kanë një program të detajuar, për arsye se mendojnë të mos lodhen, pa u merakosur se nga ky qëndrim i tyre dëgjuesit ngarkohen me një shumicë të madhe materialesh të vështira për t'u studiuar prej tyre. Kuptohet se këta nxënës, që kanë nevojë për mjaft shpjegime, duan të bëjnë pyetje, por pengohen, për arsye se ka pedagogë që i shmangen kryerjes së detyrës.

Unë dëshiroj t'u them shokëve të akademisë, veçanërisht pedagogëve, që planet e tyre mësimore, qofshin për mësimin ushtarak, qofshin për atë politiko-ideologjik, t'i bëjnë të studiuara dhe të përshtatshme për studentët ushtarakë. Të mos ndodhë që, duke u nisur nga emri i madh i akademisë, t'u japim studentëve shumë materiale pa i vënë rëndësi cilësisë, sepse kuadrot që vënë në akademi kanë nevojë për t'ua dhënë lëndët me cilësi të lartë. Në qoftë se i zhvillojmë si duhet lëndët e mësimin, këta kuadro do t'i bëjmë të aftë që, në mënyrë individuale, të zhvillojnë më tej dituritë e tyre. Përfundimi i akademisë nuk shënon mbarimin e studimeve për studentin, sepse akademia nuk është fundi për aftësimin e tij, as fundi i zhvillimit të shkencës sonë ushtarake. Jo, çdo shkollë që kryhet;

qoftë në sektorët civilë, qoftë në ata ushtarakë, jep vetëm bazat e mjaftueshme, parimet kryesore, që pastaj studenti të theilohet më tej në studimin e shkencës, sipas specialitetit. Dituritë e njeriut nuk mund të qihen kurrë të plota. Ato përsosen dhe pasurohen vazhdimisht gjatë jetës me praktikën, që vërteton teorinë e mësuar, me studime të mëtejshme dhe me debate konstruktive krijuese për çdo tezë të teorive të ndryshme që përplasen për një problem. Këtij i thonë studim krijues. Në këtë drejtim pedagogët e shkollave ushtarake e kanë për detyrë të bëjnë shumë, pse janë prapa, mendoj unë.

Trajtimi i çështjeve nuk duhet të bëhet kurrë i shkëputur nga problemet aktuale të përditshme të Partisë dhe të ushtrisë sonë. Vetëm kjo punë e kryer me kujdes ngre nivelin ideologjik të leksioneve. Po nuk u përgatitën kështu leksionet, po nuk u zbërthyen e nuk u konkretizuan mirë, niveli i tyre do të jetë i ulët. Përdorimi në to i shembujve të gjallë nga Lufta Nacionalçlirimtare dhe lidhja e tyre me Artin tonë Ushtarak të Luftës Popullore janë të domosdoshëm. Në rast se nuk veprohet siç thashë më lart, nuk do të kemi rezultatet që kërkojmë. Shokët pedagogë ta kuptojnë mirë këtë anë të problemit dhe të mos mendojnë se i njohin deri në imtësi artin ushtarak të popullit tonë, Luftën Nacionalçlirimtare, teorinë, taktikën e strategjinë e saj. Taktika dhe strategjia e Luftës Nacionalçlirimtare nuk ishin spontane, siç mund të duken në një shikim të përciptë. Ato udhëhiqeshin nga orientime të drejta marksiste-leniniste dhe drejtoheshin në mënyrë të organizuar, duke synuar që nëpërmjet tak-

likave të ndryshme të lidhura me luftën që na bënin armiq të, me metodën e luftës sonë dhe me terrenin tonë, të realizohet detyra strategjike kryesore — çlirimi i atdheut.

Në shkollat tona ushtarake duhet të mos mungojnë gjatë tekstet, që nuk janë përgatitur akoma. Pa to, si çdo lëndë, nuk mund të mësohen mirë as lëndët ushtarake. Mendoj se duhet të lihen mënjana shfaqësime, se «kemi pasur punë të tjera». Unë e di që ka pasur shumë punë, por këto punë do të bëhen mirë kur të kemi oficerë dhe kuadro të stërvitur e të edukuar si duhet me Artin tonë Ushtarak të Luftës Popullore.

Shokë të akademisë, ju këshilloj shoqërisht të mënjani krejtësisht shfaqjet e intelektualizmit nga radhët tuaja. Intelektualizmi shfaqet në veprimet konkrete dhe kur ky shoqërohet edhe me përtaci, atëherë krijohet monotoni në dhënie e mësimi, gjë që e bën studentin të mos interesohet si duhet për lëndën. Intelektualizmi dhe monotonia, mungesa e gjallërimit të leksioneve që jepen, hedhja e tyre si «simite» pa kripë brenda e bëjnë studentin skllav të frazeologjive që përdoren në këto leksione. Mendoj se, duke shpjeguar mirë parimet e Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore, udhëzimet e Komitetit Qendror të Partisë dhe të Këshillit të Mbrojtjes, që ju i keni tash në duar, leksionet duhet të pasurohen edhe me shembuj konkretë nga stërvitjet, nga pozicionet luftarake të imagjinuara dhe nga pozicionet e relievit tonë të shumëllojta. Një mësim i tillë i dhënë në shkollat ushtarake i përgatit mirë studentët për terrenin, për repartin, për lojën ushtarake edhe për luftën, në rast nevoje. Në qoftë se të gjitha

mësimet i zhvillojmë me një frymë të tillë të gjallë — dhe kështu duhet t'i bëjmë — atëherë do të kemi rezultate më të mira edhe në terren.

Këto, shokë të ushtrisë, kërkojnë që ju të kuptoni thellë edhe se ç'është demokracia proletare në shkollë. Demokracia proletare në marrëdhëniet midis pedagogëve, nga njëra anë, dhe nxënësve e studentëve, nga ana tjetër, nuk ul asnjë prestigj, të kujt do qoftë, asnjë autoritet, të kujt do qoftë, përkundrazi, ajo i çelikos marrëdhëniet në mes pedagogëve e studentëve me një dashuri të sinqertë, me një respekt të thellë. Pyetja, kritika, autokritika i edukojnë dhe i sqarojnë njerëzit, bëjnë që ushtria jonë të jetë ashtu si quhet, një Ushtri e vërtetë Popullore dhe jo ushtri e kastave. Prandaj të mos i shmangeni ballafaqimit, si në akademi, edhe në shkollat e tjera.

Pse nuk japin llogari pedagogët e këtyre shkollave përpara studentëve? Pse preken ata prej vërejtjeve të tyre? Pedagogët e dinë që jo të gjithë punojnë si duhet, e dinë, gjithashtu, se nxënësit dhe studentët e tyre kanë kapacitet, janë të zgjuar dhe kanë dëshirë të dalin të aftë nga shkolla për të udhëhequr mirë repartin ku do të shërbejnë, prandaj bëjnë pyetje dhe kërkojnë llogari. Atëherë është detyrë nga ana juaj, shokë, që t'u jepni llogari. Kush ndërton marrëdhënie të tilla është më i dashur për nxënësit, studentët dhe trupën. Kurrë të mos mendoni se nxënësit ose studentët janë të paaftë. Natyrisht, zotësinë dhe eksperiencën e pedagogëve ata nuk e kanë sot, por nesër do ta fitojnë dhe do të ecin përpara. Ata janë dërguar në shkollë që të fitojnë njohuritë e nevojshme dhe ju e keni për de-

tyrë t'ua jepni këto njohuri dhe diturinë marksiste-leniniste.

Gjithashtu, ju duhet të kuptoni se me të vërtetë ka ndarje pune, por ajo nuk është ashtu sikurse e mendojnë disa, që shkojnë në rrugën e njëanshmërisë. E kam fjalën këtu për një pjesë të atyre pedagogëve, të cilët mendojnë se kanë për detyrë vetëm të mbajnë referate brenda kohës së caktuar e pastaj të marrin çantën e të çajnë ferrën, pa pyetur e pa u interesuar më çfarë bëhet në shkollë, sepse këtë, sipas tyre, «e di komanda». Të tillë pedagogë nuk e kuptojnë si duhet detyrën e madhe që kanë jashtë orarit të mësimit për edukimin moralo-politik të nxënësve e të studentëve, për t'u ngulitur në ndërgjegje ndjenjën e respektimit të rregullit e të disiplinës dhe për t'u futur në botën e tyre të brendshme që të njohin nga afër gëzimet dhe hallet që mund të kenë. Të gjitha këto vallë duhet të zgjidhen në rrugë administrative, vetëm nga komandanti? Nuk e kanë parasysh këta pedagogë porosinë e Komitetit Qendror të Partisë që në komandë të bëjnë pjesë shokë ushtarakë dhe politikë? E kuptojnë ata se kjo do të thotë që taktika, politika dhe ideologjia duhet të ecin së toku?

Sistemi «Tejlor» nuk ka vend në shkollat tona ushtarake marksiste-leniniste, prandaj për rritjen e nivelit të mësimit, për gjallërimin e tij dhe për përgatitjen nga ana politike dhe ideologjike të të gjithë studentëve oficerë, duhet të veprojmë ashtu siç thashë më lart. Në rast se ecet në rrugën e dhënies së mësimit në forma burokratike dhe rutine, atëherë nuk mund të bëhet fjalë për zhvillimin e shkencës sonë ushtarake.

Më kanë vënë në dijeni se në stërvitjet që janë bërë kemi pasur shumë suksese, se ato janë zhvilluar në një nivel të mirë, se kuadrot janë treguar të aftë të veprojnë në kushte e në situata të ndryshme etj. Unë ju përgëzoj për këtë gjë, shokë të ushtrisë. Mirëpo këtu shoh se pedagogët e akademisë dhe të shkollave të tjera presin të marrin analizat që do të bëjnë komandat për këto stërvitje. Kjo pritje nuk është e drejtë. Komanda e Përgjithshme do të bëjë analizën marksiste-leniniste të këtyre stërvitjeve dhe këtë do t'jua çojë edhe juve që të orientoheni për përgatitjen e mësimeve që jepen, por kjo punë nuk është e plotë. Kuadrot dhe pedagogët duhet të mos presin, por të interesohen shumë që të bëjnë edhe vetë përgjithësimet, të thonë mendimet e tyre, të nxjerrin konkluzione dhe jo vetëm nga këto stërvitje, por edhe nga puna kur shkojnë në terren. Është absolutisht e nevojshme për ta të shkojnë në terren, në trupa, që të përgjithësojnë stërvitjet e bazës. Atje vlerësohen kuadrot e njësive të ndryshme dhe shihet dobia e mësimeve që u janë dhënë këtyre kuadrove në shkollë. Njohja me bazën do të shërbejë për të ecur edhe më përpara dhe për të korrigjuar të metat në dhënie e mësimeve.

Prandaj, shokë pedagogë të shkollave ushtarake, ju rekomandoj që të kualifikoheni dhe të mos ngurroni për perfeksionimin e bazës materiale. Me forcat tona, në të gjithë sektorët, ne kemi krijuar gjëra me vlerë, që përpara dukeshin të pamundura për t'u bërë, kurse sot nuk qenka e mundur të ngrihen disa kabinetet!

Partia, si kurdoherë, duhet të jetë në krye të punëve, komunistët të prijnë në ballë të vështirësive.

Nuk mund të mendohet që Partia në ushtri të merret vetëm me pranimin e komunistëve të rinj, me ndëshkimin e atyre që nuk respektojnë Statutin, me lëvizjet e kuadrit, me thirrjet në raport të studentëve për thyerje disipline etj. Këto detyra duhen kryer me rigorozitet e në mënyrë të drejtë nga Partia, se kanë një rëndësi të madhe edukative etj., por duhen kryer edhe të gjitha punët e ushtrisë që thashë më lart, duke ushtruar mbikëqyrje për to. Ndryshe, kush do t'i ndreqë të metat që vërtetohen, kush do t'i kontrollojë, do t'i ndihmojë dhe do t'i korrigjojë të gjithë ata që gabojnë ose që punojnë keq? Pra, puna e Partisë është shumë e gjerë. Po të mos kuptohet kështu çështja, Partia në ushtri do të vihet në bisht të situatës. Këtë gjendje asnjëri nuk e do, prandaj do të luftojmë që të mos na krijohet.

Neve nuk na mungojnë kuadrot për të dhënë mësim. Në të gjitha shkollat kemi një numër të konsiderueshëm pedagogësh, që kanë mbaruar Akademinë ose Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe që kanë një përgatitje të mirë. Këta bëjnë pjesë në organizatat-bazë të Partisë, ku ka edhe kuadro me arsim të ulët, të cilët nuk duhen nënvleftësuar. Në organizatë nuk duhet të predominojë mendimi i kuadrit të lartë, qoftë ky edhe mendim i mirë. T'i lëmë të flasin edhe kuadrot me më pak shkollë, t'i dëgjojmë ata me respekt, të jemi më modestë në bashkëbisedimet që bëjmë me ta, t'u plotësojmë mendimet kur e kanë zor të shprehen, t'u korrigjojmë gabimet që bëjnë, por t'i lejojmë që edhe ata të korrigjojnë gabimet tona. Prandaj Partia në ushtri nuk duhet të kufizohet në disa veprime, por të jetë e pranishme në të gjitha çështjet.

Me metodën e punës për demokratizimin e jetës së shkollës dhe për realizimin e boshtit ideologjik marksist-leninist në brendinë e leksionit të kihet parasysh që të inkurajohen të shkathtit, të zgjuarit, të vendosurit, të ndihmohen të prapambeturit, të kritikohen të mefshtët. Të gjitha këto i përkasin veprimtarisë së Partisë dhe revolucionarizojnë shkollën e njerëzit. Po të bëhet mirë kjo punë, kemi siguri të plotë në revolucionarizimin e ushtrisë. Kështu kuadrot e dalë nga shkollat ushtarake do t'i përgatitim edhe si teknikë, edhe si edukatorë të vërtetë, të aftë që të drejtojnë ushtrinë, e cila do t'i dojë dhe do t'u vejë pas.

E kam theksuar edhe herë të tjera dhe Komiteti Qendror i Partisë ka bërë shumë herë vërejtjen që ushtarët dhe shumica e kuadrove janë të rinj, prandaj organizata e rinisë duhet të jetë shumë më e gjallë nga çështë sot. Partia në ushtri të ketë parasysh se një nga detyrat kryesore të saj është ndihma që duhet t'u japë organizatave-bazë të rinisë dhe të rinjve veçanërisht. Është e domosdoshme që kjo të zbatohet në të gjitha shkollat, që nga dhënia e mësimit, i cili nuk duhet të bëhet i sipërfaqshëm.

Në shkollat tona ushtarake nuk ka vetëm gjëra për t'i kritikuar, po ka edhe shumë punë për t'u lavdëruar, por këto kritika i bëra se jam i bindur që do të ndihmojnë për të ecur përpara. Dëshiroj të theksoj me këtë rast se, në krahasim me të kaluarën, është shënuar një kthesë shumë e mirë në punën e shkollave, janë gjallëruar pedagogët, nxënësit dhe studentët. Materialet e plenumeve të Komitetit Qendror, si për gjithë Partinë, kanë qenë një armë e madhe edhe në du-

art e ushtrisë. Ju, shokë, keni parë të metat dhe gabimet, jeni thelluar në to, keni nxjerrë konkluzione, keni kuptuar mirë rrezikshmërinë e tradhtisë së Beqir Ballukut, të Petrit Dumes, të Hito Çakos e të të tjerëve dhe i keni dënuar e dërrmuar ata. Besimi juaj i madh te vija e drejtë e Partisë ka shkaktuar këtë lthesë rrënjësore jo vetëm në shkollat ushtarake, por në të gjithë ushtrinë. Këshilli i Mbrojtjes ka marrë në shqyrtim shumë probleme me një rëndësi jetike. Më kanë raportuar vazhdimisht dhe konkretisht për zbatimin e detyrave dhe Këshilli i Mbrojtjes është i kënaqur, por, siç na mëson Partia, asnjëherë nuk duhet të notojmë në eufori. Ne kemi për detyrë të zbatojmë plotësisht vendimet, të mësojmë, të zhvillojmë pareshur dituritë tona, që ta bëjmë ushtrinë të aftë nga çdo pikëpamje. Në masat që ka marrë Partia për forcimin e ushtrisë, një rol të rëndësishëm luan edukimi i kuadrit, prandaj detyra juaj, shokë të shkollave ushtarake, është e madhe dhe me shumë përgjegjësi. Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Mbrojtjes kanë besim te ju, te patriotizmi juaj i madh dhe te dashuria juaj e pafund për Partinë.

*Botuar për herë të parë,
me shkurtime, në librin:
Enver Hoxha, «Raporte e
fjalime 1976-1977», f. 22*

*Botohet i plotë sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Sekretariatit të
KQ të PPSH, që njendet në
AQP.*

**EDHE NGA GURI MUND TË NXIRRET GRURË,
NË QOFTË SE KUPTOHET DREJT RRETHIMI
IMPERIALISTO-REVIZIONIST**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

30 janar 1976

Ju, shoqe e shokë, mbase vini për herë të parë në Sekretariatit e Komitetit Qendror të Partisë, megjithatë mos u emociononi.

Në këtë mbledhje ne jemi të tërë shokë partie. Këtu ne i shprehim mendimet hapur, flasim ashtu siç mendojmë. Ne presim këshilla dhe vërejtje sidomos nga ju. Partia kërkon që jo vetëm ne t'ju kritikojmë juve, por edhe ju të na kritikoni ne, sepse edhe këtu nuk dalin kurdoherë gjërat të përsosura. Ju bëtë shumë mirë që erdhët.

(Duke iu drejtuar shoqes Leta Bardhi²): Ti, sigurisht je takuar me shoqe të tjera kooperativiste dhe ke biseduar me to, prandaj të na flasësh hapur për pro-

1. Në këtë mbledhje u diskutua për punën e Partisë në rrethin e Beratit lidhur me zbatimin e direktivave të KQ të PPSH për zhvillimin e zonave malore dhe të luftës së klasave.

2. Në atë kohë kooperativiste nga Kutalla e Beratit.

blemet që po diskutojmë, nga pozitat e kooperativistes së thjeshtë.

Në Kutalli kam çenë¹ dhe e mbaj mend mirë kooperativën tuaj. Tani ju duhet të keni bërë përparrime të mëdha.

Kur keni probleme ose kur ju vjen ndonjë direktivë nga lart, ka diskutime të gjalla në organizatën-bazë, apo bëhen mbledhje sa për të kaluar radhën? Më parë e zbërtheni problemin që shtrohet dhe pastaj filloni nga debatet, apo procedoni ndryshe?

Keni bërë ndonjëherë mbledhje të organizatës-bazë të Partisë duke thirrur nja shtatë a tetë veta, anëtarë të Bashkimit të Rinisë ose pleq etj., që të dëgjojnë dhe të thonë ndonjë fjalë edhe këta?

Pasi shoqja Leta Bardhi iu përgjigj pyetjeve të mësipërme, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Dua të të pyes edhe diçka tjetër. A mund të na thush, kështu si para nesh flet edhe atje kur je në mes shoqeve të tua, apo akoma më lirisht e më hapur?

SHOQJA LETA BARDHI: Po, shoku Enver, hapur flas edhe në mbledhjet tona, sepse hapur duhet t'ia themi Partisë të gjitha ato që kemi për t'i thënë.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo vetëm hapur, por mbarë e prapë, ashtu si mendoni.

SHOQJA LETA BARDHI: Të flasim hapur dhe për probleme të ndryshme.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, edhe për probleme të ndryshme, për të gjitha, si i thonë, «edhe për djepin e hankos», pavarësisht se mendimet mund të

1. Më 27 shkurt 1969. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 40, f. 214.

mos shprehen mirë. Në raste të tilla nuk na hyjnë shumë në punë lidhjet gjuhësore që u bëhen fjalëve, por mendimet, propozimet e gjalla. E lidhe mirë a s'e lidhe mirë frazën që shqiptove, kjo nuk ka shumë rëndësi.

SHOQJA LETA BARDHI: Do të luftojmë për rendimente të larta sidomos në drithërat e bukës, pa lënë pas dore edhe bimët e tjera bujqësore.

SHOKU ENVER HOXHA: Drejt e ke, në radhë të parë drithërat e bukës, për arsye se drithi është problem në të gjithë botën. Sasi më të mëdha të drithit i kanë në dorë kapitalistët, që me to bëjnë edhe presione. Ne duhet t'i kapërcejmë këto presione të tyre, prandaj vendimi që keni marrë ju për të situar prodhimin e drithit dhe të bimëve të tjera, është me rëndësi të madhe jetike. Ne kemi besim se ju do t'i realizoni detyrat. Kur të ktheheni në fshat do t'u thoni kooperativistëve: «Unë isha në Sekretariatit e Komitetit Qendror dhe diskutova. Shokët e Sekretariatit ishin dakord me diskutimin që bëra».

Ju urojmë suksese në punën tuaj, në qoftë se nuk keni gjë tjetër për të thënë.

Përveç atyre që do të na thuash shkurt ti¹, shoku nga Berati, për kooperativën tënde, dëshiroj të na shprehësh mendimin edhe për kooperativat e tjera malore që nuk i kryejnë detyrat.

Në formimin tuaj si komunist, domethënë në kuptimin e çështjeve teorike të Partisë, ju ndihmojnë gjë

1. I drejtohet shokut Zalo Hamzaj, në atë kohë kooperativist nga Karkanjozi i Beratit.

leksionet dhe dokumentet që dërgon Komiteti Qendror i Partisë? I kuptoni si duhet këto materiale, apo ndieni vështirësi?

Po kur mbliidheni atje bashkë me instruktorin e Komitetit të Partisë, si i zhvillon mbledhjet? Ka zyrtarizëm në këto mbledhje që bëni apo ka frymë shoqërore? Ju mund të veproni edhe kështu: Të grumbulloheni në shtëpinë e ndonjë shoku e, duke biseduar, të rrihni probleme. S'prish punë po nuk pati tavolinë: uluni afër oxhakut dhe, si komunistë që jeni, bisedoni për çështje të rëndësishme. Mbledhjet zyrtare ku dikush nxjerr letrën nga xhepi dhe flet e të tjerët thonë «amin», e mbushin protokollin, nuk vlejné kurdoherë. Unë e kam fjalën këtu jo për mbledhje të organizuara, por për takime shoqërore. Bëhen këto apo jo?

Ti, fjala vjen, a vete në shtëpinë e kushërinjve, të shokëve dhe vëllezërve, a bisedon për probleme të fshatit, për plehun, për grurin pse u bë kështu, pse u bë ashtu? Po këtë bisedë popullore a nuk mund ta shtrijmë edhe ndër komunistët? Pse të këtë zyrtarizëm në marrëdhëniet midis tyre? Kur flet gju më gju me sekretarin e parë të komitetit të Partisë, ti e konsideron atë njësoj si veten dhe ashtu duhet ta konsiderosh, që të bisedosh lirisht. E kemi drejt këtë mendim, apo mos nuk duhet vepruar kështu, por ndryshe?

SHOKU ZALO HAMZAJ: Është shumë e drejtë, shoku Enver, por nuk e kemi bërë kështu. Nëpërmjet këtyre bisedave gjendja njihet më mirë, problemet zgjidhen më drejt dhe konkretisht. Unë nuk mendoja që këtu, në Sekretariatën e Komitetit Qendror, të bi-

scdonim gju më gju me ju, shoku Enver, dhe me tërë udhëheqjen e Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po pse jo, edhe unë jam komunist si gjithë të tjerët.

Pasi shoku Zalo Hamzaj iu përgjigj pyetjeve të bëra dhe diskutoi për problemet që po trajtoheshin, shoku Enver Hoxha iu drejtua shoqes Sofie Çuedari, në atë kohë punëtore në Uzinën Mekanike të Qytetit Stalin:

Atëherë, kur kam ardhur unë në uzinën tuaj, ajo ishte në ndërtim e sipër. Tani sigurisht që është zgjeruar shumë. Unë nuk kam mundur të vij tani afër, se, siç jeni në dijeni, këto vitet e fundit kemi pasur shumë punë.

Së pari, shoqja Sofie, doja të të pyesja se a ka mundësi në uzinën tuaj për ta zëvendësuar punën e burrave, që janë të rinj në moshë e në profesion, me atë të grave? Ç'bëjnë komiteti i Partisë dhe komiteti ekzekutiv, pse nuk i zëvendësojnë këta atje ku mund të bëhet kjo? Unë, sigurisht, nuk e kam fjalën këtu për ata që janë të vjetër.

Pasi diskutoi edhe shoqja Sofie Çuedari, shoku Enver Hoxha, duke iu drejtuar shokut Vangjel Ziu, në atë kohë nastëtar në Qytetin Stalin, tha:

Sipas mendimit tënd dhe të shokëve të tu, ka apo nuk ka naftë në Qytetin Stalin? Ç'thonë punëtorët për këtë gjë? Ç'mendon ti për gjecologët, janë kurajozë apo jo, kanë guxim apo nuk kanë?

Puset e vjetra, në Qytetin Stalin, janë prishur, apo tubacionet gjenden akoma në to? Kontrollohen ato herë pas here, për të parë nëse grumbullojnë naftë? Keni zbuluar aty rrotull naftë në gëlqerorët?

Ti ose shokët e tu, që janë sekretarë organizatash, jeni thirrur ndonjëherë në Institutin e Naftës e të Gazit, në këshillin shkencor etj. që të dëgjoni se si flasin e diskutojnë atje inxhinierët e gjeologët?

Pasi diskutoi shoku Vangjel Ziu e pas diskutimeve të shokëve të tjerë, shoku Enver Hoxha tha:

Në raportin që na është paraqitur për zhvillimin e zonave malore dhe për luftën e klasave në rrethin e Beratit, konstatoj se puna e pushtetit, veçanërisht në këtë rreth, është e dobët. Nuk mjafton vetëm të themi se kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit «nuk e ka kryer detyrën» dhe me kaq të kalojmë vetëm duke thënë se «ai ka përgjegjësi të rëndë», por mendoj se për këtë shok, të cilit nuk i mungon eksperiencia, Sekretariati duhet të gjejë për ç'arsye nuk e ka kryer si duhet detyrën me kaq përgjegjësi që i është ngarkuar.

Për shembull, ç'e ka penguar atë që për dy vjet me radhë nuk i ka paraqitur komitetit ekzekutiv ndonjë studim për punën e organeve të pushtetit dhe për problemet e kooperativave malore e kodrinore? Vetëm nga kjo ne duhet të nxjerrim konkluzionin se ka një nënvleftësim nga ana e organeve të pushtetit dhe e seksionit të bujqësisë të rrethit të Beratit për zhvillimin e kooperativave malore e kodrinore. Ky nënvleftësim është i dënueshëm, ca më tepër edhe për arsyet që thuhet në raport, se rezervat dhe mundësitë për zgjidhjen e problemeve, sidomos për të marrë rendimente të larta në drithërat e bukës, kanë qenë të shumta. Këtë na e vërtetojnë rezultatet e arritura në kooperativat malore të Karkanjazit dhe të Tomorit. Të

dyja këto kooperativa, si dhe të tjera kanë marrë rendimente të larta në grurë. Gruri atje nuk është bërë vetë; kanë punuar mirë njerëzit me tokën, kurse në disa kooperativa të tjera, si në atë të Sinjës, të Tërpanit, të Mbrakullës, të Roshnikut e të Lumasit, nuk është punuar si duhet.

Ju na keni sjellë këtu shokë e shoqe nga ato kooperativa që e kanë realizuar planin e grurit, po pse nuk na sollët edhe një shok nga një kooperativë tjetër ku marrin pak të ardhura për ditë-punë? Pse na keni sjellë ata më të mirët dhe nuk na sollët nga ata të tjerët që t'ua «lanim një çikë kokën»? Mos është kjo një prirje për të na fshehur të metat? Ju bëtë mirë që na i sollët këta shokë e shoqe dhe ne do të themi fjalë të mira për ta, por të na kishit sjellë edhe nga ata që kanë punuar keq.

Po çfarë t'i them, fjala vjen, kësaj shoqes nga kooperativa e Kutallisë? Kjo kooperativë shkon mirë, këtë ne e dimë me kohë. Ti bërë mirë që erdhe, moj shoqe, dhe, pasi të mbarojmë mbledhjen, do të bëjmë një fotografi së bashku edhe me këta shokët e tjerë, por, në këtë mbledhje, do të ishte mirë të diskutojmë edhe për ata që nuk i kanë kryer detyrat. Kijeni parasysht që të vijnë këtu e të mësojnë edhe ata që e bëjnë punën, por edhe ata që nuk e bëjnë punën.

Drejtuesit e Partisë e të pushtetit në rreth dhe të të gjitha këtyre kooperativave, si dhe vetë kooperativistët të mos vijnë të na thonë se terreni ynë është malor dhe të mbulojnë me këtë dobësitë e të metat në punën e tyre. Ne e dimë që në pjesën më të madhe territori ynë është malësi, por Partia na mëson që edhe

nga guri mund të nxirret grurë, në qoftë se kuptohet drejt rrethimi imperialisto-revizionist dhe merren të gjitha masat e nevojshme, i qëndrohet punës në kokë dhe zbatohen një për një të gjitha kërkesat e kodit agroteknik. Rrugë tjetër për ngritjen e mirëqenies së mbarë popullit tonë, si dhe të vetë krahinave kodrinore e malore, nuk ka. Disa nga këto kooperativa nuk kanë arritur të marrin as 10 lekë për ditë-punë, bile ka nga ato që mezi kanë marrë nga 6-7 lekë. Mund të ketë kooperativistë që janë të kënaqur me një nivel të tillë të ulët të ardhurash, por ne u themi atyre se Partia nuk është e kënaqur dhe këtë e thekson për të mirën e tyre, ashtu edhe për të mirën e republikës. Këto vende janë fole trimash, të cilët në të kaluarën kanë luftuar dhe kanë derdhur gjak për një jetë më të mirë. Atëherë realiteti të shikohet ndryshe: socializmi duhet ndërtuar si në fusha edhe në male. Në zonat malore, natyrisht, ka ca vështirësi më shumë dhe kjo është plotësisht e vërtetë. Po të mos ishim hedhur nëpër male gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, nuk do ta kishim çliruar dot atdheun. Liria na erdhi nga malet, prandaj e kemi për detyrë që t'i çojmë edhe në male të gjitha të mirat e socializmit.

Ju, shokë të rinj e të reja, mos e harroni kohën e Luftës Nacionalçlirimtare, se ne më të moshuarit s'e harrojmë kurrë atë kohë, kur luftonim në male dhe fshatari ynë patriot ndante me ne krodhën e bukës prej misri. Ju e njihni ose keni dëgjuar për Shmilin e Elbasanit. Vendi atje quhej Çermenikë e Zezë dhe ishte me të vërtetë e zezë, populli vuante për bukë, por zemrat e miqve të mi e të Partisë, të paharruar e patriotë, si Ali Disha, Zenel Disha, Sherif dhe Ram Çeka, Halil

Bozhiqi, Ram Karagjozi, Ali Gjura e të tjerë, e të tjerë, buçitnin nga entuziazmi për Partinë. Shtabi ynë ka qëndruar në kasollet e tyre dhe ka ngrënë krodhën e bukës së misërt e gjizën si gëlqere, që atëherë na dukeshin më të ëmbla se mjalti. Nganjëherë edhe kjo bukë na mungonte.

Një natë plaka e Ali Dishës s'kishte ç'të më jepte, prandaj nga një sepet i vjetër nxori një dardhë dimërore dhe ma dha në vend të bukës. E mora, e vura në xhepin e xhamadanit dhe u shtriva për të fjetur pranë Abazit të vogël 3-4-vjeçar, që tash duhet të jetë bërë burrë i fortë. Në mëngjes ai u ngrit dhe më përgëzonte nagantin. I thashë: «Lëre koburen, gëzo «bombën»!» dhe ai mori menjëherë dardhën e munda urinë.

«Shoku komisar, — më tha njëherë Ram Karagjozi, — duhet të vish edhe në kasollen time, se më ngelet qejfi».

«Që tash», — i thashë.

Morëm pushkët dhe Rama përpara e unë pas, nëpër dushk, duke çarë errësirën e natës, arritëm në kasollen e tij. Rama më ndezi zjarr, më ngrohu ca qumësht e kulaç dhe më tha: «Të ta grij, o shoku komisar?». «Grije Ramë!», — i thashë.

Pasi hëngrëm në dritën e zjarrit, Rama më pyeste:

«O shoku Enver, ç'do të na sjellë neve, të varfërve, kjo luftë?».

«Dëgjo, Ramë, — i thashë, — mbaje mend këtë që po të them: Unë mund të vritem, kurse Partia dhe populli s'do të vdesin kurrë, ata do të rrojnë dhe do të fitojnë, çdo gjë në Shqipëri do të jetë jona. Ja, edhe këto kodra të thata me dushk të Shmilit do të mbushen

plot me dhen e me dhi, misri do të bëhet një bojë njeriu, do të mbillen dardha e vreshta».

«Jarabi, kështu dhashtë zoti e u bëftë», — thoshte Rama.

Unë nuk e prekja në besimin e tij, po i thosha: «Këtë do ta bëjnë Partia dhe partizanët». Dhe sot më bëhet zemra mal që dëshirat e popullit i realizoi Partia. Në gjithë Shmilin janë marrë 45 kuintalë misër për hektar, janë shtuar dhentë, dhitë, pemët frutore. Çermenikën e Zozë e bëri të kuqe Partia. Kjo është rruga e gjithë malësisë së vendit tonë.

I thashë këto, pse kam mall dhe respekt të pafund për gjithë kooperativistët malësorë trima, besnikë të Partisë dhe punëtorë të palodhur për çështjen e socializmit, që kanë lulëzuar jetën e tyre, kanë ndërtuar shtëpi të reja, e kanë bërë tokën të begatshme dhe mbajnë pushkën e mitralozin në dorë. Në emër të Partisë dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror unë i përshëndes ata të gjithë me këtë rast.

Siç e dimë, rrethin e Beratit e kemi lavdëruar për punën e mirë që bëri lidhur me zhvillimin e pemëtarisë, por kur tash konstatojmë se ato pemë frutore të reja, që janë mbjellë, janë nënvleftësuar dhe të tjera të reja mezi mbillen, na vjen keq dhe prandaj e kritikojmë. Si mund të heshtet kur mbi 700 hektarë të mbjellë me pemë frutore të llojeve të ndryshme dhe me ullinj janë lënë prej disa vitesh pa u shfrytëzuar, sepse u shërbehet shumë pak këtyre kulturave kaq të rëndësishme për shëndetin e njeriut dhe për eksport? As që mendohet nga komiteti ekzekutiv dhe nga kryesitë e kooperativave për të ardhurat e konsiderueshme që i

sjellin ekonomisë sonë popullore pemët frutore, ullinjtë dhe vreshtat. Mirëpo këto të ardhura dihet se nuk vijnë vetvetiu, pa punë. Dhe kur konstatohet se gjatë vitit 1974 janë bërë vetëm 39 për qind e ditëve të punës të planifikuara për këto kultura, atëherë s'ka nevojë të bëhet ndonjë filozofi për të kuptuar ç'nënvleftësim të madh e të dënueshëm ka në këtë sektor. Do të vazhdohet të ecet kështu, shokë drejtues të Partisë dhe të pushtetit dhe shokë kooperativistë të rrethit të Beratit? Partia mendon se nuk është aspak e dëshirueshme dhe nuk duhet të vazhdohet në këtë rrugë, po të bëhet sa më parë kthesa, siç na mëson Partia.

Byroja Politike ka dhënë shumë udhëzime, të cilat as Ministria e Bujqësisë nuk po i zbaton ashtu si kërkohet dhe nuk po kontrollon mirë vënien e tyre në jetë. Ajo ka një përgjegjësi të rëndë edhe për kooperativat kodrinore e malore. Janë dhënë porosi prej kohësh për krijimin e skuadrave të specializuara për pemëtarinë. Mirëpo fare pak, për të mos thënë aspak, është bërë në këtë drejtim. Ecet me mendjen e gjyshit, siç rezultoi nga fakti se numri i pemëve frutore në prodhim që nga viti 1971, në vend që të ngrihet, është ulur 15 mijë rrënjë dhe i vreshtave 350 hektarë. A nuk është e dënueshme kjo gjendje?

Ne nuk mund t'ia hedhim fajin popullit për këtë që ka ndodhur, kurse përgjegjësit për gjendjen e krijuar duhen dënuar ose duhen hequr menjëherë që të vënë mend. Drejtuesit e rrethit ose të kooperativave bujqësore na paskan gjetur një praktikë për të hequr gratë nga detyrat drejtuese, duke reduktuar në minimumin e minimumit numrin e brigadierëve. Po pse e

kanë bërë këtë? Mos vallë shoqet nuk janë të afta për punë? Mendoj se ato janë më të afta nga ata burra ose djem që qëndrojnë sot në krye të disa kooperativave malore dhe kodrinore të rrethit të Beratit, që u kritikuan për këtë gjendje të pakënaqshme. Shkaku i mënjanimit të shoqeve nga punët drejtuese duhet kërkuar te mungesa e ngritjes ideologjike të këtyre kuadrove, të cilët kanë ndjenja të theksuara komandimi mbi gruan, siç po duket edhe në jetën shoqërore, ku ende vërehen martesat vajzash të reja sipas zakoneve të vjetra.

Këta njerëz që punojnë keq, nuk kanë kuptuar, gjithashtu, parimet dhe normat e Partisë jo vetëm për zhvillimin e bujqësisë dhe për marrjen e të gjitha masave për përmirësimin e jetës së popullit, por konstatohet se deri brenda në radhët e Partisë në fshatra kanë lejuar të krijohen tarafa në bazë gjinie dhe familjeje, të cilat shkaktojnë grindje, mëri, zënka. Mund të mbajnë taserën e Partisë të tillë komunistë, siç janë ata në fshatin Perisnak, ku 7 familje nuk flasin me njëra-tjetrën dhe vetë komunistët nuk flasin me banorët e lagjes?!

Shumica e këtyre familjeve në grindje e zënka me njëra-tjetrën kanë komunistë në gjirin e tyre. Mendoj se këto çështje duhen shtruar në çopull, që ky t'i shkundë këta komunistë dhe organizatat-bazë përkatëse të marrin masa ndaj tyre, në qoftë se këta nuk i ndjekin e nuk i zgjidhin drejt, në rrugë partie, këto probleme me rëndësi politike dhe ideologjike, që kanë lidhje me unitetin e Partisë, me forcimin e republikës. T'i bëhet e qartë popullit atje se qëndrime të tilla Partia nuk i pranon dhe njerëz të molepsur me këto yese

jo vetëm nuk duhet të mbahen në radhët e Partisë, por duhet të dënohen përpara masës së popullit dhe të edukohen, ndryshe lejojmë të na krimbet shoqëria e bukur socialiste që po ndërtojmë me gjak e me djersë.

Në organizatat-bazë, ku ka të tilla shfaqje të huaja, duhet të punohet për të likuiduar sa më parë atë gjendje të sëmurë që krijon sjellja në pushtet ose në detyra me përgjegjësi e njerëzve në bazë fisi. Në vendet me përgjegjësi duhet të vijnë elementë të shëndoshë, të qëndrueshëm politikisht dhe ideologjikisht, njerëz të klasës. T'i thuhet popullit nga ana e Komitetit Qendror që të mos lejojë më zënka e tarafe dhe t'i kritikojë komunistët kur bien në pozita të tilla. Në rast se organizata-bazë e Partisë edhe pas kritikave nuk vihet në rrugë të drejtë, t'i shkruhet menjëherë Komitetit Qendror për atë që ndodh në organizatën e fshatit. Ky është një kontroll nga ana e masës kundër shkeljes së normave të Partisë brenda në Parti dhe në organet shtetërore.

Në raportin që lexuam, pasi jepet konkretisht gjendja jo e mirë e këtyre kooperativave, flitet se ka rezerva të mëdha në çdo drejtim. Atëherë vihet pyetja: Përse nuk shfrytëzohen këto rezerva të mëdha? Përse janë bërë kaq shumë mungesa në punë? Me slogane nuk mund të ecet, shokë. Duhet ta themi me plot gojën se organizata e Partisë në këtë rreth nuk bën një punë politike intensive përderisa lejon që në disa organizata-bazë komunistët të merren me grindje e me tarafe, përderisa pushteti nuk mbron si duhet njerëzit e punës, përderisa komiteti ekzekutiv i këshillit popullor

të rrethit dhe seksioni i tij i bujqësisë nuk ndjekin e nuk kontrollojnë si duhet realizimin e planit dhe të detyrave. Jemi të bindur se s'ka asnjë kooperativist në fshatrat që përmenda, që mos ta ndiejë thellë në zemër detyrën e lartë që ka vënë Partia për lulëzimin e fshatit tonë, duke përfshirë edhe malësinë. Arritja e këtij objekti do të sjellë përmirësimin e jetës së tij dhe forcimin e republikës. Çdo kooperativist e di se në një luftë me imperialistët apo socialimperialistët do të jetë po ai fshat që do të luftojë për mbrojtjen e fitoreve, do të jetë po ajo tokë, që do të mbajë me bukë popullin ushtar.

Ju na thoni në raport se mundësitë për shtimin e sipërfaqeve të ujitshme kanë qenë dhe janë të mëdha. Ose ju nuk na thoni të vërtetën dhe në këtë rast bëni një gabim të rëndë, ose keni lidhur duart dhe këtë mundësi të madhe nuk po e shfrytëzoni për të mirën e ekonomisë kooperativiste. Prandaj të merrni masa sa më parë që uji të grumbullohet për të ujitur tokat e mbjella dhe në këtë punë me vlerë të madhe të angazhohet tërësisht mbarë populli i këtyre kooperativave. Si në çdo drejtim tjetër edhe për ujitjen shteti do të ndihmojë brenda mundësive, por ekonominë bujqësore nuk duhet të presin që t'u bëhen të gjitha nga shteti. Kooperativistët e dinë se shteti, që është i tyre, ka mbi kokë gjithë ato probleme, të cilat nuk mund të zgjidhen veçse nga vetë populli, nën udhëheqjen e Partisë, me një organizim të përsosur nga ana e saj dhe e pushtetit.

Për zhvillimin modern të bujqësisë kërkohet më shumë mekanizim, prandaj Partia dhe shteti kanë vënë në dispozicion të saj shumë traktorë e makineri të tje-

ra bujqësore. Si drejluesit e kooperativave dhe vetë kooperativistët e kanë të qartë që për këto mjete ka një regjim se ku duhet të punojnë, për arsye se inu-ndësitë tona nuk janë të tilla që ato të dërgohen kudo, në çdo skaj të largët të territorit tonë malor. Komiteti Qendror ka theksuar vazhdimisht se në shumë rrethe, veçanërisht në rrethin tuaj, nuk po zbatohen drejt orientimet lidhur me kujdesin që duhet treguar për trajtimin dhe rritjen e numrit të kafshëve të punës. Edhe për këtë çështje, ashtu si për pemët frutore, ndodh e kundërta me ju, shokë të Beratit. Kudo në rrethin tuaj po pakësohen dhe po theren çetë e punës. Me keqardhje konstatojmë se në zonat kodrinore çdo pende qesh i bien për të punuar 9 hektarë tokë, ndërsa në fshatrat malore 7,3 hektarë, prandaj duhet të mendoni thellë dhe t'i jepni zgjidhje të drejtë këtij problemi kaq të rëndësishëm.

Është për të ardhur keq që gjatë pesëvjeçarit të kaluar në këto kooperativa, për të cilat po diskutojmë, edhe blegtoria nuk paraqitet në një gjendje të mirë. Në kooperativat bujqësore të zonave malore të rrethit tuaj, sipas të dhënave të raportit, janë shtuar vetëm 2 400 krerë dhen e dhi, kurse në oborret kooperative janë rritur 519 lopë dhe 5 000 bagëti të imëta. Konkluzioni del vetvetiu: kooperativat bujqësore nuk e kanë të qartë këtë situatë zhvillimi; kur nuk e kanë të qartë kooperativat, nuk e ka të qartë as Partia në bazë dhe, si rrjedhim, as udhëheqja në rreth.

Spektori i blegtorisë është nënvleftësuar në mënyrë të pashpjegueshme. Po pse të nënvleftësohet ky sektor, që nuk është i panjohur për kooperativistët e zo-

nave malore? A nuk ka rrojtur tërë jetën me dele e me dhi fshatari ynë? A nuk i ka shtuar bagëlitë, me prodhimin e të cilave ka siguruar jetën e tij në regjimet shtypëse? Po tash që ne kemi mundësi kaq të mëdha, sa nuk kanë të krahastuar me të kaluarën, për ç'arsye të nënvleftësohet ky sektor me rëndësi kaq të madhe për ekonominë kolektive? Çfarë po bën udhëheqja në rrethin e Beratit, komiteti i Partisë dhe komiteti ekzekutiv, kur nuk merren me këto probleme kyç të jetës së popullit në rreth? Apo shokët përgjegjës kapardisën nëpër zyra, merren me çikërrima për t'u ndrequr punët një apo dy personave dhe të lënë pa kryer detyrën, duke mos u kujdesur për rritjen e prodhimit në krahina të tëra, siç janë zonat malore, për të cilat po bisedojmë?

Ç'doni të thoni ju, shokë drejtues të rrethit të Beratit, me atë që na radhitni se në qytet keni kaq e aq familje kulakësh? Çfarë dëshironi t'u bëjmë këtyre? Partia vazhdimisht ka porositur që këto kategori njerëzish t'i neutralizojmë politikisht, ata të punojnë jo që të udhëheqin popullin, por që të nxjerrin bukën e gojës me djersë dhe nën kontrollin e vëzhgimit e vazhdueshëm revolucionar të Partisë dhe të masave. Kontrolli dhe edukimi, natyrisht, bëhen duke marrë kontakt me ta dhe jo duke i izoluar. Por puna për edukimin e tyre nuk duhet kuptuar që të hamë, të pimë e të bëjmë ahengje bashkë, që të marrohen djemtë e vajzat e tyre me fëmijët tanë. Këta elementë të deklasuar janë armiq të klasës dhe si të tillë duhet të punojnë nën drejtimin e rreptë të ligjeve të shtetit të diktaturës së proletariatit.

Partia dhe pushteti duhet ta luftojnë parazitizmin si në fshat, edhe në qytet. Por vërehet se jo vetëm te ju, po edhe në qytete të tjera ka të rinj e të reja që rrinë pa punë dhe jetojnë në kurriz të prindërve, të motrave e të vëllezërve më të rritur. Natyrisht, duhet të punohet politikisht me këta të rinj, por puna politike që bëhet duhet të japë rezultate dhe të mos kënaqemi me një lëksion ose me një fjalim të përgjithshëm. Krahas punës politike, të caktohen njerëz të posaçëm të organizatës së Frontit, të cilët të bisedojnë me prindërit e këtyre të rinjve parazitë dhe t'i bindin këta që bijtë e tyre të shkojnë në punë në çdo kënd të atdheut, ku nevojiten mendja dhe dituria e tyre.

Natyrisht, e kemi të qartë se nuk është bërë shir ndaj krimeve të kryera në dëm të pronës socialiste. Na thuhet që shumica e këtyre krimeve kryhet nga të rinj parazitë të paangazhuar në punë, që kërkojnë vende të zgjedhura në qytete. Nuk na vjen aspak mirë që ndodhin gjëra të tilla dhe kjo duhet të kuptohet si një minus i punës politike të Partisë.

Si konkluzion, mendoj se është bërë mirë që na është treguar realiteti pa dorashka dhe personalisht shokëve drejtues të rrethit të Beratit, popullit dhe Partisë të këtyre zonave kodrinore e malore dëshiroj t'u them që, në qoftë se nuk janë me vend këto që parashatrova, le të më tërheqin vërejtjen, unë do t'i pres me gjithë qejf këshillat dhe vërejtjet e tyre, por mendoj se është detyrë të kuptohet drejt që problemet e ngritura në këtë mbledhje duhet të analizohen thellë dhe të merren masa sa më parë, e theksoj, të merren masa, dhe kjo është e rëndësishme për interesat e atdheut.

Këto probleme janë të pasqyruara në planet e mëparshme, ku kanë qenë vërtetuar gjithë këto të meta. Prandaj, në planin e vitit 1976 dhe në atë pesëvjeçar në asnjë mënyrë nuk duhen lejuar të meta të tilla serioze. Në këtu u kufizuar për gjendjen e krijuar vetëm në këto krahina malore e kodrinore dhe jo për gjithë rrethin e Beratit, se në shumë kooperativa të këtij rrethi konstatojmë që bëhet një punë shumë e mirë, planet janë realizuar në mjaft zëra e drejtime. Organizatat e Partisë atje janë në pozita të shëndosha. Në pozita të shëndosha janë organizatat e Partisë edhe në këto krahina malore për të cilat folëm këtu dhe nuk ka se si të jetë ndryshe, se shumica e komunistëve të këtyre krahinave janë bij dhe bija patriotësh, që kanë marrë pjesë aktivisht në Luftën Nacionalçlirimtare, ata janë bijtë dhe nipat e gjyshërve të tyre që kanë luftuar për lirinë e atdheut edhe në të kaluarën. Por si në organizatat e këtyre zonave kodrinore-malore, edhe në ato fushore, ka akoma elementë që duhen edukuar nga Partia, të cilët nuk duhen lejuar në asnjë rast të shkelin interesin e përgjithshëm të popullit dhe të nxitin tekat e tyre personale e mikroborgjeze.

Më falni që u tregova pak i ashpër në kritikë, por kam besim se kjo kritikë e hapët, që po ju bëj, do të japë rezultate dhe ju këshilloj se me të qara, me llafe, pa një organizim të shëndoshë, pa një punë politike dhe ideologjike intensive e të palodhur, kjo gjendje nuk mund të ndryshojë. Unë besoj se organizatat e Partisë dhe komunistët që punojnë në kooperativat e këtyre zonave janë në gjendje t'i kuptojnë dhe t'i zbatojnë shumë mirë këto këshilla. Në kemi shpresë

të madhe që situata do të ndryshojë në mënyrë rrënjësore dhe veçanërisht në këto kooperativa malore e koordinore, si dhe në gjithë rrethin e Beratit.

*Botuar për herë të parë,
me shkurtime, në librin:
Enver Hoxha, «Raporte e
fjalime 1976-1977», f. 9*

*Botohet i plotë sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Sekretariatit të
KQ të PPSH, që gjendet në
AQP*

BAZA KA NEVOJË PËR NDIHMË KONKRETE

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të
Kuvendit Popullor të RPSH¹*

31 janar 1976

Materialet që i vijnë Presidiumit për shqyrtim nuk duhet të trajtojnë cikërrima që u përkasin t'i shikojnë dhe t'i zgjidhin drejt organet e tjera shtetërore, sidomos ato ekzekutivet. Futja në detajet, e arsyeuar me atë se gjoja kontrollohet zbatimi i vendimeve të Presidiumit, nuk mund të jetë kurdoherë e drejtë, si në rastin konkret, që na raportohet deri edhe meremetimi i këpucëve nga artizanati i një kooperative. Prandaj kam disa vërejtje për raportin që na është paraqitur.

Mendoj se është i tepërt dhe i panevojshëm për ne, anëtarët e Presidiumit, shpjegimi me hollësi i natyrës së kompetencave që u janë dhënë këshillave popullorë të kooperativave të bashkuara ose të atyre të fshatra-ve. Një e metë e tillë duhet kërkuar tek ata punonjës të aparatit të Presidiumit që harrojnë se nuk janë anë-

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit mbi rezultatet e arritura lidhur me zbatimin e kompetencave të këshillave popullorë dhe për detyrat që dilnin për të ardhmen.

tarë komitetesh ekzekutive ose instruktorë rrethi, por funksionarë të aparatit të Presidiumit të Kuvendit Popullor. Kur shkojnë në bazë, ata mund të shohin shumë gjëra, të vogla e të mëdha, por Presidiumit të mos i sjellin për shqyrtim çdo gjë që u del përpara. Për të voglat të marrin masa në vend bashkë me organet ekzekutive të pushtetit, kurse Presidiumit t'i sjellin çështjet e mëdha e parimore.

Ja, për shembull, në raport ngrihet çështja se hartimi i projektplaneve e i projektbuxheteve të këshillave popullorë të fshatrave të bashkuara nuk bëhet në kohën kur hartohen planet e rretheve. Unë mendoj se kjo çështje mund të ndreqet në vend dhe në kohën e duhur, prandaj nuk ka pse bëhet problem i mbledhjes së Presidiumit. Pastaj unë di që të gjitha planet e bujqësisë, të ndërtimeve, të shkollave ose ndonjë gjë tjetër që bën shteti për fshatin, i diskuton, i rakordon me kooperativat bujqësore, kurse detyrimet që i përka-sin kooperativës bujqësore për buxhetin e këshillit popullor, i vendos mbledhja e përgjithshme e anëtarëve të saj.

Pushteti në fshat dhe kryesia e kooperativës duhet t'i zbatojnë vendimet e popullit, të mbledhjes së përgjithshme. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin mes këshillave popullorë dhe kryesive të kooperativave bujqësore, për problemet që përmenda, mund dhe duhet të ndihmojë edhe pushteti në rreth, por mbledhja e përgjithshme e anëtarëve të kooperativës është ajo që vendos dhe zhvendos, si për problemet e prodhimit bujqësor, ashtu dhe për ato sociale në fshat, sigurisht, brenda kompetencave të saj, në

konformitet me statutin dhe me interesat e përgjithshëm të shoqërisë socialiste. Të metat, që ekzistojnë në këtë aspekt, mendoj se nuk duhen përgjithësuar dhe shfaqja e tyre nuk duhet konsideruar sikur po shkelen parimet. Ka dhe shumë shkaqe objektive që ndikojnë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, si për caktimin e fondeve për shtëpinë e kulturës, për materialet etj.

Nuk kuptoj aq mirë natyrën e vendimeve apo të planeve që komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit duhet t'ia ndajë çdo këshilli fshati. Planet e bujqësisë rrethi ua ndan; të ndonjë ndërtimi që bën shteti, ua komunikon, ka (dhe për këtë jam i sigurt) edhe urdhra e vendime të panevojshme që u dërgohen e që formojnë burokracinë. Baza ka nevojë për ndihmë konkrete dhe jo për letra.

Mua më duket se nuk është një praktikë e drejtë ajo që ne të autorizojmë bankën dhe kjo të xhirojë fondet e kooperativës bujqësore në fondin e këshillave popullorë, pa miratimin e mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve ose të kryesisë së kooperativës. Kjo gjë është një e drejtë e mbledhjes së përgjithshme dhe kryesia e kooperativës duhet të zbatojë vendimet e saj. Edhe çështja e shërbimeve të artizanatit duhet të zgjidhet brendapërbrenda vetë kooperativës. Në këtë çështje mund të ndihmojë edhe rrethi, por probleme të tilla nuk duhet t'i sillen Presidiumit.

Si pa të keq shkruhet se këshillat popullorë duhet t'i ndihmojë ky apo ai, përmenden këtu deri dhe organet qendrore. Në këtë drejtim duhet të jemi ca realistë. Unë vë pyetjen: Po këshillat dhe këshilltarët

interesohen vallë vetë për ushtrimin e të drejtave dhe, sidomos, për zbatimin e detyrave? Lëvizin ata jashtë orarit të punës dhe lodhen ndonjë çikë për të kryer këto detyra në shërbim të popullit? Unë mendoj se ka prej tyre që nuk lodhen sa duhet. Ata duhet të dinë se gjithçka arrihet me luftë, se çdo gjë nuk do t'u vijë e gatshme në gojë; të dinë se duhen bërë sakrifica, se ka vështirësi dhe këto kapërcohen jo vetëm duke kritikuar ata lart, por edhe veten, pse edhe lart, në qendër, edhe në rreth e në bazë ka të meta e gabime.

Thuhet nga baza, gjithashtu, që dikasteret dhe organet qendrore kanë të meta në dhënien e ndihmës rretheve, por duhet të njohim se të meta ka edhe vetë rrethi, i cili duhet të korrigjohet, të interesohet për mbarëvajtjen e punëve; se të meta ka edhe vetë këshilli popullor i kooperativës, i cili duhet të kërkojë të luftojë, të marrë ç' i përket dhe të zbatojë ç' i ngarkohet. Lëshimi i udhëzimeve të shumta në këtë drejtim është i dëmshëm, prandaj duhet hequr dorë nga një praktikë e tillë. Ne nuk vuajmë nga mungesa e udhëzimeve, por nga fakti se të tilla lëshohen shumë dhe se ato nuk zbatohen si duhet.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Presi-
diumit të Kuvendit Popullor,
që gjendet në AQP*

TË JEMI TË VËMENDSHËM NË MARRJEN E VENDIMEVE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Presidiumit
të Kuvendit Popullor të RPSH¹*

31 janar 1976

Demokracia jonë proletare nuk mund të pranojë që për çdo krim kundër shtetit të parashikohet kurdoherë dënimi me vdekje. Për krimet më të rënda kundër shtetit siç janë: tradhtia ndaj atdheut, spiunazhi, veprat terroriste, organizimi i bandave të armatosura ose pjesëmarrja në to, diversioni, sabotimi, gjenocidi etj., me të drejtë Kodi Penal parashikon edhe dënimin me vdekje. Me këtë lloj dënimi ne duhet të ndëshkojmë tradhtarët, armiqtë e popullit, që organizojnë komple kundër pushtetit popullor, por, kur vepra penale nuk kryhet në kohë lufte ose kur nga kjo vepër nuk kanë ardhur pasoja shumë të rënda, për personin që e kryen është i mjaftueshëm dënimi nga tre gjer në dhjetë vjet heqje të lirisë.

Të jemi të vëmendshëm në marrjen e vendimeve.

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth disa projektdekreteve që ishin paraqitur për miratim.

Ne këtu kemi miratuar dekretin «Mbi ndërrimin e emrave dhe të mbiemrave të papërshtatshëm». Për të argumentuar nevojën e miratimit të dekretit, na u paraqit në Presidium edhe një listë e gjatë me emra të papërshtatshëm e përqmues. Të tërë ishin dakord që të ndërroheshin këta emra dhe, për këtë gjë, miratuam projektdekretin e paraqitur. Tani duhet të kemi kujdes që të mos bëhen gabime në zbatimin e tij. Nga ndonjë pakujdesi në zbatimin e një vendimi, padashur, mund të krijohen edhe shqetësime.

Ka armiq të jashtëm që flasin e shkruajnë në shtyp se gjoja në Shqipëri po shkelen të drejtat e minoritarëve, ose po u ndërrohen emrat fshatrave etj., etj. gjë kjo që, siç e dini, nuk është aspak e vërtetë. Akuza të tilla nuk qëndrojnë. Në vendin tonë as Partia, as Kushtetuta nuk lejojnë të bëhet qoftë edhe presioni më i vogël ndaj pakicës kombëtare për të penguar ushtrimin e të drejtave të saj. Edhe sikur të vinte ndonjë propozim, për shembull, që një fshati të minoritetit grek në vendin tonë t'i ndërrohej emri, këtë ne nuk do ta pranonim, sepse banorët e tij janë të pakicës kombëtare greke dhe kanë të drejtat e tyre, të cilat ne i respektojmë dhe i zbatojmë praktikisht me ligj. Emrat e vjetër që mbajnë fshatrat e minoritetit grek në vendin tonë, janë dëshmitarë të gjallë të kësaj së vërtete.

Në trajtimin e çështjes nacionale ne kemi kurdoherë parasysh vijën e Partisë sonë të bazuar në marksizëm-leninizmin. E theksoj këtë çështje se ka edhe raste që shtetas shqiptarë me kombësi greke kanë deklaruar sikur kanë kombësi shqiptare! Kur u thuhet

këtyre se ju keni shtetësi shqiptare, kurse kombësinë greke, ata përgjigjen: «Kjo s'ka rëndësi». Por nuk është kështu. Deklarimi i saktë i kombësisë ka shumë rëndësi, bile parimore. Minoritari që jeton në vendin tonë është i vendosur për socializmin në Shqipëri, ai e do shtetin shqiptar, lufton për të siç ka luftuar në të kaluarën dhe do të luftojë prapë në të ardhmen, po të jetë nevoja, por kombësinë e ka greke. Shtetasit e pakicës kombëtare greke flasin greqisht. Kjo është e drejta e tyre dhe ne e mbështetim këtë të drejtë. Atyre u kemi krijuar të gjitha kushtet që ta mësojnë e ta flasin gjuhën amtare, kemi ngritur shkolla ku jepet mësimi në gjuhën greke dhe u themi që t'i dërgojnë në këto shkolla djemtë dhe vajzat e tyre. Partia dhe shteti ynë respektojnë e do t'i respektojnë rreptësisht edhe në të ardhmen të drejtat që i njeh Kushtetuta jonë pakicës kombëtare greke.

Për sa i përket mbylljes së kishave dhe të xhamive, reaksionarët grekë mund ta ngrenë zërin gjer në qiell, por s'kanë të drejtë, se ato i ka braktisur vetë populli. Mbyllja e kishave, e xhamive nuk përbën aspak shkelje të Kushtetutës sonë, e cila garanton lirinë e besimit, por nuk bën fjalë për ushtrimin e rriteve fetare në kisha e xhami. Shteti ynë është ateist dhe, si i tillë, bën propagandë kundër fesë. Ka pleq që zbatojnë ndonjë rit fetar. Në këtë drejtim ndiqet rruga e bindjes, punohet për t'i shpëtuar këta njerëz nga skllavëria fetare. Kjo punë me karakter riedukimi nuk është e thjeshtë dhe nuk mund të gjejë zgjidhje në rrugë administrative, ajo do kohë, durim, vazhdimësi dhe këmbëngulje.

Mendoj se duhet të hiqet doemos nga ky projekt-dekret shprehja që njerëzve t'u sigurohet punë «sipas profesionit», se ndryshe do të ndodhë që, fjala vjen, një xhenerik, i cili dërgohet për të punuar në një punë tjetër, pse sot për sot s'ka punë në profesionin e tij, nuk do të pranojë të bëjë një punë tjetër. Ose një shofer, i cili ngul këmbë të punojë në këtë profesion, por aktualisht s'ka makinë për të, ne do ta dërgojmë të punojë gjetkë e jo të presim sa t'i gjejmë një automobil. Ndryshe nuk do të arrijmë t'i edukojmë nëpërmjet çfarëdo pune ata që i shmangen punës.

Unë nuk jam dakord gjithashtu që për krijimin e distinktivit «Vullnetar i dalluar» të vendosë Presidiumi. Dekorimet janë vërtet prerogativë e Presidiumit të Kuvendit Popullor, por kjo s'do të thotë që ai të merret edhe me distinktivat. Nesër, organizatat e masave mund të kërkojnë edhe lloje të tjera distinktivash. Prandaj, Komiteti Qendror i Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë të kërkojë nga Komiteti Qendror i Partisë dhënien e pëlqimit për shpërndarje distinktivash. Me këtë rast të dërgohet forma e distinktivit, arsyet dhe motivet e kërimit etj. Komiteti Qendror i Partisë nuk do t'ua refuzojë kërkesa të tilla të arsyeshme. Në këtë drejtim s'duhet me qenë shumë sektarë, por edhe liberalë jo, se ndryshe humbet qëllimi i nxitjes për punë të njerëzve dhe distinktivi bëhet një gjë pa shumë vlerë. Presidiumi i Kuvendit Popullor akordon tituj, urdhra dhe medalje, si, bie fjala, titujt «Mësues i Popullit» dhe «Mësues i merituar» për arsimtarët, Urdhrin e Punës, Medaljen e Punës, medaljen «Naim Frashëri» etj., etj.

Për sa i përket së drejtës së propozimit për heqjen e titujve dhe të dekoratave personave që bëhen të padenjë për mbajtjen e tyre, atë nuk e kanë vetëm organet që përmenden në relacion dhe që kanë të drejtën t'i propozojnë Presidiumit të Kuvendit Popullor dhënie e dekoratave. Të drejtën e propozimit e ka, në radhë të parë Komiteti Qendror i Partisë. Meqenëse relacioni numëron Qeverinë, komitetet ekzekutive etj., mendoj se në fillim duhej të radhitej Komiteti Qendror i Partisë. Kjo do të bëhet sipas nomenklaturave të caktuara.

Në pikën «c» të relacionit, aty ku shënohet: «... nga komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rrethëve, për personat që janë marrë masa në rrugë partie...» mendoj se propozimin për heqjen e dekoratës atij që dënohet nga Partia, nuk duhet ta bëjë komiteti ekzekutiv dhe Qeveria, por organi kompetent i Partisë. Kjo çështje duhet rishikuar me kujdes. Jo për çdo masë partie që merret ndaj komunistit, mund të hiqen edhe dekoratat. Në Statutin e Partisë parashikohen një sërë masash që fillojnë nga më të lehtat e deri në përjashtimin nga radhët e Partisë. Por, edhe në rastin e përjashtimit të komunistit, ne nuk mund t'ia heqim kurdoherë dekoratat. Tani, siç dihet, ne po bëjmë ndërrimin e dokumenteve të Partisë. Në këtë proces pune disa shokë do të mbeten jashtë (ose do të përjashtohen) por atyre, po të mos jenë implikuar në veprimtari armiqësore, nuk mund t'u hiqen dekoratat. Ata që tradhtojnë atdheun nuk i meritojnë dekoratat e akorduara, mirëpo ka nga ata që përjashtohen nga Partia, se vërtet kanë bërë gabime, por atdheun nuk e kanë

tradhtuar, prandaj nuk duhet t'ua heqim dekoratat që mbajnë. Kjo çështje shikohet rast pas rasti.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Presi-
diumit të Kuvendit Popullor,
që gjendet në AQP*

PËR PUNËTORIN E PARTISË ËSHTË I DOMOSDOSHËM STUDIMI I VAZHIDUESHËM PËR NGRITJEN E NIVELIT PROFESIONAL E KULTUROR

Diskutim në organizatën-bazë të Partisë

5 shkurt 1976

Unë kisha për të bërë disa pyetje, jo vetëm për sekretarin e organizatës, por për të tërë shokët. Këto pyetje të gjata dhe disa sugjerime e mendime që do të shfaq, le të konsiderohen edhe si diskutim nga unë.

Së pari, si për të gjithë anëtarët e Partisë, edhe për ju, shokët e organizatës-bazë, ku bëj pjesë edhe unë, dhe, në veçanti për ju që merreni me kuadrin, për shokët e Komisionit Qendror të Kontrollit e të Revizionimit dhe, përgjithësisht, për shokët që merren me çështjet organizative, mua vazhdimisht më ka preokupuar dhe më preokupon ky problem: A punoni ju, shokë, për zgjerimin e kulturës suaj të përgjithshme dhe a lexoni libra jashtë specialitetit të punës suaj? Punën tuaj e kuptoni si diçka speciale e të veçuar apo të lidhur me literaturën ideopolitike, kulturore e shkencore, me psikologjinë marksiste-leniniste, me studimet shoqërore, me studimin e historisë së popullit tonë dhe të popujve të tjerë të botës?

Së dyti, mos mendoni ju se studimet që keni kryer në shkollën e mesme apo në universitet janë të mjaftueshme për ta përballuar me sukses detyrën që ju është ngarkuar? Apo kënaqeni vetëm me leximin e disa artikujve që botohen herë pas here në shtyp? E përdorni ju kulturën tuaj për të ilustruar tezat apo këshillat që jepni gjatë kontrolleve që bëni në bazë, apo shkoni atje me disa formula të përgjithshme dhe stereotipe?

Jeta, shokë, ecën përpara. Krahas ecjes përpara të jetës te ne zhvillohen edhe njerëzit, zgjerohen dituritë e tyre, perfeksionohen shijet që kanë dhe u shtohen vazhdimisht dëshirat. I ndiqni ju këto dëshira dhe u paraprini masave në këtë drejtim apo, duke bërë një punë rutinë, krijoni monotoni në mbledhjet e organizatave-bazë dhe në mbledhjet e tjera ku shkoni? Ju, shokë, si punonjës të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, mendoni se, si të tillë, duhet të lini gjurmë dhe përshtypje të mira për zotësinë tuaj kudo që shkoni, ndryshe ulni autoritetin e këtij aparati.

Çështja e studimit të vazhdueshëm është shumë e rëndësishme për punëtorin e Partisë. Për të konkluduar drejt nëse një person duhet përjashtuar ose jo nga Partia për arsye politike apo për qëndrime liberale në punë e në jetë, çështje kjo me një përgjegjësi të madhe, duhet të kemi koncepte e ide të qarta. Në qoftë se nuk jemi të qartë se ç'është qëndrimi armiqësor ose ç'është liberalizmi, si shfaqen e çfarë rreziku paraqesin ata, jo vetëm me fraza, por në mënyrë të thelluar, atëherë nuk do të jemi në gjendje të mbajmë qëndrim të drejtë partie ndaj fajtorit ose atij që gabon. Të

njëjtën gjë mund të themi edhe për çështje të tjera që mund të na dalin në punën tonë të përditshme.

Për të ngritur çështjet që më shqetësojnë, mua më shërbeu raporti i organizatës. Unë kam lexuar variantin e shkurtër të këtij raporti, por do të më interesonte më shumë dhe do të më ndihmonte më tepër po të ishte akoma më i shkurtër, me mendime të qarta e interpretime të sakta që kanë lidhje me direktivat e drejta të Partisë.

Në raport me të drejtë vihet në dukje se në takime e mbledhje nuk duhet të shkohet duke u mjaftuar me atë se çfarë të del përpara, por duhen bërë përgatitje serioze e paraprake, duke menduar edhe për detyrat që duhen shtruar e të tjera si këto. Ky është një mendim shumë i drejtë, po përse ta përsëritim në këtë sa herë bëjmë raporte, në vend që të luftojmë për ta zbatuar në jetë?! Këtë rekomandim Komiteti Qendror e ka bërë kurdoherë, prandaj do të ishte më mirë që në raport të thuheshin arsyet përse nuk përgatitemi ashtu siç ka porositur Partia. Shokët, që shkojnë për të ndihmuar e për të kontrolluar punën, duhet të mendojnë me kohë se për çfarë problemesh, të zakonshme apo të veçanta, do të marrin takim me kuadrot dhe që kërkojnë zgjidhje shumë të shpejtë. Po kështu, të mendohet nga ana e tyre edhe për punën me organizatat e masave, me gratë etj., si dhe me kuadro ushtarakë, me ushtarët dhe me njerëz të kategorive të tjera, natyrisht, pa u futur në cikërrima.

Shpeshherë për nxjerrjen e konkluzioneve shokët bazohen vetëm në çfarë thuhet në raport ose në mbledhjen e morisë së fakteve që u serviren. Këto të dhëna

sigurisht na ndihmojnë, por të bëjmë kujdes që të mos mbytemi në to, të mos kapemi në çështje të dorës së dytë, duke u përpjekur të japim për çdo cikërrimë nga një këshillë, nga një qortim dhe të harrojmë, këshutu, problemin kryesor. Në radhë të parë, duhet të punohet shumë për rritjen e personalitetit dhe të vetëveprimit të organizatave-bazë, se shokët e aparateve të Partisë, sado që të përpiqen, nuk mund të zgjidhin dot vetë çdo gjë. Duhet të veprojnë organizata-bazë e Partisë.

Është i vërtetë mendimi i shprehur në raport, sipas të cilit ka raste që materialet, të cilat duhet të studiohen, mbeten pa u studiuar nga shokët. Kjo gjë nuk duhet të ndodhë, por nuk është aspak e drejtë që përpiluesit e këtyre materialeve, duke u nisur nga opinionet e paraformuara, të shkruajnë gjëra të pasakta, të shtrojnë përciptas dhe jo objektivisht probleme të ndryshme dhe të mos trajtojnë jetën e gjallë që zhvillohet te ne. Debatet e njerëzve, të zhvilluara në frymë luftarake, të hidhen në raporte të gjalla, ashtu siç janë në realitet, pa lustër, që t'u shërbejnë edhe atyre që do t'i studiojnë pas nesh.

Për pyetjet që bëra dhe për thellimin në çështjet e tjera, që më shqetësojnë, dëshiroj të tërheq vëmendjen e të gjithë shokëve dhe propozoj që, kur të diskutojë ndonjëri prej tyre, mundësisht të na japë mendimin lidhur me sa pyeta.

Ju, shokët e Komisionit Qendror të Kontrollit e të Revizionimit duhet të ndihmoni në shqyrtimin e drejtë nga ana e organeve lokale të Partisë të atyre çështjeve që kanë të bëjnë me komunistë që kanë

dobësi e të meta në punë. Ju takon juve të ndihmoni në mënyrë sistematike për korrigjimin e vendimeve të nxituara që merren në ndonjë rreth, pa pritur që t'ju vijjnë ankesa për probleme të caktuara.

Nga Komiteti Qendror janë dhënë udhëzime të qarta se si duhet të punohet për ndërrimin e dokumenteve të Partisë, çfarë masash duhet të merren në këtë drejtim etj. Unë dua të di përgjithësisht nëse është analizuar në mbledhjen e ndonjë komiteti partie rrethi çështja se si zbatohen këto udhëzime dhe si kanë ndihmuar konkretisht shokët në dhënien e mendimeve përpara komitetit ose byrosë së Partisë?

Mund të na thuhet, në përgjithësi, nga shokët e Komisionit Qendror të Kontrollit e të Revizionimit të Partisë se si janë shikuar nga ana e tyre ankesat e komunistëve që janë ndëshkuar për arsye se kanë gabuar? Janë shikuar ato drejt apo jo? Natyrisht, ata të mos hyjnë në të tëra hollësitë e problemeve të organizatës së Partisë, për shembull, të rrethit të Kolonjës, por të flasin shkurtimisht për çështjet më të rëndësishme, për metodën e punës etj.

Komisioni Qendror i Kontrollit e i Revizionimit mban apo jo lidhje të ngushta me komisionet e kontrollit e të revizionimit të Partisë në rrethe për t'i kontrolluar dhe ndihmuar këto të fundit me qëllim që të aktivizohen gjallërisht në punën për ndërrimin e dokumenteve të Partisë, që po bëhet tashti? Pse Komisioni Qendror nuk ka hartuar një plan pune për këtë qëllim? Këto komisione të rretheve, që vazhdimisht e vazhdimisht merren me verifikime dhe që i njohin mirë kuadrot, përse nuk janë inkluduar në këtë çështje

të rëndësishme? A janë futur në grupet e punës shokët e komisioneve të kontrollit e të revizionimit nga komitetet dhe aparatet e Partisë në rrethe për t'u aktivizuar për problemin e ndërrimit të dokumenteve? Nuk flas këtu vetëm për kryetarët e këtyre komisioneve, por edhe për anëtarët, që i njohin mirë komunistët.

Nuk është e drejtë që ata të mos aktivizohen. Pse nuk keni shkuar te shoku Hysni [Kapo] dhe te shoku Hekuran [Isai] për të ngritur problemin që në punën për ndërrimin e dokumenteve duhet të marrin pjesë herë pas here edhe shokë nga Komisioni Qendror dhe nga komisionet e rretheve? Ju duhet të bëni autokritikë për këtë gjë. Puna juaj e rëndësishme ka të bëjë vazhdimisht edhe me pastrimin e Partisë nga elementë që nuk e meritojnë të jenë në radhët e saj, prandaj është e pakuptueshme të qëndroni të mënjanuar në këtë çështje. Detyra e ndërrimit të dokumenteve të Partisë duhet të përfundojë me sukses, prandaj kjo e metë që po kritikojmë këtu, menjëherë të ndreqet.

Këto probleme kanë rëndësi dhe nuk mund t'i çojnë përpara vetëm shokët e Sektorit të Kuadrit apo të atij të Statutit, prandaj lypset të veprohet në mënyrë kolegjiale. Ju shokët e Komisionit Qendror të Kontrollit e të Revizionimit jeni ata që ju ka zgjedhur Kongresi i Partisë, kurse komisionet e kontrollit e të revizionimit në rrethe i kanë zgjedhur konferencat e Partisë të rretheve pikërisht për këtë punë, prandaj ju duhet të merreni me këtë çështje. Është kështu apo jo, shokë?

Që nesër mendoj të merreni me këtë çështje. Lidhur me ato që u thanë këtu, se apelimet tash janë trefishuar, çështjet duhet t'ua dërgoni përnjëherë për ve-

rifikim komisioneve të kontrollit e të revizionimit të rretheve. Në qoftë se një komunist është përjashtuar padrejtësisht nga Partia, për shembull, prej organizatës së Partisë të Shkodrës dhe bën apelimin këtu, në Komisionin Qendror të Kontrollit e të Revizionimit, atëherë çështjen detyrimisht duhet ta shqyrtoni. Por, kur vëreni se përjashtimet nga Partia bëhen të nxituara, kjo çështje duhet të shikohet në vend, në rrethin përkatës. Gjatë kohës që ju do të shkoni, ta zëmë, në Vlorë, në Lushnjë, në Shkodër e gjetkë, do të keni vërejtje dhe do të krijoni mendimet tuaja, të cilat, kur të ktheheni, t'ia thoni shokut sekretar të Komitetit Qendror të Partisë, duke e vënë në dijeni se në këtë rreth, fjala vjen, nuk jepen gjykime objektive për njerëzit, kurse në rrethin tjetër vërehet se vërtet ka disa komunistë të mështë, megjithëkëtë, ata duhet të qëndrojnë në Parti. Kjo punë ka shumë rëndësi, më duket mua.

Qoftë Komisioni Qendror i Kontrollit e i Revizionimit, qofshin komisionet e kontrollit e të revizionimit në rrethe duhet t'i shqyrtojnë me shumë kujdes letrat, ankesat dhe sinjalizimet e komunistëve. Ju, po të keni mundësi, bëjeni edhe këtë punë, shqyrtoni edhe apelinet e bëra nga anëtarët dhe kandidatët e Partisë, por nuk besoj t'ju mbetet kohë për të dyja, se ndërrimi i dokumenteve duhet të bëhet i saktë e jo sa për të kaluar radhën.

Shqyrtimi i ankesave të komunistëve duhet bërë kurdoherë me vëmendje dhe me shumë përgjegjësi, sepse në jetë nuk mungojnë edhe raste kur ndonjë ndëshkohet ose trajtohet keq edhe për hakmarrje. Do të ketë pastaj njerëz që do të pretendojnë se u është

bërë «padrejtësi», megjithatë edhe ankesat e këtyre duhen gjykuar me urtësi, drejt dhe në frymë partie, duke mos përjashtuar *a priori* versionin se ankuesi nuk ka të drejtë. Në një rast si ky që zura në gojë, Komisioni i Kontrollit e i Revizionimit, pasi të bindet, t'i thotë organit kompetent se qëndrimi i mbajtur ndaj këtij apotij njeriu duhet rishikuar.

Gjatë shqyrtimit të ankimeve duhet zhvilluar vigjilenca, sepse me këtë mund të zbulohen edhe gjurmët e armiqve të fshehtë, për të cilët dalin të dhëna në mjaft nga ankesat që bëhen. Nga apelimet e komunistëve të organizatës së Partisë të Shëngjergjit të rrethit të Tiranës, që keni shqyrtuar ju, ka pasur mundësi të shikohej me sy kritik edhe qëndrimi i kryetarit të kooperativës bujqësore të atjeshme, po ju as që i keni rënë fare kësaj ane me shumë rëndësi të çështjes.

Ju e keni dëgjuar të gjithë se në bregdetin tonë të Adriatikut ndodhet vendi që quhet Bishti i Pallës. Në këtë pjesë të bregdetit armiqtë e brendshëm dhe agjentët e huaj na kanë sabotuar nxjerrjen e naftës. Kjo flet qartë për domosdoshmërinë e rritjes së vigjilencës. Dje mësova se një oficer kishte shkelur rregullat e ruajtjes së sekretit, duke marrë një person, që nuk kishte të bënte fare me punët e ushtrisë, për t'i shkruar bukur, me kaligrafi, disa materiale, që përbënin sekret ushtarak. Po ç'na duhen neve shkrimet e bukura kur na dëmtohen interesat e mbrojtjes?!

Fjalën e kam që të mos mbahet qëndrim i mefshtë për zgjidhjen e atyre problemeve që duhen zgjidhur shpejt. Nuk ka përse të pritet, duhet vepruar shpejt në kryerjen e punëve dhe të zihet kau nga brirët, duke

zbuluar arsytet e vërteta përse ngjet kështu ose ashtu, për të parë nëse është vetëm ai njeri që shkel vijën e Partisë apo ka edhe të tjerë që e pasojnë. Në veprimtarinë kundër vijës së Partisë, armiku mund të jetë i vetëm, por ai mund të ketë edhe bashkëpunëtorë, prandaj duhet të shikohen më thellë punët. Unë e kam zët «qetësinë e përjetshme», por atje ku ka «paqe», duhet shikuar mirë se mos ka familjaritet, se mos njerëzit e pandërgjegjshëm hanë e pinë në kurriz të shtetit. «Paqja», në kurriz të shtetit, duhet dënuar rreptësisht.

Prandaj letrat që na vijnë, ne duhet t'i shikojmë të lidhura me njëra-tjetrën, ashtu sikurse ndodh me fenomenin e osmozës. Dua të them se është nevoja të bëjmë një infiltrim të kujdesshëm të çështjeve që shqyrtojmë.

Punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, që punojnë në sektorin e letrave, janë gjithashtu përgjegjës për zgjidhjen e drejtë e të shpejtë të problemeve, që ngrihen në letrat e popullit. Ju duhet të bashkëpunoni me ta, t'i ndihmoni e t'i kontrolloni, me qëllim që secili prej tyre ta kryejë sa më mirë detyrën e ngarkuar.

Para se të përfundoj, dëshiroj të dal edhe një herë në atë që thashë në fillim, te nevoja dhe përpjekjet që duhet të bëjnë punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror për rritjen e vazhdueshme të horizontit të tyre, për edukimin me këmbëngulje, për ngritjen e pandërprerë të nivelit ideopolitik, por edhe profesional e kulturor.

Lidhur me Bishtin e Pallës që përmenda më parë,

pyeta një ditë, në bisedim e sipër, një shok: «E di ti, — i thashë, — përse një kep nga të bregdetit tonë quhet Bishti i Pallës»? Bashkëbiseduesi m'u përgjigj: «Se atje kishte dalë Skënderbeu me pallë në dorë, duke luf-tuar kundër turqve». Kështu na e kanë mësuar në shkollë prejardhjen e këtij emri. Mirëpo, kur lexon, del se, për rastin konkret, nuk është e vërtetë ajo që dimë. Duke shfletuar një libër me titull «Aleksiada», të shkru-ar më 1148 nga Ana Komnena, historiane e njohur bizantine, për babanë e vet, Aleks Komnenin, perandor-in e Bizantit, mësova se në kohën e kryqëzatës së parë, babait të saj i qe dërguar një letër nga mbreti i Francës, që merrte pjesë në këtë kryqëzatë. Në letër ftohej Aleks i që ta priste mbretin në qytetin Dyrakium, sepse që andej ai do të shkonte në Bizant. Autorja e librit tregon se babai i saj kishte shkuar në këtë rast në Dyrakium, të cilin ajo e përshkruan me hollësi; flet për pritjen dhe nderimet e mëdha që iu bënë mbretit atje, dhe tregon se anija e tij u shkatërrua në Kepin e Pallës. Nga ky libër dhe nga ngjarjet historike të shekujve të 11-të e të 12-të, që përshkruhen në të, kuptohet që ky vend është quajtur kështu në shekullin e 11-të, pra shumë më përpara nga koha e Skënderbeut, çka do të thotë se emri Bishti i Pallës s'ka të bëjë as me shpatën e tij. Kjo, që tregova, ishte vetëm kuriozitet i thjeshtë, por që vërteton se njohja e historisë ka një rëndësi të ma-dhe, prandaj kurrë nuk duhet të mjaftohemi me atë bagazh që kemi, por të punojmë pa reshtur për zgjeri-min e dijeve tona.

Leximi dhe studimi i librave, sikurse thashë, hap horizontin ideopolitik, kulturor, artistik dhe shkencor

të njeriut, ai e ndihmon atë ta kryejë gjithnjë e më mirë detyrën. Unë nuk them se ju, shokë, nuk lexoni, por kam mendimin se duhet të lexoni edhe më shumë, prandaj të nxitet më tepër dëshira e secilit për leximin e librave, duke punuar me këmbëngulje individualisht.

Në këtë raport, shoku sekretar, përmendet se shokët e organizatës sonë kanë vajtur për ndihmë e kontroll edhe në ushtri. Meqenëse është kështu, unë do të dëshiroja që, kur të diskutojë ndonjë nga shokët, të na thotë si e kanë parë gjendjen atje dhe cilat janë ndryshimet që duken në krahasim me punën e mëparshme. Unë, natyrisht, nuk jam i paazhornuar për problemet e ushtrisë, por dua të mësoj se si e shikojnë çështjen e ushtrisë shokët e mi, me të cilët bëj pjesë në një organizatë-bazë.

Dua gjithashtu të theksoj edhe një herë nevojën e kritikës nga poshtë-lart. Komunistët janë të barabartë para Partisë, pavarësisht nga përgjegjësitë që kanë. Duhet t'i shikojmë me kurajë komuniste dobësitë dhe t'i korrigjojmë shpejt, sepse vërtet puna jonë ka shumë të mira, por duhet njohur se kemi edhe dobësi e boshllëqe.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

SA MË SHUMË TË DINË KOMUNISTËT, AQ MË MIRË ËSHTË PËR PARTINË, PËR POPULLIN

Nga biseda me disa anëtarë të organizatës-bazë të Partisë¹

5 shkurt 1976

Shumë pedagogë ndjekin metodën shkollareske në shpjegimin e mësimeve. Kështu veprojnë edhe shumë nxënës e studentë në përvetësimin e lëndëve. Këta, duke mos pasur parasysh sa duhet se teorinë lypset ta përvetësojnë për të kuptuar, interpretuar dhe cilësuar në rrugë marksiste sjelljet e qëndrimet e njerëzve, për të analizuar shkencërisht të shkuarën, të tashmen dhe për të parashikuar po në mënyrë shkencore të ardhmen, për të shpjeguar drejt ngjarjet e fenomenet e realitetit objektiv, nuk çmojnë si duhet nevojën e lidhjes së ngushtë të teorisë me praktikën, me jetën. Të gjitha çështjet që lindin në jetë nuk janë parashikuar

1. Këtë bisedë shoku Enver Hoxha e zhvilloi në pushimin midis seanceve të mbledhjes së organizatës-bazë të Partisë, në vazhdim të problemeve që ngriti në diskutimin e tij në këtë mbledhje.

kurdoherë në libra, shpeshherë ato që janë mësuar në shkollë, duhen përpunuar në praktikë.

Në qoftë se njeriu e ka përvetësuar mirë diçka dhe bën përpjekje për ta thelluar më tej shkallën e njohjes së saj, duke punuar me zell e me këmbëngulje, ai e përvetëson mirë teorinë. Me kalimin e kohës, natyrisht, mund të harrohet, fjala vjen, se ku, në cilën vepër, është shprehur kjo apo ajo ide e Marksit, e Engelsit, e Leninit apo e Stalinit, sepse ky është një proces mekanik i kujtesës, por vetë ideja, e mbajtur mend në mënyrë logjike, nuk harrohet lehtë. Për të riprodhuar fjalë për fjalë idenë e shprehur dhe për ta cituar saktë këtë ide, shfletohen librat. Në këtë drejtim them që shokët duhet ta zhvillojnë dhe ta zgjerojnë më tepër kulturën e tyre.

Ne flasim për vështirësi në analizën e fenomeneve të kohëve tona, mendoni pak për vështirësitë e mëdha të Engelsit, i cili, në mënyrë gjeniale, ka nxjerrë deduksione mbi origjinën e familjes, të pronës private dhe të shtetit, duke iu referuar shoqërisë njerëzore gjatë shekujve të shkuar. Konkluzionet e tij janë aq shkencore, sa nuk i lëviz as topi. Sigurisht, këtë sukses Engelsi e ka arritur në sajë të kulturës së gjerë që kishte. Ai ishte njeri me talent të madh.

Ne flasim për familjet tona në kohën e Zogut, por për periudhat e mëparshme ka çështje që nuk njihen me saktësi. Ja, për shembull, ç'është bërë për të studiuar prejardhjen e ilirëve? Ne nuk dimë shumë gjëra për këtë prejardhje. Ka pasur qytetërim përpara ilirëve? Sigurisht, ka pasur, sepse, po të ishte ndryshe, ilirët do të ishin asimiluar. Por është fakt që ata nuk u asimiluan.

Nga toka jonë kanë kaluar shumë fuqi të huaja push-tuese: romakë, sllavë e të tjerë, por ata nuk na asimiluan dot, sepse paraardhësit tanë kanë pasur një kulturë të zhvilluar autoktone. Këto çështje i përmend, se më duket që kanë rëndësi sidomos për ne, komunistët.

Çdo specializim në fusha të caktuara të kulturës, të shkencës etj., duhet të ketë një qëllim dhe të lidhet me gjithë zhvillimin shoqëror. Dikush mund të jetë, bie fjala, linguist i zoti, që di se diftongu dikur «ue» sot është bërë «o», gjë që ka dashur një periudhë të gjatë kohe, por, në qoftë se ai nuk di të shpjegojë pse ndodhi ky fenomen në gjuhën tonë, dijet e tij nuk kanë shumë vlerë. Linguisti duhet të dijë që ky apo ai fenomen gjuhësor nuk ndodhi ngaqë ashtu i deshi qejfi ndonjërit, por sepse ashtu e ka dashur nevoja e zhvillimit të shoqërisë. Gjuha e folur, veshja etj. nuk janë njësoj në të gjitha krahinat e Shqipërisë. Ajo që mund të ketë ndodhur, ta zëmë në Shkodër, në kohët e lashta, nuk ka ndodhur në Elbasan. I vogël është populli ynë, por ka pasur zakone të ndryshme në krahina e zona të veçanta. Nga këto shfaqje heterogjene në jetën tonë duhet të dilte dhe doli uniteti etj., etj. Besimet fetare, zhvillimi i zejtarisë e i tregtisë, mënyra e jetesës, e veshjes, e këngëve, e vajtimet etj. të kohëve të kaluara kanë rëndësi të madhe, prandaj duhen studiuar që të njihen, sepse këto janë tregues që vërtetojnë shkallën e qytetërimit të popullit tonë për një epokë të tërë.

Sa më shumë të dimë ne, komunistët, aq më mirë është për Partinë dhe për popullin tonë. Në jetë kur-

doherë duhet të mësojmë për të përmbushur plotësisht detyrat, jo vetëm ndaj vendit tonë, por edhe ndaj ambientit rreth e rrotull. Të huajt kanë studiuar për ilirët, ata kanë dhënë kontribut me vlerë në këtë drejtim, por edhe dijetarët tanë kanë bërë përparime në këtë fushë. Hani nuk e njihje jetën e popullit shqiptar gjatë shekujve, por ai dinte diçka mbi këtë jetë gjatë periudhës së shekullit të 18-të. Hani ishte një albanolog i njohur austriak, i cili, si shkencëtar, duke bërë krahasimin e gjuhës sonë me gjuhët e tjera, nxori deduksionin se gjuha shqipe është gjuhë indoevropiane.

Është e vërtetë se ne nuk kemi trashëguar një gjuhë të shkruar nga koha e lashtë, por kjo ndodh edhe me shumë popuj të tjerë. Shumë popuj në botë nuk kanë lënë shkrim, por historia e tyre njihet, se me kohë kanë dalë njerëz, që janë marrë jo vetëm me studimin e linguistikës, por edhe me arkeologjinë, me teologjinë, me etnografinë etj. Ekziston një shkencë, e cila jep të dhëna shumë të sakta mbi evolucionin e qenieve të gjalla. Ka jetuar një shkencëtar i dëgjuar francez, i cili, vetëm duke pasur një kockë të trupit të kafshës apo të njeriut, ishte në gjendje të orientohet për të përfytyruar në mënyrë të saktë se si ka qenë gjithë trupi që i përkiste kockës së gjetur. Shkenca ka zbuluar sot të gjitha epokat e erat e ndryshme, nëpër të cilat ka kaluar planeti ynë.

Kështu duhet të veprohet edhe për historinë e popullit tonë, duke i përcaktuar e i shpjeguar drejt faktet që dimë dhe, duke u nisur nga e njohura, të përcaktojmë të panjohurën; nëpërmjet një hallke, të hidhemi në tjetrën dhe kështu të punojmë shkallë-shkallë gjer-

sa të formojmë një zinxhir të tërë faktesh të lidhura organikisht brenda vendit e jashtë tij. Këtë ne do ta bëjmë, sepse duhet të kemi parasysh që disa shkencëtarë u kanë kaluar shumë përciptas mjaft fakteve, që hedhin dritë mbi historinë e lashtë të popullit tonë. Kështu për shembull, po të thellohemi në historinë e Durrësit, do të mësojmë për luftën e Mark Antonit e të Cezarit, të cilët kanë qëndruar në këtë qytet të lashtë. Po të qëmtohet në këtë drejtim, do të gjejmë shumë të dhëna me vlerë për historinë e lashtë të popullit tonë.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

INTERVISTË VETËDEMASKUESE E TITOS

Shënime

6 shkurt 1976

Më 30 janar agjencia jugosllave Tanjug transmetoi intervistën që Titoja i ka dhënë gazetares së «Vjesnikut» të Zagrebit, Dara Janekoviç. Dialogu Tito-Janekoviç vërteton drejtësinë dhe saktësinë e parashikimeve të Partisë sonë për rrugën e zhvillimit të Jugosllavisë titiste. Po hedh, në formë shënimesh, në Ditarin tim Politik, mendimet që më lindën pas leximit të kësaj interviste.

Që kur revizionisti modern dhe agjenti i borgjezisë e i kapitalizmit botëror, renegati Tito, tradhtoi komunizmin, Partia jonë e ndoqi këmba-këmbës veprimtarinë e klikës së tij dhe e demaskoi atë pa mëshirë. Ajo bëri analiza të ndryshme në të gjitha kohët dhe në të gjithë sektorët e brendshëm e të jashtëm ku vepron kjo klikë dhe vërtetoi, në mënyrë marksiste-leniniste, se rryma revizioniste jugosllave ishte vënë në shërbim të plotë të imperializmit amerikan dhe të kapitalit botëror. Kjo bandë, me Titon në krye, i vuri detyrë vetes të shkatërronte socializmin në Jugosllavi, të shkelte mbi gjakun dhe djersën e popujve të këtij

vendi, të ndryshonte orientimet marksiste-leniniste të ish-Partisë Komuniste të Jugosllavisë, ta lidhte vendin e vet me kapitalin perëndimor, ta shndërronte Partinë Komuniste të Jugosllavisë në një parti borgjeze dhe vendin ta shiste te kapitali i huaj. E gjithë kjo analizë e drejtë e Partisë sonë u vërtetua nga jeta.

Kjo rrymë antimarksiste, revizioniste mori përpjesëtime të përbindshme me marrjen e fuqisë nga revizionistët e tjerë modernë, hrushovianët, në Bashkimin Sovjetik, të cilët u solidarizuan me Titon për të luftuar socializmin shkencor, ideologjinë marksiste-leniniste dhe ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik dhe kudo që ishte e mundur për ta që ta bënin këtë gjë.

Pamja e Jugosllavisë sot ka ndryshuar qind për qind nga ajo e viteve të para pas çlirimit, kur lidhjet e klikës së Titos, që edhe në atë kohë ishin të maskuara me «ideologjinë marksiste-leniniste» e me «miqësinë me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e tjera të demokracisë popullore», pengonin të shiheshin shtrembërimet e theksuara dhe veprimet e dënueshme armiqësore në drejtim të politikës së brendshme të Jugosllavisë, si dhe kundër vendeve të demokracisë popullore e, në veçanti, kundër vendit tonë. Fryma e gjithë këtij fillimi të maskuar i jepte mundësi kësaj bande të fshihte fytyrën e saj përpara popujve të tjerë që ajo synonte t'i shfrytëzonte politikisht dhe ekonomikisht, t'ua nënshtronte urdhrave dhe diktatit të saj, për t'i shpënë drejt degjenerimit ku shkoi vetë.

Është shumë mirë që për gjithë këtë degjenerim të brendshëm e të jashtëm të partisë dhe të pushtetit në

Jugosllavi dëgjojmë sot të flitet edhe nga vetë shkak-tari i kësaj katastrofe, renegati Tito, me intervistën që i dha gazetares së «Vjesnikut» të Zagrebit, Dara Jane-koviçit. Kjo intervistë ka një karakteristikë të veçantë. Gazetarja në fjalë, me një sërë pyetjesh që i ka drej-tuar Titos, e karfos këtë në murin e tradhtisë. Dhe Titoja është i detyruar t'u përgjigjet pyetjeve të saj, ku drejtpërdrejt, se nuk ka si bën ndryshe, ku tërtho-razi. Ai herë përpiqet të minimizojë fajet, herë, të japë shpresë se «çdo gjë do të ndreqet».

Karakteristikë kryesore e regjimit të renegatit Tito është se jo vetëm kemi të bëjmë me një regjim tipik kapitalist, por edhe me një regjim kapitalist anarkist. Atë që nuk e vunë dot në zbatim në kohën e tyre dhe në vende të ndryshme Prudonët dhe Bakuninët, e vuri Titoja në Jugosllavi pas Luftës së Dytë Botërore. Në shtetin federativ anarkist të Jugosllavisë lulëzojnë sot të gjitha llojet e krimeve, bile atje siç e pohon vetë me gojën e tij Titoja, mungojnë edhe ligjet kryesore të këtij lloj shteti jugosllav.

Në pyetjet që i bën gazetarja në lidhje me vendi-met që ka marrë Kongresi i 10-të i Lidhjes së Komu-nistëve të Jugosllavisë për të evituar krimbjen dhe katastrofën përfundimtare të regjimit të Federatës, Ti-toja pohon se «veprimtaria nacionaliste rrezikonte fito-ret e revolucionit, rrezikonte jo vetëm shtetin, por edhe partinë».

Këtë analizë Partia jonë e ka bërë me kohë. Ne parashikuam se revizionizmi do të ngjallte në Jugos-llavi, ashtu si edhe në Bashkimin Sovjetik, ndjenjat e shovinizmit të shtetit më të madh brenda Federatës

Jugosllave e të kombësive të tjera. Kjo jo për shkak të një apo dy njerëzve, por për shkak të ideologjisë kapitalisto-revizioniste, pse kapitalizmi i shtyp, i shfrytëzon popujt dhe sundon mbi ta me kërbaç. Vetë federalizmi anarkist dhe «struktura e re» që vendosi klika e Titos, vetadministrimi, e krijuan dhe e nxitën këtë konflikt në mes kombësive, në mes republikave. Nuk ka asnjë dyshim se kjo gjendje rrodhi nga ajo ideologji antimarksiste që mbretëronte në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, «**cila e humbi krejtësisht rolin drejtues dhe edukues**». Ajo nuk ishte më një udhëheqje, pse banda e Titos e shkurorëzoi nga ky rol.

Mirëpo Titoja, si antimarksist e që përpiqet të fshehë rolin e tij minues, nuk i shpjegon arsyet politike, ideologjike dhe organizative, të cilat u shkaktojnë këto fatkeqësi popujve të Jugosllavisë. Ai ka menduar dhe mendon se «**uniteti i shtetit socialist jugosllav**» arrihet duke mbajtur fjalime të çmendura, të paqëndrueshme, të gënjeshtërtë dhe të mbështetura në një ideologji antimarksiste. Prirjet centrifugale Titoja i shjeron me atë se «ekzistonte një synim i fuqishëm i udhëheqjeve të disa republikave që të shkëputen sa më shumë nga udhëheqja më e lartë e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë». Mirëpo ai lë në heshtje faktin se kjo shkëputje ishte e natyrshme, pse vetë grupi renegat, me Titon në krye, e dobësoi derisa e zhdukua centralizmin demokratik. Për titizmin centralizmi demokratik ekziston në bredhjet e Titos nëpër botë, në bërjen e një politike «të madhe» të përgjithshme të Federatës, kuptohet në shërbim të imperializmit ame-

rikan dhe për të siguruar me këtë punë prej spiuni të ardhura në kredi.

Vetë Titoja për këtë çështje pohon: «Centralizmi demokratik ishte likuiduar pothuaj plotësisht nga fjalori i komunistëve» dhe vazhdon: «Në një republikë udhëheqja e partisë ishte zhytur gjithnjë e më shumë në baltën e nacionalizmit». Kjo republikë, kuptohet, ishte Kroacia, udhëheqjes së të cilës ai i ka vënë etiketën «nacionaliste-shoviniste». Edhe udhëheqjen serbe kështu e cilëson ai, por jo me atë forcë që e bën për kroatët. Sidoqoftë aty-aty jemi për të gjitha republikat dhe kjo i përket gjithë sistemit që Titoja ka ndërtuar për të likuiduar socializmin dhe për të luftuar marksizëm-leninizmin.

Në intervistë, duke iu përgjigjur gazetares Janekoviç për Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, Titoja thotë: «Ne kemi akoma një numër çështjesh të rëndësishme, të cilat një numër jo i vogël i komunistëve nuk i kuptojnë. Në radhë të parë vetë ne, Lidhja e Komunistëve duhet të punojmë në mënyrë më të organizuar dhe sistematikisht me qëllim që çdo anëtar i Lidhjes të kuptojë si duhet të sillet dhe të veprojë, me fjalë të tjera, të kuptojë rolin e tij».

Ja, deri në këtë gradë e ka katandisur klika renegate e Titos Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, duke e kthyer në një organizatë amorfe, apolitike ose, më mirë të themi, e ka mësuar të ndjekë një politikë shkatërruese për jetën e popujve të Jugosllavisë.

Titoja pohon se «Anëtarët e Lidhjes së Komunistëve duhet të jenë të disiplinuar, të ndërtojnë etikën e rendit të ri socialist vetadministrues. të cilën po e krijoj-

më dhe të mos lejojnë të myken nga psikologjia konsumatore mikroborgjeze dhe të vrapojnë pas dinarit». Vetëm këto fjalë nxjerrin në shesh degjenerimin e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Duke iu përgjigjur gazetares Janekoviç lidhur me krizat e mëdha përpara të cilave ndodhet Jugosllavia, Titoja është i detyruar të pohojë se «ato nuk kanë ardhur nga poshtë, nga baza, por nga lart». Ai detyrohet kështu të njohë fajet e udhëheqjes, por, natyrisht, jo fajet e tij. Në çdo fjalim, kur ndërmerr ndonjë kritikë, Titoja nuk mungon të thotë «e kam thënë këtë» dhe intervista që i jep Janekoviçit, e ka këtë qëllim.

Titoja e shikon qartë katastrofën që kërcënon Jugosllavinë, por kjo katastrofë është kryesisht vepër e tij. Në një vend të intervistës ai thotë: «Prej kohësh dëgjohen dërdëllisje për atë se ç'do të ndodhë në Jugosllavi pas meje (Titos)». Ai vetë e di se ç'do të bëhet. Jugosllavia është e shkatërruar që tani që Titoja është gjallë, por ky, me këtë «autokritikë», zë qoshet dhe kërkon t'u thotë atyre që do ta gjykojnë e do ta dënojnë pas vdekjes për atë që ka bërë se «ja, unë e kam thënë, kam bërë thirrje që të rikthehemi tek e kaluara».

Titoja hiqet si teoricien, por është tamam një teoricien i revizionizmit modern, një sabotator i normave marksiste-leniniste, ai është një lumpen, me kostume të qëndisura me ar, një idealist. Në intervistën dhënë Janekoviçit Titoja thotë: «Anëtarët e Lidhjes së Komunistëve duhet t'i ndreqin të gjitha gabimet me autokritikë». Vetë fjala «autokritikë» lingëllon si marksiste, prandaj ai e përdor, por në regjimin aktual jugosllav,

në fakt, është në fuqi shprehja e urtë e popullit tonë: «Faji u bë qyrk dhe këtë qyrk asnjëri nuk e vesh». Titoja është idealist gjersa shpëtimin e pret nga «autokritika spontane», duke shpresuar që vjedhësit, vrasësit, grabitësit e matrapazët të dalin vullnetarisht të deklarojnë se kanë vjedhur, kanë bërë matrapazllëqe, janë dënuar të pafajshmit etj., etj. «Kjo autokritikë, — thotë ky pseudomarksist, — na mungon dhe na mungon shumë», prandaj «ne duhet ta zhvillojmë dhe ta kultivojmë atë në çdo organizatë-bazë», sigurisht ashtu siç kultivohet batha (!) mendon ai. Pasi i kujtohet më vonë se ekziston edhe termi «kritikë» në fjalor, pse sigurisht amnezia ia ka sklerozuar trutë, Titoja vazhdon: «Autokritika është më e rëndësishme se kritika dhe unë i jap avantazhe autokritikës». Kjo, me fjalë të tjera, dëshmon për një oportunitizëm me brirë, që me fjalë nuk mungon ta dënojë, por, kur shpreh ato që përmeda më lart, do të thotë: i lini rehat njerëzit të vjedhin. të grabitin; le t'i thonë vetë të gjithë ata burra të mirë çfarë kanë për të thënë, pse u bëheni havale? Këtë mënyrë veprimi, siç e thotë vetë Titoja, e përdor jo për të shpëtuar popujt e Jugosllavisë nga kriza e rëndë ku i ka futur regjimi dhe klika e tij tradhtarë, por që nëpërmjet kësaj autokritike të rritet prestigji i Jugosllavisë dhe ai i Lidhjes së Komunistëve. E gjithë çështja për të varet këtu te prestigji, te fama dhe jo te brendia. Për Titon nuk ka hiç rëndësi që molla është krejt e krimbur brenda, mjaft që lëkura e saj të duket e bukur nga jashtë.

Pyetjeve të Janekoviçit është e zorshme t'u përgjigjet Titoja, pse ajo i bën ato të drejtpërdrejta:

Ç'është kjo Lidhje e Komunistëve që po vepron kështu?, i thotë ajo me fjalë të tjera. Dhe Titoja përgjigjet: Lidhja e Komunistëve, që të bëhet ashtu siç duhet dhe ashtu siç ka qenë dikur, duhet «të forcohet ideologjikisht dhe politikisht». Tash na i ra ndër mend Titos të futë marksizëm-leninizmin nëpër shkolla, bile deri në fillore. Ai është i detyruar të njohë se në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë ka akoma mjaft indisiplinim në zbatimin e vendimeve dhe të detyrave të ndryshme, veçanërisht në disa organizata. Po zbatohen ngadalë ose po shkelen vendimet e kongresit të 10-të. Si konkluzion, që ai e thotë vazhdimisht me fjalë, por që në realitet vepron krejt ndryshe, «duhen ndërmarrrë masa akoma më të ashpra deri në përjashtimin nga Lidhja e Komunistëve».

Titoja pohon se Lidhja e Komunistëve e ka humbur shpirtin sulmues politik dhe ideologjik dhe harron se këtë shpirt sulmues asaj ia ka ndaluar dikush dhe me diçka që ka krijuar vetë Titoja për një kohë të gjatë prej dhjetëra e dhjetëra vjetësh. Këtë, natyrisht, ai e fsheh, por gazetarja në fjalë, pavarësisht se është një «admiruese» e këtij renegati, shpreh, si me thënë, opinionin e popujve të Jugosllavisë dhe i thotë këtij «udhëheqësi», që i ka kaluar tiparet e një mbreti feudal, se janë thënë dhe konstatuar, janë marrë shumë vendime e shumë gjëra janë shkruar për të këqijat, për gabimet dhe për të metat që janë vërtetuar në regjimin jugosllav. «Megjithatë, vazhdon gazetarja, ekziston përshtypja se gabimet dhe dobësitë po ndreqen shumë ngadalë në praktikën e përditshme». Gazetarja, drejtpërdrejt, i thotë: «Kjo është vërejtja, e cila dë-

gjohet nga një numër i madh njerëzish», të cilët thonë se të këqijat vetëm sa konstatohen, por asnjëherë «nuk kalohet përtej konstatimit». Përveç kësaj, gazetarja përmend «rezistencën shumë të fuqishme të forcave burokratike».

Si t'i përgjigjet Titoja kësaj pyetjeje? Ja, po jua japim përgjigjen e tij: «Është e vërtetë se ekzistojnë gjëra të tilla, por Lidhja e Komunistëve nuk mund, si me magji dhe menjëherë, t'i ndihmojë të gjithë, t'i ndreqë të gjitha gabimet, se janë bërë gabime të mëdha» dhe, në mes të tjerave, përmend si shembull sigurimin, ku, pohon ai, «ka pasur njerëz që kanë bërë gabime të mëdha». Por se mos është vetëm sigurimi?!

Federata Jugosllave në të katër anët është krimbur nga vjedhjet dhe çfarë vjedhjesh! Gazetarja e «Vjesnikut» është e shqetësuar për këtë gjendje, pse i shqetësuar është gjithë populli, prandaj ajo pyet presidentin e vet: Si do t'u bëhet halli gjithë këtyre vjedhësve me çizme, se nuk shohim të bëhet gjë kundër tyre? Dhe Titoja i përgjigjet: «Komisionet për studimin e prejardhjes së pasurisë në fillim u dukën sikur e morën punën me zjarr», po pastaj çdo gjë u fik. Pse? Është vetë Titoja që flet: Komisionet nuk dhënë rezultate «për shkak të lidhjeve familjare, miqësore, territoriale, ose kush mund ta dijë se për çfarë lidhjesh dhe konsideratash të tjera ato kanë mbajtur qëndrime oportuniste dhe nuk e kanë kryer detyrën e tyre». Dhe, si me habi, vjedhësi i vjedhësve, mbreti i mbretërve, thotë: «Te ne nuk duhet të ekzistojnë gjëra të tilla»! Po ku mund të ekzistojnë gjëra të tilla e njerëz të tillë, kur nuk duhet të ekzistokan në

Jugosllavinë kapitaliste, anarkiste? Por, vazhdon Titoja, «do të gjejmë mënyrën ta kalojmë të gjithë këtë», vetëm, sipas tij, duhet bërë klasifikimi se kush vjedh shumë, kush vjedh pak dhe kush nuk vjedh, pse ka njerëz që kanë bërë spekulime kolosale, dhe jo vetëm janë pasuruar me punën e të tjerëve e me djersën e ndërmarrjeve jugosllave, por janë bërë miliarderë. Kështu pohon ai me gojën e vet.

Kur gazetarja i thotë se puna e këtyre komisioneve është lënë në harresë, «Jo, nuk është harruar, — përgjigjet Titoja, — do të ndërtojmë komisione të reja dhe do të bëjmë klasifikimin». Kësaj i thonë: Prit go-mar të mbijë bar! Këto ai i thotë sa për të gënjyer popullin, se asgjë nuk po ndryshon në Jugosllavinë revizioniste.

Është ideologjia titiste ajo që ka krijuar një situatë të tillë, duke përgatitur gradualisht terrenin për të zhvilluar të gjitha këto të këqija, këto vese mikroborgjeze kapitaliste. Dhe ja çfarë pohon Titoja vetë: «Komunistët në fillim nuk kanë qenë tregtarë. Në sektorin e tregtisë kanë punuar ish-tregtarët dhe kjo për disa prej tyre ka qenë ideale. Ata kanë ditur si tregtohet, në mënyrë që të fitonin sa më shumë, dhe, në këtë rrugë, ata kanë përgatitur edhe anëtarët e partisë që kanë punuar me ta, të cilët pastaj i kanë kaluar edhe mësuesit e tyre, janë bërë më të këqij nga ish-tregtarët». Nuk ka si flitet më hapur! Po çfarë të bëjë? Gjendet në pozitë shumë të vështirë ky farë presidenti, i cili më poshtë vazhdon të pohojë për gjendjen në Jugosllavi: «Ja, tash kemi shumë të arrestuar», se «kanë vjedhur me miliarda». «Mendoni, — thotë Titoja, —

sa dëme të mëdha na kanë shkaktuar këta njerëz, ato janë të pabesueshme».

Titoja është detyruar të pohojë vetë se «tregtia e jashtme e Jugosllavisë ka qenë e tëra në duart e spekulantëve, të cilët kanë ditur mirë se si të vjedhin». Rroftë parulla false: «Tregtia është në duart e shtetit», kurse Titoja e ka vënë atë tërësisht në duart e spekulantëve borgjezë, kapitalistë, të cilët, me metodën e vetadministrimit, japin e marrin me firma të jashtme kapitaliste, harxhojnë kreditë që u jep imperializmi amerikan, marrin për veten e tyre përqindje të majme nga fitimet dhe gjithë këto vlera të mëdha i depozitojnë nëpër bankat e botës kapitaliste për të kaluar jetë të rehatshme dhe luksoze.

Ishte vallë gjë e panjohur për Titon dhe për klikën e tij një situatë e tillë? Tash i pa ai gjithë këto fenomene fantastike? Jo, ai e krijoi vetë këtë situatë, ai punoi për të krijuar një borgjezi të re kapitaliste në Jugosllavi, e cila duhej ta merrte dhe e mori fuqinë, duke hedhur në dorë ekonominë e financat dhe duke ua shitur vendin imperializmit dhe kapitalizmit botëror. Si pasojë në Jugosllavi u zhvillua inflacioni dhe çmimet u ngjiten e vazhdojnë të ngjiten në qiell. Por është populli që i pëson atje të gjitha këto të këqija.

«Çfarë po bëhet për aprovimin e ligjit të ri federativ për procedurën penale? Duket sikur jemi duke pritur shumë», — e pyeti atë Dara Jenekoviçi. Procedura penale në Jugosllavi akoma nuk është vendosur dhe kjo është e qartë pse. Regjimi i vetadministrimit mbrohet kriminelët dhe kriminalitetin, mbrohet kusarinë dhe korrupsionin. Atëherë si i përgjigjet Titoja kësaj

pyetjeje? «Ligjet, në qoftë se përpilohen me shpejtësi të madhe, nuk janë të mira. Ligjet kryesore themelore që po përgatiten tash, do të jenë të vlefshme për një kohë të gjatë». Mund të presin popujt e Jugosllavisë akoma më gjatë, sipas Titos, të cilit nuk i është bërë kurrë vonë për ta. Titoja është i detyruar të pohojë se «aprovimi i ligjeve po zvarritet aq shumë sa po bëhet tepër vonë, kështu kur ligji të aprovohet, ai nuk do të jetë më aktual». Nuk ka ku vete më qartë!

Më në fund Dara Janekoviçi, që është vetë grua, i thotë Titos se në shoqërinë jugosllave «ka ligje që janë në dëm të grave dhe të pozitës së tyre në shoqëri dhe përveç kësaj është shumë i vogël kujdesi i regjimit për gratë. Është turp që kemi kaq pak çerdhe, kopshte e karusele për grumbullimin e fëmijëve». Ç'përgjigje t'i japë Titoja kësaj pyetjeje? Dhe ja çfarë thotë ai: «Këtë çështje pas luftës e filluam mirë, pastaj menjëherë dinari mori vrull dhe çdo gjë duhej të shikohej nëpërmjet dinarit. Ky ka qenë një gabim i madh yni se lamë shoqërinë tonë dhe gratë në vështirësi, lamë të futet në këtë çështje kisha». Megjithatë, për sa i përket pozitës së vështirë të gruas në shoqëri, Titoja i thotë gazetares: «Unë nuk jam plotësisht dakord me ju». Mirëpo ai flet hipur majë kalit të artë, prandaj Dara Janekoviçi i përgjigjet: «Unë këtë jua them si grua, shoku Tito, ju pyetni gratë punëtore».

Po ku nuk e kanë filluar keq Titoja dhe regjimi i tij! Ai pohon se nuk ka asnjë listë të kuadrove drejtues, nuk dihet se kush është njëri apo kush është tjetri, nga vjen, si është bërë drejtues, kush e ka shtyrë në poste me përgjegjësi dhe si kanë ndodhur këto? Dhe

mbaron duke thënë: Do t'i kalojmë këto të gjitha (!) Ka afro 30 vjet që Jugosllavia ka hyrë në rrugën e shkaktërrimit kapitalist dhe të anarkisë si ideologji dhe si realitet në shtet dhe ky renegat mendon të rregullojë gjithë këto të këqija me një të rënë të shkopit magjik titist.

Siç e thashë edhe në fillim, kjo intervistë e Titos jo se hedh ndonjë dritë të re mbi gjendjen e vajtueshme të popujve të Jugosllavisë, të kombësive të ndryshme të saj, këtë ne e dimë, e kemi ndjekur hap pas hapi, e kemi analizuar dhe e kemi dënuar. Partia jonë e ka bërë të qartë prej kohësh këtë gjendje dhe ka luftuar kundër të gjithë atyre që mbronin dhe mbrojnë klikën renegate jugosllave. Por intervista e Titos ka një rëndësi të veçantë sepse ai e pohon vetë degjenerimin e plotë të shoqërisë jugosllave, që është rrjedhim i degjenerimit revizionist të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe të të gjithë udhëheqjes së saj. Kjo intervistë u vë kapakun shumë intervistave të tjera, në të cilat Titoja s'mungonte të mburrej si gjel për «drejtësinë e vijës së tij», për rezultatet «e shkëlqyeshme» të kësaj vije, për «ndërtimin e shoqërisë së re dhe të vërtetë socialiste», por në të vërtetë të gjitha këto ishin paradat e një megalomani, të një gënjeshtari e aventurieri që rronte mbi kurrizin e popujve të Jugosllavisë si një monark i shekullit të 17-të dhe që, duke përdorur një frazeologji pseudomarksiste, hyri në shërbim aktiv të shërbimit të fshehtë imperialist kundër botës socialiste, kundër komunizmit.

Satisfaksioni i Partisë sonë qëndron në atë që vija e saj e palëkundur, e drejtë, marksiste-leniniste, jo

vetëm i ka shërbyer si një busull e pagabueshme, por e ka kalitur në luftëra dhe e ka bërë të fortë e të guximshme që të luftojë pa frikë kundër të gjithë këtyre re-negatëve e padronëve të tyre, të arrijë suksese për ve-ndin e saj socialist dhe, me qëndrimet e saj të drejta, t'u shërbejë shokëve dhe miqve të tjerë që luftojnë për socializmin e komunizmin në vështirësitë e mëdha që hasin nëpër rrugën plot kurthe e dredhi të ngritura nga kapitalizmi botëror dhe revizionizmi modern. Për Partinë tonë është një nder që, në këtë rrugë, të hedhë ndriçimin e vet për shokët dhe miqtë e saj, që ata të mund t'i kapërcejnë dhe t'i likuidojnë këto vështirësi e dredhi të armiqve të komunizmit.

*Marrë nga libri: Enver Hoxha,
«Ditar për çështje ndërkom-
bëtare» (botim i brendshëm),
nr. 8, f. 265*

KONKLUZIONET JANË TË SIGURTA KUR DALIN NGA TË DHËNA TË SAKTA

Nga biseda me shokun Pali Miska¹

19 shkurt 1976

Më fal, shoku Pali, se të mundova, por të thirra se na shqetëson shumë gjendja e pusit që ka pësuar avari. Mund të na thuash, në ç'fazë janë tani punimet në këtë objekt?

SHOKU PALI MISKA: Përpara se të largohesha unë, vendosëm që pusin ta lëmë përsëri në qetësi.

Sot u pa për herë të parë gaz dhe kjo ka krijuar optimizëm te punonjësit e pusit. Ata thanë se tani kemi një rrugë komunikimi të gazit nga shtresa në pus. Gazi me presionin e vet do të bëjë që kjo rrugë komunikimi të hapet gradualisht më shumë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po ne e shpuam, përse të mos vijë gaz?

SHOKU PALI MISKA: Vërtet kështu është, po mund të ketë akoma ardhje të argjilit, që nuk lejon të komunikojë plotësisht gazi.

1. Në atë kohë ministër i Industrisë dhe I Minierave.

SHOKU ENVER HOXHA: Aktualisht, është bërë verifikimi për të parë nëse shtresat që kemi kapur janë gazmbajtëse apo jo? Pasi të jetë verifikuar kjo, të na thuhet se ç'përmbajtje kanë ato shtresa, sa metra janë ranore, sa argjilore, sa gëlqerore e kështu me radhë.

SHOKU PALI MISKA: Shtresat që kemi kapur tani janë gazmbajtëse. Prerja gjeologjike e pusit nuk është e tëra argjilore, po argjilore me ndërfitje ranore. Sa për trashësinë e tyre, siç na thonë, nuk ka gjë të sigurt, por shprehen me: «ndoshta edhe diçka më pak ose më shumë».

SHOKU ENVER HOXHA: Po pse nuk është marrë kampioni? Ky është një verifikim material. Kur doli gaz ne e mbyllëm trungun. Tani kaluam në trungun tjetër, po edhe në këtë, në një shtresë pesëmetërshë hasëm përsëri në zonë gazmbajtëse. Tani, në deviacionin që bëmë, nga ky pesëmetërsh na interesonte që kampioni të kishte dalë patjetër.

SHOKU PALI MISKA: E drejtë është, kampioni do ta tregonte këtë, por kur u bë devijimi i dytë, në po këtë trung, gjeologët thanë se ndodhi i njëjti fenomen, si tek i pari: ata morën masa për të mos u ndodhur para së papriturës, se e kishin frikën e avarisë ose të fontanës.

SHOKU ENVER HOXHA: Avaria mund të ndodhte përsëri se nuk ishte ngritur instrumenti. Pse nuk e ngritën instrumentin?

SHOKU PALI MISKA: Kur shpuan, ata i zbritën tubat e rrethimit dhe të shfrytëzimit, që pusi të përvetësohej në kushte normale. Kur goditën me perforator, gjeologët, pohuan se nuk qenë fort të bindur,

nëse kishin qëlluar vallë tamam atë që duhej apo partën rënë në shtresë argjilore dhe kështu, në vend të gazit na vjen argjil. Specialistët thonë se, në rast se gazi nuk del me këtë metodë, do të bëjnë performime në gjithë intervalet që mendohet se mund të jenë gazmbajtëse.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë nuk them që të ndalojmë procesin e punës që ka filluar, po logjikisht, del se atje, midis mureve të pusit dhe të kolonës është krijuar një shtresë argjilore. Brenda, në këtë kolonë është instrumenti shpues, por krahas, rreth e qark, është toka. Duke e futur instrumentin më në thellësi, u arrit në një pikë, ku shpërtheu gazi. Kur u pa se instrumenti kishte shkuar më thellë dhe dilte gaz që u fut në mes instrumentit dhe kolonës, ndodhi avaria, se specialistët duhet ta kishin futur atë në kolonë, pra ta ngrinin. Këtë nuk e bënë. Domethënë, avaria na ndodhi për gabimin që u bë. Kështu, u bllokua rruga në një gjatësi rreth 70 metra, për arsye se kolona nuk ishte ulur dhe muri nuk e mbajti e u shemb. Tani ne duhet të informohemi, se në ç'kuotë na doli gazi, të cilin e dimë se ekziston, gjë që e kemi të vërtetuar e të shkruar edhe në dokumente. Atëherë, mjetet, që kishim futur në tokë, poshtë kolonës ne i çimentuam, domethënë hodhëm çimento.

SHOKU PALI MISKA: Kolona, në çastin që ndodhi avaria, ishte më lart, kurse çimentoja kishte shkuar akoma më thellë.

SHOKU ENVER HOXHA: Trungu tjetër u bë tre metra larg nga i pari dhe dimë vendin nga plasi gazi, se e kemi të regjistruar. Domethënë, kur futën në tokë

instrumentet e shpimit për së dyti, në këtë pikë, duhet të na manifestohej gazi.

SHOKU PALI MISKA: Ashtu ndodhi. shoku Enver dhe të gjitha këto u regjistruan.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne tani vazhduam shpimin më poshtë nga intervali i gazit dhe, kur ky kaloi më tej, zbritëm në fund edhe kolonën. Tani ajo duhej zbritur në fund apo në mënyrë progresive? Këtë duhej ta gjykonin specialistët, nëse duhej zbritur kolona më poshtë që kjo të evitonte shembjen. Atëherë ne, duke shpuar më poshtë duhej të zbrisnim përnjëherë kolonën.

SHOKU PALI MISKA: Specialistët e shpjegojnë teknikisht se në këtë rast nuk mund të bëhej gradualisht ulja e kolonës.

SHOKU ENVER HOXHA: Këtë e them se mos këtu na ndodhte përsëri shembja dhe, pavarësisht se ne e hiqnim instrumentin, shtresa do të na shembej. Megjithëkëtë, konstatojmë që këtu nuk ndodhi shembja, pra, nuk u bllokuan instrumentet. Tani, mes tokës dhe kolonës nuk ka gjë. Atje, sipas mendimit tim, masa e lëndëve është e puthitur.

SHOKU PALI MISKA: E putnitur dhe e plotësuar edhe me çimentim.

SHOKU ENVER HOXHA: Po ku dhe përse u fut çimentimi mes tokës dhe kolonës? Atje masa e materialeve duhet të jetë aq e puthitur, sa nuk ka si të futet çimentoja.

SHOKU PALI MISKA: Po ka ndonjë boshllëk. Kolona metalike është vërtet e puthitur me tokën, por nuk është e ngjeshur plotësisht kudo. Pikërisht, për

të arritur që të ngjishet mirë me tokën, bëhet çimentimi, me qëllim që për çdo gjë që mund të ndodhë më vonë, të mos na vijnë ujëra.

SHOKU ENVER HOXHA: Po nga e futën çimenton këtu?

SHOKU PALI MISKA: Si ulim kolonën, çimenton e injektojmë brenda saj nëpërmjet grykës së pusit.

SHOKU ENVER HOXHA: E qartë. Por, në gjatësinë e trungut në të cilin ngrihet çimentoja që injektojmë nga brenda, mund të ketë boshllëqe e kaverna të tjera, në të cilat futet çimentoja që injektojmë. Tani, me këtë që bëjmë, ne, krijojmë një ide dhe për madhësinë e kavernave, se mund të bëhen matje se sa çimento është hedhur. Duke ditur sasinë e çimentos së hedhur, gjithashtu dihet se ç'vëllim zë dhe kështu na vërtetohet nëse atje do të ketë pasur një zgavër të madhe apo të vogël. Pra, po të jetë vepruar në këtë mënyrë, çdo gjë është e qartë... Duhet kontrolluar e vërtetuar nëse është marrë dhe përdorur barit në pus.

Të vijmë tash te shtresat. Këto ne i studiojmë që kur fillon shpimi dhe derisa përfundojnë të gjitha punimet që verifikojnë prerjen e pusit. Këtu ka dy lloj punësh:

E para, karotazhi, kampioni që është i pagabueshëm, mbi të cilin specialistët, kur ta studiojnë, do të mbështeten për të konkluduar se diku ka shtresë rano-re, më poshtë gëlqerore, më tutje akoma argjilore etj. Tash dua të bëj pyetjen: është bërë studimi i prerjes së pusit? Kjo çështje ka rëndësi. se pikërisht në këtë pus mund të na kenë sabotuar dhe një nga mjetet e sabotimit mund të ketë qenë hedhja e baritit.

E dyta, avaria në fakt ndodhi. Tash është çështja që me këto procedura që bëhen ato që na dalin, duhet të verifikohen. Në qoftë se në gjithë thellësinë e pusit, duke përfshirë edhe metrat e gazifikuar, studiojmë natyrën e çdo shtrese, domethënë sa metra trashësi është shtresa argjilore, sa metra shtresa gëlqerore, sa shtresa ranore etj., nga kjo, shkencërisht, ne duhet të nxjerrim konkluzionin se cilat shtresa dominojnë në këtë prerje, fjala vjen, shtresat argjilore, pse, në përgjithësi, është vërtetuar që tri të katërtat e këtyre shtresave janë argjilore dhe vetëm një e katërta ranore; kjo është për gjithë fushën ku ka dalë gazi? Ky studim do të ishte një gjë speciale, po kjo nuk u bë, se gjeologët thanë që nuk do të ngjiste avaria. Ne duhet të mendojmë që disa metra janë shtresa gazmbajtëse, se e pamë gazin dhe aparatet atë e matën.

Tani marrim diçka aproksimative. Specialistët thonë që atje janë, për shembull, tri shtresa. Në qoftë se kjo nuk është e saktë, një gjë të tillë ne nuk duhet ta lejojmë, nuk mund të pranojmë që ata të flasin në tym. Ne perforuam tri intervale. Këtu, megjithëse nuk na doli gaz, na u vërtetua që kjo pjesë e pusit komunikon me shtresën argjilore. Pra, tani për tani, ne kemi vetëm një të dhënë: mund të kemi hasur në argjil, dhe në qoftë se kemi shpuar ekzaktësisht, ky nivel ku kemi arritur, mund të jetë fillimi i shtresës gazmbajtëse. Nga kjo mund të mendohet se, ose kemi shpuar tamam aty ku duhet, ose presioni i perforatorëve ka tronditur vendin dhe, nëpërmjet disa të çarave argjilore, ka dalë një sasi e vogël gazi. Kështu, ne duhet të ruajmë hipotezën, sipas së cilës nuk duhet

të kemi perforuar ekzaktësisht atje ku ndodhet gazi.

Kjo një. E dyta, ne duhet të verifikojmë që nga vendi ku na ka dalë gaz e poshtë janë shtresa argjilore në të cilat, sipas gjeologjisë etj. nuk mund të kemi gaz, se ky qëndron në shtresat ranore. Ne tash ose do të arrijmë rezultate me këto procedura, domethënë, do të na dalë gaz dhe do të verifikohet kështu se shtresat nuk janë plotësisht argjilore, ose nuk do të kemi gaz. Megjithatë, kjo prapë nuk do të thotë se në gjithë këtë zonë nuk kemi gaz, po duhet të arrijmë në konkluzionin që ai mund të jetë gjetkë, atje ku ndër-futjet ranore në argjilë do të jenë më potente. me trashësi më të mëdha, ndoshta dhe më lart. Prandaj mendoj se mund të ngjitemi më lart dhe të mos perforojmë më poshtë.

SHOKU PALI MISKA: Pardje, në konsultë pas gjithë atyre debateve që u bënë, doli edhe një mendim i tillë që përputhet me këtë tuajin, shoku Enver. Sipas tij, gazi që na doli nuk do të thotë se është pikërisht atje, por mund të jetë edhe më lart.

SHOKU ENVER HOXHA: Një gjë e tillë ka mundësi dhe këtë ua shpjegova edhe shokëve. Kjo mund të jetë një shtresë e hollë, kurse ne filluan të perforojmë më poshtë. Forca e gazit krijoi një boshllëk dhe i ngjeshi anët e gropës nga poshtë, nga lart dhe majtas, por jo nga ana e kolonës, se nuk na doli argjil. Presioni mund ta ketë taposur gazin lart ose mund të ketë lejuar vetëm një komunikim fare të vogël. Këtë hipotezë nuk duhet ta hedhim poshtë. Por, edhe sikur të mos na dilte fare gaz, prapë ne nuk duhet të themi që nuk ka, po të marrim masa, siç thashë, për t'u

ngjitur më lart dhe me siguri gaz do të gjendet, sidomos në qoftë se bëhet studimi i prerjes siç thamë. Kjo kërkon që të bëhen vëzhgime të imëta nga ana e specialistëve. Nëse këto na dalin shtresa ranore, me këtë verifikohet edhe teoria, sipas së cilës gazi gjendet pikërisht në këto shtresa. Ai mund të depërtojë edhe në shtresat argjilore, por me një forcë më të vogël. Të gjitha këto të dhëna që sigurohen, pas çdo procesi pune, është detyrë që të shkruhen me kujdes nga specialistët në librin e çdo pusi.

Tani na thuhet se pusi tjetër aty afër do të na sqarojë shumë gjëra. Atje po na dalin shenja gazi. Duhet t'i shkruajnë se ku dalin këto shenja, në shtresat argjilore apo në shtresat ranore. Këto të dhëna të shihen me kujdes të madh dhe të bëjmë krahasime edhe në thyerjen e këndeve, se ç'distancë është, kemi këtë thyerje apo ndonjë thyerje tjetër. Kjo varet nga kampioni që duhet të marrim të cilin duhet ta ruajmë me shumë kujdes, se me kujtesë nuk mbahen mend gjithë këto gjëra. Unë ngul këmbë në këtë drejtim. Çdo vepër që bëhet, që puna të ketë karakter me të vërtetë shkencor, duhet të regjistrohet me përpikëri dhe nga të gjitha këto të dhëna që mbledhim, të nxjerrim konkluzione, të cilat janë më të sigurta kur dalin nga të dhëna të sakta dhe jo me hamendje. Dhe, në qoftë se nuk del ky konkluzion, atëherë këtu kemi të bëjmë me një fenomen të jashtëzakonshëm. Por të gjitha të dhënat vërtetojnë se këtu, në këtë zonë, ka gaz dhe në qoftë se nuk na del, atëherë duhet të bëjmë përpjekje për të gjetur arsyen dhe të zbulojmë ç'është ky fenomen.

Unë jam dakord me ju që këto punime t'i bëni me këmbëngulje, bile futja e rërës, mendoj unë, të mos krijojë çimentim dhe në fakt rëra këtë nuk e bën se depërton. Shkencërisht ne duhet të dimë që zakonisht nga argjili kompakt nuk del gaz. Atëherë, që të dalë, duhet të bëjmë këto shpërthime me presion, bile me presione të mëdha atmosferike.

Të kihet parasysh ajo që shpjegova se edhe futja me një presion të madh në shtresën argjilore mund të na vështirësojë edhe më tepër akoma shtresën e gazit që mund të jetë më lart. Rëndësi ka që çdo veprim ta bëjmë pasi të jemi bindur në bazë të të dhënave shkencore, të nxjerra nga vetë shpimi i pusit.

Botohet për herë të parë, sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

PLANIN E RI PESËVJEÇAR DUHET TA HARTOJMË DUKE U BAZUAR NË FORCAT E NË MUNDËSITË TONA EKONOMIKE, NJERËZORE E TEKNIKE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 shkurt 1976

Jam plotësisht dakord me vërejtjet dhe me diskutimet e shokëve, të cilat i konsideroj të rëndësishme, orientuese dhe plotësuese për projektplanin që do t'i përgatitim Kongresit të ardhshëm të Partisë.

Vërejtjet që kam unë, përgjithësisht dhe pa u futur në shumë hollësi, janë në përputhje me të gjitha mendimet që u shprehën këtu. Pavarësisht se materiali që na paraqitet është voluminoz, mendimet lidhur me organizimin e mirë të punës duhen pasur parasysh. Kjo çështje është shumë e gjerë dhe e thellë, prandaj lypset të shihet me kujdes në gjerësi dhe në thellësi.

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth treguesve kryesorë paraprakë të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës gjatë viteve 1976-1980, si edhe për caktimin e kuotave që do të shërbenin për hartimin e projektplanit të pesëvjeçarit të gjashtë.

Siç doli nga diskutimet, nga vërejtjet dhe nga propozimet që u bënë në këtë mbledhje, materiali ka minuse, prandaj t'i plotësojmë ato medoemos, që plani të jetë sa më real. Gjithçka që u përmend këtu ta mendojmë dhe ta zbatojmë mirë. Duhet të njohim se rutina, metoda e stili i vjetër në punë, siç do ta them më pas, vazhdojnë, prandaj në këtë drejtim të kemi kujdes.

Plani i ri pesëvjeçar ka një rëndësi jetike për vendin tonë, prandaj atë duhet ta hartojmë në mënyrë të studiuar mirë, me vëmendje të veçantë, duke u bazuar në forcat e në mundësitë tona ekonomike, njerëzore dhe teknike. Ky plan duhet të mbështetet në rezultatet e arritura më parë dhe veçanërisht në një analizë të imët të pesëvjeçarit të kaluar. Në qoftë se analizat e pesëvjeçarit që mbyllëm bëhen me sy kritik të shëndoshë dhe në to vihet në dukje pa dorashka realiteti ynë, krijohen mundësitë që plani i ri pesëvjeçar të mbështetet në faktorë realë. Po kështu edhe llogaritë për përgatitjen e tij do të bëhen më të sakta, në bazë të forcave e të mundësive që ekzistojnë dhe plani do të hartohet në mënyrë më shkencore.

Kjo, sipas mendimit tim, është metodologjia kryesore e përgjithshme, pa të cilën nuk mund të hartojmë një plan të bazuar në realitetin dhe në mundësitë tona, një plan të parashikuar mirë qoftë nga ana e forcave materiale e financiare, qoftë nga ana e forcës së mekanizimit, e njerëzve dhe e ngritjes profesionale të punonjësve. Kuptohet se nga një plan i tillë, i përgatitur në bazë të një metodologjie shkencore, do të dalin në dukje edhe mundësitë reale për zhvillimin e

mëtejshëm të ekonomisë, të mjeteve të prodhimit e të mjeteve të konsumit. Kështu bilanci i investimeve për zhvillimin e mëtejshëm të prodhimit e për akumulimin dhe i pjesës së përdorshme për materialet e konsumit për popullin, natyrisht, do të dalë më mirë.

Ky proces as nuk mund të kuptohet, as nuk mund të bëhet si duhet në rast se Qeveria (dhe me këtë kuptoj ministritë, Komisionin e Planit të Shtetit dhe gjithë organizmat e tjerë që janë rreth saj) nuk studion, çka thashë më lart, për çdo vit e për çdo pesëvjeçar. Lypset të ndiqet si duhet realizimi i atyre që vendosim brenda caqeve e ligjeve që rregullojnë punën, prodhimin, organizimin. Në qoftë se këto çështje nuk ndiqen vazhdimisht në zhvillimin e tyre, natyrisht planet do të realizohen me shumë boshllëqe, do t'u lihet shteg të metave e deri sabotimeve.

Unë mund të them se gjer në njëfarë shkalle analizat nuk kanë munguar për çështje të planit, edhe masa gjithashtu janë marrë, por del se diçka serioze nuk po na ecën dhe kjo, mendoj, qëndron në punën e dikastereve, në udhëheqjet e tyre, në radhë të parë, pastaj në të gjithë piramidën, duke përfshirë edhe Komisionin e Planit të Shtetit.

Në Komisionin e Planit të Shtetit ne kemi pasur dy armiq, dy sabotatorë, dy elementë antiparti¹, që kanë punuar sistematikisht dhe kanë sabotuar ekonominë. Kjo tashmë është e qartë për ne, por me zbulimin e veprimtarisë së tyre nuk do të thotë se ne zbuluam plotësisht edhe format e metodën e punës së

1. Abdyl Këllezi dhe Koço Theodhosi.

tyre sabotuese dhe çështë më keq, nuk do të thotë se me kaq ne zhdulëm atë frymë të keqe antimarksiste, që është dukur në ekonomi, në organizim, në kontroll dhe në zbatim të detyrave, që këta armiq kanë futur prej vitesh me radhë në kuadrot vartës. Shumica e këtyre kuadrove janë punonjës të mirë. Pikërisht spastrimit të këtyre frymëzimeve të këqija serioze ne nuk i jemi futur akoma si duhet.

Unë mund të them se në punë e sipër ne kemi konstatuar gjëra jo të mira, kundër të cilave me të drejtë jemi revoltuar e revoltohemi, kemi marrë e po marrim edhe masa, por një sërë çështjesh kryesore, që bëjnë pjesën më të rëndësishme ekonomike të planit, akoma nuk po lëvizin si duhet përpara. Ato janë kthyer, si të thuash, në parim «betonarmeje» ose, siç u shpreh një shok në «koncepte», apo siç u shpreh një tjetër: «të tilla gjëra, zor të hiqen nga koka». Natyrisht, unë i hedh poshtë mendime të tilla jomarksiste, se këto të çojnë në pranimin e fatalitetit, të gabimeve që kanë bërë elementët jo të shëndoshë dhe elementët armiq për të shtrembëruar vijën e drejtë të Partisë dhe hovin revolucionar të masave.

Jam i mendimit që në këtë çështje ne duhet të reflektojmë thellë. Por jo reflektim për reflektim se ky nuk sjell asnjë dobi. Ne duhet të reflektojmë e, njëkohësisht nëpërmjet diskutimit jo për formë, të konkretizojmë mendimet tona e të marrim masa e vendime konkrete, të vëmë caqe dhe të kërkojmë, duke filluar nga vetja e deri te vartësit në hierarki, që t'i zbatojmë ato me përpikërinë më të madhe. Moszbatimi në jetë i masave dhe i vendimeve që marrim është

e domosdoshme të vihet në evidencë me kohë; në qoftë se ka shkaqe objektive, të jepen fakte dhe të sillen dokumente bindëse, jo për ta justifikuar moszbatimin, por për t'u marrë menjëherë, me iniciativë, brenda kompetencave, masa të reja të përshtatshme nga ana e organeve kompetente, për realizimin me kohë të detyrave. Në qoftë se nuk do të veprohet kështu, atëherë të metat, mosrealizimet dhe gabimet mund të shikohen vetëm në fund të vitit, kur do të jetë vonë. Me një praktikë të tillë, përveç dëmit, ne krijojmë edhe një situatë shumë të sëmurë dhe një pikëpamje jo të shëndoshë të disa njerëz, të cilët do të mendojnë se mund ta kapërcejnë lumin në fund të vitit.

Nga ana e dikastereve, e Komisionit të Planit të Shtetit dhe e Qeverisë, përveç dhënies llogari përpara Byrosë Politike dhe Komitetit Qendror të Partisë për realizimin e planit dhe për disa probleme kyç të ekonomisë, duhet të jepen edhe arsyetime shkëlqitëse për ndjekjen e problemeve, të shpjegohet përse ngjau ky ose ai fenomen, çfarë masash plotësuese u morën gjatë përpjekjeve për zbatim dhe çfarë rezultoi prej tyre. Kjo dhënie llogari për Byrosë Politike dhe për Komitetin Qendror, pa lëre për Kongresin e Partisë, nuk duhet të jetë as e hollësishme, por as edhe shumë e përgjithshme. Këtë e vë në dukje, sepse të dy këto ekstreme mund të ngjasin. Eksperienca duhet të na mësojë se kush duhet të merret me hollësitë, kush me problemet e një rëndësie mesatare dhe kush duhet të merret me problemet kyç, kryesore, nga të cilat varet zhvillimi me sukses i gjithë ekonomisë.

Disa hiqen si ekonomistë të mëdhenj, si organizatorë të përsosur dhe të rreptë në kërkimin e llogarisë e të tjera, por në të vërtetë nuk rezultojnë të jenë plotësisht të tillë. Në kemi pasur shumë suksese. Edhe ekonominë e kuptojmë, edhe organizimin e disiplinë kemi, dhe punë kemi bërë e llogari, gjithashtu, kemi kërkuar, por është e drejtë të njohim se nuk kemi arritur në atë shkallë që duhet dhe që kërkon Partia. Kjo vjen për shumë arsye, por më të këqijat janë të mendjemadhësia, tek indiferentizmi dhe te liberalizmi i disa kuadrove e drejtuesve. Ka dhe shokë e punonjës me përgjegjësi që nuk janë nga ata që të mos i zërë gjumi për realizimin e detyrave të veçanta, me të cilat janë ngarkuar dhe të bëjnë konkluzione për t'i lidhur ato me zbatimin e detyrës së përgjithshme. Kjo jo vetëm është një kërkesë parimore, por është, gjithashtu, një detyrë organizative jo e thjeshtë, një detyrë politike dhe ideologjike me rëndësi të madhe. E them këtë, pse kjo çështje kuptohet thjesht dhe zbatohet keq nga disa. Mendoj se mund të bëjmë akoma më shumë nga sa kemi bërë, në këtë drejtim, prandaj tek asnjëri, e aq më tepër tek udhëheqësit, nuk duhet të kenë vend as euforia, as vetëkënaqësia, as pesimizmi.

Po përse mund të kishim bërë më shumë dhe pse duhet të bëjmë edhe më shumë? Mjetet e prodhimit çdo vit dhe çdo pesëvjeçar po shtohen, njerëzit tanë kanë tridhjetë e ca vjet që drejtojnë shtetin socialist dhe kanë fituar një eksperiencë të shumanshme në drejtim, në organizim, në ekonomi, në industri, në arsim, në mekanikë, në bujqësi e në të gjithë sektorët e tjerë. Kjo eksperiencë nuk është vetëm teorike, por

edhe praktike. Partia dhe shteti kanë përgatitur me dhjetëra e qindra mijë kuadro me arsim të lartë e të mesëm, ngritja politiko-ideologjike dhe tekniko-profesionale e të cilëve vazhdon pandërprerë. Të gjithë këta bëjnë një forcë të madhe fizike e mendore, organizative e politike, që duhet e kanë mundësi të kryejnë një punë me të vërtetë më të madhe dhe më të përsosur nga ajo e deritanishmja. Këtë konkluzion nxjerr unë nga realiteti ynë dhe mendoj se kështu është e vërteta në të gjitha hallkat, prandaj, kur nuk punon si duhet «makina», kjo duhet të na bëjë të mendojmë thellë, se shkakun e mosrealizimeve nuk mund ta gjejmë as te një person, as te një mijë persona, por në ngritjen e përgjithshme të të gjithë njerëzve tanë të udhëhequr nga Partia që punojnë në organet shtetërore dhe të Partisë.

Koço Theodhosi dhe Abdyl Këllezi jo vetëm na kanë sabotuar materialisht dhe na kanë dëmtuar në fushën e organizimit, por na kanë sabotuar edhe në format e në metodat e punës që kanë praktikuar për ta fshehur këtë sabotim material, me qëllim që të mos zbuloheshin në përpjekjet e tyre për të bërë ndryshimin e rendit tonë politik, ekonomik dhe shoqëror. Format dhe metodat e punës së tyre armiqësore, natyrisht, ne duhet t'i studiojmë dhe t'i shkulum nga rrënjët.

Na është paraqitur një studim mbi metodologjinë e planifikimit, të cilin këtë herë nuk po e marrim në diskutim. Këtë material unë nuk e studiova, e ktheva, por do të dëshiroja që ai të ishte me bukë. Komiteti Qendror dhe Byroja Politike e kanë përcaktuar meto-

ologjinë që duhet të ndiqet në planifikime. Tash na duhet thënë nëse kjo metodologji është e drejtë apo jo. Në qoftë se është e drejtë, atëherë do të thotë se gjatë punës, në praktikë, ajo është shtrembëruar kryesisht nga Koço Theodhosi dhe Abdyl Këllezi. Në qoftë se metodologjia e planifikimit është e drejtë, por gjatë kësaj kohe mund të jenë krijuar kushte objektive që diktojnë nevojën e disa përmirësimeve etj., atëherë duhet të na paraqiteshin mendime për të marrë vendime plotësuese, përmirësuese për të. Pra, studimi për metodologjinë e planifikimit në Byronë Politike duhej të na paraqitej më i shkurtër dhe këtë e ka për detyrë ta bëjë Qeveria. Ajo, duke u bazuar në vendimin e Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror mbi metodologjinë e planifikimit, që është caktuar përpara, duhet të spastrojë ato shtrembërime që janë futur në të nga veprimtaria armiqësore e Koço Theodhosit dhe e Abdyl Këllezit, të spastrojë vetë të gjitha ligjet dhe urdhëresat që mund të jenë propozuar dhe që kanë dalë në bazë të sugjerimeve të bëra nga këta dy elementë armiq, si dhe nga elementë të tjerë jo të ndërgjegjshëm për ndryshimet që dëshironin të bënin dhe që kanë bërë në metodologjinë e planifikimit. Mendoj se, po të veprimej kështu, materiali do të ishte më i shkurtër.

Nuk është e drejtë që shokëve të udhëheqjes t'u humbet kohë nga një sërë punonjësish të Komisionit të Planit të Shtetit që janë mësuar me metoda të vjetra pune. Këtë e vë në dukje pse edhe në projektplanin e gjashtë pesëvjeçar, që na është dërguar, është ndjekur e njëjta metodë e vjetër paraqitjeje, e cila të

thotë shumë gjëra, për të mos thënë shumë të tjera. Kjo është një nga metodat e rrezikshme të Abdyl Këllezit për paraqitjen e materialeve, me të cilat ai është përpjekur të fshehë mosrealizimet e planit, gabimet, liberalizmin dhe shumë të këqija të tjera. Një material i tillë, pavarësisht se jep shumë shifra, nuk i shpjegon dhe nuk i arsyeton ato.

Arsyetimet që na paraqiten në relacion lidhur me treguesit kryesorë paraprakë të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës për vitet 1976-1980, për mendimin tim, janë të tepërta dhe të pavlefshme. Kjo është një metodë e vjetër pune e sajuar nga Abdyl Këllezi. Ky material, prej dyzet faqesh, i bën një koment foshnjor materialit tjetër, pasqyrave të përgjithshme të treguesve kryesorë të planit, që përmbajnë dyzet faqe me tabela, të cilat kanë gjithashtu një karakteristikë të vjetër. Mjaft prej tyre janë të pakuptueshme dhe kërkojnë shpjegime, që nuk i gjen gjëkund. Diskutimet e gjithë shokëve e vërtetuan këtë. Një punë e tillë duhej bërë nga Kryesia e Këshillit të Ministrave. Komisioni i Planit të Shtetit duhet t'i japë kësaj, për këtë qëllim, shpjegime e sqarime, bazuar në eksperiencën e gjithë viteve ose të tërë pesëvjeçarit të pestë. Duke lexuar tabelat, unë nxjerr më tepër konkluzione dhe bluaj më tepër mendime në kokë nga ç'mund të më thotë ndonjë funksionar i Komisionit të Planit të Shtetit i mësuar me metodë e stil të vjetër pune, vetëm se ato duhen diskutuar, duhen shpjeguar përse janë kështu, se nuk përjashtohet mundësia që ato të jenë plotësisht të drejta. Shokët mund të thonë se për këto çështje mund të bëj pyetje edhe në mbledhjen

e Byrosë Politike. Edhe kjo mund të bëhet, por në Byro, dhe ne e kemi këtë eksperiencë, këto çështje duhet të na vijnë më të shpjeguara. Ne i mbajmë mend pyetjet që i bënim Abdyl Këllezit, që ngrihej e na mbushte me fjalë, prapa të cilave fshiheshin të gjitha ato ligësi që dimë. Edhe Koço Theodhosi të njëjtën gjë bënte, kur ishte kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit. Edhe kur u bë ministër i Industrisë dhe i Minerave, ai përgatiste një fjalim prej dhjetë-pesëmbëdhjetë faqesh të vogla; na jepte këtu disa shpjegime të përcipta, duke ngritur sytë në qiell, pse ato që thoshte nuk i kishte të sigurta ose na fshihte të vërtetën dhe ne, natyrisht, diskutimin e planit e kalonim me ndonjë ndryshim të vogël.

Ishte kjo një punë e drejtë, e shëndoshë? Jo! Prej saj u vërtetuan shumë gabime, armiqtë na sabotuan. Tash që ata i hoqëm nga mesi ynë, na vihet detyrë të zhdukim edhe frymën, edhe metodën e tyre të punës.

Le t'i hedhim një sy faqes së tretë të relacionit ku jepen treguesit kryesorë të zhvillimit ekonomik gjatë planit të pestë pesëvjeçar, që gjoja na shpjegojnë mundësitë për të caktuar kuotat që do të shërbejnë për hartimin e projektplanit të ri. E para e punës, duhet të reflektojmë çfarë do të thotë që rritja e prodhimit shoqëror pritet të arrijë rreth 37 për qind? Në material s'ka asnjë shpjegim përse nuk janë realizuar shifrat sipas planit të parashikuar. Po kush do të na e thotë këtë? Duhet ta marrim vetë me mend apo të kënaqemi me disa fraza stereotipe që na janë thënë vazhdimisht që në kohën e Koço Theodhosit: «për arsye

objektive», «për arsye subjektive», «për mungesë materiali» etj., etj.? Këto në vija të përgjithshme, siç del edhe nga tabela në material, ne i dimë.

Unë mendoj se tabela ka një rëndësi të jashtëzakonshme, por, në qoftë se nuk shpjegohet pse nuk u realizua prodhimi shoqëror gjatë pesëvjeçarit që kaloi dhe në qoftë se nuk ndërron e gjithë metoda e parqitjes së këtij relacioni, ne nuk do të mund të gjejkojmë e të vendosim drejt mbi kuotat që na parashtrohen nga Komisioni i Planit të Shtetit. Këtu e kam fjalën për treguesit kryesorë, për prodhimin shoqëror që është realizuar 37 për qind, për prodhimin e përgjithshëm industrial 51 për qind, ose për prodhimin e përgjithshëm bujqësor vetëm 30 për qind e kështu gjithë të tjerat me radhë. Prandaj, përpara se ta bëjmë këtë, mendoj të kalojmë në një diskutim serioz të këtyre mosrealizimeve. Po të vendosim çfarë na thotë ndonjë punonjës i Komisionit të Planit të Shtetit, i mësuar me metoda të vjetra pune, siç e përmenda më lart, ose çka na nxitin dëshirat, kur të vijë koha për të bërë analizën e plotësimit të planit të gjashtë pesëvjeçar, ne do të dalim me të njëjtën tabelë si kjo e këtij pesëvjeçari dhe po kështu do të themi prapë: kjo nuk u realizua «për arsye objektive», «për arsye subjektive», «për mungesë organizimi» etj. Jo, shokë, mua më duket se nuk duhet të ecet kështu!

Dëshiroj të flas tash për disa probleme kyç, në të cilat bazohet fati i ekonomisë sonë. Le të fillojmë nga lëndët djegëse, nga nafta. Ne e dimë që kjo na është sabotuar, por duhet ta imagjinojmë sa i madh e i rrezikshëm ka qenë sabotimi, apo të kënaqemi me çka na

thuhet në këtë relacion e që në vija të përgjithshme e kemi dëgjuar? Çështja vihet: Si dhe sa do ta zhvillojmë ne këtë degë të rëndësishme të industrisë sonë? Në relacion nuk ka një vlerësim të bazuar për këtë çështje, gjë që do të thotë: Tash zgjidhe ti, Byro Politike, nëse do të jesh me mendimin e Ministrisë së Industrisë e të Minierave apo me atë të Kryesisë së Këshillit të Ministrave. Një gjë e tillë nuk është e drejtë. Për këtë problem kaq të madh neve duhet të na jepen këtu disa të dhëna organizative dhe materiale me baza shkencore dhe jo të na flitet vetëm për «rëndësinë e madhe» që ka nafta. Në material thuhet se shifra që synojmë të arrihet, duhet caktuar kaq apo aq. Mirëpo pse duhet caktuar kaq ose pse duhet caktuar aq?

Prodhimi i naftës te ne ka lidhje me shumë gjëra. por kryesisht me vënien në lëvizje të të gjithë ekonomisë së vendit tonë, me industrinë, me makineritë që kemi e që duhet të punojnë, lidhet me importin dhe eksportin dhe me rafineritë që kemi ndërtuar. Atëherë, ne do të vendosim *a priori*, siç thotë ministria, siç thotë Kryesia, apo siç thonë gjeologët, teknikët, specialistët, punëtorët e naftës, të cilët akoma nuk e kanë marrë veten nga tronditja që pësuan? Ka shembuj se edhe kohët e fundit disa elementë në këtë sektor vazhdojnë të na sabotojnë dhe përpiqen të na çojnë në rrujë të gabuar. Me gjeologët është e kuptueshme se duhet të punojmë, por shpjegimet që na jepen këtu, në Byronë Politike, nga ana e Komisionit të Planit të Shtetit duhet të jenë më të thella, më logjike e më

shkencore. Vetëm kështu, në bazë të tyre, ne do të mund të shfaqim mendime të shëndosha.

Qymyrguri është, gjithashtu, lëndë djegëse e një rëndësie kapitale për ekonominë tonë socialiste. Në këtë plan pesëvjeçar nxjerrja e tij parashikohet në një numër të madh minierash disa nga të cilat do të jenë të reja, ndërsa disa të tjera do të zgjerohen e do të modernizohen. Në relacion thuhet se gjithë kjo sasi qymyrguri që parashikohet të nxirret na duhet, dhe për këtë jam i bindur, bile edhe dyfishin e kësaj sasive po të kishim, do të ishte mirë, se do t'i gjenim treg për eksport. Vetëm në këtë zë ka disa probleme që na janë trashëguar nga Koço Theodhosi. Minierat e qymyrgurit nuk mbahen mirë, ato nuk shfrytëzohen si duhet, qymyri në to lihet të digjet, shpenzohen shuma të mëdha për ta prodhuar, ndërtimi i minierave të reja zvarritet shumë. Në material thuhet sa do të japin minierat, por, në pesëvjeçarin e kaluar, në realitet, shumë gjëra nuk u vërtetuan. Ne duam të dimë për ç'arsye ndodhi një gjë e tillë, po kjo justifikohet: «Për arsye objektive planet janë bërë me vonesë», «kanë munguar materialet», «gjeologjia nuk ka punuar mirë» etj. Nga kjo nuk del asgjë e mirë. Në rast se Ministria e Industrisë dhe e Minierave nuk u bënë një analizë serioze të gjitha deficiteve të pesëvjeçarit të kaluar dhe mungesave në të gjitha llojet e punëve në minierat e qymyrgurit, ku të dalin të metat kapitale dhe të na jepet siguria se këto nuk do të përsëriten më, atëherë plani që do të hartojmë nuk do të na shërbejë shumë dhe ne diskutojmë pa shumë dobi. Kur të hartojmë planin, të diskutojmë me kujdes. Çështjen e kam

te shpërndarja e forcave dhe te plotësimi i të gjitha nevojave të ekonomisë me qymyrguri e, bile, mundësisht edhe të eksportojmë një sasi, veçse të bëjmë përpjekje që nxjerrja e qymyrit, ashtu sikurse edhe ndërtimi i minierave të reja, të na kushtojë lirë. Mirëpo të tilla konsiderata nuk na jepen në relacion.

Unë jam dakord me të dhënat që jepen për kromin, hekur-nikelin dhe për industrinë e bakrit, por edhe në këto të dhëna, sidomos për kromin dhe për bakrin, që janë dy zëra të rëndësishëm, mendoj se mundësitë janë shumë të mëdha dhe ka mjaft probleme. Kam përshtypjen se nuk punohet mirë në nxjerrjen e këtyre dy mineraleve të vlefshme, bëhen shumë shpenzime, ka një zvarritje të madhe në ekzekutimin e punimeve të parashikuara që shkojnë deri në vitin 1980, bile dhe e tejkalojnë këtë vit. Gjithashtu ka disa miniera të largëta me sasi nxjerrjeje të paktë që dalin të nevojshme të funksionojnë, sigurisht në rast se ne nuk u vëmë supet Bulqizës dhe shtresave që ekzistojnë në fund. Prandaj edhe këtu duhet të përqendrojmë forcat, por, në qoftë se do të bëhet kështu, minierat më të largëta mund të lihen për shfrytëzim në një periudhë të mëtejshme.

Për sa i përket industrisë elektrike do të kaloj nga vërejtjet e përgjithshme që i bëra relacionit, në disa vërejtje konkrete. Orientimet kanë qenë drejt hidrocentraleve dhe plotësimit të nevojave me TEC-e. TEC-et të ngriheshin, po ato të punonin kryesisht me gaz dhe me qymyr dhe vetëm në mungesë të mjaftueshme të tyre me naftë. Këto orientime, është e kuptueshme se nuk janë zbatuar nga Abdyl Këllezi, por edhe ne

duhet të ishim treguar më tepër vigjilentë që ai me shokë të mos na gënjenin me shifrat e planit. Për naftën, në fakt, armiqtë na sabotuan dhe jo vetëm gaz nuk zbuluam, por edhe qymyrin e hodhëm tej e, në shumë objekte ku ai mund të përdorej fare mirë, e zëvendësuam si pa të keq me naftë. Prandaj këto parime që kemi caktuar dhe që mendoj se janë shumë të drejta, duhet të gjejnë pasqyrim në llogaritjen dhe në përcaktimin e orientimeve për prodhimin e energjisë elektrike.

Për investimet, përveç makinerive e montimeve, duhet të bëjmë kujdes të madh, sepse harxhohen fonde të mëdha të panevojshme. Dëshiroj të vë në dukje, veçanërisht, se fondet e caktuara për ndërtime, tejkalohen shumë. Kjo gjendje duhet ndrequr pa vonesë se ekonomia po dëmtohet rëndë për shkak të mungesës së kontrollit të duhur nga Ministria e Ndërtimit dhe e organeve të saj vartëse.

Nuk jemi kurdoherë të sigurt për preventivat, projektimet, për zbatimin e tyre. Në cilindo nga këto procese fondet ngrihen jashtë masës së përcaktuar. Në goftë se kërkojmë disiplinë të hekurt në ndërtimet dhe në qoftë se dëshirojmë që ekonomia jonë të mos dëmtohet rëndë, unë mendoj se duhet rishikuar rrënjësisht kjo çështje dhe fondet duhen ulur. Si është e mundur që për një vepër të na paraqitet preventivi, për shembull, dyzet milionë lekë dhe ajo të përfundojë duke harxhuar shtatëdhjetë milionë? Çfarë parashikimi është ky?! Në parashikim ka raste që edhe mund të gabohet, por për një shumë të vogël. Më vonë, pas parashikimeve, kur vijnë proceset e tjera në Qeveri, në By-

ronë Politike dhe në Komitetin Qendror, minisurat dhe zëvendësit e tyre, inxhinierët dhe projektuesit vihen me shpatulla për muri, sepse janë pikërisht disa nga këta që u kërkojnë institucioneve kryesore shtetërore dhe të Partisë të shtohen fondet. Do të vazhdojmë të pranojmë në një presion të tillë? Nuk duhet ta pranojmë kurrësi! Në duhet të luftojmë dhe po luftojmë që pikërisht ky koncept të zhduket te punonjësit e ndërtimit. Me fondet e veprës së caktuar ka raste që ndërtohen edhe objekte të tjera jashtë planifikimit, për të cilin është caktuar fondi. Në qoftë se lejohet një praktikë e tillë, kjo bëhet shumë e rrezikshme. Në këtë mes ka munguar edhe ndërgjegjja, edhe kontrolli.

Ka raste që vepra fillon më parë nga bishtrat, nga ngritja e ndërtesës së drejtorisë dhe e një sërë objektivesh që presin, të cilat duhet të vendosen në baraka të thjeshta, në vend që të bëhen pallate, duke harxhuar kështu sasi të mëdha fondesh. Të tilla gjëra po na i vërteton praktika, për to shkruajnë me mburrje, bile, edhe gazetat. Në to lexon se përfundoi ndërtesa e drejtorisë, mensa, klubi etj., etj. dhe pastaj, shumë më vonë, dhe më në fund, thuhet se po hidhen themelet e fabrikës. Partia ka thënë se punëtorët që venë në këto kantiere, natyrisht, nuk mund të rrinë në shi e në diell, por në fillim të ndërtohen për këtë qëllim fjetore të thjeshta, që të mund të ngremë më vonë gjëra të mëdha.

Në relacionin e dërguar nuk ka analiza të hollësishme, për të metat e vërtetuara, nuk na thuhet gjë si janë harxhuar fondet dhe çfarë masash janë marrë që të mos përsëriten teprimet që kështu të mund të jemi

të qartë për trajtimin e shumave që na caktohen për ndërtimin e veprave të reja. Tash, dëshiroj të di nëse shumat, që caktohen në këtë material, për gjithë këto fabrika e kombine të reja që do të ngremë, për të cilat fola, janë caktuar pasi janë bërë verifikimet përkatëse dhe a janë marrë masat e duhura që gabimet të mos përsëriten më, apo janë llogaritur mbi një bazë të gabuar? Këtu na numërohen çështje të tëra me radhë, renditen njëri objekt pas tjetrit, jepet sa parashikohet të kostojnë, si dhe mendimi për fondet që duhen caktuar. Mirëpo është e domosdoshme ta dijë çdonjeri nga ne pse një objekt, i vendosur të përfundojë me një fond të caktuar, nuk është realizuar? Ky, i riu, përse caktohet kaq dhe jo më shumë apo më pak?

Të marrim çështjen e bujqësisë. Herë të tjera unë kam bërë mjaft vërejtje për këtë sektor, por në këtë relacion nuk figuron asnjë përgjigje për to. Këtu thuhet vetëm se kur do të mbarojë Hoxhara, kur Karavastaja e Vogël dhe ajo e Madhe, Mallakastra etj., por afatet që janë vënë, nuk na thonë gjë. Unë dua të di, dhe këtë e kam thënë edhe herë tjetër, së pari: Përse nuk janë mbaruar me kohë veprat e bonifikimit dhe të ujitjes? Sa fonde janë harxhuar deri tash për ndërtimin e tyre dhe sa janë tejkaluar? Kush është përgjegjës që këto objekte me kaq rëndësi nuk janë realizuar me kohë dhe ka lejuar të harxhohen gjithë këto fonde? Si janë bërë llogaritë dhe a ka siguri në planifikimin e këtyre bonifikimeve apo ia lëmë këtij ose atij inxhinieri t'i projektojë këto? A është e domosdoshme të përhapemi kaq shumë në këto objekte dhe, kur të vijmë në fund të planit të gjashtë pesëvjeçar, të dalim

po me të njëjtat konkluzione, siç thamë edhe në pesëvjeçarin e pestë, që ky ose ai objekt nuk u bë për këtë ose për atë arsye etj.? Këto duhet të na tregohen për të pasur një pasqyrë të qartë mbi mënyrën e përdorimit dhe të shpërdorimit të pasurisë së popullit nga ky ose nga ai person, për të njohur veprimtarinë e njërit dhe tjetrit, për ta ditur pse ndodhin gjëra të tilla. Unë mendoj se këto janë probleme kyç, të domosdoshme, në të cilat duhet të ndalemi mirë.

Ne nuk mund të dimë zhvillimin e ndërtimeve, forcën materiale dhe ekonomike të këtij sektori, nuk mund të dimë forcën prodhuese në sasi dhe në cilësi të tokave tona, në rast se gjithë këtyre gjërave nuk u bëjmë analizën e duhur. Në bazë të një analize të shëndoshë mund të arsyetohen edhe veprat, edhe fondet, edhe detyrat. Nga gjithë kjo analizë ne duhet të bëjmë krasitjen e shumë vendimeve që kanë mbetur si norma të palëvizshme. Norma të palëvizshme nuk mund të ketë, këto duhet të lëvizin, sepse aktualisht mekanizimi është më i përsosur, kuadrot janë më të aftë, punëtorët më me eksperiencë, arkitektët dhe specialistët e tjerë, gjithashtu, kanë më shumë përvojë e dituri.

Ndërtimi i veprave në përgjithësi dhe ai i veprave joprodhuese na zënë një vend të madh në harxhimin e fondeve monetare e materiale. Është thënë se përgjithësisht duhet të caktojmë fonde për vepra të mëdha e prodhuese, por edhe për të vogla, që të jenë rentabël. Në projektimin e këtyre veprave të vogla rentabël vihet re mania e disa arkitektëve dhe projektuesve për të lakmuar më tepër «të bukurën» dhe, për rrjedhim,

të shtrenjtën sesa të lirën, rentablen me vlerë dhe me brendi. Prodhon makina që vihet në funksionim dhe jo kopshti i madh e i zbukuruar përpara drejtorisë, prodhon uzina dhe jo muri rrethues i saj i ngritur me hekura e me tulla me vrima. Kësaj manie të dëmshme i duhet vënë fre se na dëmton ekonominë.

Unë nuk do të përsëris ato që kemi thënë për tejkalimin e fondeve për veprat e mëdha, por shikoj se veprat nën kufi janë ulur. Do të bëhet shumë më mirë që ato të ulen edhe më, pa ulur prodhimin. Të vihen rregulla jashtëzakonisht të rrepta për administrimin e fondeve. Ata drejtues, që, nën pretekstin e ushtrimit të kompetencave, shpërdorjnë fondet, duke i shpenzuar jashtë veprës që u është caktuar, duhet të përgjigjen.

Te ne ndërtohen tri lloje veprash: ato që ndërton Ministria e Ndërtimit, ato që ndërtojnë ministrinë e tjera, si dhe veprat nën kufi. Të tëra këto, natyrisht, nuk duhet të grumbullohen në një dorë, por në këtë drejtim duhen ndaluar shpërdorimet që të mos ndodhë, ta zëmë, si me atë tornon e veçuar moderne, që bashkë me tornitorin e kategorisë së lartë i mban një ndërmarrje e vogël, se i duhet të bëjë një bulon në muaj. Kështu ka ngjarë edhe për veprat që ndërtojnë vetë ndërmarrjet ose ministrinë. Në këtë drejtim Ministria e Ndërtimit duhet të forcojë kontrollin. Ndodh që një drejtues ndërmarrjeje thotë se i duhet një ndërtim i tillë; dikush i bën një projekt dhe, mbi këtë bazë, caktohet çmimi. Ministria përkatëse e pranon kërkesën dhe ia paraqet atë Komisionit të Planit të Shtetit, i cili e aprovon dhe kështu ndërmarrja merr paratë, që

shpeshherë nuk i përdor për destinimin e duhur. Të tilla gjëra nuk duhen lejuar.

Duhet të reflektosh thellë, shoku Pirro Dodbiba, për këto çështje që ngjasin në dikasterin që drejton ti. Brenda këtij dikasteri, që ti e quaje se duhet të luajë vetëm rolin e këshilltarit, bëheshin të tilla veprime. Të gjithë e dëgjuaam kritikën pa dorashka që t'u bë ty drejtpërdrejt, këtu në Byronë Politike, kurse ti, shoku Pirro, në organizatën-bazë jo vetëm nuk e zure me gojë këtë kritikë, por e mohove dhe the se «nuk e kam dëgjuar».

Dëshiroj të ritheksoj, shoku Pirro, se kritikata që po të bëjmë, mund të jenë shumë të ashpra, por për këtë ne shtyhem nga dy qëllime: të mbrojmë vijën e Partisë dhe interesat e popullit për zhvillimin e bujqësisë socialiste, të të ndihmojmë gjithashtu edhe ty, si shok komunist dhe kandidat i Byrosë Politike, që të ndërrosh metodën dhe stilin në punë, me qëllim që këto t'u përshtaten vijës dhe detyrave të mëdha dhe të ndërlikuara që Partia i vë bujqësisë.

Ne e kuptojmë që bujqësia është një nga sektorët jo vetëm më të rëndësishëm, por edhe nga më të ndërlikuarit e ekonomisë sonë popullore, si objektivisht, ashtu edhe subjektivisht. Por vija e Partisë në lëmin e bujqësisë kurdoherë ka qenë dhe vazhdon të jetë e atillë që të procedojë me një organizim shkencor në zhvillimin e saj, me një edukatë të shëndoshë ideopolitike të njerëzve që merren me bujqësinë dhe me edukimin teknik të kuadrove, të kooperativistëve, për përdorimin e mekanikës bujqësore e të çdo gjëje që i nevojitet zhvillimit modern të bujqësisë sonë. Me këtë dua të

them se Partia as në parim, as në praktikë nuk i ka lënë gjë spontancitetit. Në qoftë se ekziston spontaneitet në zhvillimin e bujqësisë, ky duhet t'i ngarkohet anës subjektive, njerëzve, të cilët nuk i futen si duhet përvetësimit të teorisë së Partisë për zhvillimin e bujqësisë dhe nuk zbatojnë si duhet e ritmikiisht detyrat që u caktohen.

Problemi kyç që iu vu përpara Partisë dhe shtetit tonë ishte kooperimi i bujqësisë. Këtë detyrë Partia e realizoi me sukses, por krahas kësaj kërkohej jo vetëm perfeksionimi organizativ i kolektivizimit, por njëkohësisht edhe marrja e të gjitha masave që përmenda më lart, me qëllim që kooperativat bujqësorë të ishin bazë e shëndoshë e bujqësisë sonë dhe në to të ngriheshin vazhdimisht rendimentet e të gjitha bimëve. Bashkimi i kooperativave u bë gradualisht dhe ky ishte një problem jospontan. U bë studimi organizativ e politik i tyre, u punua ideologjikisht, u përcaktuan forma dhe norma, u bënë ndryshime në statut, u koordinuan bimët etj., etj. Nga ky bashkim kaluam më vonë në organizimin e kooperativave bujqësorë të tipit të lartë. Edhe për këto u morën gjithashtu masa, u përcaktua drejtimi politik, organizativ dhe ekonomiko-financiar i tyre etj.

Për tërë bujqësinë janë marrë masa mekanizimi dhe këto nuk ishin spontane, por të organizuara, të renditura çdo vit e çdo pesëvjeçar; janë përcaktuar metoda e rregullore, janë nxjerrë edhe ligje, që ndihmojnë për organizimin e punës dhe rritjen e prodhimit në një drejtim të vetëm — modernizimin e bujqësisë. Por Partia shkoi akoma më tej.

Këtu, në Byronë Politike, ne kemi marrë shumë vendime të rëndësishme, nga të cilat po përmend vendimin për ujitjen e tokave. Planet në këtë zë ose janë realizuar, ose janë në realizim e sipër. Në bazë të këtyre vendimeve kemi bërë studimin pedologjik dhe kimik të tokave, kemi bërë, gjithashtu, një studim në kooperativën e zmadhuar të Plasës në Korçë. Këto studime, për të cilat ne kemi marrë vendime të veçanta në Byronë Politike, duhet të zbatohen progresivisht në të gjitha rrethet, kuptohet jo në një vit, por për më shumë kohë. Rëndësia e kësaj çështjeje qëndronte te rajonizimi dhe përqendrimi i bimëve për prodhimin e madh, me synim që të modernizohet më tej prodhimi në kooperativat dhe në ndërmarrjet bujqësore duke bërë edhe balancimin e ekonomisë së çdo kooperative me ekonominë e rrethit. Natyrisht në këtë proces do të mbahen parasysh natyra e tokave, klima, uji, forcat e punës, njerëzit dhe mekanizimi. Në këto probleme kyç unë mendoj të numëroj edhe zgjerimin e rritjes së gjedhit, shtimin e sipërfaqeve për foragjere dhe për mbjelljen e pemëve frutore në blloqe e, sidomos, për mbjelljen e ullinjve.

Këto të tëra i numëroj për të dalë në konkluzionin që Partia dhe shteti ynë nuk kanë ecur në mënyrë spontane. Komiteti Qendror i Partisë u kërkon llogari Ministrisë së Bujqësisë dhe komiteteve të Partisë në rrethe se si janë zbatuar këto detyra të mëdha në zhvillim për një sërë problemesh, si për ujitjen, për përhapjen e eksperiencës së Plasës, të SMT-së së Shijakut, për futjen në shfrytëzim të pemëve frutore dhe veçanërisht të ullinjve dhe për rezultatet e kooperativave

bujqësore të tipit të lartë. Por për këto çështje, nuk na është raportuar dhe informuar nga ana jote, shoku Pirro. Pse të jetë kjo situatë? Të paktën duhet thënë kjo që ti dhe shokët e tu atje, në Ministrinë e Bujqësisë, nuk drejtoni si duhet, nuk e keni parasysh ndjekjen në vazhdimësi të këtyre problemeve kyç të bujqësisë sonë socialiste. Për këtë arsye nuk jeni në gjendje të na raportoni jo vetëm në krye të çdo viti, por as tani, në këtë moment kyç, kur ne po hartojmë dhe do të vendosim për planin pesëvjeçar. Për ato që thonë shokët të shtojmë kaq për panxharin, kaq për grurin, kaq për këtë apo aq për atë, unë jam dakord që t'i shtojmë, por ne kemi katër vjet me eksperiencën e Plasës, studimin e së cilës e bëmë posaçërisht për t'i rregulluar këto çështje dhe nuk po punohet për përhapjen e saj. Këto gjëra do t'i bëjmë në mënyrë spontane apo do të marrim masa për t'i vënë në jetë? Mua më duket se nuk është e drejtë, as e lejueshme të punohet në këtë drejtim në mënyrë spontane, të lihen pas dore këto çështje me kaq rëndësi.

Në mbledhjen e fundit të Qeverisë, ju, shoku Pirro Dodbiba u kritikuat. Nuk di nëse ju i keni raportuar Qeverisë për këtë problem kyç, që kanë marrë në analizë Byroja Politike dhe Komiteti Qendror për modernizimin e bujqësisë. Në qoftë se po, atëherë Qeveria e kishte për detyrë që tash, me rastin e hartimit të planit pesëvjeçar, të na vinte në korent. Kështu edhe ne do të ishim inë në gjendje të thoshim se më 1980 rendimentet duhet të arrijnë kaq dhe jo aq, se vajrat vegjetale duhet të arrijnë kaq e jo aq, e kështu me

radhë. Prandaj, nuk lejohet të bëhet punë rutinë dhe pa perspektivë.

Të gjitha këto pyetje na kanë dalë edhe herë të tjera dhe prandaj kemi ngritur probleme, por këto probleme bëhen të mprehta në çastet aktuale, kur ne vendosim për planin e ri pesëvjeçar, i cili duhet të jetë i ngjeshur. Ky plan bëhet shumë i vështirë në të realizuar, në qoftë se këto të meta që u ngritën këtu do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

A e realizoni ju, shokë të Ministrisë së Bujqësisë dhe shokë të tjerë, që merreni me bujqësinë, se sa të dëmshme janë ajo metodë dhe ai stil i punës suaj të zhvilluar nga pozitat e qëndrimit gjoja si këshilltarë? Mendoni ju se do të realizohen si duhet detyrat vetëm duke dhënë këshilla pa bukë nga lart? Kur ju, drejtuesit kryesorë të dikasterit, nuk i qëndroni në kokë zbatimit të këtyre vendimeve me rëndësi të Komitetit Qendror dhe të Qeverisë, atëherë si do të bëjmë për të vënë në lëvizje gjithë Partinë, organet e pushtetit dhe kooperativistët për t'i vënë në zbatim këto detyra, jo në mënyrë kaotike, spontane, por të organizuara dhe sistematike? Nga kjo mënyrë zbatimi e detyrave a mund të merren çdo vit rezultate të qëndrueshme dhe kurdoherë në ngjitje? Detyrave të parrealizuara ose të pakontrolluara nuk mund t'u dilet mbanë pa një autokritikë të thellë, as me një autokritikë të përciptë dhe gjoja patetike.

Unë, shoku Pirro, mendoj që kritika, sipas parimit tonë marksist-leninist, duhet të të shërbejë që të gjallërohesh dhe të hidhesh me forca të reja në punë e në luftë. Në qoftë se ajo do ta dobësojë forcën (dhe dobë-

simi në këtë rast vjen nga mospranimi i kritikës shoqërore, marksiste-leniniste dhe në bazë të fakteve, që po të bëhet), kjo do të thotë se nuk ke reflektuar thellë për hartimin dhe zbatimin e një plani të shëndoshë revolucionar në punë. Në Ministrinë e Bujqësisë dhe në mbarë bujqësinë tonë duhen vënë në lëvizje të gjithë kuadrot. Sipas mendimit tim, janë dy rrugëzgjdhje të çështjes: rruga e Partisë dhe rruga e gabuar. Duhet ndjekur vetëm rruga e Partisë. Komiteti Qendror i Partisë dhe Byroja Politike nuk mund të bëjnë me një ministër bujqësie, që nuk ndërron stilin dhe metodën e gabuar të punës.

Pavarësisht se janë caktuar fondet për veprat e reja që do të bëjmë, Qeveria, ministritë dhe Komisioni i Planit të Shtetit duhet të rishikojnë fondet e caktuara për secilën vepër dhe, sa nuk është vonë, të shkurtohen tepricat që konstatohen në këto fonde. Në asnjë mënyrë të mos lejohet tejkalimi i tyre. Normat e caktuara nga Qeveria për marzhet e tejkalimit duhen rishikuar dhe duhen ulur në minimum për arsyet që thashë më lart, pra, se tash kemi punëtorë me eksperiencë, kuadro të aftë dhe mekanizime më të mëdha.

Kur flas për veprat e vogla (që për ne nuk janë të vogla), kam parasysh që në fabrikën e qumështit ose në ndonjë fabrikë tjetër të këtij lloji, është e vërtetë se duhet të futim forca pune nga qyteti, por këto fabrika nuk angazhojnë shumë njerëz. Me ndërtimin e këtyre veprave ne nuk kemi për qëllim zbukurimin e qytetit, por përpunimin e shpejtë dhe sa më të lirë të qumështit. Prandaj vepra të tilla t'i ngremë kryesisht pranë lëndëve të para.

Për sa u përket hektarëve të caktuar për sipërfaqet e bimëve të ndryshme dhe për prodhime të ndryshme unë jam dakord. Kjo punë u mor seriozisht nga Byroja Politike dhe nga Qeveria. Për këtë problem u bënë mbledhje të shumta dhe u argumentua drejt marrja e këtyre prodhimeve, duke rrëzuar konceptin e mbajtjes së rezervave të fshehta, që maskonin shumë gjëra jo të shëndosha. Por mendoj se na vihet detyrë që, duke marrë parasysh edhe eksperiencën e mirë të vitit që kaloi, duhen marrë masa që rendimentet të realizohen, tokat të hapen, patatet të mbillen, fasulet dhe perimet të arrijnë rendimentet e kërkuara.

Duhet theksuar këtu që, nëse ullirit dhe pemëve frutore u kushtohet pak interesim, për vreshtat ky interesim thuhetse mungon krajt. Ose Partia dhe kooperativat bujqësore duhet të krijojnë pikëpamje të drejta për leverdinë e madhe që kemi nga vreshtat ose prodhimi i tyre do të na ecë zvarrë, do të harxhojmë para, materiale e djersë dhe të ardhura do të marrim pak. Të ardhurat nga pemët frutore nuk duhet të llogariten globalisht. Kooperativave bujqësore të rretheve t'u kërkohet çdo vit numri i pemëve frutore dhe i ullinjve të rinj që hyjnë në prodhim, i cili duhet të ndihet krahas prodhimit të pemëve të tjera. Prodhimi nga pemët e reja frutore duhet të shkojë duke u rritur, ndryshe, po të mos kemi asnjë kontroll, do të notojmë në globalizëm.

Jam dakord me reduktimin që i bëhet sipërfaqes së mbjellë me pambuk, mirëpo nuk jam dakord me përdorimin si duhet të këtij «floriri të bardhë», siç e quan populli. Pambuku nuk përdoret mirë, nuk ngri-

het niveli i përpunimit të tij në kombinat në atë shkallë, sa të kënaqë kërkesat e popullit dhe ato të eksportit.

Çështja tjetër, për të cilën merakosem, është ajo që miliona thasë ne po i prodhojmë me pëlhurë të bardhë pambuku, që bota e përdor si «flori». Ne importojmë pambuk dhe bëjmë thasë me të! Mund të pranohet kjo? Në asnjë mënyrë! Nuk mundet që në vend të thasëve prej pëlhure të përdorim plastikën, që eviton lagështirën, vjedhjen dhe grabitjen, që mund të bëhet nga thasët prej pëlhure? Thasët duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të nxënë një sasi të caktuar malli dhe pastaj të mbyllen e të ngjiten në mënyrë automatike, që të mos hapen pa u shqyer me thikë. Nuk është e lejueshme që Ministria e Industrisë së Lehtë e Ushqimore¹ të mos mendojë një çikë për këto gjëra. Kuadrot që punojnë atje, të vrasin mendjen më shumë për këto probleme, të karakterizohen nga shpirti krijues dhe të mendojnë për të bërë kursime në çdo gjë. Flitet në gazetë se ecet si në belik në këtë apo në atë drejtim, për këtë apo për atë mall, por, kur vjen puna për zbatimin e atyre që thuhet, mungon ajo edukatë socialiste për të ekonomizuar si duhet vlerat materiale, ecet me sy mbyllur dhe duke gjykuar me mendjelehtësi «Ku rafsha, mos u vrafsha!».

Shifrat e blegtorisë i pashë, por, duke marrë parasysh se në pesëvjeçarët e kaluar, sidomos në të pestin,

1. Në sesionin e parë të legjislaturës së 11-të të Kuvendit Popullor, që i zhvilloi punimet nga data 19-21 shkurt 1987, kjo ministri u nda në dy: në Ministrinë e Industrisë së Lehtë dhe në Ministrinë e Industrisë Ushqimore.

bagëtia e imët është lënë pas dore, kjo gjë na lë të dyshojmë dhe të mendojmë se vazhdohet të ecet me ngadalësi. Natyrisht plani duhet bërë në bazë të pjellshmërisë së bagëtisë së imët, por çështja qëndron që këto bagëti, pëllejat, duhet të ushqehen në mënyrë të tillë që të pjellin qengja e keca të shëndoshë, që të mos na ngordhin. Të ndalojmë në mënyrë rigorozë shitjen e qengjave e sidomos të femrave. Kështu të veprojmë edhe për kecat.

Kur shtrohet çështja e ushqimit të bagëtisë së imët, na thonë se ka akoma sipërfaqe të mëdha e të gjera ku ato mund të kullosin. Vihet pyetja: Ka apo nuk ka më vende për kullotë? Personalisht, pa qenë as topograf dhe pa e pasë shkelur me këmbë tërë Shqipërinë, mendoj se ka, por për këtë problem me kaq rëndësi mungon vullneti i mirë dhe gatishmëria e njerëzve, mungon edhe organizimi i punës. Ka ekzistuar në popullin tonë tradita e mirë e rritjes së bagëtisë, por një zakon të tillë kaq të mirë, me zor po e ruajmë dhe na duhet shumë punë për ta vënë në vend. Jo vetëm kooperativat bujqësore, por edhe shteti duhet t'i futet punës për të krijuar, ashtu siç ka krijuar, ndërmarrje blegtorale, jo vetëm me gjedhë, por edhe me bagëti të imëta për qumësht, për lesh dhe për mish. Ashtu siç blemë jashtë lopë të racës për qumësht, ashtu mund të blejmë edhe dhen të racës për qumësht, për mish dhe për lesh dhe të krijojmë ndërmarrje të specializuara, siç kemi krijuar për pulat, për matkat që bëjnë vezë, por edhe për gjelat e detit që na duhen për mish, duke i therur në kohë të caktuar. Mua më duket se nuk është përcaktuar në mënyrë sistematike tjerja e gjelave të detit për

arsye se nuk shikoj ndonjë shpjegim të shifrave të dhëna këtu. Më ndryshe janë caktuar shifrat e prodhimit të vezëve, të pulave, bile edhe të rritjes së viçit e të derrit.

Në parantezë pyes: Çfarë po bëhet me Ndërmarrjen e Rritjes së Gjedhit në Maliq, për të cilën sipas parashikimeve dilte se është rentabël? Ecën puna atje apo do të qëndrojë në vend? Do të mbarojë kjo vepër në kohën e caktuar apo do të mbetet? Përqendrimet rentable në blegtori t'i përkrahim, por të bëjmë kujdes të madh, sidomos për masën dërrmuese të blegtorisë në gjithë vendin. Ky është preokupimi im. Kështu duhet të parashikohet zhvillimi i bagëtisë së imët. Të gjenden forma më të mira pune në ndërmarrjet dhe në kooperativat bujqësore se vetëm kështu do të arrijmë të kemi edhe qumësht, kos, gjalpë, djathë e gjizë, edhe vezë, mish e dhjamë; të luftojmë seriozisht për t'i mirëmbajtur e shtuar këto kafshë që prodhojnë gjithë këto vlera ushqimore të përditshme aq të dobishme për jetën e njerëzve tanë. Kjo kërkesë duhet pasur në qendër të vëmendjes, pse me bagëtitë na kanë ngjarë dhe po na ngjasin punë jo të mira.

Në relacion flitet vërtet për numrin e lopëve dhe të gjedhëve, por mund edhe të na shpjegohej ca se çfarë po bëhet me fatin e lopëve që kemi sjellë nga jashtë, si rriten e si po zhvillohen ato, si shumëzohen, si prodhojnë e si shpërndahen. Kështu ne do të ishim në gjendje të diskutonim më mirë sesa po diskutojmë aktualisht.

Përsa i përket transportit jam dakord me masat e marra, me qëllim që hekurudha të shfrytëzohet tota-

lisht, të vendoset një regjim i rreptë i lëvizjes së automjeteve. Kjo do të thotë të punohet ditë e natë, duke mos lejuar paralelizmat me lëvizje makinash. Të mësohen njerëzit që, kur venë në fabrikë, bile edhe kur venë me shërbim e për inspektim apo për arsye të tjera, të udhëtojnë me tren, se nuk u bie qibra. Atje ku nuk ka hekurudhë, duhen lejuar medoemos transporti automobilistik dhe rimorkiot. Normat e shfrytëzimit të automobilave duhet të rriten.

Me këtë rast dua të ritheksoj çështjen e përdorimit me nikoqirllëk e të kursimit të karburanteve. Këtu na thuhet vetëm sasia e karburantit që përdoret, si dhe ajo që do të importohet, por unë, të them të vërtetën, nuk jam i qartë si përdoret gjithë ky karburant i llojeve të ndryshme. Kam dhënë porosi të bëhet një kontroll absolutisht i imët dhe matematik nga Komisioni i Planit të Shtetit për të vërejtur konsumimin e karburanteve në bazë të gjendjes së të gjitha makinerive që punojnë me llojet e ndryshme të karburantit, të kilometrave që përshkohen ose të orëve të punës që kryejnë dhe të ndryshojnë normativat e tyre. Të kërkohet llogari në ministritë e në entet që kërkojnë karburante. Jam i bindur se kështu do të gjenden rrugët e zgjidhjes për këtë çështje. Derisa ne nuk kemi ekonomi në materiale, në lëndë të parë dhe në lokë, si në ndërtim, në bujqësi e në sektorë të tjerë, pa dyshim që edhe në përdorimin e karburanteve duhet të ketë shpërdorime. Nafta, benzina, gazolina, vajguri konsumohen deri duke u shitur për mikun, për të larë duart, derdhen pa kritere, digjen më shumë nga sa duhet etj. Të gjitha këto veprime përbëjnë një abuzim të madh me këtë

pasuri me të cilën lëvizin trenat, automobilat, traktorët, punojnë TEC-et e të tjera, e të tjera objekte. Për shkak të saj bota ka hyrë në një krizë të madhe. Një vend kaq i vogël si ky yni, në raport me sipërfaqen dhe popullsinë nuk duhet të përdorë kaq shumë karburante. Kjo nuk duhet të ngjasë! Kontrolli për një lëndë kaq të vlefshme mund të na sigurojë përdorimin e drejtë të saj. Prandaj kjo çështje duhet të shikohet dhe të pasqyrohet në planin tonë pesëvjeçar.

Për sa i përket tregtisë mund të them se armiku Kiço Ngjela dhe njerëzit e tij që kishte përreth na kanë sabotuar shumë. Këta kanë vepruar në bashkëpunim të ngushtë me armiqtë Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi. Përveç karamboleve të njohura që kanë bërë këta armiq në import-eksport, kur hyn konkretisht në një sërë çështjesh, del qartë që janë sjellë nga jashtë edhe mjaft sende luksi, të cilat janë blerë, gjoja se duhej të tërhiqeshin të hollat e popullit. Sendet e luksit janë nga objektet e tregtimit të së ashtuquajturës shoqëri e konsumit, e cila ka si parim të vetin të prodhojë sa më shumë sende të tilla, sa më pak sende të nevojshme dhe shumë më pak sende të domosdoshme për njerëzit. Pra, armiqtë jo vetëm kanë sjellë sendet e luksit, por në të njëjtën kohë kanë harxhuar edhe devizën për makincri e vegla, që na rrinë të pashfrytëzuara. Këto shpenzime janë miliona dollarë, pa folur këtu për lekun valutë ose për tratativat që bënin njerëzit e Kiço Ngjelës me çmimet dhe me koniunkturat në tregjet e jashtme.

Unë mendoj se Qeveria ka gabuar që u kishte lënë në dispozicion një sasi devize disa ministrave që nga

Abdyl Këllezi e deri te disa të tjerë. Sikur këto të holla të disponoheshin për mjetet që i duheshin çdo ministrie, çdo dikasteri, kjo do të ishte e natyrshme, por këto fonde nuk janë përdorur si duhet, sepse armiqtë kanë sabotuar. Tani e tutje deviza të kalojë në dorë të Qeverisë dhe të përdoret me shumë rreptësi.

Për sa u përket treguesve të punës, sikurse e përmenda edhe pak më përpara, ne duhet të jemi të shtrënguar, të jemi rigorozë në rritjen e rendimentit dhe këtë të mos e llogaritim duke e krahasuar me pesëvjeçarin e kaluar, për arsye se gjatë viteve të pesëvjeçarit janë bërë ndryshime të mëdha, duke filluar që nga njerëzit e deri tek teknologjia dhe makinat. Për ngritjen e rendimenteve mendoj se duhet të shikohen më nga afër llojet e tij në sektorët e ndryshëm të ekonomisë që të zbulohen arsyet përse në një sektor ai është më i lartë dhe në një tjetër më i ulët. Kjo është gjendur si traditë dhe është arsyeuar në një kohë, por aktualisht nuk na shpjegohet pse të qëndrohet në këto përpjesëtime të rendimenteve. Mua më duket se, kur të vijë për miratim ky projektplan, të gjitha këto probleme duhet t'i kemi një çikë më të qarta.

Importi dhe eksporti duhet të lidhen ngushtë me prodhimin. Në këtë fushë të vendoset diçka me frymë të re, me frymë revolucionare dhe jo të vazhdohet vetëm eksportimi i prodhimeve të punuara me dorë, i sendeve artistike, i bitumit tonë, siç veprohej më parë, kur Kiço Ngjela bënte si t'i donte qejfi, kur ai i lidhte e i prishte kontratat si t'i tekej dhe nuk mbante lidhje me asnjëri. Kjo veprimtari nuk quhet eksport. Të mos

harrojmë se në tregjet e jashtme ndeshemi në vështirësi, sepse jemi një vend socialist, kurse ata me të cilët do të tregtojmë janë vende kapitaliste e revizioniste. Veç kësaj, në fund të fundit, prodhimet tona janë të një sasi të paktë, por, ama, atë që u japim. të huajt ta marrin siç duhet. Nuk mohohet se në marrëdhëniet me ne ata kanë dhe qëllimet e tyre politike, prandaj edhe ne duhet t'i respektojmë si duhet rregullat e tregtisë së jashtme, t'u përmbahemi normave dhe rregullave për cilësinë e materialeve që eksportojmë. Kiço Ngjela dhe Abdyl Këllezi, përveç sabotimit, grabitjes, shpenzimeve pa kriter etj. kishin arritur ta bllokoin tregtinë tonë vetëm në disa tregje. Prandaj, siç e kemi thënë edhe herë të tjera, tregtia aktualisht duhet të çajë përpara. Kjo porosi lypset të zbërthehet mirë se ku, në cilat drejtime duhet çarë, ku duhet të shkohet, me çfarë njerëzish, si duhen përgatitur ata etj., etj. Në qoftë se Ministria e Tregtisë nuk i zbërthen si duhet këto orientime, ajo nuk do të jetë në gjendje të zhvillojë mirë dhe si duhet tregtinë me vendet e huaja.

Vërejtjet e mësipërme mbi shifrat kryesore të planit, si dhe vërejtjet në lidhje me paraqitjen e relacionit, kam menduar se mund të shërbejnë për ta përmirësuar projektplanin, i cili do të dërgohet në bazë që të studiohet dhe të diskutohet. Kjo nuk do të thotë se nuk jam dakord me shifrat e projektplanit, me gjithë këto ndërtime të ndryshme që parashikohen aty, që nga hidrocentralet, fabrikat, bonifikimet etj. Në përgjithësi parashikimet janë të drejta e të nevojshme. Unë jam dakord me to dhe, si gjithë shokët, mendoj

se duhet të vëmë të gjitha forcat për t'i realizuar. Nuk vë aspak në dyshim përpjekjet e mëdha që janë bërë, që nga baza e deri në Kryesinë e Këshillit të Ministrave për hartimin e këtyre dokumenteve që iu paraqitën Byrosë Politike dhe që janë duke u përgatitur për Kongresin e Partisë. Por mendoj, dhe jam i sigurt se kështu gjykoni edhe të gjithë ju, e për këtë u shprehët këtu shokë, që ne mund dhe duhet t'i përmirësojmë shifrat, objektet, format e paraqitjes dhe propagandimin e shpjegimin e tyre konkret në masat e gjera të popullit. Këtë përmirësim mendoj se është e pamundur ta bëjë vetëm komisioni i Planit të Shtetit, por me ndërgjegje të kulluar, me ndjenjë të lartë përgjegjësie, me shpirt revolucionar, me frymë kursimi, Partia, në radhë të parë, dikasteret, komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe drejtuesit e ndërmarrjeve gjatë kësaj kohe duhet jo vetëm të bëjnë shpjegimin faktik të këtyre orientimeve, por, në të njëjtën kohë, të rishikojnë edhe objektet, shumat monetare e materiale të caktuara për to, forcat e punës dhe të teknikës që do të përdoret, ngritjen e rendimentit, shtimin e kursimeve, përmirësimin e cilësisë etj. E gjithë kjo rekomandoj të mos mbetet një formulë propagandistike, por të figurojë materialisht në debate, në diskutimet e në rridikutimet që do të bëhen, kur të gjitha këto gjëra t'i paraqiten udhëheqjes për vendim përfundimtar.

Besoj se mënyra e veprimit për shtruarjen e planit është e drejtë, por mendoj se puna çalon në zbatimin e tij. Në rrethe e në bazë, duke filluar që nga diskutimi i planit ka edhe formalizëm, ka mungesë thellimi, vi-

nen re teprime e gabime nga ana e njerëzve, të cilët janë mësuar të hartojnë mjaft herë në hava, sipas dëshirës për të qenë brenda.

Unë kam, gjithashtu, vërejtje edhe për punën që bëhet me direktivat që lëshojmë. Mendoj se këto direktiva që po japim për diskutim, në thelb e kanë atë çka ne, Komiteti Qendror dhe Byroja Politike, u rekomandojmë Partisë dhe punonjësve për kuptimin e drejtë dhe për diskutimin e kuotave, por mënyra se si thuhet këto është krejt shabllone. Nuk gabohej në rast se them që, po t'i marrim këto direktiva dhe t'i krahasojmë me ato të planit të pestë pesëvjeçar dhe, akoma më larg, edhe me ato të planit të katërt pesëvjeçar, do të shikojmë pak ndryshime. Propagandimi, për mendimin tim, bëhet në një formë rutinë; orientimet nuk lidhen në kohë me diçka materiale konkrete, që janë kuotat, por mbeten formula propagandistike. Kuotat dërgohen veças, por unë mendoj se këto nuk mund të shkëputen nga direktivat. Kuotat u tregojnë njerëzve të Shqipërisë ku jemi dhe ku dëshirojmë të shkojmë, pastaj t'u thuhet (dhe kjo përbën direktivën propagandistike) se çfarë duhet të bëjmë, si duhet të punojmë, si duhet të organizojmë punën apo si duhet të kursejmë për t'i arritur këta apo ata objektiva. Ky propagandim nuk duhet të bëhet global dhe për të gjitha kuotat e planit që dërgojmë poshtë, por për kuotat kryesore, pas të cilave të vihen edhe detyra që përmenda më lart.

Mendoj se nuk mund të gabohej po të them që propaganda më e mirë nuk mund të shkëputet nga realiteti material ekonomik, prandaj kjo propagandë

nuk mund të konsiderohet si diçka e veçuar nga kuotat e planit që dërgohen në bazë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

MATERIALET PËR UDHËHEQJEN DUHET TË VIJNË TË PËRGATITURA MIRE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 shkurt 1976

Më parë se të diskutojmë për këtë problem më lejoni të bëj vërejtjen që ky material², sipas mendimit tim, nuk vlen asnjë qindarkë. Çfarë mendoni ju, shokë të Drejtorisë së Punës e të Pagave, se do t'ju hapen dyert në Sekretariat e të na shtroni ato probleme, që duhet t'i zgjidhni vetë? Ne i kemi marrë këto vendime që citoni ju dhe jemi dakord me konkluzionet që bëni. Unë kam shkruar këtu mbi material: «Dakord, dakord, dakord». Pse? Se këto janë gjëra të njohura, vetëm se nuk po realizohen. Atëherë, përse na i sillni neve këtu? Ne mund t'ju kërkojmë llogari, pse nuk i realizoni këto detyra ju, shokët e Qeverisë?

Cilësia e prodhimeve është një problem kyç, kurse këtu na thuhet disa gjëra të përgjithshme, si: «Ne e kemi marrë në analizë këtë problem me hollësi... Qe-

1. Në këtë mbledhje u diskutua për disa probleme të shpërblimit të punës sipas cilësisë.

2. Materiali i paraqitur nga Drejtoria e Punës dhe e Pagave pranë Komisionit të Planit të Shtetit.

veria ka marrë vendime, ka nxjerrë urdhëresa» etj.

Në kemi të drejtë t'ju pyesim: Tërë këto vendime e urdhëresa që përmenden, përse nuk po zbatohen? Ju thatë se: «Hasim vështirësi në zgjidhjen praktike të këtij problemi», kur dihet se ka edhe çështje që do të jenë të vështira për t'u zgjidhur.

Është e vërtetë se ekzistojnë pengesa, si mungesë materiale e të meta të tjera për shkaqe subjektive. Por të tëra këto vështirësi kapërcëhen vetëm me punë këmbëngulëse e jo duke u ankuar. Çfarë doni ju, të vraponi në fushë me lule? Në qoftë se punën e mendoni se është një shesh me lule, ju nuk e paskeni të qartë se ç'është lufta e klasave, ç'është puna politike bindëse me njerëzit dhe kuptimi ideologjik i direktivave të Partisë. Kapërcëni vështirësitë që hasni, kjo është detyra juaj.

Ajo që përmendët ju se: «Për zbatimin e këtyre rregullave në praktikë, duhet të angazhohen më mirë ministrinë dhe institucionet përkatëse, sipas sektorëve që ato mbulojnë», nuk është ndonjë gjë e re. Po pse, një herë e kemi thënë ne këtë gjë?! Edhe dje tërë ditën me këtë punë jemi marrë. Prandaj, këto «arsye» që na sillni ju, nuk qëndrojnë.

Jemi dakord që ministrinë nuk janë sa duhet në krye të punëve, por kjo, siç thashë, nuk është ndonjë gjë e panjohur për ne. Ju duhet të mendoni rrugën e zgjidhjes e të kapërcimit të kësaj gjendjeje.

SHOKU HAKI TOSKA: Ky është një problem i madh. Vitin e kaluar ne organizuam një fushatë të gjerë për çështjen e cilësisë. E gjithë Partia dhe orga-

nizatat e bashkimeve profesionale u ngritën në këmbë për të vënë në jetë detyrat lidhur me cilësinë, por, me sa duket, këto nuk janë probleme që kanë të bëjnë vetëm me edukimin e njerëzve. Natyrisht, edukimi i njerëzve është një çështje e madhe, por dhe aftësimi i tyre për problemet e cilësisë ka rëndësinë e vet. Këtu ka një varg problemesh të karakterit organizativ e ligjor, që nuk zbatohen: dëmtohet malli dhe nuk zhdëmtohet; nxirren prodhime me cilësi të dytë, të tretë dhe të katërt dhe kurrkujt nuk i dëmtohet xhepi; pra, normat janë vendosur, ligjet janë caktuar, rregullat, gjithashtu, por, organizativisht për këto probleme nuk luftohet! Unë do të isha i mendimit që t'i rekomandojmë Qeverisë të vërë dorë. Kjo është një çështje serioze se kështu na mbeten mallra stoqe.

SHOKU HYSNI KAPO: Kam edhe unë një vërejtje. Këto probleme kanë të bëjnë me çështjet organizative, atëherë, përse na paraqiten neve? Pse ne do t'i themi Qeverisë që të marrë masa? I është bërë e ditur Qeverisë ky problem dhe ajo nuk ka marrë masa? Neve duhet të na jepet për shqyrtim vetëm në rast se ka ndonjë problem që duhet të zgjidhet, kurse, për atë që ka vendosur Qeveria, nuk e kuptoj përse duhet të na dërgohet neve?! Ne të vendosim tani se çfarë duhet bërë për të zbatuar rregullat e caktuara nga Qeveria për çështjen e cilësisë? Më duket se këta shokë nuk e kanë të drejtë dhe konceptin për materialin që duhet t'i paraqitin Sekretariatit të Komitetit Qendror.

SHOKU ENVER HOXHA: Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë nuk ka të tilla funksione.

Edhe një herë e përsëris se të tilla materiale me kashtë herë tjetër as nuk do t'i pranojmë fare. Materialet për udhëheqjen të vijnë të përgatitura mirë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

PO NUK PATI PARTIA THEMELI TË FORTA,
NUK MBAHET «ÇATIA»

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 shkurt 1976

Diskutimi në këtë mbledhje të Sekretariatit, ku ishin të ftuar edhe kooperativistë, mori karakterin e një bisede të ngrohtë, ku u shkëmbyen lirshëm mendime për të përmirësuar punën e gjithanshme të Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Si shkoni, shokë e shoqe kooperativiste? Kush do të na flasë nga ju, ashtu, fshatçe? Hiç mos i rregulloni frazat! Ja, le të na flasë e para kjo shoqja, Maria². Na fol ashtu si flet atje në fshat. Kritiko, ashtu si kritikon shoqet dhe shokët për gjërat që nuk shkojnë; lavdëro ata shokë e shoqe për punën e mirë që kanë bërë. Kështu të na flasësh edhe këtu.

Mos na fol vetëm për çështjen e misrit e të grurit.

1. Në këtë mbledhje u diskutua për punën e organizatës së Partisë të rrethit të Lezhës, lidhur me zbatimin e detyrave të Letrës së KQ të PPSH, të datës 8 janar 1971.

2. Marie Pjetër Gjoni, kooperativiste në rrethin e Lezhës.

Edhe këto na interesojnë shumë, sepse siç na mëson Marksi, me ekonominë lidhen të gjitha çështjet. Por, duam të na flasësh edhe për jetën e Kashnjetit, për atë se ç'mendojnë fshatarët atje për punën, për organizimin, për lopët, për dhitë. Na thuaj a keni shtëpi kulture atje, a këndonin e kërcenin e të tjera? Këto gjëra duam të na i thuash, ashtu thjesht.

SHOQJA MARIE GJONI: Në, shoku Enver, para jush vijmë me kokë ulur, sepse në prodhimin e drithërave të bukës, si zonë malore që jemi, kemi deficite të mëdha.

SHOKU ENVER HOXHA: A mund të na thuash, ti, pse ka ngjarë kjo rënie kaq e madhe.

SHOQJA MARIE GJONI: Organizata-bazë e Partisë nuk i ka kuptuar drejt e nuk i ka zbatuar siç duhet direktivat e Partisë për drithërat e bukës.

SHOKU ENVER HOXHA: Janë të rënda këto direktiva, apo se shokët drejtues të punës së Partisë nuk ju kanë ndihmuar si duhet? Na i thuaj ashtu drejt, sepse mendimi ynë është që ju, kashnjetasit jeni njerëz të zgjuar dhe nuk është se nuk i kuptoni gjërat.

A vijnë shokët kryesorë të Partisë dhe të pushtetit në rreth që t'ju shpjegojnë si duhet problemet, që t'ju pyesin çfarë s'keni kuptuar dhe atëherë të rifillojnë prapë shpjegimin, deri sa ju t'i kuptoni?

SHOQJA MARIE GJONI: Me thënë të vërtetën, shokët e Partisë dhe të pushtetit kanë qenë te ne. Ndihej ma nuk na ka munguar, por faji ka qenë kryesisht yni, imi dhe i shoqeve të tjera komuniste që nuk kemi punuar sa duhet.

SHOKU ENVER HOXHA: Me sa duket ti po i merr të tëra fajet mbi vete.

I njeh ti instruktorët e Komitetit të Partisë të Rrethit? A mund të na përmendësh disa emra?

SHOQJA MARIE GJONI: I njoh, por me thënë të drejtën emrat nuk ua di.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo tregon se ata kanë ardhur atje si era. E di ti se kush është shefi i seksionit të bujqësisë në Komitetin Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit? E ke dëgjuar ndonjëherë emrin e tij? Ka ardhur ai aty te ju? Në ç'kohë ka ardhur? Emrin mundet edhe të mos ia dish, por nëse ka ardhur ose jo ndonjëherë në Kashnjet, këtë duhet ta dish.

SHOQJA MARIE GJONI: Po, ka ardhur, edhe emrin ia kam dëgjuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Prej sa shokësh dhe shoqesh përbëhet brigada, ku ti bën pjesë?

SHOQJA MARIE GJONI: Në brigadë jemi 35 shoqe.

SHOKU ENVER HOXHA: Me siguri që ti ua di emrat të gjithave. Jo vetëm kaq, por di edhe nga sa persona janë në shtëpi, sa punojnë e çfarë thonë. Edhe shefi i bujqësisë i rrethit ka njerëz, ashtu si ke ti në brigadë, që nga kryeagronomi, agronomi, teknikët, veterinerët etj., etj. Ju kanë ardhur ndonjëherë në brigadë këta njerëz juve?

SHOQJA MARIE GJONI: Po, na kanë ardhur.

SHOKU ENVER HOXHA: Po çfarë ndihme konkrete ju kanë dhënë që të dilni nga kjo prapambetje? Partia do që ata të vijnë atje dhe t'ju ndihmojnë e jo të merrni aq lekë sa keni marrë për ditë-punë. Në goftë se ju merrni më pak lekë për ditë-punë, nga sa janë mundësitë, atëherë si do të përmirësohet jeta juaj, si do të ecni përpara? Ti thua se tokën e keni me gurë.

Kjo është e vërtetë. Edhe thatësirë ka atje dhe mund të qëllojë që ajo të vazhdojë për një kohë të gjatë e të krijohen kështu kushte jo të favorshme. Por, ka mundësi që edhe toka juaj të ujitet duke ndërtuar hauze, të cilat mund t'i bëni vetë ju me ndihmën e komitetit? Atëherë, këta shokë që vijnë atje, përse vijnë?

SHOQJA MARIE GJONI: Shokët e rrethit na kanë ndihmuar për ndërtimin e një rezervuari.

SHOKU ENVER HOXHA: Po përse të keni një dhe jo më shumë? Zona juaj është malore, prandaj mund të ndërtoni disa të tillë ku, një rezervuar mund të ketë një kapacitet ujitjeje për dhjetë hektarë, një tjetër për pesë hektarë etj. Rrethi juaj është malor dhe nuk mjafton të ketë vetëm një rezervuar, që është ndërtuar këtu e kushedi sa vjet më parë. A keni dëshirë ju që të ujitet tokat tuaja? Sigurisht që keni dëshirë, kjo është e kuptueshme. Unë pyes: a e keni shtruar ju këtë problem ndonjëherë në asamble, ku të jenë mbledhur të gjithë burrat e gratë e Kashnjetit, duke thirrur atje edhe shokë drejtues të rrethit, bashkë me agronomë e specialistë të tjerë për t'u thënë: «Ja ku i kemi krahët e punës dhe mjetet e tjera të nevojshme, prandaj propozojmë të ndërtohen kaq rezervuarë se duam ta ujitim tokën tonë malorë». Jeni mbledhur ndonjëherë për të tilla probleme?

SHOQJA MARIE GJONI: Ne jemi mbledhur e kemi diskutuar, po kështu si thoni ju, shoku Enver, nuk i kemi shtruar problemet.

SHOKU ENVER HOXHA: Është i kënaqur populli në Kashnjet me të ardhurat që merr sot? Ne e dimë

që populli është besnik dhe e do Partinë. Ai tani është më mirë se ç'ka qenë, po vlera e ditës së punës është akoma e vogël dhe kashnjetasit nuk duhet të kënaqen me ato që marrin. Edhe Partia nuk është e kënaqur me lekët për ditë-punë që merrni tani ju.

Kashnjeti është vend malor që më përpara ka rritur dhi, dele dhe derra. Unë desha të pyes: I keni shtuar dhitë në kooperativën tuaj, apo jo?

SHOQJA MARIE GJONI: Po, i keni shtuar, por jo shumë.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa e keni shtuar numrin e dhive brenda dy vjetëve të fundit? A mund të na thuash ndonjë shifër? Ti, si kooperativiste e thjeshtë, na flet drejt, nuk na i zbukuron të dhënat. Si çupë e kësaj toke që je, mund të na thuash sa kokë dhi mund të mbajë zona e Kashnjetit. Mund të mbajë 10-15 mijë kokë?

SHOQJA MARIE GJONI: Edhe mund t'i mbajë, por tani për tani nuk ka ushqim të mjaftueshëm që dhia të japë qumësht.

SHOKU ENVER HOXHA: Çështja është që të ketë të hajë. Për sa muaj e siguruat bukën sivjet?

SHOQJA MARIE GJONI: Bukën e kemi siguruar për gjithë vitin.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu?! Atëherë, keni mangët prodhimet e tjera.

Mesatarisht sa ditë-punë bëni ju?

SHOQJA MARIE GJONI: Mesatarja është 275 ditë-punë në vit.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti sa ke bërë?

SHOQJA MARIE GJONI: 395 ditë-punë.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë, të lumtë. Po pse ti ke bërë kaq ditë-punë e të tjerat jo?

SHOQJA MARIE GJONI: Kemi gra të reja që janë me fëmijë të vegjël, me leje lindjeje etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Të tëra gratë nuk janë me kalamanë të vegjël sa të pengohen në punë! Ka dhe vajza të reja. Pse gratë pa fëmijë të vegjël dhe vajzat të bëjnë kaq pak dhe ti të bësh 400 ditë-punë? Drejtuesit tuaj, a i kanë bërë llogaritë se po të bëhen 400 ditë-punë nga çdo njeri, i thonë 130 ditë-punë mbi mesataren e arritur në vit. Kështu, të ardhurat që do të merreshin nga këto 130 ditë mund t'ia jepnit kalamanit në çerdhe. A nuk do të ishte kjo një gjë e bukur që kalamani të rritet i shëndetshëm? Kështu edhe nëna do të ishte më e lirë etj., etj.

Mesatarja duhet t'i kalojë 300 ditë-punë.

Po burrat që keni atje a punojnë si duhet apo ka prej tyre që janë mbërthyer nga sëmundja e vjetër e dembellëkut? Apo mos zënë punët më të lehta, si magazinier etj.? Duhet të shkunden njerëzit. Ti je kooperativiste e dalluar, ke plot shoqe dhe shokë që janë të rregullt. Njerëzit, qofshin burrat, qofshin gratë, që nuk kryejnë mesataren e ditëve në punë, duhet t'i shkundni. Kur piqet mani, për t'i marrë kokrrat, duhet me e shkundë, prandaj edhe ju i shkundni dembelët, se ndryshe nuk mund të ngrihet vlera e ditës së punës. Flasim drejt apo e kemi gabim?

Ne shokët e Sekretariatit jemi të kënaqur që erdhët ju, veçanërisht ti që je punëtore e dalluar. Komiteti i Partisë dhe Komiteti Ekzekutiv i Rrethit duhet ta shikojnë punën e malësisë, veçanërisht të Kashnjetit,

që dita e punës të mos jetë kaq sa sot, bile, të mos jetë as nën 10 lekë. Mund të ketë mendime se: «Si do të bëhet kjo, more shoku Enver, me frymën e shën Ndout?». Jo me frymën e shën Ndout, se me këtë frymë nuk bëhet asgjë, por do të arrihet me krahët e kooperativistëve, me mendjen e Partisë dhe me mjetet që ajo ka. Ka pasur zona malësie si kjo juaja, që merrnin kaq lekë për ditë-punë, sa ju, por tani marrin nga 15 lekë e më shumë. Partia nuk do që ju të mbeteni pas ekonomikisht. I keni mirë parasysh këto porosi more shokë?

Kush do ta marrë fjalën? Shoqja Tone¹? Unë kam qenë te ju.

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Po, shoku Enver, kam qenë në Troshan dhe ne të Blinishtit jemi një kooperativë me të.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa brigada ka gjithë kooperativa?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Dhjetë brigada me tetë organizata-bazë.

*SHOKU MENTOR MUÇA*²: Shoqja Tone është sekretare e organizatës-bazë në blegtori.

SHOKU ENVER HOXHA: Na fol pak për blegtorinë, sepse ky problem për Partinë është shumë i rëndësishëm. Sa qumësht merrni nga lopët?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: 1 540 litra qumësht

1. Tone Shtjefni, kooperativiste nga Blinishti i rrethit të Lezhës.

2. Në atë kohë, sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Lezhës.

mesatarisht për çdo lopë, kurse planin e kishim 1 700 litra, pra nuk e kemi realizuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Pse nuk e keni realizuar planin?

Të flasim pak për stallat. Si i doni ju ato, moderne si këto që bënë shteti? Ata shokë që kanë vajtur jashtë dhe kanë blerë lopë të racës, kanë vizituar disa ekonomi që kanë lopë të tilla si këto që kemi blerë edhe ne. Atje marrin prej tyre 4 500 deri në 5 000 litra qumësht në vit. Por ata këto lopë i ushqenin mirë dhe i pastronin me kujdes. Stallat e tyre janë gjysmë të hapura dhe gjysmë të mbyllura, në mënyrë që të qarkullojë ajri. Po të lakmohen vetëm stallat moderne, siç ka ndodhur deri tash e që na kanë kushtuar qimet e kokës, mund të them se nuk na dalin llogaritë mirë.

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Jo, nuk na e kanë fajin stallat për të marrë rendimentin e duhur. Por, në disa raste blegtoria në zonën tonë konsiderohet si e dorës së dytë, asnjë vit të pesëvjeçarit nuk është realizuar plani i foragjereve.

SHOKU ENVER HOXHA: Ministrisë së Bujqësisë dhe Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Lezhës, a u ka shkuar ndonjëherë në mendje që t'ju sjellin farëra foragjere, jo vetëm tërfili dhe jonxhë, se këto mund të vemi t'i blini, por fjala është për të tjera barëra disavjeçare për të pasuruar kullotat tuaja? A kanë ardhur ndonjëherë shokë nga ministria ose komiteti te ju?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Edhe kanë ardhur.

SHOKU ENVER HOXHA: Punonjëset që merren me lopët janë vajza të reja apo ka edhe gra me fëmijë?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Kemi vajza, po ka edhe nëna, deri edhe me 7 fëmijë.

SHOKU ENVER HOXHA: Janë në gjendje këto t'i kuptojnë e t'i zbatojnë mirë këshillat e veterinerit e të zooteknikut për mbarështimin e lopëve? Unë jam i bindur që ato kujdesen për lopët, por e kam fjalën sidomos, në mënyrën e të ushqyerit. Ushqimi ju vjen në rregull nga sektorët e bujqësisë?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Me atë bazë ushqimore që kemi, ai na vjen në rregull.

SHOKU ENVER HOXHA: Po nuk mund të shtohet ajo? E keni ngritur ndonjëherë këtë çështje me forcë? Çfarë thonë shokët e kryesisë së kooperativës dhe shokët e pushtetit të rrethit, në qoftë se ju e keni ngritur këtë çështje?

Sa veterinerë e zooteknikë të lartë janë në kooperativën tuaj?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Tre.

SHOKU ENVER HOXHA: Tre specialistë me arsim të lartë!

Ti je vajzë e re e ndoshta nuk di gjë, por ne që na janë zbardhur flokët, që kemi jetuar edhe kohën e regjimit të Zogut, mbajmë mend që në të tërë Gjirokastrën dhe Korçën kishte shumë pak specialistë me arsim të lartë, kurse sot vetëm në kooperativën tuaj, në sektorin e blegtorisë ka tre të tillë. Është për t'u çuditur përse të mos interesohen këta shokë për ngritjen e rendimentit të qumështit nga lopët, sidomos për ushqimin e tyre. Kjo gjendje nuk duhet të lejohet. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe, shoqe. Kuadrot duhet t'i vrasë ndërgjegjja përpara kooperativistëve, të

cilët janë të predispozuar të punojnë, por duhet të drejtohen. Ata duhet të punojnë që të rritin numrin e kreve të lopëve, pasi këto janë të pakta.

Po bagëtitë e imëta pse nuk po ju shtohen? Çfarë bëhen qengjat dhe kecat që rriten? Tani, në qoftë se keni, për shembull, 100 dhi, ato duhet të shtohen afërsisht 50 krerë në vit e të bëhen 150; vitin tjetër 300. Pse nuk shtohet ky numër derisa ka kullota? A ka interes, sipas mendimit tuaj, shoqja Tone, mbajtja e deles? A doni ju të hani mish, të pini qumësht, të keni ca gjalpë në shtëpi? Natyrisht që doni, atëherë si do t'i krijoni këto? Me punë. Pse nuk i vini përpara përgjegjësisë komunistët për këto gjëra?

Mos na i merr për keq këto pyetje e kritika që bëjmë. Ne e dimë se ju keni edhe gjëra të mira. Kur kam ardhur unë në kooperativën tuaj ju kam parë që zjarr ishit, shkëndija ju lëshonin sytë. Më kujtohen një a dy plaka që folën. Unë nuk kisha dëgjuar kurrë të fliste ashtu një grua e martuar që kishte jetuar tërë jetën nën tmerrin e kishës.

Çfarë do të bëjmë këtej e tutje shoqja Tone, çfarë mendoni ju për planin pesëvjeçar? Mua më intereson sidomos çështja e bazës ushqimore. E keni caktuar konkretisht? Sa për kujdesin tuaj për lopët e për të imëtat, jam i sigurt që do të rritet akoma më shumë. Sa hektarë tokë keni caktuar gjithsej për bazën ushqimore dhe me se do t'i mbillni këto?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Për sivjet kemi caktuar rreth 300 hektarë, të cilët do t'i mbjellim jonxhë, sorgum, panxhar etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Panxhar për kafshë,

apo panxharsheqeri, se ka vende që mbjellin dhe panxharsheqeri për të ushqyer kafshët. Panxhari për kafshë ka vlera ushqyese më të mëdha. A nuk ka mundësi të mbillni më shumë nga ky? Sa njësi ushqimore do të merrni ju për hektar në këtë plan pesëvjeçar sipas parashikimit që keni bërë?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Mbi 20 mijë njësi ushqimore.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa e keni përqindjen e pjellshmërisë së lopëve?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: 89 për qind.

SHOKU ENVER HOXHA: Sigurisht që të tërë viçat i rritni, sepse e dini rëndësinë e përdorimit të qeve. Po lopët e kryqëzuara sa qumësht japin tani?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Na kanë dhënë edhe 2 000 litra.

SHOKU ENVER HOXHA: Pak është. A mund të na flasësh diçka për problemet shoqërore që keni në fshat? Për shembull, të na thuash konkretisht se çfarë pune bën atje Partia për emancipimin e grave dhe për ngritjen e tyre në përgjegjësi?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Me thënë të drejtën, gratë në kooperativën tonë janë të shkathëta dhe punëtore. Për ngritjen e grave në përgjegjësi edhe ne si byro e kooperativës nuk kemi punuar mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Pse nuk keni punuar mirë?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Është e vërtetë që gratë e bëjnë punën në çdo sektor, mirëpo ne kemi edhe një gjë të keqe që burrat vazhdojnë shkollën, kurse gratë jo, prandaj kemi pasur raste që, kur janë hequr

gratë nga përgjegjësia, në vend të tyre janë vënë burra, sepse ata kanë më shumë shkollë.

SHOKU ENVER HOXHA: Burrat i lajnë duart nga punët e shtëpisë, prandaj edhe kanë më tepër mundësi të shkojnë në shkollë pa shkëputje nga puna. Po sikur të venit edhe ju në këto shkolla?

Në kooperativën tuaj ndihet ndikimi i fesë dhe në ç'mënyrë shfaqet ai?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Në kooperativë kemi pesë ish-klerikë. Në familjet ku rrinë, kanë bërë ndonjë veprim që nuk përputhet me mësimet e Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Këta ish-klerikë i keni futur në punë apo nuk janë në moshë për të punuar?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Po. Dy nuk punojnë se kanë kaluar moshën, të tjerët punojnë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ku e keni shtëpinë e kulturës? Kërcejnë e këndojnë njerëzit në mënyrë të organizuar? Keni ndonjë program të veçantë për veprimtari të tilla kulturore-artistike si, për shembull, që një herë në javë të japë shfaqje grupi i estradës që keni ngritur? Po lexime bëni? Në radhë të parë duhen studiuar dokumentet e Partisë. Po romane lexoni, bëni recensione për to? Sa arsimitarë keni dhe a aktivizohen për këto probleme?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Si fshat kemi 8 arsimitarë, ndërsa si kooperativë 25. Kemi edhe kuadro të tjerë me arsim të lartë, të cilët, në përgjithësi aktivizohen.

Kisha edhe një diçka tjetër: kur është bërë bonifikimi në zonën tonë, është bërë me të meta, na ka krijuar vështirësi.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk ka ardhur ndonjë komision nga Ministria për ta parë gjendjen në vend?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Jo, nuk ka ardhur.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë kanë kaluar kaq vjet që kur është marrë vendimi për të ndrequr gjendjen dhe akoma shokët e ngarkuar me këtë punë nuk kanë marrë masa! Ata janë drejtpërdrejt përgjegjës dhe ndaj tyre duhet mbajtur qëndrim. Por, për këtë neglizhencë kanë përgjegjësi edhe të tjerët që i lënë punët zvarrë. Ka ardhur ndonjëri nga ju, shokët e rrethit, deri këtu, në Komitetin Qendror dhe të ngrejë këtë çështje që po zvarritet qysh nga viti 1972? Ju e dini se ka kohë që është marrë vendimi për ta rishikuar dhe për ta përmirësuar këtë zonë se këto kooperativa mbjellin grurë e grurë s'marrin.

Qetë në rreth i keni shtuar apo i keni pakësuar?

SHOQJA TONE SHTJEFNI: Si sektor, ne qetë i kemi shtuar, ndërsa si rreth kemi ulje. Në në sektorin e dytë kemi shumë toka që i punojmë me qe.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti¹ e njeh terrenin e kooperativës ku punon. Atje ka toka ku nuk mund të futet traktori dhe duhet të punojnë qetë. Si mendon ti për këto probleme?

SHOKU IDRIZ ZYBERI: Ne me traktor jemi ngjitur edhe deri në majat më të larta, në pjerrësira, në kodra, jemi futur edhe në pjesët më të vështira. Punimi i tokave në të tilla terrene e ka dëmtuar shumë me-

1. I drejtohet shokut Idriz Zyberi, traktorist në SMT-në e Lezhës.

kanikën, qoftë në harxhimin më të madh të karburantit, qoftë edhe në dëmtimin e saj.

SHOKU ENVER HOXHA: Çështjen, shokë e shoqe, duhet ta kuptoni drejt. Këtë mekanikë që kemi, ne duhet ta ruajmë dhe ta shfrytëzojmë në maksimum, sepse për traktorët që duhet të sillen nga jashtë lypset devizë, valutë, që duhet ta krijojmë vetë. Në rast se e mbajmë keq traktorin dhe e futim atje ku nuk duhet futur, ai shpejt do të dalë jashtë përdorimit. Atëherë, kujt i bëhet dëmi në këtë mes? Popullit! Prandaj dhe populli duhet të kuptojë që, kurrë të mos i nënvleftësojë qetë, por përkundrazi t'i shtojë sa më shumë. Vendet ku nuk futet dot traktori duhet të punohen absolutisht me qe. Aty mund të përdoren mjete të tjera agroteknike që ato kodra dhe male të japin përsëri rendimente të larta. Në qoftë se veprojmë kështu, ne do të forcohem ekonomikisht e do të jemi në gjendje të blejmë edhe traktorë të tjerë, sepse edhe traktori ka një kohë amortizimi.

Pra, çështja është që të kuptohet mirë politikisht, ideologjikisht dhe ekonomikisht rëndësia e qeve. Këto probleme janë të lidhura të tëra.

Keni ju ndihmëstraktoristë?

SHOKU IDRIZ ZYBERI: Po, kemi. Rreth 70 për qind të traktorëve kanë ndihmës.

SHOKU ENVER HOXHA: Ndihet nevoja e këtyre në një sasi kaq të madhe? Apo, meqenëse është thënë një herë që të ketë traktoristë ndihmës dhe tani ky duhet të ketë. Unë mendoj se ka situata dhe vende që duhet të ketë, po mundet që edhe të mos ketë.

Ju keni pasur kontakt me Shyqyri Kanaparin dhe,

përveç të tjerave, keni biseduar me të edhe për çështjen e karburantit. Ju ka thënë ai juve sa litra harxhon?

SHOKU IDRIZ ZYBERI: Nuk e di ekzakt se sa, por ne e kemi 10 litra për hektar, ai mund ta ketë 8 litra.

SHOKU ENVER HOXHA: Ta marrim këtë shifër e ta diskutojmë. Pse ju ta keni 10 dhe ai 8, domethënë, a ka mundësi të harxhohet më pak karburant apo jo? Të gjithë traktorët këtë normë harxhimi kanë?

SHOKU IDRIZ ZYBERI: Disa kërkojnë që ta ulin akoma, kurse disa të tjerë kërkojnë që të na e rritin dhe aty-aty kemi shkuar, deri te 10 litra.

SHOKU ENVER HOXHA: Hë, more shoku traktorist, na fol, se na the mjaft gjëra të mira ti. Ty mund të të duket sikur janë gjëra të vogla këto, por neve na interesojnë.

Sikur ty, si traktorist të të themi tani shko dhe drejto sektorin e bujqësisë së Blinishtit, je në gjendje ta bësh këtë punë, të vësh rregull e disiplinë atje, të kuptosh problemet e bujqësisë, të bimëve të ndryshme etj.?

SHOKU IDRIZ ZYBERI: Ne si mekanizatorë, përveç zanatit që kemi duhet të jemi edhe bujq të mirë.

Praktikisht ne, i gjithë personeli i SMT-së jemi fshatarë, e njohim bujqësinë, tokën ku punojmë. Pra, nuk jemi vetëm mekanizatorë, por edhe bujq.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti punon në sektorin e parë të Dajçit. Shumë mirë. Keni hartë pedologjike dhe kimike atje dhe, në se po, ku qëndron ajo hartë, kush e mban?

SHOKU IDRIZ ZYBERI: Atë e mbajnë agronomët.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti the që ju e njihni tokën. Po kësaj hartës pedologjike dhe kimike i je vënë ndonjëherë që ta shikosh, ta studiosh dhe ta pyesësh atë agronomin pse kjo është kështu apo ashtu? Domethënë, je përpjekur që ta kuptosh këtë hartë! Sepse ti duhet të jesh edhe praktik në punën që ke. Ti, kur lëron me traktor arat e kooperativës, shikon që toka është e zezë apo e murrme; ka rrënjë apo s'ka rrënjë; ka vlagë apo s'ka; vë re se disa pjesë të tokës janë të bardha etj. Ti mund të mos i kuptosh se çfarë lloj tokash janë ato, po ajo harta pedologjike i shpjegon të tëra këto. Ndaj të pyeta nëse i ke kërkuar ndonjëherë agronomit të t'i shpjegojë këto harta? Ja, këtë dua të di unë. Ti e di se ku e ka hallin traktori kur ia bën «puf-puf-puf» dhe, sa e dëgjon, vete e i shtrëngon një vidhë a diçka tjetër. Është kështu? Po, por duhet të njohësh dhe tokën që të thuash se me të vërtetë mendon për prodhimin. Le të jetë agronomi më superior nga ti, megjithëkëtë në disa gjëra edhe ti mund të jesh një mësues i tij. Agronomi e di teorikisht hartën, kurse ti e njeh praktikisht tokën. Në qoftë se ai nuk vjen të bisedojë me ty dhe me fshatarët, ai nuk do ta kuptojë hartën në praktikë. Kur e fut plugun në tokë ti dhe e kthen atë përmbys, sheh nga afër, direkt se si është ajo, shikon shumë gjëra të tjera që agronomi i ka të shënuara në hartë, në teori. Prandaj, duhet t'i thuash: «Hajde këtu të ta mësoj unë një çikë këtë hartë praktikisht, kurse ti të ma mësosh mua nga ana teorike». Më kupton se ku e kam qëllimin unë? Jam i sigurt që ti më kupton drejt.

E dini pse e bëjmë këtë mbledhje të Sekretariatit

kështu bashkë me ju, shokë? Këto ndërhyrje dhe pyetje ne i bëjmë më shumë për ju (sepse shokët kryesorë të rrethit, kanë qenë edhe herë të tjera), për t'ju treguar deri në njëfarë shkalle që në Sekretariat dhe në Byronë Politike çështjet nuk i lëmë të shkojnë ashtu si në gjalpë, por i bëjmë pyetje shoku-shokut dhe shtrojmë probleme që kërkojnë përgjigje e zgjidhje. Shokët që janë ngarkuar nga Partia për detyrat e ndryshme, të japin llogari si duhet për çka u është besuar. Prandaj edhe ju, kur të shkoni në organizata, në komitete, në SMT, kur të shkoni tek agronomi etj. të mos lejoni t'u çirren duke ju thënë: «Dale, se unë them të bëhet kështu!». «Thua ti, shoku kryetar apo sekretar, por edhe unë them kështu: t'i rrahim mendimet, të diskutojmë dhe të gjejmë zgjidhjen më të drejtë». Kështu u duhet thënë atyre shokëve. Mirë, më dëgjon ti mua, por duhet të të dëgjoj dhe unë ty, shokun nga Kashnjeti, sepse nuk duhet t'i marrësh ti të gjitha fajet përsipër. Pra, kur të vesh atje në organizatë dhe kur të vijnë shokët e rrethit, thuaje pa frikë atë që ke në kokë dhe në zemër. Kështu e duan interesat e popullit dhe të atdheut. Këtë ta keni të qartë. Në këtë qëndron edhe revolucionarizimi i Partisë, forca e saj. Jo vetëm duke thënë për çdo gjë: «si urdhëron!».

«Si urdhëron» duhet thënë kur merret vendim nga shumica, atëherë po. «Si urdhëron» i themi Partisë, sepse ky qëndrim është i drejtë e parimor. Partia përbëhet nga njerëzit, pra Partia është organizata-bazë, anëtarët e saj e jo vetëm sekretari. Kam të drejtë apo jo?

Ne këtu bëmë edhe kritika për të përmirësuar pu-

nën, bëmë edhe ndonjë kritikë për shokët kryesorë të rrëthit, Mentor e Baki¹. E vërteta është se këta janë shokë që punojnë. Këtë gjë duhet ta dini. Këta lodhen e nuk punojnë keq, por ne ua dhamë fjalën më parë juve, bazës, se po nuk pati Partia themeli të forta, nuk mbahet «çatia», fundoset.

Mrika qulësh ti?

SHOQJA MRIKA VUKA: Po, shoku Enver. Unë punoj në ndërmarrjen bujqësore, në prodhim.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë bukur. Po, është ndërmarrje e mirë ajo. Është e madhe, i ka tokat shumë të mira. Atje keni ujitje? Stallat i keni të mira, prandaj duhet që rendimentet t'i keni të larta. Sa hektarë keni mbjellë me grurë, sa me misër dhe sa me foragjere? Luledielli keni mbjellë apo jo? Po çfarë rendimenti keni marrë vjet dhe sivjet? Duhet të keni marrë mirë!

SHOQJA MRIKA VUKA: Jo, nuk kemi marrë aq sa duhej të merrnim. Kemi qenë deficit me lulediellin.

SHOKU ENVER HOXHA: Po misër sa morët?

SHOQJA MRIKA VUKA: Kemi marrë 50 kuintalë për hektar. Ka pasur dhe hektarë ku kemi marrë edhe më shumë.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, nuk është keq, por duhet të luftoni për më shumë, se keni mundësi. Po grurë sa keni marrë?

SHOQJA MRIKA VUKA: Kemi marrë rreth 28 kuintalë për hektar.

1. Baki Karallu, në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrëthit të Lezhës.

SHOKU ENVER HOXHA: Po normat pse nuk realizohen dhe në ç'kohë ndodh më tepër kjo? Ju punoni me traktorë atje, apo dhe me krahë? Çfarë punoni me krahë?

SHOQJA MRIKA VUKA: Në dimër, zakonisht, kur punojmë në vijat kulluese, kur pastrojmë kanale dhe kur bëjmë ndonjë qilizmë.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa metër kub bëni në ditë? Pra, sa është norma?

SHOQJA MRIKA VUKA: Po të jenë kanale të reja norma është 6 metra kub.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti shoqja Mrikë ke bërë shkollën tetëvjeçare, prandaj sigurisht që e di ç'është metri kub, pra, e merr me mend ti sa janë 6 metra kub. Është një çikë shumë, më duket mua.

SHOKU MENTOR MUÇA: Ne problem kemi normën e prashitjes, sepse kjo nuk realizohet, ndërsa normat për pastrimin e kanaleve realizohen.

SHOKU ENVER HOXHA: Po mirë, si mendon ti shoqe e ndërmarrjes bujqësore, sikur ta lidhim punën tuaj me prodhimin se ne e kemi në mendje që ta realizojmë këtë gjë. Ka njerëz që thonë: «Hajde, oburra të bëjmë normën!», por, kur vjen puna e prodhimit, ky nuk arrihet. Pse nuk arrihet prodhimi? Sepse nuk është zbatuar si duhet agroteknika, nuk janë kryer në rregull shërbimet ndaj bimëve. Atëherë, punëtori i ndërmarrjes bujqësore pagën e merr, por prodhimin nuk e jep!

Punëtori duhet ta nxjerrë prodhimin sipas kërkesave të standardit, dimesioneve etj. Në qoftë se nuk e nxjerr kështu, në sasi e cilësi, atëherë në përputhje me

këto do të marrë edhe pagën. Në qoftë se e keni lexuar këtë projektvendim ju, atëherë, ç'mendoni? Ç'kanë thënë shokët punëtorë atje në ndërmarrje, është i drejtë apo nuk është i drejtë? Keni diskutuar për këtë apo jo?

SHOQJA MRIKA VUKA: Po, ne kemi diskutuar. Shqetësimi ynë kryesor është që puna të bëhet me cilësi, se pa këtë nuk merret prodhimi i pritshëm, prandaj mua më duket se është vendim i drejtë. Brigada ime punon më shumë në toka që janë në malësi, nuk ka fushë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po ç'orientim u keni dhënë këtyre brigadave të malësisë, për të cilat flet Mrika? Tokë arash janë këto, se, duke qenë malësi me shkurre, mos janë më të përshtatshme për blegtorinë.

SHOKU MENTOR MUÇA: Ne deri më sot atë tokë e kemi shfrytëzuar për drithë. Tani mendojmë ta përdorim për blegtorinë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po pse të jetë tani ky mendim dhe jo më përpara? Qysh nga viti 1962, kur është krijuar ndërmarrja bujqësore, e deri në vitin 1976 i thonë 14 vjet. Për 14 vjet nuk është menduar se çfarë do të bëhet me këto fshatra, përmbi kala, që venë deri në Dibër?! Këto duhet të ishin mbushur, jo me shkurre, por me dhi! Atje mund të kullosin tufa të tëra me dhen e dhi! Pse kështu do të ecim ne, duke vrarë kohën?

Të dielave sigurisht që bëhen pazare atje te ju si edhe gjatë. Deri në Milot e në Shkodër venë fshatarët për të shitur kecat. Nuk venë në malin ku punojnë, për

të kullotur dhitë, por marrin rrugën gjetkë. Do t'u vëmë një kufi këtyre tregjeve, të cilat jo vetëm kanë kuptim ideologjik jo të shëndoshë, por na pengojnë edhe zhvillimin e blegtorisë?!

Partia dhe Qeveria parashikojnë t'ju japin kredi për të blerë bagëti, prandaj këto që thuhet duhet të zbatohen e jo vetëm të përmenden.

Atëherë, shokë, jemi dakord me raportin që bënë shokët e grupit të kontrollit dhe me konkluzionet që janë dhënë atje. Këto konkluzione duhet të përpunohen dhe të zbatohen.

Përfitoni edhe nga biseda që bëmë këtu në Sekretariat. Diskutimet ishin shumë të vlefshme për ne, por, shpresojmë që edhe juve do t'ju kenë vlejtur. Ky diskutim le të shërbejë për mbarëvajtjen e punës dhe si-domos për realizimin e planit të vitit 1976, vitit të parë të pesëvjeçarit të gjashtë.

Kini parasysh, shokë drojtues të Partisë dhe të pushtetit në rreth, si dhe gjithë ju, punëtorë e kooperativistë, se ky vit është shumë i ngarkuar me detyra politike, ekonomike, ushtarake, arsimore-kulturore, si dhe me problemin e Kushtetutës.

Të gjitha këto detyra duhet të realizohen, por kjo nuk mund të bëhet pa një planifikim të studiuar mirë e shkencor. Çdo detyrë të kryhet në kohën e duhur. Të gjithë duhet të punojnë fort dhe me mend në kokë, veçanërisht këtë vit. Të punojmë, të reflektojmë dhe për çdo problem që na del të dalim me konkluzione sa më të drejta. Vetëm kjo rrugë do të na çojë në Kongresin e Partisë me planin e vitit 1976 të realizuar.

Partia do të na caktojë detyra të tjera, por detyrat e sotme të mos i lëmë për nesër.

*Botohet për herë të parë, sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

ORGANIZIMI DHE KONTROLLI TË JENË NË NJË SHKALLË TË LARTË EDHE NË NDËRTIM

Bisedë me shokët Haki Toska dhe Shinasi Dragoti

10 mars 1976

Ju thirra, shokë, për të biseduar me ju disa probleme të organizimit e të planifikimit të punës studimore e projektuese në ndërtim.

Shoku Shinasi është specialist i ndërtimeve, ai ka eksperiencë në këtë fushë, se ka qenë edhe ministër i Ndërtimit, kështu që i di hallet e këtij sektori të ekonomisë. E njëjta gjë mund të thuhet për shokun Haki, i cili, si anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të Partisë, merret me zbatimin e vijës së Partisë edhe në sektorin e ndërtimeve.

Shumë herë shokët e ndërtimit i kemi kritikuar në disa drejtime, por sidomos për tejkalimin e fondeve të parashikuara, për planifikimin jo gjithmonë të përshtatshëm të anës funksionale të objekteve që ndërtohen e të tjera. Shpeshherë, në kundërshtim me ligjin dhe me fondet e aprovuara, janë ndërtuar objekte jashtë destinacionit. E keqja nuk qëndron vetëm te këto, por kryesisht te shtesat e niëdha të fondeve që shpenzohen

për ndërtimin e një vepre, së cilës i është caktuar më parë limiti i kostos. Objektet e planifikuara herë kanë qenë të përshtatshme, herë jo. Këtu unë nuk e kam fjalën për estetikën dhe për fioriturat që bëhen në to, të cilat në shumë raste duhen lënë mënjanë.

Nga sa jemi informuar, shumë prej atyre që punojnë në ndërtim, po kritikohen nëpër mbledhje për arsye se puna studimore e projektuese ka qenë disa herë jashtë kontrollit dhe me dobësi të theksuara. Këto mbledhje, natyrisht, nuk janë bërë sa për të shkuar radhën, ato kanë zgjatur shumë, edhe nga 10 e 12 orë, dhe kanë trajtuar e kanë zgjidhur probleme. Njerëzit në këto mbledhje janë kritikuar për diçka, por, në përgjithësi, kjo diçka, më duket mua, qëndron në të metat subjektive të tyre, në vend që të bëhen përpjekje për të gjetur edhe arsyet pse tejkalohe fondet, ku e ka burimin kjo e keqe e rëndë dhe si duhet zhdukur, pse lihen «bishta» nga institucionet studimore, projektuese dhe ndërtuese. Çështja kalohet me këtë mënyrë, sepse ndërmarrjet e ndërtimit nuk çajnë kokën për to dhe investitorët nuk u kërkojnë asnjë llogari.

Bëjmë mirë që kritikën të lidhim me njerëzit, por ato duhet të jenë të drejtpërdrejta, konkrete, të lidhura me të metat që vërtetohen në organizimin e punës në ndërtim për çdo njeri. Punonjësit, kudo dhe për çdo gjë, në punë duhet të venë kurdoherë të inkuadruar, me një organizim të shëndoshë dhe të drejtë. Në çdo punë, në çdo veprim politik, në çdo direktivë të drejtë, në çdo përpjekje, në çdo ndërmarrje apo institucion ndërgjegjja duhet të jetë e lartë. Organizimi dhe kontrolli të jenë në një shkallë të lartë edhe në ndërtim.

Unë nuk kam dëgjuar të flitet shumë dhe njerëzit të merakosen se për këto dobësi që vërehen mund të jetë shkak edhe një organizim jo i shëndoshë në një ose në disa hallka. Në këtë drejtim, mendoj, flitet shumë pak, ose flasim, por bëjmë pak.

Në qoftë se Ministria e Industrisë dhe e Minierave, për shembull, lidhur me nevojat që i paraqiten, do të ndërtojë një fabrikë çimentoje¹ jo për 100 mijë tonë, sa kemi projektin e një fabrike të ndërtuar më parë, por me një kapacitet më të madh, ta zëmë prej 140 mijë tonësh, ajo duhet të studiojë, së pari, ku do ta ndërtojë veprën, gjeologjinë e vendit ku do të hidhen themelet e saj, pastaj, me radhë, ku ndodhen lënda e parë, uji, të ketë parasysh burimet për sigurimin e lëndës djegëse, të energjisë elektrike etj. Të gjitha këto të dhëna që nevojiten për të konkluduar drejt, përcaktohen nga studimi që duhet të bëjë grupi i studimit të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave dhe mbi këtë bazë të llogaritet shumë përafërsisht fondi që nevojitet. Ministria e Industrisë dhe e Minierave duhet të ketë një grup planifikuesish dhe preventivuesish, sepse pa ta ajo nuk mund të kryejë dot si duhet detyrat dhe nuk mund të organizojë dot punën në mënyrë të përshtatshme.

Në qoftë se duhet ndërtuar një fabrikë çimentoje, për të cilën ministria investitore i kërkon pëlqimin Komisionit të Planit të Shtetit, studime paraprake të plota

1. Industria e materialeve të ndërtimit kishte pak kohë që i kishte kaluar Ministrisë së Ndërtimit, por shoku Enver Hoxha e merr fabrikën e çimentos si shembull për të sqaruar problemin.

për të, siç fola më lart, aktualisht nuk bëhen, por vetëm kërkohet dhe jepet një kosto e përafërt. Për analogji kjo as nga Komisioni i Planit të Shtetit më duket se nuk studiohet sa duhet dhe drejtorja e investimeve me atë të materialeve të ndërtimit punojnë më pas, gjatë projektimit të objektit, i cili varet nga Ministria e Ndërtimit. Kur Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave i lind nevoja, pra, për të ndërtuar një fabrikë çimentoje me një kapacitet, siç thashë, prej 140 000 tonësh, ajo nuk ka njerëz në dikaster që t'i porositë për të studiuar paraprakisht, në radhë të parë, ku ndodhet vendburimi më i leverdishëm i lëndës së parë, i lëndës djegëse e të tjera, për të parashikuar se sa do të kushtojë fabrika dhe për të hartuar një paraproyekt ose komponentët e tij të përafërt. Puna për të bërë të tilla studime nuk është organizuar si duhet dhe Komisioni i Planit të Shtetit, që duhet të ketë edhe ai organizimin e tij, mendoj se nuk është në gjendje t'i japë një mendim shumë të përafërt dhe të saktë Qeverisë që vendos për këtë vepër.

Gjatë hartimit të planit, sikurse ka dalë nga diskutimet, nuk është bërë që në fillim një punë serioze, prandaj vetëm gjatë vitit 1975 janë ndryshuar planet (zakonisht nga fondi rezervë) në dhjetëra objekte. Kjo është e meta kryesore e fillimit të punës, pastaj më vonë, gjatë ndërtimit, vërtetohen me radhë të meta të tjera, për të cilat nuk do të flas këtu. Vërehet se nuk ka shqetësim sa duhet për kursime. Kështu materialet e ndërtimit, mekanizmat shpërdorohen ose mbahen të papërdorur etj. Gjer në fundin e muajit shtator të vitit të kaluar, siç më kanë njoftuar, në sistemin e Minis-

trisë së Ndërtimit janë evidencuar stoqe makinerish, pjesësh këmbimi e mallrash me konsum të ngadalshëm që kanë një vlerë prej miliona lekësh.

Si mund të lejohet që Komisioni i Planit të Shtetit në fillim, pastaj Qeveria e Byroja Politike dhe Komiteti Qendror i Partisë, të vendosin duke u bazuar në një plan, i cili parashikon ndërtimin e disa objekteve të arsyeshme, por që janë përcaktuar me hamendje, dhe, kur bëhen studimet dhe projektet, fondet e caktuara tejkalohen shumë?

Kudo, si në të kaluarën, por edhe tani, edhe një person privat që dëshiron të ndërtojë një shtëpi, më parë bën mirë llogari sa do t'i kushtojë ajo. Ai synon të ndërtojë një shtëpi me aq dhoma sa ka takatin, siç thotë populli. Porositësi bie kështu dakord me të porositurit, ndërtuesit, dhe kontrollon punën, cilësinë e saj, koston e objektit, afatet e çdo procesi etj. Pra individit gjatë procesit të ndërtimit tregohet shumë i kujdesshëm që kjo shtëpi, të cilën ua ka ngarkuar t'ia ndërtojnë një ose shumë personave, të mos i kushtojë më tepër nga shuma që ka rënë në ujdë dhe, derisa të përfundojë ajo, u qëndron mbi kokë ndërtuesve që ta bëjnë atë me cilësi të mirë dhe nuk lejon që të ngrihet çmimi, përkundrazi, bën kujdes të madh që shtëpia t'i kushtojë sa më pak. Kur një person privat, si në rastin që përmenda, bën llogari të sakta për ndërtimin e një shtëpie dhe e ndjek këmba-këmbës punën deri në përfundimin e saj, po Ministria e Industrisë dhe e Minierave, që marrim si shembull, në një shtet socialist si ky yni, çfarë duhet të bëjë? Sa shumë gjëra të mëdha ka për të bërë ajo si investitore e miliarda lekëve!

Ministria e Industrisë dhe e Minierave, duke argumentuar se i nevojitet kjo ose ajo fabrikë, do të kërkojë për këtë pëlqimin e organit shtetëror kompetent. Ky organ në këtë rast do të shikojë fondet që janë caktuar për këtë ministri. Kur në mbledhjen kolegjiale të organit shtetëror kompetent, ndodh që është Komisioni i Planit të Shtetit, mund të dalë që kërkesat për objektin që mendon ministria në fjalë nuk janë të arsyeshme, siç pretendohet, përfaqësuesit e këtij organi, fillojnë debatin me përfaqësuesit e ministrisë investitore dhe më në fund i komunikohet kësaj se i janë caktuar jo aq fonde sa kërkon, por më pak, dhe atëherë Ministria e Industrisë dhe e Minierave duhet të rishikojë medoemos studimet dhe t'i sjellë në normat dhe në caqet e caktuara.

Kur ministria kërkon të ndërtojë një fabrikë çimentoje me një kapacitet prej 140 mijë tonësh, siç thanë më lart, dhe jo prej 100 mijë tonësh, sa është parashikuar nga direktivat, sigurisht të drejtën e disponimit për fondin që nevojitet lidhur me këto shtesa prej 40 mijë tonësh e ka organi shtetëror që ka aprovuar ndërtimin e veprës, domethënë Qeveria. Pa ia dhënë të drejtën Qeveria, nuk mund të bëhet asnjë pagesë për shtimin e fondit.

Kjo procedurë dihet, por tani lind pyetja: Çfarë do të bëjë Ministria e Industrisë dhe e Minierave në shembullin që morëm, kur ajo e di që ka në dispozicion një fond të caktuar për destinacionin e aprovuar dhe nuk i lejohet të bëjë gjë tjetër mbi këtë? Çfarë do të bëjë ajo për kërkesën e re me paratë që ka?

Pasi dëgjoi mendimet e shokëve Haki Toska e Shinasi Dragoti, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Kështu siç po ma shpjegoni ju, investitori, që në rastin konkret është Ministria e Industrisë dhe e Minierave, nuk ka asgjë në dorë në këtë drejtim. Si mund të interesohet ajo, të cilën e akuzojnë me të drejtë se nuk kujdeset kur hartohet projekti, por që në fillim di vetëm se do të ndërtohet një fabrikë, për të cilën janë caktuar edhe fondet përkatëse? Ajo ua ka lënë në dorë të tjerëve të bëjnë projektin, preventivin dhe zbatimin e tij. Pra, sipas thënies suaj (dhe unë vetë atë mendim kam), nuk ekzistojnë lidhje të ministrisë me preventivuesin, projektuesin dhe ndërtuesin.

Pasi i dhanë shpjegime se Ministria e Industrisë dhe e Minierave nuk ka projektues dhe preventivues dhe se këta i përkasin Ministrisë së Ndërtimit e varen nga sektori përkatës i projektimit të veprave industriale të Institutit të Projektimeve, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Domethënë Ministria e Ndërtimit nuk ka kontradikta me asnjë dikaster, sepse të gjithë sektorët e rëndësishëm për ngritjen e veprave janë të varur prej saj; ajo u jep çmimin dhe përcakton të gjitha kërkesat e tjera. Se sa do të kushtojë dhe kur do të mbarojë vepra, këtë e di vetëm Ministria e Ndërtimit. Kjo është arsyeja që kur Ministria e Industrisë dhe e Minierave, ajo e Bujqësisë ose Drejtoria e Ekonomisë Komunale¹ kërkojnë të ndërtojnë fabrika, vepra bonifikuese, shtëpi banimi etj., dëshirojnë vetëm t'u bëhet një projekt, por nuk

1. Në sesionin e 5-të të legjislaturës së 11-të të Kuvendit Popullor, që i zhvilloi punimet më 27-28 qershor 1980, në vend të saj u aprovua krijimi i Ministrisë së Ekonomisë Komunale.

kanë mundësitë e nevojshme që të bëjnë një studim paraprak për çka do të ngrihet, nuk kanë as mjetet që të interesohen dhe t'i vënë fre ndërtuesit, i cili, në kushte të tilla, cakton vetë datat, shkel afatet, tejkalon fondet etj. Në parim çdo dikaster investitues duhet të interesohet, por me se dhe kur? Kjo çështje ngrihet, por në praktikë nuk ndiqet, se duhet të ketë organe kompetente, siç shpjegova më lart, që ta ndjekin.

Në bazë të planit të shtetit Ministria e Industrisë dhe e Minierave çel kufijtë e financimit pranë Bankës së Shtetit për çdo objekt që do të ndërtohet nga ndërmarrjet që varen nga Ministria e Ndërtimit ose nga ajo vetë, edhe për ato objekte nën kufi, ose organizma të tjerë, sipas kompetencave që janë caktuar. Në këto kushte ne mund ta kritikojmë Ministrinë e Industrisë e të Minierave, por ajo di vetëm sa kushton objekti që ka caktuar, por edhe këtë pa llogari nga ana e saj, për sa kohë që nuk i kemi dhënë mjete e mundësi që të studiojë dhe të kontrollojë zbatimin. Kështu nuk mund të ecet. Ky nuk është një organizim i drejtë i punës në studim, në projektim, në ndërtim dhe në kontroll nga ana e investitorit dhe e Bankës. Unë gjykoj se në të tëra këto hallka ka të meta.

Sipas mendimit tim, Ministria e Industrisë dhe e Minierave, që marrim për shembull, por edhe të gjitha ato dikastere dhe institucione të tjera që kanë investime të rëndësishme (nuk e kam fjalën për gjëra të vogla), duhet të kenë degën ose zyrën e vet të planifikimit, e cila të shërbejë me të vërtetë si një organizëm i tillë që të lidhet mirë me zyrën ose me degën e investimeve të Komisionit të Planit të Shtetit. Kjo degë apo zyrë duhet

të ketë një detyrë me shumë rëndësi. Kur të diskutohet në kolegjiunin e ministrisë për planin pesëvjeçar, për shembull, dhe të thuhet që ka forca të atilla me të cilat mund të ndërtohen këto ose ato vepra, atëherë kjo zyrë e planifikimit dhe e preventivimit të Ministrisë së Industrisë e të Minierave duhet të fillojë përnjëherë studimin, duke mbajtur lidhje me Komisionin e Planit të Shtetit. Punonjësit e saj të shkojnë në Komisionin e Planit të Shtetit e të thonë që në mbledhjen e kolegjiunimit të ministrisë së tyre, që u organizua për të diskutuar planin pesëvjeçar, u mendua të ndërtohen këto objekte për të cilat ata kanë bërë këto studime.

Komisioni i Planit të Shtetit pastaj t'i marrë dhe t'i shqyrtojë studimet e Ministrisë së Industrisë e të Minierave për të parë nëse ato janë me të vërtetë të bazuara, nëse fabrikat që propozohet të ngrihen janë rentable, i duhen shtetit me atë kapacitet apo nuk i duhen, janë të nevojshme për këtë kohë apo mund të lihen për një kohë tjetër. Kjo gjë është e nevojshme të bëhet, sepse kur ministria i thotë Komisionit të Planit që fabrika i nevojitet me kapacitet jo prej 100 mijë tonësh, po prej 140 mijë tonësh dhe Komisioni i Planit i thotë asaj se mjafton me 100 mijë tonë etj., midis tyre duhet të zhvillohen debate parimore. Në debat e sipër Komisionit të Planit të Shtetit i jepen të dhëna sa kush-tojnë fabrika, materialet etj. dhe kështu, në këtë fazë, ai njihet edhe me kapacitetin, edhe me çmimin e fabrikës që do të ndërtohet. Pas kësaj procedure Ministria e Industrisë dhe e Minierave ka mbaruar punën e parë.

Kur diskutohet për sa thamë më sipër, përveç pu-

nonjësve të tjerë të Ministrisë së Industrisë e të Minierave ose të vetë ministrit të Industrisë, në Komisionin e Planit të Shtetit duhet të jetë i pranishëm edhe preventivuesi i ministrisë në fjalë, i cili të diskutojë dhe të punojë bashkë me të tjerët në mënyrë të organizuar dhe, së toku me ta, të bëjë llogaritë sa kushton vepra, ku gjenden materialet e ndërtimit të fabrikës, ç'parashikime janë bërë për kursimet etj. Kështu do të bëhet një plan i realizueshëm. Edhe për një material që shteti nuk e ka, preventivuesi duhet të jetë në dijeni. Prandaj të mos ndodhë më ajo praktikë e dëmshme që është vërtetuar në Ministrinë e Ndërtimit, ku kjo e ka çdo gjë në kompetencën e saj dhe si rezultat i nënvlehtësismit ose i mungesës së sektorit të preventivimit dhe të planit në dikastere të tjera, është lejuar fillimi i objekteve pa preventivat dhe këtu s'ndihen fare kontradiktat e debatet gjatë projektimit dhe zbatimit.

Edhe Ministria e Industrisë dhe e Minierave ka punonjësit e saj, të cilët duhet të bashkëpunojnë me ata të Ministrisë së Ndërtimit që të bëhen projekte të drejta, ku të merren për bazë edhe studimet e investitorit, prandaj preventivuesi e projektuesi i ministrisë do të punojnë së bashku që fabrika e çimentos, për shembull, të bëhet sipas parashikimit të Ministrisë së Industrisë e të Minierave. Për të gjitha këto Ministria e Ndërtimit (jo projektuesi) kërkon numrin e muratorëve, sasinë e gurëve e të çdo materiali tjetër të nevojshëm për ndërtim dhe që të gjithë këtyre u përcakton çmimin, të cilin duhet ta diskutojë me investitorin dhe preventivuesin. Preventivuesi, kur dëgjon për këtë shumë të hollash që cakton ndërtuesi, mund dhe duhet të thotë se nuk ka

aq fonde për fabrikën, sepse Qeveria nuk i ka akorduar më shumë. Atëherë bëhen diskutime e debate një për një për të hequr diçka andej, diçka këndeje etj. Kjo mënyrë veprimi bëhet së toku me përfaqësuesit kompetentë të investitorit, të planifikuesit dhe të ndërmarrjes së ndërtimit ose të vetë Ministrisë së Ndërtimit. Pasi aprovohet projekti, ky i vete atëherë ndërtimit dhe caktohet se cila ndërmarrje do ta ndërtojë veprën.

Fondet e planifikuara për veprat përbëjnë mundësitë maksimale që ka shteti, prandaj këto duhet të bëhen objekt i një studimi rigoroz. Mirëpo kjo direktivë e Partisë është shkelur. Nga një punë jo e rregullt janë tejkaluar fondet e caktuara më parë, për shembull, në Hekurudhën Elbasan—Përrenjas, në Hidrocentralin e Smokthinës, në Uzinën Mekanike Bujqësore në Durrës, në Kombinatin e Mishit në Tiranë, në Minierën dhe në Fabrikën e Gurit të Kuq në Pogradec etj., prandaj të merren të gjitha masat që t'i jepet fund kësaj situatë.

Pas gjithë këtyre parashikimeve që bëhen, nuk duhet menduar nga askush se tash që secili i mori të dhënat e nevojshme, çdo gjë do të shkojë mirë, sepse përveç këtij organizimi të fillimit ekzistojnë edhe një mori çështjesh të tjera që këtë organizim mund ta bëjnë të paefektshëm. Objektet ekonomike do të ngrihen ashtu siç e do interesi i punës, i atdheut dhe jo sipas dëshirës së preventivuesit ose të ndonjë tjetri, që mund të ketë rënë në ujdin me të. Vepra kërkohet të përfundojë në kohën e caktuar, me fuqinë punëtore të planifikuar dhe me rendimentin e parashikuar në kontratën e lidhur midis ndërmarrjes ndërtuese dhe investitorit.

Kontrolli i shumanshëm të jetë i rreptë dhe organizimi i madh e i vogël i punës sa më i përsosur.

Vërejtjet që bëhen rreth çmimeve kanë efekt kur janë të bazuara e jo kur flitet kuturu. Çdo kërkesë, çdo shtesë të argumentohet në mënyrë bindëse dhe të merren vendime sipas kompetencave. Kur diskutohet me projektuesin dhe del qartë se, po të mos bëhet njëfarë shtese, cenohet vepra, atëherë pranohet dhe investohet shtesa nga fondi rezervë që disponon investitori dhe kjo rezervë që ka ky përdoret me shumë nikoqirllëk dhe nuk tejkalohet. Në këtë mënyrë ministria do të jetë në gjendje të raportojë se për këtë arsye e ka harxhuar edhe këtë fond që kishte, por ama fabrika u ndërtua.

Pas diskutimit të projektit firmoset kontrata. Investitori nuk do të rrijë duarlidhur, por do të ushtrrojë vazhdimisht kontroll teknik për gjendjen e punimeve, gjatë kohës që këto do të vazhdojnë, do të vërejë me kujdes nëse materialet që përdoren u përgjigjen projektit dhe kushteve teknike etj. Veç kësaj, kjo ministri duhet të mbikëqyrë edhe vlerën e punës së raportuar, me qëllim që të mos ecet në tym, të mos tejkalohen fondet e preventivit paraprak. Ne vërtet flasim që të mos tejkalohen shifrat e aprovuara, por ama të kemi parasysh që të mos i vëmë projektit një kufi minimal ose qendra të mos vendosë kuturu, duke dhënë një urdhër gjoja kompetent.

Në procesin e zbatimit të kontratës krijohet një konfuzion i tillë, sa rolin vendimtar e luan jo investitori, por ndërmarrja e ndërtimit. Kjo ka për detyrë që të ndërtojë në kushte normale atë objekt që parashikon projekti, i cili nuk mund të bëhet sipas kokës së ndër-

tuesit, por sipas kërkesave të investitorit. Ky i fundit, sikurse thashë, duhet të ketë bërë një parastudim dhe të ketë nxjerrë konkluzione mbi potencialin ekonomik të veprës që do të ndërtohet; pastaj këtë parastudim ta miratojë Qeveria. Investitori të vërë në lëvizje planifikuesin, preventivuesin, projektuesin dhe ndërtuesin, që fabrika të ndërtohet ashtu siç do ai, sipas planit të shtetit, pa lejuar që me kursimet e bëra të zihen «vrimat». Mua më duket se në këtë drejtim investitorëve u janë lënë pak kompetenca.

Komisioni i Planit të Shtetit nuk duhet të lëshojë për diçka që është llogaritur me hamendje dhe, mbi këtë bazë, t'i propozojë Qeverisë që edhe kjo të vendosë me hamendje. Ndërtimi i një vepre nuk mund të zgjidhet me hamendje nga një ose dy shokë, por të vihen rregulla, të cilat të zbatohen me përpikëri. Në qoftë se edhe në të ardhmen vazhdohet të ndiqet kjo procedurë që është praktikuar deri tash, jam i bindur se do të ecet në një rrugë të gabuar.

Në këtë drejtim ka të ngjarë të dalin edhe vështirësi. Ndonjëri mund të thotë: «Mirë, more shoku Enver, por që të bëhet kështu si thoni ju, edhe në qoftë se kjo zgjidhje do të ishte krejtësisht e përsosur, neve na mungojnë planifikuesit e ministrisë, na mungojnë preventivuesit dhe projektuesit në komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve dhe pa këta elementë e kemi vështirë të procedojmë». Kjo mund të jetë e vërtetë, megjithatë në të ardhmen ne nuk mund të lejojmë të ecet më kështu. Unë kurdoherë kam menduar dhe kam luftuar që të mos fryhen organikat, por kur i kemi dhënë bazës njaft kuadro me arsim të lartë, si

t'i lëmë sektorët kyç pa njerëz kompetentë? Ky do të jetë një gabim i madh që bëjmë, gjoja për të shkurtuar organikat.

Në këtë pesëvjeçar ne do të procedojmë progresivisht me ato vepra që janë më të domosdoshme, pastaj, në pesëvjeçarin tjetër, do të merremi me të tjerat që presin.

Investitori i kërkon organit projektues të hartojë projektin e preventivin në bazë të programit që është studiuar në disa zgjidhje. Ai pastaj bisedon edhe me ndërmarrjen që ka ngarkuar Ministria e Ndërtimit për të zbatuar punimet dhe firmoset kontrata që përcakton përmasat, vëllimin, cilësinë, çmimin dhe afatin e mbarimit të objektit. Në krye të kësaj pune qëndrojnë investitori, planifikuesit dhe preventivuesit e tij. Mua më duket se drejt kësaj rruge duhet të ecim dhe për këtë qëllim të racionalizojmë forcat.

Ndërtimet do t'i kemi të përqendruara kështu si deri tani, domethënë ndërtimet e mëdha të vazhdojë t'i ketë kryesisht Ministria e Ndërtimit, ndërtimet e tjera t'i kenë rrethet dhe dikasteret. Ne mund të qëndrojmë edhe në atë praktikë që gjithë projektimi të jetë nën drejtimin e Ministrisë së Ndërtimit. Ky organizim le të shikohet, por, e përsëris, organizmat e projektimit do të projektojnë për investitorin, vepra do të ndërtohet ashtu siç e do investitori. Ministria e Ndërtimit duhet të ndihmojë në organizimin e mirë të forcave të projektimit dhe të ndërmarrjeve të ndërtimit. Në qoftë se kjo ministri vepron seriozisht në këtë drejtim, atëherë do të jetë në gjendje t'i njoftojë Qeverisë ose Komisionit të Planit të Shtetit se i ka organizuar forcat si duhet,

se projektet, afërsisht 90-95 për qind janë në rregull, por nuk ka forca të tjera për këto dhe për ato arsye, prandaj është e pamundur të ndërtohen të tëra ose të tjera dhe propozon që ky ose ai objekt të lihet për t'u ndërtuar një vit më vonë. Ministria mund të thotë gjithashtu që, në qoftë se asaj i jepet edhe një numër shtesë punëtorësh dhe mekanizma të tjerë, ajo mund t'i përfundojë objektet e planifikuara, por, me ata njerëz dhe me ato mekanizma që ka, mund t'i përfundojë me shumë sforcime. Në qoftë se nuk veprohet kështu, nuk ka si të ecet në rregull. Një përqindje e vogël e papara-shikuar është kurdoherë e mundshme, prandaj investitorit i lihet edhe një rezervë.

Kam mendimin se për këtë çështje demi nuk po kapet nga brirët. Ne nuk i kemi preventivuesit që na duhen, sektori i preventivimit paraqitet dobët. Te disa punonjës të Ministrisë së Ndërtimit, dhe sidomos te projektuesit, ka mbizotëruar koncepti çorientues që në fazën e projektidesë të llogariten vlera të vogla që mund të rriten me lehtësi më pas. Për sa u përket ndërtimeve vërehen gabime në preventivim, në projektim dhe në zbatim. Pse të ndodhë kështu? Kjo çështje na ka shqetësuar dhe na shqetëson të gjithë. Për të evituar të metat që vërehen, veç të tjerave, mendoj se duhet gjetur një mënyrë e përshtatshme e organizimit të punëve, duhet bërë një llogari e shtrënguar.

Projektuesi kontrollon që projekti i tij të zbatohet mirë. Preventivuesi i investitorit, që i ka të gjitha paratë, kontrollon në emër të ministrisë së vet se çfarë po bëhet, prandaj, në këtë kuptim, kontrolluesi nuk është vetëm projektues, por edhe preventivues. Ekzis-

ton një kompromis i dëmshëm midis projektuesit dhe zbatuesit që janë në një dikaster. Ata e lënë një punë pa kryer, duke kaluar radhën. Ky qëndrim duhet dënuar dhe luftuar, duke futur brenda kësaj «shoqërie» edhe investitorin, edhe Bankën. Por as Banka nuk duhet t'i lëshojë fondet vetëm pse i paraqet gjendjen e ndërtimeve Ministria e Ndërtimit; ajo duhet të pyesë edhe investitorin që ka paratë.

Prandaj ju thirra, shokë, që të reflektoni një çikë për këto që thashë. Mendoj se do të jetë mirë të thërrisni punonjësit kryesorë të projektimit, nja dy drejtorë ndërmarrjesh ndërtimi, disa planifikues të ministrisë, dy-tre preventivues, që tash janë pranë institutit, nja dy shokë ministra të ministrive investitore, si dhe shokët Petro Dode dhe Spiro Koleka. I bisedoni edhe me këta shokë këto probleme që ngrita, si dhe propozimet e mia, dhe gjykoni nëse janë të drejta apo jo. Në qoftë se e meta kryesore nuk qëndron në atë që përcaktova unë, të gjendet ku ndodhet ajo dhe të merren masa.

Midis çështjeve që ju ngrita mund të ketë nga ato që nuk i di mirë, prandaj, para se të thërrisni shokët, reflektoni ju vetë për to, pastaj i shtroni për diskutim që të merrni vesh çfarë do t'ju thonë, si do t'ju thonë, si veprohet tani dhe si mendojnë shokët të bëhet më mirë në të ardhmen. Shikoni mos duhen marrë masa organizative dhe mos duhet bërë më mirë edhe shpërndarja e kuadrove.

Ndërtimi është një ndër fushat e rëndësishme të kursimeve. Në projektim dhe në zbatim nuk janë mbajtur parasysh kurdoherë orientimet e Partisë për forcimin e regjimit të kursimit. Disa projektues futin në

projektet e tyre materiale që duhen sjellë nga importi, megjithëse në mjaft drejtime ato mund të zëvendësohen me materialet e vendit.

Ka ndërmarrje që kanë një eksperiencë të pasur, punëtorët e tyre punojnë me rendiment e cilësi më të mirë se të tjerët, sepse atje ka një organizim më të shëndoshë prodhimi etj., kurse shumë ndërmarrje të tjera e kanë të dobët organizimin e punës. Por edhe eksperiencia e mirë që kemi ne për projektimin dhe për preventivimin duhet përgjithësuar. Kjo është e domosdoshme, sepse ndryshe do të ndodhë përsëri që njërit i del llogaria 30 milionë, për shembull, kurse tjetri e çon vlerën e objektit në 50 milionë! Kjo tregon se eksperiencia nuk përdoret mirë.

Pa ekzistuar kontrolli i gjithanshëm, as kontrolli i Bankës nuk ka efekt. Banka do t'i japë fondet e ndërtimit të veprës në periudha të caktuara dhe, kur është rasti, do të lajmërojë Qeverinë se janë marrë të holla shumë para kohe. Qeveria, sipas këtij sinjalizimi, do të pyesë investitorin dhe Ministrinë e Ndërtimit se për ç'arsye nuk e kanë realizuar objektin, kur paratë i kanë marrë. Ky është kontrolli i Bankës. Që të bëhet si duhet ky kontroll, lypset të ketë disa njerëz të përgatitur për këto punë. Vetëm lajmërimi që do të jepet këto para në filan kohë, nuk i ndalon shpenzimet pa kriter.

Në qoftë se nuk pyetet fare investitori, atëherë ndërtimi i harxhon të tëra paratë ashtu si i vjen për mbarë. Investitori është shumë i interesuar të ngrejë zërin, duke thënë që ky ndërtim nuk më bën dhe, në një rast të tillë, Qeveria e thërret ministrin e Ndërtimit dhe i tërheq vëmendjen. Prandaj kontrolli i ndërtimeve

duhet të jetë i shumanshëm. Kjo është punë e vështirë. Për kryerjen e saj duhet të jenë në aktivitet të gjerë ndërmarrjet, inxhinierët, gjeologët, punonjësit e ujërave etj. Ndrsyhe nuk ka si bëhet.

Duhet të shikohet në këtë kuadër edhe puna e planifikimit që përmenda në fillim, sepse këtu mund të ekzistojë fryma e «teorisë» së Abdyl Këllezit që parashikonte gjëra të mëdha, të fryra, me qëllim që ato të mos realizoheshin, që të dobësohej kështu ekonomia, të shkeleshin afatet e parashikuara, kurse amortizimin dhe të gjitha të tjerat t'i merrte lumi. Pra, metodologjia e planifikimit që ka ekzistuar është me gabime, mendoj unë, prandaj gjatë shikimit të gjithanshëm të çështjes duhen pasur parasysh edhe metodologjia, edhe lidhjet e investitorit me zbatuesit etj.

Ndërmarrja e ka për detyrë t'i raportojë ministrit për mbarëvajtjen e punës dhe ministri, po të ketë vërejtje, të shkojë në Komisionin e Planit të Shtetit ose në Kryesinë e Këshillit të Ministrave dhe pastaj, po nuk iu zgjidh çështja as atje, të ngrejë zërin gjer në mbledhjen e Qeverisë e jo të kufizohet duke biseduar me një ose me dy njerëz, siç bënin Koço Theodhosi, Abdyl Këllezit e disa të tjerë.

Komisioni i Planit të Shtetit dhe Ministria e Financave duhet të zhvillojnë debate, të hahen, për të mbrojtur secili pikëpamjen që i duket e drejtë. Ministria e Financave është një organ qendror i administratës shtetërore i specializuar për veprimtarinë financiare; ajo nuk është e përbashkët me Komisionin e Planit të Shtetit. Ministri i Financave është anëtar i Këshillit të Ministrave dhe, si i tillë, do të raportojë para këtij organi

më të lartë ekzekutiv dhe urdhërdhënës, si dhe para organeve të larta të pushtetit shtetëror për kryerjen e detyrave që i ngarkohen. Në qoftë se ka ndonjë gjë urgjente, ai shkon e bisedon edhe drejtpërdrejt me cilindo nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Ministrave.

Ministria e Financave nuk duhet vetëm të konvertojë në monedhë të gjitha të ardhurat e shtetit tonë. Kjo ministri e ka për detyrë t'i vërë në dukje Këshillit të Ministrave që për këtë plan pesëvjeçar ose për planin e vitit 1976 janë këto mundësi dhe atëherë Komisioni i Planit të Shtetit merr nga dikasteret ato të dhëna që përmendëm më përpara, nëse mund të shtohet kaq apo mund të shtohet aq. Këto të dhëna shikohen në Kryesinë e Këshillit të Ministrave dhe pastaj bëhen preventivat. Po të teprojë gjë, mund të bëhet diçka më shumë. I tërë ky rreth vicioz duhet të shikohet me kujdes.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Raporte e fjalime 1976-
1977», f. 41*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1976-1977», f. 41*

ÇFARË E NDIHMON DHE ÇFARË NUK E NDIHMON SIGURIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E VËRTETË TË BALLKANIT

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

23 mars 1976

Pas Konferencës së Sigurimit Evropian të Helsinkit, nga drejtime të ndryshme u bënë mjaft propozime e plane për takime e mbledhje kontinentale e rajonale për të vënë në jetë të ashtuquajturën frymë të Helsinkit.

Në këtë kuadër u mbledh edhe Konferenca ballkanike për bashkëpunimin ekonomik e teknik, që u mbajt para pak kohësh në Athinë, e cila, siç thuhej në komunikatën përfundimtare të pjesëmarrësve, «frymëzohej nga parimet dhe dispozitat e aktit final të Konferencës për sigurimin e bashkëpunimin në Evropë».

Vendi ynë nuk mori pjesë dhe, në kohën e në formën e duhur, i bëri të qarta shkaqet e refuzimit të tij për të shkuar në këtë konferencë. E nisur nga politika e drejtë e konsekuente e ruajtjes së fqinjësisë së mirë me popujt e Ballkanit, nga parimet e njohura të mosndërhyrjes në punët e brendshme e të respektit të plotë të sovranitetit kombëtar, Qeveria e Republikës

Popullore të Shqipërisë shpjegoi se aktualisht në Gadhullin Ballkanik nuk ekzistojnë kushte për të realizuar marrëveshje për një bashkëpunim shumëpalësh, dhe aq më pak për ta zbatuar në praktikë atë.

Në të njëjtën kohë, ajo vuri në dukje se për krijimin e atmosferës së mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit të vërtetë në Ballkan, rruga e zhvillimit dhe e forcimit të marrëdhënieve bilaterale do të ishte një objektiv më i realizueshëm në praktikë.

Gjendja e sotme e marrëdhënieve midis vendeve ballkanike është mjaft e komplikuar dhe superfuqitë, me ndërhyrjet e tyre të shumëllojshme kanë krijuar koniunktura të rrezikshme politike e ushtarake. Disa vende të Ballkanit janë të lidhura me NATO-n, disa të tjera varen nga Traktati i Varshavës. Në to ndodhen trupa dhe baza ushtarake të superfuqive, ku janë depozituar, bile, edhe armë bërthamore. Anije e aeroplanë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të Bashkimit Sovjetik të ngarkuar me raketa e bomba atomike hyjnë e dalin atje si në shtëpinë e tyre.

Të dyja superfuqitë jo vetëm që mbajnë gjallë konfliktet e vjetra, por nxitin edhe të reja, siç është rasti i Qipros. Ndërkaq, midis shteteve ballkanike ekzistojnë shumë çështje dypalëshe të pazgjidhura, të cilat krijojnë jo pak tension midis tyre.

Kuptohet se, në kushte të tilla, as që mund të bëhet fjalë për marrëveshje e bashkëpunim shumëpalësh. Prandaj mbledhje si ajo e Athinës nuk mund të çojnë në asnjë rezultat pozitiv, nuk mund të krijojnë baza e premisa për zgjidhjen e drejtë të problemeve që preokupojnë me të vërtetë popujt e Ballkanit. Të tilla ta-

kime përmbajnë në vetvete rrezikun e madh të krijojnë iluzione të gabuara, si ato të Konferencës së Helsinkit, të cilat nuk u shërbejnë forcimit të lirisë e të pavarësisë së popujve të Ballkanit, miqësisë së vërtetë dhe bashkëpunimit normal midis tyre.

Ne e ndoqëm nga jashtë zhvillimin e punimeve të Konferencës ballkanike dhe tani, ashtu siç parashi-kohej, konstatojmë se nuk u arrit në asgjë konkrete. Bile, siç u njoftua gjerësisht edhe në shtypin e huaj, vetëm lidhur me procedurën e mbledhjes, bisedimet e debatet zgjatën me ditë të tëra. Fakti që për procedurën u bënë me dhjetëra propozime, siç ishin ato lidhur me gjuhët e punës së konferencës, me shtetet që duhej të thirreshin në të etj., dëshmon jo vetëm për ekzistencën e pozilave të papajtueshme, por edhe për presionin e ndjeshëm të superfuqive, të politikës dhe të rivalitetit të tyre.

Mund të merret me mend se ç'belara do të dilnin po t'u hyhej në thelb problemeve të shumta e të komplikuar që kanë për të zgjidhur midis tyre vendet ballkanike. Në teori, deri në njëfarë shkalle, këto çështje mund edhe të gjejnë një rrugë përmirësimi me anë të bisedimeve. Por në praktikë, në kushtet kur imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik ndërhyjnë direkt ose indirekt në punët e Ballkanit me anë të shteteve si Bullgaria, në kushtet kur ka shtete që interesat e tyre kombëtarë i kanë lidhur me këto superfuqi dhe që, si pasojë, janë në pamundësi të diskutojnë dhe të zgjidhin në rrugë të drejtë ato probleme që interesojnë popujt e këtij rajoni, ky përmirësim nuk mund të realizohet.

Situata në Ballkan komplikohet edhe për arsye se aty ka politika shoviniste e të shtypjes nacionale të pakicave kombëtare, ka shpifje dhe nxitje armiqësish nga elementët reaksionarë ndaj popujve të tjerë. Midis disa vendeve ka pretendime territoriale dhe kontradikta të mprehta, ku as njëri as tjetri nuk lëshojnë.

Disa vende bëjnë zhurmë për pavarësi, por janë të varur nga socialimperializmi dhe luajnë lojën e tij. Ka shtete të cilat kërkojnë që në bisedimet ndërballkanike të thirren si pjesëmarrëse edhe Hungaria e Italia, bile edhe Bashkimi Sovjetik e Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të qenë, siç pretendojnë ata, «garantë të marrëveshjeve të përfunduara». Kjo është si të vësh ujë të ruajnë kopenë, që popujve të Ballkanit t'u rrjepin jo vetëm lëkurët, por t'u hanë edhe kockat.

Prandaj të propagandosh se realiteti i sotëm ballkanik, i cili përfshin gjithë ato që thamë më sipër, është i tillë që lejon mundësinë e vendosjes së një bashkëpunimi të shumanshëm e shumëpalësh, jo vetëm që nuk është realist, por përfaqëson edhe një miopi politike.

Problemet e Ballkanit duhet të zgjidhen nga vetë vendet e Ballkanit pa ndërhyrjen e superfuqive dhe kundër tyre.

Ne themi dhe vazhdojmë të theksojmë se në radhë të parë është i dobishëm bashkëpunimi bilateral. Ai mund të ndihmojë në forcimin e lirisë e të pavarësisë së çdo vendi dhe të paqes e të sigurisë së përgjithshme në Ballkan. Nëpërmjet kësaj rruge dhe duke shehshuar çështjet më akute të dyanshme, mund të hapet

rruga që në një kohë të mëvonshme të shkohet edhe në një mbledhje të përbashkët. Por kushti kryesor për këtë është të përjashtohen plotësisht superfuqitë nga problemet ballkanike, të qërohen sa më parë bazat e tyre nga ky rajon, të eliminohen ata faktorë të huaj që i pengojnë popujt e Ballkanit të vendosin vetë në mënyrë sovrane për marrëdhëniet midis tyre.

Duke vënë në dukje dëshirën e popujve të Ballkanit për të jetuar të lirë në vendet e tyre, ne edhe më parë kemi theksuar: «Ta zhvillojmë miqësinë në rrugën më të përshtatshme për secilin, pa ndërhyrë në punët e brendshme të njëri-tjetrit, dhe asgjë të mos lejojmë në territoret e vendeve tona që. për një arsye ose për një tjetër, mund të cenojë ose të kërcënojë interesat e fqinjësisë së mirë».

Pozita strategjike e Ballkanit në Evropë e në Mesdhe ka tërhequr vazhdimisht lakmitë e fuqive imperialiste. Fuqitë e mëdha grabitqare e kanë quajtur Ballkanin «molla e sherrit të Evropës», «fuçi baruti», «rajoni i origjinave të luftës» etj.

Por zjarri i luftës në Ballkan nuk është ndezur vetë. Atë e kanë sjellë pushtuesit e huaj, osmanllinjtë e austro-hungarezët, carët e Ruisë e mbretërit e Anglisë, Kaizeri gjerman e Uinston Çerçilli, Italia fashiste e Gjermania hitleriane, Trumani dhe gjithfarë ujqish të tjerë imperialistë, të mëdhenj e të vegjël, që i janë vërsulur ta shqyejnë e ta copëtojnë këtë gadishull të shumëvuajtur.

Kjo histori popujve të Ballkanit u mëson shumë gjëra. Por, në radhë të parë, ajo u tregon se me gjithë dështimet që kanë pësuar fuqitë imperialiste, ato nuk

heqin dorë lehtë nga lakmitë dhe synimet e tyre grabitqare, nga përpjekjet që, kur me dhunë e kur me diplomaci, kur me intriga e kur me komplete, të futen në Ballkan e t'i vënë popujt e tij kundër njëri-tjetrit, me qëllim që t'i nënshtrojnë e të sundojnë mbi ta.

Prandaj nevoja imperative për popujt e Ballkanit dhe detyra kryesore e tyre është forcimi i vigjilencës ndaj politikës hegjemoniste e ekspansioniste të imperializmit amerikan e të socialimperializmit sovjetik, kundërshtimi i çdo ndërhyrjeje të huaj në punët e brendshme dhe i çdo influence në politikën e tyre, forcimi i pavarësisë e i sovranitetit kombëtar. Kjo do t'u shërbente njëkohësisht edhe forcimit të mirëkuptimit e bashkëpunimit të vërtetë midis shteteve të Ballkanit, vendosjes dhe ruajtjes së fqinjësisë së mirë midis tyre.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 70 (8613), 23 mars 1976

Botohet sipas gazetës «Zëri i popullit» nr. 70 (8613), 23 mars 1976

TREGUESIT

TREGUESI I LËNDËS

A

Anarkizmi, partitë e rrymat anarkiste e trockiste dhe lufta kundër tyre — 220-221, 225, 228.

Arkitektura, arkitektët — 145-149, 403-404.

Armiqtë; veprimtaria armiqësore dhe lufta kundër tyre — 6-7, 15-16, 31-32, 35, 83, 113, 184, 185, 342.

Arsimi në RPSH — programet, tekstet, lëndët mësimore; studimi i marksizëm-leninizmit në shkollë — 295-298, 304-305, 308-309, 311;

— metodat e mësimdhënies dhe të edukimit në shkollë; nxënësit, studentët, mësuesit, pedagogët dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre — 296, 304-306, 307-310, 311-313, 314, 315, 316, 358-359.

Arti Ushtarak i Luftës Popullore — 62, 72-73, 298-299, 303, 304, 308, 310, 311.

B

Ballkani, Konferenca ballkanike e Athinës për bashkëpunimin ekonomik e teknik (mars 1976) — 95-96, 467-472.

Bashkimet Profesionale të Shqipërisë — leva të lidhjes së Partisë me masat punonjëse; kompetencat; kuadrot e tyre — 43-45, 47-49, 50-51, 53-54;

— detyrat dhe roli i tyre për edukimin komunist dhe mobilizimin e punonjësve në ndërtimin socialist të vendit — 34-35, 36-37, 45-46, 47-48, 49;

— roli i tyre për popullarizimin e ligjeve të shtetit dhe për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve në punë — 47-48, 53-54.

Bashkimi Sovjetik (1917—1953), Partia Komuniste (b) e BS — 2-3, 74, 81, 122, 264, 274.

Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik — degjenerimi i

partisë, i pushtetit dhe i jetës ekonomiko-shoqërore — 96-99, 120-121, 227, 364;

- politika e jashtme social-imperialiste; përpjekjet për të forcuar hegjemoninë mbi partitë e vendet revizioniste dhe kontradiktat me to — 97-98, 100, 101-102;
- qëndrimi armiqësor ndaj RP të Shqipërisë — 79, 81-82, 122-123.

Blegtoria në RPSH — politika e Partisë për zhvillimin e blegtorisë. Baza ushqimore, kullotat — 172, 204-205, 413, 433, 434, 435-436, 445-446;

- lopa, gjedhi, bagëtitë e imëta, derri, kafshët e punës dhe shpendët. Rritja e rendimenteve në blegtori dhe e produkteve blegtorale — 174-175, 176-177, 204, 332-333, 412-414, 430, 432-433, 434, 435, 436, 438, 439.

Borgjezia e re në vendet revizioniste — 17, 373.

Bujqësia në RPSH — politika e Partisë për zhvillimin e bujqësisë. Studimet në fushën e bujqësisë — 166, 177, 405-407;

- rajonizimi dhe struktura e deqëve të saj. Specializimi dhe kooperimi në

bujqësi; rritja e rendimenteve dhe e prodhimit të përgjithshëm bujqësor — 83-89, 170-171, 172-173, 320, 407-408, 411;

- agroteknika dhe shërbimet në bujqësi. Ujitja, veprat ujtëse dhe bonifikuese. Mekanika bujqësore dhe mekanizimi i bujqësisë — 167-168, 170-171, 177-178, 256, 331-332, 402-403, 429, 438, 439;
- toka, trajtimi shkencor dhe rritja e pjellorisë së saj; hapja e tokave të reja. Hartat pedologjike — 165-166, 167, 168, 254-256, 261, 440-441;
- drithërat e bukës; problemi i sigurimit të bukës në vend. Perimet, patatja, pemëtaria, ulliri, vreshtat dhe bimët industriale — 88-89, 168-174, 175-176, 259, 320, 327-328, 411-412, 430.

Ç

Çmimet — politika e Partisë në fushën e çmimeve. Çmimet e produkteve bujqësore e blegtorale — 195, 201-202, 205.

D

Dekorimet, dekoratat. Stimujt moralë, distinktivat — 341, 345-346.

Demokracia proletare — 14, 312, 341.

Dënimi penal; arrestimi. Të dënuarit — 210, 212-214, 341.

Dëshmorët — 83, 112.

Diktatura e proletariatit; sistemi i diktaturës së proletariatit dhe roli udhëheqës i Partisë — 12, 53, 87.

Dituritë, erudicioni — 239-240, 243, 245-246, 309-310, 343, 359, 360-361.

E

Edukimi komunist — edukimi idcopolitik, moral, kulturor, patriotik dhe internacionalist — 30-31, 58, 71, 90, 347-349, 356-357;

— edukimi me dashurinë për punën dhe pronën socialiste; lufta kundër shfaqjeve të huaja — 31, 32, 203, 334;

— bindja dhe harmonizimi i saj me masën administrative — 32, 36-42, 47-48, 205-206, 257, 343.

Ekonomia popullore në RPSH — forcimi dhe balancimi i saj; shfrytëzimi i rezervave, i burimeve dhe i mundësive të

brendshme — 169, 186-187;

— masat dhe detyrat për shëndoshjen e gjendjes në ekonomi pas shpartallimit të grupit armiqësor të A. Këllezit, K. Theodhosit, K. Ngjelës etj. — 388-389, 392-394, 397-398, 417-418.

Engels, Fridrih — 91, 217, 243, 273, 291-292, 299, 300, 359.

Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 74, 77, 79, 89, 81, 82, 103, 113, 122, 215, 233, 234, 245, 248, 253, 254, 257, 266, 268, 302, 319, 322, 325-327, 432, 435.

Evropa, Evropa e bashkuar. Konferenca e Helsinkit për Sigurimin Evropian — 96-98, 99-100, 101, 111, 224, 467, 469.

F

Feja në Shqipëri, lufta kundër besimeve fetare — 343, 437.

Financat, kontrolli financiar, qarkullimi monetar — 181, 464-465.

Folklori — 114, 241.

Fondet; përdorimi i tyre me efektivitet dhe me kursim — 400-402, 403-404, 410, 448-449, 450, 452, 453, 458-459, 464.

Fshatarësia në Shqipëri. Fsha-

tarësia kooperativiste. Studimet për fshatarësinë — 194-195, 196, 201, 234-235, 324-327, 331.

Fshati socialist — 189-190, 203-204, 331.

Fuqia punëtore, politika e Partisë për fuqinë punëtore; zënia në punë e forcave të lira dhe shpërndarja e tyre në qytet e në fshat — 188-190, 203-291, 292.

G

Gruaja shqiptare — emancipimi dhe ngritja e saj në përgjegjësi. Gruaja kooperativiste — 252-253, 288, 328-329, 430-431, 436, 437.

Grupet armiqësore antiparti dhe lufta për shpartallimin e tyre

— grupi armiqësor komplotist e puçist i B. Ballukut, P. Dumes, H. Çakos etj. në ushtri — 1-2, 4, 7, 16, 57-58, 59, 61, 68, 72, 84, 86, 232, 272-273, 303, 305, 306, 317;

— grupi armiqësor sabotues i A. Këllezit, K. Theodhosit dhe i K. Ngjelës në ekonomi, në sektorin e naftës dhe në tregti — 84-85, 154, 155, 158, 159, 161, 187, 232, 267, 272-273, 354, 381, 388-389,

392, 393, 394, 395, 396, 397, 398, 399-400, 416, 417-418, 465.

GJ

Gjuha shqipe; studimet në fushën e gjuhësisë; gjuhëtarët — 240-241, 243-245, 360, 361.

Gjykatat popullore, Gjykata e Lartë, gjyqtarët — 7, 27-29, 40, 41, 211, 212-213.

H

Hetuesia, hetuesit — 207-208, 209, 210-212, 213, 214.

Historia e popujve të botës; historia si shkencë — 102, 234, 236, 239-243, 244-246, 299-301, 361-362, 471-472.

Historia e Shqipërisë — studimet për ilirët dhe periudhat para dhe pasilire. Historianët. Historianë dhe studiues të huaj të historisë së Shqipërisë — 53, 71, 234-246, 296-298, 355-356, 359-360, 361-362.

Historia ushtarake — 297-298, 299-301, 302-303.

I

Industria e lehtë dhe ushqimore në RPSH — 203, 410, 412.

Industria e rëndë në RPSH. Industria energjetike (elektrike dhe e qymyrgurit) — 159, 162-164, 165, 396, 398-400;

- industria minerale (e kromit, e bakrit, e hekur-nikelit dhe e metaleve të çmuara) — 158-161, 162-163, 399;
- industria mekanike dhe kimike — 163, 164, 178, 265, 266.

Shih edhe: Nafta dhe gazi...

Intelektualizmi, teknokratizmi dhe indiferentizmi — 33, 42, 179-180, 183-184, 306-307, 311.

Inteligjencia; lufta kundër shfaqjeve të huaja në radhët e saj — 183-184.

Investimet — 400-402, 410.

J

Jetesa dhe mirëqenia në shoqërinë tonë socialiste — 89-90, 192-196, 201, 205-206.

Jugosllavia, revizionizmi jugosllav. Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë — 112, 118-119, 363-365, 366, 367-368, 369-371, 372, 375;

- degjenerimi i partisë, i pushtetit dhe i gjithë jetës së vendit; vetadmirimi jugosllav. Grindjet nacionale në Jugosllavi — 46, 77-78, 93-95, 118-119, 227, 364-375;

- politika e jashtme demagogjike; qëndrimi armiqësor ndaj RP të Shqipërisë — 85, 93, 94-95, 119-120, 364.

K

Kamboxhia — 107, 108-109, 111, 113, 116, 119, 123.

Kapitalizmi — shfrytëzimi i njeriut prej njeriut; papunësia — 284, 289, 292.

Këshillat popullorë dhe komitetet ekzekutive; kompetencat, metoda dhe stili i tyre në punë — 169, 176, 182, 287, 289-291, 330-331, 339-340, 419;

- këshillat popullorë të fshatrave dhe të fshatrave të bashkuara. Këshilltarët — 337-338, 339-340;

- Komiteti Ekzekutiv i KP të Rrethit të Beratit — 322, 323, 327-329, 330-331, 333;

- Komiteti Ekzekutiv i KP të Rrethit të Lezhës — 428, 431-432, 433, 438, 446.

Këshilli i Mbrojtjes i RPSH — 71, 307, 311, 317.

Këshilli i Ministrave (Qeveria), Kryesia e Këshillit të Ministrave — 84, 89, 114-115, 152, 155, 158, 166, 167, 169, 172, 173, 174, 176, 181, 182,

- 187, 188, 191, 197, 202, 206, 345, 388, 390, 393, 394, 408, 409, 410, 411, 416-417, 419, 446, 451, 453, 458, 460, 461-462, 464, 465, 466, 467-468.
- Kina* — gjendja e brendshme; *Partia Komuniste (revizioniste) e Kinës; Revolucioni i madh Kulturor Proletar dhe lufta e grupeve për pushtet* — 215-233, 273-282;
- politika e jashtme koniunkturale; qëndrimi ndaj B.S. Qëndrimi ndaj partive marksiste-leniniste — 121, 222-225, 226-228, 229-230, 272-273, 278, 280;
 - presionet politike dhe ekonomike ndaj RP të Shqipërisë — 225, 230-233, 259, 270-273, 281-282.
- Klasa punëtore në Shqipëri* — roli i saj udhëheqës dhe kontrollues; edukimi komunist, kualifikimi dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja në radhët e saj — 36-39, 45, 46-47, 53-54, 164-165, 184, 196, 275.
- Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale. E drejta e punës. E drejta e procedurës penale* — 29, 208-213, 341, 344.
- Komunikacionet, transportet* — komunikacioni automobili-
stik dhe hekurudhor — 414-416.
- Komunisti* — cilësitë, virtytet moralo-politike dhe roli i tij udhëheqës — 44, 50, 139, 141-142, 264, 329-330, 357.
- Kontradiktat në arenën ndërkombëtare* — 90-93, 95, 97-102.
- Kontrolli i Partisë, i shtetit, i klasës punëtore dhe i masave* — 25, 49, 53-54, 143-144, 183, 185-186, 330, 333, 390-391;
- grupet e kontrollit punëtor e ishatar — 23-26, 140-141.
- Kooperativat bujqësore*
- organizimi dhe drejtimi i punës në kooperativat bujqësore; marrëdhëniet e tyre me shtetin — 202-203, 406-409;
 - organet drejtuese, kuadrot dhe specialistët; kooperativistët dhe pjesëmarrja e tyre në punë; të ardhurat në kooperativat bujqësore — 173, 325, 327, 328-329, 338-340, 429-432, 433-434;
 - kooperativat bujqësore të zonave malore e gjysmëmalore; zhvillimi e fuqizimi i tyre — 204-205,

323-324, 325, 327-328, 332-333, 335-336, 429-432.

Krimet, shfaqjet e kriminilitetit në Shqipëri dhe masat për parandalimin e tyre — 27-42, 334, 341.

Kritika dhe autokritika — 65-66, 127, 134, 357, 409-410, 449.

Kuadrot, specialistët — politika e Partisë me kuadrin; përgatitja, zgjedhja dhe vendosja e tyre; ngritja e kuadrove të rinj nga radhët e klasës punëtore — 182-183, 196-198, 200-201, 248-249, 261, 267-268;

— kuadrot e Partisë. Përgatitja dhe zgjedhja e kuadrove të rinj — 127-132, 134-136, 200-201, 248-249, 391;

— edukimi ideopolitik dhe kualifikimi profesional; lufta kundër shfaqjeve të huaja; dhënia llogari para masës — 140-142, 157, 161-162, 164-165, 183-184, 252, 391-392.

Kultura në RPSH — institucionet kulturore e artistike; kënga dhe muzika — 114, 148, 437.

Kushtetuta, Projektkushtetuta e RPS të Shqipërisë — 10-22, 270, 283, 342, 343, 446.

Kuvendi Popullor, deputetët; Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe aparati i tij — 7, 10, 11, 13-14, 16-17, 18-19, 21, 22, 270, 337-338, 342, 344, 345.

L

Lenin, Vladimir Iliç — 3, 23-24, 44, 45, 51, 53, 54, 90, 91, 100, 102, 121, 196, 211, 217, 220, 221, 229, 264, 273, 274, 299, 359.

Letrat, kërkesat dhe ankesat e popullit; puna me letrat — 351, 353-354, 355.

Lëvizjet dhe luftërat çlirimtare dhe revolucionare të popujve — 90-93, 96, 102.

Libri dhe puna me librin. Literatura e huaj, studimi dhe qëndrimi kritik ndaj saj — 253-254, 302, 356-357, 359.

Ligjet, ligjshmëria në RPSH — njohja dhe zbatimi i tyre; lufta kundër shkelësve të ligjeve — 40-41, 207, 208, 211, 213-214, 341-342.

Lufta Antifashiste Nacional-çlirimtare e popullit shqiptar; përvoja dhe mësimet e saj — 11, 63, 71, 251, 296, 309-310, 325-327.

Lufta e klasave dhe roli i diktaturës së proletariatit e i Partisë në zhvillimin e saj — 1-7, 15, 31, 35, 84-88, 182-185, 278, 333.

Lufta, shkaqet dhe shkaktarët e shpërthimit të saj — 98-99, 100-101.

M

Marksizëm-leninizmi — udhëheqje për veprim, studimi dhe zbatimi i tij — 183-184, 295, 299-299, 303-309, 359.

Marks, Karl — 91, 183, 211, 217, 218, 220, 221, 241, 273, 291, 299, 300, 359, 427.

Masat popullore — roli i tyre vendimtar në socializëm — 14, 50.

Mbrojtja e atdheut — përgatitja dhe forcimi i gatishmërisë së popullit, të ushtrisë dhe të të gjithë vendit për mbrojtje — 15-16, 62, 87, 89-90, 103-104, 105.

Metoda dhe stili në punë — 161-162, 178-180, 185-186, 253, 257, 266, 267-268, 320-321, 323-324, 339-340, 348-350, 354-355, 389-390, 391, 393-396, 401, 408-409, 441-442.

Metoda materialiste dialektike në trajtimin e fenomeneve të shoqërisë. Analiza dhe sinteza — 235-246, 358-362.

Ministritë dhe kuadrot e tyre — 34, 161-162, 163-164, 179, 287, 388, 390, 401, 404, 417, 419, 423, 454, 455-456;

— *Ministria e Mbrojtjes Popullore. Komiteti i Partisë* — 59, 66-67, 198-199, 314;

— *Ministria e Punëve të Brendshme dhe kuadrot e saj. Komiteti i Partisë* — 41-42, 138-139, 143, 144, 199;

— *Komisioni i Planit të Shtetit* — 84, 152, 166-167, 290, 388-389, 390, 393, 394, 396, 397-398, 404, 410, 415, 419, 450, 451, 452, 453, 455-456, 460, 461-462, 465-466;

— *Ministria e Financave* — 181, 465-466;

— *Ministria e Industrisë dhe e Minierave* — 155, 160-161, 162-163, 397, 398, 450, 452-453, 454, 455, 456, 457;

— *Ministria e Bujqësisë* — 8, 152, 153, 166, 169, 176, 177, 323, 405, 407-408, 409, 410, 433, 438;

— *Ministria e Ndërtimit* — 152, 167, 179, 180-181, 400, 404, 451-452, 454, 457, 458, 459, 461, 462, 463, 464, 465;

— Ministria e Tregtisë —
85, 159, 187, 418.
Minoriteti grek në Shqipëri —
342-343.

N

Nafta dhe gazi; gjeologjia e naftës; shpim-kërkimet dhe shpim-shfrytëzimet për naftë e gaz; kuadrot e specialistët e naftës — 154-158, 162, 163, 266-267, 322, 377-385, 396-397, 415-416, 440.

Ndërmarrjet bujqësore e blegtorale — 153, 154, 413-414.

Ndërtimet në RPSH — politika e Partisë në fushën e ndërtimeve — 178-180, 400-402, 403-405, 461;

— organizimi, drejtimi dhe kontrolli i punës në fushën e ndërtimeve — 178-180, 181-182, 403-404, 448-465;

— projektuesit, preventivuesit, zbatuesit (ndërtuesit), investuesit; lidhjet dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre — 152, 180-182, 400-401, 403-405, 448-465, 466;

— ndërtimi i hidrocentraleve, i termocentraleve dhe i objekteve të tjera industriale; ritmet e ndërtimeve. Teknikët dhe

specialistët e ndërtimit — 165, 179-180, 401, 402, 410.

Ndërtimi i socializmit në Shqipëri; politika e Partisë për ndërtimin socialist të vendit — 11-13, 109-110, 202-203, 292-293, 325, 406.

Ngushtimi i dallimeve thelbësore ndërmjet fshatit dhe qytetit — 175, 189-190, 192-206.

O

Opinionit shoqëror — 27-28, 30, 37.

Oportunizmi (djathtëzimi) — 221, 369.

Organet e Punëve të Brendshme — roli udhëheqës i Partisë. Organizatat dhe komitetet e Partisë në to. Platforma e punës së tyre. Punonjësit dhe kuadrot e organeve të PB — 41-42, 137-144;

— Sigurimi i Shtetit. Policia — 139, 141-142, 144.

Organizata — bazë e Partisë — gjallërimi, revolucionarizimi; forcimi i unitetit dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja në të — 29-30, 33, 49, 65, 142, 319, 329-330, 350.

Organizatat e masave; roli udhëheqës i Partisë — 29-30, 33, 45, 49-50.

Organizimi dhe drejtimi i punës e i prodhimit — 30, 31-32, 90, 126-127.

P

Paga — politika e Partisë në këtë fushë; masat për ngushtimin e dallimeve ndërmjet pagave — 175, 193, 195-201, 205-206;

— paga nominale dhe paga reale. Zbatimi i shpërblimit sipas sasisë dhe cilësisë së punës. Honoraret dhe shpërblimet për të drejtën e autorit — 181, 196-198, 199-201, 444-445.

Partia e Punës e Shqipërisë — lufta e klasave në Parti — 35;

— qëndrimi ndaj të metave e gabimeve dhe ndaj elementëve që gabojnë e bëjnë faje — 1-6, 152, 182-183, 186, 334-335, 389-390;

— ndërrimi i dokumenteve në Parti. Përjashtimet nga Partia; apeliomet nga të përjashtuarit — 263, 264, 345-346, 351-354.

Partia e Punës e Shqipërisë — organet udhëheqëse qendrore e lokale

— Kongresi VI i PPSH (1-7 nëntor 1971) — 12, 13, 168;

— Komiteti Qendror, Byroja Politike dhe Sekretariati i KQ — 13, 14, 16, 17, 57, 59, 60-61, 66, 67, 68, 79, 80, 84, 87, 89, 92, 96, 103, 130, 137, 145, 167-168, 170, 171, 176, 180, 182, 206, 207, 233, 249, 250-251, 252, 264, 270, 313, 316, 317, 318, 328, 330, 332, 344, 345, 349, 351, 390, 392-393, 394-395, 397-398, 405, 407-408, 409, 411, 420, 425, 431, 441-442, 446, 452;

— Komisioni Qendror i Kontrollit dhe i Revizionimit të Partisë. Komisionet e kontrollit dhe të revizionimit të Partisë në rrethe — 347, 350-353.

— Plenumi i 5-të e i 6-të (1974) dhe i 7-të e i 8-të (1975) të KQ — 5;

— aparati i KQ të Partisë; organizata-bazë e Partisë në të — 17, 30, 44, 61, 66, 140, 200-201, 347-350, 352, 355, 357, 358;

— komitetet, plenumet, byrotë e komiteteve të Partisë në rrethe dhe anëtarët e tyre — 124-136, 143-144, 200-201, 352;

— organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Be-

- ralit — 322, 330-331, 333, 335-336;
- organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Lezhës — 431-432, 442-443, 445-446;
 - organizata, Komiteti dhe Byroja e Partisë e Rrethit të Lushnjës — 247, 250, 252, 262-263, 264, 266, 267-268;
 - organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës — 135, 354.
- Partia e Punës e Shqipërisë**
- *vija, vendimet dhe direktivat; organizimi dhe jeta e brendshme*
 - Statuti i Partisë, vija, vendimet e direktivat e saj; njohja dhe zbatimi i tyre — 15, 38, 60-61, 80, 87, 88, 286-287, 307, 315, 375-376, 409, 420, 423, 427;
 - roli udhëheqës dhe forcimi i Partisë — 11, 65, 84, 137-144;
 - lidhjet e Partisë me masat, informimi i masave; uniteti në Parti dhe në udhëheqje — 7, 79-80, 84, 88;
 - puna e Partisë, përmbajtja e saj; kapja pas hallkës kryesore — 31-32, 161-162, 315, 350, 390, 400;
 - pranimet në Parti — 88, 263, 264-265;
 - studimet, raportet dhe materialet për organet udhëheqëse — 125-126, 191-192, 350, 392-394, 395-396, 422, 425.
- Partia e Punës e Shqipërisë**
- *strategjia dhe taktikat në arenën ndërkombëtare. Analiza marksiste-leniniste dhe qëndrimi parimor ndaj gjendjes ndërkombëtare* — 79-80, 90-93, 95-97, 100, 117-118, 365-366.
- Pensionet** — 198-199, 200.
- Planifikimi, planet** — *metodologjia e planifikimit; organet e planifikimit; përmirësimi i planeve, pjesëmarrja e masave në hartimin dhe plotësimin e tyre* — 151-190, 258-259, 387-388, 392-396, 402-403, 418-420, 451-453, 455-458, 460-461, 465;
- planifikimi, planet në kooperativat bujqësore, realizimi i tyre — 7-9, 253-259;
 - plani i pestë pesëvjeçar (1971-1975). Projektplan i gjashtë pesëvjeçar (1976-1980) — 151-160, 386-388, 393-404, 409, 411-421, 461.
- Politika dhe teknika, politika në plan të parë; kuptimi po-**

- litik i problemeve* — 46, 59-51, 67, 68-69.
- Politika e jashtme parimore e RPSH* — 73, 92-93, 95, 104-105, 108, 111, 119, 120, 121, 467-468, 470-471;
- demaskimi i imperializmit, i revizionizmit dhe i reaksionit — 16, 91, 99-100, 365-366, 471-472;
 - përkrahja internacionaliste për lëvizjen marksiste-leniniste dhe luftërat revolucionare e çlirimtare të popujve — 102, 104, 105, 107-108, 109, 110-111, 113-114, 117-118, 123, 375-376;
 - qëadrimi ndaj BS dhe lufta për demaskimin e revizionistëve sovjetikë — 79-81, 103, 113, 121, 122-123;
 - marrëdhëniet me vendet fqinje (me Greqinë dhe Jugosllavinë); demaskimi i revizionistëve jugosllavë — 85-86, 93, 94, 95-96, 119-120, 363-364, 365-366, 375, 467-468, 471;
 - marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj Kinës; demaskimi i revizionistëve kinëzë — 222-223, 225, 227-229, 230-233;
- përkrahja internacionaliste e popujve për RP të Shqipërisë. Të huajt, miqtë për Shqipërinë — 103-104, 105, 109-110, 270.
- Populli shqiptar — traditat, cilësitë, virtytet moralopolitike; pjesëmarrja dhe roli i tij në Luftën Nacionalçlirimtare dhe në ndërtimin socialist* — 11-12, 21, 87, 104, 108, 109, 114;
- të dhëna demografike dhe onomastike — 284-289, 342.
- Prodhimi material — cilësia dhe sasia e prodhimit* — 422-423, 444-445.
- Prokuroria, Prokuroria e Përgjithshme, prokurorët* — 27, 40-41, 207-211, 213-214.
- Propaganda dhe agjitacioni* — 262, 419, 420-421.
- Propaganda dhe shtypi borjezo-revizionist* — 76-77, 225-226, 230, 270-272, 280, 342, 343, 469, 470.
- Puna — kuptimi dhe rëndësia e saj; puna ullnetare* — 51-53, 291-293, 334;
- normat, normimi i punës në bujqësi dhe normativat e harxhimit të karburanteve — 199, 200, 403, 410, 415, 440, 444-445.

R

Regjimi i kursimit — 415-416, 440, 451-452, 463-464.

Rendimenti i punës — kush-tet dhe faktorët për rritjen e pandërprerë të tij — 417.

Revizionizmi modern. Partia revizioniste e Francës, e Italisë dhe ajo e Spanjës — 101, 223, 228-229.

Rinia dhe Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë — cilësitë moralo-politike të rinisë; edukimi i saj me dashurinë për punën e fshatin dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja — 29-30, 35-40, 169-190, 316, 334, 344.

RR

Rrethimi, bllokada e presioni imperialisto-revizionist dhe lufta për përballimin e tyre — 6-7, 192, 320, 324-325.

S

Sekreti, konspiracioni; sekreti ushtarak — 62, 63, 138, 139, 140, 141-143, 354.

SMT (Stacioni i makinave dhe i traktorëve), traktoristët — 177-178, 202, 440-441.

Spontaneiteti dhe zhvillimi i ndërgjegjshëm — 405-406, 408.

Stalin, Josif Visarionoviç — 3, 79, 80, 81, 85-86, 91, 122, 217, 227, 273, 299, 359.

Superfuqitë — politika e tyre demagogjike dhe hegjemoniste; kontradiktat ndërmjet tyre — 91, 96-99, 110-111, 118, 468-472.

SH

Shfaqjet e huaja dhe lufta kundër tyre — 2, 3-4, 264-265, 329.

Shkenca, shkencat e antropologjisë — 361-362.

Shkollat ushtarake; revolucionarizimi i mëtejshëm i tyre — 294-299, 304-317.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës — politika e jashtme, krizat — 90-99, 101, 102.

Shtypi në RPSH. Shtypi ushtarak — 55-61, 63, 61-66, 70, 71-72, 73-75, 299, 301, 401, 412.

T

Teorja dhe praktika — uniteti dialektik i tyre — 121, 295-296, 310, 358-359.

Teoritë e pikëpamjet borgjezo-revizioniste për partinë politike të klasës punëtore e rolin e saj udhëheqës dhe kritikë ndaj tyre — 46;

— kritikë pikëpamjeve të revizionistëve kinezë për revolucionin dhe forcat lëvizëse të tij, për rrugën paqësore, për teorinë e «lulëzimit të 100 luleve» dhe atë të «tri botëve»; «Maocedunideja» — 92, 213-225, 223-229, 274-275, 277, 278, 279.

Tregtia e brendshme — shpërndarja e prodhimeve, furnizimi i popullsisë. *Tregu i vogël fshatar* — 182, 203-204, 446.

Tregtia e jashtme — eksporti, importi; organet e tregtisë së jashtme dhe punonjësit e tyre — 152, 163-164, 189-193, 416-418.

U

Uniteti i popullit, ushtri
Parti—popull — 34, 114-115, 264, 329.

Ushtria Nacionalçlirimtare; Shtabi i Përgjithshëm, Komanda e Përgjithshme. Lufta e dy divizioneve të saj për çlirimin e Kosovës dhe të krahinave të tjera në Jugosllavi — 63, 83, 112, 336.

Ushtria popullore — roli udhëheqës i Partisë; organizatat dhe komitetet e Partisë në ushtri — 4, 59-61, 65, 66-69, 314-315, 316;

— tiparet, karakteri popullor. *Strategjia dhe taktikat; njohja e armikut (e strategjisë, e taktikës dhe e armatimit të tij)*

— 61-62, 298, 301-302, 303-304, 308, 310-311, 314; — kuadrot ushtarakë dhe ushtarët; përgatitja ideopolitike, ushtarake dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre — 2-6, 58-60, 82, 63, 66-68, 70-71, 295, 299-300, 301, 303-304, 306, 309-310, 314, 315, 316;

— masat dhe puna për shëndoshjen e gjendjes në ushtri pas zbulimit të shpartallimit të grupit komplotist të B. Ballukut, P. Dumes, H. Çekos etj. — 72-73, 86, 316-317.

V

Vendet revizioniste — papunësia, grevat. *Depërtimi i kapitaleve të huaja. Përpjekjet e tyre për të shpëtuar nga hegjemonizmi sovjetik* — 17, 29, 53, 97-98, 284, 289.

Vigjilanca revolucionare — 1, 5, 64, 64, 86, 99, 104, 113, 182-183, 184-185, 354, 472.

Vija e masave — tërheqja e mendimit dhe dëgjimi i zërit të tyre — 14, 18-21, 45, 87, 88.

TRËGUESI I EMRAVE

A

- Alia, Ramiz — 61. 363
 Aleksandri i — 297. 302.
 Aleksis i Pashë, Komaneni —
 245, 356.
 Anteni, Mark — 362

B

- Bashir, Mihal — 329 365
 Baku, Baqir — 1. 3. 16, 37,
 79, 81, 92, 95, 134, 232, 273,
 303 305, 306, 317
 Bardhi, Let — 318-319, 326
 Barleti, Mërisë -- 146
 Bekteshi, Sadik --
 Bendit, Kon — 226
 Berra, Lavrentiev --
 Blyher, Gebhard — 363.
 Bonaparti, Napoleon --
 362, 363.
 Bozhiqi, Halil — 325-326.
 Brezhnjev, Leonid — 231, 277.
 Buda, Aleks — 147.

C

- Cezari, Jul — 362.
 Curri, Bajram — 71.

Ç

- Çako, Lenka — 197-253, 255,
 259-257, 259, 299-363, 295-
 -296, 297-299.
 Çako, Hito — 1. 15, 37, 39,
 61, 72, 273, 305, 306, 317.
 Çan Çun Çiao — 279, 289.
 Çan Kai Shi -- 222.
 Çausheku, Nikolae — 113-
 -117, 224, 273.
 Çeta, Ramë — 325.
 Çeka, Sherif — 325.
 Çen Po To — 181, 272.
 Çërcilli, Uinston — 471.
 Çian Çin — 236.
 Çudari, Sofie — 322.
 Çu En Lai — 217, 220, 222,
 256, 251, 276, 277, 278, 279,
 280, 281.

D

- Dash, Lul Nikola --- 303.
 Disha, Aban -- 325.
 Disha, Ali — 325.
 Disha, Zenel — 325.
 Dodbiba, Pirro — 152, 153-
 -154, 166, 167, 168, 170, 176,
 405, 403, 409.
 Dode, Petro — 463.

Dragoti, Shinasl — 448, 453.
Dume, Petrit — 1, 3, 16, 57,
59, 61, 273, 305, 306, 317.

F

Franko, Françisko — 96, 100,
224, 226, 278.

G

Grushi, Emanuel — 303.

GJ

Gjoni, Marie — 426-429, 430,
431.
Gjura, Ali — 326.

H

Hanžaj, Zalo — 320, 321-322.
Han, Johan — 361.
Hazbiu, Kadri — 208.
Hitler, Adolf — 100.
Hith, Eduard — 224.
Hrushov, Nikita — 80, 91, 103,
120, 122, 217, 228, 230, 232,
273, 277.

I

Isai, Hekuran — 124, 127, 133,
181, 268, 352.
Isufi, Budo — 178.

J

Janekoviç, Dara — 363, 365,
367, 368, 369-371, 372, 373,
374,
Jeh Çien Jin — 233.

K

Kapo, Hysni — 11, 13, 268, 352.
Koleka, Spiro — 463.
Kanapari, Shyqyri — 178,
439-440.
Kanrober, Fransua — 300-301.
Karagjorgjeviç — 94.
Karagjozi, Ramë — 326, 327.
Karalliu, Baki — 443.
Karriljo, Santiago — 226.
Kastro, Fidel — 229.
Kavur, Kamilo Benso — 300.
Këllezi, Abdyl — 1, 159, 184,
188, 232, 273, 288, 388, 392,
393, 394, 395, 399, 416, 417,
418, 465.
Kolontaj, Aleksandra — 44.
Komneni, Ana — 245, 356.
Konfuci — 280.
Kozlov, Frol — 120-121.

L

Lin Biao — 221, 277, 273, 279,
280, 281.
Li Hsien Nien — 220, 279.
Li Li San — 274, 275, 279.
Liu Shao Çi — 216, 217, 220,
221, 223, 276, 277-278, 279,
280.
Luli, Dedë Gjo — 71.

LL

Lleshi, Haxhi — 110.

M

Marko, Rita — 49.
 Miska, Pali — 159, 173, 377-
 -381, 383.
 Mihali, Qirjako — 37, 155.
 Malenkov, Georgi — 79, 81.
 Mao Ce Dun — 216-218, 219-
 -220, 221, 222, 223, 224, 225,
 229, 230, 232-233, 274, 276,
 277, 278, 279, 280, 281.
 Marashi, Ndue — 184.
 Mikojan, Anastas — 79, 81,
 103, 120.

Mobutu, Sese Seko — 96.
 Molotov, Viaçeslav — 217.
 Muça, Mentor — 432, 443, 445.
 Musolini, Benito — 100.

N

Nagi, Imre — 82.
 Napoleoni III, Charl Lui Bo-
 napart — 300.
 Nashi, Lipe — 188.
 Neji, Mishel — 303.
 Ngjela, Kiço — 159, 161, 187,
 189, 416, 417, 418.
 Noli, Fan — 146.

P

Pen Çen — 217.
 Pin De Hua — 276, 277.

Pinoçet, Augusto — 224, 278.
 Prudon, Pier — 220, 365.

R

Reka, Iljaz — 262.

S

Skënderbeu, Gjergj Kastrioti
 — 146, 245, 297, 356.
 Spahiu, Xhafer — 197.
 Sartr, Zhan Pol — 225.
 Sihanuk, Norodom — 107, 109,
 110, 111, 113, 114, 115, 116.
 Sult, Nikola — 303.
 Suslov, Mihail — 82, 103.

SH

Shehu, Feçor — 203.
 Shtirner, Maks — 220.
 Shtjefni, Tone — 432, 433-434,
 435, 436-438.
 Shtylla, Behar — 230.

T

Toska, Haki — 266, 268, 423-
 -424, 448, 453.
 Ten Hsiao Pin — 217, 220, 222,
 230, 276, 277, 278, 279, 280,
 281.
 Tito, Josip Broz — 46, 77-78,
 85, 93, 94, 118, 224, 227, 273,
 363, 364, 365, 366, 367-369,
 370, 371, 372-375.
 Truman, Harri — 471.

TH

Theodhosi, Koga — 1, 154,
179, 184, 303, 392, 393, 395-
396, 398, 416, 465.

U

Uhas (mbretë) — 245.
Uelington, Artur — 303.

V

Van Han Van — 200.
Van Min — 274, 275, 279.

Viktor Emanueli II — 300.
Voban, Sebastian — 147.
Vuka, Mirika — 443-444, 445.

Z

Ziu, Vangjel — 322-323.
Zogu, Ahmet — 359, 434.
Zyberi, Idriz — 438-441.

ZH

Zhitkov, Todor — 225.

REGJISTRU I GJEOGRAFIK DDBE I EMËRTIMEVE TË TJERA

A

- Adriatik (deti ~) — 119.
 Afrikë — 108, 121-122.
 Akademia Ushtarake, Tiranë
 — 74, 296, 309, 311, 312, 314,
 315.
 «Aleksiada» (libri ~, A.
 Komneni) — 245, 356.
 Amerikë Latine — 168.
 Athinë — 467.
 Austriacë (Çekoslovaki) —
 302.
 Australi — 92.
 Austri — 102, 302.
 Azi — 166.

B

- Banka e Shtetit Shqiptar —
 179, 359, 455, 463, 464.
 «Bashkimi» (gazeta ~) — 59.
 Berat — 264, 320, 323-325, 327-
 -328.
 Bizant — 245, 356.
 Britania e Madhe — 97, 102,
 471.
 Budapest — 82.
 Bullgari — 226, 469.
 Banë (dorni ~) — 119.

Bishti i Pallës [Kepi i Pallës]
 (Durrës) — 245, 354, 355-356.

C

«Citate të Marksit, të Leninit
 e të Stalinit mbi luftën» (li-
 bri ~) — 299.

Ç

Çekoslovaki — 95, 103.

D

Deti i Zi — 81.
 Dëbër — 170, 445.
 Drejtoria e Përgjithshme e
 Ekenomisë Komunale — 454.
 Drejtoria e Punës dhe e Pa-
 gëve — 422-423.
 Durrës [Dyrrakium] — 29, 245,
 260, 266, 267, 356, 362.

DH

«10 Korriku» (revista ~) —
 61, 70, 71, 74, 75.

E

Eqipt — 116, 272.

F

- Fabrika e Margarines, Fier — 175.
 Francë — 97, 101, 102, 147, 300.
 Fusha e Gjirokastrës — 170-171.
 Fusha gazmbajtëse e Divjakës, Lushnjë — 267.

G

- Greqi — 85, 95, 102.
 Grupi Komunist i Korçës — 133.
 Guomindan (Partia Nacionaliste) — 274.

GJ

- Gjermani — 147, 471.
 Gjermania Lindore (RD Gjermane) — 101.
 Gjermania Perëndimore (RF e Gjermanisë) — 97, 101.
 Gjirokastër — 148, 434.

H

- Hekurudha Elbasan—Përrenjës — 458.
 Hidrocentrali i Smokthinës, Vlorë — 458.
 Historia e Shqipërisë (teksti ~, vëll. I dhe II) — 235.
 Hoxharë (këneta ~), Fier — 167, 402.

HISINHUA (Agjencia Kina e Re) — 271.

Hungari — 82, 470.

I

«Ideologjia gjermane» (K. Marks — F. Engels, vepra ~) — 292.

Instituti i Naftës e i Gazit, Fier — 323.

Instituti i Studimeve dhe i Projektimeve të Urbanistikës dhe Arkitekturës — 463.

Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH — 299.

Itali — 470, 471.

Izrael — 117, 118.

J

Jordani — 117.

K

«Kapitali» (K. Marks, vepra ~) — 291.

Karavasta (Lushnjë) — 167, 402.

Këneta e Durrësit — 168.

Kili — 278.

KNER (Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke) — 93, 99-100.

Kombinati i Mishit, Tiranë — 458.

- Kombinati Metalurgjik [Kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë»], Elbasan — 163, 180, 186.
- Komisioni i posaçëm për hartimin e projektkushtetutës së re të Republikës Popullore të Shqipërisë — 10-11, 13-14, 16-17, 18-22.
- Komuna e Parisit (1871) — 196, 300.
- Komunikata e Gjykatës së Lartë të RPSH për dënimin e grupit armiqësor, komplotist e puçist të B. Ballukut, P. Dumcs e H. Çakos në ushtri (14 nëntor 1975) — 7.
- Konferenca e Vjenës për «pakësimin e ekuilibruar të ushtrive» (janar 1973) — 111.
- Kongresi i 10-të i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë — 365, 370.
- Kongresi i Manastirit (1903) — 71.
- Kongresi i 8-të i Partisë Komuniste (revizioniste) të Kinës — 217.
- Kooperativa bujqësore e Bllinishtit, Lezhë — 440.
- Kooperativa Bujqësore e Karkanjazit, Berat — 320, 323-324.
- Kooperativa Bujqësore e Kashiçit, Lezhë — 427-432.
- Kooperativa Bujqësore e Këmishtajt, Lushnjë — 8, 252, 259.
- Kooperativa Bujqësore e Kuttallisë, Berat — 319-320, 324.
- Kooperativa Bujqësore e Lumasit, Berat — 324.
- Kooperativa Bujqësore e Mbrakullës, Berat — 324.
- Kooperativa Bujqësore e Roshnikut, Berat — 324.
- Kooperativa Bujqësore e Sinjë, Berat — 324.
- Kooperativa Bujqësore e Shëngjergjit, Tiranë — 184.
- Kooperativa Bujqësore e Tërpanit, Berat — 324.
- Kooperativa Bujqësore e Tiptit të Lartë e Plasës, Korçë — 407, 408.
- Kooperativa Bujqësore e tipit të lartë «J.V. Stalin» e Krutjes, Lushnjë — 251-252, 259.
- Kooperativa Bujqësore e Tomorit, Berat — 323-324.
- Kooperativa Bujqësore e Troshanit, Lezhë — 432-438.
- Korçë — 77, 85, 434.
- Kosovë — 112.
- Kroaci — 94, 367.
- Krujë, Kalaja e Krujës — 146, 147.

L

- Lezhë — 438, 446.
- Liban — 118.

Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë — 199.
 Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881) — 71.
 Lufta (beteja) e Austerlicit (1805) — 302.
 Lufta (beteja) e Vajkalit (1465) — 149.
 Lufta (beteja) e Vaterlosë (1815) — 302-303.
 Lufta e Albulenës [beteja në Ujë të Bardhë] (1457) — 149.
 Lufta e Krimesë (1853-1856) — 300.
 Lufta e Madhe Patriotike e BS (1941-1945) — 74.
 Lufta partizane — 297.
 «Luftëtari» (gazeta ~) — 55, 57, 60, 61, 70.
 Lushnjë — 252, 254-256, 257, 258, 259, 260, 261, 262, 265.

M

Mali i Zi — 112.
 Mallakastër (Fier) — 402.
 Mbledhja e partive Komuniste e punëtore në Moskë (nëntor 1957) — 103, 217.
 Mbledhja e 81 partive komuniste e punëtore në Moskë (nëntor 1960) — 121.
 «Mémorial des Siècles» [Kujtime të shekujve] (seria ~) — 245.
 Mjeshtë (zona ~) — 471.

Milot (Krujë) — 445.
 Miniera e Qymyrgurit e Valiasit, Tiranë — 159.
 Miniera dhe Fabrika e Pasurimit të Hekur-nikelit në Gur të Kuq, Pogradec — 458.
 Mont Sen Zhan (Belgjikë) — 303.
 Moskë — 79, 80, 81, 82.
 Muzeu i Gjergj Kastriotit — Skënderbeut, Krujë — 145-150.
 Myzeqe — 248, 250.

N

NATO (Pakti i Atlantikut Verior) — 99, 224, 468.
 Ndërmarrja Eujqësore, Lezhë — 443-445.
 Ndërmarrja bujqësore «29 Nëntori», Lushnjë — 269.
 Ndërmarrja e Rritjes së Gjedhit, Maliq — 414.

O

«Origjina e familjes. e pronës private dhe e shtetit» (F. Engels, vepra ~) — 243.
 Osmanllinjë — 147, 471.

P

Palestinë — 117.
 Patos (Fier) — 157.
 Perisnak (Berat) — 329.
 «Për mbrojtjen e atdheut» (revista ~) — 61, 70, 71, 74.

- Piemont (mbretëria — Shkolla e lartë e bashkuar e
300. oficerëve «Enver Hoxha», Ti-
Poloni — 226. ranë — 309-309, 315.
-Pravda» (gazeta ... — 54 Shkolla e lartë e Partisë «V.I.
Lenin», Tiranë — 308.
Shkolla e mesme ushtarake
«Skënderbej», Tiranë — 295-
-296.
Qipro — 168. Shmil (Elbasan) — 325, 326-
-327.
Qyteti Stalin — 157, 161 Shqipëria e Jugut — 95, 162.
Shqipëria e Veriut — 162.
R
Radio Televizioni Shqiptar —
65-17
Romë, Perandoria Romake —
239, 255.
Rumani — 101, 116-117
Rusi — 302, 471.
RRE
-Rruga e Partisë» (revista ...)
— 59.
S
Serandë — 76.
Serbi — 94, 367. U
Sinkiang (Kinë) — 250.
Sistemi «Tejlor» — 313.
SMT, Shijak — 407.
Spanjë — 226, 273.
Suhum (BS) — 81.
SH
Shëngjergj (Tiranë) — 354.
Shkodër — 445.
TANJUG (Agjencia Telegra-
fike e Jugosllavisë së Re) —
77, 363.
Tiranë — 77, 112, 271, 266.
Traktati i Varshavës — 96, 99,
400.
Tregu i Përbashkët Evropian
— 99-100, 224, 278.
Turqi — 147, 278.
UDB (Drejtoria e Sigurimit
Shtetëror) — 371.
Uzina e Lëndëve Plastike, Lu-
shnjë — 265, 266.
Uzina e Përpunimit të Thellë
të Naftës, Ballsh — 180, 186.
Uzina e Polivinilkloridit, Vlo-
rë — 265, 266.

Uzina Mekanike Bujoësore,
Durrës — 458.

Uzina Mekanike, Qyteti Stalin
— 322.

V

Varrezat e Dëshmorëve të Ko-
mbit, Tiranë — 112.

Vaterlo (Belgjikë) — 302-303.

Velipojë (fusha ~), Shkodër
— 167.

«Vepra të zgjedhura» (K.
Marks — F. Engels, vëll. II)
— 292.

«Vepra të zgjedhura ushtara-
ke» (F. Engels, vëll. I dhe II)
— 299.

«Vjesnik» (gazeta ~) — 363,
365, 371.

Vlorë — 76, 265, 266.

«Vorio-Epir» — 6, 95.

Z

Zgërdhesh (Krujë) — 146.

«Zëri i popullit» (gazeta ~)
— 59, 66.

«Zëri i rinisë» (gazeta ~) —
59.

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 56-TË V—IX

1975

- TË DIFERENCOJMË ELEMENTËT QË KANË GABIME NGA ELEMENTËT ARMIQ E TRADHTARË — Nga biseda në takimim ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (7 nëntor 1975) 1—9
- PROJEKTI I KUSHTETUTËS DO TË PASQYROJË REALITETIN TONË SOCIALIST DHE DO T'I HAPË PERSPEKTIVA ATDHEUT — Fjala në mbledhjen e parë të komisionit të posaçëm për hartimin e projekt kushtetutës së RPSSH (17 nëntor 1975) 10—22
- NË GRUPET E KONTROLLIT PUNËTOR E FSHATAR TË VIHEN NJERËZIT MË TË AFTË, MË TË NDRSHËM E MË VIGJILENTË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (24 nëntor 1975) 23—26
- MË PARË EDUKIMI I NJERËZVE, PASTAJ MASAT ADMINISTRATIVE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (24 nëntor 1975) 27—42
- PUNA KRYESORE E BASHKIMEVE PROFESIONALE ËSHITË EDUKIMI — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (26 nëntor 1975) 43—54
- DISA MENDIME PËR FORCIMIN E SHTYPIT USH-

TARAK DHE TË PROPAGANDËS PËR MBROJTJEN NË SHITYP DHE NË RADIOTELEVISION — Disku- tim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (26 nëntor 1975)	55—75
PARTIA NA MËSON TË JEMI TË PATUNDUR NË MBROJTJEN E PARIMEVE — Nga biseda me një përfaqësues të PK të Australisë (m-1) (29 nëntor 1975)	76—82
SITUATAT NË BOTË JANË TË TURBULLTA. PRA- NDAJ NUK KA VEND PËR VETËKËNAQËSI, PËR QETËSI OSE PËR EUFORI — Nga biseda me një për- faqësues të PK të Australisë (m-1) (6 dhjetor 1975)	83—103
NDAJ ARMIQVE DUHET MBAJTUR QËNDRIM I PRERË DHE TË MOS HYHET NË PAZARLLËQE ME TA — Nga biseda me princin Norodom Sihanuk (9 dhjetor 1975)	107—115
NË MARRËDHËNIET ME TË TJERËT NE JEMI KO- RREKTË, VIGJILENTË E GJAKFTOHTË — Nga bi- seda me princin Norodom Sihanuk (15 dhjetor 1975)	116—123
PLENUMET E KOMITETEVE TË PARTISË TË RRE- THEVE TË VIHEN PLOTËSISHT NË ROLIN UDHË- HEQËS — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 dhjetor 1975)	124—126
TË MOS DOBËSOHET ROLI UDHËHEQËS I PAR- TISË NË ORGANET E PUNËVE TË BRENDSHME NËN PRETEKSTIN SE ÇËSHTJET E TYRE JANË SEKRETE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 dhjetor 1975)	137—144
NGRITJA E MUZEUT TË SKËNDERBEUT ËSHTË NDRËMARRJE DELIKATE DHE KOMPLEKSE — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (23 dhjetor 1975)	145—150
PLANI ËSHTË REAL, TË MOBILIZOHEMI TË GJI-	

THE PER REALIZIMIN E TIJ — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 dhjetor 1975)	151—150
NË DALLIMET NË NIVELIN E JETESËS SË PUNONJËSVE TË FSHATIT E TË QYTETIT TË ECIM DREJT MBYLLJES SË GËRSHËRËS --- Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 dhjetor 1975)	191—296
ORGANET E PROKURORISË DHE TË HETUESISË TË QËNDROJNË NË LARTËSINË E DETYRAVE — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Populler të RPSH (27 dhjetor 1975)	207—211

1976

ZIGZAGET E VIJËS KINEZE — Shënime (1 janar 1976)	215—235
DISA PROBLEME TË STUDIMIT DHE TË SHKRI-MIT TË HISTORISË SË LASHTË TË POPULLIT TONË — Shënime (20 janar 1976)	234—248
MËSIMET E PARTISË I KALITIN DHE I AFTËSOJ-NË KUADROT TË KRYEJNË SA MË MIRË DETY-RAT — Nga biseda me shogën Lenka Çuko (22 janar 1976)	247—283
KINEZËT NUK PROPAGANDOJNË VIJËN E DREJ-TË TË PARTISË SONË — Shënime (22 janar 1976)	278—282
ZËNIA E NJERËZVE ME PUNË — PROBLEMI KRYESOR PËR ZHVILLIMIN E FORCËVE PRO-DHUESE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (23 janar 1976)	283—293
KUADROT E DALË NGA SHKOLLAT USHTARAKE T'I PËRGATITIM EDHE SI TEKNIKË, EDHE SI	

EDUKATORE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (30 janar 1976)	294—317
EDHE NGA GURI MUND TË NXIRRET GRURË, NË QOFTË SE KUPTOHET DREJT RRETHIMI IMPERIALISTO-REVIZIONIST — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (30 janar 1976)	318—336
BAZA KA NEVOJË PËR NDIHMË KONKRETE — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (31 janar 1976)	337—340
TË JEMI TË VËMENDSHËM NË MARRJEN E VENDIMEVE — Nga diskutimi në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (31 janar 1976)	341—345
PËR PUNËTORIN E PARTISË ËSHTË I DOMOSDOSHËM STUDIMI I VAZHDUESHËM PËR NGRIJTJEN E NIVELIT PROFESIONAL E KULTUROR — Diskutim në organizatën-bazë të Partisë (5 shkurt 1976)	347—357
SA MË SHUMË TË DINË KOMUNISTËT, AQ MË MIRË ËSHTË PËR PARTINË, PËR POPULLIN — Nga biseda me disa anëtarë të organizatës-bazë të Partisë (5 shkurt 1976)	358—362
INTERVISTË VETËDEMASKUESE E TITOS — Shënime (6 shkurt 1976)	363—376
KONKLuzionet janë të sigurt kur dalin nga të dhëna të sakta — Nga biseda me shokun Pali Miska (19 shkurt 1976)	377—385
PLANIN E RI PESËVJEÇAR DUHET TA HARTOJMË DUKE U BAZUAR NË FORCAT E NË MUNDËSITË TONA EKONOMIKE, NJERËZORE E TEKNIKE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 shkurt 1976)	386—421
MATERIALET PËR UDHËHEQJEN DUHET TË VIJ-	

<p>NË TË PËRGATITURA MIRË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 shkurt 1976)</p>	422—425
<p>PO NUK PATI PARTIA THEMELI TË FORTA, NUK MBAHET «ÇATIA» — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 shkurt 1976)</p>	426—447
<p>ORGANIZIMI DHE KONTROLLI TË JENË NË NJË SHKALLË TË LARTË EDHE NË NDËRTIM — Bisedë me shokët Ilaki Toska dhe Shinasj Dragoti (10 mars 1976)</p>	446—466
<p>ÇFARË E NDIHMON DHE ÇFARË NUK E NDIHMON SIGURIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E VËRTETË TË BALLKANIT — Artikulli i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (23 mars 1976)</p>	467—472
<p>Treguesi i lëndës</p>	475
<p>Treguesi i emrave</p>	489
<p>Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera</p>	493